

**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP**

**STUDIME
ALBANOLOGJIKE**

14

Shkup, 2016

*Kryeredaktor
Prof. Dr. Qemal Murati*

*Redaksia
Prof. Dr. Qemal Murati
Dr. Naim Halimi
Dr. Izaim Murtezani
Dr. Bukurije Mustafa
Dr. Besnik Emini*

*Sekretar i redaksisë
Dr. Besnik Emini*

*Adresa e redaksisë:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
Kutia Postare nr. 171
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë*

*Adresa elektronike:
studimealbanologjike@yahoo.com
studimealbanologjike@itsh.edu.mk*

ISSN 1857-6958
UDK 930.85
COBISS.MK-ID 82595850

PËRMBAJTJA**STDUDIME DHE ARTIKUJ***Rami MEMUSHAJ*

KOMISIA LETRARE E SHKODRËS 100 VJET MË PAS.....9

Qemal MURATI

KOMISIA LETRARE SHQIPE (1916-1918) NGA PERSPEKTIVA E SHQIPES SË SOTME.....13

Hidajete AZIZI

HIPOKORISTIKA NË ANTROPONIMI.....21

Haredin XHAFERI

TOPONIMIA E TOMORICËS.....33

Xhevat LLOSHI

MARRËDHËNIET E LËVIZJES PROTESTANTE ME RILINDJEN KOMBËTARE.....51

Riza SADIKU

HASAN KALESHI PERSONALITET ME FAMË BOTËRORE, POR I MARGJINALIZUAR NGA INSTITUCIONET SHKENCORE.....61

Muharrem BAZDUL

GJYSMË SHEKULLI I “GJENERALIT TË USHTRISË SË VDEKUR”.....71

GONXHE BOJAXHI DHE FLETORJA E FSHEHTË ME POEZI.....77

Genciana ABAZI - EGRO

LETËRSIA NË PROCESIN E FORMIMIT TË KOMBIT TE SHQIPTARËT.....81

Skifter KËLLIÇI

NJË LEXIM NDRYSHE I “LAHUTËS SË MALCIS”.....89

Mirlinda KRIFCA BEQIRI

“NJË SAGË E VOGËL” – E EROSIT DHE THANATOSIT.....122

Isamedin AZIZI

BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMITETIT TË KOSOVËS DHE
KOMITETIT MAQEDONAS 1918-1920.....**131**

Nelson R.ÇABEJ

KOMBI SHQIPTAR DHE FANTAZMA E “KOMBIT KOSOVAR”.....**139**

*Millovan GJILLAS: SHQIPTARËT JANË AUTOKTONË DHE POPULLI
MË I VJETËR I BALLKANIT*.....**145**

Dorian KOÇI

IDENTITETI FETAR E KOMBËTAR I SHQIPTARËVE ORTODOKSË
TË REKËS.....**149**

Fauzi SKENDERI

VEÇORITË DEMOGRAFIKE TË KOMUNËS SË BËRVENICËS.....**155**

Naim HALIMI

DISA DOKE TË LINDJES E RITE TË VDEKJES NË ANËN E
KUMANOVËS.....**171**

Jeton DOKO

NJË DOKUMENT MAQEDONAS KU PËRSHKRUHET SITUATA
POLITIKE TE SHQIPTARËT NË OHËR ME RRETHINË.....**177**

Arsim SINANI

PËRNDJEKJA E FAMILJES DERALLA NGA TETOVA.....**181**

Petro MARKO

Ç’JEMI NE?.....**189**

Robert DUNIER

FSHATARËT ORTODOKSË SHQIPTARË NË GREQI NË VITIN
1912.....**193**

Faik KONICA

BORIS SARAFOV - CA KUJTIME DHE CA MENDIME.....**197**

Robert ELSIE

NJË VJEDHJE NË DUBROVNIK DHE DALJA NË SKENË E GJUHËS
DHE E KULTURËS SHQIPTARE.....**203**

Miron ÇAKO
 VESHJA, SHPREHJE E DINJITETIT NJERËZOR.....209

Abla XHAFERI
 KONSIDERATA PËR LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ
 FËMIJËVE.....213

RECENSIONE

NJË FJALOR ME GJUHËN SHQIPE NË BULLGARI (Hajri SHEHU)..223

STUDIM MONOGRAFIK PËR AREALET GJUHËSORE TË
 RAHOVECIT (Qemal MURATI).....227

NJË “TAPI” PËR SHKUPIN ME RRETHINË NDËRMJET DY
 LUFTËRAVE BOTËRORE (*Skender Asani, Shkupi ndërmjet dy luftërave
 botërore, I-II, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2015, f. 1048*) (Nuridin
 AHMETI).....232

ETNOGJENEZA SHQIPTARE E REKËS SË EPËRME

*Branko Manojlovski “Reka e Epërme dhe fshati Kiçinicë”, “Tringa
 Desing”, Tetovë, 2016*) (Metush SULEJMANI).....235

POLLOGU NË DRITËN E FAKTEVE DHE DOKUMENTEVE
 HISTORIKE

(*Zeqirja Idrizi, Treva e Pollogut në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899-
 1913, Tetovë, 2007*) Miftar KURTI.....239

KRONIKA SHKENCORE

Gjuha shqipe në një konferencë për gjuhësinë e korpuseve (Rami
 MEMUSHAJ).....239

KRONIKË PËR PUNËN SHKENCORE TË ITSHKSH GJATË VITIT
 2016 (Sefer TAHIRI).....250

STUDIME DHE ARTIKUJ

RAMI MEMUSHAJ**KOMISIA LETRARE E SHKODRËS 100 VJET
MË PAS**

Këto ditë u mbushën njëqind vjet nga krijimi i institucionit të parë të planifikimit të gjuhës shqipe, Komisioni Letraro, e cila e nisi veprimtarinë e saj në Shkodër më 1 shtator 1916. Ndonëse për të është shkruar jo pak, disa aspekte të jetës dhe të veprimtarisë së saj nuk janë ndriçuar sa duhet, si çështja se kush e krijoi, cili ishte statusi i saj, ç' vend zë veprimtaria e saj në planifikimin gjuhësor të shqipes dhe cilat janë mësimet që duhen nxjerrë nga arritjet dhe mosarritjet e Komisionit.

Lidhur me atë se kush e krijoi Komisionin Letraro, disa autorë themelues të saj quajnë Luigj Gurakuqin, Gjergj Fishtën etj., nisma e të cilëve u mbështet nga komanda austriake; autorë të tjerë ia njohin këtë meritë Luigj Gurakuqit, që ishte në krye të drejtorisë së arsimit. Po cila është e vërteta?

Para se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, le të sjellim në kujtesën e lexuesit se në janar 2016 Shqipëria e Veriut dhe e Mesme deri në Vjosë u pushtua nga ushtria austro-hungareze, e cila Shkodrën e bëri qendër administrative ku u vendos komanda e korparmatës dhe administrata civile, e përbërë nga shqiptarë. Austro-Hungaria ishte një perandori që, me kushtetutë, u kishte dhënë kombeve të sunduara të drejta që njihen me emrin *Kultusprotektorat* (protektorat kulturor), nga të cilat përfituan edhe shqiptarët. Pavarësisht nga synimet e largëta politike të Austro-Hungarisë, dhënia e vetëqeverisjes, liritë kulturore, lejimi i mësimin të gjuhës shqipe në shkollë dhe i përdorimit të saj në administratë, nuk mund të mos vlerësohen si të drejta që shqiptarët i fitonin për herë të parë në historinë e tyre. Kjo nuk kishte ndodhur nën Perandorinë Otomane, e cila, që nga fillimi e derisa u shemb, i trajtoi shqiptarët si një popull i ndaluar.

Nga dokumentet e kohës merret vesh se roli i komandës austriake të pushtimit ishte vendimtar jo vetëm për kushtet që krijoi për mësimin e shqipes në shkollë dhe përdorimin e saj si gjuhë e administratës, po edhe për nxitjen e drejtpërdrejtë të intelektualëve shkodranë që të krijonin Komisionin. Këtu duhet pasur parasysh se në Shkodër në ato vite vepruan figura të shquara të jetës politike e kulturore të Austrisë, si konsulli i përgjithshëm August fon Kral, njohës i mirë i Shqipërisë; intendent i përgjithshëm profesor Mariano San Nicolò, historian i së drejtës etj. Ishte pikërisht konsulli austriak ai që u sugjeroi më 1916 Luigj Gurakuqit, Ndre Mjedës, Mati Logorecit dhe Gjergj Fishtës të vendosnin “në lidhje me çështjen e përdorimit zyrtar të drejtshkrimin, si dhe për të nxitur botimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe”.

Rolin e austriakëve në themelimin dhe mbarëvajtjen e Komissisë e vërtetojnë një numër aktesh zyrtare të komandës së korparmatës. Kështu, Komisia u themelua me vendimin nr. 737, datë 30 korrik 1916, të komandës së lartë ushtarake austro-hungareze në Shqipëri. Kjo pohohet në statutin e saj, ku thuhet: “Mbas urdhnit të Komandës së Naltë në Shqipni po themelohet në Shkodër një komisi letrare shqiptare”; për vetë statutin, në vendimet lexojmë se “Komisija pëlqen e pranon shtatutin e përgatitun prej mâ të Naltës Komandë në Shqipni...” Madje, edhe rregullat e ortografisë u miratuan nga komanda e lartë ushtarake me urdhrin e saj të 24 shkurtit 1917. Më në fund, që themelimi i Komissisë ishte meritë e austriakëve, këtë e dëshmon edhe ajo që ky institucion pati aq jetë sa zgjati pushtimi austriak në Shqipëri.

Roli vendimtar i austriakëve pranohet dhe në “Historinë e Shqipërisë” (1965, 1984), në të cilën thuhet se “për të mos shkaktuar kundërshtimin e hapur të shqiptarëve, ata (austriakët – R. M.) filluan të vinin në zbatim në Shqipëri politikën e tyre të autonomisë kulture-kombëtare që ndiqnin kundrejt popujve të tjerë të shtypur të perandorisë, ngritën flamurin shqiptar, hapën shkollat shqip, formuan “Komisinë letrare” për lavrimin e gjuhës shqipe, organizuan administratën me nëpunës shqiptarë, por nën kontrollin e plotë të tyre” (1965). Të njëjtën pikëpamje kanë edhe studiuesit e huaj Maksimilian Lamberg, Robert Elsi e Noel Malkolm. Lambergci, që pati qenë një ndër anëtarët e huaj të Komissisë, në gramatikën e tij të gjuhës shqipe (1958) thotë se “nismëtar i saj ishte komisar i për çështje civile vendore dhe njëheri konsull i përgjithshëm August Ritter fon Kral”. Edhe R. Elsi thotë se Komisia “u ngrit nga austro-hungarezët me sugjerimin e konsullit të përgjithshëm August fon Kral për të vendosur mbi çështjet e drejtshkkrimit të gjuhës për përdorim zyrtar dhe për të nxitur botimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe”. Kurse historiani anglez N. Malkolm shkruan: “Autoritetet austriake i emëruan shqiptarët (e Kosovës – R. M.) në pushtetin lokal, lejuan përdorimin e gjuhës shqipe në vendin e tyre të punës dhe ndihmuan në hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Një politikë e tillë u zbatua edhe në Shqipërinë e Veriut dhe në Shqipërinë e Mesme, më 1916. Në këto anë austriakët hapën dy shkolla normale shqipe dhe formuan një “Komision Letrar Shqiptar” për të standardizuar ortografinë dhe për të botuar libra shqip në botime të lira e të popullarizuara.”

Duke e paraqitur themelimin e Komissisë Letrare si vepër të austriakëve, nuk ua mohojmë aspak meritat patriotëve shqiptarë, të cilët, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara, arritën që brenda pak muajsh të japin të parin projekt ortografie të gjuhës shqipe dhe të bëjnë punë aq të vyera për gjuhën tonë.

Edhe për çështjen e statusit të Komissisë mendimet e studiuesve ndahen: për disa ajo luajti rolin e një kongresi gjuhësor, për disa të tjerë rolin e një komisioni gjuhëtarësh. Në këtë pikë, të drejtë kanë ata autorë që shohin tek ajo një institucion shkencor kombëtar, që u krijua për të zgjidhur një varg detyrash. Kjo krijesë që kishte një seli, një statut e një rregullore të brendshme dhe anëtarë “të paguem” e “të papaguem”, të cilët për gati dy vjet mbledheshin disa herë në javë për të kryer detyrat që u qenë ngarkuar, nuk mund të ishte kongres a komision, po një institut gjuhësie.

Naturën e vërtetë të Komissisë e dëshmon vetë rrethi tepër i gjerë i çështjeve me të cilat u mor. Zgjedhja e dialektit që do të ishte si “urë në mes të dy dialekteve” për “gjuhën e përgjithtë” a “të përbashkme”, hartimi i rregullave të drejtshkrimit, puna me terminologjinë, botimi i librave mësimorë e letrarë, këshillimi gjuhësor dhe përkthimet përbëjnë një problematikë shumë më të gjerë madje edhe nga ajo që mbulojnë sot institutet shqiptare të gjuhësisë. Këto detyra nuk mund t’i zgjidhte një kongres a një komision. Një kongres mund të vendoste për çështjen e bazës dialektore të gjuhës letrare dhe të miratonte një projekt drejtshkrimi të hartuar paraprakisht; një komision, që do të mblidhej disa herë në vit, mund të diskutonte çështje të veçanta, po të gjitha detyrat e mësipërme mund t’i merrte përsipër vetëm një institucion.

Kjo veprimtari e gjerë e Komissisë në dy vjet jetë të saj përbën një trashëgimi të vyer, studimi i së cilës është me rëndësi të veçantë për teorinë e planifikimit gjuhësor. Komisia e nisi punën aty ku e la Kongresi i Manastirit, alfabeti i njësuar i të cilit shënoi përmbylljen e fazës së parë të planifikimit të gjuhës sonë. Veprimtaria e Komissisë shënon fillimin fazës së dytë të planifikimit, kodifikimin e normave të saj, që u përmbyll me Kongresin e Drejtshkrimit. Në veprimtarinë e Komissisë Letrare do të gjejmë në embrion të gjitha hallkat e fazës së dytë: *zgjedhjen* e bazës dialektore të gjuhës letrare, *ndërtimin* e kodit drejtshkrimor dhe *zbatimin* e këtij kod, çka pasqyrohet në urdhrin e komandës austriake për zbatimin e ortografisë në administratë, në botimet, në shkollë etj.

Ky urdhër është dekreti i parë për gjuhën në historinë e shqipes, që do të pasohet edhe nga dy dekrete të tjera, ai i vitit 1923 dhe i vitit 1974. Fakti që dekrete për shqipen janë lëshuar në tri kohë të ndryshme, dëshmon se ndërhyrja e autoritetit shtetëror nuk është arbitrare, sikundër mëtohet prej disave këtu e në Kosovë, po pjesë e planifikimit gjuhësor. Edhe në ditët tona, për zbatimin e normave gjuhësore në ligjërimin e shkruar e të folur ndihet nevoja e ndërhyrjes e të dy shteteve tona, ashtu siç kanë bërë gjatë shekullit të kaluar qeveritë shqiptare.

Puna e Komissisë Letrare për shqipërimin e terminologjisë dhe pastërtinë e gjuhës, që u vijua nga Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë në Tiranë dhe Instituti Albanologjik në Prishtinë, në këta tre dhjetëvjetëshat e fundit është fashitur, ndërkohë që kjo punë duhet të jetë e pandërprerë, sidomos po të kemi parasysh që, me rënien e perdes së hekurt, leksiku dhe strukturat sintaksore të shqipes po ndikohen shumë nga gjuhët me prestigj të Europës, duke bjerrë karakterin popullor dhe origjinalitetin e saj.

Është jo pa interes të kujtojmë se në “Statutin e përkohshëm” të Komissisë, thuhet se ajo do të kishte edhe “*rangun e një këshilli* ndër çashtje e ndër pyetje që i përkasin mësimin botnuer”. Pra, funksioni i këshillimit gjuhësor ishte një funksion i dytë që i njihte Statuti Komissisë. Por kjo përvojë çmuar e një shekulli më parë është shpërfillur dhe, si rrjedhim, instituteve tona të gjuhësisë u ka munguar dhe u mungon sektori i këshillimit gjuhësor, i cili sot është bërë shumë i nevojshëm, për shkak të shtimit të numrit të aktorëve të përfshirë në ligjërimin publik.

Mësime duhen nxjerrë edhe nga dështimi i Komissisë Letrare për sa i përket zgjedhjes së elbasanishtes si bazë e gjuhës letrare, e cila në periudhën midis dy luftërave u përdor vetëm si gjuhë e administratës, po nuk u pranua nga autorët

shkodranë, ndër ta dhe anëtarë të Komissisë, dhe as nga autorët toskë. Shkaku kryesor i këtij dështimi që se si bazë e gjuhës letrare u zgjodh një variant pa traditë letrare, kur ekzistonin dy variante letrare me prestigj (toskërishtja letrare dhe shkodranishtja letrare). Po të kishte qenë rrethi i vendimmarrësve më i madh dhe me përfaqësim më të gjerë krahinor, ndoshta që atëherë do të ishte arritur në një zgjidhje tjetër të pranueshme nga gegët dhe toskët.

Për fat të keq, ky gabim në fillimet e planifikimit të gjuhës shqipe, po përsëritet në ditët tona nga Këshilli Ndërkademi, që ka një përfaqësim të ngushtë krahinor dhe shumicën e anëtarëve me ndihmesa të pakta ose të aspakta për sipërmarrjen në të cilën janë thirrur të jenë aktorë. Reforma e drejtshkrimit dhe ndryshimet e normave të tjera të gjuhës të propozuara nga ky Këshill po kundërshtohen gjerësisht, pikërisht sepse në to duket hapur përpjekja e frymëzuar jo nga arsye shkencore për ta përmbysur bazën e gjuhës standarde, duke ia ndërruar asaj tingëllimin, drejtshkrimin dhe morfologjinë. Por, ashtu si ndodhi me të folmen e Elbasanit, që nuk u bë dot gjuhë letrare, edhe kjo reformë nuk do të zbatohet, sepse nuk është e diktuar nga nevoja e vetë gjuhës për ndryshime, po nga nevoja e disa gjuhëtarëve për ta ndryshuar atë. Megjithatë, puna e tyre dëmin ka filluar ta bëjë, duke sjellë si pasojë të parë një rënie të dukshme të kujdesit për pastërtinë e gjuhës dhe për zbatimin e normave të saj.

QEMAL MURATI

KOMISIA LETRARE SHQIPE (1916-1918) NGA PERSPEKTIVA E SHQIPES SË SOTME

Në 100-vjetorin e themelimit të Komissisë Letrare Shqipe në Shkodër

KLSH me zgjidhjet për një gjuhë shkrimi të përbashkët që ofroi, i dha vulën më pas edhe Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Hipotetikisht, edhe sot po të ishte formuar, ta zëmë, një Komisi Letrare për caktimin e bazës dialektore të shkrimit të shqipes së përbashkët, rezultati do të ishte po ai që ka dhënë KLSH një shekull më përpara. E po kështu mund të thuhet edhe për Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, i cili jo vetëm që nuk ndryshon në thelb nga KLSH, por është binom i KLSH.

Më 1 shtator 1916 në Shkodër, me nismën e Akademisë së Shkencave të Vjenës, filloi veprimtarinë e vet *Komisia Letrare Shqipe*, 8 vjet pas njësimit të alfabetit të përbashkët të gjuhës shqipe më 1908 në Manastir. Dhe kështu hidhet edhe një hap tjetër i rëndësishëm për standardizimin e gjuhës shqipe. Kjo ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme për kulturën shqiptare në përgjithësi e të gjuhësisë në veçanti, si themelvënëse e rrugës së gjatë të njësimit të gjuhës shqipe. Është institucioni i parë që hartoi "*Rregulla mbi ortografinë e gjuhës shqipe*", dhe, kësajsoj, dha kodifikimin e parë të drejtshkrimit tonë, në të cilën u vendos që gjuha standarde shqipe të jetë gjuha letrare e normëzuar mbi të folmen e Elbasanit. Ky vendim u sanksionua edhe me "Fletoren zyrtare" të Shqipërisë më 1923, pasi që kishte marrë edhe miratimin në Kongresin Arsimor të Lushnjës më 1920. Në këtë Kongres qe njësuar edhe terminologjia që do të përdorej në tekstet shkollore. Tani edhe studimi i strukturës gramatikore të gjuhës shqipe bëhej, kryesisht, mbi këtë bazë. Mund të thuhet se shumica e gramatikave që u botuan në periodën e Pavarësisë ishin në mbështetje të plotë të vendimeve të Komissisë Letrare Shqipe të Shkodrës. Mbi këto baza qenë edhe të gjitha gramatikat e Aleksandër Xhuvani, të hartuara për shkollat fillore dhe të mesme. Megjithëkëtë, nuk mungonin as gramatikat që botoheshin mbi bazën e së folmes së Shkodrës ose mbi variantin letrar të toskërishtes (Fadil Raka, *Çështje të mjeteve kodifikuese të shqipes, "Filologji"* 11).

Kongresi i Manastirit (1908) dhe Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916-1918) pa dyshim janë dy arritjet më të mëdha të gjysmës së parë të shekullit XX, sepse Kongresi njësoi alfabetin, ndërsa Komisia kodifikoi për herë të parë

drejtshkrimin e gjuhës letrare, terminologjinë shkollore e administrative me bazë elbasanishten, a dialektin e gegërishtes jugore lindore. Komisia e çoi më përpara njësimin e gjuhës letrare dhe kodifikimin e drejtshkrimit të saj, duke i afruar më shumë të dy variantet letrare. Në vijim të Kongresit të Manastirit, Komisia do të pranonte në rregullat drejtshkrimore grupet e bashkëtingëlloreve të toskërishtes si: **mb, nd, ng, ngj**, dyzanorshin **ua** në vend të **u** (*duar/dur, u fillua/fillu*), do të mbahej zanorja **ë** e patheksuar për ruajtjen e formave të fjalëve etj. Sipas qëndrimit të Komisisë, siç theksohej për shkrimin e Ë-së paratheksore ose pastheksore (“menjiherë përpara ose menjihërë mbrapa rrokës së theksueme” - siç shkruanin), Ë-ja do të shkruhet ashtu sikur përdoret në toskërishten “dhe si asht me arrësye mbas ethymologisë” (*vëlla, përrue; mollë, mirë* etj.). Në këtë mënyrë, drejtshkrimi i standardit të sotëm filloi të merrte trajtën e njësuar në përmasa kombëtare (Rrokaj 2016: 63).

Në thelb, te parimet dhe rregullat që kishte vendosur KLSH, e ka bazën edhe Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, gjysmëshekulli më vonë (1972), që prodhoi “standardin si gjuhë e rrafshët” (term i shqipëruar nga gjuhëtari Ruzhdi Stringa, në përfaqje me termin e përhapur për gjuhën angleze “*plain English*” fr. *anglais courant* “anglishtja e zakonshme”), paçka se standardi i sotëm shihet gabimisht nga disa gjuhëtarë e pseudogjuhëtarë krahararë si produkt i regjimit dirigjist. Këtë e pohonte shprehimisht edhe gjuhëtari Bahri Beci në fillim të fjalës së tij në Kongresin e gjuhës shqipe (1972):

“Rregullat e drejtshkrimit të shqipes” (projekt), botuar më 1967, kanë ruajtur dhe zhvilluar më tej në radhë të parë parimin themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe të formuluar që më 1917 në Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej Komisis Letrare” (Beci 1974: 157).

Komisia Letrare Shqipe që një nismë e organizuar me themel e me pjesëmarrje të autoriteteve të larta të filologjisë, figura të shquara të gjuhësisë dhe të kulturës shqiptare: dr. Gjegi Pekmezi (kryetar; një vit më vonë këtë detyrë e mori Luigj Gurakuqi), Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Mati Logoreci, Ambroz Marlaskaj, Hilë Mosi, Luigj Naraçi, Anton Paluca, Ali Korça, Aleksandër Xhuvani, Vinçenç Prendushi, Sali Nivica, Josif Haxhimima, Maximilian Lambertzi dhe Rajko Nachtigalli.

Një ndër objektivat themelore të Komisisë ishte që të njësonte drejtshkrimin, i cili do të shërbente si një hallkë për njësimin e gjuhës standarde shqipe.

Për krijimin e një varianti standard duhej të merret për bazë një dialekt

Mjaft peshë në Komisi pati mendimi i kryetarit të saj Gj. Pekmezi, sipas të cilit *për krijimin e një varianti standard të shqipes, midis të tjerash, duhej të merrej për bazë një dialekt e prej këtij të krijohej një skelet i cili do të mvishej e do të zbkurohej më pas me frazeologjinë dhe leksikografinë e tërë dialekteve të tjera* (Myrta 2014: 11).

Dr. Gjergj Pekmezi kishte botuar veprën më të rëndësishme të asaj kohe “*Gramatika e gjuhës shqipe*” (1908). Në këtë vepër, e cila dëshmon studimet më

themelore, autori erudit nuk ka ofruar vetëm mjetin ndihmës shumë të vlefshëm për mësimin praktik të gjuhës, por ka bashkuar në mënyrë shumë mësimdhënëse rezultatet e deritanishme të studimit gjuhësor. Duhet theksuar veçanërisht në mënyrë lavdëruese se Dr. Pekmezi ka trajtuar si dialektin toskë ashtu edhe atë gegë në një mënyrë që mund të quhet si shumë e arritur. Askujt, i cili merret me studimet e gjuhës shqipe, nuk mund t'i mungojë kjo vepër themeltare (Ziberçi 2015:6), hartuar nga një gjuhëtar me dije të hollë filologjike dhe njohës i shkëlqyer i dialekteve të shqipes dhe të Elbasanit.

Përse u zgjodh për bazë të shqipes së përbashkët të shkrimit pikërisht e folmja e Elbasanit dhe jo ndonjë e folme tjetër dialektore?

“Dialekti i Elbasanit është bashkim natyral i dy dialekteve të mëdhenj: toskërishtes dhe gegnishtes. Në pikëpamje morfologjike dialekti i Elbasanit është toskërisht, dhe në pikëpamje fonetike është gegënisht” (Et’hem Haxhiademi, “*Gjuha letrare: të preferohet dialekti i Elbasanit*”, gazeta “Tomorri”, 1940).

Pra, arsyet janë në radhë të parë të rendit filologjik, e jo të natyrës politike a kraharariste, siç i ngatërrojme punët sot. E folmja e qytetit të Elbasanit e gegërishtes jugore lindore karakterizohet nga një qëndrueshmëri e theksuar fonetike e gramatikore dhe afron me të folmet e toskërishtes veriore më shumë se me të folmet e krahut të gegërishtes jugore perëndimore, në të cilat vihet re një zhvillim relativisht i madh i sistemit vokalik (Çeliku 1968: 134).

Gjuha letrare shqipe me bazë elbasanishten, që ishte zbatuar tashmë për 30 vjet në Shqipëri (nga 1916 deri në vitin 2046), dhe 50 vjet në Kosovë dhe në trojet e tjera jashtë Shqipërisë, si një dialekt kompromisi midis toskërishtes dhe gegnishtes, nuk u injorua dhe nuk u ndalua arbitrarisht nga Ministria e Informacionit dhe Propagandës, që drejtonte Sejfulla Malëshova, më 1946, dhe nuk u imponua me dhunë ligjërimi i toskërishtes në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), siç shprehet dikush (Shefqet Deliallisi). Në fakt, nga kleri katolik Fishta...

Komisia Letrare Shqipe e themeluar në Shkodër, për zhvillimin e përmirësimin e gjuhës e të letërsisë sonë, pranoi si themel të një gjuhe të përbashkët dialektin e Elbasanit, por, veç kësaj, më të shumtët e dijetarëve dhe albanologëve ishin prapë të këtij mendimi: që dialekti i Elbasanit të merret si bazë për një gjuhë shkrimi, por natyrisht i përmirësuar e i qëruar.

Shqipja e sotme letrare dhe drejtshkrimi i saj, ligjëruar në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), bazën e saj e ka pikërisht tek toskërishtja letrare veriore, krejt e afërt me format e gegërishtes jugore lindore të arealit të Elbasanit që kishte caktuar KLSH. Pra, në elementet thelbësore mund të thuhet se Kongresi i Drejtshkrimit nuk dallon aspak nga vendimet e *Komisionit Letrare Shqipe*, paçka se ky Kongres anatemohet primitivisht si të ishte produkt i diktaturës (!)

Androkli Kostallari, që konsiderohet si projektuesi i Kongresit të drejtshkrimit të shqipes, gjatë diskutimit të rregullave të drejtshkrimit me mësuesit e Beratit, më 1967, se mbi ç’baza do të bëhej njësimi i gjuhës shqipe, është shprehur se: *gjuhë letrare do të ishte toskërishtja, duke marrë edhe elemente të gegërishtes*. Dhe për këtë qëllim solli disa shembuj si fjalët me prapashtesën *-ues* të gegërishtes, që kishte zevendësuar prapashtesën *-onjës* të toskërishtes, (*mësues* për *mësonjës*, *punues*, për *punonjës*), si edhe fjalët e kahershme që ishin futur në toskërishte,

huazuar nga gegërishtja, si *ranishte* e jo *rërishte*, zanafillë e jo *zërafillë*, e *folme* dhe jo *folur*, *domethënë*, pra, me paskajoren e gegërishtes: do+methënë) etj.

KLSH dhe çështja e paskajores

Parimin e drejtë filologjik që ngrinte Faik Konica se “*Një gjuhë letrare formohet duke studiuar mirë gjuhën e popullit*”, Komisia Letrare Shqipe e përvijoi më së miri, duke u marrë edhe me studimin e gjuhës në terren, e natyrisht duke i kushtuar vëmendje edhe çështjes së të ashtuquajturës *paskajore*. Linguisti i njohur slloven Rajko Nahtigal, i cili ishte përfshirë në gjirin e Komisionit Letrare Shqipe si njohës i mirë për çështjen e gjuhës letrare, dhe bashkë me Gjergj Pekmezin, Kryetar i Komisionit, dhe Ndre Mjedën, kishin realizuar një ekspeditë hulumtuese në Elbasan në vitin 1917 për të dhënë një mendim më të saktë lidhur me propozimin që bazë e gjuhës së përbashkët letrare shqipe të bëhej e folmja e Elbasanit dhe e rrethinave të tij. Nahtigal në Raportin e tij të punës, për sa i përket çështjes së futurit, jepte këto konsiderata:

“Për relacionin në mes gegërishtes dhe toskërishtes më në fund ka rëndësi edhe formimi i futurit. Të dy format (*do* me lidhore dhe *kam* me paskajoren) mund t’i gjejmë pak a shumë kudo dhe mund të kenë bile edhe një kuptim të ndryshëm, por megjithatë nuk duhet të dyshojmë se formimi me *kam* në radhë të parë është gegnishte e veriut kurse ai me *do* është toskërishte. Në Elbasan dominon kjo e fundit dhe me këtë tregohet se pozicioni që ka në mes të vendit i jep pozitën ndërmjetësuese edhe në çështjet gjuhësore” (Nahtigal 2015: 39).

Gj. Pekmezi jep si formë kryesore për Elbasanin të ardhmen me **do**. Për kohën e ardhshme forma kryesore, zotëruese, që përdoret në gegërishten jugore është forma me **do+lidhore**. E ardhmja me **do+lidhore** duhet vështruar si formë zotëruese, jo vetëm në të folmet e Jugut dhe në të folmet veriore që ndodhen mbi lumin Drin, siç pohon J. Gjinari, por edhe në gegërishten jugore. Me një fjalë, **do+lidhore** është forma zotëruese në tërë shqipen (Çeliku 1968:130). Studimet e shumta dialektore kanë dëshmuar se trajta e së ardhmes me **do**, nuk është vetëm e toskërishtes, por edhe e gegërishtes, madje ajo gjendet edhe te arbëreshët e Italisë.

Infinitivi gegë (**me punue**) ekziston në shumicën e të folmeve, por ka një përdorim shumë të vogël, madje në ato të folme që kanë tipare gege, përdoret më shumë si folje, kallëzues i një fjalie qëllimore, kundrinore: *do të shkoj me punuar, desha me dal* etj. (Gjinari 2003:156).

Pra, ishte realiteti gjuhësor ai që përcaktoi në lënien jashtë të paskajores gege si në Komisionin Letrare Shqipe (1916-1918) e si më vonë në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), dhe jo sundimi dirigjist!

Nga ana tjetër, toskërishten letrare si gjuhë zyrtare, shumë e afërt me të folmet e gegërishtes jugore lindore të Elbasanit, nuk e imponoi dhe sforcoi pushteti komunist pas vitit 1945, sepse ajo ishte krijuar si e tillë prej kohësh.

Koinéja e toskërishtes veriore – lloji mbidialektor i folur i komunikimit për një regjion të gjerë dialekti, ka ndodhur jo në kohën e regjimit komunist të Hoxhës dhe jo me urdhër të regjimit dirigjist, por qe rezultat i proceseve brendagjuhësore dhe i

përpunimit në shkallë më të lartë të gjuhës së shkrimit shumë kohë më përpara, nga një plejadë e tërë shkrimtarësh e veprimtarësh si: Naim Frashëri, Sami Frashëri, Mati Logoreci, Fan Noli, Faik Konica, etj.

I pari dijetar që zhvilloi konceptin e filologjisë ballkanike, Profesori i Lajpcigut *Gustav Weigand*, që e mësoi shqipen më së pari si toskërishte në Manastir, pastaj me një elbasanas gegënishten në Athinë në vitet 1889/90, dhe hartoi një *Gramatikë të gjuhës shqipe* që u mbështet mbi gegërishten jugore të Elbasanit, shkruan në parathënien e librit të tij, përse vuri në themel të gramatikës së tij dialektin gegë jugor të Elbasanit. Por edhe shpjegon që gegët e jugut përdorin si gjuhë shkrimi toskërishten dhe jo dialektin e tyre:

“Në jug te toskët, ku prej kohësh shkollat greke kanë ndikuar për emancipimin dhe kulturën, shpejt filloi edhe shkrimi i gjuhës amtare; edhe këtu zuri vend një propagandë e fortë kombëtare, kështu ndodhi që gegët e jugut përdorin si gjuhë shkrimi toskërishten dhe jo dialektin e tyre” (Klosi 2010).

Varianti i toskërishtes letrare kishte filluar ta krijonte shtratin e vet edhe në hapësirat e Maqedonisë qysh përpara Konsultës gjuhësore të Prishtinës (1968). *“Është për t'u theksuar fakti se nga disa arsimtarë, sidomos në disa shkolla të mesme të Shkupit e të ndonjë qendre tjetër arsimore, po edhe në gazetën “Flaka e vëllazërimit” të Shkupit, - kishte nisur që përpara Konsultës të zbatoheshin varianti i toskërishtes letrare, ndërsa në të tjera raste zbatoheshin pika të veçanta të këtij varianti e të drejtshkrimit të tij, si në ortogramet shtëpia, shtëpinë; atë, këtë me të dy funksionet; shtrirja e përdorimit të trajtës së lidhore në vend të paskajores së gegërishtes etj.”* (Bajçinca 1989).

Qysh Konstantin Kristoforidhi si njohës shumë i mirë i të gjitha të folmeve të të dy dialekteve të gjuhës shqipe e kishte hetuar shumë qartë se standardizimi i gjuhës shqipe do të duhej të orientohej nga toskërishtja, për shkak të unitetit të madh të të folmeve të saj në të gjitha nëndialektet. Të folmet e dialektit të gegërishtes kishin ndryshime shumë të mëdha midis tyre dhe kjo shkaktonte vështirësi të pakapërcyeshme për hartimin e një gramatike mbi bazën e gegërishtes (Fadil Raka, www.gjuhashqipe.com/albanologjiprintversion...).

- Synimi i Komisionit Letrare Shqipe ishte përpjekja për afrimin e dialekteve me qëllim që të arrihej gjuha letrare shqipe, e kjo të flitej e të shkruhej nga të gjithë shqiptarët;

- KLSH e zhvilloi veprimtarinë e vet në luftë të papajtueshme me pikëpamjet e ngushta lokaliste. Ndërsa sot, njëqind vjet më pas, disa qarqe gjuhëtarësh e pseudogjuhëtarësh, paradoksalisht, këllasin bajraktarizmin dhe krahinën në gjuhë edhe aty ku nuk do të duhej ta qasnim – në dezintegrimin tonë gjuhësor e kombëtar;

- Koha që ka ndërmjetësuar që nga KLSH e deri te Kongresi i Drejtshkrimit ripohon se zgjidhjet e kryera në ngritjen e normës letrare të shqipes kanë qenë koherente e të drejta;

Nëndialekti i Elbasanit ishte më i kulluari nga të gjitha nëndialektet e Veriut dhe, për më tepër, më afër toskërishtes

Në një studim të tij me titull "*Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*", (Zëri i së vërtetës", volumni 15-të, nr. 2, 2002), prof. Shaban Demiraj thekson:

"Të gjithë jemi në dijeni se si lidhur me këtë vendim, (është fjala për vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit), ka pasur dhe ka vërejtje të mbështetura në arsyetime të ndryshme dhe sidomos të karakterit politik, duke e lidhur marrjen e vendimit të vitit 1972 me ndikimin e pushtetit monist të asaj kohe".

Më poshtë, duke argumentuar se përse toskërishtja u bë gjuhë standarde, ai vazhdon:

"Por, siç e kam pohuar edhe më parë, (Demiraj, 1996: 121), edhe dialekti verior mund të kishte shërbyer si bazë për shqipen standarde, natyrisht duke iu nënshtruar një procesi standardizimi, që me siguri do të kërkonte më shumë punë, për shkak të dallimeve të shumta të të folmeve të ndryshme të atij dialekti".

Sigurisht, në këtë pikë prof. Demiraj ka plotësisht të drejtë, se, me të vërtetë, nëndialektet e veriut, duke përfshirë edhe ato të Shqipërisë së mesme, pra, nga zonat e Tiranës, Durrësit, Krujës, Laçit, Zadrimes, Shkodrës, Dibrës, Kukësit, Kosovës...janë të shumta dhe të diferencuara nga njera-tjetra, dukuri që nuk ndodhin në nëndialektet e jugut, pra, të krahinave të Lushnjës, Beratit, Vlorës, Gjirokastrës, Korçës, Çamërisë, ku dallimet janë kryesisht fonetike. Por, duhet të vihet në dukje se në përgjithësi në të gjitha vendimet e marra që nga Komisia Letrare e Shkodrës (1916) e deri në vendimet e Institutit të Studimeve Shqiptare më 1940, si bazë e gjuhës së ardhme letrare shqipe mbahej parasysh nëndialekti i Elbasanit, që ishte më i kulluari nga të gjitha nëndialektet e Veriut dhe, për më tepër, më afër toskërishtes.

Sot ka intelektualë nga Veriu ose Shqipëria e mesme, që këmbëngulin se gegërishtja duhej të ishte gjuhë standarde. Ata, për këtë qëllim, vënë në dukje se ky dialekt flitet, duke përfshirë edhe trojet shqiptare në ish-Jugosllavi, Maqedoni dhe sidomos në Kosovë, nga më shumë se tri të katërtat e popullsisë shqipfolëse, ndaj dhe do të meritonte të ishte gjuhë e njësuar. Por kjo është relative e prandaj prof. Demiraj vë në dukje:

"...Ka dhe raste të tjera që gjuha standarde e një kombi, për një arsye a një tjetër, është mbështetur në një dialekt të caktuar, folësit e të cilit nuk përbënin shumicën e kombit përkatës. Mjafton të kujtojmë këtu italishten standarde që është mbështetur në dialektin e zonës së Toskanës, ose frëngjishten standarde, që është mbështetur në variantin letrar të zonës së Parisit, ose gjermanishten standarde, që është mbështetur në variantin letrar të gjermanishtes së mesme lindore (Saksonia)" (Këllëçi).

KLSH me zgjidhjet për një gjuhë shkrimi të përbashkët që ofroi, i dha vulën më pas edhe Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Hipotetikisht, edhe sot po të ishte formuar, ta zëmë, një Komisi Letrare për caktimin e bazës dialektore të shkrimit të shqipes së përbashkët, rezultati do të ishte po ai që ka dhënë KLSH një shekull më përpara. E po kështu mund të thuhet edhe për Kongresin e drejtshkrimit

të gjuhës shqipe, i cili jo vetëm që nuk ndryshon në thelb nga KLSH, por është binom i KLSH.

Si përfundim, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1972) nuk është produkt i “regjimit dirigjist”, ai i ka rrënjët te Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës, e përtej kësaj te koineja letrare e toskërishtes dhe te baza dialektore e arealit të shqipes qendrore.

Bibliografia

Bajçinca 1989 = Bajçinca, Isa, *Konsulta gjuhësore e Prishtinës dhe njësimi i shqipes letrare*, Seminari i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Filologjik, Prishtinë, 1989.

Beci 1974 = Beci, Bahri, *Rreth parimit tradicional-historik në drejtshkrimin e shqipes*, “Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, 20-25 nëntor 1972, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1974).

Çeliku 1968 = Çeliku, Mehmet, *Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre*, në “SF” 3, 1968.

Këlliçi = Këlliçi, Skifter, *Si u bë toskërishtja gjuhë standarte?* (publikim në internet).

Klosi 2010 = Klosi, Ardian, *I dashuruar me Ballkanin: Gustav Eëigand në 80-vjetorin e vdekjes*, Shekulli, 2010.

Myrta 2014 = Myrta, Manola, *Në gjurmë të elbasanishtes letrare*, Doktoratë për mbrojtjen e gradës shkencore “doktor”, Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2014.

Nahtigal 2015 = Nahtigal, Rajko, *Për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 2015.

Shefqet Deliallisi, *Pse u injorua dialekti i Elbasanit?*, faqe në internet, 2014).

Ziberci 2015 = Ziberci, Paul, *Shqipëria dhe shqiptarët*, Botimet Plejad, 2015

HIDAJETE AZIZI

HIPOKORISTIKA NË ANTROPONIMI

Antroponimia është një det pa fund që për çdo ditë pasurohet me emra të rinj, të papërdorur më parë. Secili emër që lind ka një qëllim. I pari, të identifikojë personin që bart këtë emër, dhe i dyti, të reflektojë idetë e botëkuptimet e personit që përzgjedh emrin. Këto ide e botëkuptime nga më të ndryshmet, përçojnë mesazhe për shkallën e zhvillimit shoqëror e kulturor, për psikologjinë, mendimin estetik e nivelin ideologjik të një grupi shoqëror a një populli në periudha të caktuara të zhvillimit të tij. E sipas kësaj mund të thuhet se, më të shumtë se sa llojet e emrave, janë motivet për lindjen e këtyre emrave nga që emra të njëjtë mund të kenë edhe motive të ndryshme. Kjo laryshi motivesh edhe tek emra të njëjtë bën që secili emër të jetë rast i veçantë. Zakonisht janë prindërit ata që në aktin e vënies së emrit, reflektojnë botëkuptimet e këtyre grupeve shoqërore. E në të gjitha motivet e mundshme, shpeshherë gjejmë të ndërthurur edhe motivin që mbështetet në përkëdhelinë që natyrshëm buron nga dashuria e prindit ndaj fëmijës. Edhe në ato raste kur emrat zyrtarë, të regjistruar në trajtën e tyre të plotë, nuk kanë një kuptim përkëdhelës të realizuar përmes mjeteve gjuhësore për të shprehur këtë kuptim, në praktikë vështirë se gjejmë një emër që nuk ka fituar të paktën një trajtë të dytë përkëdhelëse, qoftë përmes shkurtimit, qoftë përmes zgjerimit me anë të prapashtesave me karakter përkëdhelës apo edhe përmes të dy mënyrave njëkohësisht. Në këtë mënyrë krijohet një bigëzim formash të antroponimeve: forma zyrtare të shkruara dhe forma jozyrtare gojore. Arsyet pse ndodh kjo janë të shumta. Në të dyja rastet e realizimit, edhe të procesit të zgjerimit edhe të procesit të shkurtimit, si të emrat zyrtarë të shkruar ashtu edhe të ata të gjuhës së folur, veprojnë faktorë të ndryshëm gjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Arsyet e krijimit të trajtave hipokoristike janë shumë më të mëdha kur bëhet fjalë për gjuhën e folur, përkatësisht për trajtat jozyrtare gojore. Studiuesit P. Daka (1986 : 142), B. Baliu (2004 : 82), Gj. Shkurtaç (2000 : 124) e të tjerë, numërojnë shumë arsye pse antroponimet pësojnë ndryshime në trajtë e shpeshherë edhe në përmbajtje duke fituar në këtë mënyrë edhe një ngjyrim ekspresiv. Gjithsesi që këtyre arsyeve u prin qëndrimi subjektiv-përkëdhelës kundrejt personit të cilit i drejtohem nga fakti se përkëdhelia gjen shprehje të gjerë jo vetëm në marrëdhëniet e prindërve me fëmijët, e përgjithësisht të të rriturve me të vegjlit, përfshirë këtu edhe prurjet nga periudha e *'baby talk'* (Gj. Shkurtaç, 2000 : 124), por edhe në mjediset familjare e intime, miqësore e shoqërore. Studiuesit në fjalë përmendin edhe arsyet tradicionale, fetare e mistike. Meqenëse në këtë trajtim objekt studimi do të jetë hipokoristika në antroponiminë e shqiptarëve të Maqedonisë, në këtë kontekst vlen të theksohet fakti që të shqiptarët e Maqedonisë tradita për të trashëguar emrat e paraardhësve

në familje është shumë e gjallë. Me këtë traditë ndërliiden edhe rastet shumë të shpeshta të krijimit të trajtave të dyta të emrave, zakonisht me karakter hipokoristik, qoftë për të mos përmendur emrin e prindërve a gjyshërve të ndjerë me të cilin është emërtuar fëmija, qoftë për të mënjeluar emrat që dyfishohen brenda familjes, atëherë kur personi me emrin e të cilit është emërtuar fëmija akoma jeton. Edhe arsyet pse përcillen te fëmija emrat e prindërve të gjallë janë të ndryshme. Te shqiptarët e Maqedonisë është mjaft i njohur fenomeni i besëtytnisë sipas të cilës, në familjet ku ka shumë vajza, për të ndërprerë procesin e lindjes së njëpasnjëshme të tyre, te vajza e fundit trashëgohet emri i njërit nga prindërit, me shpresë se fëmija i radhës do të lindë djalë¹, i cili në këto raste emërtohet ose thirret me një variant hipokoristik të emrit në fjalë. Në këtë kontekst mund të futet edhe fenomeni i, siç e quan Shkurtaj (2000:128), *mashkullorizimit për përkëdheli*, në familjet ku nuk ka djem por vetëm vajza, duke krijuar trajta të dyta hipokoristike të gjinisë mashkullore për emrat e gjinisë femërore. Në të shumtën e rasteve, emrat të cilët mbështeten në motivin e trashëgimisë, pa marrë parasysh arsyet pse janë trashëguar, janë emra të vjetër orientalë, jashtë mode, që për bartësit shpeshherë nuk janë të pëlqyeshëm. Nga informatat e ndryshme nga terreni na bëhet e ditur se këta emra jo të preferuar për bartësit, dhe jo vetëm ata që mbështeten në motivin e trashëgimisë, po edhe shumë emra të tjerë të cilët nuk tingëllojnë bukur a ndjehen si të vjetër, ka raste kur kanë krijuar edhe komplekse me pasoja psikologjike për shkak të mënyrës se si i qaset rrethi personit që bart këtë emër, e sidomos rrethi shoqëror. Këto pasoja ndjehen jo vetëm në kohën e fëmijërisë, po edhe në moshën madhore, prandaj rezistenca e cila haset nga gjeneratat e reja kundrejt këtyre emrave reflektohet përmes ndërrimit të trajtës së tyre me një trajtë të dytë me qëllim që i njëjti të tingëllojë si emër më modern apo të ngjasojë me emër shqiptar. Do të shtojmë këtu edhe arsyet e tjera besëtytnore që përmendin studiuesit, siç është besimi tek njerëzit se me ndërrimin e emrit mund të përmirësohet gjendja shëndetësore e ligë e personit të cilit i ndërrohet emri me një trajtë të dytë me karakter hipokoristik, po që krahas arsyeve të përmendura më herët dhe gjithnjë duke u thirrur në informatat nga terreni, mendojmë se krijimi i trajtave të dyta të emrave mbështetur në një besim të këtillë është shumë më i rrallë. Trajtat e dyta të emrave të cilat fitohen me shkurtim, megjithëse nuk mund të përjashtohen edhe trajtat e dyta që fitohen me zgjerim me prapashtesa hipokoristike, më së shpeshti krijohen për arsye praktike a për lehtësi shqiptimi, sidomos tek të miturit, për të shmangur emrat e gjatë ose të vështirë për t'u shqiptuar e që sipas Shkurtaj (2000 : 124), kjo mënyrë *ka qenë dhe mbetet më tipikja në traditën e antroponimisë shqiptare*. Ekonomizimi në të shprehurit mund të jenë mënyra më tipike, sipas nesh, edhe për traditën e antroponimisë shqiptare të Maqedonisë ngaqë edhe trajtat zyrtare të emrave edhe ato të gjuhës së folur më së shumti janë sajuar përmes shkurtimit. Këtë mendim e mbështesim sidomos për trajtat zyrtare të emrave të cilat edhe janë objekt i studimit tonë. Rezultatet që dalin pas analizës së bërë të

¹ Zakonisht trashëgohet një trajtë e përshtatur hipokoristike e emrit të nënës apo një trajtë e përshtatur sipas gjinisë e emrit të babait, si bie fjala: *Miradije-Miradush, Mihane-Hanush, Azem-Azemine, Kadri-Kadrush* e të ngjashme.

korpusit të përgjithshëm të antroponimeve² rezulton me një numër më të madh të emrave të shkurtuar se sa të emrave të sajuar me prapashtesim hipokoristik. Kjo, sidomos sa i takon emrave me origjinë orientale ngaqë këta emra edhe mbizotërojnë në fondin antroponimik të shqiptarëve të Maqedonisë. Megjithëkëtë, motivet për krijimin e trajtave të dyta, si me anë të shkurtimit ashtu edhe me anë të zgjerimit me prapashtesa hipokoristike, apo edhe me anë të të dyja mënyrave së bashku, mund të ndërthuren dhe të jenë nga më të ndryshmet, ashtu siç janë të ndryshme edhe motivet e përcaktimit të emrit me të cilin emërtohet fëmija në formën zyrtare, sepse, siç thotë edhe R. Ismajli (1991:403), *akti i zgjedhjes së emrit është gjithmonë vetëm individual, psikologjik*. Do theksuar edhe fakti se këto arsye nuk janë çdoherë të njëjlojta për të gjitha vendet. Ato ndryshojnë shpesh jo vetëm nga një rreth në tjetrin, po edhe brendapërbrenda një rrethi më të ngushtë. Prandaj, në këtë trajtim, më shumë se sa në motivet, do të përqendrohemi në analizën e mënyrës se si janë sajuar nga aspekti i fjalëformimit trajtat përkëdhelëse të antroponimeve të dokumentuara të korpusit të vjelë nga regjistrat e gjendjes civile dhe regjistra të tjerë, nga rajone të ndryshme të Maqedonisë të banuara me shqiptarë.

Në gjuhësi, këta emra përkëdhelës që quhen antroponime hipokoristike bëjnë pjesë në derivimin stilistik – ekspresiv. Në të vërtetë, ky lloj derivimi nënkupton derivim deminutiv-hipokoristik, që do të thotë se këto antroponime kanë vështrim përkëdhelës sepse përfshijnë kategorinë e zvogëlimit e përkëdheljes njëkohësisht, veçanërisht kur bëjmë fjalë për fëmijë sepse të gjithë ne jemi të prirë të shprehim simpati e dashuri për më të vegjlit, dhe përdorim stilistikor, me karakter intim, familjar a shoqëror, kur bëhet fjalë për persona në moshë të rritur. Dy janë mënyrat kryesore me anë të të cilave realizohen antroponimet me karakter stilistik-ekspresiv, me zgjerim, duke u shtuar prapashtesa hipokoristike antroponimeve neutrale, si bie fjala, *Erë + -zë = Erzë*, dhe me shkurtim të emrave, si për shembull, *Abdurrahman = Man; Ramadan = Ramë/Dan* e të ngjashme. Një mënyrë tjetër e realizimit nënkupton bashkëveprimin e të dy mënyrave të përmendura, pra, me shkurtim e zgjerim njëkohësisht, si: *Fatime = Fatë + ush = Fatush*. Pastaj, secila prej këtyre mënyrave të realizimit ka edhe veçoritë e veta. Në këtë kontekst do ta theksojmë faktin se në fondin e emrave të regjistruar me burim nga shqipja kemi takuar mjaft raste të emrave hipokoristikë që janë sajuar me anë të zgjerimit me prapashtesa hipokoristike, ndërkaq që antroponime hipokoristike të sajua me anë të shkurtimit dhe me anë të metodës së shkurtimit e zgjerimit njëkohësisht, pothuajse nuk kemi takuar fare, ndërkohë që kjo mënyrë e sajimit të emrave është mjaft e shpeshtë për emrat me etimologji orientale si dhe për emrat e nomenklaturës krishtere.

Antroponime hipokoristike të realizuara me prapashtesim

Analiza e antroponimeve të cilat kanë ose kanë fituar karakter hipokoristik përmes zgjerimit me prapashtesa, përqendrohet në përkufizimin e llojit të temës së

² Korpusi ynë i antroponimeve numëron rreth 10 500 njësi, i vjelë në pjesën më të madhe të vendbanimeve të Maqedonisë të banuara me shqiptarë.

cilës i bashkëngjiten prapashtesat hipokoristike; e karakterit të prapashtesave (nëse janë prapashtesa apelative, karakteristikë edhe për leksikun e përgjithshëm, apo prapashtesa antroponimike, karakteristikë vetëm për leksikun onomastik); e etimologjisë së prapashtesave (nëse janë prapashtesa me burim nga shqipja ose të huazuara nga gjuhë të tjera); e funksionit të prapashtesave (nëse kanë funksion vetëm hipokoristik apo funksion të dyfishtë, për të shprehur ngjyrim emocional dhe për të dalluar gjininë njëkohësisht); dhe e numrit të prapashtesave.

Para se të kalojmë në këtë analizë, do të japim një pasqyrë të shkurtër për fondin e prapashtesave hipokoristike në gjuhën shqipe. Në *Gramatikën e gjuhës shqipe I* (1995 : 144), inventari i prapashtesave hipokoristike numëron vetëm pesë prapashtesa. Për gjininë mashkullore *-th* e *-ush* dhe për gjininë femërore *-z(ë)*, *-ushkë* dhe *-icë*. Këto prapashtesa përdoren në leksikun e përgjithshëm të gjuhës shqipe për të sajuar *emra me ngjyrim ndjenjësor përkëdhelie, përkëdhelie e zvogëlimi njëkohësisht, ose vetëm zvogëlimi*. Disa prej tyre kanë kaluar edhe në leksikun e përveçëm. Në krahasim me gjuhët e tjera³, ky inventar i prapashtesave në gjuhën shqipe është dukshëm më i varfër. Mirëpo, për dallim nga gjuha letrare, gjuha e folur e shqiptarëve të Maqedonisë është shumë më e pasur me këtë lloj prapashtesash. Ky konstatim bazohet në rezultatet e analizës për praninë e prapashtesave hipokoristike në gjuhën e folur të shqiptarëve të Maqedonisë⁴. Për këtë mund të ketë ndikuar, ndër të tjera, edhe kontakti i vazhdueshëm me gjuhën maqedonase, në të cilën këto prapashtesa janë të zhvilluara në masë të madhe⁵. Si rezultat i ndikimit të drejtpërdrejt nga maqedonishtja⁶, në gjuhën e folur kanë hyrë këto prapashtesa hipokoristike: prapashtesa me bazë *-k* (me variantet: *-kë*, *-ko*, *-çkë*, *-uçkë*, *-içkë*, *-içkëz*, *-uck*, *-ushkë*, *-ushkëz*, *-oshkë*, *-oskë*, *-ashkë*, *-cko*, *-çko*, *-aleckë*, *-uleckë*, *-areshkë*, *-ulkë*, *-unkë*, *-ajkë*, *-alkë*, *-ukle*, *-arake*, *-ulinë*, *-këz*); prapashtesa me bazë *-c* (me variantet: *-icë*, *-uc*, *-alec*, *-avec*, *-çic*); prapashtesa me bazë *-ç* (me variantet: *-çe*, *-iç*, *-içe*, *-uçe*, *-uç*) dhe prapashtesa me bazë *-l'* (me variantet: *-le*, *-ile*, *-ale*, *-ule*, *-ul*, *-ulinë*). Ashtu si edhe prapashtesat hipokoristike të gjuhës letrare, një pjesë e këtyre prapashtesave kanë kaluar nga leksiku i përgjithshëm në atë të përveçëm. Nga fondi i përgjithshëm i prapashtesave hipokoristike të gjuhës letrare shqipe në leksikun e vjelë të antroponimeve, të paktën sa i takon korpusit tonë të përgjithshëm të vjelë në terren, ka kaluar vetëm prapashtesa me bazë *-z* dhe prapashtesa me bazë *-sh*, të cilat janë shtrirë, si tek

³ Si bie fjala, në gjuhët si spanjishtja, italishtja, gjermanishtja e sidomos maqedonishtja, ku prapashtesat me karakter hipokoristik janë të zhvilluara në masë të madhe.

⁴ Shih për këtë, H. Azizi, *Ligjërimi emotiv i realizuar me anë të derivimit prapashtesor në gjuhën e folur të shqiptarëve të Maqedonisë*. SA, 2009, f. 162.

⁵ Vetëm në maqedonishten letrare ka mbi 13 prapashtesa me karakter hipokoristik, ndërsa në gjuhën e folur numri i tyre është dukshëm më i madh. Shih për këtë: K. Koneski, *Зборообразувањето во современиот македонски јазик*. 1995, f. 68.

⁶ Për më tepër shih: V. Dançetoviq, *Sufiksi diminutiv*, Prishtinë 1960; A. Poloska, *Лексичката интерференција на македонскиот и албанскиот дијалект во Преспа*, Shkup, 1985; E. Hoxha, *E folmja toske e rrethit të Strugës*, Jehona II, Shkup 1979/5 etj.

⁷ Burimi i së cilës në gjuhët ballkanike lidhet me latinishten. Për më tepër, shih E. Çabej, *Studime Gjuhësore III*, Prishtinë 1976, f. 288.

emrat me burim nga shqipja, si: *Diellza, Erza, Yllza; Engjëllushe, Lulash, Kalosh* etj., ashtu edhe tek ata me burim të huaj, ku kemi takuar vetëm prapashtesën me bazë *-sh*, si: *Hamdush, Avdush, Hisnush, Vebush*, etj., për të mbetur jashtë këtij fondi, prapashtesat e tjera, si: *-th* dhe *-icë*. Nga fondi i prapashtesave hipokoristike të gjuhës së folur kanë kaluar vetëm dy nga këto prapashtesa, si: *-ka* dhe *-ul(-ina)*, të cilat gjithashtu janë shtrirë edhe tek emrat me burim nga shqipja, si: *Hanka, Lirka, Yllka, Bubulina* etj., ashtu edhe tek ata me burim të huaj, si: *Ramizka, Sherifka, Axherka, Raimka, Nehalka, Majtapka, Servetka, Avka, Pashul* etj. Vlen të përmendet edhe fakti se frekuenca e antroponimeve ma karakter hipokoristik dhe mundësia e krijimit të trajtave të ndryshme hipokoristike nga i njëjti emër, nuk është shumë e madhe⁸. Nga korpusi ynë i përgjithshëm i antroponimeve të vjela, kemi takuar vetëm 24 antroponime hipokoristike me burim nga shqipja, për të dyja gjinitë, të realizuara me prapashtesim, që me gjithë variantet e paraqitjes dhe me frekuencën e tyre arrijnë në 70 paraqitje dhe 20 antroponime me burim të huaj/oriental, që me frekuencën e tyre arrijnë deri më 51 paraqitje. Shumica e këtyre antroponimeve rezultojnë vetëm me një variant të realizimit të tyre, pa pasur mundësi që i njëjti antroponim të marrë prapashtesa të ndryshme e me këtë edhe të krijojë forma të ndryshme hipokoristike. Një numër shumë i vogël i antroponimeve të njëjta shoqërohen më së shumti me dy prapashtesa të ndryshme, si bie fjala, antroponimi *Era*, me trajtat *Erza - Erushe*, me prapashtesat *-z(ë)* dhe *-ush(ë)*; *Yll: Yllza - Yllka*, me prapashtesën *-z(ë)* dhe *-k(ë)*, *Hana: Hanka - Hanush, Hava: Havka-Havush*, me prapashtesën *-k(ë)* dhe *-ush(ë)* etj., ndërkaq edhe më i vogël është numri i antroponimeve të njëjta që dalin me trajta të ndryshme të së njëjtës prapashtesë, si bie fjala, me prapashtesën me bazë *-sh*, antroponimi *Mir-ush* e *Mir-ash* etj.

Sa i përket llojit të temës së cilës i bashkëngjiten prapashtesat hipokoristike mund të themi se si proces, derivimi hipokoristik haset tek antroponime të shprehura me temë emërore, me temë mbiemërore dhe me temë foljore, të cilat nga pikëpamja e strukturës morfologjike mund të jenë të thjeshta e të përbëra, me origjinë shqiptare e të huaj. Në analizën e mëtutjeshme lidhur me llojin e temës, do të përfshihen vetëm antroponimet me burim nga shqipja.

Nga analiza e fondit të përgjithshëm të antroponimeve të vjela, kemi konstatuar se antroponimet hipokoristike me origjinë shqiptare janë realizuar kryesisht nga emra të thjeshtë duke iu bashkëngjitur prapashtesa hipokoristike. Të tilla janë:

- **antroponimet me rrënjë emërore**, të realizuara me prapashtesat në vijim: **-ush(ë)**: *Dren-ush-a* (dren), *Engjëll-ush, Engjëll-ush-e* (engjëll), *Er-ush-e* (er(ë)),

⁸ Nëse e krahasojmë këtë segment me gjuhën maqedonase, ku T. Stamoski, *Личното име Димитр(-j, -ja) и неговите деривати во македонскиот јазик*, 1972, f. 149, vetëm për emrin *Dimitri(j, -ja)* jep mbi 200 forma të realizuara nga i njëjti emër, dhe të dhënat që na jep S. Ognenoski, *Британските антропоними во македонската ономастика*, 2006, f.208, për emrin *Bogdan* nga i cili realizohen mbi 100 variante, apo për emrin *Petar* me mbi 150 variante dhe për emrin *Radomir* me mbi 200 variante, shohim se gjuha shqipe në këtë drejtim është dukshëm më e varfër.

Fat-ush-e (fat);⁹ **-esh(ë)**: *Flor-esh-a, Flor-esh-e* (flor(ë)); **-ash**: *Lul-ash* (lul(e)); **-osh**: *Kal-osh* (kal(ë)); **-z(ë)**: *Diell-z-a, Djell-za* (diell), *Er-z-a* (er(ë)), *Puhi-zë* (puhi), *Yll-za* (yll), *Bulë-za, Bul-za* (bul(ë)); **-ka**: *Han-ka* (h(ë)n(ë)), *Yll-ka* (yll) dhe **-ul**: *Bub-ul-ina*;¹⁰

- **antroponimet me rrënjë mbiemërore**, të realizuara me prapashtesat: **-ush**: *Mir-ush, Mir-ush-e, Mer-ush-e* ((i/e) mir(ë)), *Lar-ush-e* ((e) larme);¹¹ **-ash**: *Mir-ash* ((i) mir(ë)); **-z(ë)**: *Njom-z-a* ((e) njom(ë)); **-ka**: *Lir-ka* (e lir(ë)) dhe **-yl**: *Bardh-yl, Bard-ul* dhe *Bardh-il* ((i) bardh(ë));

- **antroponimet me rrënjë foljore**, me prapashtesën **-z(ë)**: nga tërë korpusi i përpunuar kemi hasur vetëm një antroponim hipokoristik me rrënjë foljore, të shprehur me prapashtesën **-z(ë)**, si: *Linde-z-a* (nga folja *lind*).

Nëse e marrim për bazë karakterin e prapashtesave, vërejmë se të gjitha këto prapashtesa, pa përjashtim, janë prapashtesa apelative, karakteristike edhe për leksikun e përgjithshëm, të bartura nga leksiku apelativ në leksikun antroponimik, e të cilat u shtohen emrave me etimologji shqipe, si bie fjala: **-ush**: *Mirush-e/zemrush-e*, **-osh**: *Kalosh/kalosh*, **-ash**: *Lulash/bardhash*, **-ka**: *Hanka/çupka*, **-zë**: *Diellzë/zogzë* e të ngjashme, ndërsa prapashtesa antroponimike, karakteristike vetëm për leksikun onomastik, për sa i përket fondit të antroponimeve me burim nga shqipja nuk kemi hasur.

Sipas etimologjisë së prapashtesave, konstatojmë se shumica e tyre janë prapashtesa shqipe, që i gjejmë edhe në fondin e prapashtesave të gjuhës letrare, dhe një prapashtesë nga gjuhët sllave **-ka**, te emrat: *Hanka, Lirka, Yllka* dhe te një numër më i madh i emrave të tjerë të huaj, por që është adaptuar në gjuhën e folur shqipe duke u bërë pjesë përbërëse e saj.

Sipas funksionit, shumica e prapashtesave kanë vetëm funksion hipokoristik. Nga 14 shembuj të emrave me burim të shqipes, vetëm dy shembuj na dalin me prapashtesa me funksion të dyfishtë, hipokoristik dhe për dallimin e gjinisë. Të tillë janë shembujt: *Diellza/Djellza* dhe *Yllza*, te të cilët, prapashtesa **-z(ë)a** shërben njëkohësisht edhe për të shprehur ngjyrim emocional, edhe për të sajuar gjininë femërore sepse në gjuhën shqipe, të paktën për sa i përket fondit tonë të vjelë në terren, nuk ka emër *Ylle* e *Dielle*.

Dhe së fundi, sipas numrit të prapashtesave, konstatojmë se të gjithë shembujt na dalin vetëm me një prapashtesë hipokoristike, edhe pse mund të ketë raste kur një antroponimi i bashkëngjiten më shumë prapashtesa,¹² sidomos në gjuhën e

⁹ Antroponimi *Fatushe* mund të jetë edhe antroponim hipokoristik i formuar nga shkurtimi dhe prapashtesimi i emrit oriental *Fatime*.

¹⁰ Për karakterin hipokoristik të emrit *Bubulina* shih Q. Murati, *Gjuha e humbur*, SA 3 (2011):106.

¹¹ Emrat *Larosh, Larash, Larok, Laro, Larisk, Laris, Larik, Lari* etj., zakonisht përdoren për emërtimin e kafshëve që janë me lara të ndryshme. Për emërtimin e njerëzve nuk është i zakonshëm, prandaj ky emër bën përjashtim nga të gjithë emrat e tjerë të kësaj kategorie.

¹² Sidomos antroponimeve që trajtohen si hipokoristike historike, d.m.th. antroponimeve me prapashtesa hipokoristike, por që gjatë përdorimit të shpeshtë mund ta kenë humbur kuptimin hipokoristik, prandaj prapashtesat shtesë në këtë rast përdoren për të fituar një ekspresivitet më të fuqishëm.

folur, por në fondin tonë antroponimik të emrave të dokumentuar, raste të tilla nuk kemi takuar.

Antroponime hipokoristike të realizuara me shkurtrim

Për shkak të laryshisë me të cilën na paraqiten emrat hipokoristikë të realizuar me anë të shkurtimit, çështja e ndarjes dhe e klasifikimit të tyre ka shkaktuar një varg dilemash te studiuesit. Bazuar mbi studimet e deritashme, mendimet ndahen për sa i përket mënyrës se si janë realizuar format e shkurtuara të emrave vetjakë. Kështu për shembull, Xh. Lloshi (1969 : 171) mendon se nuk mund të ketë çdoherë rregullsi fonetike në shkurtimin e emrave, sidomos për sa i përket atyre emrave të cilët trajtat e shkurtuara dali si rrjedhojë e faktorëve jashtëgjuhësorë, përkatësisht si rrjedhojë e shumë elementëve subjektivë, por nuk përjashton edhe mundësinë që një kategori e emrave të shkurtuar mund të shqyrtohen edhe nga ana e rregullsive fonetike të cilat me siguri mund ta dijme se vijnë nga një trajtë e plotë a nga një trajtë e parë, siç e quan ai. Edhe sipas Gj. Shkurtaj (2000 : 121), në radhë të parë është faktori jashtëgjuhësor ai që ka ndikuar në shkurtimin e emrave, prandaj edhe e konsideron të vështirë procedurën e dallimit të trajtave të dyta a të shkurtuara nga ato të para a të plota duke përfunduar se shkurtimet e emrave shpeshherë dalin pa kurrfarë kriteresh fonetike. Ndërkaq, ndryshe nga studiuesit e përmendur më parë, Palok Daka (1968 : 137) është përpjekur që te emrat e shkurtuar të gjejë rregulla fonetike të ndryshme në realizimin e tyre nëpërmjet të rënies së tingujve në mes, në fillim apo në fund të emrave apo ndërrimeve të ndryshme tingullore duke bërë kështu një klasifikim të emrave në nëntë grupe. Në këtë vijë, edhe B. Baliu (2004 : 86) ka bërë një klasifikim të trajtave të shkurtuara nga emrat e plotë në katër grupe.

Duke i pasur parasysh këto që u thanë dhe duke u mbështetur në informatat e marra nga terreni, pajtohem me faktin se trajtat e dyta janë rrjedhojë e shumë elementëve subjektivë, si rezultat i të cilëve e kemi shumë të vështirë të gjejmë te secili emër i shkurtuar rregulla të caktuara fonetike, sepse secili prej tyre mund të ketë mënyrën e vet të realizimit që nuk do të thotë se mund të vlejë edhe për emrat e tjerë, madje mund të ketë edhe emra të shkurtuar të cilët nuk gjejmë shpjegim fare me rrugën fonetike në rastet kur nga emri i plotë merren vetëm një tingull, një rrokje ose disa tinguj, duke rezultuar kështu si reformime mjaft arbitrare. Prandaj ne jemi munduar që të shqyrtojmë vetëm ato trajta të cilat me një shkallë sigurie mendojmë se vijnë nga një trajtë e plotë dhe të cilat gjejmë vazhdimësi fonetike nga trajta e plotë.

Nga përpunimi i materialit të vjelë bie në sy se shkurtimi i antroponimeve të korpusit tonë zakonisht është bërë në dy mënyra: me anë të procesit të shkurtimit, përmes rënies së një ose disa rrokjeve, me ç'rast kanë vepruar dukuri të ndryshme fonetike, si: apokopa, afereza, sinkopa etj., dhe me anë të procesit të shkurtimit shoqëruar edhe me ndërrime tingullore. Rënie e vetëm një foneme në procesin e shkurtimit nuk e kemi marrë parasysh sepse në këtë mënyrë trajtat e plota të emrave nuk kanë rezultuar në antroponime të shkurtuara me karakter hipokoristik, por vetëm forma të reja të emrave të plotë, siç është rasti me antroponimet në vijim: Samedin/Isamedin, Brahim/Ibrahim e të ngjashme.

Para se të japim shembuj konkretë për mënyrën e realizimit të emrave hipokorisitkë me anë të shkurtimit, vlen të theksohet fakti që derivimin hipokorisitkë të realizuar me anë të shkurtimit, si proces e kemi takuar vetëm te antroponimet me burim të huaj, kryesisht oriental dhe te antroponimet tradicionale shqiptare të nomenklaturës krishtere të cilët në korpusin tonë përfaqësohen me një numër të vogël. Në gjuhën e folur, në përditshmëri, takojmë shumë emra të shkurtuar me burim nga shqipja, por si forma të dokumentuara nuk kemi takuar. Në fondin tonë të antroponimeve me burim nga shqipja, kemi takuar emra të cilët mbase mund të jenë përdorur edhe si trajta të shkurtra të emrave të plotë, si për shembull: *Linda* nga *Lindita*, *Luli* nga *Lulzim*, *Lume* nga *Lumnije* a *Lumturije* etj., por meqenëse këto trajta hipotetikisht të shkurtra të antroponimeve gjejnë përputhshmëri të plotë me trajta të plota të antroponimeve të cilat mund të jenë sajuar nga leksiku i përgjithshëm (si për shembull nga folja *lind*, nga emri *lule*, nga pjesëza *lum* etj.), nuk i kemi trajtuar si trajta të shkurtuara të emrave në fjalë, por si antroponime të plota të krijuara nga leksiku i përgjithshëm.

Gjatë realizimit të mënyrës së parë të shkurtimit të trajtave të plota të emrave kemi takuar këto dukuri fonetike, si te shembujt në vijim:

- apokopën e dy e më shumë rrokjeve a tingujve, respektivisht ruajtjen e pjesës së parë të emrit të plotë, i cili mund të fitojë edhe një mbaresë për formë e që në fakt, sa i përket fondit tonë të vjelë, është mënyra më e shpeshtë dhe më e lehtë për t'u realizuar: *Musa* (Mustafa/Musli)¹³, *Hisa/Isa/Iso* (Hisamedin/Isamedin), *Rama* (Ramadan/Ramiz), *Sulo* (Sulejman), *Zulfi* (Zulfikar), *Zija* (Zijaudin/Zijaver), *Neki* (Nekib), *Sefo* (Sefedin/Sefulla), *Suli* (Sulejman), *Shefi* (Shefik, /Shefket/Shefki), *Shemo* (Shemsedin/Shemsi), *Xhelo* (Xhelal/Xhelil), *Bajri* (Bajram), *Xhem/Xhemi/Xhemo* (Xhemaludin/Xhemali/Xhemil/Xhemshit/Xhemshir), *Emro* (Emrulla), *Zena* (Zenulla/Zenun/Zenel), *Zylfi* (Zylfikar), *Arzu* (Arzije), *Eme* (Emele), *Kada* (Kadire/Kadrije/Kademe/Kadife/Kadune), *Feto* (Fetije/Fetah/Fethi), *Laze* (Lazime), *Nure* (Nurije), *Safa* (Safere/Safete/Safije), *Sala* (Salije/Salime), *Selva* (Selvet/Selvije), *Shera* (Sherife), *Zyra/Zura* (Zyrafet/Zurafet), *Zera* (Zerafet), *Zade* (Fahrizade/Mirzade/Shehrizade), *Veda* (Vedade) dhe emra krishterë, si: *Pashk* (Paskal), *Nikë* (Nikollë), *Marë* (Marije), *Fran* (Françesk) etj.

- aferezën - ruajtjen e pjesës së dytë të emrit: *Sulo/Suli* (Resul), *Meti* (Muhamet), *Xhani* (Saberxhan), *Uza* (Firuza), *Mide* (Hamide/Samide), *Fize* (Hafize), *Nure* (Ajnur), *Nife* (Hanife), *Sibe* (Hasibe/Nesibe), *Shime* (Hashime), *Zije* (Arzije), *Hira* (Mahire/Tahire/Zahire), *Lime* (Halime/Salime/Selime), *Naze* (Firinaze), *Rime* (Qerime), *Xhibe* (Nexhibe), *Zize* (Azize) dhe emra krishterë, si: *Kolë* (Nikollë), *Toni* (Anton), *Ndre* (Andrea) etj.

- sinkopën - ruajtjen e ndonjë elementi të pjesës së parë dhe të fundit njëkohësisht: *Xhani* (*Xhejlan*), *Xhide* (*Xhezide*), *Hafe* (*Hafife/Hafse*) etj.

Siç mund të shihet nga shembujt e dhënë, apokopa tek emrat vetjakë në rajonin e Maqedonisë është mjaft e pranishme, madje si tek emrat e gjinisë femërore ashtu edhe tek emrat e gjinisë mashkullore. Edhe afereza është mjaft aktive si dukuri

¹³ Në kllapa janë dhënë trajtat e plota të antroponimeve nga të cilat supozojmë se janë fituar trajtat e shkurtuara.

fonetike në shkurtimin e emrave vetjakë, por jo aq sa edhe apokopa, ndërkaq sinkopa është mjaft e rrallë dhe e takojmë kryesisht tek emrat e gjinisë femërore. Kuptohet, këto konstatime vlejnë vetëm për sa i përket fondit tone të vjelë nga terreni.

Një mënyrë mjaft e shpeshtë e shkurtimit të emrave të plotë të fondit tonë antroponimik është edhe ndarja në dy emra të barabartë. Kjo ndarje, në të shumtën e rasteve, ka të bëjë me emra kompozita, kryesisht të gjinisë mashkullore me burim oriental, të cilët gjatë shkurtimit ndahen në dy trajta me vlerë të barabartë dhe të cilat si të tilla i takojmë edhe si trajta të plota të emrave, si: *Avdirrahman=Avdi+Rrahman*; *Avdirrahim=Avdi+Rrahim*; *Avdisamet=Avdil+Samet*, *Avdivait=Avdi+Vait*, *Abdulfeta=Abdul+Feta*, *Abdulkadër=Abdul+Kadër*, *Abdilselam=Abdil-Selam*, *Abdinaser=Abdi-Naser*, *Abdirezak=Abdi-Rezak*, *Abdulamit=Abdul+Amit*, *Abdulbari=Abdul+Bari*, *Abdulhakim=Abdul+Hakim*, *Abdulnijat=Abdul+Nijat*, *Abdulsami=Abdul+Sami*, *Abdulveap=Abdul+Veap*, *Abdulvedat=Abdul+Vedat*, *Abdulxhemil=Abdul+Xhemil*, *Memetali=Memet+Ali*, *Muhamedali=Muhamed+Ali*, ose edhe në dy trajta të shkurtuara, gjithashtu me vlerë të barabartë, si në rastet: *Ramadan=Ramë+Dan*, *Mustafë=Musë+Tafë*, *Nuredin=Nurë+Din etj.*

Mënyra e dytë e realizimit të trajtave hipokoristike të emrave me anë të shkurtimit shoqërohet edhe me ndërrime tingullore që pësojnë trajtat e dyta. Në vazhdim japim shembuj konkretë ku përveç shkurtimit të trajtës së parë të emrit me anë të apokopës, sinkopës e aferezës, ose edhe kombinimit të tyre, takojmë edhe ndryshime të një a më shumë tingujve, si: *Cufë (Jusuf)*, *Bale (Baftisha)*¹⁴, *Samet (Samedin)*, *Tush/Tushe (Sadush, Metush, e këta nga Sadri/Sadik dhe Memet)*, *Azra (Azemine)*, *Xhika/Xhike (Naxhije/Naxhike/Xhihan)*, *Leta (Shyhrete, Makfirete)*, *Gjule (Xhylbehare, Xhylizare, Xhylsime, Xhyltene)*, *Qime (Hashime)*, *Xife (Nazifë)* etj., dhe emra krishterë, si: *Lesh (Aleksandër)*, *Ndue (Andon)* etj., ndërsa te shembujt në vazhdim nuk shohim ndërrime tingullore por vetëm veprim të dy a më shumë dukurive fonetike njëkohësisht: *Azi (Havzi)*, *Bahri (Bahrudin)*, *Zije (Zimijet)*, *Shera (Musherefe)*, *Veda (Mevedete)*, *Zydi (Fevzydin)*, si dhe emra krishterë: *Lekë (Aleks/Aleksandër)*, *Jak (Joakim)*, *Pal (Paul)* etj. Disa emra, pas shkurtimit, mund të formojnë edhe çifte a grupe homonimike, si: *Xhem* nga *Xhemaludin*, *Xhemali*, *Xhemil*, *Xhemshit* e *Xhemshir*; *Mide* nga *Hamide* e *Samide*; *Emre* nga *Ekreme*, *Hateme*, *Kademe*, *Bademe* e *Merjeme*; *Lime* nga *Halime*, *Salime* e *Selime* e të ngjashme.

Antroponime hipokoristike të realizuara me shkurtim e prapashtesim

Në fondin tonë të vjelë antroponimik kemi takuar edhe një numër të vogël emrash hipokoristikë të krijuar me anë të procedurave të përziera: shkurtim dhe prapashtesim njëkohësisht, herë-herë shoqëruar edhe me rënie të ndonjë foneme.

¹⁴ Edhe në regjistrin e gjendjes civile nga i cili e kemi vjelë emrin, janë regjistruar të dy trajtat, ajo zyrtare *Bale*, ndërkaq në kllapa është gjetur forma e plotë *Baftisha*, nga e cila është fituar trajta e shkurtuar.

Gjatë procesit të shkurtimit kemi takuar kryesisht dukurinë fonetike të apokopës dhe më pak edhe të aferezës.

Shkurtimet ku ka vepruar dukuria e apokopës janë realizuar me këto prapashtesa: -ko: *Shef-ko* (Shef-ket), *Rem-ko* (Rem-zi), *Zen-ko* (Zen-un/Ze(j)n-el/Ze(j)n-ulla); -ush: *Dem-ush* (Dem-ir), *Ram-ush* (Ram-adan), *Sad-ush* (Sad-ri), *Met-ush* (Met-in), *Ed-ush* ((H)ed-i), *Ib-ush/Ib-ish* (nga Ibrush, e ky nga Ib-rahim), *Ekr-ush* (Ekr-em), *Emr-ush* (Emr-ulla), *Ed-ush-e* (Ed-ibe, Ed-ime), *Veb-ushe* (Ve(h)b-ije), *Fid-ushe* (Fid-ajete), *At-ush-e* (At-ije), *Fat-ush-e* (Fat-ime), *Hat-ush* (Hat-eme), *Hed-ush* (Hed-ije), *Sam-ushe* (sam-ije), *Zen-ushe* (ze(j)n-ije); -ish: *Mem-ish* (Me(h)m-ed), *Selv-ish-e* (Selv-ije, Selv-ete, Selv-e), *Ruki-she* (ruki-je).

Shkurtimet me anë të aferezës janë realizuar kryesisht me anë të prapashtesës –ush: *Dan-ush* (Rama-dan), *Min-ush-e* (E-min-e), *T-ush-e* (Fa-tushe-Fa-time) dhe *Vushe* (Ha-vushe-Hava).

Po qe se analizojmë raportin ndërmjet antroponimeve neutrale - pa ngjyrim emocional dhe atyre hipokoristike – me ngjyrim emocional a stilistik, përfshirë këtu të gjitha mënyrat e realizimit të derivimit hipokoristik, arrijmë të konkludojmë se antroponimet hipokoristike - përkëdhelëse dalin me një numër shumë më të vogël sesa ato neutrale, sidomos për sa u përket antroponimeve të dokumentuara me burim nga shqipja, që do të thotë se nuk kanë arritur të zyrtarizohen shumë.

Nga tri mënyrat e paraqitura të sajimit të antroponimeve me karakter stilistik-ekspresiv, më e shpeshtë rezulton mënyra me shkurtim, e pas saj, ajo me zgjerim me prapashtesa, ndërsa më e rrallë, mënyra e tretë që nënkupton bashkëveprimin e dy mënyrave të para, shkurtim e zgjerim njëkohësisht.

Sa i takon etimologjisë së emrave të cilëve u bashkangjiten prapashtesat hipokoristike, konstatojmë se të njëjtat prapashtesa përdoren edhe me emra me burim nga shqipja edhe me emra me burim të huaj. Gjithashtu, vlen të theksohet se, të njëjtat prapashtesa u bashkëngjiten edhe emrave të plotë, edhe atyre me temë të shkurtuar, gjë të cilën e konstatojmë pas analizës që u është bërë emrave me origjinë të huaj, ndërsa për sa u përket emrave me burim nga shqipja, nuk kemi takuar emra të shkurtuar, të cilëve u janë bashkangjitur prapashtesa hipokoristike.

Për sa i përket prodhimitarisë së prapashtesave, nga analiza e fondit tonë emëror konkludojmë se ndër prapashtesat më të përhapura dhe më prodhimitare na del prapashtesa –ush(ë) (te 42 antroponime), si te antroponimet me burim nga shqipja, si te ato me burim të huaj dhe sidomos tek antroponimet e shkurtuara me burim oriental; pas saj vjen prapashtesa –ka te emrat e plotë me burim nga shqipja dhe me burim të huaj dhe –ko te emrat e shkurtuar orientallë (te 17 antroponime); prapashtesa –zë e cila te emrat me burim nga shqipja është më prodhimitare se sa prapashtesa –ka (nga 11 antroponime me burim nga shqipja, 8 dalin me prapashtesën –zë dhe vetëm 3 me prapashtesën –ka), ndërsa tek emrat me burim të huaj, në fondin tonë emëror nuk është përdorur fare. Prapashtesat e tjera, si: -esh(ë), -ash, -osh, -ul e -yl janë dukshëm më pak prodhimitare.

Edhe sa i takon dallimit sipas gjinisë, konstatojmë se bindshëm më i madh është numri i antroponimeve hipokoristike të gjinisë femërore se sa i atyre të gjinisë mashkullore. Nga 81 antroponime hipokoristike të sajuara me prapashtesim, 63 dalin të gjinisë femërore dhe vetëm 18 të gjinisë mashkullore.

Literatura:

- Agalliu *et al.* *Gramatika e gjuhës shqipe*, vol. I. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1995.
- Azizi, Hidajete. *Ligjërimi emotiv i realizuar me anë të derivimit prapashtesor në gjuhën e folur të shqiptarëve të Maqedonisë*, Studime albanologjike 1/2009.
- Baliu, Begzad. *Onomastika e Gallapit. (Disertacion)*, 2004.
- Çabej, Eqrem. *Studime Gjuhësore III*, Prishtinë: Rilindja, 1976.
- Daka, Palok. *'Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe'*, Studime filologjike 3/1968.
- Dançetoviç, Voislav. *Sufiksi diminutiv e emnave të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja, 1960.
- Hoxha, Esat. *'E folmja toske e rrethit të Strugës'*, Jehona 6/1979.
- Ismajli, Rexhep. *Gjuhë dhe etni, artikuj dhe ese*. Prishtinë: Rilindja, 1991.
- Конески, Кирил. *Зборообразувањето во современиот македонски јазик*. Скопје: 1995.
- Lloshi, Xhevat. *'Mbi rregullsitë në ndryshimet e emrave të njerëzve'*, Studime filologjike 2/1969.
- Murati, Qemal. *'Gjuha e humbur'*, Studime albanologjike 3/2011.
- Огненовски, Сашо. *'Британските антропоними во македонската ономастика'*, НДиск. 32/2006.
- Poloska, Agim. *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës*. Shkup: Asdreni, 2003.
- Stamatoski, Trajko. *'Личното име Димитри (-j, -ja) и неговите деривати во македонскиот јазк'*. МЈ 23/1972.
- Shkurtaj, Gjovalin. *Onomastikë e etnolinguistikë*. Tiranë: SHBLU, 2000.

HAREDIN XHAFERI**TOPONIMIA E TOMORICËS****HYRJE**

Krahina e Tomoricës, krahina më e madhe e rrethit të Skraparit, sot përfshihet ndër krahinat më të shpopullarizuara të vendit, pas braktisjes që iu bë pas viteve '90.

Ajo ndodhet në pjesën veriore të rrethit të Skraparit dhe kufizohet me Sulovën (në veri); me Oparin (në lindje); me krahinat e Skraparit (në jug e jugperëndim) dhe me Nahijen (në perëndim e veriperëndim).

Kjo krahinë ka përgjithësisht reliev kodrinor e malor. Përbëhet nga shkëmbinj flishorë dhe gëlqerorë, pjesa më e madhe e të cilëve është lehtësisht e gërryeshme. Truallin e saj e çajnë përrrenj të shkurtër dhe të rrëmbyeshëm, sidomos gjatë stinës së dimrit, që zbresin nga shpatet e larta të maleve dhe faqet e kodrave. Burimet natyrore në krahinë janë të pakta dhe gjatë periudhës së verës gati shterojnë.

Në drejtimin veri – jug, gati mes për mes saj, kalon lumi me emrin e krahinës, me gjatësi 41,7 km. Në pjesën lindore krahina mbrohet nga shpateve e maleve të Koshnicës, të Grevës, Majës së Metës dhe malit të Gjogovicës, ndërsa në pjesën perëndimore e ndajnë nga krahina e Nahijes (Berat) dhe nga krahinat e tjera të Skraparit shpateve e malit të Tomorit, Malit të Zaloshnjës dhe Malit të Mëlovës. Në jug ndahet me fshatrat e tjera të Skraparit nga disa kodra të ulëta.

Megjithëse me numër popullsie jo të madh, Tomorica ka qenë e banuar që nga koha e pellazgëve dhe e ilirëve. Për këtë flet edhe ekzistenca e disa rrënojave në Vidhan, Katundas, Tërovë e gjetkë, si dhe gjetjet arkeologjike në disa fshatra të tjerë të saj. Gjurmë të një kohe të lashtë ruhen sidomos në rrënojat e kalasë së Vidhanit dhe në disa rrënoja në Tërovë.

Në vitet 1420 - 1435 kjo krahinë është e njohur si vilajet më vete, në të cilën janë përfshirë pjesa më e madhe e fshatrave që ekzistojnë edhe sot.¹ Ato janë

¹ Shumë prej fshatrave të Tomoricës janë të dokumentuar me emra gati të njëjtë me ata që kanë edhe sot, në regjistrin turk *Suret - i defter - i sancak - i Arvanid*, botuar në Ankara më 1954 nga studiuesi turk H. Inalçik: *Romas, Gerbes (Gjerbës), Jalojine (Zaloshnjë), Duklis (Duks), Tunçkoz (Dunckë), Çirtota (Çorrotat), Çirnice (Çerricë), Barç, Dobratin (Dobrenj), Mirlove (Mëlovë), Kruzezi (Gurazez), Buraniy (Burani), Leshkove (Leskovë), Zhapove (Zhepë), Kuçe (Kuç), Filok (Floq), Rahove (Rehovë), Kalkovice (Gjogovicë), Vishaniy (Vishanj), Trebele (Trebël), Tirnove (Tërovë), Krapičko (Kërpicë), Kradic (Gradec), Armen (Ermenj)*. Shih për këto në “*Historiku i arsimit të rrethit Skrapar*” (dorëshkrim), 1979; D. Luka, *Rreth disa toponimeve të regjistrin turk të vitit 1431*, SF, 1, 1978, f. 87 - 88.

vendosur më tepër rrëzë shpateve të maleve dhe gjatë luginave të lumenjve dhe të përrenjve, ku kanë kaluar edhe rrugë karvanësh.

Megjithëse ka pasur popullsi relativisht të vogël, banorët e saj, kanë qenë të lidhur ngushtë me mjedisin e tyre dhe kanë krijuar një toponimi mjaft të pasur, si në makrotoponime dhe në mikrotoponime.²

Emërtimet toponimike të kësaj krahine janë të burimit shqip. Ato janë të lidhura me konfiguracionin e tokës, me veçori e karakteristika të vendit, me pasurinë e botës bimore dhe shtazore, me ndodhi të ndryshme, ngjarje historike të krahinës etj. Megjithatë, mbi truallin e kësaj krahine, si dhe në shumë krahina të tjera, në periudhën e dyndjeve sllave shkelën fiset barbare, të cilat lanë gjurmë edhe në toponiminë e saj.

Emërtimet toponimike janë të larmishme dhe ngjallin interes. Pasqyrimi i tyre në fjalor ndihmon për ruajtjen e tyre si dhe për hulumtimin e dukurive të ndryshme gjuhësore, mjaft prej të cilave janë karakteristike për këtë sferë. Nga analiza e tyre dalin dukuri gjuhësore të veçanta, të cilat plotësojnë në një kuadër më të gjerë, përmes ballafaqimit e krahasimit, studimin mbi të folmen e krahinës. Ato shfaqin interes në planin fonetik, morfologjik, fjalëformues, semantik dhe historik.

Krahina e Tomoricës, veç ndarjes gjeografike, ka edhe një ndarje administrative. Ajo u përket dy rrethëve: të Skraparit dhe atij të Gramshit. Në Tomoricën e Skraparit përfshihen fshatrat: *Përrenjas, Mëlovë, Zaloshnjë, Davidh, Gjerbës, Ujanik, Gradec, Shpatanj, Trebël, Dunckë, Rromas, Tërovë, Gjogovicë, Grëmsh, Kuç, Floq, Rehovë, Barç, Vishanj, Straficë, Grevë, Kovaçanj, Postenë, Leskovë, Konak, Çerricë, Zhepë, Gurrazez, Çorrotat, Burranj, Dobrenj.*

Sipas një botimi të vitit 1922,³ në Tomoricën e Gramshit bëjnë pjesë fshatrat: *Brasnik, Bregas, Dardhë, Delven, Dumbreas, Kërpicë, Vidhan, Kotkë, Siman, Lemnushë, Ermenj, Shëmbërdhenj, Sotirë, Paktos, Shmitër.* Të moshuarit thonë se pjesë e krahinës së Tomoricës kanë qenë edhe fshatrat: *Bletëz, Kullollas, Kushovë, Ulovë, Jançë, Tunjë, Duzhë,*⁴ të cilat sot përfshihen në krahinën e Sulovës. Në të kaluarën kufijtë midis dy pjesëve kanë lëvizur, duke kaluar fshatrat në kufi të tyre me njërin ose me tjetrën pjesë.

E themi me keqardhje se kemi mundur të grumbullojmë vetëm pasurinë toponimike të fshatrave të pjesës së Skraparit, të cilën do ta pasqyrojmë sipas fshatrave ku është mbledhur. Largimi im I hershëm nga krahina, nuk më dha mundësinë për ta grumbulluar të plotë këtë pasuri, sidoqoftë, edhe materiali i mbledhur besoj se është i vlefshëm dhe është një kontribut për grumbullimin e pasurisë gjuhësore të krahinave të vendit tonë.

² Për mbledhjen e materialit janë eksploruar 30 fshatra, emrat e të cilëve do të pasqyrohen me shkronjën ose shkronjat e para në kllapa sipas radhës së mëposhtme: *Gjogovicë* (Gj.), *Grëmsh* (G.), *Kuç* (K.), *Floq* (F.), *Rehovë* (R.), *Barç* (B.), *Vishanj* (V.), *Straficë* (S.), *Kovaçanj* (Ko.), *Grevë* (Gr.), *Postenë* (Po.), *Leskovë* (L.), *Zhepë* (Zh.), *Gurrazez* (Gu.), *Çerricë* (Ç.), *Çorrotat* (Ço.), *Burranj* (Bu.), *Dobrenj* (Do.), *Tërovë* (T.), *Rromas* (Rr.), *Dunckë* (D.), *Trebel* (Tr.), *Shpatanj* (Sh.), *Gradec* (Gra.), *Ujanik* (U.), *Gjerbës* (Gje.), *Davidh* (Da.), *Zaloshnjë* (Z.), *Mëlovë* (M.), *Përrenjas* (P.).

³ Sipas M. Hoxhës, në "Zenel Braçi i Tomoricës", 2003, f. 10

⁴ Shih edhe *Fjalorin enciklopedik shqiptar*, 1985, f. 1102.

Për ta bërë më të kuptueshëm materialin e pasqyruar në fjalor, më poshtë do të bëjmë një përshkrim fonetik, morfologjik, fjalëformues dhe në disa raste edhe historik të tij.

Duhet të themi që në fillim se mjaft dukuri fonetike, morfologjike dhe fjalëformuese që dalin në emërtimet toponimike, janë karakteristikë edhe për të folmen e krahinës. Ato janë analizuar më parë dhe nuk do të rimerren. Këtu do të vihen në dukje fenomene e dukuri specifike për toponominë, që paraqesin interes dhe pasurojnë më tej karakteristikat dhe veçoritë e kësaj të folmeje.

Ndërrime dhe modifikime tingujsh

Zanorja *a* e theksuar në dy emërtime toponimike që kanë në strukturë emër personi, ka përfunduar në *ë*: *Ar e Osmënit* (Gu.), *Rramënk* (Z). Emërtimi i fundit është formuar nga emri i personit *Rraman*. Ky emër dëgjohet i tillë në të gjithë krahinën, ku ruhet *a* - ja e theksuar, gjë që nuk ndodh me emrin *Osmën*. Ky i fundit shqiptohet me *ë* edhe në krahina të tjera jugore⁵ e përgjithësisht në toskërishte. Në fshatin Barç të kësaj krahine ky emër ruhet si patronim me zgjerim në prapashtesën me burim turk - llari: *Osmëllari*.

Ruajtja e *a* - së tek emri *Rrahman* duhet të jetë për analogji me emrat me *a* të theksuar: *Hekuran*, *Ramadan*, *Daljan*, *Kanan* etj., që janë mjaft të njohur në krahinë. Dalja e zanores *ë* të theksuar tek *Rramënkë* duhet të lidhet ndoshta edhe me një përdorim pejorativ të emrit *Rraman* (*Rramën*) me prapashtesën - *kë*. Kur dëgjohet ky emër të shqiptohet me *ë*, përdoret me kuptim përbuzës.

Vëmendjen ta tërheq edhe ruajtja e zanores *a* të theksuar tek gjymtyra e dytë e emërtimit *Arre Mani* (U.) dhe *Bregu Osmanës* (R.). Për emërtimin e parë do të flitet më pas (shih klasifikimi semantik). Ruajtja e *a*-së tek pjesa e dytë e emërtimit *Bregu Osmanës* mendojmë të ketë lidhje me gjininë që del në këtë përdorim. Mund të jetë edhe ndikim nga ndonjë e folme tjetër, siç mendojmë për toponimin *Arre Mani*, pasi emri *Osmën* shqiptohet i tillë në gjithë krahinën.

Mjaft mirë përdoret *ë*-ja e theksuar në emërtimet që lidhen me emrin *Gramsh*, i cili shqiptohet me *a* të theksuar në shqipen letrare edhe në mjaft krahina të vendit. Në këtë krahinë ky emër emërton një fshat në trajtën *Grëmsh*. I tillë ruhet edhe në toponimet: *Sheshi Grëmshit* (Do.), *Shullëri Grëmshit* (G.), *Are Grëmshit* (M.), *Mali Grëmshit* (M.) etj.

Në emërtimin toponimik *Arre Mijës* (Gu.) < - e *Mujës* zanorja *u* e theksuar ka kaluar në *i*. Këtë emërtim në trajtën *Arre Mujës* e ndeshim në fshatin *Tërrovë*. Emrin *Mijë* nuk e kemi gjetur as si trajtë zbusese të ndonjë emri në krahinë.⁶

Zanorja *e* e patheksuar ka kaluar në *ë* dhe kjo e fundit në *i*: *Lërishta* (Z., F., G., Gra.), *Lirishta* (M.) < *Lerë*, *Bregu Shinkollit* (B.) < *Shënkollit*. Emri *Lerë* - at

⁵ Shih M. Totoni, *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, Dialektologjia shqiptare, I, 1979, f. 43

⁶ E bëjmë këtë vërejtje, pasi kemi grumbulluar mjaft emra njerëzish të krahinës e jemi duke i analizuar.

shqiptohet me *e* gjithëherët në të folmen, por edhe në toponimi: *Ler - at* (F.) "Toka të ujshme e me baltë", *Përroi Lerave* (F.) etj.

Në dy emërtime toponimike vihet re kalimi i *a* - së së patheksuar në *ë* dhe anasjelltas: *Bërdhëm - a* (Gj.) < *i bardhë*, (truall) dhe *Lëmi Farkuar* (U.) < *i fërkuar*. Kalimi i *a* - së në *ë* është mjaft i shpeshtë në emërtimet që lidhen me botën shtazore të krahinës.

Grupi *ye* në toponimin *Krezith - i* (Ço.) ka përfunduar në *e*, karakteristikë vetëm për toponiminë. (Ndoshta pasojë e ndikimit nga ndonjë krahinë tjetër).

Bashkëtingëllorja *nj* ka përfunduar në *th* në toponimin *Bregu Ermëthit* (U.) < *i Ermënjit* (Fshat i krahinës). Ndërrimi i këtyre bashkëtingëlloreve nuk duhet të jetë bërë me nuanca zvogëlimi, por më tepër të jetë mënyrë jo e drejtë shqiptimi e ngulitur edhe te të tjerët.

Te toponimi *Shkërkanjë* (Sh.) < *Skërkanjë* < *Skërkë* "Vend i thepisur, me shkëmbinj të shumtë" duhet të ketë vepruar ligji historikisht i njohur i kthimit të *s* në *sh*, që është i mbarë shqipes.

Në dy emërtimet që lidhen me emra të përveçëm personash, labialja e zëshme *b* përdoret në vend të labiales së shurdhët *p* në pozicion nistor, por edhe në trup të një emërtimi kopmoztitë: *Moçali Memet Bashës* (Gu.) < - *Pashës, Alibashëz - a* (Bu.) < *Ali Pasha*.

Grykorja *k* ka kaluar në grykoren e zëshme *g* në emërtimet: *Bogëz - a* (Sh.) < *bokë* dhe *Figu Haxhiut* (R.). Emri *fik* shqiptohet me *g* në të gjithë krahinën, ndërsa emri *bokë* dhe emrat e formuar prej tij, si *bokërimë* (bimë) etj., shqiptohen me *k* në këtë të folme.

Bashkëtingëlloret *sh, zh* e *gj* kanë kaluar në *xh*: *Gropë e Xheganit* (Gj.) < *e sheganit* (kafshë), *Xheletina* (Gr.) < *Zheletina* (zhele), *Xhogovinat* (F.) < *Gjokovinë* (*Gjokë*) - edhe me ndërrim të *k* në *g* (shih më sipër). Këtë mënyrë formimi ka ndjekur edhe emri i fshatit *Gjogovicë*. (Për analizën e dy emërtimeve te fundit shih edhe më pas tek prejardhja).

Te toponimi *Kryz - a* (Tr.) ka ndodhur kalimi i *q* - së në *j*.

Për një dukuri të vjetër duket se flet emërtimi toponimik *Shkëmbi Mulës* (Sh.), ku mendojmë se ruhet *l* - ja në vend të *j* - së, karakteristikë për të folmet më jugore të vendit.⁷ Gjymtyra e dytë e këtij emërtimi duhet të jetë: *Mujës* < *Mujos* < *Muajsiut*. Kjo edhe sepse trajta *Mulë* nuk ndeshet në emrat e banorëve të krahinës. Bashkëtingëllorja *j* del edhe në emërtimet: *Arre Mijës* (Gu.), *Are Mujës* (Tr.).

Në të folmen e krahinës nuk vihet re fenomeni i asimilimit të grupeve të bashkëtingëlloreve *mb* e *nd* në trup të fjalës. Në toponimi, megjithëse mjaft rrallë, ndeshet ky fenomen: *Gjemioti* (Do.) < *Gjemb i Jotit, Katunisht - a* (Ç.) < *Katundishta*. Kjo duhet të ketë ndodhur si pasojë e shurdhimit të *b* - së në *p* dhe të *d* - së në *t* dhe më pas, të rënies së tyre për lehtësi shqiptimi.

⁷ Shih për këtë dukuri Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, "Dialektologjia shqiptare" I, 1971, f. 146; M. Totoni, *Vëzhgime mbi të folmen e Muzinës*, SF. 3, 1965, f. 106

Fenomeni i shurdhimit vihet re në toponimi edhe në pozicion të mbyllur në emërtimet kompozita dhe jokompozita: *Brekàle* (T.), *Brekth* (T.), *Brekqytëtës - i* (Bu.), *Brekselìm - i* (Bu.), *Hije Brèkthit* (T.) etj.

Shtesa e tingujve është fenomen mjaft i rrallë: *Bregu Mbòrës* (Zh.), *Poshtëndàrëz - a* (K.). Tek komponenti i dytë i emërtimit të fundit është shtuar parafjala *ndë(në)*, që ka përdorim tepër të kufizuar në këtë krahinë, por është mjaft aktive në krahinat e Korçës.⁸

Theksi

Gjendja e theksit paraqitet si në të folmen e krahinës. Në emërtimet e formuara me prapashtesë, theksi në përgjithësi lëviz mbi këtë të fundit: *Arrisht - a* (Z.), *Bishtaràk - u* (Rr.), *Bregàl - i*, *Elbishtez - a* (Da.), *Kuqìn - a* (U.), *Kulturèc - i* (R. F. M.), *Lagësir - at* (Zh.) etj.

Nuk ndodh ky fenomen në formimet me prapashtesat - *as*, - *az*, - *ez*, - *th*, - *je*: *Kàlas - i* (F.) < *kalë* a *Kalo* (em. personi), *Plàkas - i* (T.), *Gorrìcaz - i* (Gje. T. B.), *Gùrez-i* (F. K.), *Fùndëz-a* (Rr.), *Luadhëz - a* (Z.), *Kasòllëz - a* (B.), *Gaxhùlez - a* (Sh.), *Brekth - i* (T.), *Lëmth - i* (F. Gj. D.), *Luadhje - a* (F.), *Shëshje - a* (Ço.), *Beqark - a* (Sh.), *Qorrk - a* (F.) etj.

Gjinia e emrit

Në emërtimet toponimike të kësaj krahine që kanë në strukturë fjalën *ujë*, kjo fjalë përdoret gjithmonë në gjininë asnjëse. Në këtë trajtë përdoret kjo fjalë edhe në bashkëvjajtje me një emër tjetër a një mbiemër: *Ujët* (Gj.), *Ujët e Ftohtë* (F. G. K.), *Ujët e Ngùrrës* (U.), *Ujët e Qelbur* (Po. Gr.) etj.

Disa emra mashkullorë duke u bashkuar me prapashtesën - *ëz*, formojnë emërtime të gjinisë femërore: *Vidhëz - a* (Rr.), *Mënëza e Veliut* (F.), *Fùndëz - a* (Rr.), *Luadhëz - a* (F.) etj.

Ruajnë gjininë e fjalës primitive formimet me prapashtesat - *as*, - *t*, - *th*, - *al*: *Kalàs - i* (F.), *Fikthi-i* (Do.), *Stanth-i* (F.), *Bregàl - i* (B.) etj.

Duke u bashkuar prapashtesa - *z* me trajtat e njëjësit e të shumësit te disa emra femërorë, formohen emërtime toponimike që dalin përkatësisht në gjininë femërore dhe mashkullore: *Àrëz - a* dhe *Àraz - i* (K.), *Dàrdhëz - a* (F.) dhe *Dàrdhaz - i* (K.), *Hùrdhëz - a* dhe *Hùrdhaz - i* (F.), *Gjollëz - a* dhe *Gjollaz - i* (M.) etj.

Përdorimi i këtyre dy trajtave lidhet me konceptimin tërësor ose jotërësor të trojeve të një vendi të caktuar. Trajta femërore përdoret zakonisht për emërtimin e një trualli të veçantë, të një pjese të veçantë. P. sh. "Vetëm *Hurdhëza* e Veliut prodhon pak në *Hurdhaz*". Zakonisht në femërore emërtimi del i shoqëruar me një emër a mbiemër. Emërtimi në gjininë mashkullore ka në strukturë një emër në shumës, prandaj merr kuptim kolektiv, megjithëse del në trajtën e njëjësit. Pra, trajta e mashkullores emërton një tërësi trojesh të njëjta (zakonisht toka të

⁸ V. Milkani, *Vëzhgime mbi të folmen ...*, art. cit., f. 183

punueshme): "Vreshtazin e mbollëm të gjithë me grurë" (nënkuptohen disa toka, ara).

Numri

Disa emërtime toponimike të formuara nga emra në trajtën e shumësit me prapashtesën - z, përdoren në të shquarën në të dy numrat. Në shumës ato marrin mbaresën - t: *Gorricaz - i* (Sh.), por edhe *Gorriczat*, *Gremnaz - i* dhe *Greminzat* (B.), *Gropaz - i* dhe *Gropazt* (L.), *Hambullaz - i* dhe *Hambullazt* (K.), *Murez - a* dhe *Murrezt* (K.), *Moçalez - a* dhe *Moçalezit* (F.), *Stanez - a* dhe *Stanezt* (Sh.), *Rripaz - i* dhe *Rripaz - t* (F.), *Vidhishtaz - i* dhe *Vidhishtaz - t* (U.) etj.

Në trajtën e shquar shumës ato emërtojnë një tërësi më të madhe vendesh, jo vetëm tokë të punueshme e troje, por edhe pyje, kullota, shkëmbinj etj. P. sh.: "Dhëntë i kulloste në Arazt". Në trajtën e pashquar të këto emërtime nuk del shumë qartë përdorimi i cilësdo forme të numrit. Nuk ka një kriter të caktuar për përdorimin e trajtës së pashquar njëjës dhe shumës në drejtim të të shprehurit të kuptimeve toponimike. Emërtimet toponimike që lidhen me emrat *vgje* (pishë) dhe *gur*, krahas trajtës së rregullt të shumësit: *Vgjenjtë* (U.), *Gurët* (B.), *Gurët e Çipit* (M.) etj., dalin edhe në trajtë dialektore karakteristike: *Vgjenjsit* (Gu.), *Gursit e Dhelprave* (F.), *Gursit e Mbëdhenj* (P.) etj.

Për emrin *gur* në krahinë kemi dëgjuar edhe trajtën e pashquar të shumësit gurës, p. sh. "Mblidh ca gurës të veckël e bëj gaxhole", ndërsa trajta *vgjenjs* del vetëm në toponimi.

Rrallë herë emërtimet dalin në shumës me një mbaresë të vjetër të cunguar: *Bregu Vërrinjet* (D.) < *Vërrinjve*, *Gorricat e Pleqet* (F.) < *e Pleqve*, *Ligat e Komenjet* (Gu.) < *e Komenjve* etj.

Nyja e përparme

Kur emërtimet e pathjeshta janë zgjeruar me më shumë se dy gjymtyrë, nyjat para gjymtyrës së tretë nuk ndihen: *Damari Udhës Re* (Gu.), *Gryke Varrit Lamit* (B.), *Hije Gurit Lalës* (Gra.), *Sheshi Arës Madhe* (F.), *Përroi Rripës Ujkut* (Do.) etj.

Nyja e përparme nuk ndihet në mjaft raste kur tema e gjymtyrës së parë mbaron me *u*: *Bregu Arës Re* (U.), *Shtegu Përrojt Fellë* (F.), *Lugu Bregut Math* (R.) etj.

4. Në toponiminë e kësaj krahine të tërheqin vëmendjen disa emërtime të pathjeshta me gjymtyrë të dyta një emër të pashquar, që del me funksion ndajshtimi: *Ara Cane* (Gje.), *Ara Dane* (Gje.), *Ara Lashnje* etj.

Klasifikimi kuptimor

Kjo toponimi, e vështruar në plan semantik, paraqitet e larmishme dhe interesante. Edhe në këtë krahinë, si në çdo krahinë tjetër, populli, duke pasur

lidhje të vazhdueshme me mjedisin rrethues, ka përdorur forma, rrugë dhe mënyra nga më të ndryshmet për emërtimin e vendeve.

Klasifikimin semantik të toponimeve do ta ndjekim sipas grupeve që përbëjnë numrin më të madh të tyre.

1. *Emërtime sipas emrave të njerëzve*. Në këtë grup dallohen disa nëngrupe:

a. Emërtime vendesh që kanë qenë prona të njerëzve të ndryshëm dhe që dalin vetëm me emrin e tyre, duke marrë ose jo prapashtesë: *Avdink - a* (Sh.), *Daùtk - a* (Zh.), *Dýlk - a* (T.), *Kàlas - i* (F.), *Kùrtjez - a* (Z.), *Xhafèrr - i* (Da.), *Yzenik - a* (L.), *Zeqìrk - a* (Tr.), *Zhupàn - i* (Sh.), *Sk(ë)ndèrth - i* (Gje.) etj. Janë emërtime arash të punueshme.

b. Emërtime sipas konfiguracionit, përcaktuar nga emra personash që lidhen me mënyra të ndryshme me këtë vend. Emrat e personave në këto emërtime dalin edhe në trajtën e tyre zbuluese: *Are Aliut* (D. Zh.), - *Arzikos* (U.),⁹ - *Cenos* (Sh.), *Brinje Breamit* (Gj.), *Çairi Hysenit* (B.), *Çuke Çobos* (Rr.), *Dërrase Qamilit* (Gje.), *Grope Abazit* (T.), - *Bidos* (F.), - *Muços* (Po.), *Guri Batos* (Gr.), - *Lalagjonit* (L.) (emri *Lalagjon* nuk ekziston dhe as nuk ka ekzistuar në këtë krahinë, por si apelativ në të folmen e krahinës kjo fjalë përdoret në rastin kur një person kërkon të tregohet para të tjerëve për një punë a diçka që i përket atij, duke mbivlerësuar veten. P. sh.: "Këtë e ka bërë Lalagjoni". Ky emër zëvendëson vetëm vectorin e vetës së parë unë. Emri *Gjon* takohet në antroponominë e Skraparit si patronim), - *Lleshit* (Gra.), *Udhe Gjonit* (Da.)¹⁰ etj.

c. Emërtimet sipas konfiguracionit, përcaktuar nga një emër personi që tregon moshë, ves, mjeshtëri, marrëdhënie fisnore etj.: *Are Çobanit* (Da. Gje.), - *Dajës* (Do.), - *Evgjitkës* (Tr.), *Bregu Babës* (Rr.), - *Çalamënit* (Do.), *Gropze Dinakut* (U.), - *Kovaçit* (Do. Gj.), *Guri Nuses* (Gra.) etj.

Në këtë nëngrup (rrallë) gjenden edhe emërtime të bëra thjesht sipas emrit që shënon karakteristikë të personit: *Beqark - a* (Sh.), *Çobankat* (Tr.), *Kollovark - a* (Po.), *Kovaç - i* (P.), *Kovaças - i* (Sh.), *Plakas - i* (T.). Janë emra arash.

ç. Emërtime sipas emrave të bimëve që kanë qenë ose ndodhen në atë vend, përcaktuar nga emri i personit, i cili lidhet me këto bimë nëpërmjet mbjelljes, prerjes së tyre, ndonjë ndodhie a diçka tjetër: *Ahet e Ramizit* (U.) "Pyll", *Dëllinje Hysenit* (F.) "Luginë me shkurre", *Panje Sakos* (T.) "Pyll", *Shkoze Beshirit* (Da.) "Pyll", *vidhi Manes* (Gr.) "Arë" etj. Në disa raste ekzistojnë edhe lidhje pronësie, si: *Dardhe Hazizit* (R.) "Arë", *Mëni Lilos* (Da.) "Arë" etj.

d. Emërtime sipas emrave të personave që sot janë kthyer në patronime: *Delinjk - a* (L.) "Arë", *Kadillark - (Zh.) "Arë"*; *Sulat* (Zh.), "Ara", *Xheloz - a* (Sh) "Arë", *Are Cakes* (Gu.), *Bregu Çipit* (Bu.), *Grop Mezinis* (Do.) "Arë", *Sheshi*

⁹ Kur i njëjti emër përsëritet disa herë, në vend të tij në emërtimet e pathjeshta është shënuar vijë (-).

¹⁰ Antroponime nga krahina e Veriut në të folmen e gjallë të Tomoricës nuk gjenden dhe në toponimi takohen shumë rrallë. Prania e këtyre emrave në toponimi shpjegohet më shumë me ndonjë ngjarje a akt që i ka ndodhur ndonjë personi të ardhur nga krahina të ndryshme të Veriut gjatë rrugës për emigracion.

Cirongut (L.) "Lëndinë", *Shkoze Dorozhanit* (L.) "Pyll me shkurre", - *Sulës* (Gje.)¹¹ etj.

Në toponiminë e Tomoricës kemi gjetur edhe emërtime që lidhen me emra personash historikë, si: *Alibashz - a* (Ali Pasha) (Bu.), *Bregu Ali Pashës* (Gje.), *Moçali i Memet Bash(ë)s* (Gu.), *Prroi i Ballabanit* (Da.) etj.

2. *Emërtime vendesh sipas konfiguracionit.* Ky grup përbëhet nga emra të vënë thjesht sipas formës, pozicionit, paraqitjes natyrore të vendit, madhësisë etj., duke marrë edhe prapashitesa të ndryshme: *Bishtarak - u* (Rr.), *Bokat* (D.) (ka kuptimin "Vendi i thyer me rripa", kurse *Bokë* ka kuptimin "Breg i vogël"), *Brek -gu* (Gu. D. F.), *Bregal - i* (B.), *Bregth - i* (T.), *Brinj - a* (Ço. Gje.), *Copz - a* (T.) "Arë", *Çuk - a* (L. Gra. Ç.), *Dërras - a* (M. V.), *Faq(ë)z-a* (V.), *Fush - a* (Rr. Z. K. Gj.), *Govatz - a* (Rr.), *Gjalmrz - a* (P.), *Lëndin - a* (Z.), *Livath - dhi* (T.), *Luath - dhi* (Po. V.), *Lugjet* (F.), *Shkall(ë)t* (Rr.), *Vrimas - i* (Tr.) etj. Në të folmen e krahinës emërtimet *livadh*, *luadh* nuk përdoren si apelativa. Siç shihet nga shembujt e dhënë dhe nga ata që do të sjellim më poshtë, metonimia në toponiminë e Tomoricës është një fenomen i rëndomtë. Emërtimet e këtij grupi shoqërohen zakonisht nga një emër në gjinore dhe nga një mbiemër që përcakton përmasat, formën, pozicionin e natyrën e tij, p. sh.: *Are Mushasë* (R.), - *Shkëmbit* (L.), *Bregu Bregut* (B.), *Brinje Çukës* (B.) - *Gropave* (K.), *Çuke Kodrës* (Bu.), *Damari Çukës* (Gu.), - *Dushkut* (F. Sh.), - *Gropës* (Do.), *Lëmi Rrasës* (Gje.), *Are Gjatë* (Ç. M. Gj. Do.) - *Madhe* (Gje. G. Ko. Rr. Gu. D. F.), - *Rrëzuar* (Gj.), *Bregu Bukur* (L.), *Bregu Gjatë* (M. Da.), - *Madh* (G. T. Z. D. F. T. B.), *Çuke Mesme* (Gje.), *Prroi Fellë* (Da. M. F. R.), - *Thatë* (Po.) etj.

3. *Emërtime vendesh sipas emrave të bimëve:* *Bokërrime - ja* "Brinjë e veshur me bokërrima", *Breth - dhi* (Rr.) "Pyll", *Buq - i* (M.), "Pyll", *C(ë)mrdele -ja* (Zh.), *Driz - a* (T.), *Ferr - a* (Z. Zh. M. D.), *Fiqt* (R.), *Goric - a* (D.), *Gjemb - i* (T. Gj.) "Lëndinë me gjembaçë", *Panj - a* (K.) "Pyll", *Qersh - i* (D. Ço. T.), *Vidh - i* (Do. Ço. Gu.) etj.

Disa nga emërtimet e vëna sipas emrit të bimës dalin të shoqëruara me një emër tjetër bime në rolin e përcaktorit: *Arre Mani* (U.) "Arë", *Dardhe Misrit* (Tr.), *Fieri Thanës* (M.), *Shkoze Lisit* (G.), *Shkozat e Marës* (Z.) etj. Për shpjegimin e toponimit *Arre Mani* ekzistojnë dy mundësi: ose emërtimi lidhet me emrin e bimës së *manit*, që në këtë të folme, si në mbarë toskërishten, shqiptohet me zanoren *ë* të theksuar, ose lidhet dhe me emrin e një personi me trajtë zbnuese *Man - i*. Ne mendojmë që ky emërtim të lidhet me emrin e bimës, pasi te banorët e krahinës nuk ekziston një trajtë zbnuese e tillë. Po të pranojmë mundësinë e parë, mbetet për t' u sqaruar ruajtja e *a - së*, pasi kjo zanore në pozitë të tillë ka kaluar në *ë*, përgjithësisht në toskërishte dhe plotësisht në këtë të folme.

Megjithatë, edhe po t' i pranojmë të dy mundësitë, do të theksojmë se një trajtë e tillë duhet të jetë pasojë e ndikimit të ndonjë të folmeje tjetër, pra, emërtimi të

¹¹ Fjalët përcaktuese të emërtimeve të mësipërme janë patronime përkatësisht në fshatrat: *Deliu* (Tërrovë), *Kadiu* (Zhepë), *Sula* (Zaloshnjë), *Xhëloz* (Shpatanj), *Çipi* (Burranj), *Mezini* (Dobrenj), *Ciròngu*, *Dorozhàni* (Leskovë), *Càka* (Osojë - Skrapar).

jetë vënë ose të ketë lidhje me emrin e ndonjë kalimtari nga krahinat veriore dhe të jetë ruajtur deri në ditët tona.

Emri i bimës mund të përcaktohet edhe nga një mbiemër, i cili shënon karakteristikë e veçori të bimës: *Ahu Biglaç* (P.), "Pyll me ahe", - *Madh* (P. Ço. Gu.) "Pyll", *Dardhe Butë* (Gje.) "Arë", *Dëllinje Madhe* (V.) "Brinjë e veshur me dëllinje", *Gorice Kuqe* (Ç.) "Arë", - *Mirë* (Gra.), *Ilqe Trashë* (Do.) "Pyll", *Lisi Çatall* (U.) "Pyll", - *Djegur* (D. T.), *Shkoze Madhe* (P. L.), *Vgjeri Vetëm* (Gu.) etj.

Emri i bimës mund të përcaktojë edhe një emër sipas konfiguracionit. Në shumicën e rasteve vendi i emërtuar sipas konfiguracionit bën pjesë në vendin e emërtuar nga emri i bimës: *Brinje Bathores* (F.)¹² "Brinjë, shpat i zhveshur i mbuluar me bar, më tepër gjenden bathore", *Grope Bredhit* (F.) "Pyll me bredha e ahe", *Gryke Bushit* (Ço.) "Qafë mali e veshur me shkurre", *Bregu Dëllinjës* (L. K.), - *Frashërit* (Gu.), *Grope Goricës* (T.) "Arë", - *Gjembit* (Tr. M.) "Lëndinë me gjembaçë", *Grope Mëllezës* (T.) "Pyll", *Grope Vidhit* (T.) "Arë" etj. Në disa raste emërtimi i vënë sipas emrit të bimëve përcaktohet nga një emër sipas konfiguracionit (i cili shërben si makrotoponim për emërtimin e parë), p. sh. : *Arre Gurit* (Rr.), *Gërrjehde Bregut* (Bu.) "Breg me shkurre", *Gorrice Trapit* (Gra.) "Djerrinë me gorrica të rralla", *Lisi Bregut* (B.) etj.

4. *Emërtime sipas ngjyrës së truallit.* Rastet e emërtimit të vendit thjesht sipas ngjyrës së truallit janë mjaft të rralla. Më tepër ngjyrën e tregon mbiemri, kurse emri është vënë sipas konfiguracionit: *Bërdhëm - a* (Gj.)¹³ "Arë me dhera të hirtë", *Boje Kuqe* (B.) "Dhera të kuq", *Kuqin - a* (U.) "Arë me dhera të kuq", *Balte Kuqe* (G. V. F. D.) "Faqe e zhveshur me dhera të kuq", - *Zeze* (G.), *Bregu Bardhë* (R. Do. Da.), - *Kuq* (Gu.), *Dheri Bardhë* (Po.),¹⁴ - *Kuq* (Da. M.), *Fushe Bardhë* (Ço. Tr. Gu.), *Guri Bardhë* (T. Rr. F. Gj.), - *Kuq* (Gu.), - *Zi* (Gr. Bu.), *Shkëmbi Bardhë* (M. K.), *Shpelle Kuqe* (T. P.), - *Zeze* (P.), *Shuri Kuq* (B.).

5. *Burim tjetër i formimeve toponimike të Tomoricës është bota shtazore e krahinës.*

Në toponimet e Tomoricës kemi gjetur vetëm emrin *Blet - a* (Rr.) "Shkëmb ku janë strehuar bletë", të vënë thjesht sipas emrit të insektit. Emërtimet e vendeve që lidhen me këtë sferë janë vënë sipas konfiguracionit dhe emri i kafshës, i shpendit a i insektit del si përcaktues në gjinore: *Are Ariut* (Gra.), *Gorice Ariut* (R.) "Arë", *Shkëmbi Bletës* (Gra.), *Grope Dërrit* (K.) "Pyll", *Bregu Dosës* (Sh.) "Pyll", *Grope Dhelprës* (Z.) "Pyll", *Bregu Dhive* (Gj.), - *Galave* (R.), - *Kaposhit* (V.), *Shtegu*

¹² Në këtë paragraf renditja e shembujve është ndjekur sipas emrave të bimëve. Kjo renditje është ndjekur edhe në disa raste të tjera në shembujt e mëposhtëm.

¹³ Kjo ka evoluar: *bërdhëmë* < *bërdëllëmë* < *bardhëllëmë* < (*e*) *bardhë*. Mbiemri e *bërdëllëmë* përdoret në të folmen e Tomoricës me kuptimin "Ngjyrë e bardhë e përzier me nuanca tjetër, ku zotëruese është nuanca e ngjyrës së bardhë".

¹⁴ Theksojmë edhe një herë se edhe emërtimet e të dy pjesëve të krahinës së Tomoricës: *Tomoricë e Bardhë* dhe *Tomoricë e Zeze*, siç e kemi theksuar më parë (shih *Fjalë e frazeologji të botës bimore...*, art. cit., shën.1), janë vënë duke u bazuar në përbërjen e tokës dhe në ngjyrën e truallit, pasi në toponiminë e kësaj krahine takohen përcaktorët "i zi" dhe "i bardhë".

Kaprolles (T.), "Pyll", *Çuke Korbit* (Gu. Ço.) "Majë kodre", *Bregu Lepurit* (Gu.), *Hije Maces* (T.) "Pyll", *Are Maçokut* (L.), *Bregu Mushkës* (P.), *Rripe Pelës* (F.), *Bregu Qenit* (Gje.), *Bregu Vitoreve* (Do.), *Grope Xhufit* (M. K.) "Majë mali jo e rrafshhtë" etj.

6. *Emërtime sipas rrjedhave ujore*. Këto emërtime përbëjnë një numër më të pakët.

Kjo shpjegohet edhe me atë që kjo krahinë, sidomos në periudhën e verës, ka pak ujë, nuk ka burime ujore me rrjedhë të vazhdueshme, me përjashtim të disa vendburimeve. Të tilla emërtime përmendim: *Gurr - a* (Gje.) "Vendburim uji", *Gurrz - a* (Tr. D.) "Vendburim uji", *Gjoll - i* (T. Gj. V. B. G.) "Vend me ujëmbledhës natyror", *Kroraz - i* (F. K. B.) "Vendburim uji", *Lagësirat*

(Zh.) "Toka me lagështi", *Moçalet* (B. M. Z. Zh.) "Toka të ujshme", *Moçal - i* (Sh. Rr. G. Gj.)¹⁵

7. *Emërtime sipas lëndës që përbën truallin e vendit*. Këto emërtime janë të pakta: *Çmës - i* (M.) "Shpat i veshur me shkurre, dherat e të cilit përmbajnë shkëmbinj të copëzuar, të çimentuar të formës konglomerat (me majë) dhe brekçe (me majë të rumbullakuar)", *Kërqeje-ja* (Gëlqere) (Gj.), *Rërz - a* (M.) "Arë me përbërje ranore", *Shëllirat* (G. U.) "Brinjë me rrëke të vogla, të thara, mbi siparfaqe të të cilave gjendet një përqindje shumë e vogël kripërash", *Shuf - i* (D. U.) "Breg me shkëmbinj sedimentarë të ngjeshur, me përmbajtje argjili të lartë, ngjyrë kafe të çelët", *Shur - i* (Rr. M. Gu. Z.) "Brinjë me shkëmbinj sedimentarë të copëzuar, të ndarë nga njëri - tjetri, të grumbulluar në masive mikrozonale", *Vapem - i* (Gu.) "Brinjë me dhera me depozitim të lartë gëlqereje, e cila është bërë një masë e vetme me dheun, por me xhepa, me pika gëlqerore", *Zall - i* (F.) "Arë e hapur në shtrat të lumit, me gurë (zaje) të shumtë" etj.

Këto emërtime janë edhe të pathjeshta, fjala e parë e të cilave është një emër sipas konfiguracionit: *Përroi Shëllirës* (F.), *Bregu Zallit* (V.) etj.

8. *Një grup emërtime janë vënë sipas emrit të një objekti të ndërtuar në atë vend* (duke përmendur në disa raste edhe ndërtuesin ose vepruesin). Objektet janë të vjetra ose të ndërtuara vonë, rrjedhimisht edhe toponimet janë të lashta ose të reja: *Çesmat* (Gu. L.), *Furrat* (F. V. B.), *Gjoll(ë)t* (Z. Zh. Gu. Sh. F. M. U. Gra. T. R.), *Kalldrëm-i* (M.), *Kolubet* (Gu.), *Kulat* (V. U.), *Mulli - ri* (Gu. Sh. U. Ko.), *Pus - i* (Gu.), *Qivur - i* (K.), *Vil - a* (Gra.) etj.

Emërtimet e këtij grupi përcaktohen nga një emër në gjinore, që tregon përkatësinë e objektit ndaj një personi, kafshe a diçkaje tjetër dhe nga një mbiemër, që shënon moshën ose përmasa a karakteristika të tjera të objektit: *Burimi Hysenit* (R.), - *Laces* (U.), *Çezme Fetaut* (T.), - *Hasanit* (Bu.), *Furre Lazes* (T.), *Kasolle*

¹⁵ Për vendet e emërtuara me emrin *Hurdhë* (*Hurdh - a* (F. Z.) "Arë", *Hurdhat* (B.) "Ara", *Hurdhas - i* (F. Gj.) ne flasim me rezervë që ky emër të lidhet me rrjedhë ujore, siç ndodh në ndonjë krahinë tjetër, sepse në toponimet e kësaj krahine kjo fjalë ka kuptimin "Tokë, arë, korie, pa ujë, ku është vështirë të nxjerrësh ujë". Për toka me lagështirë në Tomoricë përdoren emërtimet *moçal* e *lagësirë*. Vendet e emërtuara me emrin *moçal*, janë në të shumtën e rasteve ara, por dikur kanë qenë toka të ujshme. Fjala *moçal* në të folmen ka kuptimin "Tokë me lagështirë".

Velos (D.), *Kroi Buçkos* (K.), - *Isufit* (Ço.), - *Qershisë* (L.), *Mulliri Mahmutit* (V.), *Stani Beqirit* (K.), - *Çobos* (T.), - *Kajos* (U.), - *Priiftit* (Gje.), *Topile Alos* (K.), *Varret e Kaurit* (Da. K.), *Varri Lamit* (F.), *Vathe Çeços* (T.), - *Saliut* (M.), - *Veliut* (U.), *Çezme Gozhdës* (Tr.) (këtu emri Gozhdë është përdorur me kuptimin "shumë i ftohtë"). Këtë kuptim të kësaj fjale e kemi gjetur edhe te toponimi *Bregu Gozhdës* (Gu.), që do të thotë "Breg ku të kap shumë të ftohtit", *Gaxhole Madhe* (V.), *Kroi Bardhë* (Gje.), *Mulliri Vjetër* (B. K.), *Qivuri Madh* (T. Sh.), - *Vogël* (T.), *Shtëpit e Djegura* (Gje.), *Vile Bardhë* (Gje.) etj.

Emërtimi sipas një objekti del edhe si përcaktues në gjinore i një emri sipas konfiguracionit: *Are Hanit* (Do.), *Bregu Dyqanit* (M.), - *Stanit* (Zh.), *Grope Kalldrëmit* (Do.), *Përroi Kasolles* (Do.), *Rripe Qivurit* (Sh.).

Disa nga këto emërtime lidhen me institucione të ndryshme fetare: *Kish - a* (Gu. T. P. D. F.), *Kishz - a* (K.), *Kryqz - a* (F.), *Mekam - i* (Do.), *Teqe -ja* (U. K.), *Vakëfet* (V.), *Are Teqes* (F.), *Bregu Kish(ë)s* (Ço. Bu. Gra. R.), - *Teqes* (K.), *Çahiri Teqes* (K.), *Sheshi Xhamis* (Gje.) etj.

Do të sjellim këtu edhe disa emërtime që lidhen me qendra dikur të banuara, por që sot janë kthyer në troje, ara e kullota: *Duks - i* (R.), *Fshati Vjet(ë)r* (Gj) "Shpat", *Kazan - i* (Rr.) "Rrafshinë", *Meteriz - i* (F.) "Ara", *Qytet - i* (T.), *Qytez - a* etj.

9. *Emërtime të vëna sipas emrave të fshatrave përkatës, të fshatrave fqinjë ose të fshatrave të tjerë të krahinës së Tomoricës e të krahinave të tjera dhe në ndonjë rast sipas emrit të ndonjë rrethi.* Kjo shpjegohet jo vetëm se vendet e emëruara kanë qenë ose janë pronë e banorëve të fshatrave në fjalë, por edhe me lëvizjen e banorëve nga një fshat në tjetrin, brenda dhe jashtë krahinës, me imigrime të popullit dhe me ngjarje e ndodhi të ndryshme që lidhen me banorët e tyre. Emërtimet e këtij grupi dalin thjesht me emrin e fshatit a të rrethit, por edhe në trajtë të pathjeshtë. Në rastin e parë këto emërtime rrallë kanë marrë edhe prapashtesë. Të këtij grupi do të përmendim : *Zelenak - a* (Z.), *Zhepas - i* (L.), *Burranej - i* (U.), *Marjan - i* (L.), *Osoj(ë)z - a* (K.), *Patoz - i* (L.), *Skrapar - i* (Sh.), *Slatinj - a* (L.), *Varvar - a* (Ko.), *Vodic - a* (Ç.), etj.¹⁶ Emrat e fshatrave në fjalë mund të jenë edhe përcaktorë në gjinore të emërtimeve sipas konfiguracionit: *Are Çorrotatit* (Gu.), - *Davidhit* (Gr.), - *Dunckës* (Rr.), - *Floqit* (R.), - *Grabovës* (T.), *Bregu Dunckës* (Tr.), - *Gradecit* (U.), - *Skraparit* (Sh.), *Çuke Tërrovës* (D.), *Fushe Potomit* (Rr.), *Gropat e Sojatit* (Z.), *Grope Gjogovicës* (K.), *Luadhi Sojatit* (B.) etj. Këtu do të renditim edhe ato emërtime vendesh që i përkasin një lagjeje të fshatit dhe banorët e kanë emërtuar me emrin e asaj lagjeje: *Bendo - ja* (Z.), *Luadh - i* (Tr.), *Zelenak - u* (T.), *Fushe Konakut* (Ç.), - *Lagësirës* (K.) etj.

10. *Disa emërtime kanë në strukturën e tyre emra personash të huaj e vendesh të huaja.* Kjo shpjegohet me sulmin dhe pushtimin e vendit tonë nga shtetet e tjera, ushtritë e të cilave kanë kaluar edhe Tomoricën. Këto emërtime janë të pakta: *Çuke*

¹⁶ Këta fshatra gjenden në krahinat: Tomoricë, Potom, Qendër e Skraparit, Opar (Korçë) e gjetkë.

Fr(ë)ngut (T.),¹⁷ *Frëngjet (Gu.)*, *Furre Austrisë (K.)*, *Lëmze Grekut (V.)*, *Lëmi Turkut (T.)*, *Sheshi Turkut (Da.)* etj.

11. *Pak emërtime janë të lidhura me besime të ndryshme fetare.* Banorët e Tomoricës kanë qenë të besimit mysliman, megjithatë në toponimi gjenden edhe emërtime që lidhen me besime të tjera: *Bregu Sh(ë)nkollit (B.)*, - *Sh(ë)ndlliut (Gje.)*, - *Sh(ë)mitrs (G.)*, *Guri Shepremtës (Sh.)*, *Shepremtëz - a (F.)*, *Shmitr - a (Z.)*, *Sh(ë)nd(ë)llia (M.)*, *Sh(ë)ngjergj - i (Gje.)*, *Ujët e Sh(ë)ngjergjit (Ko.)*, etj.

12. Në këtë grup do të renditim ato emërtime që nuk mund të grupohen sipas një kriteri të caktuar, për vetë kuptimin që ato përmbajnë në vetvete. Këto janë emërtime të pathjeshta ose një fjalë e vetme: *Furtun - a (Z.)* "Vend ku kap shumë era dhe bën shumë ftohtë", *Koritat (T.)* "Vend ku kanë qenë disa korita", *Lopataz - i (Tr.)*, *Mashaz - i (Sh.)*, *Mundimez - a (Sh.)*, *Nishan - i (Sh.)* "Vend ku merrnin shenjë", *Qilizm - a (U.)*, *Bregu Buk(ë)s (Gje.)*, - *Cinglit (M.)* "Breg ku luanin cingël", - *Daulles (Sh.)* "Breg ku bën shumë ftohtë", - *Kopaçes (Rr.)* "Vend ku dikur janë rrahur", - *Kosave (K.)* "Vend ku pushonin e kalitnin kosat kosaxhinjtë", *Çuke Djepes (Gje.)*, "Greminë ku janë hedhur gra të këtij fshati megjithë fëmijë për të mos rënë në duart e pushtuesit", - *Pilafit (Gje.)*, *Faqe Les(ë)s (Z.)*, *Fushe Boj(ë)s (Gu. Ço.)*, - *Pazarit (Do.)*, *Grope Palldëmit (P.)*, - *Qypit (Gj.)*, *Guri Spat(ë)s (Gr.)*, *Lëmi i Shamatas (T.)*, *Prroi Dasm(ë)s (Da.)*, *Rripe Dh(ë)mballs (D.)*, *Shpelle Pilafit (T.)* etj.

Formimi i toponimeve

Parashtesa *nd(ë)r* - duke iu paravënë një emri sendi, objekti, bime etj., formon emërtime që tregojnë vende ku gjendet me shumicë ajo që tregon tema fjalëformuese dhe vendi i emërtuar gjendet në mes a midis tyre: *Nd(ë)rthanas (Rr. T. Gj.)*, *Nd(ë)rvidhas (L.)*, *Nd(ë)rgurës (Da. V.)*¹⁸

Parashtesa *n(ë)n* - formon emra topikë prej emrash: *N(ë)nmoçal (Gr.)*, *N(ë)nshkëmb (Po.)*.

Prapashtesa - *al(e)* me emrin *breg* ka formuar: *Bregal (B.)*, *Brekale (T.)* (me shurdhim të *g* - së). Kjo prapashtesë ruan kuptimin e zvogëlimit, si dhe në të folmen e krahinës.

Prapashtesat - *as*, - *az* paraqiten si variante në formimin e këtyre emërtimeve. Të tilla funksionojnë ato edhe në gjuhën e përgjithshme.¹⁹ Prapashtesa - *az*

¹⁷ Ky toponim gjendet edhe në fshatin Kapinovë (Krahina e Potomit - Skrapar).

¹⁸ A. Xhuvani dhe E. Çabej vërejnë se kjo parashtesë gjendet më shpesh në fjalë të gegërishtes dhe tregon tek emri një objekt etj. që është midis dy të tjerëve (shih A. Xhuvani - E. Çabej, *Parashtesat në gjuhën shqipe*, "Aleksander Xhuvani", vep.cit., f. 391). Këtë funksion kjo parashtesë me origjinë parafjalore e ruan edhe në Tomoricë. Kur përdoret si parafjalë në këtë të folme, veç këtij funksioni, tregon edhe drejtimin e veprimit, p. sh. "Nesër ai vjen ndër ne (tek ne)". Me këtë funksion duhet të jetë përdorur tek toponimi: *Nd(ë)rkishëz (Rr.)*, sepse edhe emri është në njëjës.

¹⁹ Shih E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare*, SF, 1, 1970, f. 125

shqiptohet *as* shpesh dhe dallimi bëhet i qartë në trajtë të shquar, p. sh.: *Kalas - i* (F.) < *Kalo, Plakas - i* (T.), *Kovaças - i* (Sh.), *Dardhas - zi* (K.), *Hurdhas - zi* (F.), *Palas - zi* (K.), *Sëraz - i* (T.), *Greminas - zi* (B.), *Gropas - zi* (L.), *Kasollaz - i* (Bu.), *Kumbllaz - i* (K.), *Vreshtaz - i* (K.) etj.

Prapashtesa - *ez* del shumë rrallë në formimin e këtyre emërtimeve. Vetëm në dy raste ajo bashkë me një emër sendi e bime ka formuar emër që emërton toka të punueshme: *Gur - ez* (K.), *Oriz - ez* (Do.). Tek toponimi *Jonxhez* (G.) duhet veçuar prapashtesa -*z*, pasi trajta *jonxhe* e emrit *jonxhë* është mjaft e përhapur në krahinë. Toponimi *Gurez* del edhe në trajtën *Gurëz* me prapashtesën - *z*, por tek *Gurez* ne veçojmë prapashtesën - *ez*, sepse shumësi *gure*, që përdoret në krahinat e Vlorës, Beratit etj., në Tomoricë e Skrapar nuk përdoret.

Prapashtesa - *ëz* ka formuar me emra mashkullorë emra arash, që dalin gjithnjë në femërore njëjës: *Luadhz - a* (Z.), *Mënz - a e Veliut* (F.), *Vidhz - a* (Rr.), *Fundz - a* (Rr.) etj.

Prapashtesa sllave - *nik*,²⁰ mjaft aktive në të folmen e krahinës, me epentezë me *a* ka formuar *Molanik* (M.). Kjo prapashtesë ka formuar edhe emrin e fshatit *Ujanik* nga një fjalë shqipe (Shih më poshtë të prejardhja).

Prapashtesa - *arak(e)* formon emra arash nga emra mbi bazën e krahasimit, ku ruhet edhe kuptimi zvogëlues: *Bishtarak* (Rr.), *Bishtarake* (U. Gu. F.) etj.

Prapashtesat sllave - *ov(ë)* dhe - *ec*²¹ dalin në emërtime me burim të huaj, për të cilat në të shumtën e rasteve është vështirë të gjendet primitivi: *Bobov(ë)* (Gj.), *Plavov(ë)* (Gj.), *Sadov(ë)* (Gj.), *Borzovec* (Da.), *Privadec* (Gj.), *Leskovec* (K.). Me këto prapashtesa janë formuar edhe emrat e fshatrave *Leskov(ë)*, *Mëlov(ë)*, *Gradec* nga një fjalë me burim të huaj.

Prapashtesa - *rishte* ka formuar dy toponime që lidhen me terminologjinë blegtorale: *Plerishte* (P.), *Vathrishte* (M.).

Prapashtesa - *th* ka formuar emra arash, lëndinash etj., duke iu shtuar një emri bime, sendi etj.: *Fik - th* (Do.), *Fikthet* (Tr.), *Lëm - th* (Gj. D. F.), *Sk(ë)nder - th* (Gj.), *Stan - th* (F.). Kjo prapashtesë nuk ruan kuptim zvogëlues në këto formime.

Prapashtesa - *z* është mjaft prodhuese në formimet toponimike të Tomoricës. Kjo prapashtesë u shtohet temave të njëjësit a të shumësit. Kur i shtohet temës së shumësit, emërtimi i formuar tregon vend ku gjendet shumicë sendesh etj. të emërtuara nga tema fjalëformuese: *Mure - z* (K.) "Ara ku gjenden disa mure", *Moçale - z* (F.), *Stane - z* (Sh.), *Sheshe - z* (K.), *Kryqe - z* (F.), *Mundime - z* (Sh.).

Në përgjithësi kjo prapashtesë në emërtimet toponimike e ka humbur kuptimin zvogëlues: *Govat - z* (Rr.), *Lëpjet - z* (Rr.), *Sër - z* (M.), *Xhelo - z* (Sh.) etj. Ruan këtë kuptim në disa emërtime: *Kulë - z* (F.) "Breg i vogël", *Qafë - z* (K.), *Shkall - z* (M.), *Shapk - z* (B.).

Në toponiminë e Tomoricës ndeshen edhe emërtime të formuara nga dy prapashtesa: *Elb - isht - ez* (Do.), *Ferr - isht - az* (K.), *Vath - risht - az* (Gu.), *Vjesht - al - ez* (Do.), *Jak - llar - kë* (Zh.), *Kadi - llar - kë* (Zh.) etj.

²⁰ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat....*, vep. cit., f. 518

²¹ *Po aty*, f. 464

2. Emërtimet e vendeve të krahinës së Tomoricës dalin edhe në trajtën e një kompozite. Këto emërtime kompozita do të analizohen sipas komponentëve përbërës të tyre.²²

a. Një numër i madh emërtimeësh kompozita janë formuar nga dy tema nominale. Këtu dallohen emërtimet me komponent të parë një emër vendi, zakonisht i vënë sipas konfiguracionit, ose një emër tjetër me komponent përcaktues që zërthehet si një gjinore plotësore.²³ Komponenti i dytë është një emër që tregon përkatësi, pronësi, një tipar a diçka tjetër: *Brekselim - i* (Bu.), *Breksk(ë)nder - i* (Ço.), *Luadhkuç - i* (G.), *Sheshaliu* (Tr.), *Brekqytet(ë)s - i* (Bu.) etj. Tek emërtimi *Bregjigrëmsh - i* (Gje.) krahas kthimit të *g - së* në *gj*, ruhet edhe nyja e përparme *i*. Zakonisht emri komponent i dytë në këto emërtime del në gjininë e komponentit të parë, por tek emërtimi *Dushkulus - a* (M.) nuk ka ndodhur kështu.

Tek disa emërtime të këtij lloji, për lehtësi shqiptimi, në fjalën e parë ka ndodhur fenomeni i sinkopës (rënia e një a disa tingujve), si: *Gjohelm - i* (B.), *Groplak - u* (Z.), *Prrogoleme - ja* (Z.) etj. Emri i parë në këto kompozita është një emër bime, sendi a diçkaje tjetër që tregon se ku ndodhet një truall, pyll, kullotë etj: *Gropdos - a* (Z.), *Rrëzpajn - a* (Po.). Dy emërtimet kompozita: *Gjemiot - i* (Do.) dhe *Këmborr(ë)z - a* (Rr.) emërtojnë toka (ara) ku ka me shumicë bimë të emërtuara nga komponenti i parë ose e tërë kompozita.

Rrallëherë komponenti i parë është një emër që tregon konfiguracion mbi një krahasim: *Veshdos - a* (Gje.), *Bishtali - u* (Gra.).

Në të dy emërtime toponimike të këtij lloji të dy komponentët janë të barazvlefshëm dhe lidhen me lidhëzën *e*: *Sheshemën - i* (U.), *Prroi Ylleshenjs* (Bu.).

Në një rast të vetëm në toponiminë e Tomoricës kemi ndeshur emërtimin kompozitë të formuar nga dy emra të përveçëm (emri dhe patronimi): *Alibash(ë)z - a* (Bu.) < *Ali Pasha*.

b. Numër më të kufizuar përbëjnë emërtimet kompozita me strukturë *emër + mbiemër*. Tek këto kompozita komponenti i dytë jo në çdo rast ka ngarkesë pronësore e mëvetësi absolute: *Brinjkeqe - ja* (Gu.), *Krezith - i* (Ço.) (me prapashtesën - *th*), *Pllajmath - dhi* (Tr.), *Are Salimadhit* (B.), *Gjëmkuq - i* (Do.), *Damari Gjëmkuqit* (Do.) etj. Bëjnë përjashtim këtu disa emërtime, të cilat emërtojnë troje që ruajnë lidhje të ndryshme me personin a sendin e treguar nga komponenti i parë: *Bukmir - a* (Ço.) "Arë që bën bukën, grurin të mirë", *Birbijak - a* (Gj.), *Bushtrkuq - a* (Ço.), *Hasankuq - a* (B.). Tek emërtimi i fundit mbiemri tregon tipar të truallit që emërton gjithë kompozita.

c. Të pakta rezultojnë në toponiminë e kësaj krahine emërtimet kompozita të formuara nga *ndajfolje + emër* dhe anasjelltas. Formimi i këtyre emërtimeve ka ndjekur një rrugë të drejtë formimi, ku komponenti i parë është i përcaktuari dhe i

²² Për analizën e këtyre strukturave jemi mbështetur në klasifikimin e bërë nga A. Kostollari në artikullin "Kontribut për klasifikimin e tipeve kryesore të kompozitave në fushën e mikrooronimisë shqiptare," SF, 3, 1971, f. 51 - 63

²³ Po ai, po aty, f. 52

dyti përcaktuesi. Këto kompozita janë mjaft të rralla: *Lumbashk - a* (M.), *Sheshbashk - a* (U.). Numër më të madh përbëjnë emërtimet kompozita të formuara në mënyrë të përkundërt me rrugën e formimit logjik:²⁴ *Përtejulum - a* (Ko.), *Pobreg - u* (Gj.) (me sinkopë tek komponenti i parë), *Prapabreg - u* (M.), *Prapakish - a* (Ko.), *Praparrip - a* (T.), *Prapashkëmb - i* (Po. K.), *Poshtëndarz - a* (K.). Komponenti i dytë është zgjeruar në *nd* dhe me prapashtesën zvogëluese - z.

d. Emërtim kompozitë i formuar nga *mbiemër + mbiemër* në materialin e grumbulluar del vetëm toponimi *Balibardh - a* (Gra.). Ky emërtim gjendet edhe në toponiminë e Skraparit dhe A. Kostollari e analizon si antroponim të epokës antike *Bardibalus*²⁵

e. Një emërtim i vetëm rezulton i formuar nga *ndajfolje + ndajfolje : Atjeposht - a* (L.).

f. Emërtimet toponimike të formuara me anë të substantivimit të qëndrueshëm të mbiemrit, me ose pa fjalë përcaktuese, janë të pakta: *E djegura* (D. Ko. Do.), *Të djegurat* (Gj.), *E lerosura* (R.) etj.

Prejardhjen e disa toponimeve

Në këtë kapitull do të mundohemi të japim shpjegim për disa toponime, të cilave nuk u zëbërthet kuptimi sipas kriterëve të mësipërme dhe që mund të jenë fjalë të gurrës autoktone ose të huaj. Do të vështrojmë nga pikëpamja historike e gjuhësore disa nga makrotoponimet e kësaj krahine dhe ndonjë mikrotoponim, duke vënë në dukje raportin element vendës dhe i huaj.

Disa emërtime vendesh të Tomoricës janë të njëjta me ato të krahinave të tjera dhe nga prejardhja janë shpjeguar nga studiues të tjerë.²⁶

Emri i krahinës në defterin e Inalçikut del *Tomornicë*, ku ruhet grupi *rn*, i cili ka përfunduar në *r*. Ky emërtim është formim me prapashtesën me burim sllav - *icë*²⁷ nga emri *Tomor* (mali i Tomorit).

Fshati *Gjogovicë* është shënuar nga Inalçiku *Kalkovicë*, ndërsa në hartën e Selishçevit është shënuar *ДЯКОБуЦа*.²⁸ Vendësit tregojnë se ky emër ka ardhur nga *Gjokë* (emër i një fisi), i cili ka banuar në këtë fshat. Këtij emri i janë shtuar prapashtesat e burimit sllav - *ovë* dhe - *icë*. Selishçevi, nga ana tjetër, pranon dy mundësi për emërtimin e këtij fshati: e para, emri i këtij fshati mund të tregojë për qënien këtu të një dhjaku (dhjak nga greqishtja e re δᾶκος). Në këtë fshat ka pasur dhjakë që lexonin lutjet. Në fshatin ДЯКОВИЦа ndodheshin pronat e një dhjaku të tillë. Por, thotë Selishçevi, është e vështirë që këta dhjakë lexues të kishin prona në Shqipëri. Në Shqipëri edhe priftërinjtë e kamur nuk kanë lënë gjurmë të

²⁴ A. Xhuvani, *Kompozitat*, "Studime mbi leksikon...", I, vep. e cit., f. 171

²⁵ A. Kostollari, "Kontribut për klasifikimin e tipeve kryesore ..., art. cit., f. 56.

²⁶ Emërtimet *Korita*, *Selishta*, *Golem*, *Kuç*, *Katafiq* dhe *Trap*, të cilat takohen edhe në toponiminë e Tomoricës: *Koritat* (U.), *Selishta* (F. L.), *Gropa e Golemit* (F.), *Përroi i Golemit* (Z.), *Kuç* (fsht), *Katafiq* (U.), *Trap* (F.) janë analizuar nga A. Dhrimo në "Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit", SF. 4, 1974, F. 174, 176, 177, 182, 183.

²⁷ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat...*, vep. cit., f.448

²⁸ A. M. Selishçev, *Slavianskoe naselenie v Albanii*, Sofia, 1931, 252, 253 (4C)

rëndësishme në toponimi; e dyta, francezi J. Burkar (J. Bourcart'a) në hartën e punimit të tij "Les confins albanais" ("Kufijtë shqiptarë"), f. 304 e shënon *Gjogovicë*. Selishçevi shpreh mendimin se, në qoftë se trajta *Gjogovicë*, e shënuar nga J. Burkari është më e vjetër se ДЯКОВИЦА (Djakovica), ky emër është formim shqiptar. Për mendimin tonë, trajta *Gjogovicë* është primare, jo vetëm për çka thuhet më sipër, por edhe për faktin tjetër se në toponimet e këtij fshati do të kishte edhe emërtime të tjera që lidheshin me sferën kishtare sllave. Emri *Gjogovicë* do të jetë formim sipas emrit të personit e më vonë emër fisi *Gjokë* me sonorizim të velarit *k* në *g*. Një mundësi tjetër për emërtimin e këtij fshati është lidhja e emrit të tij me *gjog-u* "Kalë i bardhë". Skraparllinjtë kanë mbajtur pranë shtëpive të tyre si kafshë samari që në kohë të vjetra mushka dhe kuaj për shkak të rrugëve të gjata, për pazare etj. Një dukuri të tillë e vërejmë edhe tek emërtimi *Xhogovinë* (F.), i cili duhet të ketë ardhur nga emri *Gjokë* (emër fisi, që jeton edhe sot në *Floq*) ose *Gjog - u* me prapashtesën sllave *-ovinë*.²⁹ Tek emri *Gjogovicë* kemi vetëm sonorizim të velarit *k* në *g*, kurse tek emri *Xhogovinë* kemi kalim të *gj - së* në *xh* (dukuri karakteristike për të folmen veriore) dhe të *k - së* në *g* (karakteristike për këtë të folme).

Emri *Kovaçanj*, sipas Selishçevit, ka ardhur nga kobaЧ (u) profesion që është ushtruar shumë në këtë fshat. Ai e shënon në hartën e tij КоваЧани (4С, 248), pa asnjë ndryshim fonetik nga trajta e sotme. Meqë fjala *kovaç* është e mbarë shqipes dhe jeton si apelativ edhe sot, duhet thënë se emërtimi është bërë nga vetë shqiptarët, me një fjalë të gurrës së huaj (sllave). Emrit *kovaç* i është shtuar edhe prapashtesa *-anj*, që sipas studiuesve tanë, është trajta e parë e prapashtesës *-aj* të shqipes së sotme dhe është e burimit shqip.³⁰

Ujaniku, fshat në lartësitë e Tomorit nuk është shënuar nga Inalçiku, kurse Selishçevi e shënon УЯНИК (Ujanik) (217, 247, 301, 326, 4С). Sipas Selishçevit, kjo fjalë ka ardhur nga УЛЯР që reflekton sllav. "Rritës bletësh". Banorët e këtij fshati, më shumë në të kaluarën, por edhe sot merren me rritje bletësh. Megjithatë, emërtimi i këtij fshati nuk mund të jetë bërë sipas këtij profesioni të ushtruar nga vendësit, sepse në krahinën e Tomoricës ka pasur (edhe ka) edhe fshatra të tjerë, banorët e të cilëve e kanë ushtruar këtë profesion ndoshta edhe më shumë. Prandaj, për mendimin tonë, emërtimi i këtij fshati ka më shumë mundësi të jetë bërë nga shqiptarët me një fjalë të shqipes ujë³¹ Trevat ku është vendosur fshati janë të pasura me ujë, sidomos në jug të tij rrjedh mjaft ujë. Selishçevi jep dy trajta të këtij emri: УЛЯНИК e УЯНИК dhe thotë se trajta me *j* është huazim më i hershëm, kurse trajta me *l* është mjaft e vonë. Meqë fshati ruan emrin *Ujanik* (ku ruhet *j - ja*), pranohet më shumë mundësia që ky emër të jetë krijuar nga vendësit me emrin *ujë* dhe me prapashtesën *-nik*.

Emrin *Gjerbës* (emër fshati) e ka trajtuar gjerësisht prof. E. Çabej. Ai, duke polemizuar me studiues të ndryshëm, si Maks Vesmer, J. Shrofer (J. Schropfer), E. Hamp (E. Haemp) e sidomos J. Zaimov, të cilët vënë për bazë të këtij emri një

²⁹ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat...*, vep. cit., f. 505

³⁰ По ај, по аты, f. 429

³¹ E. Çabej, *Dy çështje gjuhësore*, GJA SF, VII, 1977, Prishtinë, 1978, f. 33

sllav. Гъбеш dhe e lidhin brenda sllavishtes me гърбѣ "Kurriz", sheh te fjala *gjerbë* kuptimin thelb të saj "pikë", "cirkë", "cikë", ndër të tjera *gjerbë* "pikë uji".³² Siç shihet, në thelb të fjalës është *gjerbë*, një fjalë mjaft e vjetër, që sot ka një përdorim mjaft të shpeshtë dhe një shtrirje të gjerë në krahinë e gjetkë. Në Tomoricë përdoret edhe emri *gjerbë*, edhe folja *gjerbit* "Pi pak nga pak". Meqë jemi vendës në këtë krahinë, do të saktësojmë se fshati *Gjerbës* është i pasur me kroje e burime të vogla, që gjatë periudhës së verës kanë ujë të pakët, e pothuaj shterojnë. Ky emër është dokumentuar në regjistrin turk të vitit 1431 dhe ka pasur përhapje të madhe.³³ Ky emër i lashtë është vënë nga vetë shqiptarët dhe dëshmon për banimin e hershëm të tyre.

Emrin *Krasta* Selishçevi e lidh me sllav. КРАСТА (215) "shkëmb", rus. *ymëc*, "shkëmb". Vendi është shesh dhe në anën e poshtme është shkëmb. Ky emërtim mund të jetë vendosur mbi këtë bazë, por theksojmë se në fshatin *Leskovë* ky emërtim na del edhe si emër are, ndërsa në një krahinë tjetër të Skraparit del emër fshati, *Krasta*. Ky i fundit ka terren joshkëmbor. Këto raste nuk mbështetin prejardhjen sllave të këtij emri.

Emri *Barç*, emër fshati i dokumentuar në regjistrin turk në trajtën e sotme *Barç*, duhet të ketë kuptimin "i bardhë", "bardhë" duke iu shtuar prapashtesa - ç. Sot ky fshat është i ndarë në dy pjesë: *Barç i Sipërm* dhe *Barç i Poshtëm*. Karakteristikë është se trualli i këtij fshati është me ngjyrë disi të bardhë. Fshati *Barç* bën pjesë në *Tomoricën e Zezë*, dhe, meqë ka këtë karakteristikë të veçantë të truallit, emërtimi është bërë nga vendësit në bazë të kësaj karakteristike. Emri *Barç* dëgjohet edhe në krahina të tjera si Korçë e gjetkë.

Fshati *Burranej* i shënuar në regjistrin turk *Buraniy*, është formim nga emri *burrë* me prapashtesën - *anj*, që është e burimit shqip.

Edhe emri i fshatit *Floq*, dokumentuar në regjistër *Filok*, ka ardhur nga fjala *flok* me kalim të velarit *k* në *q*. Është formim pa ndonjë prapashtesë. Ky emër del edhe në Korçë e gjetkë. Kjo tregon se është një emër i vjetër.

Fshati *Grëmsh*, ku ndihet *ë* - ja e theksuar në vend të *a* - së nazale, nuk dokumentohet në regjistrin turk. Ky emër duhet të jetë vënë sipas fjalës *gram* - *i*, duke iu shtuar prapashtesa - *sh*. Kjo prapashtesë ka ndërtuar edhe emra të tjerë topikë.³⁴ Emri *Grëmsh* (Gramsh) del edhe në krahina të tjera të vendit.

Vazhdimësi etnokulturore të një popullsie vendëse që në periudhën parasllave e deri më sot shpreh edhe prania e një numri mikrotoponimesh që lidhen me sferën kishtarë romake dhe sferën kristiane ortodokse. Zhvillimi i tyre shpjegohet me ligjet fonetike të gjuhës shqipe. Të tilla emërtime përmendim: *Shëmbërdhenj* - *i* (fshat), *Shepremtëz* - *a* (F.), *Guri i Shepremtës* (Sh.), *Shëmitër* - *a* (Z.), *Shëngjergj* - *i* (Gj.), *Bregu i Shënkollit* (B.), *Shëndëlli* - *a* (M.), *Kishëz* - *a* (K.), *Kryqëz* - *a* (K.) etj.

Prania e terminologjisë kishtarë romake dhe mungesa e asaj sllave në toponiminë e Tomoricës tregon se në kohën e ardhjes së sllavëve në vendin tonë

³² *Po aty*, f. 33

³³ *Po aty*, f. 31

³⁴ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat...*, vep. e cit., f. 538

kisha shqiptare kishte formën e saj të plotë dhe të organizuar. Një gjë e tillë vihet re edhe në vise të tjera të vendit.³⁵

Për një kohë të lashtë dhe për vazhdimësi na duket se flasin edhe disa makrotoponime që lidhen me emra personash ose që shfaqin dukuri të vjetra të shqipes. Emri i fshatit *Gurrabez* është një kompozitë e formuar nga *gurrë* dhe *i zi* me zanoren lidhëse *a*. Kompozita të kësaj natyre janë të vjetra.³⁶

Emërtimet *Faqez - a* (V.), *Lugjez - t* (F.), *Gurez - a* (F.), janë formime me prapashtesën e vjetër shqipe - *z* me origjinë indoevropiane.³⁷

Emërtimet *Gjink - a* (F.), *Gjinisht - i* (G.), *Gjinjat* (T.) kanë në bazë të tyre emrin *Gjin*, që është mjaft i përhapur në krahinat veriore.

³⁵ M. Trepça - A. Hoxha, *Vështrim historiko - gjuhësor mbi toponimet e trevës së Dibrës*, SF, 3, 1982, f. 175

³⁶ A. Xhuvani, *Kompozita...*, vep. e cit., f. 70; A. Kostollari, *Mbi disa veçori të fjalës së përberë...*, vep. e cit., f. 86

³⁷ A. Xhuvani - E. Çabej, *Prapashtesat...*, vep. e cit., f. 577, shën. XI.

XHEVAT LLOSHI**MARRËDHËNIET E LËVIZJES PROTESTANTE
ME RILINDJEN KOMBËTARE**

Historia e Shqipërisë është histori e një vendi europian. Është e vërtetë që deri në shekullin e kaluar ajo u ndodh nën sundimin e gjatë prej një vendi aziatik, por na bie të pranojmë se edhe çlirimi prej tij nuk mund të bëhej pa rrjedhat europiane. Historiografia jonë pothuaj kurdoherë ka nënvizuar rolin e faktorëve të brendshëm, qëndresën në rritje deri te kryengritja e armatosur e popullit shqiptar, që solli pavarësinë. Ndërkaq, më duket se është e nevojshme tashti të vëmë në dukje gjithashtu, që kjo nuk ishte një veprimtari e izoluar, e përfutur vetëm nga proceset e brendshme, sepse atëhere do të ishte e shkëputur prej zhvillimeve europiane, domethënë duke nënkuptuar padashur, se nuk ishte pjesë e historisë sonë europiane.

Në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX në viset shqiptare depërtuan idetë e iluminizmit europian, jehonat e parimeve dhe të ngjarjeve të përfutura nga Revolucioni Francez e më pas nga romantizmi, si dhe më nga afër, shembulli i përpjekjeve mes popujve të tjerë të Ballkanit për t'u shkëputur si nga sundimi i huaj e prapambetja, ashtu edhe për të ecur në rrugën e qytetërimit, pjesëmarrës të të cilit kishin qenë edhe viset shqiptare si vise europiane. Lëvizja që i mori përsipër këto detyra madhore është quajtur Rilindja Kombëtare. Kjo lëvizje e thellë ideore, politike dhe më pas luftarake nuk mund të përfutohej pa e vetëdijësuar popullin për fatet e tij, domethënë pa e çuar nga gjumi i vetëdijes kombëtare, ku e kishte zhytur sundimi i huaj po aq i gjatë, sa edhe i prapambetur. Ndërsa zgjimi për të dalë nga errësira e natës drejt dritës së përparimit mund të arrihej në radhë të parë nëpërmjet ndriçimit të mendjes, domethënë arsimimit dhe kulturës. Nuk është e rastit atëhere, që në gjithë ligjëratën rilindëse vend qendror zë figura e dritës dhe e diturisë si dritë. Pothuaj kushdo i ruan në kujtesë fjalët e Naimit: “Dhe dritë’ e diturisë përpara do na shpjerë.”

Dituria jepet sistematikisht në shkollë dhe nëpër Shqipëri shkolla kishte gjithandej, veçse asnjë në gjuhën shqipe, domethënë asnjë kombëtare, sepse shkollë kombëtare para së gjithash do të thotë shkollë në gjuhën shqipe. Nga ky këndvështrim, për arsimin shqip kanë dhënë ndihmesën e tyre të gjithë ata që kanë lëvruar shqipen e shkruar, duke nisur me Gjon Buzukun më 1555. Ndërkaq, edhe në fillim të shekullit të Rilindjes ende nuk kishim arritur te një alfabet i përbashkët, i cili është porta e parë për ta hapur, që të hysh në botën e madhe të librit, të shkollës, të gazetave, të letërsisë dhe më së fundi të gjuhës së shtetit të pavarur. Kjo do të thotë se për kulturën tonë merrte një peshë të jashtëzakonshme përcaktimi i alfabetit.

Edhe për udhën e shkronjave të alfabetit tonë nuk është vënë në dukje, se për ta shtruar atë ka pasur ndihmesa gjithashtu nga dija europiane. Pa hyrë në hollësi, do të pohoj se Kongresi i Manastirit e zgjidhi mjeshtërisht këtë detyrë të parë madhore të shqipes së shkruar, sepse nga autorët shqiptarë dhe dijetarët e huaj ishte përcaktuar sistemi tingullor i shqipes. Kurse në etapat e kësaj udhe nuk mund të mos e drejtojmë vëmendjen te një prurje e çmueshme, që lidhet me veprimtarinë protestante.

Më 1804 në Londër ishte themeluar Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Vetëm dhjetë vjet më pas filologu dhe iluministi sloven, Jernej Kopitari (1780-1844), pasi mësoi për ngritjen e Shoqërisë Biblike, me vizionin e tij perandorak përpunoi idenë për ta përkthyer Dhiatën e re në disa gjuhë të Ballkanit, domethënë edhe shqip, si hapin e parë për t'i ndriçuar këta popuj, sepse vetë iluminizmi do të thotë ndriçimtari. Kopitari iu drejtua Londrës dhe çështja vajti në duart e përfaqësuesit më të rëndësishëm të Shoqërisë Biblike gjatë dyqind vjetëve, Robert Pinkertonit (1780-1859). Ai erdhi në Vjenë dhe që të dy bashkë e parashtruan çështjen në sferat më të larta të shtetit austriak. Ishte Pinkertoni, që e përmendi për herë të parë në Projektin e tij më 24 gusht 1816 nevojën e një përkthimi shqip, kurse vetëm katër ditë më pas njofton se e njeh shtrirjen e shqiptarëve, gjendjen e tyre arsimore, cili alfabet do të ishte më i pranueshëm dhe kush mund ta ndërmerre përkthimin. Por sidomos tërheq vëmendjen, se ai e ka biseduar gjithanshëm çështjen me shqiptarë të arsimuar në Vjenë.

Ky është pra, takimi i parë vendimtar i shqiptarëve me lëvizjen protestante. Zhvillimet e mëtejshme i kam trajtuar në një libër më vete,¹ por nuk mund të mos theksoj, se Pinkertoni e ndoqi punën më tej dhe e shtroi si një nga detyrat parësore të Shoqërisë Biblike Joniane, kur kjo u themelua në Korfuz në korrik 1819, madje vajti edhe në ishujt egjeanë, ku u habit nga prania e madhe e arbëreshëve, ndërsa vërente se një e treta e banorëve të Athinës ishin shqiptarë. E që në këta hapa të parë shfaqet interesimi për dialektet e shqipes, shqetësimi për gjendjen e mjerueshme të paditurisë ashtu si dhe te vëllezërit e tyre në malet e Epirit, por si synimi madhor del, që shqipja e shkruar të bëhet gjuhë e familjeve të tyre, sepse ky ishte një kusht i domosdoshëm, që të bënin përparime të qëndrueshme në rrugën e qytetërimit të mirëfilltë. Jemi në vitet pararendëse të Rilindjes sonë, por sa të ngjashme janë këto me idetë dhe qëllimet e saj. Kush e ndihmonte shqipen në shekullin e Rilindjes sonë ishte i mirëpritur dhe e kishte të fituar fushën edhe për sipërmarrjen e vet. Dëshiroj të nxjerr në pah një dukuri, që i jep një mbështetje të jashtëzakonshme pohimit të mësipërm. Dokumentet e kohës i përshkon ky konstatim i shumë njerëzve të kohës: megjithëse përkthimet biblike natyrshëm i përkisnin konfesionit të krishterë, ato merreshin me dëshirë edhe nga myslimanët shqiptarë. Po citoj vetëm fjalët e librashitësit Mihail më 1883: “Kam parë që përdorimi i gjuhës amtare është një forcë tërheqëse e fuqishme për shqiptarët myslimanë, ndër të cilët jo pak vetave u kam mësuar si të lexojnë shqip.”²

Pinkertoni nënshkroi marrëveshjen me Vangjel Meksin për përkthimin shqip, po gjithsesi nuk e bëri këtë thjesht sepse ia kërkonte detyra e tij. Ai e ka thënë shkoqur: “Përkthimi në gjuhën shqipe më është lidhur në zemër në këta disa vjet të shkuar aq fort, sa me të vërtetë nuk mund të shpëtoja prej tij.”³ Duke bërë një

përgjithësim mbi shtjellimet e mëtejshme për njëqind vjet, do të shprehesh, se punën me shqipen dhe me shqiptarët përfaqësuesit protestantë e kanë bërë edhe me pasion, me dashuri për këtë popull të lashtë e mikpritës.

Pa pasur rrezik se kjo do të quhej e tepruar, unë do të nënvizoja se lëvizja protestante në Ballkan ka qenë filoshqiptare dhe si e tillë, natyrshëm do të përputhej me dëshirat e çdo rilindësi për bashkatdhetarët e vet. Kur pas Kongresit të Berlinit në Stamboll po vendosej harta për territoret, që do të shkëputeshin prej Turqisë së mundur, i shqetësuar nga pretendimet e fqinjëve shovinistë, Tomsoni ka shkruar se ai: “kundërshton me forcë çfarëdo ndarje të territoreve, që nuk do të merrte parasysh mëtimet e shqiptarëve për ekzistencën e tyre kombëtare të dalluar, për njohjen e së cilës atje ka një dëshirë gjithnjë në rritje mes tyre.”⁴ Ka qenë Tomsoni, që Lordin Ficmoris (E. Fitzmaurice), të dërguarin e Britanisë për bisedimet e Komisionit të Rumelisë në Stamboll, e lidhi me Kristoforidhin për një intervistë, e cila u botua në dokumentet zyrtare.⁵ Duke kapërcyer mbi 30 vjet, do të citoja fjalët e misionarit amerikan Telford Erikson më 1913: “Ky komb është një zambak i bukur, por i rrethuar prej ferrash, që nuk e lënë të lëshojë erën e tij të këndshme.”⁶

Nga një anë tjetër, këta përfaqësues i kanë pranuar dhe i kanë shprehur në raste të ndryshme përfytyrimet e Rilindjes për shqiptarët, si një nga popujt më të vjetër në Ballkan, për autoktoninë, për gjuhën e tyre si shumë të lashtë, për zakonet e shkëlqyera, për natyrën burrërore e luftarake, për dashurinë ndaj lirisë e përgjithësisht për karakteristikat e tyre të shquara. Këto mite romantike të Rilindjes ishin të domosdoshme si për zgjimin kombëtar, edhe për rrënjosjen e besimit se ishte një popull i denjë për pavarësinë dhe për një të ardhme të përparuar. Do të sjell vetëm pak gjëra si ilustrim. A. Tomsoni ka shkruar disa herë se “Shqiptarët janë një popull fisnik.” Po edhe misionari J. W. Baird-i, që erdhi në Manastir më 1873, i ka shkruar sekretarit Klark në SHBA, se “Shqiptarët janë më fisnikë nga karakteri dhe mund t’u besosh”,⁷ ndërsa në vijim aty shprehet keq në krahasimet me popujt e tjerë, diçka që nuk pajtohem sot ta rikujtojmë, por sa për humor po sjell vijimin: “turqit e kanë zor të vënë dy gjëra në një vijë të drejtë, për të mos thënë tri.” Autori amerikan Xhejms Barker (James Barker), në librin me titull “Turqia”, kreun për Shqipërinë e hap me këto fjalë: “Nga ana fizike shqiptarët janë një racë e shkëlqyer njerëzish, të cilët mund të mëtojnë se janë një nga racat më të vjetra dhe më të pastra në Europë, kurse të vetmit rivalë të tyre mund të jenë iberianët e Gadishullit të Spanjës.”⁸ T. Hoxhsoni, pasardhësi i Tomsonit në agjencinë e Stambollit, pas udhëtimit në Shqipëri më 1909 ka thirrur i entuziazmuar: “Çfarë vend i mrekullueshëm është ky, që pret prekjen gjallëruese të qytetërimit e të lirisë për ta sjellë në rrethin e Europës, të cilit i përket me të drejtë!”⁹

Përmbushjen e sipërmarrjes që e nisi Pinkertoni, e kreu Isak Laundzi (Isaac Lowndes, 1791-1874). Ai e vuri Grigor Gjirokastritin të plotësonte përkthimin, të bënte redaktimin dhe ndjekjen e shtypjes, e kështu doli Mateu më 1824 dhe e gjithë Dhiata e re shqip më 1827. Alfabetin e përpunoi I. Laundzi në letërkëmbimin me librarin e Shoqërisë në Londër, T. Platt. Këta dy dijetarë janë të parët që kanë shqyrtuar në tërësi sistemin e tingujve dhe të shkronjave për të ndërtuar një alfabet

të shqipes. Zgjidhja e tyre ka qenë mbështetje edhe për disa nga gjuhëtarët më të rëndësishëm europianë gjatë atij shekulli për ta shkruar shqipen. Bibliotekari Plat është gjithashtu i pari që hartoi një histori të përkthimeve biblike shqip më 1828.

Gjithsesi, edhe dyzet vjet më vonë çështja e alfabetit mbetej e pazgjidhur. Kur A. Tomsoni nisi bashkëpunimin me K. Kristoforidhin më 1865, patën një diskutim të gjithanshëm dhe vendimin përfundimtar e dha Tomsoni. Sipas kërkesës së tij u hartuan dy alfabetet, për botimet gegërisht dhe toskërisht, duke u nisur nga sistemi i egjiptologut të njohur K. R. Lepsius, domethënë alfabetet e përkthimeve biblike të Kristoforidhit nuk janë prej tij, por prej Tomsonit. Ndërkaq, nuk mund të harrohet, se jo vetëm Tomsoni në fund të fundit ishte për alfabetin latin, por edhe i ka përcjellë përpjekjet e rilindësve për alfabetin e përbashkët që përfunduan me alfabetin e Stambollit, dhe rrjedhimisht erdhi dita kur botimet e Shoqërisë Biblike u bënë me alfabetin e sotëm.

Anasjelltas, edhe rilindësit e vlerësonin këtë ndihmesë. Kështu, përfaqësuesit e Shoqërisë së Stambollit i janë drejtuar Tomsonit: “Anëtarët e këtij Komiteti shprehën falënderimet për Shoqërinë Biblike, që ka çarë rrugën dhe u ka dhënë dijet më të mira njerëzve në gjuhën amtare dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë me ne.”¹⁰ Për ta mbyllur këtë pikë, e vlen të shënohet, se Shoqëria Biblike i jepte kaq rëndësi alfabetit të shqipes, saqë Gjergj Qiriazin, rolin e shquar të të cilit në Manastir më 1908 e njohim të gjithë, ajo e ka quajtur delegatin e saj, ndërsa T. Hoxhsoni, të cilin e kishin ftuar në Kongres dhe ne e kemi ftesën për të, e ka pranuar, që rezultatet e Kongresit do të përcaktonin në një shkallë të madhe botimet e reja shqip.¹¹

E quaj të nevojshme ta nxjerr në pah, që lëvizja protestante në Shqipëri nuk përfaqësohet vetëm nga interesimi i gjatë prej Shoqërisë Biblike. Kur Grigor Gjirokastriti e kreu punën me botimin shqip, u mundësua që të merrej me përkthimin e disa broshurave shqip. Për këtë I. Laundzi iu drejtua një organizate tjetër, Shoqërisë së Broshurave Fetare në Londër, dhe do të jenë botuar të paktën dy broshura shqip. Por të bën përshtypje të veçantë, që gjejmë njoftimin për këtë në periodikun “Revista amerikane e broshurave”¹² qysh në qershor 1824. Gjithashtu revista tjetër amerikane “The Missionary Herald”¹³ më 1828 ka njoftuar për botimet shqipe në vëllimin XXIV. Rrjedhimisht, del se organizatat misionare amerikane dhe periodikët e tyre janë interesuar për punën me gjuhën shqipe mjaft heret. Kështu do të kuptojmë edhe shtjellimet e mëtejshme.

Misionarët amerikanë erdhën në Turqi më 1829. Një nga njerëzit me kompetencën më të gjerë gjuhësore midis tyre ka qenë Elias Rigzi (Riggs, 1810-1901), që është quajtur edhe dijetari më i madh i Bordit Amerikan. Ai ka shkelur në Janinë më 1833 e më pas në Athinë. Në Revistën e Shoqërisë Orientale Amerikane më 1849 (nr. 4) është shkruar se Rigzi kishte punuar për alfabetin e shqipes. Nuk ka hapësirë këtu për të riprodhuar përgjigjet e tij të botuara në këtë revistë, por nuk mund të anashkaloj, që ai e njihte abetaren e N. Veqilharxhit dhe shpresonte në suksesin e alfabetit të tij. Pasi u vendos në Stamboll, kur po diskutohej më 1856 përkthimi i Shkrimeve shqip, Rigzi ka thënë se në cep të tryezës së tij kishte një gramatikë të shqipes, që e kishte hartuar kur ishte marrë me bullgarishten.¹⁴ Ai ka drejtuar botimin e “Morning Star”, që bullgarisht dilte me titullin “Zornica” dhe

pastaj u bë emërtimi i shoqërisë dhe i revistës së motrave Qiriazit “Ylli i Mëngjesit”.

Misionari tjetër amerikan ka qenë Cyrus Hamlin (1811-1900), nismëtari i seminarit në Bebek të Stambollit (1840), i cili me një largpamësi të habitshme e zbuloi K. Kristoforidhin në Izmir dhe e ftoi të vinte në atë seminar. Po e përsëris, ishte Hamlini që e ka zbuluar Kristoforidhin dhe e futi në atë rrugë, në të cilën ai me aftësitë natyrore, me përgatitjen dhe me idealet e larta u bë një nga përfaqësuesit më të shquar të Rilindjes sonë. Njëkohësisht, nëpërmjet kësaj fushe Kristoforidhi u njoh me veprimtarë të tjerë ballkanas. Mjafton të përmend iluministin bullgar Petar Sllavejkov, gjithashtu përkthyes i Dhiatës së re, i cili në faqet e gazetës së tij “Makedonija” më 1867 e përshëndeste me gëzim botimin e librave shqip, që e lehtësonin “përhapjen e ideve të Iluminizmit mes shqiptarëve”, ndërsa nga ana e vet ishte për zhvillimin dhe afirmimin e kombësisë së tyre.¹⁵

Alfabeti nevojitet për ta shkruar gjuhën dhe veçanërisht për të botuar libra. Rilindja Kombëtare përgatitjen e librave, duke filluar me abetaren, e quante një nga sipërmarrjet më të vyeshme si për të punuar shkollat, ashtu edhe për daljen nga analfabetizmi, për lulëzimin e letërsisë, për përhapjen e diturisë dhe për të hedhur poshtë përfytyrimin e ushqyer nga armiqtë e shqiptarëve, se ishin një popull pa histori, shkurt, pa libra. Në korrik 1867 A. Tomsoni e ka shprehur me këto fjalë: “Unë do të shpresoj që qortimi për arnautët qitapsëzë së shpejti do të pushonte së përdoruri për këtë popull interesant.” Që nga Pinkertoni deri te Tomsoni ndeshemi me interesimin rreth përhapjes së shqiptarëve jo vetëm në Perandorinë Osmane, por edhe në diasporë, te arbëreshët e Italisë, të cilëve u janë dërguar libra shqip.

Lëvizja protestante në qendër të synimeve të saj kishte përhapjen e librave të shenjtë në gjuhët amtare të popujve të gjithë botës. Qysh me botimin e vitit 1827 u bë një hap domethënës pikërisht në këtë drejtim për botimet shqip. Veçse ndërsa shqiptarët i gëzoheshin me përmallim çdo fjale të shtypur shqip, kishte një varg rrymash të përpunuara ideologjikisht, dëshira e të cilave ishte të mbahej ndezur vazhdimisht një zjarr, ku të hidhej e të bëhej hi çdo shkronjë e shqipes. Për herë të parë librin shqip në Manastir e kanë çuar më 1864-1865 librashitësit H. Riedel-i dhe A. Davidsoni. Porse më 1888 valiu i Manastirit u betua, se do ta bënte shitjen e librave shqip aq të vështirë dhe të kushtueshme, saqë Shoqëria Biblike do të detyrohej të hiqte dorë nga ajo punë.

Librat shqip pengoheshin me çdo mënyrë, mbaheshin nëpër dogana në kundërshtim me ligjet osmane në fuqi, mbylleshin depozitat dhe botimet burgoseshin bashkë me shitësit. Librashitësit u janë nënshtruar përndjekjeve nga më të pabesueshmet jo sepse librat e protestantëve i ndalonin ligjet osmane, por vetëm e vetëm sepse ishin shqip. Ka qenë e domosdoshme që jo pak herë lirimi nga burgosja e librave dhe e librashitësve të arrihej duke iu drejtuar ambasadorit britanik në Stamboll, domethënë nëpërmjet ndërhyrjes në nivelet më të larta të dy perandorive të mëdha të asaj periudhe, duke e shndërruar kështu hyrjen në Shqipëri dhe qarkullimin e librave shqip në një çështje ndërkombëtare. Mund të shtoj, se autoritetet osmane nuk e lejonin të hynte libri shqip as te të burgosurit, ndërsa ua lejonin atyre botimet në gjuhët e tjera.

Krejt përkundrazi, përfaqësues që ndiqnin me vëmendje të gjitha zhvillimet arsimore e kulturore mes shqiptarëve, kurdoherë kanë mbajtur anën e shqiptarëve kundër shtypjes së huaj dhe veprimtarisë antishqiptare. Siç shkruhet në Raportin e BFBS të vitit 1907, “Qeveria ia ka frikën në Shqipëri ndikimit përbashkues të gjuhës dhe të letërsisë kombëtare, por ajo do të donte të përpiqej që edhe t’ua shuante dritën e diellit e t’ua hiqte ajrin.” Ndërsa dy vjet më pas vihet në dukje, se: “Atdhetarët shqiptarë, myslimanë e të krishterë, kanë bërë përpjekje dhe sakrifica që nuk gjejnë paralele në historinë e kombësisë së tyre për çështjen e përparimit kombëtar, të bashkimit dhe të ndriçimit.”¹⁶ Misionarët dhe Shoqëria Biblike jo vetëm e kanë shoqëruar me përkujdes përparimin e gjuhës së shkruar, të librave e të shkollave shqipe, por edhe kanë bërë publike vlerësimet e tyre në çdo rast. Në Raportet vjetore, të cilat shpërndareshin anglisht në gjithë botën, ata jepnin rregullisht njoftime.

Rilindësit nga ana e vet, e përcillnin me interes të veçantë përhapjen e librit shqip dhe nuk ngurronin ta shprehnin edhe ata vlerësimin për këtë ndihmesë të mirëpritur prej të huajve, që vepronin në trevat shqiptare.¹⁷ Edhe pse kanë qenë të huaj pjesa më e madhe e depozitarëve dhe e librarëve, ata kanë hasur kudo mikpritje të ngrohtë, pavarësisht nga besimi i blerësve. Natyrisht, kur ishin shqiptarë, siç e dëshmon rasti i njohur i Kristoforidhit, nuk mungonte as entuziazmi. Kurse pas një udhëtimi nëpër Shqipëri, Gjerasim Qiriazhi: “Ashtu si edhe në rastet e mëparshme, është ndeshur me një ndjenjë të habitshme afekcioni kundrejt Shoqërisë Biblike nga ana e bejlerëve dhe fshatarëve, të varfër e të pasur, myslimanë e të krishterë njësoj. Ata i kushtuan mjaft kohë dhe kudo, në qytet e në fshat, në dyqane e në shtëpi private të të gjitha shkallëve, hasi kopje të ruajtura me kujdes dhe shumë të lexuara të librave shqip të Shoqërisë.”¹⁸

Me ngritjen e depozitave të Shoqërisë Biblike në disa qytete mund të themi se ka filluar hapja e librarive në Shqipëri, ndërsa një ndihmesë të veçantë kanë dhënë depozitarët dhe librashitësit shëtitës. Atyre u bie merita që aq shumë kopje të librave shqip shpërndareshin në mbarë trevat shqiptare. Për të krijuar një ide mbi përmasat e kësaj pune, do të sjell disa shifra, domethënia e të cilave na bëhet e qartë tashti, kur e dimë se cilat janë tirazhet e librave që hidhen në treg sot edhe për libra me mjaft jehonë publike, pa përmendur se numri i shqiptarëve është shumë më i madh se shekuj më parë dhe nuk kemi më analfabetizëm, por shkolla kudo. Dhiata e vitit 1827 u shtyp në 2000 kopje; gjashtëdhjetë vjet më vonë libri i Gjenezës dhe Mateu në përkthimin e Kristoforidhit janë shtypur në 5000 kopje secili, ndërsa më 1910 janë shitur gjithsej 23 mijë kopje të përkthimeve shqip.

Përmes mundimeve, vështirësive e përpjekjeve të pafund, u arrit që të merrte trajtë shqipja e shkruar dhe të bëheshin libra, pa të cilët nuk mund të ketë shkollë. E vërteta është se Shoqëria Biblike interesohet për shtypjen dhe qarkullimin vetëm të Biblës, mirëpo Aleksandër Tomsoni e kuptonte thellë, se pa abetare, pa libra leximi dhe pa shkolla shqip nuk mund të gjenin vend as botimet biblike. Si rrjedhim, në rastin e shqipes ai me bindje të patundur u mor edhe me këto aspekte. Dëshiroj ta vë në dukje, se për abetaren e Kristoforidhit në të dy variantet ka qenë Tomsoni, që ka përzgjedhur modelin e anglishtes, aq sa më 1867 poshtë disa klisheve kanë mbetur diciturat anglisht. Për Gramatikën e Kristoforidhit ai i prishi me nismën e

vet disa pak të holla që ishin mbledhur, duke u përligjur se kjo ishte mënyra më e mirë për t'i shpenzuar ato para për shkollën shqipe. Në çdo udhëtim nëpër Shqipëri ai gjente mënyrën për të vizituar shkollat dhe ka dhënë njoftime për gjendjen e tyre, për frytshmërinë e mësimdhënies në një gjuhë jo amtare, për shkallën e përgatitjes së mësuesve dhe depërtimin e librave shqip. Mund të thuhet me plot gojën, se bashkë me të dhënat e librashitësve nga viset e ndryshme, kemi kështu një lëndë të pasur për arsimin shqiptar, që nuk e gjejmë në asnjë burim tjetër.

Këto ditë është 125-vjetori i Shkollës së vajzave në Korçë. Ne e dimë se ajo u ngrit vetëm katër vjet pas shkollës së djemve, ndërsa rrënjët e shkollës shqipe shkojnë mjaft më thellë në histori. Nuk është vendi të rilexohen faqet mbresëlënëse të rrugës së arsimit shqiptar, që ishte një prej drejtimeve më të rëndësishme të punës së rilindësve. Gjithsesi, ky përvjetor jep shkas për ta parë të lidhur me përkujdesin e posaçëm të rilindësve për gruan shqiptare. Ishte Rilindja Kombëtare, që e shtroi ballas dhe nga disa anë problemin e zgjimit dhe të ngritjes së gruas si bashkëluftëtare e burrit në luftën për liri, për drejtësi dhe përparim. Janë të gdhendura në mermer fjalët e Sami Frashërit për gruan shqiptare dhe të ardhmen e saj në një shoqëri të lirë e të përparuar. Kristoforidhi vërente me kënaqësi të veçantë, se si gratë mësonin prej tij të lexonin e të shkruanin, se si kërkonin të mos ua ndërpriste leximin e librave shqip.

Jo më pak i shqetësonte edhe protestantët, që vinin nga qytetërimi evropian, gjendja e rëndë, e prapambetur dhe e mjeruar e gruas në Shqipëri gjatë shekujve të shoqërisë patriarkale, feudale dhe të sunduar prej pushtuesve të huaj. Interesimi i protestantëve për arsimimin e femrës ka qenë i përhershëm. Kur I. Laundzi kishte qenë drejtues i arsimit në Korfuz në vitet 1820-1830, ishte interesuar për të ngritur shkolla për vajzat. Kur vizitoi Shqipërinë më 1856, gjeti nga nxënëset e dikurshme dy vajza mësuese në Janinë dhe një në Prevezë. Në letrat e A. Tomsonit ka një numër të pamatë thëniesh për nevojën e arsimit të gruas. Që në udhëtimin e parë më 1863 nëpër Shqipëri kishte vënë re se: "Arsimimi i femrave është pothuaj tërësisht i panjohur si mes të krishterëve, edhe mes myslimanëve." Jo vetëm kaq, ai ka bërë edhe konkretisht përcapje për të ngritur klasa ose shkolla të shqipes. Proven e parë e bëri me depozitarin H. Riedel në Shkodër më 1865. E shoqja e tij arriti të kishte në një klasë të shqipes 6 nxënëse dhe të varfrat ndër to nuk paguanin. Shpresa të reja iu ngjallën Tomsonit, kur nisi bashkëpunimin me Gjerasim Qiriazin. Që më 1882 i shprehu dëshirën të hapej një klasë e mbrëmjes, sepse "mjete i vetëm për arsimimin e një kombi është gjuha amtare."

Dy vjet më vonë, pasi e vinte në dukje që Gjerasimi kishte dëshirë të madhe të punonte për bashkatdhetarët e vet në Shqipëri dhe mendonte të hapte në Manastir një dhomë leximi dhe një shkollë të së dielës shqip, kishte bërë edhe një gramatikë të shqipes. Më 1885 Gjerasimi nisi mësimin e shqipes me tri vajza shqiptare, nxënëse të shkollës së vajzave të Misionit Amerikan dhe në dhjetor tashmë kishte 10 nxënës të dielave. E motra, Sevastia, ka shkruar se ishte Gjerasimi që i mësoi shkrimin e këndimin në gjuhën amtare, ndërsa ajo sillte në dhomën e leximit shoqet e saj dhe u tregonte librat shqip, domethënë e para shkollë për vajzat shqiptare ka qenë vetë shtëpia e familjes Qiriazit. Sevastisë Tomsoni i ka kërkuar që t'u mësonte shqipen grave të dy librashitësve, sipas shembullit të mëparshëm të Shkodrës,

ndërsa ka botuar artikuj në shtypin skocez për të mbledhur fonde që të hapej një shkollë për vajzat. Për Gjergj Qiriazin Tomsoni ka paguar të hollat, që të shkonte në shkollë në Samokov. (shtator 1885) Ishte një rastësi fatlume, që Bordi Amerikan i Komisionerëve për Misionet e Huaja (themeluar më 1810) me J. Baird-in dhe E. Jenney-n u vendosën më 1873 në Manastir, pikërisht në shtëpinë prapa Qiriazëve.

Si përgjithësim do të theksoja, se veprimtaria e rilindësve tanë dhe veprimtaria e përfaqësuesve të ndryshëm protestantë është përputhur në disa anë thelbësore me peshë të veçantë në historinë shqiptare të shekullit XIX dhe fillimi i shek. XX. Këtë aspekt nuk po e vë re unë për herë të parë, sepse e kanë parë prej kohësh të gjithë ata, që kishin të bënë me realitetin shqiptar të kohës. Po citoj vetëm diçka. Nënkonsulli britanik në Manastir ka qenë Hauard Shipli (Howard Shipley). Në mars 1893, pasi ka njoftuar se përpjekjet arsimore të Gjerasimit gëzonin përkrahjen e Misionit Amerikan të Manastirit dhe se, me përjashtim të Komitetit shqiptar të Bukureshtit, shkollat në krahinën e Korçës e të Kolonjës nuk kishin asnjë mbështetje tjetër nga jashtë përveç atij misioni, Shipli ka shkruar: “Kjo nismë si përpjekje për ndërthurjen e lëvizjes fetare me lëvizjen për qëllime laike, që të zhvillohet mësimi i gjuhës shqipe, mund të sjellë më shumë të mira sesa të këqija.”¹⁹ Nga krahu tjetër, në një letër të janarit 1893 prej Bukureshti, Nikolla Naçoja si kryetar i Shoqërisë “Drita” i ka shkruar dr. Klarkut në Boston ndër të tjera, se nga kishat “ne do të flakim të gjitha portretet e atyre që deri më sot e kanë mbytur ndjenjën tonë kombëtare dhe në vend të tyre do të vëmë portretet e njerëzve që mbështesin, mbrojnë dhe kultivojnë kombësinë tonë qoftë me shkolla, qoftë me kisha, qoftë me organe të shtypit.” (janar 1893). Një nga historianët e Shoqërisë Biblike, James Moulton Roe, më 1965 është shprehur: “As për herë të parë, as për të fundit përfaqësuesit e Shoqërisë i kanë gjetur përpjekjet e tyre të lidhura në një shkallë të habitshme me çështjen e patriotizmit vendës.”²⁰

Do të shtoj edhe ndonjë hollësi domethënëse, që na e japin dokumentet. Ishte Misioni Amerikan në Manastir që e financoi shkollimin e Gjerasim Qiriazit më 1878-1882 në Samokov. Gjysmën e dytë të vitit 1903 i vëllai, Gjergji, bashkë me 3 librashitës të tjerë e ka kaluar duke shpërndarë falas libra me fondet e ndihmave angleze dhe amerikane. Gjatë zisë që pllakosi Beratin në dimrin 1908-1909, miqtë e BFBS dërguan një shumë, e cila iu shpërnda si ndihmë 17 familjeve nëpërmjet librashitësit Lluka, të Përnderuarit Theona dhe Jorgji Karbunarës.

Me përfaqësuesit protestantë kanë pasur kontakte e marrëdhënie të ndryshme pjesa më e madhe e rilindësve, prandaj po përmend vetëm disa: K. Kristoforidhi, Dh. Kamarda, J. Vretoja, Daut Boriçi, A. Kullurioti, Th. Mitkoja, N. Frashëri, P. Kupitori, Pandeli Sotiri, katër Qiriazët, Thanas Sina, F. Konica. Kurorëzimin e kësaj liste e përbën emri i themeluesit të shtetit tonë modern. Kur ishte për çështjen shqiptare në Londër në maj 1913, Ismail Qemali gjeti kohën edhe për një vizitë në Shoqërinë Biblike. Përgjegjësi i botimeve ka shkruar me këtë rast: “U gëzua kur dëgjuam vlerësimin që i bënë ata punës së Shoqërisë Biblike. Ishte kënaqësi të vërenim interesimin e tyre për botimin tonë me alfabetin kombëtar.”²¹

Arkivi i Shoqërisë Biblike është një thesar i vërtetë tejet i çmueshëm për historinë e gjuhës së shkruar shqipe, për përkthimet e botimet dhe për arsimin e kulturën tonë gjatë pothuaj një shekulli e gjysmë. Por do ta mbyllja, duke treguar se

kjo histori ka edhe një vazhdim të sotëm. Në Tiranë është themeluar Instituti për Studimet Shqiptare dhe Protestante, i drejtuar nga David Hosaflook-u, që po bëhet një qendër, ku jo vetëm po grumbullohen thesaret nga e shkuara, por edhe po shtohen pasuri të reja, të hapura për dashamirësit e kulturës shqiptare në lidhjet me kulturën botërore.

SHËNIMET


1. LLOSHI, XH. (2012): *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit*. Tiranë.
2. THOMSON, A. (1883): *Raport i Agjencisë së Stambollit për vitin 1883*. 4 mars 1884.
3. *Reports of BFBS, vol. VI, 16th Report*, f. 23.
4. *76th Report of BFBS, 1880*.
5. *Blue Book*, vol. I, Turkey, No. 15, 1880. London, 1881.
6. ERICKSON, CH.T. (2012): *Shqiptarët – enigma e Ballkanit*. Tiranë.
7. Letër e 26 marsit 1877, dërguar nga Manastiri për sekr. N. Clark në Boston.
8. BAKER, J. (1877): *Turkey*. New York, f. 317.
9. HODGSON, T. R. (1909): *A Tour Through Albania*, në “The Bible in the World”, November. f. 343.
10. THOMSON, A. (1888): *Letër e 30 majit*, në; BFBS, “Editorial Correspondence. Inwards”. No. 23, f. 259.
11. *105th Report of BFBS, 1909*, f. 163.
12. *The American Tract Magazine*. Vol. 1, June 1924, No. 1, f. 10.
13. *The Missionary Herald for the Year 1828*. Vol. XXIV, f. 34.
14. *Journal of the American Oriental Society*. Vol. 1, No. 4 (1849), f. 58.
15. DIMITROV, S. (1968): *L’Albanie et la Renaissance Albanaise dans la presse dirigée par P. R. Slavejkov*, në: “Etudes Balkaniques”, 7. Sofïa, f. 191- 206.
16. *106th Report of BFBS, 1910*. f. 142.
17. Shih, p.sh. *124th Report of BFBS, 1928*, f. 128.
18. *104th Report of BFBS, 1908*. f. 160.
19. Foreign Office, Turkey, 294-17.
20. ROE, J. M. (1965): *A History of the British and Foreign Bible Society*. London, f. 73.
21. BFBS, “Translation Department Correspondence. Albanian, I.” Letër për H. Ch. Woods, Esq., 21 maj 1913.

RIZA SADIKU

HASAN KALESHI PERSONALITET ME FAMË BOTËRORE, POR I MARGJINALIZUAR NGA INSTITUCIONET SHKENCORE¹

Me rastin e 40- vjetorit të vdekjes të prof. dr. Hasan Kaleshit

Hasan Kaleshi i takon gjeneratës së parë të kuadrove të shkolluara në mesin e shqiptarëve pas Luftës së Dytë Botërore, personalitet që la gjurmë të thella në shumë fusha të shkencës dhe dijes, la emër në shumë institucione të vendit me të cilat ka bashkëpunuar në ish- Jugosllavi, në Evropë dhe botë; me emrin e tij është identifikuar mbarë shkenca shqiptare.



Prof. Dr. Hasan Kaleshi
1922- 1976

¹ Për herë të parë pas 40 vjetësh të vdekjes së Hasan Kaleshit, me iniciativën e Katedrës së Orientalistikës dhe Institutit Jonuz Emre nga Turqia, më 6 tetor 2016, në Prishtinë u organizua një simpozium shkencor kushtuar Prof. Dr. Hasan Kaleshit, në të cilin morën pjesë disa itelektualë dhe shkencëtarë nga Kosova, Maqedonia, Kosova Lindore dhe nga Franca, Turqia, Siria dhe Jordani, por mjerisht edhe kesaj radhe nuk morën pjesë as fizikisht, disa ish- asistentë të Dr. Hasan Kaleshit, të cilëve ua hapi rrugën dhe perspektivën jetësore.

Hasan Kaleshi lindi më 7 mars të vitit 1922, në fshatin Serbicë të Kërçovës. Mësimet e para në gjuhën arabe i mori nga babai qysh në moshën 6 vjeçare, i cili në atë kohë ka punuar si hoxhë në fshatin Serbicë dhe ka gëzuar autoritet dhe respekt në gjithë rrethin e Kërçovës, kurse në moshën 10 vjeçare Hasani e ka ditur përmendsh Kuranin. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjashtë klasë në Medresenë e Madhe “Kral Aleksandër” në Shkup, kurse dy vjet të shkollës së mesme i kreu në Gjimnazin “Sami Frasheri” në Prishtinë, në gjuhën shqipe.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pas mbarimit të gjimnazit, Hasan Kaleshi punësohet si përkthyes, pasi në atë kohë ka njuh disa gjuhë të huaja, sidomos gjermanishten dhe italishten. Hasani si ri, ka qenë përkrahës dhe simpatizant i ideve të platformës të çlirimit dhe bashkimit kombëtar, si i tillë mbeti gjatë tërë jetës së tij, kur nuk pranoi të bëhet anëtar i Partisë Komuniste të Jugosllavisë, edhe pse ka pasur oferta të tilla me privilegje të veçanta.

Në shtator të vitit 1946, regjistrohet në Fakultetin Filologjik, në Degën e Orientalistikës dhe në atë të Romanistikës. Diplomohet në vitin 1951 në Orientalistikë, me sukses të shkëlqyeshëm me notë mesatare 9 (nënte), kurse në Romanistikë i jep të gjitha provimet, por nuk diplomohet.

Hasan Kaleshi, për shkak të kushteve të vështira ekonomike, gjatë studimeve ka qenë i detyruar të punojë punë të ndryshme fizike, kurse prej vitit 1947-1950, punoi si përkthyes e lektor në Redaksinë e gjuhës shqipe në Radio Beograd, në shkurt të vitit 1952, emërohet profesor i shkollës së mesme në Katedrën e Filologjisë orientale në Beograd, kurse në vitin 1955 zgjidhet asistent. Më 26 shkurt të vitit 1960, mbron disertacionin e doktoratës me titull: “*Najtariji vakufski dokumenti iz Makedonije na arapskom jetiku*” (*Dokumentet më ta vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Maqedoni*), në Fakultetin Filozofik në Beograd. Po atë vit Profesor Hasani, në katedrën e Orientalistikës do të konkurrojë për docent, edhe pse për të shkruhet referat pozitiv, zgjedhja e tij pezullohet deri në vitin 1965. Duke qenë i demoralizuar për këtë zgjatje të mosëmërimit pa përgjigje, ai e lëshon punën në fakultet. Gjatë kësaj kohe ka qenë disa herë në Dedinje si përkthyes i disa delegacioneve zyrtare arabe, si dhe ka marrë pjesë në disa kongrese shkencore ndërkombëtare.

Punimet e publikuara të Dr. Hasan Kaleshit, deri në këtë kohe, sidomos nga fusha e turkologjisë, do t’u bien në sy dhe do të përcillen me simpati nga shkencëtarët eminentë, për çka edhe i ndahet bursa shtetërore gjermane përmes Shoqatës së Studimeve Uralo-Altaike të Universitetit të Hamburgut për vitin 1965. Këtu qëndron dy vjet specializon turkologjinë, te profesorë të shquar me famë botërore, siç ishte Dr. Annemarie von Gabain etj. Nga mesi i marsit i vitit 1967, me ftesën e qeverisë së Egjiptit Dr. Hasan Kaleshi qëndron tre muaj si mysafir në institucionet shkencore të Kajros. Gjatë kësaj kohe së bashku me Kamil El Buhajin përgatisin për shtyp Fjalorin e madh serbo-kroatisht-arabisht, të vetmin të këtij lloji aso kohe në Jugosllavi, por për shkak të shpërthimit të luftës arabo-izraelite, në qershor të vitit 1967, fjalori mbetet i papërfunduar. Fjalori e sheh dritën e botimit në vitet 1980, pasi Prof. H. Kaleshi kishte ndërruar jetë.

Në shtator të vitit 1967, Hasan Kaleshi zgjidhet Bashkëpunëtor i Lartë Shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, dhe është njëri nga themeluesit e

këtij institucioni. Tre vjet me vonë, Dr. Hasan Kaleshi zgjidhet profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Në Katedrën e Historisë, në fillim, Dr. H. Kaleshi do të ligjërojë dy lëndë, Gjuhën Osmane dhe Shkencat Ndhimëse të Historisë. Gjatë vitit 1973/1974, me iniciativën e Dr. Hasan Kaleshit, hapet për herë të parë Katedra e Orientalistikës në Universitetin e Prishtinës.

Dr. Hasan Kaleshi me punë shkencore filloi të merret mjaft herët, punimet e tij të para i hasim prej vitit 1949. Dr. Kaleshin për t'u marre me punë shkencore e shquante prirja, talenti dhe stili, sepse ai posedonte dituri të gjera enciklopedike, ishte një erudit i madh dhe poliglot i vërtet. Pos gjuhës amtare – shqipes, ai shkëlqyeshëm e njihte serbo-kroatishten dhe maqedonishten, kurse nga gjuhët orientale dhe botërore, me të cilat komunikonte, i shkruante dhe i lexonte për mrekulli këto gjuhë: Turqishten, Osmanishten, Arabishten, Frëngjishten, Gjermanishten, Italishten, Latinishten, kurse Anglishten e ka shkruar dhe lexuar. Dr. Kaleshi nuk ishte vetëm njohës i mirë këtyre gjuhëve, por edhe njohës i shkëlqyer i atyre kulturave të gjuhëfolësve të atyre popujve. Si tillë ai i kishte të gjitha parakushtet të merrej me veprimtari shkencore në shumë disiplina. Çështjet dhe problemet që i shtronte Dr. Kaleshi, nuk i trajtonte në mënyre sipërfaqësore, por në mënyrë të argumentuar shkencore, duke u ballafaquar me çështjet thelbësore, në bazë të të cilave depërton thellë në ndriçimin dhe studimin e tyre, jo vetëm për çështjet e pastuduara e të pazbuluara, por edhe për çështjet e keqinterpretuara, si nga fusha e orientalistikës, turkologjisë, albanologjisë, etnologjisë, si dhe historisë kombëtare gjatë periudhës osmane. Prof. Hasan Kaleshi me punën e tij shkencore nuk shquhet vetëm si orientalist i njohur dhe i pranuar në botë, por kontributi i tij shkencor aspak nuk është i vogël as në fushën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, por edhe në historinë tonë kombëtare.

Opusi i bibliografisë së punimeve shkencore të Dr. Prof. Hasan Kaleshit është shumëdimensional, pasi ai ka njohur disa gjuhë të huaja, është marrë edhe me disa fusha të ndryshme shkencore, si me: onomastikë, arabistikë, albanologji, turkologji, filologji, historinë e popullit shqiptar gjatë periudhës osmane, me përkthime fusha shkencore. Dr. Hasan Kaleshi kontribut të veçantë ka dhënë edhe në zbulimin e shkrimeve më të vjetra arabe në Maqedoni dhe Jugosllavi, përkthimin e librave të ndryshëm, botimin e artikujve të ndryshëm, kritikave, recensioneve, përgatitjen e fjalorit, tekstin universitar për Katedrën e Orientalistikës, (i cili tekst deri më sot nuk e ka parë dritën), përgatitjen e studimeve të veçanta të veprimtarisë politike dhe kombëtare të Faik Konicës, në atë kohë kur nuk përmendej në asnjë nivel shkollor emri i F. Konicës as në Shqipëri e as në Kosovë, në kohën e regjimit komunist, Dr. Kaleshi publikonte artikuj të veçantë për personalitetet të tilla, siç ishte F. Konica, Ibrahim Temo, Midhat Frashri (e kishte në dorëshkrim biografinë e tij kombëtare) e shumë personalitete të tjera. Dr. Kaleshi, edhe pse ndërroj jetë në kohën kur arriti kulmin e njohurive shkencore, si dhe afirmimin e veprimtarisë së tij shkencore në Ballkan, Evropë dhe botë, ai në moshën 54- vjeçare ndërroi jetë, pas veti la afër 400 njësi bibliografike. Punimet e tij janë botuar në shumë revista shkencore të vendit dhe të huaja, përmes të cilave ka hapur vizione të reja shkencore të pa trajtuara e të pa ndriçuara më parë, jo vetëm në mesin tonë, por edhe në Ballkan, Evropë, por edhe më gjerë. Dr. Kaleshi, përmes veprimtarisë

shkencore të hulumtuar me fakte dhe argumente, është përpjekur të zgjerojë fushën e kërkimeve, të hapë horizonte dhe opsione të reja, të zbulojë figura, personalitete dhe ngjarje të panjohura deri atëherë nga fusha të ndryshme shkencore.

Publikimet e Dr. Hasan Kaleshit shquhen për rreptësinë shkencore, objektivitetin, paanshmërinë dhe paluhatshmërinë, virtyte të rralla të cilat i posedojnë vetëm shkencëtarët me famë botërore, pra i tillë ka qene dhe ka mbetur edhe Prof. Dr. Hasan Kaleshi.

Derisa punoi në Prishtinë, Hasan Kaleshi u angazhua në përgatitjen e disa revistave shkencore, të cilat në atë kohë botoheshin në Prishtinë dhe jashtë saj: Ishte anëtar i redaksisë në “*Gjurmimet Albanologjike*”, anëtar dhe kryeredaktor i “*Studimeve Historike dhe Filologjike*”, anëtar i redaksisë të “*Vjetarit*” të Arkivit të Kosovës, anëtar i redaksisë të *Buletinit të Muzeut të Kosovës*, anëtar i revistës “*Balkanica*”, organi i Institutit Ballkanologjik ne Beograd, anëtar i redaksisë të revistës “*Jugoslovenski Istoriski Časopis*”, me seli në Beograd, anëtar i redaksisë “*Prilog za orijentalnu filologiju*”, organ i Institutit Oriental të Sarajevës, kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i revistës “*Studio Humanistika*”, anëtar i redaksisë së revistës “*Antikitetet e Kosovës*”, e tjera revistave shkencore.

Dr. Hasan Kaleshi i cili në vitet e shatëdhjeta, me publikimet e tij shkencore dhe pjesëmarrjen në kongrese të ndryshme ndërkombëtare, krijoi emër dhe famë botërore, andaj është zgjedhur edhe anëtar i disa redaksive të revistave shkencore ndërkombëtare si në: “*Der Islam*” e cila botohej në Berlin, në revistën “*Uralo-Altaschen Jahrbuch*” me seli në Hamburg, revistën *Sudost Forschungen*, me seli në Munih, anëtar nderi i Institutit të Studimeve Shqiptare në Minhen dhe anëtar i redaksisë të Edicionit “*Albansche Forschungen*”. Dr. Hasan Kaleshi ka qenë anëtar nderi, anëtar me korrespondencë dhe bashkëpunëtor i disa shoqatave shkencore, institucioneve dhe akademive botërore: Anëtar me korrespondencë i Akademisë së Gjuhës Arabe të Kajros (i vetmi anëtar nga ish- Jugosllavia), anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare shkencore “*Uralo-Altaike*” me qendër në Hamburg, anëtar i konferencës Altaistike te Blomingtonit në SHBA, bashkëpunëtor i Akademisë të Shkencave të Bullgarisë në Sofje, bashkëpunëtor profesional i Institutit të Filmave Shkencore dhe Dokumentar, me seli në Getyngen. Dr. Kaleshi, përmes këtij Instituti ka realizuar një seri filmash shkencorë, të cilët kanë të bëjnë me folklorin shqiptar, turk, lidhur me etnologjinë, zanatet të cilat vdesin, si dhe kanë bërë incizime lidhur me ritualet fetare nga territori i Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore, shumica e kopjeve të këtyre filmave sot gjenden në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Dr. Hasan Kaleshi ishte bashkëpunëtor edhe i disa enciklopedive me karakter botëror: *Enciklopedisë Islame* me seli në Stamboll, *Enciklopedisë Arabe*, me seli në Frankfurt, *Enciklopedisë Kinematografike* për filma shkencorë me seli në Getyngen të Gjermanisë, *Leksikonit Zyr Geshihte Sudosteurapas me seli në Minhen*, në të cilin Dr. H. Kaleshi ka botuar mbi 28 artikuj për personalitetet e lëvizjes kombëtare gjatë periudhës osmane për: *Sami Frasherin, Abdul Frasherin, Naim Frashrin, Pashko Vasen, Eqrem Bejë Vlorën, Syryja Bejë Vlorën, Ali Pashë Gucinë, Dervish Himën, Faik Konicën, Ismail Qemalin, Fan Nolin, Haxhi Zekën,*

Hasan Prishtinën, Shahin Kolonjën, Kristo Luarasin, Ibrahim Temon, Turhan Pashë Përmetin etj.

Punimet e Dr. Hasan Kaleshit, për shkak se mbështeteshin në fakte dhe dokumente origjinale, me kohë krijuan besim dhe interesim te lexuesit dhe kolegët e tij, prandaj edhe si të tilla ishin të mirëseardhura për publikim. Punimet e dr. Kaleshit sot i hasim në shumë revista shkencore dhe qendra të ndryshme universitare si në: Prishtinë, Shkup, Beograd, Sarajevë, Titograd, Zagreb, Stamboll, Athinë, Ankara, Kajro, Kuvajt, Damask, Paris, Berlin, Napoli, Strasburg, Grac, Muni, Visbaden, Hamburg, Getyngen, Nju Jork etj.

Nga e gjithë kjo që u theksua me lart, shihet se opusi i veprimtarisë shkencore të Dr. Hasan Kaleshit është shumë e gjerë dhe shumëdimensional, këtë e dëshmon edhe pjesëmarrja e tij në më se 40 kongrese e simpoziume ndërkombëtare dhe të vendit, gjithmonë me referate, të cilët çdo herë kanë zgjuar një interesim të veçantë te kolegët e tij, si për mënyrën e interpretimit të problemeve shkencore ashtu edhe për idetë origjinale. Për këtë arsye kudo që merrte pjesë krijonte emër, autoritet dhe respekt, sidomos në arenën ndërkombëtare, për këto arsye edhe është ftuar në shumë Kongrese dhe Konferenca ndërkombëtare si në: Muni, Hamburg, Paris, Athinë, Sofje, Bukuresht, Stamboll, Ankara, Berlin, Romë, Grac, Tiranë, Kajro, Aleksandri, Çikago, Nju York e të tjera qytete.

Njohja e shkëlqyeshme e shumë gjuhëve të huaja dhe botërore, Dr. Hasan Kaleshit do t'i mundësonte hulumtimin në arkivat më të pasura dhe më bashkëkohore të Evropës, si në: Vjenë, Stamboll, Ankara, Berlin, Muni, Romë, Sofje, Paris, Bukuresht, Kajro etj.

Vlen të theksohet se Dr. Hasan Kaleshi, duke qene shumë i rreptë në shkencë, ai ka zhvilluar edhe polemika të ashpra si nëpër Kongreset Ndërkombëtare dhe vendore ku ka marrë pjesë, ashtu edhe në mjetet e informimit të kohës.

Dr. Hasan Kaleshi punoi pa ndërprerje dhe gjithmonë i preokupuar me shkencë dhe me fushën e paskajshme te dijes, duke mos u kujdesur sa duhet as për shëndetin e tij, e cila moskujdesje do t'i kushtonte me jetë. Vdes nga sulmi në zemër në *moshën 54 vjeçare, më 19 korrik 1976, në shkallët e ndërtesës të Entit për Mbrojtjen e Përmendoreve të Kosovës në Prishtinë*. Vdekja e gjeti në detyrën e shefit të Katedrës të Orientalistikës. Dr. Hasan Kaleshi ndërroi jetë në zenitin e dijes, në kulmin e autoritetit shkencor, në kohën kur mund të kontribuonte edhe më tepër për shkencën tonë, për ndriçimin e personalieve të anatemuara dhe te pa zbuluara kombëtare.

Vdekja e papritur e Prof. Dr. Hasan Kaleshit, nuk pikëlloi vetëm familjen e tij, por edhe miqtë dhe dashamirët në Prishtinë e gjetiu, sidomos vendësit e tij në Kërçovë, të cilët bënë përpjekje maksimale për varrosjen e Dr. Hasan Kaleshit në vendlindje, por një gjë te tillë nuk ua mundësonte Ligji i kohës në fuqi, andaj varrimi i tij u bë më 23 korrik 1976 në varrezat e myslimanëve në Beograd.

Nga këto pak shënime të shkurta biografike të Prof. Dr. Hasan Kaleshit, shihet se veprimtaria e tij shkencore është shumëdimensionale, temat e ndryshme të cilat i ka trajtuar Dr. Hasan Kaleshi sot citohen jo vetëm nga punonjësit shkencorë në trojet etnike shqiptare, por edhe nga punonjësit e tjerë shkencorë të Ballkanit dhe Evropës, dhe më gjerë. Një personalitet me një diapazon të tillë shkencor lakmojnë

ta kenë shumë shtete të Ballkanit apo Evropës, kurse ne që e kemi, deri më sot për 40 vjet, vetëm Katedra e Orientalistikës në bashkëpunim me Institutin Jonuz Emre nga Turqia në Prishtinë, më 6 tetor 2016 organizuan një simpozium shkencor, ashtu siç e meriton Prof. Dr. Hasan Kaleshi dhe dy manifestimeve të organizuara me karakter lokal të financuara privatisht nga bashkëvendësit e tij të Kërçovës, njëri u organizua me rastin e 20- vjetorit të ndërrimit të jetës së tij (1996), kurse tjetri manifestim u organizua me rastin e 90- vjetorit të lindjes të Prof. Dr. Hasan Kaleshit, në vitin 2012, të dy janë mbajtur në Kërçovë.

Deri më sot, me emrin e këtij shkencëtari të madh nuk është pagëzuar asnjë institucion shkencor, shkollë apo rrugë. Do të ishte një privilegj i veçantë për institucionin, shkollën apo rrugën sot ta mbante emrin e Prof. Dr. Hasan Kaleshit.

Shpresoj, dhe jam thellë i bindur, se gjeneratat e reja të cilat do të merren me veprimtarië shkencore të Dr. Hasan Kaleshit do të dinë më mirë se ne, ta çmojnë dhe vlerësojnë kontributin e tij shkencor dhe me emrin e tij jo vetëm që do të stolisin shumë institucione shkencore, shkolla dhe rrugë, por edhe veprimtaria e tije kombëtare, do të zërë vendin e merituar në Historinë e popullit shqiptar.

Kontributi shkencor i Kaleshit për trashëgiminë dhe historinë kombëtare

Prof. Dr. Hasan Kaleshi, si njohës i shkëlqyer i disa gjuhëve orientale dhe botërore, të cilat i kanë mundësuar të merret me hulumtime dhe disa disiplina shkencore, në mesin e të cilave, pa dyshim gjurmë të thella ka lënë edhe në fushën e Historisë sonë Kombëtare. Duhet theksuar se çështjet të cilat shtrohen në publikimet shkencore të Prof. Dr. Hasan Kaleshit nuk janë stolisje shkencore, por ai depërton thellë në problematikën dhe ndriçimin e tyre. Në publikimet e tij shpesh objekt trajtimi do të jenë tema të paprekura, personalitete të ndryshme nga historia e popullit shqiptar, paraqitja e tezave të reja, trajtimi i çështjeve deri atëherë të panjohura, të padefinuara, të pasqaruara ose gabimisht të interpretuara nga fusha e orientalistikës, turkologjisë, albanologjisë, etnologjisë dhe historisë sonë kombëtare, nga periudha osmane.

Dr. Hasan Kaleshi, në punimin e publikuar në Sarajevë në vitin 1961, të titulluar “*Vakefnamja më e vjetër në Jugosllavi*”, përmes të cilit me fakte dhe argumente e ka dëshmuar se vakefnamja më vjetër e shkruar në gjuhën arabe është ajo e *Sungur Çaush beut nga Manastiri*, e cila daton nga pjesa e dytë e shek. XIV, në bazë të të cilit dokument shihet se *Sungur Çaush beu* ka ndërtuar xhaminë e parë në Jugosllavi, që është njëra ndër më të vjetrat edhe në Ballkan, e cila është ndërtuar në Manastir në vitin 1435, e cila ka ekzistuar deri në vitin 1946 në rrugën “Ivan Milutinoviç”, në vendin e të cilës xhami tani është ngritur një kompleks banesash. Dr. Kaleshi, me këtë publikim e hedh poshtë tezën e Glisha Elezoviçit, se Allaxha Xhamia e Shkupit është xhamia më e vjetër në Jugosllavi, e cila daton nga viti 1444.

Kontribut të veçantë në fushën e trashëgimisë të historisë të popullit shqiptar, Dr. Hasan Kaleshi ka dhënë në heqjen dilemave se kush e ka ndërtuar xhamin e Sinan Pashës në Prizren dhe të Sinan Pashës në Kaçanik, përmes punimit “*Veziri i madh Koxha Sinan Pasha dhe vakefnamja e tij.*” Në Kosovë ekzistojnë dy xhami

të rëndësishme të cilat e mbajnë emrin e Sinan Pashës, njëra gjendet në Prizren, tjetra në Kaçanik. Për ndërtuesit e këtyre xhamive, është shkruar mjaft si përmes shtypit, ashtu edhe në historiografi, mirëpo këto shkrime kanë krijuar shumë dilema dhe paqartësi për ndërtuesit e këtyre dy xhamive. Në shumë raste është thënë se këto dy xhami i ka ndërtuar Koxha Sinan Pasha, ose të kundërtën, atë në Prizren Koxha Sinan Pasha, kurse atë tjetrën në Kaçanik Sofi Sinan Pasha. Përmes punimit të lartcekur, Dr. Kaleshi i heq të gjitha dilemat dhe në mënyrë faktografike dëshmon se xhaminë e Sinan Pashës në Prizren e ka ndërtuar *SOFI SINAN PASHA, Bejlerbe i Budimit*, me prejardhje shqiptare, i lindur në katundin *Vili të Lumës në Shqipëri*, kurse xhaminë në Kaçanik, e cila po ashtu e mban të njëjtin emër, e ka ndërtuar *KOXHA SINAN PASHA*, vezir i lartë në hierarkinë e Perandorisë Osmane, pushtues i Jemenit, Tunizit dhe Gjeorgjisë, si dhe udhëheqës i shumë ekspeditave ushtarake, përndryshe me prejardhje shqiptare i lindur në Topojan të Lumës në Shqipëri.

Dr. Hasan Kaleshi me punimin "*Kush dhe kur është ndërtuar Kurshumli Hani në Shkup*" të botuar në vitin 1971, në revistën "GLASNIK" të Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, në bazë të dëshmive autentike, i ka hequr dilemat edhe për ndërtimin e *Kurshumli Hanit në Shkup*, për ndërtuesin e të cilit kanë ekzistuar disa mendime dhe teza të ndryshme. Disa kanë menduar se hanin e ka ndërtuar *Perandori Konstantin*, disa kanë menduar se e ka ndërtuar *Perandori Justinian*, kurse disa shkencëtarë serbë kanë përhapur tezën se atë e ka ndërtuar *Car Dushani*. Të gjitha këto dilema dhe teza i ka hedhur poshtë Dr. Hasan Kaleshi, në bazë të një dokumenti origjinal në arabisht, përmes të cilit vërteton se Kurshumli Hanin në Shkup e ka ndërtuar *MUSLIHUDDIN al MADINI në vitin 1550*, përveç këtij hani, ka ndërtuar një xhami në Trepçe dhe një në Novi Pazar.

Vlen të theksohet se Dr. Hasan Kaleshi kontribut të veçantë për historinë kombëtare ka dhënë edhe me punimin: "*Çfarë të dhënash na japin kronikat osmane mbi luftërat shqiptaro-turke në shek. e XV*". Në këtë punim Dr. Kaleshi bën fjalë për rëndësinë e kronikave turke, për njohjen me të kaluarën e historisë të trevave shqiptare. Në punimin në fjalë, autori ka trajtuar tri kronika më të vjetra turke, të *Shukurzllahut, ASHIK-PASHAZADES dhe HOXHA SADUDDINIT*. Rëndësia e kronikës së parë qëndron në faktin se në të përmenden shqiptarët për herë të parë lidhur me pjesëmarrjen e tyre në *Betëjen e Kosovës*. Në kronikën e dytë (të Ashikpashzades), përmenden për herë të parë *tokat shqiptare*, kurse në kronikën e tretë (të Hoxha Saduddinit) shqiptarët përmenden lidhur me *plaçkitjen e plotë të territoreve shqiptare*.

Dr. Hasan Kaleshi kontribut të rëndësishëm për historinë tonë kombëtare ka dhënë edhe me punimin: "*Një burim turk mbi kryengritjen e shqiptarëve në vitin 1909-1912*". Në punimin në fjalë, autori jep shënime interesante për situatën politike në territoret shqiptare gjatë periudhës së kryengritjeve shqiptare kundër regjimit të osmanlinjve në vitet 1909-1912. Dr. Kaleshi, përmes këtij artikulli thekson se nuk do të kemi vlerësim real për kryengritjet shqiptare në këtë periudhë nëse nuk shfrytëzohen burimet osmane dhe literatura e autorëve pjesëmarrës të kohës, udhëheqësve të ekspeditave turke për shuarjen e kryengritjeve shqiptare. Rëndësia historike e këtij burimi turk qëndron në faktin se në të përveç shënimeve

të detajuara që jep për ngjarjet që janë zhvilluar në atë kohë, konstatohet se kryengritjet shqiptare kanë qenë *shkaktarët kryesor që Perandoria Osmane të humbë Rumelinë*. Punimi i lartcekur ka rëndësi të madhe jo vetëm për historinë e popullit shqiptar, por edhe për Historinë e Ballkanit në tërësi.

Kontribut të veçantë Dr. Kaleshi ka dhënë edhe në nxjerrjen në dritë të veprimtarisë shkencore të leksikografit dhe enciklopedistit Sami Frasheri, me punimin e thellë studimor : *“Sami Frasheri në letërsinë dhe filologjinë turke”*, botuar në Gjurmime Albanologjike në vitin 1968, në Prishtinë. Në këtë punim Dr. Kaleshi nxjerr në dritë në mënyrë më të plotë veprimtarinë shkencore të Sami Frasherit dhe veprat e tij, të shkruara në gjuhën turke, arabe dhe atë shqipe. Dr. Kaleshi ka arritur që veprimtarinë e Sami Frasherit ta afirmojë edhe jashtë kufijve të Turqisë dhe Shqipërisë dhe ta radhisë në vargun e shkencëtarëve dhe enciklopedistëve botërorë. Dr. Hasan Kaleshi për Sami Frasherin ka shkruar edhe disa punime në revista të ndryshme evropiane. Për historinë tonë kombëtare, rëndësi të veçantë ka punimi: *“Mendimet e Sami Frasherit për “Megali Idea”*, botuar në revistën “Belgeler Turk Tarih Dergisi” në vitin 1971. Në këtë punim trajtohen polemikat e Sami Frasherit kundër Shoqatës Shkencore Greke e cila gjatë dhe pas Kongresit të Berlinit ka ekzistuar në Stamboll, përmes Megali Idea, Shoqata në fjalë ka propaganduar aneksimin e territoreve të Shqipërisë së Jugut. Këtë propagandë greke, Sami Frasheri e ka kundërshtuar ashpër me fakte dhe argumente, në gjuhën greke, të cilën e ka njohur shkëlqyeshëm, përmes gazetës *Terxhimani Shark*, i cili në atë kohë ka qenë Kryeredaktor i saj.

Në punimin me titull: *“Depërtimi turk në Ballkan dhe islamizimi-faktorë të ekzistencës etnike dhe kombëtare të popullit shqiptar”*, botuar në vitin 1975 në gjuhën gjermane, Prof. Dr. Hasan Kaleshi paraqet këtë tezë të tij të re, e cila tezë sot është standardizuar, edhe pse pas rënies të sistemit monist, ka pasur shumë raste që këtë tezë kanë dashur të përvetësojnë disa shkencëtarë shqiptarë si të veten, duke tentuar të tregojnë se ato janë të parët të cilët e përhapin një tezë të tillë.

Në kundërshtim me historiografinë bashkëkohore shqiptare të kohës, e cila në depërtimin e Perandorisë Osmane në Ballkan dhe në islamizimin e shqiptarëve gjen vetëm elemente negative, Dr. Hasan Kaleshi në këtë studim paraqet një tezë krejtësisht tjetër, duke theksuar dhe argumentuar se në kohën kur shqiptarët ishin *pa shtet, pa kishë të tyre, pa tradita kulturore, pa kler, pa shkolla, të rrethuar nga Bizanti në njërin anë, nga shteti serb në anën tjetër, nga Venediku në anën bregdetare*, në këto rrethana nuk ka pasur kurrfarë gjasash të ekzistojnë si komb. Me depërtimin turk në Ballkan, me shkatërrimin e Bizantit dhe të shtetit serb, me deziorentimin e kishave të tyre i hapet rrugë ekspansionit shqiptar nga veriu, në këtë mënyrë njëkohësisht pengohet asimilimi i shqiptarëve nga elementet e lartcekura.

Kontributi shkencor i Prof. Dr. Hasan Kaleshit, në fushën e historisë kombëtare, nuk është i vogël, edhe në ndriçimin e veprimtarive kombëtare të një vargu të personalitetëve shqiptarë të cilët vepruan në kohën e Perandorisë Osmane. Për disa prej tyre, për herë të parë shkroi pikërisht Dr. Hasan Kaleshi, siç është rasti për *Dr. Ibrahim Temon*, i cili është themelues i komitetit Xhonturk, ‘Bashkim

e Përparim”, organizator i Revolucionit Xhonturk, i cili rezultoi me heqjen e Sulltan Hamitit nga fron. I. Temo, shqiptar nga Struga, qe i angazhuar me tërë qenien shpirtërore në lëvizjen kombëtare shqiptare, bashkë me N. Naçon ka punuar në Bukuresht, ka qenë një nga udhëheqësit e kolonisë shqiptare në Konstancë, ka marrë pjesë në Konferencën e Paqes në Paris, si delegat i shqiptarëve të Rumanisë, ka qenë bashkëpunëtor i revistës ”Albania” të F. Konicës, etj. Mirëpo deri në atë kohë as në historiografinë shqiptare, as në atë turke nuk i është dhënë vend i merituar dhe nuk është shkruar asnjë artikull për personalitetin dhe veprimtarinë e tij politike dhe kombëtare, kurse disa në bazë të fakteve dhe dokumenteve do t’ua begatojë veprimtarinë e tyre kombëtare, kurse disa nga ato do t’i ngrejë në pedestalin më të lartë shkencor, duke i radhitur në mesin e enciklopedistëve dhe shkrimtarëve më të mëdhenj të rangut botëror, siç është rasti me Sami Frashërin.

Dr. Kaleshi, jo vetëm që ka pasur prirje dhe talent të veçantë për t’u marrë me punë shkencore, por ai ka pasur edhe guxim, sepse ai ka publikuar veprimtarinë kombëtare të disa personaliteteve, që kolegët e tij të kohës nuk kanë guxuar t’ua përmendin as emrat, siç është rasti me Mid’hat Bej Frashërin, për të cilin më së miri na flet dorëshkrimi i cili është gjetur mbi tavolinën e punës, duke e përgatitë artikullin për leksikonin biografik cili botohej në Muni, por mjerisht, dorëshkrimi ka mbetur i papërfunduar dhe pa u botuar, jo vetëm për Mid’hatin Frashërin, por edhe për shumë personalitete të tjera kombëtare të cilët kanë qenë të paraparë të botohen në atë leksikon, për shkak të vdekjes së pa prituri të Dr. Hasan Kaleshit. Për të shkruar në atë kohë për Mid’hat Frashërin, themeluesin e Ballit Kombëtar, nuk është dashur të kihet vetëm dituri, por edhe guxim, të cilat virtyte nuk i kanë munguar Prof. Dr. Hasan Kaleshit. Në këtë kontekst duhet cekur se Dr. Kaleshi shkroi në atë kohë artikuj edhe për disa personalitete kombëtare, për të cilët në kohën e komunizmit nuk flitej as që shkruhej në të dy anët e kufirit si për: *Faik Konicën, Eqrem e Syreja Bej Vlorën, Ibrahim Temon* e shumë të tjerë. Kur është fjala për Faik Konicën Dr. Kaleshi me rastin e shënimit të 100- vjetorit të lindjes së Konicës, të cilin përvjetor e shënon Federata Panshqiptare “VATRA” në vitin 1976 në Nju Jork, paraqet temën: “*Faik Konica dhe marrëdhëniet e tij me Austro-Hungarinë*”, të cilin referat, për shkak të ndërrimit të papritur të jetës së tij, e ka lexuar në simpozium me lot në sy, Z. *Edvard Lico*. Profesor Kaleshi, përmes punimit në fjalë, jep një kontribut të veçantë të lëvizjes kombëtare, politike dhe letrare të Faik Konicës. Po ashtu përmes këtij artikulli, autori nxjerr në pah aktivitetin politik dhe kombëtar të Konicës, në përhapjen e ndjenjave kombëtare shqiptare dhe popullarizimin e tyre të intelektualët e kolonive shqiptare në vende të ndryshme të botës, në ngritjen dhe afirmimin e problemit shqiptar në Evropë dhe Amerikë, luftën e tij diplomatike dhe intelektuale kundër copëtimit të territoreve shqiptare, si dhe pjesëmarrjen e tij në konferencat ndërkombëtare lidhur me caktimin e kufijve të shtetit shqiptar.

Vlen të theksohet së në **Biographische Lexikon zur Geschichte Sudosteuropas**, (Leksikon për historinë e Evropës Juglindore), me qendër në Muni, Dr. Hasan Kaleshi ka botuar 28 artikuj të personaliteteve të lëvizjes kombëtare shqiptare gjatë periudhës osmane, si për : *Abdyl Frashërin, Pashko Vasën, Eqrem Bej Vlorën, Syrija Bej Vlorën Ali Pashë Gucinë, Sami Frashërin,*

Haxhi Zekën, Hasan Prishtinën, Abedin Pashë Prevezën, Dervish Himën, Shahinë Kolonjën, Faik Konicën, Kristo Luarasin, Turhan Pashë Përmetin, Ibrahim Temon, Fan Nolin, Ismail Qemalin e shumë të tjerë, veprimtaria kombëtare e të cilëve ka qenë kryesisht zgjedhja e çështjes shqiptare, krijimi i një shteti të natyrshëm shqiptarë. Artikujt e lartcekur për personalitetet në fjalë, për mendimin tim, nuk janë botuar rastësisht në atë kohë në gjermanisht nga Dr. Hasan Kaleshi, por, për qëllime të caktuara, duke dashur përmes tyre, ta njohi opinionin më të gjerë intelektual shkencor evropian, lidhur me kërkesat dhe angazhimet e rilindësve tanë, për zgjedhjen e çështjes kombëtare.

Siç kemi theksuar më lartë, punimet shkencore të Prof. Dr. Hasan Kaleshit, nga fusha e historisë, nuk janë të qëndisura me korniza romantike, por duke qenë të mbështetura në dokumentet autentike, kanë vlera të veçanta për historinë tonë kombëtare, sepse përmes tyre ai hap shtigje të reja në fushën e historisë, zbulon personalitete të mirëfillta kombëtare, jep teza të reja, heq konfuzione dhe dilema deri atëherë të pasqaruara. Dr. Hasan Kaleshi me veprimtarinë e tij parimore dhe principet shkencore, ka mbetur i pavdekshëm për botën shkencore dhe ka pasuruar të gjitha ato disiplina shkencore me të cilat është marrë, ka pasuruar edhe Historinë e tonë Kombëtare, andaj si i tillë do të zërë vendin meritore në Historinë e Popullit Shqiptar.

MUHARREM BAZDUL

GJYSMË SHEKULLI I “GJENERALIT TË USHTRISË SË VDEKUR”

Vreme, Beograd: Ismail Kadare (lindur në vitin 1936 në Gjirokastrë, në Jug të Shqipërisë) është ndoshta shkrimtari më i rëndësishëm bashkëkohor ballkanik ende i gjallë...

Djep dhe varr

Ismail Kadare (lindur në vitin 1936 në Gjirokastrë, në Jug të Shqipërisë) është ndoshta shkrimtari më i rëndësishëm bashkëkohor ballkanik ende i gjallë. Para pesëdhjetë vitesh, Kadareja publikoi Gjeneralin e ushtrisë së vdekur, romanin e tij më të dëgjuar. Pas këtij romani, Kadareja ka shkruar një opus të tërë romanesh të cilat me të drejtë, krahas për krahas me Ivo Andriçin dhe Niko Kazanqasin, e vendosin atë në majat e letërsisë Ballkanike, botë e tre qytetërimeve, tri kulturave, tri gjuhëve, botë në një tokë të askujt ndërmjet jetës dhe vdekjes, botë në të cilët shtatzënia e vejushave të Hercenit nuk është metaforë, por fat real.

Tek Borgesi ka një ese sugjестive mbi të paturit turp të historisë, tezë kryesore e së cilës është ajo se ngjarjet kryesore të historisë nuk mund të njihen në kohën kur zhvillohen, por më vonë, sepse historia nuk është gazetari, por është shumë më e turpshme. Në gjurmë të kësaj teze me ra ndërmend mundësia e datimit të një viti në të cilin Serbia e ka humbur Kosovën në mënyrë thelbësore, dhe e cila të përputhet me stereotipat e zakonshme publicistike, dhe, kësaj, më dolën përpara viti i eliminimit të autonomisë së Kosovës, viti i bombardimit të NATO-s, apo viti në të cilin Prishtina shpalli formalisht pavarësinë. Viti që më vjen ndërmend është viti 1997, vit në të cilin shtëpia botuese e Nishit “Prosveta” pati botuar “Viti i zi” (me sa duket bëhet fjalë për romanin “Viti i mbrapshtë“-shënimi im. Xh.F.), roman të Ismail Kadaresë, të cilin e kishte përkthyer Vilotije Ristiç nga gjuha frënge (origjinalin në shqip në frëngjisht e ka përkthyer përkthyesi i atëhershëm dhe i përhershëm i Kadaresë në këtë gjuhë Jusuf Vrioni, dhe pas kësaj Ristiçi e ka përkthyer në serbisht).

Të kuptohemi, Kadareja është nga ata shkrimtarë i cili përkthimet e ndonjë prej librave të tij në një gjuhë “të madhe” në njëfarë mënyre i lejon dhe autorizon të përkthehen në gjuhë të treta që pikërisht këtë përkthim të përdorin si “ndërmjetës”. Në rastin e Kadaresë ky është përkthimi në gjuhën frënge. Ndoshta edhe të gjithë përkthimet nga Kadareja në gjuhën angleze nuk janë përkthime nga origjinali, por nga përkthimi në frëngjisht, por ama reputacioni i Kadaresë në Angli dhe Amerikë është i një shkallë të lartë (madje ai është edhe fituesi i parë i Buker-it

ndërkombëtar). Vetëm se këtu rasti i Serbisë dhe i gjuhës serbe në asnjë rast nuk është i krahasueshëm me ata vende në të cilat flitet anglisht. Në atë vitin 1997, Kosova ishte pjesë e Serbisë dhe këtë fakt askush në botë nuk e refuzonte. Në Serbi atëbotë jetonte ndoshta një e pesta e popullsisë e cila e kishte shqipen gjuhë amtare. Nga ana tjetër, kjo popullsi është e përqendruar në një krahinë e cila nga Nishi nuk është më larg se njëqind kilometra.

Dhe na del se botuesi, i cili pati dëshirën e lavdërueshme të publikojë një roman të shkëlqyer të një prej shkrimtarëve më të mëdhenj europianë dhe botërorë, nga njëra anë, dhe në anën tjetër, nuk ka shqiptarë që di serbisht dhe që dëshiron të përkthejë shkrimtarin më të rëndësishëm shqiptar për botuesin serb, dhe as ka serb që është përkthyes letrar nga shqipja.

Tre temperament

Në RFS të Jugosllavisë gjithsesi nuk ka pas qenë puna kështu. Gjeneralin e ushtrisë së vdekur (në serbisht *General mrtve vojske* - shënimi - im Xh.F.) e pati përkthyer në serbisht Esad Mekuli në vitin 1968. Kështjellën në vitin 1977 e ka përkthyer Vehap Shita, i njëjti përkthyes i cili dy vite më vonë përktheu edhe Kronikë në gur, ndërsa Pallatin e ëndrrave në vitin 1991 e ka përkthyer Shkëlzen Maliqi. Të dy librat e parë të përmendur më sipër i kanë publikuar botues nga Serbia, ndërsa dy të fundit botues nga Sarajeva. Është interesantë gjithashtu të vëmë në dukje, dhjetë vite më vonë se përkthimi i Mekulit të Gjeneralit të ushtrisë së vdekur, shtëpia botuese e Rijekës (Kroaci) “Otokar Kershovani“, botoi një përkthim tjetër të të njëjtit libër, me titullin General mrtve Armije.(V.O. vini re dallimin me përkthimin e Mekulit titulli është përkthyer *General mrtve vojske* - shënimi im Xh.F.).

Megjithëse pasuesi mesatar i tezës se gjuha kroate dhe ajo serbe janë gjuhë të ndryshme, ka mundësi që fjalën vojska ta konsiderojë fjalë kroate, ndërsa armija serbe, tek Kadareja na doli e kundërta, ndoshta për shkak të dëshirës së përkthyesit dhe botuesit në mënyrë që qysh në titull të vihet në dukje dallimi, meqenëse fjala vojska ka qenë e zënë nga versioni serbisht. Është më rëndësi këtu që të shënojmë se përkthimi kroat (Gjure Plemenčica) është bërë jo nga shqipja por, nga frëngjishtja. Është interesante të shënojmë se edhe përkthimi slloven i romanit më të famshëm të Kadaresë (*General mrtve Armade*) të Jakob Emershçit i vitit 1976, ka qenë gjithashtu i përkthyer nga frëngjishtja. Një vit më herët, është përkthyer në gjuhën maqedone (*Generalot na mrtvata vojska*), ashtu si duhet, nga gjuha shqipe (përkthyes Adem Gajtani).

Më duket se ka shumë të dhëna dhe gjëra indikative madje edhe në kronologjinë e përkthimeve të Kadaresë; në fillim Serbia, pastaj Maqedonia, pastaj Sllovenia dhe Kroacia, dhe në mënyrë të veçantë në faktin se përkthimet në serbisht dhe maqedonisht janë bërë nga gjuha shqipe, ndërsa ata në sllovenisht dhe kroatisht nga frëngjishtja. Në librin e Enes Çengiçit (poet dhe publicist nga Sarajeva-shënimi im) të titulluar Me Kërlezhën nga dita në ditë, një shënimin ditor të datës 3 shkurt të vitit 1978, na zbulohet se Çengiçi e pati pyetur Kërlezhën (Miroslav Kërlezhë- shkrimtari më i madh kroat i të gjitha kohërave-shën.im) nëse e kishte

lexuar Generalin e ushtrisë së vdekur (Çençiqi përdor: General mrtve vojske, pra përkthimi serb). Kërlezha, i cili atyre ditëve dinte të ishte cinik ndaj Tolstoit, Ujeviçit (Augustin Ujeviç- poet dhe shkrimtar kroat. Shën. im), i ishte përgjigjur se e kishte lexuar atë libër dhe kishte shtuar: “Shkrimtar i talentuar, roman modern dhe do të lexohet me interes të veçantë si në Romë, si edhe në Tokio apo Londër”.

(Pak digresion-është interesante përputhja me atë të gjashtë viteve më parë, pasi është publikuar Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Alen Boskeja pati publikuar një ese për këtë roman në revistën “Combat“, në të cilën shkruan: “Në kufirin e tre temperamenteve, Greqisë e cila i jep meloditë e saj, Shqipërisë e cila i jep qëllimet e qarta dhe Malit të Zi i cili kufizon me të, i japin një mrekulli të çuditshme Ismail Kadaresë një zë që duhet llogaritur... Duke u ndjerë njësoj mirë si në Paris, Pekin apo në Nju Jork, ai mund të bëhet një shkrimtar i rëndësishëm botëror”. Dihet se Kërlezha e lexonte “Combat-in“. A thua, gjashtë vite pas këtij ilustrimi të Boskesë, universaliteti i prozës së Kadaresë, nëpërmjet numërimit simbolik të tre metropoleve, njëri europianoqendror, tjetri i Lindjes së Largët, e tjetri anglosakson në mënyrë të pavetëdijshme kanë jehuar tek Kërlezha, vetëm me ndryshimin se Parisi është bërë Romë, Pekini, Tokio- ndërsa Nju Jorku, Londër?)

Dy përbindësha

Në Shqipërinë e Enver Hoxhës, Kadareja nuk ka qenë disident i vërtetë. Në ndryshim nga shkrimtarët që kanë vuajtur nëpër qelitë e burgjeve, Kadareja gjithmonë ka qenë anëtar i denjë i bashkësisë. Gjithashtu nuk është se librat e tij kanë qenë thellësisht subversivë. Në një mënyrë të njohur, pozita e tij në Shqipërinë Socialiste, mund të krahasohet me atë të Andrzej Vajdës në Poloninë Socialiste, apo ndoshta edhe me pozitën e disa regjisorëve të sotëm të Iranit. Thënë thjesht, lavdia globale dhe fama e fituar i kanë mbrojtur nga hakmarrja. Kadareja e ka fituar lavdinë letrare shumë herët. Qëkur ishte në moshën njëzet e shtatë vjeç, me publikimin e romanit Gjenerali i ushtrisë së vdekur në vitin 1963.

Roman i cili fillon me një ton gri dhe melankolik: Gjenerali arrin në një vend të huaj, në një qytet të panjohur, në një kohë që bie shi përzier me dëborë. Misioni i gjeneralit është i pikëllueshëm: i duhet të kthejë në atdhe eshtrat e ushtarëve italianë të vrarë në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Ajo që vjen pas është njohja e gjeneralit me Shqipërinë nëpërmjet kërkimit të varrezave, nëpërmjet ekshumimit dhe identifikimit. Rrallë ndonjë shkrimtar ka shkruar në mënyrë kaq sugjestive mbi luftën se sa Ismail Kadareja në Gjeneralin e ushtrisë së vdekur, e pra është fjala për një roman ngjarjet e të cilit zhvillohen disa vite pas përfundimit të luftës. Lufta është disi e harruar, por jeton pikërisht nëpërmjet, dhe, nën lëkurën e atyre që jetojnë dhe eshtrat e atyre që kanë vdekur. Gjithçka bie erë vdekje, sikurse është edhe shënimi i gjeneralit në fund të romanit.

Megjithëse romani si formalisht ashtu edhe për nga përmbajtja është zhgënjyes për kanonet e realizimit socialist, gjë e cila vihet re tek pesimizmi metafizik i Kadaresë, madje edhe tek njëfarë opsioni i tij për vdekjen, në Shqipërinë e asokohshme është lexuar nën prizmin i ngritjes lart të Luftës çlirimtare antifashiste shqiptare dhe fitores ndaj fashizmit. Përgjithësisht kjo ishte strategjia politike e

Kadaresë: në të shkruar të ndjekë, porë në përgjithësi, linjën bazë të së lejuarës, por ama të jetë kryengritës kur vjen puna tek detajet: gjë për të cilën cinikët mund të shpreheshin; ta gërryente diktaturën nga brenda. Një citat autopoetik i Kadaresë është indikativ në këtë kuptim: “Ndryshe nga sa është menduar shpesh herë, kohët tragjike, kohët kur diktaturat egërsohen, i shkojnë për shtat letërsisë. Diktatura dhe e drejta e letërsisë mund të ekzistojnë vetëm në një formë: duke u shqyer ditë e natë me njëra tjetrën. Për nga natyra shkrimtari është armik natyror me diktaturën. Ai lufton kundër saj në çdo moment, madje edhe atëherë kur ai mendon se është në gjumë. Kjo është diçka që është e shkruar në kodin e tij gjenetik. Diktatura dhe e drejta për letërsi nuk mund të mendohen ndryshe veçse si dy përbindësja që janë përherë në dyluftim me njëri tjetrin...”. Kadareja ka studiuar në Moskë dhe në shkrimet e tij shumë veta njohin stilin e Gogolit dhe Bulgakovit. Më vonë në shkrimet për librat e tij, në mënyrë të veçantë në Perëndim, është shfaqur edhe krahasimi i tij me Heminguejn, Kafkën dhe Oruellin. Nuk është puna se në këto krahasime nuk ka gjëra të vërteta, por gjithsesi ato janë të pabazuara. Sepse Kadareja është shkrimtar Ballkanik me themel.

Një Ballkan

Ndoshta në mënyrë të vetëdijshme (ose megalomane) është quajtur “Homeri shqiptar“, Kadareja është gjithsesi një shkrimtar shumë i ngjashëm me Ivo Andriçin ose Niko Kazanzaqisin. Kjo ngjashmëri nuk është vetëm letrare. Që të tre kanë patur një eksperiencë direkte në politikë. Kazanzaqisi ka qenë ministër pa portofol në qeverinë greke pas Luftës së Dytë Botërore, Andriçi, sikurse e dimë, ka qenë nëpunës i Ministrisë së Jashtme dhe ambasador i Mbretërisë së Jugosllavisë. Kadareja ka qenë deputet në parlamentin e Shqipërisë Socialiste. Tek të tre gjithashtu ekziston edhe qëndrimi se gjithçka në këtë botë i nënshtrohet veprës, porse, gjithashtu letërsia është gjëja më e rëndësishme në botë.

Thënë ndryshe, sipas fjalëve të Andriçit, për të letërsia kurrë nuk është thjesht lënia pa frë e fantazisë me dëshirë dhe gjuhë të zgjidhur, porse diçka që kurrë nuk është jashtë rrethit të interesit direkt shoqëror. Për këtë nuk janë të çuditshme edhe kontraversat e fuqishme që u ngjishen që të treve, që nga problemet e Kazanzaqisit me kishën, nëpërmjet “kritikave“ të ndryshme ndaj Andriçit (duke filluar që nga akuza për islamofobi dhe urrejtje ndaj shqiptarëve për shkak të disertacionit të tij të doktoraturës, apo elaboratit mbi çështjen shqiptare dhe interpretimet analfabete të disa veprave të tij letrare e deri në vërejtje për të ashtuquajturin „pakt të tij me komunistët“ dhe hartimin e propozimit që Titos t’i jepet çmimi “Nobel“ për paqen) deri tek etiketimet gjithfarëshe ndaj Kadaresë (shërbëtor i Enver Hoxhës, nacionalist etj.) Edhe për Andriçin edhe për Kadarenë mund të zbatohet fraza të cilën e shkruan Milena Jovanoviçi për Kazanzaqisin: “Mund të thuhej se në politikë ishte luajal (ndaj interesave shtetërore), ose më saktë, aktiviteti i tij politik i “detyrohej“ patriotizmit të tij, i cili ishte i frymëzuar me dëshirën për të ndihmuar, që njerëzve tu bëhej mirë, pa asnjë interes personal të tij“. Krahasimi i Andriçit dhe Kadaresë meriton një tekst të veçantë, por ia vlen të kujtohet se për shembull Ura me tre harqe e Kadaresë është e pamendueshme pa

Urën mbi Drinë të Andriçit. Ndjehen jehonat e Andriçit edhe në romanet e tjera të Kadaresë mbi “vaktin turk“. Si edhe Andriçi, Kadareja është më shumë mjeshtër i traseve të shkurtra dhe të mesme se sa atyre të gjata: zhanri i tij kyç është romani i shkurtër por i rënduar Oborri i mallkuar (Në Kronikën e Travnikut dhe në Urën mbi Drinë Andriçi shkruan proza të shkurtra shumë prej të cilave mund të funksionojnë të pavarura; eseja e Xhejms Vudit për opusin e Kadaresë ka titullin Kronika dhe fragmente titull me të cilin në mënyrë mjaft komode mund të shkruhej edhe për opusin e Andriçit). Si Andriçi (ose edhe si Meshja Selimoviçi), edhe Kadareja është i prirur për të shkruar për modernen nën petkun e alegorisë. Por gjithsesi, në kohët e reja, në mënyrë të veçantë tek novela Vajza e Agamemnonit, romani Trashëgimtari dhe në disa tregime të tjera të shkurtra, Kadareja shkruan për Shqipërinë nën Enver Hoxhën në një rregjistër tjetër, në atë dokumentar. Në kontekstin e pareles Kazanzaqis-Andriç-Kadare, është me vend të citohet edhe një fragment i intervistës së fundit të Kadaresë dhënë Branka Bogovacit: “Në Ballkanin e zvogëluar, sot, pas vetëtërheqjes së Sllovenisë dhe Kroacisë, ekzistojnë tre popuj që vazhdojnë të mbahen dhe në të vërtetë janë të paevitueshëm: Grekët, Shqiptarët dhe Sllavët. Këto janë tre qytetërime, tri kultura, tri gjuhë. Ballkani nuk mund të përfytyrohet pa njeriun që i përket kontekstit të tij Ballkanik. Të ngjeshur prej kohësh në këtë zonë europiane, mbijetesa e kujtdo ishte e kushtëzuar nga të tjerët. Në situata të ndërlukuara, dashje pa dashje, kemi qenë të detyruar të merremi vesh. A ju duket i errët ky vizion? Mendoj se ajo që përjetuam në kohët e reja, nuk ishte aspak më e tmerrshme.

Që ti kthehemi një vizioni që jep më shumë shpresa, mund të thuhet se, megjithatë, në Ballkan është vendosur një ekuilibër. Sot, në kushtet e ekzistencës së Bashkimit Europian, tutor që e kemi pranuar që të gjithë, ky ekuilibër është i sigurtuar shumëfish. Që ti kthehem treshes së ekuilibrit Ballkanik: Grekët, Sllavët, Shqiptarët-besoj se jeni dakord me mua kur them se asnjëri prej këtyre tre popujve, për asnjë arsye dhe në asnjë rrethanë, nuk mund të ndahet nga ky gadishull problematik. Gjithçka qëndron në atë që ky fakt të kuptohet“. Nga perspektiva jonë është dobiprurëse që të kuptohet ky perceptim i Kadaresë: Grekë, Shqiptarë dhe Sllavë. Si serbët, si boshnjakët, si maqedonasit, si malazezët, pa hajde të themi edhe bullgarët, Kadareja, në kontekstin Ballkanik i sheh si një popull i vetëm, si sllavë (të jugut). Me grekët dhe shqiptarët, sllavët (e jugut) ndajnë së bashku Ballkanin, djepin e qytetërimit.

Është e lehtë të biesh dakord me Kadarenë se Grekët, Shqiptarët dhe Sllavët janë treshja e ekuilibrit Ballkanik, por megjithatë nuk është e lehtë, së paku nga perspektiva e sotme, që si garant të këtij ekuilibri të shihet Bashkimi Europian. Vizioni që të jep më shumë shpresa është vizioni i Ballkanit të lirë, vizioni sipas të cilit popujt Ballkanikë e njohin dhe e ndihmojnë njëri tjetrin. Simbol i këtij vizioni më parë është Goran Bregoviçi dhe kënga që grupi Bjello Dugme këndon në gjuhën shqipe (është fjala për këngën “Mora mandolinën“ e kënduar në shqip nga grupi i famshëm jugosllav i muzikës rok Bjello Dugme, ku frontmen ka qenë këngëtari kosovar Agron Berisha- shënimi im), se sa përkthimi i një prej romaneve më të mirë shqiptarë-nga gjuha frënge. Vizioni i errët i Ballkanit, vizioni i varrezave masive, vizioni i ekshumimeve dhe identifikimeve, vizioni që na

pikturon Ismail Kadareja tek romani *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, është vizioni që shohim edhe sot, teksa familja Tomashiç në Prijedor të Bosnjë e Hercegovinës vazhdon të gërmojë në një vend ku gjendet një varrezë e përbashkët që nga koha e luftës në Bosnjë e Hercegovinë.

Kadareja romanin e tij e ka publikuar tetëmbëdhjetë vjet pas Luftës së Dytë Botërore, tetëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Bosnjë e Hercegovinë, vështirë se mund të gjendet ndonjë libër i cili, me fuqinë e *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur*, do të mund ta përkujtojë atë luftë. Skena nga romani i Kadaresë, ajo skenë në të cilën plaka i flet gjeneralit për njërin prej të vdekurve që ai kërkon, njeriut i cili i ka vrarë burrin dhe i ka përdhunuar të bijën, pothuajse njëlloj mund të pikturojnë kohën tonë. Ismail Kadareja është shkrimtar i botës Ballkanike, botës sonë, botës në të cilën vejjshat shtatzënë nuk janë një metaforë e Hercenit, por fate reale, rreth të cilëve gërshetohen legjenda gojore, maksima të Sioranit dhe narracione epike artistike mbi të cilat qëndron pezull aureola e tragjediëve antike.

Muharrem BAZDUL, shkrimtar dhe publicist nga Sarajeva

Përktheu: **Xhelal Fejza**

Shënim i përkthyesit: *E gjej me vend të informoj se krahas romaneve të Kadaresë të cituar më sipër në gjuhët sllave (të popujve të ish- Jugosllavisë) është përkthyer nga Smajl Smakaj (gazetar i TV Kosovës dhe njëkohësisht edhe përkthyes i poezive të Visar Zhitit në kroatisht) dhe botuar nga shtëpia botuese „Drita“ e Malit të Zi, edhe romani i fundit i Kadaresë “Darka e gabuar“. Është shitur madje edhe nëpër libraritë e Beogradit. Përkthyesi Smakaj, në versionin në gjuhën malazeze të Darkës së gabuar titullin e ka përkthyer Pad kamenog grada (Rënia e qytetit të gurtë) gjë e cila edhe mund ta ketë ngatërruar shkruesin e artikullit për nga ngjashmëria me Kronikën në gur (përkthyer si pamë në artikull nga Vehap Shita) dhe për këtë edhe nuk e ka evidentuar.*

“Vreme“, Beograd, 21.11.2013

GONXHE BOJAXHI DHE FLETORJA E FSHEHTË ME POEZI

Kujtimet e të vëllait, Lazrit: Fëmijëria dhe largimi nga Shkupi



Gonxhe Bojaxhiu

“Ajo ishte një vajzë normale, mbase pak e tërhequr dhe e rezervuar, por kishte shumë miq. Ajo kalonte një pjesë të madhe të kohës me ta dhe ata shpesh vinin në shtëpinë tonë. Talenti i saj në shkollë u shqua që në vitet e para në klasë, gjithnjë e gatshme për t’i ndihmuar të tjerët. Më kujtohet që ajo kishte një shoqe të ngushtë, e bija e doktor Milkoviqit. Si vajzë e re kishte prirje për poezi, shkruante vjersha të shkurtra që ua lexonte të gjithëve”, kështu e kujton të motrën Anjeze Gonxhe Bojaxhi, i vëllai Lazri. Në kujtimet dhënë për biografin e saj, Dom Lush Gjergji, teksa flet për fëmijërinë, ai sjell pasazhe nga jeta e shenjtores shqiptare. “Ajo ishte shumë e hapur dhe e përzemërt me shoqet, kurse me meshkujt disi e druajtshme. Mirëpo ajo ishte e shoqërueshme me të gjithë, pa ndonjë përjashtim feje, gjuhe a kombësie. Kurrë nuk më ka rënë ta shoh të mos i dëgjojë prindërit. Nëna shpesh më thoshte: ‘Bëhu si Gonxhja, anise është më e re se ti!’. Nëna gjithnjë kërkonte nga ne të ishim të rregullt dhe të urtë. Për çdo mbrëmje na duhej që me rend t’i pastronim këpucët, Agia, unë dhe Gonxhja. Shpesh e lusja: ‘Të lutem Gonxhe,

pastroji sot për mua ...’, sepse për mua si djalë më dukej turp të bëja disa punë, sillesha si Zot. Dhe ajo ma kthente: ‘Ani vëlla, do ta bëj për ty!’ Kur bëja ndonjë sherr dhe ajo e zbulonte këtë, e mbante për vete. Besoj se nëna e ndiente se Gonxhja ishte me bindje religjioze. Më kujtohet kur i thoshte se me dëshirë do të qëndronte tërë jetën me Gonxhen dhe frigohej se do ta humbte për dy arsye: shëndeti i saj i lig dhe kushtrimi i saj ndaj Zotit. Për këtë arsye ajo e donte më shumë Gonxhen, por kur Zoti e ftoi, ajo ia dha Atij duarhapur ...”, kujton Lazri.

Përpos mësimit, Gonxhja merrte pjesë aktive edhe në aktivitete bashkiake të famullisë, ajo këndonte në kor, recitonte në teatrin e qytetit, si dhe në shfaqje të festivaleve të ndryshme të famullisë, ku vallëzonte, shkruante shumë vjersha dhe i binte mandolinës. Për të, si dhe për familjen Bojaxhiu, famullia ishte një shtëpi e dytë. Ndikimi i saj më i madh ishte arkipeshkvi i Shkupit, imzot Lazër Mjeda, që ishte mik i familjes Bojaxhiu, të cilën ai e vizitonte shpesh. Përsos shkollës në famulli, kishte gjithashtu dhe mësim të katekëzës, këndimit, dramës, teatrit të vogël dhe shumë aktiviteteve të tjera. Më 1924-n, atë Cepetiqi u shkroi prapë eprorëve të vet në Zagreb këtë letër: “Falënderoj Zotin, nuk kam probleme me nxënësit e gjimnazit. Ata vijnë të mbushur me shpresë dhe unë bëj çmos për t’i ndihmuar. Po të mos jem në gjendje t’u gjej libra për katekizëm, do t’u huazoj të miat. Nganjëherë gjatë javës mbaj edhe nga dhjetë orë mësim, pasi kam mbetur prapa në këtë lëndë dhe dua ta plotësoj dhe të bëj ç’është e mundur. Pas shkollës fillore fëmijët vijnë tek unë dy herë në javë për mësim të katekizmit dhe nganjëherë i mbaj edhe të dielave pas meshës ...” Gonxhe Bojaxhi e ndihmonte priftin madje edhe në katekizim, pasi ajo vetë përkthente nga serbokroatishtja në shqip, sepse shumicës së fëmijëve, duke mos e kuptuar gjuhën, e kishin të vështirë të ndiqnin mësimet e katekizmit në famulli. Për të vëllain, Lazrin, Gonxhja u rrit në oborrin e kishës. “Kishte diçka që për të ishte më me rëndësi se çdo gjë tjetër: kisha. Ne jetonim shumë afër kishës katolike të Shkupit dhe kur ishim të vegjël, prifti i famullisë ishte shqiptar. Herë-herë më dukej sikur nëna dhe motrat e mia jetonin në kishë. Ato ishin shumë të përshpirtshme dhe gjithmonë të gatshme të zgjasnin dorën për të ndihmuar. Sa ishte gjallë babai shtëpia jonë i ngjante një vatre politike. Pas vdekjes së tij na mbante gjallë feja”, kujton Lazri. Më tej ai shton: “Kur dola nga shtëpia, Gonxhja nuk kishte mbushur 13 vjet. Ajo që atëherë ishte shumë e interesuar për punën e misionarëve. Sa herë vinin nga vendet e largëta, ajo kishte dëshirë t’i takonte dhe të fliste me ta. Njëri prej tyre një ditë i tha: Çdo njeri ka rrugën e vet, të cilën duhet ta ndjekë. Këto fjalë e prekën thellë në zemër motrën time. Jezuiti që zëvendësonte priftin shqiptar një ditë hapi një hartë në kishë në të cilën ishin shënuar të gjitha misionet. Më kujtohet se edhe kjo gjë e preku shumë Gonxhen, pasi ajo erdhi menjëherë të më tregonte: “O vëlla, sikur të dije ku punojnë misionaret tona ... çfarë jete bëjnë...”, kujton ai. Gonxhja shpesh i thoshte se “isha shumë e re pa mbushur dymbëdhjetë vjeç e rrethuar nga familja kur ndjeva dëshirën për t’iu dhënë krejtësisht Zotit. Gjashtë vjet kam medituar dhe jam lutur. Nganjëherë më dukej se po bëja gabim, se kjo nuk ishte thirrje, por më në fund u binda se isha e ftuar nga Zoti. Zonja jonë e Letnicës, Zoja Černagore më ndihmoi shumë për të arritur një vendim të tillë”. Duke u përballur me thirrjen, Gonxhja vendos të shkojë në Letnicë, për të gjetur paqen e brendshme. Lorenc Antoni e

kujton kështu: “Përpara se të arrinte deri te vendimi përfundimtar, se a do të bëhej murgeshë misionare apo jo, ajo tha: “Do të shkoj në Letnicë dhe do të qëndroj atje nja dy muaj”. Ishte viti 1927. Në Letnicë ajo bëri ushtrimet shpirtërore. Këtë përvojë e përsëriti edhe më 1928-n. Para se të merrte vendimin ajo kishte një fletore të tërë të mbushur me poezi. “Kush e di në do të lexoj e shkruaj më poezi”, do të shprehej. Dëshira e saj e hershme kishte qenë të bëhej mësuese. Lazri e kujton me trishtim kohën e largimit të saj nga Shkupi. E gjithë familja ishte e pikëlluar, sipas tij. Ja si shkruan Lorenc Antoni në ditarin e tij për këtë ngjarje. “Në mbremjen e 25 shtatorit 1928, ne të gjithë u tubuam në shtëpinë e Gonxhes për t’i dhënë lamtumirën. Secili i kishte blerë ndonjë dhuratë të vogël, ndonjë laps, libër etj. Unë i dhurova një stilograf të artë, të cilën ajo e ruajti dhe e përdori për një kohë të gjatë më pas. Të nesërmen, më 26 shtator, ishte dita e largimit të saj. Shumë kishin dalë për ta përcjellë, fëmijë, të rinj, pothuaj mbarë famullia, madje edhe shokët e shkollës. Të gjithë i kishin mbërthyer sytë mbi të, të gjithë të mbushur me pyetje të pathëna: cila do të ishte e ardhmja e kësaj vajze në Indi, një vend i huaj dhe aq i largët? Unë u zgjova herët. Së pari, vajta në kishë dhe pastaj në stacion. Kisha blerë tri bileta për Zagreb (për Dranen, Agen dhe një për Gonxhen). Në stacionin e trenit të gjithë po qanin, dhe ajo po qante, ndonëse pak kohë më parë kishte thënë që nuk do ta bënte këtë. Edhe unë vetë kisha buzën në vaj, sapo mendoja se do të humbisja një kushërirë, një mike të mirë. Në çastin e nisjes ajo ma shtrëngoi fort dorën. Reagimi im ishte gati i ftohtë që të mos lejoja të pushtohej nga pikëllimi i nisjes. Treni u nis. Ne të gjithë valëvitnim shamitë, derisa treni u tret. Dielli ia kishte hedhur rrezet, duke u ndriçuar të tërën: ajo i ngjante një hënë që dalëngadalë humbet në lindjen e diellit ...”.

a.b

GENCIANA ABAZI - EGRO

LETËRSIA NË PROCESIN E FORMIMIT TË KOMBIT TE SHQIPTARËT

Në krye të poetëve të Shqipërisë qëndron Hasan Zyko Kamberi dhe pas tij vijnë Nezim Berati dhe Dalip Frashëri.

Kështu shprehet Naim Frashëri në vitin 1896 duke shtuar më tej se të gjithë këta poetë të mëdhenj janë fajtorë për përdorimin e shqipes me fjalë të huaja. Ky realitet letrar është prezantuar nga Naim Frashëri në parathënien që shoqëronte përkthimin e këngës së parë të Iliadës, të kryer nga ai vetë.

Një hyrje e tillë e shkruar nga poeti i madh i shqiptarëve merr një rëndësi të veçantë edhe sepse jep një panoramë të asaj që mund të konsiderohet tradita letrare shqipe. Nga ana tjetër ajo është edhe një dëshmi të asaj që shqiptarët kishin lexuar dhe shijuar.

Madje po të kemi parasysh se ky vlerësim dhe kjo hierarki letrare e përcaktuar nga Naim Frashëri është dhënë kohë mbas vdekjes së poetëve Nezim Berati (vd. 1760) dhe Hasan Zyko Kamberit (vd. pas 1822), mund të pohojmë edhe për një marrëdhënie të vazhdueshme dhe të stabilizuar që këta poetë, deri në këtë kohë ruanin me lexuesin.

Nga ana tjetër ky përcaktim i Naim Frashërit, në vetvete shpreh në një farë mënyre edhe një tension ndërmjet kësaj të kaluarë letrare dhe pritshmërive që kishte poeti për gjuhën kombëtare.

Vërejtjet lidhur me përdorimet gjuhësore të poetëve venë në pah qartë se kjo letërsi është larg nacionalizmit gjuhësor të artikuluar dhe aplikuar në këtë periudhë. Por nga ana tjetër konsiderata e shprehur për krijimtarinë e tyre letrare, i bëjnë ata pjesë të rëndësishme të së kaluarës së shqiptarëve.

Sami Frashëri

Hapja e shqiptarëve drejt të kaluarës letrare kishte filluar disa dekada përpara këtij vlerësimi. Zef Jubani më 1871 në antologjinë e tij letrare kishte përfshirë krijimtari nga Pjetër Bogdani, poetët shkodranë Molla Sali Pata dhe Molla Hysen Dobraçi, Nezim Berati dhe Pjetër Zarishi; Thimi Mitko përgatit për botim poezi nga Hasan Z. Kamberi; më 1882 Sami Frashëri harton një botim përmbledhës të Divanit shqip të N. Beratit; Jani Vreto më 1888 botoi poemën e gjatë Erveheja të Muhamet Kyçyikut (Çamit); kurse Ismail T. Gjakova më 1907 boton në Sofje, veprën Emni Vehbije të Tahir Efendi Gjakovës.

Prandaj dhe qasja që Naim Frashëri kishte ndaj traditës letrare të shqiptarëve, e shprehur më 1896, duhet vlerësuar si një mendim sintetik mbi gjithë këtë punës të kryer në epokën e nacionalizmit. Vëmendja ndaj të kaluarës është një proces i

natyrshëm që ka shoqëruar në përgjithësi popujt në procesin e kombformimit modern.

Ndërtimi i ndjenjës së përbashkët politike, kulturore e kombëtare kalon nga vlerësimi i trashëgimisë, që me fjalë të tjera do të thotë përcaktimi i plotë i vlerave që kombi kërkon t'i ruajë dhe t'i transmetojë në përputhje me pritshmëritë e kohës së re.

Inventarizimi i trashëgimisë letrare Intelektuali shkodran Zef Jubani që ndër nacionalistët e parë që shkroi për çështjet e historisë dhe të kulturës tek shqiptarët. Më 1871 ai boton në Trieste një antologji të letërsisë shqipe, të kultivuar dhe folklor.

I ndikuar nga De Rada, që vetëm pesë vite më parë kish botuar një përmbledhje të folklorit arbëresh (Rapsodie d'un poema albanese...), ai e emërton veprën e tij duke përdorur termin rapsodi (Raccolta di Canti Popolari e Rapsodie di Poemi Albanesi).

Mirëpo ndryshe nga De Rada, i cili kërkon të tregojë fragmente të një poeme epike të një rapsodie hipotetike të periudhës së Skënderbeut, Jubani përpiqet të dëshmojë fragmentet e letërsisë shqipe. Dhe ajo që kërkon të ndërtojë nuk është një poemë epike e lashtë, por trashëgimia letrare e shqiptarëve.

Kështu në antologjinë e Zef Jubanit gjejmë poezitë e Pjetër Bogdanit, Hysen Dobraçit, Nezim Beratit, Sali Patës dhe Pjetër Zarishit, d.m.th. më shumë se një shekull e gjysmë letërsi shqipe. Ndërsa vlerësimet që ai jep për këta poetë shënojnë dhe përpjekjen e parë për të kuptuar letërsinë shqipe dhe pozicionin që kanë në të poetët e sipërpërmendur.

Nga ana tjetër, historinë e letërsisë shqipe, apo më saktë trashëgiminë letrare të shqiptarëve ai e sheh në funksion të vendosjes së një lidhjeje me të kaluarën heroike dhe prezantimit të saj në funksion të ngjalljes shpirtërore e mendore, dhe jo vetëm kaq por edhe të krenarisë kombëtare dhe krijimit të modeleve.

Përveç kësaj, në përpjekje për t'i integruar shqiptarët në qarkun e popujve të qytetëruar të Europës, ai vendos paralele midis zhvillimeve letrare europiane me ato të shqiptarëve, dhe poetët Nezim Berati e Hysen Dobraçi i konsideron pasues të Anakreontit, kurse poetin satirik shkodran Sali Patën e përngjason me poetin satirik italian Casti.

Zef Jubani me shumë gjasë është i pari nationalist shqiptar që e përdori listën e heronjve dhe dijetarëve të shqiptarëve si mënyrën më të qartë dhe të drejtpërdrejtë për prezantimin e kombit.

Pas vdekjes së Z. Jubanit, për shkak të koniunkturës së re ndërkombëtare përpjekjet për inventarizimin e trashëgimisë kulturore njohën një hop të ri. Në këtë kohë në Europë po artikulohej qartë pyetja se cila nga popullatat e shumta europiane që mund të klasifikoheshin si kombësi duhej të kishin shtetet e veta.

Dhe në këtë kuadër përbërësit kryesorë të check-list-ës identitare ishin përcaktuar qartë dhe po aq qartë dhe rrugët nëpër të cilat duhej të ecte kombformimi modern. Shqiptarët kishin dijeni për këtë realitet dhe rëndësinë e tij e kuptuan më mirë veçanërisht gjatë Kongresit të Berlinit, ku u përballën në mënyrë të drejtë për drejtë me copëtimin e tokave të tyre.

Në kujtimet e tij Mihal Grameno, shkruan se gjatë vizitave që Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali Pashë Vrioni ndërmorën në pranverën e vitit 1879 në kryeqytete kryesore të Europës, atyre iu kërkua që shqiptarët të dëshmonin se kishin të gjitha veçoritë e një kombi modern, veçanërisht të konfirmonin se ishin një komb me gjuhë të shkruar.

Këtu e ka bazën, sipas Mihal Gramenos dhe puna themeltare që kryen Naim Frashëri dhe Sami Frashëri në këtë periudhë. Në të vërtetë, Lëvizja Nacionaliste e Shqiptarëve, pas shpërndarjes së Lidhjes së Prizrenit, u fokusua veçanërisht në afirmimin e elementeve identitare të kombit modern.

Në këtë kuadër, edhe puna për inventarizimin e trashëgimisë letrare të shqiptarëve fitoi një dimension të ri. Ky inventarizim bëhet zyrtarisht pjesë e platformës kulturore të shoqërisë Dituria. Jani Vreto, në parashtrimin e kësaj platforme më 1896 në mbledhjen e shoqërisë në Bukuresht, çështjen e trashëgimisë letrare të shqiptarëve e rendit ndër prioritet e para.

Ai kërkon gjetjen dhe botimin e veprave të Pjetër Budit, Pjetër Bogdanit, Hasan Zyko Kamberit, Nezim Beratit, këngëve labe dhe këngëve të shqiptarëve të Italisë dhe Greqisë.

Dy janë kriteret që përcaktojnë përkatësinë në trashëgiminë letrare të shqiptarëve në këtë periudhë: 1. Veprat të jenë pëlqyer në kohën e tyre; 2. Të jenë transmetuar nga një brez në tjetrin, duke sjellë në këtë mënyrë dhe konservimin e tyre.

Ndërsa në rastin e Hasan Zyko Kamberit, duke ju referuar gjithnjë Jani Vretos, kemi edhe një element tjetër shtesë. Poezitë e këtij poeti janë pëlqyer jo vetëm nga shqiptarët myslimanë, por edhe nga shqiptarët ortodoksë. Në të vërtetë edhe burimet dokumentare të kohës dëshmojnë se lexuesit e këtij poeti, veçanërisht në krahinën e Korçës janë si shqiptarët myslimanë, ashtu edhe shqiptarët ortodoksë.

Madje poezitë e këtij poeti janë qarkulluar dhe transmetuar veçanërisht edhe nga shqiptarët ortodoksë të krahinës së Korçës. Në kujtimet e tij Visarion Dodani bën me dije se një dorëshkrim të poezive të Hasan Zyko Kamberit e posedon në Korçë Rafail Avrami, i cili e kish marrë nga Filip Mano dhe i ky i fundit nga babai i teqesë në qytetin e Korçës. Kështu, në periudhën pas Lidhjes së Prizrenit, në ndryshim nga puna e Zef Jubanit, lista e trashëgimisë letrare hartohet në funksion të njohjes dhe transmetimit të këtyre vlerave.

Ajo është konceptuar si etapa e parë e domosdoshme që paraprin botimin e tyre. Në këtë mënyrë kemi kalimin nga parashtrimi dhe prezantimi i njerëzve të shquar të kombit, në përdorimin e tyre në funksion të procesit të afirmimit të kombi modern shqiptar.

Ndaj këto materiale hartohen vetëm në shqip dhe si publik kanë vetë shqiptarët. Në kuadrin e përdorimit të historisë letrare në funksion të çështjes kombëtare Jani Vreto do të trajtojë dhe historinë e shkrimit të gjuhës shqipe.

Në sprovën e tij Mendime mbi shkrimin e gjuhës shqipe, i mbetur në dorëshkrim, ai do të japë një listë të veprave të shkruara në shqip, të shoqëruara edhe me detaje të rëndësishme mbi vendndodhjen e dorëshkrimeve dhe veçanërisht për eksperiencat që shqiptarët kishin me këto krijimtari.

Këtij inventari, krahas veprave të përmendura në listën e trashëgimisë letrare, ai do t'i shtojë edhe Theodor Haxhifilipi, Tahir Efendi Gjakovën, vëllezërit Stefan dhe Nikolla Konomi prej fshatit Postenan, Naum Veqilharxhin dhe Muhamet Çamin.

Vetë J. Vreto ka gjetur edhe krijimtarinë e Tahir Gjakovës, por duket se përpjekjet e Jani Vretos kanë mbetur deri këtu, për shkak të vështirësive që ka hasur në deshifrimin e alfabetit arab me të cilën ishte shkruar shqipja.

Botimin e kësaj vepre me alfabetin e Stambollit do ta realizojë më 1907, në Sofje, Ismail Tahir Gjakova me ndërmjetësinë e shoqërisë Bashkimi, në shtypshkronjën "Mbrothtësia" të Kristo Luarasis.

Ndryshe ka vepruar Jani Vreto me krijimtarinë e poetit Muhamet Çamit. Dorëshkrimin e poemës Erveheja, Vreto e bën pjesë të projekteve të veta dhe e boton më 1888, në Bukuresht, në kuadrin e botimeve të shoqërisë Dituria.

Pavarësisht ndërhyrjeve të shumta që ai ka bërë në tekst, ky botim ka qenë shumë i suksesshëm, pasi deri më vitin 1925 rezulton të jetë ribotuar edhe pesë herë të tjera, (Selanik, Korçë dhe Vlorë). Kështu Jani Vreto ka meritën për krijimin e një panorame të plotë të traditës letrare shqiptare, në përputhje me njohjet e deri atëhershme, por edhe si autor i botimit të parë modern të letërsisë shqipe me alfabetin arab.

Qasje kritike Poetët Nezim Berati, Hasan Z. Kamberi, Muhamet Çami, Tahir Gjakova, Hysen Dobraçi dhe Sali Pata ishin pjesë e të kaluarës që dëshiron të kujtohet dhe që nuk do të harrohet plotësisht. Kështu intelektualët nacionalistë në marrëdhënien me të kaluarën, në këtë periudhë, nuk krijuan hendeqe apo harresa të vullnetshme që si pasojë prodhojnë përjashtimet.

Në kuadrin e vazhdimësisë (continuity) apo ndërprerjes (discontinuity) ata zgjedhën të parën, por kërkuan që kjo e kaluar të vlerësohet në kuadrin e ideologjisë kombëtare. Dhe pikërisht ideologjia kombëtare do të përcaktonte dhe mënyrën e transmetimit të mëtejshëm të këtyre veprave.

Problemin që ekzistonte ndërmjet letërsisë shqipe me alfabetin arab dhe nacionalizmit gjuhësor e ka vënë në dukje për herë të parë Thimi Mitko, gjatë përgatitjes për botim të poezive të Hasan Zyko Kamberit. Sipas tij poezitë, të cilat ai i vlerësonte maksimalisht, ishin plot me fjalë turke.

Për këtë arsye ai u përpoq që të zëvendësojë një pjesë të mirë të tyre. Kjo praktikë u ndoq më pas edhe nga Sami Frashëri dhe Jani Vreto. Madje ky i fundit e ve në dukje që në titull këtë fakt (Erveheja: vjershëruar prej Muhamet Çamit, mbaruarë prej Hajdar Argjirokastriti edhe qëruarë fjalët' e huaja prej J. Vretosë).

Megjithatë ky nuk ishte tensioni i vetëm që ekzistonte ndërmjet kësaj letërsie dhe kohës së nacionalizmit. Tensioni i dytë do të artikulohet nga Sami Frashëri në sprovën që ai ndërmerr për botimin e Divanit shqip të Nezim Beratit. S. Frashëri, më 1882, 25 fragmente poezish nga Divani shqip i Nezim Beratit i përgatit për botim së bashku me 12 këngë popullore, nën titullin *Mbledhje këngëve shqip të vjetëra dhe të ra*.

Edhe Zef Jubani në antologjinë e tij, letërsinë reflektive e kish botuar së bashku me folklorin. Në këtë periudhë të afirmimit të kombit, e kaluara letrare e shqiptarëve vlerësohej e plotë, d.m.th. letërsi e kultivuar dhe folklor.

Kjo përtej faktit që letërsia shqipe sikurse e cilëson Z. Jubani ishte në fazën “e fëmijërisë,” lidhej me rëndësinë që kish fituar folklori në këtë etapë të ndërtimit identitar. Folklori është ruajtësi i karakterit kombëtar dhe për shqiptarët edhe tabani i përbashkët për të gjithë komunitetet fetare.

Duke qenë i tillë, ai është edhe trualli që ushqen letërsinë e kultivuar kombëtare. Nga ana tjetër, botimi i letërsisë së kultivuar bashkë me letërsinë popullore, do të kthehet në një traditë në tekstet e më pasme antologjike të letërsisë shqipe.

Mirëpo S. Frashëri, ndryshe nga Z. Jubani që këto dy krijimtari i ka dhënë të integruara sipas kronologjisë historike të shkrimit, i diferencon qartë grafikisht. Ai e ndërton punimin me dy pjesë që pasojnë njëra-tjetrën, por edhe e shoqëron këtë ndarje me cilësimet respektive, i vjetër dhe i ri.

Kështu, S. Frashëri është mendimtari i parë shqiptar që ka përdorur termat i ri dhe i vjetër në gjykimin e një veprë letrare. Prandaj është me interes për të kuptuar përmbajtjen e këtyre dy termave dhe më konkretisht vijën ndarëse që përcaktonte një vepër të re dhe të vjetër.

Në vlerësimin thjeshtë historik, krijimtaria e Nezim Beratit është shkruar në gjysmën e parë të shek. XVIII. Ndërsa për sa i përket këngëve popullore, vetëm tri prej tyre mund të datohen, për shkak se bëjnë fjalë për ngjarje konkrete historike (Lufta greko osmane 1821; kryengritja kundër reformave të Tanzimatit 1847 dhe lufta ruse-osmane 1877). Kurse të tjerat i këndojnë ngjarjeve universale (lindja, dashuria), apo besimit në Zot dhe është i pamundur datimi i tyre.

Për më tepër që kjo pjesë nuk fillon me këngët historike, por me këngët lidhur me besimin Islamit. Kështu duke ju referuar krijimtarisë së N. Beratit, është e vështirë, madje e pamundur që të përcaktohet në se këngët popullore janë krijuar para kohës kur ka jetuar poeti, apo pas tij.

Kështu që S. Frashëri, cilësimet i vjetër dhe i ri për këto krijime, më shumë se për një referencë kohore i ka përdorur për të treguar qëndrimin me vetë kohën. Krijimtaria e N. Beratit qëndron përpara folklorit jo sepse është krijuar para këngëve popullore, por sepse i përket një kohe tjetër.

Në të vërtetë, i ri dhe i vjetër janë dy terma që në këtë periudhë kanë fituar përmbajtje sociale dhe kulturore të caktuar, në Perandorinë Osmane, pjesë e së cilës ishin dhe territoret shqiptare. Hapja e letërsisë turko-osmane ndaj perëndimit në gjysmën e dytë të shek. XIX, solli në rend të ditës ballafaqimin dhe përplasjen ndërmjet letërsisë klasike të divanit dhe letërsisë realiste.

E para e vlerësuar si letërsi e vjetër dhe e dyta si letërsi e re. Për S. Frashërin, aktiv në këto debate, vija ndarëse ndërmjet letërsisë së vjetër dhe të re, përcaktohet nga modeli dhe natyra e letërsisë; e para letërsi për kënaqësi estetike kryesisht të elitave, sipas modelit lindor, kurse e dyta funksionale sipas modelit të letërsisë realiste perëndimore. Edhe në vlerësimin e letërsisë shqipe S. Frashëri ka mbartur gjykimin e letërsisë në funksion të ideologjive të kohës.

Në zërin shqiptarët, në enciklopedinë e tij *Kamus-ul-alam*, lidhur me letërsinë tek shqiptarët ai shkruan se shqiptarët myslimanë, ortodoksë dhe katolikë kanë patur letërsitë e tyre. Por këto nuk mund të zënë vendin e letërsisë kombëtare të shqiptarëve, për shkak se myslimanët i kanë shkruar me alfabet arab, ortodoksët me

alfabet grek e katolikët me alfabet latin, për shkak se veprat i kanë mbushur me fjalë e shprehje të huaja dhe për shkak se janë sipas modeleve të letërsisë së popujve të tjerë. S. Frashëri historinë e letërsisë e parashtron në funksion të kohës së re që po jetonin shqiptarët në dekadat e fundit të shek. XIX.

Dhe letërsia e shekujve të mëparshëm ballafaqohet me letërsinë kombëtare. Kështu që e gjithë letërsia e krijuar tek shqiptarët, sipas tij, klasifikohet në dy grupime të mëdha, kombëtare dhe jo kombëtare (para kombëtare).

Pavarësisht se për këto grupime ai nuk përdor termat i ri dhe i vjetër, marrëdhënia që ato vendosin me kohën është në funksion të raportit që ato kanë me ideologjinë nacionaliste. Në këtë kuadër, koha e letërsisë parakombëtare ka kaluar, edhe në se në këtë rast nuk është cilësuar e vjetër, i gjithë përshkrimi është në funksion të këtij vlerësimi. Madje edhe karakteristikat dalluese të saj janë dhënë mbështetur në këtë qasje.

Sipas tij, karakteristikë e letërsisë parakombëtare është krijimi sipas modelit të letërsisë së popujve të tjerë, përdorimi i shqipes me fjalë të huaja, shkrimi me alfabetë të ndryshme (arab, grek dhe latin) dhe leximi i këtyre veprave vetëm nga shqiptarët e një konfesionit të caktuar. Me këtë qasje ndaj të kaluarës letrare, Sami Frashëri është i pari që proceset letrare parakombëtare tek shqiptarët i sheh të lidhura me qarqet kulturore fetare.

Edhe në antologjinë e tij Mbledhje këngëve shqip të vjetra dhe të ra S. Frashëri në mënyrë shumë koncize ka dhënë këtë qasje që ai ka ndaj letërsisë. Forma që ka përdorur për të ndërtuar antologjinë, dhe cilësimet përkatëse në titull për secilën pjesë, të shpien drejt një ballafaqimi ndërmjet tyre.

Nga ana tjetër ky ballafaqim, përcakton jo vetëm pozicionin e letërsisë klasike, si letërsi të vjetër, por parashikon edhe një prognozë të mirëmenduar të përdorimit të saj: "...Koha e tyre ka kaluar. Ato duhet t'i lexojmë vetëm për të mësuar historinë e letërsisë sonë dhe etapat nëpër të cilat ka kaluar gjuha jonë. Le të përpiqemi që t'i ruajmë mirë si veprat e vjetra më të vyera të historisë së letërsisë. Le t'i respektojmë, le t'i nderojmë, le t'i japim vlerat sipas shkallës së tyre, por nuk mund të jenë modele për t'u marrë shembull." do të shprehet S. Frashëri në një shkrim të tijin mbi letërsinë.

Në konfigurimin e ri kulturor që shqiptarët po kalonin në gjysmën e dytë të shekullit XIX, ishte e pashmangshme ballafaqimi i dy kohërave, kombëtare dhe parakombëtare. Botimi i trashëgimisë letrare nga nationalistët shqiptarë duhet parë edhe si një përpjekje për të zbutur pikërisht këtë hendek apo tension që ekzistonte ndërmjet këtyre dy epoka.

Madje edhe politika botuese që ndoqën, modernizimi i shqipes dhe zëvendësimi i fjalëve me origjinë turke, që herë shkonin deri në tjetërsimin e koncepteve fetare e kulturore si në rastin tipik të Ervehesë, botuar nga Jani Vretos, ishin pikërisht në funksion të kësaj përshtatjeje.

Përveç kësaj, qasja ndaj trashëgimisë letrare në periudhën nacionaliste, duhet vlerësuar edhe si faza embrionale e studimit të letërsisë shqipe. Nga ana tjetër trashëgimia letrare, në këtë kohë është parë e lidhur ngushtë me procesin e kombformimit.

Ajo shërbeu për të treguar se çfarë kishin qenë të zotët të krijonin shqiptarët, por edhe për të inkurajuar krijimin e identitetit modern kombëtar.

Për këtë arsye dhe Naim Frashëri poetët e ashtuquajtur bejtexhinj i quan “vjershëtorë të Shqipërisë,” duke theksuar se ata ishin pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shqiptarëve.

*SKIFTER KËLLIÇ***NJË LEXIM NDRYSHE I “LAHUTËS SË MALCIS”**

Në këto shënime nuk i kam vënë qëllim vetes të vë në dukje vlerat e kësaj vepre që është dhe do të mbetet nga krijimet më të arrira të letërsisë shqiptare të të gjithë kohëve dhe që janë nxjerrë në pah që më 1991, kur Fishta, për arsye që dihen, u ringjall, pasi ishte varrosur prej vitit 1945 nga diktatura komuniste.

Tashmë që Fishta botohet në Shqipëri, Kosovë, studiohet nëpër shkolla dhe universitete, njihet edhe nga shqiptarët jashtë atdheut, dalin sërishmi në pah vlerat krijimtarisë së tij, veçanërisht të “Lahutës...” në të cilën ka faqe që na sjellin ndërmend fragmente të “Iliadës” së Homerit.

Për shembull në këngën e 22-të të kësaj vepre, ku përshkruhet dyluftimi i Hektorit me Akilin, ndeshim këto vargje:

“Kshtu tha e vrik të mprehtë e nxuer taganin,
 Qi të madh për mnerë deri n’teposhtë i varej,
 E tue u përkulë me hov iu turr si shqipja,
 Qi s’eprash maje fluturon drejt sheshit,
 Prej reve t’errëta kur bvertitet me rrëmbye
 Ndo’ ikingj kulloshtre, ja frigacin lepur,
 Kshtu msyn Hektori kah vringllon taganin,
 Njiheri turret porsi rfe edhe Akili...”

Te denja për këto vargje homerike janë dhe vargjet fishtjane, të shkëputura nga Këanga e Njezët “Lekët’ e “Lahutës...(faqe 275):

“Si ‘i larosh qi hek’rash pështue,
 kërlesh qymen e shpinës për mnerë,
 zhgjetë t’u lëshohet qejve tjerë,
 me ta haju edhe përlaju,
 dboju shtekut dhe hendekut,
 tue hungruem e cingruem,
 hikin qejtë n’p’r proska e lamë,
 shtangue bishtin hell ndër kambë,
 njikshtu shkjetë n’p’r atë log mejdanit,
 hikin podit derdhen planit,
 para ushtimës së Rushman Hasanit...”

Por në këto shënime, duke bërë edhe vlerësime, do të ndalem kryesisht në vërejtje të karakterit gjuhësor dhe artistik që për mendimin tim hasen te “Lahuta...”.... (mbaron shitesa..)

...disa prej të cilave deri tani janë vënë në dukje kryesisht pr. dr. Shefkije Islamaj në librin e saj dyvëllimësh, me titull “ Gjergj Fishta, gjuha dhe stili”, kushtuar veprës, botuar nga Instituti Albanologjik në Prishtinë, më 2012.

Ndër të tjera, në studimin e saj ajo vë në dukje se Fishta nuk ka arritur t’i shpëtojë prolisitetit, teprisë së përshkrimeve, teprisë së fjalëve, përsëritjeve të panevojshme si dhe gabimeve drejtshkrimore...veprim ky i pamotivuar, i paarsyetuar, për shkak të aplikimit të rregullave të metrikës, kur është fjala për veprat në vargje. (Vëllimi i dytë i veprës së mësipërme, faqe 104).).

DISA VËREJTJE GJUHËSORE

Dihet se Fishta ka përdorur në veprat e veta, veçanërisht te “Lahuta e malcis”, gegërishten veri-perendimore, ose me saktë, të lagjeve katolike të Shkodrës dhe të rrethinave të saj, (gjithnjë katolike). Dhe kjo e folme dallohet nga e folmja e lagjeve myslimane të këtij qyteti dhe rrethinave të të njejtit besim fetar, kryesisht nga shqiptimi i bashkëtinglloreve gj, q, dh, të cilat shndërrohen përkatësisht në xh, ç dhe ll.

Pra, qeni-çeni, gjaku- xhaku, ndodhi- ndolli.

Por ka raste kur bashkëtingëllorja q kthehet në gj, (qytet- gjytet), dhe bashkëtingëllorja ll në dh, (llampa-dhampa). Por, siç dihet, ndodh dhe që bashkëtingëllorja q të kthehet në k, si qime, kime, qaj-kjaj.

Këto dukuri vihen re rëndom kryesish te “Lahuta...,” ku madje prapashtesa -si (mal-malsi), kthehet në trajtën nëndialektore –ci; mal- malci. Ndaj dhe veprën e titullon “Lahuta e malcis” dhe jo të paktën “Lahuta e malsis”.

Kështu ndodh edhe në titullin e veprës tjetër “Shqiptari i gjytenuem”, për “Shqiptari i qytetnuem” dhe “Pika voeset” për “Pika vese”, pra, në këtë rast, përdorimi i trajtës nëndialektore në rasën rrjedhore të emrit në të dyja gjinitë.

Dukuritë e mësipërme nuk përbëjnë ndonjë lajthitje, por janë përdorime të ndërgjegjshme dhe këmbëngulëse të Fishtës, sepse, siç dihet, ai ka dashur që e folmja e përdorur prej tij, të ishte bazë e gjuhës letrare shqipe dhe jo elbasanishtja që miratoi Komisia Letrare me 1916, të cilën ai e ka parodizuar me vargjet e një bejtjeje, ku e quan atë “gjuhë mushke me gjithë veshë dhe bisht”, ose “që turçe nuk asht, po ashtu po i thonë, por që s’asht, qe besa, as gjuhë shqiptare”, (!?).

Për më tepër, edhe në botimin përfundimtar të “Lahutës..”, më 1937 Fishta i mbeti besnik i idesë që nëndialekti i tij të ishte bazë e gjuhës letrare shqipe, me të cilën kishte shkruar këngët e para të saj, që më 1905 dhe nuk bëri as edhe një ndërhyrje për ta afruar me gegërishten jo më të Elbasanit, por as edhe të Shkodrës, të paktën në këtë vepër.

Po sjell disa shembuj të kësaj vepre, të botuar nga Salih Kabashi, (Ljubjanë, 1990), së cilës do t’i referohem vazhdimisht në këto shënime:

“...thue se t’parit qi do t’veka,
petku cohet do t’iu preka,
e jo ma se po i pret deka”.
 (“Preja”, faqe 30).

Nga sa del, folja në mënyrën habitore “veka”, ndoshta një trajtë nëndialektore, për hir të rimimit me foljen e vargut të dytë “..preka”, zë vendin e foljes “vika”.

Më poshtë Fishta shkruan:

“O zotnitë e Shqiptarisë...”

Është e vërtetë që në ” Fjalorin e gjuhës shqipe”, me fjalën “shqiptari” kuptohet “tërësia e shqiptarëve, populli shqiptar...”, por, më saktë do të ishte të përdorej fjala ” ... e Shqipnisë”, sepse me fjalën “shqiptari” kuptohet edhe “ndjenja kombëtare shqiptare, ndërgjegjja kombëtare e popullit shqiptar...”, siç shkruan dhe Vaso Pasha se “Feja e shqiptarit asht shqiptaria”.

Pastaj Fishta vazhdon:

“Mos lakmoni pares s’huej”, kur duhej të shkruante :

“Mos lakmoni paren e huej”, sepse pas foljes kalimtare “lakmoj”, (në këtë rast “lakmoni”), emri duhet të jetë në rasën kallëzore dhe jo dhanore. Dhe ky gabim përsëritet në poemë edhe në raste të tjera. Është përdorim nëndialektor që, me sa di, haset kryesisht në të folmen e Shkodrës.

Po të ishte vënë para foljes “lakmoni” trajta e shkurtër “i” e përemrit “ata”, “ato”, në rasën dhanore, kjo frazë do të ishte e saktë vetëm nga ana morfologjike, pra: ” Mos i lakmoni pares s’huej”, por do të ishte jashtë natyrës së gjuhës letrare.

Më poshtë pasojnë vargje me karakter didaktik dhe pa vlera artistike që i hasim edhe në raste të tjera në këtë poemë.:

Kinje n’ mend: për ju detyra,
s’asht me mjelë veç dele t’hueja,
s’asht me m’kambë veç gjuhët e hueja,
por me atë Fe qi kam prej qiellit,
me t’bardhën dritë t’Ungjillit,
brendë dashtëninë m’ua ndezë shqiptarëve, për kah gjuha e vendi i t’parëve”,
(“Vranina”, faqe 45)

Kështu del se poeti paska “me ua ndezë dashtëninë”, ose me saktë ” dashtuninë”, ose edhe më saktë ”dashuninë”....

Është për të ardhur keq që në poeme ka plot e plot vargje të tilla, që përmbledhen me fjalë “proloksitet”, “tepri”, të cilat po të mënjanoheshin, do ta bënë veprën më të rrjedhshme dhe me nivel më të lartë artistik.

Në fund të faqes 45 Fishta vazhdon:

“...qi shqiptarët t’shërbejne njaj mbretit,

qi për mbret e troje t'veta,
mos t'u dhimbet gja as jeta,
por të desim si Oso Kuka,
qi asht tue dekë, ehu, n'ato suka!”.

Duhet:

“..qi shqiptarët t'i shërbejnë atij mbretit” ose thjesht:”...t'i shërbejnë mbretit”, sepse mbiemri dëftor “njatij”, për “atij” në këtë rast është i tepërt.

Fishta gabon gjithashtu kur përemrin ose mbiemrin dëftor “ai” e zëvendëson me trajtat nëndialektore “njaj” dhe “qaj”.

SHQIPTARËT T'I SHËRBEJNË NJAJ MBRETIT? ...

Në vargjet e mësipërme Fishta dy herë nënvizon fjalën “mbret”. Kuptohet se me të ai nënkupton sulltanin e Turqisë. Pra, shqiptarët t'i shërbejnë sulltanit dhe madje për të mos i dhimbset as jeta, ashtu si Oso Kukës...

Në zërin “Oso Kuka”, të përfshirë në FESH, botim i dytë, midis të tjerash, shkruhet:”Atdhetar nga Shkodra, komandant i një njësie, që dha jetën për mbrojtjen e trojeve nga shovinistët malazeze”, (faqe 1396, vëllimi i dytë, 2008). Pra, nuk theksohet shprehja që ai dha jetën edhe ” për mbret”, me një fjalë për sulltanin, paraardhësit e të cilit prej shekujsh kishin pushtuar Shqipërinë dhe të cilën ai e mbante me dhunë nën sundimin e tij mizor.

Mendoj se edhe Fishta kishte mundësi të mënjanonte shprehjen “për mbret”, të cilën e ka nënvizuar edhe në fund të faqes 44, kur shkruan:

”Mallkue kjoftë njaj n'Shqipni,
...qi për mbret e për liri,
s'çohet sot me armë mizore...”.
 (“Vranina”, faqe 44)

Po ashtu dhe në Kangën e Dytë “, Oso Kuka”, ai mund të mënjanonte dhe takimin e këtij heroi me Avdi pashën, sundimtarin turk të Shkodrës, të cilit i kërkon 40 trima dhe me ta nisët për në Vraninë, për t'u përballur me trupa malazeze që kërkonin të pushtonin toka shqiptare, por që ishin prej shekujsh të pushtuara nga Turqia.

Po kështu Fishta kishte mundësi që në Kangën e 6-te, “Dervish Pasha”, të mënjanonte takimin e shtegtarit shqiptar me Abdyl Hamitin, të cilin përsëri e quan “mbret” dhe jo “sulltan”, aq më tepër që ky shtegtar shkon në Stamboll që t'i lutet sulltanit, pra, atij që vazhdonte ta mbante Shqipërinë nën zgjedhë, që të dërgonte forca, për të zmrapsur malazetët, të cilët kërkonin të pushtonin toka shqiptare. Pra, ky shtegtar, që përfaqëson Shqipërinë, i kërkon ndihmë.... pushtuesit, për të zmrapsur pushtuesit e rinj.(!?).

Është e vërtetë që më pas Fishta thekson se Dervish pasha i ngarkuar nga mbreti, pra sulltani, u nis me 50 tabore që të zmrapste forcat malazezeve, jo për

t'i mbrojtur shqiptarët, por për t'i mbajtur si gjithnjë nën zgjedhen turke, por ky fakt historik nuk i shton poemës as vlera artistike dhe as ideore.

Fishta mund të mos e përfshinte takimin e shtegtarit me sulltanin të “Lahuta...”, për më tepër sepse ai është krijim tërësisht letrar, sidoqë me motive epike dhe historike.

Besoje se nuk do tingëllonte mirë një vepër letrare, ku të ngrihej lart akti heroik deri në vetëmohim i një shqiptari, i cili në vitet 40-të të shekullit të kaluar, duke qene si plot shqiptarë të tjerë ushtarak i rreshtuar në njësitë e ushtrisë italiane, që komandohej nga vetë Musolini, të kryente aktin heroik të Oso Kukës, p.sh. në luftë me forca ushtarake malazeze, të cilat cenonin kufijtë e Shqipërisë, këtë radhë të pushtuar nga Italia fashiste. Aq më keq, po të mburrej se jepte jetën “për mbretin, (italian) dhe për liri”, siç shkruan Fishta të “Lahuta...”.

Përkundrazi, dihet se shumica e ushtarëve shqiptarë që bënë pjesë në repartet e ushtrisë fashiste italiane, të cilat më 1940 u dërguan në front gjatë Luftës Italo-Greke, jo vetëm nuk luftuan kundër grekëve, por edhe dezertuan.

Me këto argumente nuk kërkoj kurrsesi që të nënçmoj aktin atdhetar të Oso Kukës, por e përsëris, kam mendimin se Fishta, mund të kishte hequr nga “Lahuta...” takimin e Osos me Avdi pashën dhe fjalët se ai lufton edhe “për mbret”.

Duket se vargje të tilla përbëjnë thjesht shkarje rastësore, sepse e tërë poema përshkohet nga urrejtja e thellë ndaj pushtuesve osmanë dhe shovinistëve malazezë, të mbiquajtur me përbuzje “shkje”, që dëshmohet edhe në vargjet e mëposhtme:

Kam shkue jetën si bisha,
Zbathë e zhveshë edhe pa ngranë,
Poe as mbretit, por as krajlit,
Tungjatjeta nuk i kam thanë.
 (“Lidhja e Prizrenit”, faqe 110)

LUFTËRAT KUNDËR SHOVINISTËVE MALAZËZË DHE PUSHTUESVE TURQ

Në analizën sado të përciptë që i bëjnë kësaj poeme, autorët e tekstit të “Historisë së letërsisë shqiptare”, të botuar gjatë më 1958, pra gjatë periudhës komuniste, ndër të tjera kanë vënë në dukje se vepra kryesore e Fishtës, poema “Lahuta e Malcis”, duke sulmuar shovinizmin e fqinjëve të Veriut, propogandonte antisllavizmin dhe vinte në plan të dytë luftën kundër pushtuesit otoman.

Më saktë, duhej thënë luftërat kundër synimeve grabitqare të shkjavave malazezë zënë më shumë vend se luftërat kundër pushtuesve osmanë, të cilët ishin dhe mbeteshin armiqtë kryesorë të Shqipërië. Madje, edhe në vitet 1858-1913, periudhë gjatë së cilës zhvillohen ngjarjet e poemës, siç e vë në dukje dhe vetë poeti që në vargjet e para të Kangës së Parë, (Pesëqind vjet kishin kalue/çësë të buk'rën këtë Shqipni./Turku e mbante në robni), ishin pikërisht pushtuesit

otomane, të cilët vazhdonin ta mbanin shtrirë sundimin e tyre, që nga viset më të epërme veri-perendimore dhe veri-lindore të krahinave shqiptare, duke përfshirë Kosovën dhe Dibrën, deri në Shqipërinë e Jugut, në Çamëri.

Dhe pikërisht në vitin 1858 kur fillojnë edhe ngjarjet e poemës, malazezët nisën sulme të vazhdueshme për të rrëmbyer sa më shumë toka shqiptare.

Fishta këtyre synimeve grabitqare për pushtimin e viseve të veriut të vendit, bashkë me Shkodrën, deri në lumin Drin, me të drejtë u kushton në këngët e para; por, duhet të vijmë në Kangën 6-të, që përmenda pak më sipër, për të vazhduar deri në Kangën e 10-të, “Mehmet Ali Pasha”, që ai të theksojë se në njëjtën kohë, synimet e perandorisë turke ishin që t’i zbrapste ushtritë malazeze, jo për t’i lënë shqiptarët të lirë, por për t’i mbajtur gjithnjë nën thundrën e saj

Prandaj poeti paralajmëron në mënyrë figurative Shqipërinë:

Por a njimend thue se Dervishi,
këtë ushtri nën armë e grishi,
Për me ardhë me t’ dal zot ty,
Edhe hek’rat me t’ shpërthye....
Jo, mo’ e shkretë! Dervishi s’lot,
Për me të dalë ty zot,
por ai vjen përse Stambolla,
s’do’ qi t’ hijë n’ Shkodër Nikolla,
pse do’ vetë edhe mbas sotit,
me të mbajtë rob ajo si motit...
("Dervish Pasha", faqe 67)

Mirëpo këto vargje bien kryekëput në kundërshtim me vargjet që janë renditur në dy faqet e mëparshme të kësaj kënge, ku një shtegtar që ka udhëtuar nga Shqipëria në Stamboll, (personazh i krijuar nga poeti), i thotë me qesëndi sulltanit, të cilin Fishta vazhdon çuditërisht ta quajë mbret (!!):

...për jetë tande, lala Mbret,
a ti mbahe mbret n’ Shqipni,
apo mbret asht krajl Nikolla,
qi i ka mbledhë cubat n’ Cetinë
e u ka pri ktej kah Shqipnia...
(“Dervish pasha”, faqe 65)

Mendoj se bashkëbisedimi i shtegtarit me sulltanin, nuk duhej të kishte vend në poemë, sepse nuk është aspak e natyrshme që ky personazh, që përfaqëson Shqipërinë, pasi i lutet sulltanit, pushtetin e të cilit e mban prej qindra vjetësh, tashmë e urdhëron me fjalët:

Për jetë tande, lala mbret,
A hiq dorë ti prej Shqipniet,
Ase ndryshe çoe një ushtri,

që t'i bjerë Malit të Zi,
pse gjallë kështu ma nuk u rrucka. (!?)

E pakuptueshme, sepse kështu, gjithë shpresat e shpëtimit nuk u gjetkan në forcat e vetë malësorëve, pra dhe të të gjithë shqiptarëve, por në dëshirën e sulltanit.

Në Kangën e 9-të të poemës, të titulluar “Lidhja e Prizrenit”, duhej të vihej në dukje se Turqia nuk i falte Malit të Zi me dëshirë toka shqiptare, por detyrohej ta bënte këtë pas vendimeve të Kongresit të Berlinit, më 1878, si humbëse në Luftën Ruso-Turke. Ky fakt mund të qartësohej edhe në Kangën e 8-të, pra në këngën e mëparshme.

Por, çuditërisht, duhet të presim Kangën e 27-të, ”Xhymyjeti”, dhe tri këngët e fundit të “Lahutës...”, pra ngjarjet e vitit 1908 dhe më të mëvonshme të cilat mbyllin poemën, që Fishta t'u kthehet kryengritjeve të shqiptarëve të krahinave të veriut kundër sundimit turk. Por për këtë çështje do të ndalem sërishmi në një një nënkapitull nga fundi këtyre shënimeve.

LIDHJA E PRIZRENIT DHE ”LAHUTA...”

Deri në Kangën e 8-të, siç dihet, ngjarjet e poemës përqendrohen kryesisht në Malësinë e Veriut. Dhe ja, në Kangën e 9-të para nesh me vargun e tij plot patos dhe dinamizëm Fishta zbulon një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë të shekullit të 19-të, Lidhje e Prizrenit, (1878-1881).

Nuk do të ndalem te paralelet e gjetura dhe të e goditura të poetit tonë të madh që krahason personazhet historike të Lidhjes me personazhe mitologjike ose periudhës së lashtë greko-romake, homerikë, dhe na shpjen : ” ...kah Urali,/ n'pr ato breshta ta larta,/ siellej shkja, si shkërbe mali,/ tue kërkue për molla t' tharta,/ kur n'kta vise të Ballkanit,/ të parët tanë, pellazgët e motit,/ gjanë e gjallë kullotshin n'fushë t'Zotit”, (faqe 105). Do të citoj vetëm disa nga personazhet që poeti në bisedë me Zanën na i paraqet në kuvendin që zhvillohet në Prizren. Të tillë janë, siç i radhit autori, janë Ali pasha, (është fjala për Ali pashë Gucinë), që rrinte “n' krye të vendit”, Marash Vata, bajraktari i Shkrelit, Frashër Begu, pra, Abdyl bej Frashëri, që në këtë këngë duhej cituar kështu, sepse nuk njihet me epitetin e mësipërm, i vënë nga Fishta për hir të rimës: “...Frashër Begu./...ku e qiti shtegu”. Pastaj autori na njeh me Preng Dodë Bibën, kapiten i Mirditës, pranë të cilit ndodhet Zogolli, Gjetë Gjekkë Shllaku, edhe Begolli, Cun Mula, Mar Lula “njëni Hot e c tjetri Shalë”, siç nënvizon ai, ”...Dodë Preçi prej Kastratit, /me atë Vrionin e Beratit”.

Pastaj renditen dhe emra krerësh bajraktarë, ku del në pah Abdullah pashë Dreni, “...: njaj pa të cilin s'hecë kuvendi,/e ia dro t'keqen Prizreni,/dro Prizreni, dro Gjakova,/rreth e çark ia dro Kosova”, (faqe 104).

Është e drejta e autorit që figurat e atdhetarëve që citohen më sipër, t'i trajtojë si personazhe të Lidhjes së Prizrenit, ndonëse, duhet thënë se ata, me përjashtim të Abdyl Frashërit, që nuk kuptohet se përse Fishta e mbiquan edhe Dulë, si dhe Abdullah Drenin, për të cilin do të flitet gjerësisht më poshtë, në këtë këngë jo

vetëm nuk njihen si personazhe të rëndësishme historike, por mbetën vetëm emra. Pra nuk zhvillohen artistikisht. Dhe kjo dukuri, siç do të shohim më poshtë, do të vihet re dhe në këngë të tjera.

Dhe në qoftë se Fishta, duke renditur emrat e mësipërm të bajraktarëve malësorë, ka dashur t'i qëndrojë besnik historisë, atëherë ai duhej të shtonte dhe emrat e atyre atdhetarëve që për më tepër u zgjodhën në këshillin e përgjithshëm të Lidhjes së Prizrenit, si Iliaz pashë Dibra, dhe , veç Abdyl Frashërit, anëtarë të tjerë të tij, Ymer dhe Shaban Prizreni, dhe mbi të gjithë Sulejman Vokshi, nga Gjakova, “ ...një nga nismëtarët e themelimit të Lidhjes dhe ndër udhëheqësit kryesorë politikë”, i cili: ”Qëndroi në ballë të luftës për mbrojtjen e tërësisë së trojeve shqiptare dhe të luftës për realizimin me forcën e armëve të autonomisë së tyre”.(FESH vëllimi 2, 2009, faqe 1514).

Nuk kuptohet gjithashtu se cilët janë për shembull, Zogolli, Begolli, Vrioni...Dhe kjo, sepse ata, si dhe krerët e tjerë që përmenden më sipër, ashtu si dhe trimat malësorë, me të cilët do të njihemi gjatë përshkrimit të betejave të tyre kundër shkjavë malazezë, me përjashtime të rralla, si Mar Lula, i pari i Shalës, për fat të keq mbeten të patipizuar. Kjo edhe sepse poeti e ka pasur vështirë ta bëjë këtë brenda faqeve të kësaj kënge.

Megjithatë, shprehje të tilla që Mar Lula nxjerr plot duf nga shpirti dhe zemra në kuvendin e mbledhur në Prizren kundër vrasësve grabitqarë sllavë si:

...M'ka mbytë ai tatë e nanë,
 e shnjerezue m'ka grue e motër,
 e s'm'ka lanë me u rritë djalë në votër,
 ...m'ka marrë arën e punueme,
 m'ka marrë tokën e trashgueme,
 e tue m'ba kanun paçavër.
 m'ka marrë qetë, po, për nën lavër,
 ...m'ka marrë dhen e m'ka marrë dhiz,
 m'ka marrë vathë m'ka marrë mriz.
 (faqe 111-112 ...

të nguliten në mendje dhe bashkë me to edhe vetë ky personazh.

Por pas pasqyrimit të kësaj ngjarjeje, Fishta duhej të kishte vazhduar me episode brenda saj, ose edhe në ndonjë këngë tjetër edhe veprimtarinë e mëtejshme të Lidhjes së Prizrenit, që vazhdoi deri në vitin 1881, pra për tre vjet. Duhej të dilte më në pah se betejat e përgjakshme që përshkruhen në këngët e mëpastajme, sidomos te Kanga “Te Ura e Rrzhanices”, “Në qafë Hardhi”, ”Te Ura e Sutjeskës”, ishin veprimtari të organizuara nga udhëheqësit e kësaj lidhjeje, ashtu siç dëshmohet qartë dhe në dokumentet historike, ku,veç të tjerash, pasqyrohet edhe rezistenca e vendosur e kryengritësve shqiptarë, për të mos lëshuar pa luftë Plavën, Gucinë dhe troje të tjera, të cilat sipas vendimeve të Kongresit famëkeq të Berlinit i merreshin Turqisë, për t’iu dhënë Malit të Zi.

”Kur ushtritë malazeze erdhën pasdite, (është fjala për pasditen e 17 prillit të vitit 1880, SK), për të marrë në dorëzim Hotin dhe Grudën, u ndeshën me repartet e Lidhjes Shqiptare që kishin zënë prita te Ura e Rrzhanicës”. (FESH, vëllimi 2, 2008,faqe 1514).

Kjo do të sillte një zhvillim më të harmonishëm të Kangës së 9-të ”Lidhja e Prizrenit, me këngët që citova pak më sipër. Në këtë mënyrë Fishta do të pasqyroste bashkëpunimin e forcave të Lidhjes së Prizrenit me kryengritësit e Malësisë duke shmangur në një farë mënyre karakterin e saj fragmentar.

“LAHUTA...” DHE KOSOVA

Nuk duhet harruar se gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të, krahas kryengritjes kundërosmane që shpërtheu në Mirditë, (1876-77), e cila kërkonte autonomi nga Porta e Lartë, me shumë rëndësi ishte kryengritja kundërosmane e vitit 1893 në Kosovë, e drejtuar nga Bajram Curri dhe Haxhi Zeka dhe kryengritja e vitit 1910, që përfshiu rrethet e Pejës, Gjakovës dhe të Dibrës, e udhëhequr nga luftëtari tjetër i madh kosovar, Isa Boletini. Gjithashtu, duhet të theksojmë edhe se një vit më pas shpërtheu dhe një tjetër kryengritje kundërosmane, përsëri e udhëhequr nga Isa Boletini, e cila mori përpjesëtime të mëdha po në Kosovë. Porta e Lartë arriti ta shtypte këtë kryengritje edhe falë ndërhyrjes së Rusisë dhe Serbisë.

Kam mendim se Fishta në poemën e tij mund të kishte gjetur hapësirë që të paktën në Kangën e 28-të, “Dedë Gjo’ Luli”, të përfshinte edhe episode të këtyre kryengritjeve, aq më tepër që zhvilloheshin në krahina të Kosovës dhe kështu që krahas tij të përjetësonte te “Lahuta...” edhe figura të tilla të mëdha historike, si Isa Boletini dhe Bajram Curri, figura përjetësisht kaq të shtrenjta të Kosovës dhe Shqipërisë.

Ja sepse Fan Noli më 1925 pas vrasjes së këtij të fundit, ashtu si Gurakuqit, i kushtonte një elegji, nga e cila po përmendim vargjet:

O Bajram, bajrak i gjallë,
More namë me gjak në ballë,
Te një shpellë e Dragobisë,
Yll i rallë i trimërisë.

Mbi të gjitha, Fishta duhej të vinte në dukje edhe mizoritë e ushtrive serbe që qysh atëherë kryen ndaj popullsisë së pambrojtur kosovare. Dhe kishte mundësi, sepse pas këngës së mësipërme, pra së 9-tës, ”Lidhja e Prizrenit”, së cilës i paraprin Kënga e 7-të, “Kuvendi i Berlinit”, vijnë në Këngën e Dhjetë, “Mehmet Ali Pasha”, me ngjarje që zhvillohen në Prizren dhe Gjakovë dhe me personazhe historike kosovare, si Abdulla Dreni dhe Haxhi Zeka.

Siç dihet, në këtë këngë përshkruhet takimi i këtij pashai turk në shtëpinë e Abdulla Drenit në Gjakovë, me krerë shqiptarë, ku ai u kumton atyre se sulltani ka vendosur t’i lëshojë Malit të Zi Plavën dhe Gucinë. Krerët revoltohen dhe kështu Mehmet pasha vendos t’i burgosë. Shqiptarët kur mësojnë këtë mënxyrë, i kërkojnë Abdulla Drenit që t’u dorëzojë pashën turk. Por ai, sipas zakonit, nuk mund ta bëjë këtë, sepse e ka atë mik, kurse shqiptarët që kanë rrethuar shtëpinë e tij, e quajnë të dërguarin e sulltanit armik, dhe si pasojë shtëpia merret me sulm.

Mbeten kështu të vrarë Mehmet pasha, Abdulla Dreni dhe shqiptarë që luftonin për ta shtënë atë të gjallë në dorë.

Në vargjet e mëposhtme Fishta shpreh dhembje që shqiptarët vriten midis tyre për shkak të turqve:

Prandej keq a' e si a' ma zi,
Kështu shqiptarët sot me u përzi,
E me u gri këta ndërmjet veti,
për një pashë që çueka Mbreti...
("Mehmet Ali Pasha", faqe126)

Por përse kjo ngjarje duhej të zinte vend në poemë? #farë vlerash i shton asaj? Përse Kosova t'u paraqitet lexuesve me këtë mënyrë? Aq më shumë, kur errësohet figura e një atdhetari aq të njohur nga Gjakova që "... u shqua si kundërshtar i rreptë i synimeve pushtuese serbe ndaj Kosovës dhe i politikës ruse, që i përkrahte ato....Mori pjesë në formimin e Lidhjes shqiptare të Prizrenit, u bë kryetar i degës së saj në Gjakovë, (K.Frashëri, FESH, vëllimi 2, faqe 526).

Në fjalimin e e tij tronditës, si pjesëtar i delegacionin shqiptar në punimet e Lidhjes së Kombeve që mbahej në Gjenevë më 1919, Fishta, ndër të tjera, dëshmon edhe për krimet e përbindshme të ushtrive serbe kundër shqiptarëve të Kosovës. Sidomos kur prapa tyre fshihej diplomacia ruse, që përsëri nxiste dhe ndihmonte politikën pushtuese serbomadhe ndaj shqiptarëve.

Episode të kobshme të këtyre ngjarjeve tragjike duhej të na shpaloste Fishta dhe të vazhdonte të na përshkruante ato që lexojmë që në këngë e parë "Cubat" të poemës së tij, ku tregon se si cari i Rusisë i shkruan letër knjaz Nikollës, ku i tërheq vëmendjen:

Po a s'ta mbushë synin Shqipnia,
me ato male të madhnueshme,
me ato fusha të blerueshme...
("Cubat", faqe, 10)

Mendoj se gjatë ripunimit të "Lahutës...", të botuar e plotë më 1937, Fishta kishte mundësi që këto dukuri tragjike që kishin ndodhur dhe ndodhnin në Kosovë, t'i pasqyronte në faqet e kësaj vepre.

Dikush mund të thotë se ai nuk bën histori në poemën e tij. Por në këtë rast është lexuesi, sidomos kosovar, që shtron një kërkesë të tillë. Dhe kjo se vetë autori me këngët "Ali Pashë Gucia", "Lidhja e Prizrenit", "Mehmet Pasha", që citova pak më sipër, na shpie në mjedise kosovare duke u përpjekur gjithashtu të na japë edhe atmosferën historike të atyre kohëve.

Sendërtimi qoftë edhe i disa prej ngjarjeve të mësipërme që zhvilloheshin në Kosovë, do të zgjeronte kornizat e poemës që, siç është vënë në dukje, u kushtohen kryesisht luftërave të malësorëve të veriut kundër shovinistëve malazezë. Madje këtë Fishta mund të kishte gjetur hapësirë për ta shprehur edhe në këngën e mësipërme kushtuar Dedë Gjo'Lulit. Si pjesëtar dhe drejtues i mbledhjeve

të përfaqësuesve të popullsisë së Shkodrës për autonominë e Shqipërisë, Dedë Gjo' Luli ishte ndër ata atdhetarë që vendosën bashkimin me Lidhjen e Pejës, (1899-1900), vazhduese e rrugës së Lidhjes së Prizrenit, kryesuar nga atdhetari i njohur Kosovar, Haxhi Zeka, e cila u shpreh me vendosmëri "...për të përballuar me forca ushtarake vullnetare çdo orvatje të re që monarkitë ballkanike, Serbia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Greqia, ndërmorën për copëtimin e trojeve shqiptare", (FESH, vëllimi 2, faqe 1512).

Detaje të tilla do të ndriçonin dhe më mirë figurën e Dedë Gjo' Lulit dhe do të tregonin lidhjet midis malësorëve të veriut me luftëtarët kosovarë, që luftonin për një qëllim: kundër pushtuesve otomanë dhe serbo-malazezë.

Vargje të tilla ku poeti i drejtohet Ali pashë Gucisë si:

M'kamë pra Ali, për n'kjoft kund gjallë,
Nuk asht nga eja sod me u tallë,
Knjazi topin asht ka e kallë,
Dil e piqu me Haxhi Zekën,
Grish Kosovën bashko Rekën,
Lsho kushtrimin n'Toskë e Gegë,
Mblidhnu tok si kokrrat n'shegë,
(“Ali Pasha i Gucisë”, faqe 94),

nuk mund të plotësojnë si duhet këtë detyrim të poetit për Kosovën që duhej të zinte vend më të gjerë të "Lahuta...", të paktën me nxjerrjen në pah të disa personazheve historike kosovare që kam përmendur më sipër, të përshkruara me forcën e fuqishme artistike me të cilën Fishta ka gdhendur figurën e pashlyeshme të Oso Kukës ose Tringës.

Këto probleme nuk do të lindnin, në rast se Fishta t'ia kishte kushtuar poemën e tij vetëm ngjarjeve që lidhen me heroizmit të shqiptarëve të Malësisë së Veriut kundër pushtuesve otomanë dhe malazezë, të cilat në faqet e saj janë përshkruar në mënyrë të pasqyruar. Dhe kështu ai do të ishte plotësisht justifikuar para lexuesit.

Por si shpjegohet atëherë fakti që në Kosovë dhe në trevave të tjera shqiptare në Maqedoni, qysh në vitet 30-të të shekullit të kaluar janë mësuar përmendësh kënga të tëra të "Lahutës..."

Siç ma kanë pohuar dhe vetë kosovarë, me të cilët kam pasur rast të bisedoj, kjo ka ndodhur, sepse Fishta me talentin e tij të mahnitshëm, të shprehur me gjuhë shumë të komunikueshme dhe me ngjyra popullore, ka lartësuar bëmat e mëdha të malësorëve të veriut, pra vellezërve të tyre të një gjaku, me të cilët i ndanin veç disa male e fusha, kundër shkijeve malazezë, që ishin po aq mizorë sa shkjetë serbë, sundimin e egër të të cilëve e mbanin dhe vazhduan ta mbanin për dekada të tjera mbi kurriz.

KOMPOZICIONII “LAHUTËS...” DHE PERSONAZHET E SAJ

Përqendrimi i ngjarjeve të poemës vetëm në vitet 1858, 1878 dhe më pas në vitet 1908 dhe 1913 ka sjellë si pasojë që vepra të jetë fragmentare dhe herë-herë

monotone, siç e ka vë në në dukje ndër të tjera edhe Ismail Kadareja në studimin e tij “Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe”.

“Lahuta...” bëhet fragmentare edhe sepse në pjesën më të madhe të saj këngët nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe përfshijnë ngjarje me vete, me personazhe me vete.

Këtë dukuri të kësaj vepre vë në dukje dhe pr. Çabej, kur nënvizon:

”Përsa i përket arkitekturës së jashtme, e cila përshkruan luftat e dy brezave, nuk është një vepër e njënjëjtë me veprim të vetëm të madh, që ta përshkonte nga kreu deri në fund. Ajo është më fort një varg këngësh epike, prej të cilave çdo grup përshkruan një ngjarje historike. Ndërmjet është ndërlikuar nga ndonjë këngë e vetme, e cila përshkruan një episod të vetëm që qëndron më vete, ose na largon e na shpie në botën e përrallave...Po të krahasojmë formën e parë, shumë të shkurtër të veprës, me trajtën definitive të vitit 1937, shohim përpjekjen e poetit për të shtrënguar disi lidhjen e dobët ndërmjet një kënge e kënge, herë duke ndërruar rendin e parë të këngëve, herë duke shtuar këngë të reja të krijuara më vonë, për të mbuluar kështu plasat e para e për të dhënë një pamje të plotë”. (“Epika e Fishtës”, shkruar me rastin e vdekjes së poetit, 30 dhjetor 1940, marrë nga google, internet).

Është e vërtetë që më poshtë në artikullin e tij studimor me shumë vlera edhe sot, pr. Çabej shkruan për Fishtën:

“Në themel nuk ka qenë qëllimi i tij të krijojë një poemë me një veprim kryesor të vetëm dhe me një hero kryesor”. (Po aty).

Por te “Lahuta...” ka raste ku personazhet i ndeshim nga një këngë në tjetrën. Kjo ndodh veçanërisht me personazhe të tilla historike, si knjaz Nikolla, Mark Milani, të cilët janë dhe më të realizuarit në poemë.

Kështu knjaz Nikollën e shohim të shfaqet në Kangën e Parë “Cubat”, kur merr letrën nga cari i Rusisë dhe pastaj në bisedë me vartësin e tij, Vullo Radoviç, kur nis e thur plane kundër Shqipërisë.

Ky episod është shumë i gjetur për të karakterizuar tiparet e knjaz Nikollës. Them i gjetur, sepse më 1858 knjaz i Malit të Zi ishte Danilo, ungji i Nikollës, që u vra më 1860. Dhe atëherë vendin e tij e zuri Nikolla. Por kjo nuk ka aspak rëndësi. Rëndësi ka fakti se me marrjen e letrës nga cari i Rusisë, ngjarjet që pasojnë, intrigohen, sepse pastaj Vullo Radoviçin e shohim në Kangën e 2-të, “Oso Kuka”, kur malësorët, të prirë nga Oso Kuka, dëbojnë bandat malazeze nga Vranina dhe në Kangën e Tretë, “Preja”, kur ai vret pabesisht trimin shqiptar, Avdi Hisa.

Përballë tij po në këto këngë shohim edhe Oso Kukën, që e hasim pastaj edhe në Kangën e 3-të “Preja”, Kangën e Katërt “Vranina” dhe Kangën e Pestë, “Deka”, ku me ngjyra shumë prekëse autori përshkruan vdekjen e tij heroike.

Të hamendësojmë për një çast se Fishta do ta mbyllte “Lahutën...” me këtë episod, që shënon pikën kulmore shumë tronditëse të ngjarjeve që përfshihen në pesë këngët e para, (“Cubat”, “Oso Kuka”, ”Preja”, “Vranina”, dhe ”Deka”), të shkruara me frymëzim magjik, dhe, mbi të gjitha, dhe me kompozicion të harmonishëm.

Atëherë askush nuk do të vinte në dyshim se ndodhemi para një kryevepre, të cilën mbase do të kishte dashur të kishte të vetën cilido poet i njohur në botë dhe bashkëkohës i Fishtës...

Le t'i analizojmë përsëri shkurtimisht kompozicionin e këtyre këngëve:

Ekspozimin e ngjarjes:

Biseda e Knjaz Nikollës me Valo Radoviçin, pas ardhjes së letrës nga cari i Rusisë dhe planet që thurin për pushtime tokash shqiptare...

Pika e lidhjes:

Valo Radoviçi me bandën e tij sulmon dhe pushton Vraninën. Oso Kuka mbledh një grup luftëtarësh të zgjedhur dhe nisët për dëbimin e tyre...

Zhvillimi i ngjarjeve:

Vulo Radoviçi vret bariun shqiptar, Abdi Hasa. E motra e vajton... Osoja thërret shokët që të marrin hak. Luftime të ashpra të luftëtarëve shqiptarë kundër hordhive malazeze, që munden... Knjaz Nikolla trembet nga trimëritë e Oso Kukës me besnikët e tij. Mbledh komandantët dhe u tregon planet kundër tyre... Por edhe Oso Kuka parandjen rrezikun... Kënga e Kacel Dodës për bëmat e Gjergj Elez Alisë, tradhtia e Zeliq Gjokës, që u rrëfen rrugën malazezëve... Betejat midis të dy palëve... Shqiptarët zbrapsen të thyer.

Pika kulmore:

Osoja i rrethuar në depon e barotit ...Lufta e tij kundër malazezeve të shumtë.

Zgjidhja:

Osoja lufton, nuk dorëzohet, hedh veten në erë bashkë me armiqtë malazezë.

Këto pesë këngë së bashku mund të përbënin "Pjesën e parë" e poemës.

Në pjesën e dytë mund ta përbënin Kanga e 6-të, "Dervish Pasha" deri te Kanga e 25-të, "Koha e re". Kurse në pjesën e tretë dhe të fundit do të përfshiheshin këgët e tjera, që mbyllen me Kangën "Konferenca e Londonit".

Por në ecurinë e ngjarjeve që përfshihen në këto këngë, poema bëhet fragmentare, sepse ngjarjet në to me disa përjashtime nuk kanë lidhje organike me njëra-tjetrën.

A mund të mënjanohej kjo mangësi? Mendoj që po.

Siç u përmend dhe më sipër, Knjaz Nikolla paraqitet sërishmi në Kangën e 7-të, "Kuvendi i Berlinit", kur del i reckosur para krerëve të shteteve të Evropës dhe u lyp ndihmë, pra lyp toka shqiptare, lutje që i plotësohet. Ky personazh, tepër kompleks dhe tepër intrigues dhe imponues, më i realizuari në poemë, shfaqet pastaj në Kangën e 11-të, "Lugati", kur i fanitet në ëndërr Mehmet Ali Pasha i vrarë, në Kangën e 15-të "Kasneci", kur merr vesh për humbjet që ka pësuar nga shqiptarët komandanti i tij, Mark Milani. Madje, sado kalimthi, ai shfaqet edhe në këngën e fundit "Kongresi i Londonit", si të ishte kështu fill përçues i tërë poemës, rol të cilin mund ta kishte luajtur edhe Marash Uci ose Zana e Frymëzimit që është cituar më lart.

Po kështu Mark Milani shfaqet pastaj në Kangën e 17-të, "Te Ura e Rrzhanicës", dhe në Kangën e 21-të në një bisedë plot dredhi dhe lajka më patër Gjjonin, gjatë armëpushimit për të varrosur luftëtarët e vrarë nga të dy palët, ku i thotë:

A ma mirë ju rob nën turk,
qi ka qenë gjithmonë tërfuk,
me u ra shpinës me u lllomitë,

mandej gjanë me u grabitë,
apo ortakë me u ba me ne,
tue ruejtë doke, gjuhë dhe fe,
e tue njoftë për”gospodar”,
Knjaz Nikollën, trim bujar...
 (“Ndërmjetësia”, faqe 293)

Dhe pastaj Mark Milani merr nga patër Gjoni përgjigjen kuptimplote:

Unë, zotni, n’ushtri kam dalë,
jo me turq, por me shqiptarë,
turq a t’kshtenë si muhamedanë,
Shqipninë s’bashkut gjithë e kanë.
(Po aty, faqe 294)

Nga këto dëshmohet se në këngët e tjera që mund të përbënin pjesën e dytë dhe të tretë të “Lahuta...” nuk kemi një hero pozitiv që t’i kundërvihet Knjaz Nikollës dhe Mark Milanit, por vetëm një, patër Gjoni, që e shohim në Kangën e 14-të “Patër Gjoni” dhe në Kangën e 21-të “Ndërmjetësia”, dhe që bëhet kështu një nga figurat më mbresëlënëse të poemës.

A kishte mundësi poeti që këtë figurë ta zhvillonte më tutje. Si në rastin e mësipërm përsëri mendoj që po...Por kështu më shumë mund të zhvillohej dhe figura e Tringës, që gjithsesi, edhe pse e shohim në Kangëne 22-të, mbetet një personazh i rrallë në poezinë tonë të gjithë periudhave.

Do të kishim kështu një poemë të ndarë në tri pjesë të veçanta nga njera-tjetra, me kompozime gjithashtu të veçanta, por që, siç kam përmendur më sipër, mund të lidheshin me anë të figurave të tilla si Zana e Frymëzimit ose Marash Uci.

Me aq sa ka mundur, Fishta është përpjekur të paraqesë figura të diplomacisë evropiane. Ndër ta, ku më shumë e ku më pak, dalin në pah Franc Josefi i Austro-Hungarisë Vilhelmi i Gjermanisë, Krajli i Inglizit, i Moskovit, Francës, Italisë, (Kanga e 30-të, “Konferenca e Londonit”), e cila, siç do ta shpjegoj më poshtë, duhej të hiqej dhe të zëvendësohej me një këngë kushtuar Shpalljes së Pavarësisë më 1912 në Vlorë.

EDHE NJË HERË PËR BETEJAT KUNDËR PUSHTUESVE TURQ

Siç e kam përmendur më sipër, në këngët e “Lahutës...” ato zenë një vend më të vogël se betejat e shqiptarëve kundër malazezëve, dhe përqendrohen kryesisht në Kangën e 27-të, “Dedë Gjo Luli”.

Në këtë këngë, veç betejave të mësipërme, të përshkruara nga autori me nota epiko-tragjike, nuk të shlyhet nga mendja figura e Llesh Nikë, veçanërisht në vargjet:

T’janë mbledhë miq prej s’dij se kahit:
Pse m’rri shtri si dru prej ahit?

Cou njiherë për me ligj' rue,
 çou, djelminë për me e trimnue!
 folja 'i fjalë babës Nikë, t' motuem,
 Ty nuk t'tremi gjylja e topit,
 nuk t'ligështoi duhmja e barotit,
 kur mbi turq mësyne rr'fe motit.
 ("Dedë Gjo' Luli", faqe 487)

Është hera e parë dhe e fundit që Fishta ngjarjet e poemës i zhvendos nga krahinat e veriut, në viset e Matit, ku shqiptarët e atyre viseve ngrihen kundër pushtuesve turq....

Pastaj poeti na shpalos një faqe tjetër të luftërave të popullit tonë kundër sundimit turk, që kulmon me fushatën e madhe të Turgut pashës, i cili në krye të 100 taborëve sulet mbi Shqipërinë, veç të tjerash që shqiptarët të mos mbajnë më armë, që madje të mos ta quajnë më veten shqiptar, aq më shumë kur në parlamentin turk, Xhavit Pasha dëshmon për ta::

Veç se sherrin...s'di a dini,
 çë se turku s'parit hini,
 në Shqipni e deri sot,
 jo ma pak, po them me lot,
 se pesëdhet e katër herë,
 m'ne shqiptarët janë lshue poterë..”
 ("Xhemjeti", faqe 461).

Sidoqoftë, Fishta kishte mundësi të përshkruante në poemën e vet edhe disa ose të paktën edhe një nga të 54 kryengritjet që pashai turk përmend më sipër, të cilat i hasim në kronikën historike të fillimit të shekullit të 20-të, ose, siç kam vënë në dukje, nëpërmjet rrëfimeve ë Marash Ucit ose Zanës së Frymëzimit, të tregonte edhe për betejat të hershme kundër pushtuesve turq.

Kështu ai do të dëshmonte se populli ynë, siç e shohim që në vargjet e para të poemës, luftonte së pari kundër pushtimit shumëshekullor otoman dhe njëherësh edhe kundër synimeve pushtuese të shovinistëve serbo-malazezë që ishin bërë rrezik shumë i madh për fatet e kombit tonë.

Po kthehemi përsëri te personazhet, për të vënë në dukje se nga dëshira që të përjetësojë në poemë luftëtarët malësorë që kanë marrë pjesë në betejat kundër malazezëve, Fishta në këngët ku i përshkruan, i përmend thujtë të tërë. Por, me gjithë këtë dëshirë, ata mbeten vetëm emra dhe jo personazhe, siç ndodh në Kangën e 18-të "Te Ura e Sutkjeskës":

..Si njaj Osja i Shas Alltunit,
 Zeqir Meta e Met Halili,
 Osman Zela 'i zog bylbylit,
 Janiq Mirko e Tomiq Pera,

Rrahman Dyli porsi fjera,
Krye më kreu me Janiq Gjurën...
(faqe 223)

Këtë dukuri e vemë re dhe te Kanga “Dedë Gjo’ Luli”, ku brenda 9 vargësh radhiten emrat e 9 luftëtarëve të njohur :

“Sokol Baci, mendeqar,
Mirash Luca, pushkatar,
Mehmet Shpendi, dervendi,
Frano Pali, e Mirash Pali,
Si dy plumba n’”xheverdare”.
Me atë Tomë Nikën, harushë mali,
qaj Lukë Marku, rr’fe zhgjetare,
Me atë Islamin Mukalashi,
prej Shkodranësh Luigj Gurakuqi...”.
(faqe 481)

Sado që poeti u vë luftëtarëve të sipërpërmendur epitete, disa prej të cilave, si “harushë mali” e “rrfe zhgjetare”, janë përdorur dhe në faqe të tjera të poemës, ata nuk mund të pohohet se janë portretizuar, aq më tepër figura e atdhetarit dhe poetit të njohur, Luigj Gurakuqi, mbi të gjitha, mik dhe shok i penës edhe i vetë autorit, që përmendet për herë të parë dhe të fundit në faqet e “Lahutës...”.

Dhe të mos harrojmë se Luigj Gurakuqi ,” Më 1911 mori pjesë në kryengritjen e malësorëve të Mbishkodrës dhe si një nga udhëheqësit e saj, hartoi së bashku me Ismail Qemalin Memorandumin e Greçës, drejtuar Portës së Lartë, me 12 kërkesa, një ndër më të rëndësishmet e të cilit ishte njohja e plotë e kombit shqiptar, dhe më 1912 zhvilloi veprimtari të dendur për organizimin e kryengritjes së përgjithshme”.(FESH, vëllimi 1, 2008, faqe 798, 2008).

Kur Fan Noli, i mërguar pas kthimit të Zogut në fuqi në dhjetor të vitit 1924, që edhe ai, siç dihet, e kishte Gurakuqin shok dhe bashkëpunëtor të ngushtë, i kushtonte atij elegjinë nga ku shkëpusim strofën:

”Nëno moj, , vajto merr malin,
Larot ta përmbysnë djalin,
Që me Ismail Qemalin,
ngriti flamur trimëror”,

kuptohet se edhe Fishta, gjithashtu për të njëjtat arsye i arratisur në Itali, duhej t’i kushtonte Gurakuqit edhe ai jo mënjë poezi, por një vend të dukshëm në poemë dhe të mos mjaftohet me një varg, aq më shumë kur, siç e thekson Noli në elegjinë e mësipërme, ai ishte ndër atdhetarët e flaktë për shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor të vitit 1912 në Vlorë.

Mendoj se trajtimi i figurës së Luigj Gurakuqit, do t'i jepte më shumë frymëmarrje poemës, kur kujtojmë se veç Oso Kukës, vështirë të na kujtohet ndonjë personazh i spikatur nga Shkodra.

Po kështu në poemë duhej të zinte vend të dukshëm edhe figura e Mehmet Shpendit, i cili, "...në nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit mori pjesë në mbrojtjen e trojeve shqiptare nga copëtimi i parashikuar në Traktatin e Berlinit". Gjithashtu: "Mori pjesë aktive në kryengritjen kundërosmane të vitit 1911 dhe më 1912 ishte një nga udhëheqësit e forcave kryengritëse në luftimet për çlirimin e Shkupit". (FESH, vëllimi 3, 2009, faqe 2530).

Edhe në Kangën e 20-të, "Lekët", Fishta citon rreth 40 emra luftëtarësh, nga të cilët të le mbresë malësori shqiptar, Bec Patani, dhe malazezit Mil Spasi, të cilët gjatë luftimeve dalin se janë dhe probatinë, përshëndeten dhe sipas zakonit mbështesin kokat në supet e njeri-tjetrit.

Ky episod, siç nënvizon studiuesi kanadez, Robert Elsi, në veprën e tij "Histori e letërsisë shqiptare", (Pejë, 1997, faqe 294), është i ngjashëm me episodin e takimit të Glaukut me Diomedin në muret e Trojës së lashtë. Mbase Fishta është ndikuar prej tij. Sidoqoftë, më duket se episodi në fjalë i kësaj kënge, të vënë në poemë mbase për të nxjerrë në pah këtë zakon kanunor, mund të mos zinte vend në poemë.

Nuk më duket aspak e arsyeshme që Fishta në Kangën e 21-të, "Ndërmjetësia", nga të goditurat e poemës, ndër tjetra tregon se si malësori Bec Patani, krahas Oso Kukës, fratit Gjon, Tringës, nga personazhet pozitivë më të skalitur në poemë, së bashku më shokë të tij ndërmerr një aksion në një fshat malazez, gjatë të cilit lidh në një fron të zotin e moshuar një të shtëpie dhe bashkë me ta... rrëmben plaçka e bagëti(!?). Me fjalë të tjera, vepron bash si cubat malazezë që përshkruan në këngët e para të "Lahutës...".

Dhe Fishta e justifikon këtë "bëmë" të Becit me fjalë që ky i fundit i drejton plakut malazez:

...Hallallë, mixhë,
pse pak sonte t'kem tundue,
Vathin gjajet tue t'shkretnue,
Pa na pasë ti gjak në varrë,
Ne' pre mik, ne' erzin marrë,
As thye vi, as luejtë kufi,
veç se ti shkja ke le,
dhe ban hije mbi dhe.
("Tringa", faqe 303).

Robert Elsi, gjithnjë në librin e tij "Histori e letërsisë shqiptare" e justifikon këtë veprim të Becit, i cili sipas tij "...na kujton "Iliadën" plaçkitjen e Odiseut dhe Diomedit natën në kampin trojan", (faqe 234 e veprës së mësipërme). Por mua ky arsyesim më duket fund e krye pa asnjë bazë.

Duke marrë parasysh se Fishta e ka botuar "Lahutën... " të plotë me 1937, me rastin e 25-vjetori të kremtimeve kushtuar Pavarësisë së Shqipërisë, pra, 32 vjet pas krijimit të këngëve të para të saj, kam bindjen se po ta kishte parë atë me

sy kritik, ai do të kishte mundur të krijonte një lidhje më organike dhe më të natyrshme të këngëve. Për këtë qëllim, mund të kishte krijuar edhe një personazh historik, si Marash Uci, që përmenda më lart, vdekur me 1914, pikërisht atë që e përjetëson në Këngën e 12-të, të titulluar me emrin e këtij malësoni, të cilin e kishte njohur me 1902 në një fshat dhe nga tregimet e të cilit ishte frymëzuar për të shkruar këngët e para të “Lahutës...”

Fishta, jo vetëm kishte përkthyer dhe përshtatur drama, por ishte dhe vetë dramaturg. Si pasojë, njihte mirë rregullat të cilave u nënshtrohet një vepër letrare. Prandaj, në rast se edhe ”Lahutën...” do ta kishte parë nga ky këndvështrim, mund të kishte krijuar një poemë më organike.

PERSONAZHET MITOLOGJIKE TE “LAHUTES...”

I ndikuar nga vepra të letërsisë antike greke dhe kryesisht nga “Iliada” e Homerit, edhe Fishta ka ndërthurur te ”Lahuta...” personazhe mitologjike, por shqiptare, si zanat, orët, kulçedrat, qofshin shqiptare ose malazeze, të cilat, si te veprat homerike, ndërhyjnë në ngjarjet që shtjellohen në poemë.

Më të goditurat, sipas mendimit tim, janë episodet të cilat përshkruajnë bisedat e zanave që ndjekin debatet e atdhetareve në Kuvendin e Prizrenit, (Kanga e 9-të “Lidhja e Prizrenit”) dhe episodet që përshkruajnë vdekjen dhe varrinin e Tringës nga zanat, (Kanga e 24-t ”Zanat e Vizitorit”), edhe kjo ndër më tërheqëset e poemës.

Por edhe në këtë këngë Fishta ka rreshtuar një numër jashtëzakonisht të madh zanash, orësh, e shtojzovallësh, rreth 60, (dhe brenda 32 faqesh), nga të cilat të zhvilluara artistikisht janë Zana e Madhe, e Mira, Ora e Trojanit dhe Zana malazeze e Vizitorit. Kjo e fundit zhvillohet dhe rritet edhe më shumë para syve të lexuesve, sidomos gjatë dyluftimit qiellor dhe Zanën e Dormitorit, ku mundet keqas prej saj dhe përfundon robinë e zanave, e lidhur pas një bliri, pranë varrit të Tringës.(Kanga “Gjaku i marrun”).

Kurse zanat, orët dhe shtojzovallët e tjera mjerisht mbeten emra dhe vetëm emra.

Po e ilustruj këtë me vargje të tilla :

...Ndigjoni,

Jere, Lere, Tere, Gere,

Ti, Culinë, e ti Dalinë,.

Tile, Gile, Tale, Gale,

Bashkë me Donen e Berdonen,

Beken, Ceken e Cërleken,

Shpejt me m’endë ju një këmishë deke.

Dy vargje më poshtë:

E ju, Care, Nare, Dare,

Nji rizë t’gjatë, t’bardhë e t’hollë

Si ato rrezet për t’më endë keni...

Dy vargje të tjera më poshtë:

Ti Fatale, Naze, Raze,
Nji “ndjesë” arit shpejt m’ia shkrini. (faqe 382, 383)

Më tutje:

Edhe Syne, Lore, Loshe,
Mine, Mile, Mele, Groshe,
Para duersh aty po bijshin,
Mirë t’lëmueme ‘i rrasë mermerit. (faqe,385, 386)

Dhe më tutje:

Motrat’veta: Bjeshkë e Borë,
Thrake, Dake, Vace, Grace,
Lali, Lice, Like, Dike,
e sa jeni motra t’mija... (faqe 400)

Siç e kam shprehur më sipër, Kanga e 26-të, “Kulshedra”, nga më të goditurat e poemës, nuk ka asnjë lidhje organike me ngjarjet e saj. Por do të qëndronte krejt natyrshëm, në rast se Fishta pas përshkrimeve tronditëse dhe me nivel të rrallë artistik të ndonjëres prej betejave kundër shkijeve malazezë, njëherësh ta ndërthurte atë me tregimin a këngën e një luftëtari për përleshjet e malësorëve me kulshedrën, ashtu siç vepron në Kangën e 5-të “Deka”, ku Oso Kuka i kërkon një luftëtari të këndojë një këngë trimërie. Dhe ky luftëtar këndon këngën e Gjergj Elez Alisë.

SKENDERBEU TE “LAHUTA...”

Heroi ynë i madh kombëtar duhej të kishte vend më të gjerë në poemë dhe lexuesi të mos njihej me të nëpërmjet Fishta përsëritjes së vazhdueshme të fjalëve “...nipa të Kastriotit, a Skënderbeut”. Për mendimin tim në Kangën e 9-të, “Lidhja e Prizrenit”, ku zanat soditin nga malet ç’po ndodh në këtë kuvend kaq të rëndësishëm historik, Fishta mund t’i kishte vënë të rrëfenin se, ashtu siç është mbledhur ky kuvend, ato kishin parë të mblidhej dikur edhe Kuvendin e Lezhës, i kryesuar nga Gjergj Kasrioti. Kështu ai do të skaliste sado pak edhe figurën e heroit tonë legjendar që në poemë i ka kushtuar këto vargje:

Skanderbegu ‘i rr’fe prej qiellit,
pallën xier atje në Krue,
se ç’vetue ka n’rreze t’diellit,
e si ula’ tue buluritun,
shqiptarisë ia lëshon kushtrimin,

qi, shk' a' burrë në luftë me zbritun,
Turkut në kambë m'ia shtypë guximin...
("Lidhja e Prizrenit", faqe 107)

Sidoqoftë, pak dhe jo me nivelin artistik që Fishta ka derdhur në faqet e "Lahutës.. " për shumë ngjarje të tjera historike. Mbase ai ka gjykuar se heroit ynë legjendar njihej edhe atëherë falë gojdhaneve, të cilat studiuesi Marin Sirdani, i mblodhi në librin e tij "Skënderbeu pas gojdhaneve", (1926)", ose dhe nga tekstet shkollorë ku pjesë të "Lahutës..." besoj të jenë përfshirë në vitet 30-të të shekullit të kaluar Por, sidoqoftë, Skënderbeu duhej të mishërohej si personazh të "Lahuta...", madje dukshëm.

Meqë më sipër përmenda zanat, duke bërë një parantezë, mendoj se Kanga e 22-të "Tringa", mund të rrëfehej një zanë e pranishme në vdekjen e saj heroike, e cila pastaj me zanat e tjera kujdesen për varrimin e saj sipas riteve tradicionale shqiptare.

"LAHUTA ..." DHE SHQIPERIA E JUGUT

Fishta mund të zgjeronte edhe më shumë gjeografinë e kësaj poeme dhe me ngjarje nga Shqipëria e jugut.

Është e vërtetë që ai ka përfshirë te "Lahuta..." vargje të tilla:

E t'janë çue Toskë e Dibrinë,
E t'janë ngritë lumë e pejanë,
Gash, Krasniqe e Gucinjanë,
Me Gjakovë e me Tetovë,
me ra n' Tuz me ra n'ushtri,
me dhanë jetën për Shqipni.
("Kasneci", faqe171)

ose:

Bini Toskë, ju në pikë te vrapit,
mos t'u ndalin mal e zall,
Naim Frashëri i ra qitapit,
Mos me lshue Shqipnin t'gjall.
("Pater Gjoni", faqe 255,256)

Por, sidoqoftë, këto vargje dhe të tjera si këto, të cilat, veç të tjerash, nuk janë në nivelin e shumë e shumë vargjeve të kësaj natyre që Fishta ka derdhur në faqet e poemës, heronj të Toskërisë, të tillë p.sh., si Rrapo Hekali ose Zenel Gjoleka, nuk na paraqiten në poemë. Është e vërtetë që si personazh nga Jugu, ai ka zgjedhur atdhetari i madh Abdyl Frashëri, që zë vend kryesor në Kangan e 9-të, "Lidhja e Prizrenit". Por nuk është e logjikshme se përse në vargjet e mësipërme të

këngës “Patër Gjoni” poetin tonë të madh të Rilindjes , Naimin, vëllanë e Abdylit , Fishta mjaftohet ta përmendë vetëm me vargun, madje të rëndomtë:

“Naim Frashër i ra Qitapit”,

Aq më tepër me fjalën turke... “qitap”.

Dhe të mendosh se Çajupi, bashkëkohës i Fishtës, i kushtonte këtij poeti të madh të Rilindjes Kombëtare një elegji, ku, ndër të tjera, shkruante:

“Vdiq Naimi, që këndoi
trimërinë, Skëndërbenë,
vdiq Naimi që lëvdoi,
Dhe nderoi mëmëdhenë”.

Ishte rasti në këtë këngë Fishta të nxirte më në pah figurën e Naim Frashërit edhe me episode të tjera, të përshkruara me ngjyrime të dukshme emocionuese, siç ka vepruar në rastin e rrëfimit tronditës kushtuar Eufrosinës, në këngën “Kulshedra”.

Jo vetëm kaq. Por ai kishte mundësi të gjente hapësira të paktën për të rrëfyer heroizmin e grave suliothe të cilat, për të mos rënë në duart e pushtuesve turq, dhanë jetën duke u hedhur poshtë shkëmbinjve.

Por akoma më e paperceptueshme është se përse në këtë poemë nuk përmendet asnjë krahinë, a qytet i Shqipërisë së Jugut, madje as Vlora, ku më 28 nëntor të vitit 1912 u shpall pavarësia e Shqipërisë, ngjarje të cilën do trajtoj në nënkapitujt e tjerë.

PËRSËRI PËR QENIET MITOLOGJIKE

Duke u kthyer sërishmi te qeniet mitologjike, Fishta mund të kishte mënjanuar episode tjera, me qenie të tilla, që ndeshim në Kangën e 26-të, “Koha e re”, aq më tepër që nuk shquhen për vlera artistike. Të tilla janë episodi i bëmave të Lleshit të Zi, që lufton me kulçedrën në një shpellë, ku poeti këshillon zanën që që të mos hyjë... dhe episodet me floçkat, kshtesat, qenie mitologjike femra, që flasin shqip, madje njëra prej të cilave edhe martohet me një kelmendas...Për më tepër, sepse edhe këto ngjarje nuk shkrihen organikisht me rrëfimet historike të poetit për mbretërit ilirë, luftërat me pushtuesi romakë dhe në vazhdim me episode të tjera që lidhen me Gjergj Kastriotin.

Në këtë këngë është poeti që në bisedë me Zanën, i rrëfen asaj për orë dhe zana, për shtriga e kulshedra, për shtojzvalle të Elikonës që “...kanë lanë bjeshkë e vërrije e zalle,/ të Grekisë e dalë në’Shqipni,/ ku n’gjuhë shqipe-bukuri-/ herë tue folë e herë tue këndue./ kanë rysë gjinden me feksue...”, (“Koha e re”, faqe 455), kur duhej të ndodhte e kundërta, sepse zanat janë hyjnore, pra dhe të pavdekshme.

Sikur Fishta të vepronte kështu, atëherë dhe bëmat e qenieve të mësipërme mund të ishin më të natyrshme, si ngjarje të përjetuara në gojëdhëna nga vetë Zana

, sepse tingëllojnë si të stisura vargjet e mëposhtme, në të cilat poeti i kallëzon zanës:

Kur të dalësh n'atë detë,
Aty bregut ke me pa,
Floçka e Kshetsa tue ndejë n'shulla,
tue u krehë e tue bubitë,
shoqja shoqen tue ngallitë...
(Po aty, faqe 454)

Pra, edhe e përsëris dhe një herë, si mundet që poeti t'i kallëzojë Zanës ngjarje shumë të lashta, kur ajo vetë është e përjetshme dhe si si pasojë është e logjikshme që këto ngjarje t'i këtë përjetuar vetë më parë se ai vetë?..

Veç kësaj, vargjet kushtuar këtyre qenieve mitologjike janë të dobëta si dhe vetë ngjarjet që shtjellohen në praninë tyre, sidomos po t'i krahasojmë me vargje të tilla të kësaj kënge, me të cilat poeti i drejtohet zanës:

...leni sot, moj shtojzavallet,
leni flut'rat t'marrin zallet,
leni sutat t'marrin malet,
.....
behma këtu n'kët Lissus t'vjetër,
ku larg zhurmet e poteret,
dola dhe u'n'këtë buzë pranveret,
për me këndue n'Lahutë t' Malcis,
se si u end fati i Shqipnisë...
(Po aty, faqe 446)

Kur përmend se varri i Skënderbeut ndodhet pikërisht në Lezhë, Fishta kishte rastin më të mirë që të ndalej përsëri te figura e heroit tonë kombëtar, siç kam theksuar dhe më lart, mbetur në poemë vetëm në disa vargje të përgjithshme dhe t'i ofronte lexuesit të paktën një episoed, qoftë historik, a të trilluar prej tij ose luftëtarëve të tij, për të mos thënë se mund të shfrytëzonte edhe legjenda për Skënderbeun, me të cilat sigurisht ai ka qenë i njohur.

Madje, në këtë këngë ishte rasti më i mirë që Fishta të rikujtonte se pikërisht në këtë qytet më 1444 nën kryesinë e Skënderbeut ishte mbledhur kuvendi i princërve shqiptarë për organizimin e luftës së përbashkët kundër pushtuesve otomanë. Dhe një episoed i tillë mund, të rrëfehej nga Zana e Frymëzimit, siç kemi përmendur, bashkëbiseduese e natyrshme dhe e goditur me poetin në disa këngë, edhe në këngën e fundit.

Të bën përshtypje fakti se, përse me përjashtim të bisedave të tij të shkurtra me këtë zanë, me figurat e tjera mitologjike Fishta na njeh te "Lahuta..." kryesisht vetëm në këngët që përfshijnë vitin 1878, më saktë, duke filluar nga Kanga e 9-të, "Lidhja e Prizrenit", kur zanat soditin nga malet zhvillimet e këtij kuvendi.

Mendoj se autori , ashtu siç na njeh me to në episodet që lidhen me vrasjen tragjike të Tringës dhe varrimin e saj, mund të kishte gjetur hapësirë që të na njihte, fjala vjen, edhe pas vetëflijimit të Oso Kukës, duke na rikujtuar dhe ndonjë heroizëm të një luftëtari tjetër shqiptar në kohë më të hershme.

Gjithashtu të bën përshtypje edhe fakti tjetër, që këto figura mitologjike, pra zanat, orët, nuk shfaqen në pjesën e tretë dhe të fundit të poemës, nëse mund ta përcaktojmë kështu, pra në ngjarjet e viteve 1908-1913....

Pasurimi i “Lahutës...” me ngjarje që lidhen me këto figura, mund t’i kishte dhënë mundësi poetit që të plotësonte dhe më mirë portrete e tyre, sepse, me përjashtim të Zanës së Frymëzimit, Zanës së Vizitorit dhe deri diku zanës malazeze të Dormitorit, siç e kam përmendur më sipër, figurat e tjera mitologjike, ngaqë janë edhe të shumta, mbeten edhe të zbehta.

GJUHE FIGURATIVE, POR EDHE FJALOR ARKAIK

Siç është vënë në dukje dhe nga kritika, gjuha e Fishtës është shumë e pasur me figura letrare, veçanërisht me epitete dhe krahasime, jo vetëm me fjalë, por edhe me fraza të zgjeruara, që ndeshen aq shume dhe te “Iliada” e Homerit, nga e cila mund të jete ndikuar edhe në këtë rast.

Fjala “pushkë” çuditërisht është përdorur rrallë nga Fishta dhe në vend të saj ndeshim fjalët hutë, mauzer, karajfile, breshanë, martinë, fjalën turke xheverdare, fjalën sllave novicë. Aq më pak është përdorur dhe fjala shpatë, e zëvendësuar thujse tërësisht nga fjala turke tagan,si dhe fjala pallë.

Duke bërë një parantezë, 27 vjet pas botimit të “Lahutës...”, më 1964, Kadareja në poemën e tij të njohur “Përse mendohen këto male”, pavarësisht se për kushtet e kohës ajo iu nënshtrua kërkesave ideologjike, përdor për armën vetëm fjalën “pushkë”, e njohur nga te gjitha dialektet.

Dhe e përdor në mënyrë të figurshme:

Se gruaja lindte fëmijë.
Por pushka lindte krisma,
Dhe për shqiptarin ishin,
Po aq te shtrenjta te dyja,
Dhe krisma dhe fëmija.

Ose:

Dhe mbi trup,
Si shtesë e hekurt,
I rritej e zezë,
Pushka e gjatë,
Një çast i shkurtër,
Dhe një histori e gjatë.

Pra, pushka fiton te Kadareja një përgjithësim më të madh artistik dhe filozofik. “Ndaj me simbolikën e vet, - shkruan pr. dr. Milazim Krasniqi, - poema ”Përse mendohen këto male”, ka ushtruar një ndikim të ndieshem në mendimin e lexuesve, veçmas në Kosovë”. (“Përse mendohen këto male”, “Shqipëria.com”, nga faqet e internetit).

Natyrisht, këtë dukuri që vëmë re te kjo poemë e Kadaresë, nuk mund ta quajmë mangësi të “Lahutës...”. Dhe kjo, sepse Fishta nuk përdor figura te tilla letrare, kryesisht metafora, ngaqë një shekull e më shumë më parë, ai i drejtohej së pari popullit te thjeshtë, shumica e të cilit nuk dinte as të shkruante dhe as të lexonte. Prandaj kemi emërtime të ndryshme të pushkës që njihej në krahinat e veriut dhe në tërë Shqipërinë, për t’i dhënë ngjyrimet e duhura mjediseve luftarake ku zhvillohen betejat midis shqiptarëve dhe malazezeve.

Veç kësaj, në shekullin 19-te dhe dekadat e para të shekullit te 20-te Fishta ndiqte shkollën e poezisë tradicionale evropiane, romantike, qoftë dhe në zhanrin epiko-historik, që u pasurua më pas me vepra letrare të një një stili të ri poetik, të cilin në Shqipëri nisi ta përdorte Poradeci në poezitë e tij lirike dhe Migjeni në poezitë me tema të mprehta shoqërore dhe më pas Kadareja dhe poetë të tjerë, të mëvonshëm, të tërë të ndikuar nga poezia moderne botërore, e shoqëruar dhe me shprehje te reja metaforike më të avancuara.

Fishta është kujdesur ta pasurojë “Lahutën...” dhe me fjalor. Sipas studiuesve në këtë veper numërohen 1274 fjalë, shumica të vjetra, ndër të cilat dhe turqizma të panumërta, të marra nga të folmet e rrethit të Shkodrës dhe Malësisë së Veriut, të cilat nuk i gjejmë të përdorura kaq dendur nga shkrimtarë të tjerë të Veriut.

Si pasojë. këto fjale, si zatete, agzot, fulikare, i zotet, serotinë, kolla, karrani, kurne, telatin, misnik, sergji, kullme, mshil, zburth, gaperr, senjur, melaqe, nemi, orok, bubis, gajres, ushtuer, kacaturre, fuzhnje, rrëfane, mutue, e plot e plot të tjera, e bëjnë veprën te vështirë për t’u lexuar, jo më nga banorët e Shqipërisë së Jugut edhe te Mesme, por edhe të Shqipërisë se Veriut. Madje, brenda vargjeve të para të faqes 288 të “Lahutës...” , (Kanga “Ndërmjetësia”), Fishta ka përfshirë fjalët: calina, shejshana, sylah, harbi, xhurdi, caruqe, duqe, zanambare, bunjet, cungal ... duke i bërë këto vargje thuajse të pakuptueshme.

Do të kishte qenë e arsyeshme që vetë autori në fund të çdo faqeje ku hasen fjalë të tilla, të bënte shpjegimin e tyre, si ka vepruar Daniel Gjeçaj në botimin e dytë, (Romë,1958).

Por duhet vënë në dukje se në veprat e tjera poetike, sidomos në poezitë lirike, gjuha e Fishtës është e zhveshur nga fjalori arkaik, siç e pamë i përdorur enkas nga prej tij për t’iu përshtatur mjediseve dhe personazheve që përshkruan, ndonëse edhe me tepri, për t’ia lënë vendin një gjuhe të rallë poetike, që rrjedh kumbueshëm dhe me nivel të lartë artistik.

RIMAT, APOSTROFAT DHE PERSERITJET

Jo rallë, për hir të rimës, ka raste që ai i deformon fjalët. Kështu ndajfolja “vona” (“..ne e vona”, pra: “tek e vona”), rimon me emrin “zakona” që në

shumës është “zakone”. Për të rimuar me mbiemrin “serbjane”, që duhej të ishte “serbe”, ai Kishën e Deçanit e kthen në “Kishë Deçjane”, (!?).

Gjithashtu, për të rimuar me emrin “hana”, Fishta përdor mbiemrin “të mëdhana”, për “të mëdha”, (?). Për të njëjtën arsye emri Nikolla kthehet në Nikolli që të rimojë me fjalën Stambolli:

“...me mbret t’Stambollit,/ bamun ballë Nikollit” dhe:

“..për mbretin e Stambollit,/...thonë se knjaz Nikollit, (faqe 112,113)

Fishta e tepron me përdorimin e apostrofit. Kështu parafjalën “nëpër” ai e shkruan “n’p’r”, kur dihet se bashkëtingëlloret në gjuhën shqipe nuk mund shqiptohen pa ndihmën e zanores “ë”.

Shembull tjetër:

“Shk’a’ gegë, shk’a’ Toskë”..,

kur fare mirë mund të shkruante:

“ Shka asht Gegë,shka asht Toskë”.

ose më saktë:

“Kush asht Gegë, a kush asht Toskë”,

sepse peremri pyetës “shka”, më saktë “çka”, “çfar”, përdoret për emra jo frymorë”, (faqe 99).

.Jo vetëm kaq, por për hir të apostrofimit edhe i cungon fjalët . Kështu ai shkruan jo rrallë ”ki’n”, për “kishin” dhe “ki’të” per “kishtë”, kur rrokja “shi” në fjalën e parë dhe bashkëtingëlloretja “sh” në fjalën e dytë, nuk e prishin aspak ritmin e tetërrokëshit, të cilin ka jo pak raste që ai e kthen në dhjetërrokësh si :

Por vetimë si kokrra e rr’fesë,

n’kondak t’pushkës i mbet shkjaut kresë.

“Lahuta...” vuan edhe nga përsëritje të panevojshme, qoftë fjalësh, qoftë edhe vargësh. Ka përsëritje të tilla si “...i dhimbet miut në mur dhe gjarpnit në gur”, “i dhimbet gurit dhe drunit”...

Ka gjithashtu përsëritje të shumta të shprehjes “nipa te Kastriotit..”, ose “nipa t’ Skanderbeut”. Madje edhe brenda dy faqesh:

”Kush asht nipash t’Skënderbeut”, (faqe 108) dhe: ”Kush asht nipash t’ Kastriotit”, (faqe 109), si dhe brenda një faqeje:”..nipat e Kastriotit”, dhe “nipave të Kastriotit”, (faqe 161). Po kështu brenda faqes 203 përsëritet dy herë emri “Cernagore: ”...moj Cernagore”, “Kerserderi i Cernagores”, pasuar po në atë faqe nga mbiemri “cernagoras”.

Veç këtyre ka gjithashtu epitetesh, si sokol mali, zogu i verës, bylbyli në pranverë, trim bujar, burrë zotni, drague, ose drangue, e plot e plot të tjera si këto, veçanërisht në përshkrimin e tipareve të personazheve që i kanë mustaqet “vesh me vesh”, janë “kaleshanë”, me “vetulla të trasha”, trima “azganë”...

Mbi të gjitha, ka përsëritje, nga njëherë dhe me tepri përshkrimesh, dhe ndonëse jo shpesh, edhe të betejave, sidoqë ato janë dhënë me vërtetësi dhe nivel të rrallë artistik, të denja për “Iliadën” e Homerit, si në këtë episod kur shqjetë pushtojnë Nokshiqin, që na kujton pushtimin e Trojës nga grekët:

Kur qe, Shkjau, si drita duel,
ban e sheh ai për kundruell,
se si gjindja vu janë në t'hikun...
Se ç'kanë nisë atëherë me shti,
m'gjindje t'ngratë dhe n'bagëti,
si me gjuejtë shkërbe' n'lisni,
këtu vra'i plak, atje një fëmijë,
këtej një grue, përtej një dhi,
dike dekë, dike varrue,
njan'lësho n'proskë e tjetrin n' përue,
ment e kresë me t'u dërmue.
("Tringa", faqe 316)

Mangësitë që përmenda shkurtimisht më sipër, qofshin gjuhësore dhe artistike, cenojnë sado pak vlerat e padiskutueshme të kësaj poeme madhore.

Veçanërisht ato që vihen re në këngën e fundit, të 30-ën, "Konferenca e Londonit".

KONFERENCA E LONDRES VIHET MBI SHPALLJEN E PAVARESISE!?

Është për t'u habitur se si Fishta, në vend që ta mbyllte poemën e tij me një këngë himnizuese, kushtuar Shpalljes së Pavarësisë, në 28 nëntor të vitit 1912, parapëlqen ta mbyllë me një këngë kushtuar Konferencës së Ambasadorëve, që zgjati nga viti 1912 deri më 29 korrik të vitit 1913, datë në të cilën e shpalli Shqipërinë të pavarur, duke përjashtuar çdo lidhje me Perandorinë Osmane. Mirëpo kjo konferencë nuk njohu qeëverinë e Përkohshme të Vlorës dhe drejtimin e administratës së shtetit shqiptar ia ngarkoi Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Kështu dhe Kanga e 30-të që mbyll poemën titullohet "Konferenca e Londonit", e cila "...përsa u përket kufijve kreu një padrejtësi të madhe në dëm të kombit shqiptar. Fuqitë pjesëmarrëse nuk përfillën të drejtat dhe interesat themelore të shtetit shqiptar. Brenda kufijve të tij u përfshinë vetëm gjysma e tokave shqiptare, një sipërfaqe prej rreth 28 mijë km² dhe më pak se gjysma e popullsisë me kombësi shqiptare, rreth 800 mijë frymë. Më tepër se gjysma e shqiptarëve mbetën jashtë kufijve të atdheut. Pjesa më e madhe shkuan nën Serbinë, pjesa tjetër nën Malin e Zi dhe Greqinë", (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi i dytë, faqe 1242, Tiranë 2008).

Kjo është me të vërtetë e paperceptueshme....

Me shumë keqardhje, por në këtë mënyrë Fishta injoron ditën e 28 Nëntorit, që kremtohet kudo në Shqipëri si dita në të cilën atdhetarët tanë u mblodhën nga të katër anët e vendit në Vlorë dhe vendosën që Shqipëria të jëtë më së fundi e pavarur, krijuan edhe qeverinë e përkohshme, dhe e mbyll poemën, për të cilën ka punuar rreth 32 vjet, me vargjet shumë të dobëta, siç është në përgjithësi e tëra kjo këngë:

Edhe kështu mbas sa mjerimit,
 mbas sa gjakut dhe shëmtimit,
 e p'r inatë t'shkjeve të Ballkanit,
 për gazep t'atij sulltanit,
 si premtue kisht' Perendia,
 prap zojë m'veti duel Shqipnia.
 ("Konferenca e Londonit", faqe 518)

Kësodore Fishta nuk përfshin në poemë personazhe të tilla të mëdha historike si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, i cili, siç u vu në dukje më lart, përmendet në poemë vetëm një herë, Isa Boletinin, të ardhur nga Kosova, që vuante nga shtypja turke, si dhe figura të tjera të rëndësishme atdhetarësh.

Dhe vendin e tyre në Kangën e 30-të, "Konferenca e Londonit" e zënë përfaqësuesit e atyre vendeve që i bënë varrin atdheut tonë, si të Anglisë, Rusisë, Gjermanisë, Italisë, Francës, ata që, siç shkruan Fishta në këtë këngë, i parodizojnë atdhetarët tanë të mëdhenj me vargjet:

Varg e vistër kanë dalë në Vlonë,
 .. e i paçavër kuq e zi,
 vjerrë na e paskan për një hu,
 edhe hunin ngulë m'nji ship,
 t'madhe niskan me këndue,
 kin me demek po duem Shqipni,
 kinse kështu na jem shqiptarë.
 Eh, madhni, as ne s'hamë bar,
 na edhe i kemë po mendtë n'kandarë,
 e kem sy edhe me pamë...
 (faqe 514, po aty).

Dhe është për të ardhur shumë keq që Fishta, satirik i mprehtë dhe i ashpër, nuk ndërhyr për të bërë shkrumb e hi këto shprehje të neveritshme që ka vënë në gojë të përfaqësuesit francez, sepse ai vetë nuk e ka përmendur, pale të himnizonte këtë datë të madhe historike, Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorën legjendare. Dhe, siç e pamë, e zëvendëson atë me Kongresin famëkeq të Londrës,(!?)...

Për një lexues me origjinë shqiptare, që nuk e njeh historinë e Shqipërisë, si dhe për një të huaj që edhe ai ka dëshirë ta njohë atë nëpërmjet të përkthimeve të "Lahutës...", nga leximi i vargjeve të mësipërme dhe pastaj të kësaj kënge që mbyll poemën, arrin në përfundimin se ngjarja më e rëndësishme në historinë e Shqipërisë është vendimi i kësaj konference kobzezë, më 29 korrik të vitit 1913, dhe kurrsesi Shpallja e Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, e parodizuar në gojën e ambasadorit francez në atë konferencë.

Veç kësaj, Fishta te "Lahuta..." nuk ndalet te rrethimi i Shkodrës nga ushtritë serbe dhe malazeze për gjashtë muaj, (20 tetor 1912 - 23 prill 1913), nuk përshkruan qëndrimin heroik të banorëve të këtij qyteti, të cilët përballuan këtë

rrethim me heroizma të papara, nuk përshkruan tradhtinë e Esat Pashë Toptanit, që pasi vrau komandantin Hasan Riza Pasha, i cili kërkonte të mbronte qytetin, ua dorëzoi qytetin malazezëve, kurse vetë u largua me ushtrinë e tij dhe iu kundërvu Shpalljes së Pavarësisë...

Dhe të mos harrojmë se gjatë këtij rrethimi Fishta ka qenë i strehuar në Kishën e Arrës së Madhe dhe kështu ka përjetuar ngjarjet e këtij rrethimi kaq të gjatë.

Ishin pikërisht këto ngjarje që qysh më 1913 frymëzuan shkrimtarin Ndoc Nikaj, të botonte romanin e tij “*Shkodra e rrethueme*” dhe më 1978 shkrimtarin e njohur Skënder Drini, “*Vraje tradhtinë*” më 1978. Kurse Fishta, për habitinë e lexuesit, e ka përmbledhur këtë rrethim vetëm me vargjet e mëposhtme:

E kokë-fortë, kur knjaz Nikolla,
ku më pushkë e ku me t'holla,
s'po do' Shkodrën me e lirue,
të shtatë krajlat ç'janë idhnue,
Donamtet n'Shqipni kanë çue,
Ku admiralat m'breg sa dolën,
Kap për për veshit knjaz Nikollën,
Fill prej Shkodret jashtë e nxorën.
(“Konferenca e Londonit”, faqe 517).

Jam i sigurtë se, ashtu siç ka shkruar faqe të mahnitshme, kur përshkruan betejat e malësorëve kundër ushrive malazeze, (kujtoni “Kangën “Te Ura e Rzhanicës”, “Në Qafëhardhi”, “Te Ura e Sutjeskës”...), po ashtu Fishta do ta kishte përjetësuar rrethimin e Shkodrës nga ushtritë serbo-malazeze. Aq më tepër kur këto ushtri ishin shumë më të mëdha se forcat e luftëtarëve shkodranë të ndihmuar dhe nga të moshuar e fëmijë që u vunë përkrah ushtrisë turke të Hasan Riza pashës dhe zhvilluan beteja edhe më të përgjakshme kundër tyre.

Për t'u bindur, le të ndalemi te këto vargje:

E si përrue kur të bjerë shi,
Turbull bjeshkëve tue shung'llue,
Landë e gurë tue rrukullue,
Urat merr q' të gjejë përpara,
E then ledhet për nën ara,
Bujkut t'ngratë zemrën tue ia tha,
Njashtu n'luftë Malsia ra,
Aman zot se shka me pa!
(“Te ura e Rrzhanicës”, faqe 162)

MANGESI QE MUND TE SHMANGESHIN...

Por a kishte Fishta mundësi që të paktën një pjesë të këtyre mangësive t'i shmangte para se t'i paraqiste publikut të gjerë botimin e plotë dhe përfundimtar të

“Lahutës...”, me rastin e 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1937?

Pa dyshim që kishte. Mbase jo ai vetë, sepse autori e ka shumë të vështirë të bëjë vetë ndreqjet e duhura. Këtë mund ta kishte bërë dikush tjetër, pra, një koleg, shkrimtar, poet, gjuhëtar, të tillë si si Mjeda, Koliqi... që besoj se i kanë qëndruar pranë dhe kanë ndjekur krijimtarinë e tij, si dhe ai të tyren, ose miku i tij, Viktor Volaj, që është marrë me përgatitjen e kësaj vepre.

Në radhë të parë vepra duhej t’i nënshtrohej rregullave gjuhësore, të miratuara, nga Komisia Letrare, më 1916, ku bënte pjesë dhe ai vetë. Dhe të mendosh se Veç studiuesve të shquar atdhetarë, Gjergj Pekmezi, Aleksandër Xhuvani, Haviz Ali Korça, Josif Haxhistasa, Sotir Peci, anëtarët e tjerë të kësaj komisie, Luigj Gurakuëi, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Ndre Mjeda, Ambroz Marlaskaj, Ndue Paluca dhe Vinçenc Prenushi qenë nga veriu i Shqipërisë. Por, edhe pse i pranoi ato rregulla që bazoheshin në të folmen Elbasanit, pra të dialektit gegë, Fishta nuk i zbotoi kurrë në veprat e veta duke përfshirë dhe “Lahutën...”. Për më tepër, siç dihet, e quajti atë “gjuhë mushke me gjithë veshë e bisht”, ose: “... që turçe nuk asht, por që ashtu po i thonë, por që s’asht, qe besa, as gjuhë shqiptare”.

Kështu vepra na ka ardhur e shkruar në nëndialektin veri-perëndimor dhe me gabime drejtshkrimore, siç do të ve në dukje më poshtë.

Që nga viti i botimit të plotë të “Lahutës..”, siç thamë më 1937, kanë kaluar shumë dekada.

Nuk dimë në sa kopje u bë ky botim, në cilat qytete u shpërnda, në cilat biblioteka të Shqipërisë u depozitua. Nuk dimë ç’jehonë pati vepra te lexuesit e qyteteve jugore të Shqipërisë. Mbi të gjitha, nuk dimë sa u lexua dhe kuptua prej tyre...Nuk dimë a arriti të shpërndahej dhe në Kosovë, që vazhdonte të vuante nën thundrën serbe, ose vise të tjera shqiptare, ose të diasporës sonë.

Duke qenë se “Lahuta...” është shkruar në nëndialektin veri-perëndimor, mendoj se leximi dhe kuptimi i saj nga banorët toskë në Shqipërinë e asaj periudhe kur u botua, ka qenë disi i vështirë.

Pas ardhjes së regjimit komunist në fuqi, Fishta, siç dihet, u cilësua poet reaksionar, agjent i fashizmit...Kështu vepra e tij u varros si ai vetë.

Dhe ja, pas shembjes së kësaj diktature të pashembullt në Evropë, Fishta u ringjall. Bashkë me të edhe tërë krijimtaria e tij letrare, duke përfshirë edhe “Lahutën...”.

Dhe nga mallkimi, erdhi himnzimi i tij, ngritja në piedestalin e lavdisë, nga ku komunistët padrejtësisht e kishin rrëzuar, për të mos e ngritur kurrë.

Nisën të botoheshin studime kushtuar veprës së Fishtës me analiza të gjithanshme, për të nxjerrë në pah vlerat e mohuara të saj. Dhe u bë shumë mirë. Ai nisi të zinte vend edhe në botimet shkollore, të bëhet i njohur kështu edhe nga nxënësit dhe studentët.

Por deri tani, siç është vënë në dukje, edhe në fillim të këtyre shënimeve, me përjashtim të pr. dr. Shefkije Islamajt, që ka shkruar një vepër në dy vëllime kushtuar gjuhës dhe stilit të Fishtës, dhe ka vënë në dukje mangësi të saj që janë përmendur më sipër, nëse nuk jam i gabuar, nuk kam parë që veprës së tij, veçanërisht “Lahutës...”, t’i bëhet edhe një shikim kritik, ku të vihen në dukje

edhe mangësitë e tij, disa prej të cilave rendita dhe unë më sipër, dhe të cilat mund të jenë edhe subjektive.

FISHTA DHE LEXUESI I SOTEM

Përsëri bëj pyetjen: A kuptohet tërësisht “Lahuta...” nga masat e gjera të lexuesve të sotëm, sidomos të rinisë?

Duhet vënë në dukje se përfshirja e Fishtës në antologjitë e shkollave të mesme, me komente dhe shënime përkatëse, përgatitur nga dr. Tonin Çobani, ku vend të rëndësishëm zë dhe “Lahuta ...” është një ndihmesë e madhe për njohjen dhe kuptimin e saj nga brezi që ndjek këto shkolla.

Sidoqoftë, është mirë të bëhet një anketim në bibliotekat e Shqipërisë dhe Kosovës, për të parë sa tërhiqet kjo vepër nga lexuesi i përgjithshëm.

Që nga viti 1972 me vendimin e Kongresit të Drejtshkrimit që toskërishtja të jetë bazë e gjuhës standarde, gegërishtja mbetet gjallë në veprat e shkrimtarëve që kanë shkruar në këtë dialekt.

Por ata, ndër të cilët Mjeda, L. Gurakuqi, Shiroka, Koliqi, Migjeni...deri te Mekuli në Kosovë, kanë përdorur një gegërishte të butë, ndryshe nga gegërishtja veri-perëndimore shkodranishte e Fishtës. Duke marrë parasysh se, ndryshe nga poezitë e tjera lirike dhe atdhetare, Fishta përdor në këtë vepër dhe një fjalor të pasuruar me fjalë të rralla të atyre krahinave, si dhe turqizma, kryesisht për t'i përcjellë lexuesit ngjyrimet e kohës kur zhvillohen ngjarjet, pra, të gjysmës së dytë të shekullit të 19-të, kuptohet se lexuesi i sotëm e ka disi të vështirë ta kuptojë plotësisht “Lahutën...”, madje edhe lexuesi i sotëm verior.

“Lahuta...”, bëhet disi monotone edhe nga përsëritjet dhe përsëkrimet e gjata dhe të panevojshme, një pjesë të të cilave i vura në dukje më sipër.

Jam i mendimit se kjo vepër duhet të ribotohet me disa shkurtime, ku të mënjanohej mangësitë e mësipërme. Të mos harrojmë se ajo është 512 faqe e gjatë, pa dyshim më e gjata poemë në letërsinë shqiptare dhe mbase ndër më të gjatat në letërsinë e huaj, dhe mund të lexohet me nge nga ata që kanë pasion dashuri dhe durim, por që edhe mund të kenë vështirësi për ta lexuar edhe për arsyet e mësipërme.

Veç shënimeve që Fishta ka vënë në krye të çdo kënge, në disa prej të cilave ai u paraprin ngjarjeve duke na shuar deri diku kureshtjen për fundin e tyre, mendoj se vepra duhet shoqëruar me shënime të tjera më të hollësishme historike dhe fjalor pas çdo kënge.

Dhe kjo, sepse për fat të keq, fjalët që përdor Fishta, të gjetura nga krahina rreth Shkodrës, siç u vu në dukje edhe në shembullin e mësipërm, nuk janë përhapur në popull dhe në pjesën më të madhe nuk janë përdorur nga shkrimtarë të tjerë, ndaj kanë nevojë të shpjegohen.

Mbi të gjitha, krahas botimit origjinal, që shërben për studiuesit dhe studentët e fakulteteve të gjuhës dhe letërsisë së universiteteve tona, dhe në Kosovë, “Lahuta...” duhet të botohet në gegërishten shkodrane, pak a shumë të Mjedës a Koliqit, pra, duke mënjeluar trajtat nëndilektore, si shndërrimin bashkëtingëlloreve “ç” në “q”, (gjeraçinë në gjeraqinë,) ose “q” në “k” (kime, në

qime), “gj” në “q” (gjytetnuem, në qytetnuem, “c në “s”, (malci, në malsi), “sh” në “ç” (shka në çka)... mënjanimin e rjedhore nëndilektore (voeset në vese”) etj. Me fjalë të tjera “...”Lahuta..” të shkruhet pak as shumë në shkodranishten e shkrimtarëve të mësipërm dhe kësaj me një drejtshkrim të përafërt me të cilin ata shkruan veprat e tyre, që nuk ndryshonte nga drejtshkrimi i elbasanishtes, e cila u miratua nga Komisia Letrare qysh në vitin 1916, të cilën për fat të keq Fishta, siç e pamë , nuk e përfilli .

Të gjitha këto nuk do të preknin stilin e autorit dhe faqet e mahnitshme të “Lahutës...”, veç përsëritjeve dhe zgjatjeve, do të çliroheshin nga këto “barëra”që i zënë frymën dhe do të dilnin më shumë më mirë në pah edhe dhe vlerat e padiskutueshme të kësaj poeme madhore. Kështu ajo do të shfaqej me tërë madhësinë e Fishtës si poet i zhanrit epiko-historik, më i madhi në letërsinë shqiptare dhe do të bëhej kështu dhe më i afërt dhe më e dashur për lexuesit tanë.

Qershor-korrik, 2016, North Quincy, Boston, SHBA

MIRLINDA KRIFCA BEQIRI

“NJË SAGË E VOGËL” – E EROSIT DHE THANATOSIT

Shkrimtari Besnik Mustafaj, një nga shkrimtarët më të njohur dhe më të përkthyer shqiptar, zë një vend të rëndësishëm në libraritë evropiane, si një nga reprezentët e mëdhenj të letërsisë shqiptare të periudhës pas-kadareane, gjegjësisht të letërsisë së viteve '90.

Studimet që synojnë krijimin e fizionomisë që po merr romani bashkëkohor shqiptar, pjesë cilësore dhe e rëndësishme e të cilit është, pa diskutim, vepra e Besnik Mustafajt, dëshmojnë arritje të tilla të romanit shqiptar, që mundësojnë që të bëhet i krahasueshëm me modele të të njëjtit zhanr, që shkruhen në letërsitë me difuzion më të gjerë gjuhësor.

Pavarësisht se Mustafaj është cilësuar si shkrimtar me prirje moderniste, vepra e tij dëshmon se nuk është e lehtë vendosja e saj në kallëpet e një formacioni të caktuar stilistikor. Fundja, veprat e mëdha janë të rëndësishme për nga vlera që ngërthejnë, e jo për nga drejtimi letrar të cilit i takojnë.

Vepra “*Një sagë e vogël*” karakterizohet me thyerje, që ofrohet nëpërmjet rrëfimeve paralele, thyerje këto që, sipas Linda Aronsonit, janë të preferuara në artin bashkëkohor, për shkak të mundësisë që ofron kjo formë narrative për të pasqyruar rrëmujën e ekzistencës sonë. Vepra karakterizohet me shumësi të diskurseve, që vërehet nëpërmjet të shtresimit të materialit folklorik e mitologjik, si dhe me teknikën e përzierjes së qëllimshme mes diskursit të prozës dhe poezisë, si dukuri e shpeshtë në letërsinë pas viteve '90. Sigurisht, nuk është e rastit që, tekstit narrativ i paraprin poezia “*Unë vdekjes i qeshë fare pranë*”, e cila paralajmëron temën e jetës dhe vdekjes, ashtu siç paralajmëron edhe temën e burgut, të shoqëruar me shpresën se përfaqësuesit e gjeneratës së re, burgjet do t'i shndërrojnë në *muzej për mesjetën*, shpresë kjo që, për rrethanat tona ballkanike, megjithatë, duket shumë optimiste.

Vepra karakterizohet me ndërlepsje të së vërtetës e fiksionit. E vërteta e këtij romani paraqitet si perceptim i individit, si interpretim, pra s'ka fakte, por interpretime të fakteve, ashtu siç vrojtohen ato nga aspekti individual. Tema e jetës dhe vdekjes, gjegjësisht erosit dhe thanatosit është temë qendrore e romanit. Mes erosit dhe thanatosit qëndron institucioni i burgut. Burgu ishte “*një ankth i errët*”, që kishte rënduar familjen e personazhit –narrator, Bardhyl Hutës, djalit të Omer Hutës dhe nipit të Oso Hutës, si dhe familjen e Lindës. Nëna e saj, Selvi kishte qenë vajza e gardianit, Hyqmet Hidi. Fataliteti i burgut përcillet, prej gjenerate në gjeneratë, te të dy familjet.

Burgu qëndron mes Oso Hutës e të birit, Omerit; mes Bardhylit e Lindës dhe mes Hyqmetit dhe të shoqes e të bijes. Ai paracakton fatalitetin e jetës së dy

famijeve, nëpër tri gjenerata. Së këtejmi, fjala “burg”, luan rolin e fjalës bërthamë në veprë. Sipas M. Riffaterre “*funkcioni i një fjale bërthamë është organizimi i kuptimit të fjalëve selektive*”.¹

Tema e burgut është shumë e pranishme në letërsinë shqiptare të shek. XX. Është konteksti politik e shoqëror shqiptar dhe ballkanik ai, që imponon nevojën e pranisë së shpeshtë të temës në fjalë. Kjo temë është veçmas sfiduese për autorët e gjeneratës së Besnik Mustafajt, një pjesë e mirë e të cilëve edhe vet përjetuan burgjet famëkëqia të sistemit totalitar dhe krijuan atë që sot njihet si “*letërsi e burgut*” ose “*burgologji*”, siç e quan një nga reprezentët e njohur të saj, Visar Zhidi. Autori mëton të paraqesë egërsinë e burgut, përpjekjet e tij për të zhbërë njerinë, identitetin e tij njerëzor të asfiksuar nga frika. Burgu është institucion që tjetëron njeriun, duke e bërë të humb dinjitetin e vet. Fundja, dëshira për t’i lejuar që të takohet me të shoqen, Lindën, bëri që Luli të bëj atë që bënin shumë fatprerë të tjerë si ai, që të shtyrë nga pasioni apo ndjenja familjare, nënshtroreshin para xhandarëve e gardianëve, rojtarëve “vigjilent” të burgut. Pasojat që lë burgu në jetën psikike të të burgosurit janë të padiskutueshme. Kështu Jean Améry, 20 vjet pas daljes së tij nga kampi i përqëndrimit nazist, do të shprehet: “*Çdo ditë, që kur ngrihem në mëngjes, mund të lexoj në parakrahun tim numrin e Auschwitz-it, kjo më prek qenien deri në rrënjët më të skajshme, madje nuk jam fort i sigurt, se mos kjo është e gjithë qenia ime*”.²

Konteksti i mbrapshtë politik i nënqiellit shqiptar dje dhe sot, ka ndryshuar, ndoshta, shumë gjëra, por ajo që ka mbetur gati e pandryshuar në të gjithë këto sisteme, është burgu. E burgu, pavarësisht se a është i kralit, i mbretit, i okupatorit apo i sistemit vetjak diktatorial, mbetet burg, institucion që tjetëron njeriun dhe që, si fatalitet, përcillet nga një gjeneratë në tjetrën.

Fundi i romanit, na jep të kuptojmë se fatalist do të jetë edhe fati i fëmijës që Linda mban në trup, meqë si pinjoll i një të burgosuri politik apo i një gardiani, ai s’kishte si t’ju ik labirinteve të burgut dhe si rrjedhojë, s’mund të ishte i dashur dhe i respektuar. Ai s’do të kishte mundësinë e zgjedhjes, që jeta ia ofron njeriut. Duke qenë i privuar nga zgjedhja, ai vetvetiu do ta ketë të vulosur fatin e tij tragjik, diçka që na kujton heroin e veprës së Migjenit i cili, duke lindur në një familje skamnore, kishte fat të destinuar – atë të cubit ose të lypësit.

Struktura e veprës

Romani është i ndarë në tri libra. Në librin e parë, në qendër të vëmendjes është fati i familjes së Bardhyl Hutës, narratorit të veprës. Babai i Bardhyllit, Omeri, e përfytyronte të atin, Oso Hutën, si heronjtë e këngëve kreshnike shqiptare, para së gjithash, si Mujin. Mbi këtë bosht semantik, Omeri ngre figurën e Mujit të ri, kurse veten, të pranuar në odën e burrave, e me këtë edhe të burrëruar para kohe, e paramendon si Omerin, djalin e Mujit, figurë e trimërisë së parakohshme. Mbase, koençidenca në emrat e tyre, ishte një nga arsytet e shumta të një dëshire të vetve-

¹ Michael, Riffaterre, *Semiotics of Poetry*, Indiana University Press, Bloomington and London, 1978, f.39.

² Jean, Améry, “Kufijtë e intelektit”, Saras, Tiranë, maj 2016, nr. 13, f. 20.

tishme për identifikim, për idealizim, për ëndërrim. Si pasojë, edhe trishtimi që përjeton në moshën e tij 12 vjeçare, kur takon të atin, që nga hero shndërrohet në antihero. Osoja fare s'ngjasonte me burrin madhështor, që ai kishte përfytyruar. Burri, që ai takoi, s'ngjante në njeri që mund ta tund shpatën e Skënderbeut dhe topuzin e Gjergj Elez Alisë, apo ta shkulë lisin si Muji. Ky takim shumë tronditës, e zhbën imazhin që ai kishte krijuar për të atin dhe sigurisht edhe për vete, si bir i një babai, që zanat e kishin ushqyer me qumështin e dhisë së bardhë. Omeri që thyer mes ëndrrës së e bukur dhe zgjendrës së keqe.

Në librin e dytë, burgu qëndron mes Bardhyl Hutës, narratorit të veprës dhe gruas së tij, Lindës. Autori, pa dhënë shpjegime paraprake, na njofton se Bardhyli ishte i burgosur politik. Ai vuante dënimin politik në një burg tjetër dhe në një kohë tjetër, atë të pasluftës. Luli kishte gradën e doktorit të shkencave në fushën e inxhinierisë mekanike. Së këtejmi, si intelektual që ishte, jeta e burgut për të bëhej edhe më e padurueshme. Në esenë me titull "*Kufijtë e intelektit*", Jean Améry shprehet se në kampet e përqendrimit, pozita e intelektualit, rezulton të jetë më e pafavorshme se e ajo e një njeriu që merret me punë fizike, meqë të burgosurit që zotëronin një zanat të thjeshtë, kishin shans të ishin më të nevojshëm se një intelektual. Ai do të shprehet: "*Intelekti në totalitarizmin e tij në kamp u shpall jokompetent. Si vegël e vlefshme në përballimin e detyrave të vëna para nesh, ai abdikoi*".³

Pas qëndrimit 11 mujor në burg, Luli i qe lejuar që të kalonte një natë në "dhomën speciale" me të shoqen. Luli mezi priste natën e caktuar dhe gjatë tërë kohës mendohej të gjejë fjalë miklonjëse, përkëdhelëse, me të cilat do ta befasonte të shoqen, e cila gjithmonë e kishte kritikuar për mungesën e fjalorit romantik. Kjo pritje që iu duk shumë e gjatë, e shtyri Lulin të mendojë rreth ndryshimit që kishte përjetuar ai brenda kësaj periudhe. Ai tani më, mund ta shihte *tjetrin* brenda vetes, por vështirë se mund ta luftonte atë. Ai nuk ishte më ai i pari, ishte *ndryshe*, pavarësisht se ndoshta të tjerët, madje edhe Linda, s'mund ta vërenin këtë. Fundja, po të mos ishte bërë *ndryshe* ose ishte zhbërë, sigurisht nuk do ta meritonte këtë natë. Koha e tepërt e burgut dhe librat e lexuar e bindën, se s'kishte ndryshuar vetëm ai gjatë kësaj kohe, por se kishin ndryshuar edhe *tjerët*, ata që ishin *jashtë*, gjatë jetëgjatësisë së këtij sistemi të mbapshtë. Pra, Luli tani ishte në gjendje të vërejë edhe thyerjen individuale edhe atë kolektive. Ai, nga *brenda*, ishte në gjendje të bëjë një paralele mes leksikut të librave, që i kishin rënë në dorë dhe leksikut që përdornin ata që ishin *jashtë* e që, të prirë nga dëshira për të imituar *Udhëheqësin* në çdo gjë, madje edhe në leksik, kishin filluar t'i harrojnë fjalët e bukura për të shprehur familjaritet, afëri, dashuri. Kjo gjë e tmerronte.

Luli kishte kohë të mendojë tani edhe për fatin e femrës, përfshirë këtu edhe femrën e zemrës së tij, në shoqërinë meskine të kohës. Ajo shoqëri kishte tjetërsuar femrën shqiptare, kishte bërë që ajo të heq dorë nga gjërat që nxirrnin në pah femnitetin e saj. Përdorimi i parfumeve dhe tualetit ishin gjëra, që konsideroheshin se ju takojnë vetëm *grave të përdala*. Anekdota e një funksionari të lartë shqiptar, që i kishin bërë përshtypje gratë e parfumosura franceze, është tekst brenda tekstit

³ *Ibid.*, f. 21.

dhe paraqet një zgjidhje fatlume të autorit për të prekur edhe këtë temë të ndjeshme. Kjo episodë e veprës, pavarësisht se nuk është drejtpërdrejtë e lidhur me boshtin kryesor të rrëfimit, megjithatë dëshmon se sa qe shpërftytyruar, mashkullarizuar gruaja shqiptare e kohës.

Bardhyli mendon që këtë natë do t'i shpalosë të gjithë energjitë libidike, të ngërthyera brenda tërë kësaj periudhe. Ai mezi priste natën e planifikuar me aq imtësi, priste që erosi, me fuqinë e tij t'i kundërvihet të vërtetës faktike, ta harrojë ambientin ku gjendet, së paku për një natë – por kjo ishte e pamundur. Fjalët e komandantit të kampit, të përsëritura pastaj edhe nga një i burgosur i vjetër, se s' duhej të kishte biseda politike, e kthyen atë në realitet, në atë realitet që aq shumë kishte nevojë ta harrojë. Ishte e kotë, këto fjalë qenë zhbiruar thellë në trurin e tij. Linda e mezipritur erdhi, por jo edhe emocionet me të cilat ai shpresonte t'i shpalos gjithë ata fjalë të bukura, të gëlltitura nga librat e lexuar. Ai s' mund të çlirohet nga prania emocionale e *tjetrit, të tretit, të paftuarit*, por të *pranishmit* në “*dhomën speciale*”, që do të duhej të ishte dhomë e dyshes. Ajo që e shqetësonte akoma më tepër, ishte fakti se Linda s' mund ta kuptonte këtë. “*Si t'ia shpjegoja se unë nuk isha më ai i dikurshmi?! Si ta hapja kraharorin tim, që ajo të shihte vetë policin që kishte mbirë aty? Dyshova nëse ajo do të më kuptonte.*”⁴ Ajo s' ishte në gjendje të shikojë atë, që ishte e padukshme.

Ishin të papushtetshme miklimet dhe afshet e Lindës që nata të merrte kahen e dëshiruar dhe të shumëpritur. Ëndërrimet e Lulit për ta mposhtur kufizimin fizik të burgut me fuqinë e lirisë së brendshme dhe pasionit, megjithatë dështuan. Jeta e burgut, qoftë edhe për atë periudhë, sikur kishte bërë që Luli t'i humb aftësitë e të përjetuarit të gjërave thelbësore të qenies njerëzore. Fundja, fillimi i shuarjes së prirjeve pasionante të tij, fliste edhe për një fillim të shuarjes së instinktit të jetës.

Libri i tretë nxjerr në pah fatin e familjes së Lindës. Nëna e Lindës, Selvi, kishte pësuar trauma të rënda nga burgu dhe kujtesa, që e kishte të pamundur ta shtyp, e bënte atë fatkeqe. Në tërë romanin, e veçmas në pjesë të caktuara të tij, kujtesa luan një rol shumë të rëndësishëm në jetën e personazheve. Ky fakt na bind edhe njëherë se arti paraqet kujtesë të estetizuar. Sipas Barbara Smith-it: “*Përvoja estetike është e pandashme nga memorja, konteksti, domethënia e fatit kush jemi, ku jemi, si dhe nga tërësia e gjithë asaj që ka ndodhur më parë*”.⁵

Plagët e të shkuarës që, në një mënyrë apo në një tjetër, vërtitën në qerthujt e kujtesës, sigurisht se në moment të caktuara shpërthejnë. Fundja, s'ka si të interpretohet ndryshe mospajtimi i Selvit që e bija të martohet në qytet me burg, kur në gërmadhën ballkanike, në të cilën ajo ishte rritur dhe vazhdonte të jetojë, s'kishte qytet pa burg. Është kujtesa e pavullnetshme ajo që e shtyn të mos i gëzohet martesës së vajzës së saj të vetme. Në fund, edhe Linda, si e ëma para saj, vuan nga kujtesa, të cilën e kishte të pamundur ta mposht. Ajo ishte më e fuqishme se fuqia që posedonte Linda për të luftuar kundër fatalitetit të jetës. Sipas U. Eco-s: “*Askush nuk jeton në të tashmen e menjëhershë; që të gjithë ne i lidhim gjërat apo*

⁴ Besnik, Mustafaj, *Një sagë e vogël*, Arbri, Tiranë, 1995, f. 120.

⁵ Barbara, Herrnstein Smith, *Contingencies of Value: Alternative Perspectives for Critical Theory*, Harvard University Press, Cambridge, Mass, 1988, fq. 69.

ngjarjet nëpërmjet funksionit ngjitës të kujtesës, asaj personale apo kolektive (histori apo mit qoftë)”.⁶

Sevli kishte qenë vajza e vetme e Hyqmet Hedit, që kishte shërbyer si gardian edhe në kohën e mbretit edhe në kohën e sundimit italian. Me kapitullimin e Italisë, në javën e parë të shtatorit, të burgosurit kishin thyer burgun dhe kishin ikur, duke marrë me vete gardianët tjerë më të ri për t'i ndëshkuar, por e kishin lënë Hyqmetin. Kur burgu kishte mbetur bosh, ai, i mësuar me jetën e burgut, në pamundësi që ta shohë atë të zbrazët, kishte marrë gurë të mëdhej dhe i kishte vendosur e mbyllur nëpër qeli. Njerëzit flisnin dhe trillonin ngjarje të ndryshme. Berberanja e Ali Qyfyryes ishte vendi, ku më shumë diskutohej për këtë çështje. Madje edhe Mala i marrë merrej me punën e Hyqmetit e gurëve të burgut. Disa thonin se e kishte shpënë të shoqen në burg; të tjerë thonin se vetë ishte murosur në një qeli e se pastaj kish hapur një tunel nëntokësor dhe, nëpër kanal, kishte dalë e kishte shkuar në shtëpi. Të shoqës, Sanijes i vinte turp të dalë jashtë, kurse të bijës, Selvit, i vinte ndot që ishte rritur e ushqyer me bukën e burgut.

Jeta e gardianit, e heroit të burgut, e kishte bërë atë që të mos mund të jetojë pa burg, e kishte tjetërsuar atë, ashtu siç i kishte tjetërsuar edhe të burgosurit. Në fund, në pamundësi që të pajtohet me situatën e re të krijuar, ai vrau djalin e kasapit ose dhëndrin e tij të ardhshëm, vrau gazetarin, që deshte t'ia zbulojë ëndrrat dhe në fund vrau veten. Hyqmeti ishte çmendur.

Linda, si edhe e ëma Selvi, nuk mund t'i ikën të kaluarës dhe ta shlyejë atë nga e tashmja, meqë ajo e tashme, me apo pa dashje, formësohet nga e shkuara e hidhur. Kjo do të thotë se qe hapur thëllësisht kutia e Pandorës, që shpaloste dhembjet e të shkuarës.

Në fund të romanit, Linda ishte shtatzënë, por s'kish kujt t'ia tregonte lajmin për shtatzëninë e saj. Ajo e dinte se fëmija e saj, do të merrte njërin prej këtyre dy drejtime të paracaktuara: atë të të burgosurit, që do ta mbushte me ndjenjën e urrejtjes kundër atyre që ia vodhën ëndrrën e jetës, kundër *tjetrin ideologjik*; ose do ta zgjedhë rrugën e dytë, atë të gardianit, që do ta bënte të jetë i përçmuar ose i urretur nga të tjerët, duke filluar nga njerëzit e familjes. Drejtim të tretë nuk kishte. Linda s'dinte ç'fat t'i uronte fëmijës. Ajo s'ishte e sigurt, a është më e vështirë njeriu të përçmojë e urrejë, apo të jetë i përçmuar e i urretur. Ajo, si grua e si nënë, nuk e dinte a është më keq të jesh gruaja e një burri të përçmuar, apo nëna e një biri të përçmuar?! Në pëmundësi që të gjejë një përgjigje, ajo me ironi shprehet se, mbase, më mirë do të ishte që të mbetet deri në fund gur, meqë: *“Në murin rrethues të burgut ashtu si brenda në qeli ai është njësoj gur,.. .”*⁷

Kronotopi

Vepra karakterizohet me kohë objektive dhe subjektive. Koha objektive e romanit përfshin jetën e tri brezave, gjegjësisht kohën e Ahmet Zogut, kohën e okupimit fashist dhe kohën e pasluftës. Ajo që i lidh këto kohë, është prezenca e burgjeve politike që, si të tilla, nuk ndryshonin shumë nga një regjim në një tjetër,

⁶ Umerto, Eco, *Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, Dituria, Tiranë, 2007, f. 15.

⁷ Mustafaj, *op. cit.*, f. 179.

pavarësisht se a ishte ai i huaj ose jo. Ndryshimi i realiteteve dhe konteksteve politike shqiptare, mund të kishte sjellë shumë risi, mund të kishte bërë apo zhbërë shumë institucione, po një institucion mbetet i pandryshueshëm në të gjithë këto realitete, goxha të ndryshme mes veti – burgu. E burgu është burg. A nuk e zhbëri burgu Oso Hutën, *trimin kokëkrisur*, për të cilin vendasit ruanin kujtimet më të mira?! Po ky Oso, e kishte humbur pamjen madhështore dhe dinjitetin që kishte pasur dikur. Po ky burg bëri që i biri, Omer Huta të përsojë zhgënjim dhe të frikohet nga burgu politik, si nga djalli. Fatalizmi mbetet fat i familjes së tij. Burgun politik do ta përjetojë edhe i biri, Bardhyli, në një kohë tjetër, pa mbret e pa pushtues.

Burgu që fatal edhe për familjen e Lindës, e cila kishte fatin të jetë mbesa e një gardiani, që tërë jetën e kishte kaluar në burg dhe që, e kishte të vështirë të pajtohet me boshllëkun e burgut. Jeta në mesin e mureve të burgut bëri që ai, në fund të jetës, të ngrejë dorë mbi *Tjetrin*, që ia preku nderin e familjes ose *Tjetrin*, që desh t'ia zbulojë ëndrrat e gjumit 72 orësh, për të cilin ishin thurur thashetheme, nga më të ndryshmet.

Pos kohës reale, që përshin ngjarjet e gati një shekulli të tërë, autori shërbehet edhe me kohën subjektive, kohë zembereku i së cilës nuk përkon me atë të kohës reale. Ajo herë është kohë e shtangur, ose kohë që lëviz shumë ngadalë, si në rastin: “*Koha e të burgosurit ecën gjithnjë ngadalë. Mua, pasi më ishte caktuar data e takimit me Lindën, koha më mbeti thuajse në vend*”,⁸ herë është kohë ireale, e rrejshme, si në rastin: “*Të dy, të shtyrë nga nevoja për pak gëzim, kishim ndërtuar një kohë të mrekullueshme, por të rrejshme, që nuk mund të ekzistonte*”.⁹ Kemi, madje, edhe raste kur ajo kohë zgjatej tejmasë. Kështu: “*Gjashtë muaj pa u parë me Lindën janë padurimisht të gjatë. Janë një jetë më vete.*”¹⁰

Për dallim nga koha, hapësira që dominon në vepër është hapësirë reale. Kështu, derisa në librin e dytë, precizohet vendi i ngjarjes, përkatësisht jepet informacioni se Linda e Luli jetonin në Tiranë, vendin ku Luli dergjete burgun, në pjesën e parë dhe të tretë të romanit, autori nuk e lokalizon vendin e ngjarjes, sado që nuk është e vështirë të kuptohet se ngjarja vendoset në një qytete verior, pranë minierës së bakrit, në zonën ku ruheshin ligjet e Kanunit, ashtu siç ruheshin në kujtesë edhe këngët kreshnike mbi Mujin e Halilin ose balada mbi Gjergj Elez Alinë. Pra, ngjarja vendoset në një tokë reale, në tokën shqiptare. Sigurisht se vendi i saktë s`mund të nënkuptohet nga prezenca e burgut, meqë burgje kishte në të gjitha qytetet shqiptare.

Pjesa më e madhe e ngjarjes zhvillohet në burgun, që gjendej te kështjella e qytetit verior, e një pjesë më e vogël zhvillohet në shtëpinë e familjes Huti ose në atë të Hyqmet Hidit. Vet ambient i burgut, sikur zbulon fatin tragjik të protagonistëve të veprës të cilët, sigurisht, duke jetuar apo duke punuar në një ambient të tillë të zymtë, s`mund të pritët të ishin të lumtur. Kjo lumturi aq shumë e pritët dhe e ëndërruar, s`mund të arrihet, madje, as në hapësirën prej dy metrash të

⁸ *Ibid*, f. 65-66.

⁹ *Ibid*, f.81.

¹⁰ *Ibid*, f.68.

shtrahit të “dhomës speciale”, ku Lulit dhe Lindës i lejuan që të kalonin një natë, meqë hapësira aq e ëndërruar humbet në zymtësinë e hapësirës së burgut, ku ajo ndodhej. Viktimë e burgut kishte qenë edhe gjyshi trim e krenar i Bardhylit, kurse hero i tij, që me shumë “vigjilencë” e kishte ruajtur atë një jetë të tërë, kishte qene gjyshi i gruas së tij, me fat po aq tragjik.

Sigurisht, me një kronotop të veçantë në vepër karakterizohen episodet e ndërfitura, që luajnë rolin e tekstit në tekst, siç është koha e ëndrrës ose koha, për të cilën flitet në këngët e Mujit dhe Halilit, këngë këto me të cilat vepra vendos dialog letrar frytdhënës. Këtu flitet për një zone, që është e ngjashme me atë që është objekt trajtimi në roman, por ajo që ndryshon është koha.

Intertekstualiteti

Vepra “Një sagë e vogël” e Besnik Mustafajt dëshmon një kulturë të gjërë letrare dhe jo vetëm letrare të autorit të saj. Sigurisht, kjo kulturë dëshmon njohje të mirë të jetës dhe mentalitetit shqiptar, të kronotopit që është objekt trajtimi, ashtu siç dëshmon edhe njohje të mirë të kontekstit politik shqiptar të tri periudhave kohore, që janë objekt trajtimi. Shqipëria e secilës prej këtyre periudhave, mund të ishte e varfër për nga numri i shkollave, spitale, fabrikave e institucioneve tjera, por jo nga institucionet ndëshkuese, si burgu politik, me famëkeqi, por edhe më i shpeshti mes burgjeve. Sigurisht, prezenca e shumë burgjeve, kishte lënë pasojë edhe te heronjtë edhe te viktimat e tij. Burgu kishte arritur të thente, zhbënte ose tjetërsonte të dy palët, pavarësisht se mënyrat se si bëhej ky tjetërsim nuk ngjasojnë, ashtu si nuk ngjasojnë edhe fatet e protagonistëve, që të përbashkët kanë vetëm fatalitetin.

Vepra ndërthen shumë elemente intertekstuale. Po rikujtojmë, në këtë rast, teorinë intertekstuale të studiueses Julia Kristeva, e cila e koncepton tekstin të përbërë nga dy akse: “aksi horizontal që e lidh autorin me lexuesin dhe aksi vertikal që e lidh tekstin me tekste tjera”.¹¹ Romani hyn në dialog frytdhënës me vepra tjera. Sipas Rolan Barthes-it nuk ekziston “ligjërim i virgjër”.¹² Vepra dëshmon mbështetje të dukshme në këngët kreshnike mbi Mujin e Halilin apo në baladën shqiptare mbi Gjergj Elez Alinë. Në të vërtetë, edhe vet Muji është një lloj mishërimi i modelit të Gjergj Elez Alisë. Të dy janë sinonim i njeriut që gjakon ruajtjen e lirisë, kanunit dhe zakoneve, gjuhës e këngës së të parëve. Mbështetja dhe rimarrja nga letërsia gojore, në këtë roman, është në shërbim të ushqimit të fantazinë e Omer Hutës, në sytë e të cilit, i ati, s’ mund të ishte ndryshe nga Muji e Halili apo nga Gjergj Elez Alija. Autori ndërfit episode të tëra të veprave në fjalë, që në këtë rast, topiten dhe fitojnë një funksion të ri. Sigurisht, autori merr atë dhe aq sa i duhet nga këto krijime, që ruhen akoma mirë në memorijen kolektive, duke arritur që t’i përshtasë ose resemantizojë në kushte të tekstit të ri.

Mënyra si zhvillohet dialogu letrar apo raporti intertekstual me këngët e Mujit e Halilit ose Gjergj Elez Alisë, ose me folklorin në përgjithësi, nuk është gjithmonë

¹¹ Julia, Kristeva, *Desire in Language: A Semiotic Approach to Literature and Art*, Columbia University Press, New York, 1980. F. 69.

¹² Roland, Barthes, *Aventura semiologjike*, (përkth. R. Ismajli), Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 37.

e njëjtë. Ka raste kur autori merr episode të tëra nga hipoteksti folklorik dhe, duke u shërbyer me teknikën e palimpsestit, e ndërton tekstin e ri – hipertekstin, duke mos e ndryshuar kuptimin semantik të tekstit, por duke ndryshuar tipin e tij – nga tipi poetik në atë prozaik. Kjo vërehet në epizodin e vizitës, që motra e Gjergj Elez Alisë ia bën nallbanit pobratim për ta mbathur kalin e të vëllait, e ai si shpërblim kërkon nderin e vajzës.

Kemi raste kur raporti intertekstual me folklorin vihet në një formë tjetër, që vërehet në ëndrrën e Omer Hutës, para se ta takojë të atin, ëndërr kjo në të cilën ai ëndërron gjogun e Mujit që kishte ardhë për ta çliruar Oson nga burgu i kralit. Për t'ia arritur këtij qëllimi, atij iu desh të dalë në dyluftim me një figure tjetër të njohur të memories folklorike shqiptare e ballkanike, me atë të Arapit të Zi, që lexuesi shqiptar e ka të njohur nga balada mbi Gjergj Elez Alinë. Pra, këtu autori zhvillon dialog të dyfishtë, nga njëra anë me gjogun e Mujit e nga ana tjetër me Arapin e Zi, duke arritur që nga ky bazament të ngrejë ëndërrën, që luan rolin e tekstit në tekst. Pra, pavarësisht se këtu autori, nuk mbështetet në një epizodë konkrete nga njëra vepër folklorike apo tjetra, aluzioni në të dyja veprat, që vijnë si të gërshetuara, është i dukshëm.

Pos raportit që vendoset me këngët e përmendura folklorike, vepra e Mustafajt dëshmon rimarrje edhe nga bota e pasur e përrallave shqiptare. Kujtesa nga bota e pasur e përrallave, me të cilat qe rritur, i mundëson Omer Hutës që të krijojë një imazh mbi qytetin e bukur e të paqëm me pallat mbretëror, në bodrumin e të cilit gjendej burgu. Sigurisht, imazhi i tij ishte larg të vërtetës.

Mustafaj, sikurse edhe shumë shkrimtarë bashkëkohorë, mbështetet edhe në bazamentin mitologjik, duke sonduar në të nga perspektiva e bashkëkohësisë, gjë me të cilën i jep veprës së tij përmasa moderne. Fundja “*Në poetikën moderne evropiane, miti është gjenerator i fuqishëm i letërsisë*”.¹³ Raporti i romanit me hipotekstin mitologjik, më shpesh se i drejtpërdrejtë, është raport i tërthortë, meqë mes tekstit të ri dhe mitit, qëndron folklori. Bota e zanave, orëve, kuçedrave e dragonjve, është një botë që vjen në shprehje në ëndërrat e Omer Hutës, e që burimin e ka në kujtesën e tij folklorike.

Romani mbështetet edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit që vjen në shprehje, sidomos, në kronotopin e pjesës së parë dhe të tretë të veprës. Kështu, këtu gjejmë rolin e dhomës së burrave, rolin e bajraktarit dhe gatishmërinë e tij që ta ruajë flamurin me armë, në rast nevoje.

Vërehet edhe një formë e dialogut letrar me traditën shqiptare, sado që ky dialog nuk ka as përmasat e as formën e dialogut me letërsinë gojore. Kështu, në botimin e parë të veprës, në pjesën e tretë, përmendet figura e Adhamudhit, që na kujton qëndrimin parodik të Çajupit ndaj këtij personaliteti shqiptar të kohës dhe dramën e tij “Pas vdekjes”. Epilogu i veprës me temën e fatalitetit, gjithsesi aludon në personazhet e veprës së Migjenit.

Vepra mbështetet edhe në Biblën, si burim shumë frytdhënës dhe si hipotekst universal letrar, gjegjësisht në “Këngën e këngëve”. Autori shprehet: “*Dashuria*

¹³ Todi, Dhama, *Lufta e Peloponezit (parathënie)*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 5.

është më e fortë se vdekja, thuhet në Këngën e Këngëve".¹⁴ Raporti i vendosur me paratekstin biblik është i markuar, meqë në të zbulohet burimi dhe është i formës së parafrazimit.

Një temë tjetër joshëse që inicon romani në fjalë, por që kërkon një qasje në vete është edhe raporti ndaj *tjetrit*, raport ky që në studimet e sotme krahasimtare letrare, përkatësisht në fushën e imalogogjisë, tërheq vëmendjen e studiuesve. Romani "Një sagë e vogël" ofron mundësi të qasjes imalogogjike, në të cilën *tjetri* që është objekt shqyrtimi, mund të vrojtohet, në radhë të parë si *tjetër brenda vetes*, ashtu siç mund të vrojtohet edhe si *tjetër ideologjik* ose si *tjetër gjinor*. Sigurit, kjo mund të jetë një temë në vete, që kërkon edhe një qasje më serioze.

Përfundimi

Botimi i romanit "*Një sagë e vogël*" të Besnik Mustafajt nga shtëpia botuese "Rezna", pos cilësisë më të mirë teknike krahasuar me botimin e parë të v.1995 (Tiranë: Arbri), paraqet, në të vërtetë botim të një versioni të ri të veprës, që karakterizohet me intervenime, që nuk janë të pakta. Intervenimet e tilla, që kryesisht janë të natyrës së inkorporimit, nuk ndryshojë semantostukturën e veprës por, gjithsesi, janë intervenime të natyrës stilistikore, që ndikojnë në poetikën e saj, sado që mesazhet që përcillen mbeten, me pak përjashtime, të pandryshueshme. Romani "Një sagë e vogël" i tejkalon kufijtë e titullit që mban, meqë nga një sagë e vogël familjare, ngrihet në një sagë të madhe kombëtare.

¹⁴ Besnik, Mustafaj, *Një sagë e vogël*, Rezna, Tetovë, 2016, f. 83.

Literatura

1. Améry, Jean, “Kufijtë e intelektit”, Tiranë: Saras, 13, maj 2016.
2. Barthes, Roland, *Aventura semiologjike* (përkth. R. Ismajli), Prishtinë: Rilinda, 1987.
3. Dhama, Todi, *Lufta e Peloponezit (parathënie)*, Prishtinë: Rilindja, 1988.
4. Eco, Umberto, *Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, Tiranë: Dituria, 2007.
5. Mustafaj, Besnik, *Një sagë e vogël*, Tiranë: Arbri, 1995.
6. Mustafaj, Besnik, *Një sagë e vogël*, Tetovë: Rezna, 2016.
7. Kristeva, Julia, *Desire in Language: A Semiotic Approach to Literature and Art*, New York: Columbia University Press, 1980.
8. Riffaterre, Michael, *Semiotics of Poetry*, Bloomington and London: Indiana University Press, 1978.
9. Smith Herrnstein, Barbara, *Contegencies of Value: Alternative Perspectives for Critical Theory*, Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1988.

ISAMEDIN AZIZI

BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMITETIT TË KOSOVËS DHE KOMITETIT MAQEDONAS 1918-1920

Realiteti i ri gjeopolitik në Ballkan i krijuar pas luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, në dukje ishte i qëndrueshëm, por në thelb ishte një gjenerator i konflikteve luftarake në regjion gjatë gjithë shekullit XX. Si rrjedhojë e marrëveshjeve paqësore (asaj të Londrës, Bukureshtit dhe Parisit), faktori ndërkombëtar kishte vendosur për krijimin e shteteve të reja në Ballkan duke mos i respektuar parimet bazë, si parimet etnike, gjeografike dhe ekonomike e këtyre shteteve. Vendimet e faktorit ndërkombëtar rezultuan nga kompromiset gjeostrategjike¹ të palëve brenda këtij faktori. Si rezultat i këtij realitetit të ri në Ballkan, filluan lëvizjet për krijimin e një afërsie ndërmjet komiteteve revolucionare shqiptare dhe atyre maqedonase, edhe pse kontakte ndërmjet tyre kishte pasur edhe më herët, por jo të këtyre përmasave. Dimensionet e këtyre relacioneve gjatë periudhës 1919-1924 determinoheshin nga politikat reciproke dhe interesat strategjike kundër politikës serbomadhe si dhe kundër faktorëve të jashtëm, interesa këto të cilët ishin të ndërlidhura në Ballkan².

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u gjet në një udhëkryq të rrezikshëm sepse rreziku nga ndarja ishte më i shprehur se kurrë. Brenda një situatë të këtillë, Lëvizja Kombëtare doli më e pjekur politikisht duke kapërcyer pengesat që e përcollën deri në shpalljen e pavarësisë dhe pas saj. Kjo pjekuri politike del në pah edhe përmes veprimtarisë së veçantë që zhvilloi komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”³ nga fundi i vitit 1918. Ky komitet përfaqësonte një nga organizatat më të rëndësishme në Shqipëri në vitet 1918-1920.⁴ Në udhëheqjen e këtij komiteti

¹ Лубен Лапе, *Одбрани текстови за историјата на Македонскиот народ*, II дело, Трето дополнето и проширено издание, Универзитет Кирил и Методиј-Скопје, Скопје 1976, 801-804; Андреј Митровић, *Југославија на коференцији мира 1919-1920*, Београд 1969, 130-157.

² Shukri Rahimi, *Një elaborat i konsullit serb në Korçë mbi aktivitetin kultural të patriotëve shqiptarë brenda dha jashtë atdheut*, Arkivi i Kosovës-Arhiv Kosova, Vjetar-Godisnjak, IV-V, Prishtinë 1971, 339

³ Lush Culaj, *Programet, regullorja dhe organizimi i Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”* në vitin 1918-1920, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike, 25-1995, Prishtinë 1997, 176.

⁴ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë, 1992, f. 97, Z. Shtylla, Rreth krijimit të veprimtarisë së komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” në vitet 1918-1920. *Studime Historike, nr.3, Tiranë 1986, f.101.*

vepronin veprimtarë të shquar për çështjen kombëtare si, Kadri Prishtina (Hoxhë Kadriu) - kryetar, Hasan Prishtina që njihej si udhëheqësi ideologjik, politik e ushtarak i komitetit, Bajram Curri e të tjerë.⁵ Programi themeltar i komitetit përbëhej prej tri pikash: “*me u përpjekë para Fuqive të Mëdha të Antantës dhe me kërkue bashkimin e krahinave të Kosovës (këtu kihet parasysh të gjitha territoret me popullsi shqiptare të pushtuara nga forcat serbo-malazeze në vitin 1912) me Shqipërinë e lirë e veturdhënuese; “me protestue para fuqive të Mëdha të Antantës kundër mizorinave sllave ndër krahinat e Kosovës; dhe me zgjedh e me çue një delegacion për me i mbrojt me fitim dy pikat e sipërpërmendura para botës zyrtare e jashtëzyrtare”.*⁶

Në periudhën e pas luftërave të lartpërmendura, në gjendje të njëjtë, mbase edhe më të rëndë, u gjet edhe populli maqedonas. Për shkak se dy popujt ndanin fatin e njëjtë dhe po të dy popujt ishin nën pushtimin e po të njëjtit shtet, bashkëpunimi ndërmjet tyre ishte më se i domosdoshëm. Në një situatë të këtillë, në fillim të vitit 1919, bashkëpunimi ndërmjet komiteteve shqiptare dhe atyre maqedonase u ngrit në një nivel më të lartë, në atë të një lufte të organizuar kundër armikut të përbashkët. Në këtë kohë, raportet ndërmjet tyre lëkundeshin varësisht nga trazirat e brendshme politike në Shqipëri dhe në Bullgari, si dhe nga pozicioni ndërkombëtar i këtyre dy shteteve.

Nga faktorët e jashtëm, përveç Bullgarisë, rol të rëndësishëm në afrimin e lëvizjeve revolucionare shqiptare me ato maqedonase ka luajtur edhe diplomacia italiane.⁷ Politikën e saj të jashtme lidhur me ndikimin në Ballkan, Italia e orientonte nëpërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë. Duke e konsideruar Mbretërinë e SKS-së si rivalin e saj kryesor për sundim në Adriatik e në Ballkan, Roma synonte të pengonte procesin e konsolidimit të kësaj mbretërie. Për këtë qëllim, Roma ishte e interesuar që të shkaktojë konflikte të brendshme, duke përkrahur elementet separatiste në Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Slloveni dhe në Mal të Zi, nëpërmjet financimit të gazetave. Në morinë e këtyre masave nuk përjashtohet edhe përpjekja e Romës për ta shtënë në dorë, në mos të gjithë udhëheqjen e VMRO-së, të paktën disa nga përfaqësuesit kryesorë të kësaj organizate e sidomos Petar Çaulevin, i cili disa herë kishte qëndruar në Shqipëri dhe në Itali.⁸ Sipas burimeve jugosllave,⁹ që nga fillimi i gjysmës së parë të vitit 1919, Italia vazhdimisht ka përkrahur dhe ka ndihmuar “Komitetin shqiptaro-maqedonas” në Stamboll, si dhe disa “shoqëri tjera shqiptare” në Sofje.¹⁰ Italia e udhëhequr nga ideja për një veprimtari të përbashkët

⁵ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942), (Kujtime dhe vlersime historike)*, Tiranë 1995, f. 111

⁶ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë, 1992, f. 97, AQSH, Fondi 846, dosja 1, viti 1918, f. 1.

⁷ Halim Purellku, *Relacionet midis komiteteve shqiptare dhe komiteteve maqedonase 1919-1924, Jehona e Re*, 5/2006, f. 106.

⁸ Arhiv Jugosllavije-Beograd, Fond 334, Ministarstvo Inostranih Poslova, fasikla br. 6, jedinica br. 21.

⁹ Nën termin “burime jugosllave” mendohet në burime serbe të kohës së Mbretërisë SKS-së.

¹⁰ Paskal MILO, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë, 1992, faq. 266.

të armatosur, veprimtarinë e Komitetit Maqedonas e ndihmon rreth furnizimit me armatim dhe bartjes së udhëheqësve të dalluar të këtij komiteti për në Shqipëri.¹¹ Në telegramin e përfaqësuesit të delegacionit italian në Paris, z. Bonini, derguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, me 10 gusht 1920, ndër të tjera thuhej: *Korespondenti i gazetës "Journal de débats" nga Beogradi, paralajmëron për një marrëveshje ndërmjet Basri beut dhe përfaqësuesve të Komitetit Revolucionar Maqedonas. Aleanca kundër Jugosllavisë është e inspiruar nga agjentët italian, të cilët shpresojnë se me sulmet në kufirin shqiptar-jugosllav do të arrihet qëllimi i dyanshëm: e para të tërhiqet një pjesë e ushtrisë jugosllave e koncentruar në Kroaci dhe e dyta të kenë motiv për të kërkuar të drejtën e deklarimit të popullit për referendum në regionin e Prizrenit, Dibrës dhe Ohrit.*¹²

Gjatë viteve 1919-1920, brenda komiteteve shqiptare, sidomos të udhëheqësia e Komitetit të Kosovës, mbisundonte mendimi për një kryengritje të përgjithshme të armatosur kundër shtetit të ri, Mbretërisë së SKS-së. Kjo kryengritje sipas tyre duhej të ndodhte në një kohe të përshtatshme, derisa Serbia ende ishte e dobët dhe nuk do të ishte në gjendje t'i kundërshtojë.¹³ Çetat e armatosura shqiptare kishin për qëllim që nëpërmjet aksioneve të armatosura të krijojnë vatra të luftës, e me këtë, jo vetëm të largojnë forcat serbe nga territoret shqiptare, po edhe të internacionalizojnë kauzën shqiptare, e nëse do të ishte e mundur, edhe t'i detyrojnë faktorët e jashtëm të ndërhyjnë në këtë situatë.¹⁴

Përveç çetave të armatosura shqiptare, sipas burimeve serbo- jugosllave,¹⁵ nga viti 1919 në Maqedoninë e Vardarit janë organizuar dhe kanë vepruar disa çeta të armatosura të komiteteve të ndara në grupe. Ata kishin për qëllim që gjatë muajit mars të vitit 1919, të shkaktojnë revoltë ose kryengritje kundër regjimit jugosllav në këtë pjesë, me qëllim që të krijohet opinioni para Konferencës Paqësore të Parisit se popullata maqedonase ishte e pakënaqur me regjimin e ri serb. Pikërisht për këtë arsye, në pranverën e vitit 1919, udhëheqësit e Lëvizjes Revolucionare Maqedonase kishin përgatitur një plan operativ strategjik për veprime të armatosura të çetave komite në Maqedoni.¹⁶ Sipas këtij plani parashihej që çetat komite të fillojnë aksione në Krushevë, të cilat do të përhapeshin në Ohër, Kërçovë dhe Gostivar. Këtyre çetave do t'u bashkëngjitej e tërë popullata e kësaj ane, me qëllim që të çlirohej e tërë Maqedonia Perëndimore, e më këtë edhe do të vendoseshin kontakte të drejtpërdrejta me Shqipërinë e nëpërmjet asaj edhe me Italinë.

¹¹ *Италијански дипломатски документи за Македонија 1918-1924*, Том I, Книга 1, (Избор, редакција и коментар: д-р. Иван КАТАРЦИЈЕВ и Аленка ЈАПЕ), Скопје 2001. стр.161

¹² *Италијански дипломатски документи.....* 139.

¹³ Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë (1919-1928)*, Prishtinë 1981, 91-93.

¹⁴ Halim Purellku, *Relacionet midis komiteteve shqiptare dhe komiteteve maqedonase ...*, 109.

¹⁵ Архив на Институтот за Национална Историја, Скопје (АИНИ) Фонд, Трета Армска Област, (ТАО), Београд-Скопје, 2.03.1919, Телеграма 5208, из Београда-Скопје.

¹⁶ Архив Jugosllavije-Beograd, fond 388, Poslanstvo Kraljevine Jugosllavije u Francuskoj-Pariz, fasikle br. 6/7.

Realizimi i këtij plani do të mbështetej në ndihmën dhe përkrahjen e Italisë, e cila insistonte në veprimtarinë e përbashkët të komiteteve revolucionare shqiptare dhe maqedonase.¹⁷

Në funksion të realizimit të idesë për një kryengritje të përbashkët shqiptaro-maqedonase, u zhvilluan bisedime ndërmjet faktorëve politik shqiptarë dhe atyre maqedonas, për arritjen e një marrëveshje politike. Sipas kësaj marrëveshjeje, në rend të parë do të duhej të definohehin pretendimet territoriale, gjegjësisht të shënohej vija kufitare ndërmjet dy anëve pas aneksimit të këtyre territoreve nga ana e Serbisë në vitin 1913, e cila paraqet dimensionin bazë të besimit dhe të përkrahjes së ndërsjellë.¹⁸ Sipas këtij dokumenti thuhet se *“bisedat janë zhvilluar ndërmjet përfaqësuesve për Maqedoni Autonome dhe përfaqësuesve shqiptare për veprim të përbashkët. Të dy palët janë dakorduar për gjitha çështjet, në përjashtim të çështjes për statusin e Dibrës dhe Ohrit, që kanë ngelur si çështje të hapura”*.¹⁹

Se ishte planifikuar një kryengritje e përbashkët e armatosur kundër Mbretërisë së SKS-së e udhëhequr nga Komiteti i Kosovës në fillim të vitin 1919, krahas bisedave politike, flasin edhe të dhënat e korrespondencën ndërmjet Bajram Currit dhe Aleksandar Protogerovit, ku ky i fundit i drejtohet me një shkresë Bajram Currit, si në vijim: *“Zotëri kolonel, do të jeni si gjithmonë luftëtari i parë, udhëheqës dhe këshilltar për luftën të cilën do ta ndërmarrim për çlirimin e Kosovës dhe Maqedonisë”*.²⁰ Në vazhden e bashkëpunimit shqiptaro-maqedonas, në janar-shkurt të vitit 1919, Todor Dimitrovi,²¹ së bashku me 5-6 komitë maqedonas, nisen nga Sofja për në Shqipëri për t’u takuar me Kalosh Danin nga Zajazi i Kërçovës, i shoqëruar me vëllezërit Gjorgji dhe Mihajlo Mugjevci, komitë nga fshati Capar, për të biseduar rreth organizimit të përbashkët.²² Osman Mustafa nga fshati Jellovjane i Tetovës, anëtar i lartë i “Klubit shqiptaro-bullgar” nga Sofja dhe njeri i afërt me Aleksandar Protogerovin, në maj të po të njëjtit vit dërgohet nga Sofja për në Shqipëri për t’u takuar me Dervish Himën dhe Jashar Erebarën, për t’u angazhuar rreth fillimit të përgatitjeve për kryengritjen e përbashkët ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve në pjesën e Maqedonisë së Vardarit.²³ Në fillim të vitit 1919, Kërste nga Dibra (nuk jepen të dhëna tjera për këtë person), së bashku me Todor Dimitrovin, me anije italiane nisen nga Burgasi i Bullgarisë për në Durrës, prej nga pastaj shkojnë në Ohër për t’u takuar me disa udhëheqës shqiptarë.²⁴ Bisedimet për kryengritjen e përbashkët kanë vazhduar edhe në pjesën

¹⁷ *Италијански дипломатски документи за Македонија 1918-1924*, Том I, Книга 1, Скопје 2001.

¹⁸ АИНИ, Скопје, Ф. ТАО, Инв. бр. 1205, Београд, Лубен Лапе...стр.875

¹⁹ Njëjtë. Sipas gjitha gjasash ky dokument interpreton marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Komitetit të Kosovës dhe Komiteteve Maqedonase në vitin 1921.

²⁰ Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare e demokratike shqiptare 1908-1933*, Prishtinë, 1990, 231

²¹ Todor Dimitrovi është anëtarë i lartë i Komitetit Qendror të VMRO-së.

²² Halim Purellku, *Relacionet midis komiteteve ...*, 112.

²³ Државен архив на Република Македонија, Скопје (натаму ДАРМ), микрофилм 341, телеграма од Софија за Скопје, 26-27.05.1919, бр. 3165

²⁴ АИНИ, Скопје, Ф. ТАО, Инв.бр.1593, 24.03.1919, Београд

e dytë të vitit 1919. Sipas burimeve të njëjta, në tetor të po të këtij viti, Irfan Olloman Beu (Irfan Ohri) ka zhvilluar bisedime në Elbasan me përfaqësuesit e Komitetit Maqedonas për veprime të përbashkëta shqiptaro-maqedonase kundër Mbretërisë së SKS-së.²⁵ Të gjitha këto të dhëna flasin për seriozitetin dhe gatishmërinë e këtyre dy organizatave revolucionare për një veprimtari të përbashkët kundër shtetit të ri të krijuar në Ballkan.

Në kohën kur kontaktet ndërmjet këtyre dy organizatave revolucionare ishin forcuar, qëllimi kryesor i të cilit ishte kryengritja e përbashkët, nën presionin dhe kërcënimin e fuqishëm të Beogradit për intervenim ushtarak në zonat kufitare me Bullgarinë, zona ku kryesisht vepronin çetat komite maqedonase, qeveria e Sofjes ishte e detyruar që të kërkojë nga çetat komite maqedonase që përkohësisht t'i pushojnë të gjitha aktivitetet ushtarake në këtë zonë.

Si rrjedhojë e rrethanave të krijuara, në një kohë kur edhe zhvilloheshin bisedimet në Konferencë Paqësore të Parisit e cila ngjalli shpresat, sidomos te një pjesë e anëtarëve të komitetit maqedonas, për mundësinë e shfrytëzimit të së drejtës për “vetëvendosje” të proklamuar nga ana e presidentit amerikan, Wilson, si dhe për shkak të mospërgatitjes nga të dyja palët për një kryengritje mirë të organizuar, gjatë vitit 1918-1919 nuk erdhi deri te një kryengritje e përbashkët shqiptaro-maqedonase.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Nejit,²⁶ formalisht dhe juridikisht i jepet fund iluzioneve që kishte Sofja, udhëheqësve të VMRO-së dhe të komiteteve të tjera maqedonase për mundësinë e bashkimit të Maqedonisë së Vardarit me Bullgarinë. Pas një vendimi të tillë, vjen deri te ndryshimi i kursit politik të VMRO-së në raport me statusin juridik të Maqedonisë. Në takimin e fshehtë të Komitetit Qendror të VMRO-së, mbajtur me 20 dhjetor 1919 në Sofje, qe vendosur për një qëndrim dhe organizim të ri të një lufte të armatosur kundër pushtetit serb

²⁵ Arhiv Jugosllavije-Beograd, Fond 334, Ministarstvo Inostranih Poslova, fasikla br. 6, jedinica br. 21

²⁶ Kjo marrëveshje është nënshkruar me 27 nëntor të vitit 1919, në Nej, paralagje e Parisit, ndërmjet vendeve të Antantës, si fitues në Luftën e Parë Botërore në njërin anë, dhe Bullgarisë, si shtet humbës në këtë luftë nga ana tjetër. Sipas kësaj marrëveshjeje Bullgaria, si shtet humbës i kësaj lufte, ishte e detyruar të dorëzojë disa pjesë të territorit të cilat i zotëronte para fillimit të luftës. Pjesa më e madhe e territorit të humbur ishte ajo e pjesës së Thrakisë Perëndimore (që në fillim u administrua nga Antanta, e më vonë i kaloi Greqisë), territoret rreth Caribrodrit, Bosilegradit dhe Strumicës të cilat tani do t'i takojnë Mbretërisë së SKS-së si dhe pjesa e Dobruxhës Jugore e cila do t'i takojë Rumanisë. Sipas kësaj marrëveshjeje, Bullgaria detyrohet ta pranojë edhe formalisht ekzistimin e Mbretërisë së SKS-së. Me këtë rast, reduktohet forca ushtarake e Bullgarisë 20 mijë ushtarë si dhe armatimi i kësaj ushtrie. Çdoherë sipas kësaj marrëveshjeje, Bullgaria obligohet të paguajë dëme lufte në vlerë prej 2,25 miliarda franga ari, gjegjësisht 445 milion dollarë. Më vonë Bullgarisë i falen tri të katërtat e këtyre obligimeve. Gjithashtu, një obligim tjetër për Bullgarinë nënkupton që shteteve fqinje t'u kthejë arkivat, pikurat dhe gjësendet tjera me vlerë që ishim marrë nga administrata Bullgare gjatë Luftës së Parë Botërore nga këto vende.

dhe atij grek, me të vetmin qëllim për realizimin e idesë për një “Maqedoni Autonome”. Në fillim të vitit 1920, një numër i konsiderueshëm i çetave komite ishin transferuar në Maqedoninë e Vardarit dhe në Shqipëri, në veçanti në regjionin e Ohrit, për të filluar me veprime të përbashkëta me kaçakët shqiptarë. Shembull për një bashkëpunim ndërmjet komitëve maqedonas dhe kaçakëve shqiptarë ishte ai i udhëheqësit Stefan Allabakov-Hoxha nga Struga dhe çetës së Kalosh Danit në maj të vitit 1920. Kishte edhe raste kur në kuadër të çetave komite apo të atyre kaçake kishte përfaqësues nga të dyja palët.²⁷ Për të siguruar përkrahje materiale dhe morale për një Maqedoni Autonome, VMRO-ja autonomiste ndërmerr një ofensivë të fuqishme diplomatike. Sipas burimeve jugosllave, në mars të vitit 1920, përfaqësuesit e kësaj organizate vizitojnë misionet diplomatike në Romë, Vjenë dhe në Sofje. Në prill të po këtij viti, Todor Aleksandrovi ilegalisht viziton Italinë për të “marrë ndihmë materiale për financimin e komitëve”.²⁸ Sipas burimeve të njëjta, ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë italiane dhe përfaqësuesve të VMRO-së arrihet marrëveshja e parë diplomatike dhe ushtarake, sipas së cilës do të mundësohej transporti nga limanet italiane i materialit ushtarak dhe i komitëve maqedonas nëpërmjet Shqipërisë për në pjesën e Maqedonisë së Vardarit. Krahas bisedimeve në Romë, Aleksandar Protogegovi, njeriu i dytë i hierarkisë së VMRO-së, viziton Vjenën dhe Budapestin, me përfaqësuesit e të cilëve dakordohet që të hapen përfaqësi në vendet e tyre për përkrahje materiale dhe për krijimin e korridoreve ilegale për në Maqedoni për anëtarë të VMRO-së.²⁹

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet komiteteve shqiptare dhe maqedonase, do të shtojmë edhe angazhimin e “Komitetit shqiptaro-maqedonas” nga Stambolli, i cili në shkurt të vitit 1920 dërgon në Sofje katër vojvodë shqiptarë (emrat e të cilëve nuk përmenden) nga Pogradeci, Dibra, Janina dhe Elbasani, për të biseduar me Komitetin Qendror Maqedonas rreth punëve shqiptaro-maqedonase.³⁰ Për shkak të mungesës së informacioneve të mëtutjeshme, mendojmë se këto bisedime nuk kishin dhënë ndonjë rezultat konkret.

Aspirata e organizatave revolucionare politike maqedonase për të vendosur kontakte të drejtpërdrejta me organizatat revolucionare shqiptare lidhej me qëllimin e kësaj organizate për të vendosur kontakte të drejtpërdrejta edhe me Qeverinë e Tiranës, me qëllimi që në Shqipëri, respektivisht në Elbasan, të hapet një përfaqësi e tyre, apo me drejt “selia perëndimore e VMRO-së”.³¹ Nga ana tjetër, edhe Qeveria e Tiranës nëpërmjet përfaqësuesve të saj ishte interesuar për të vendosur kontakte rreth bashkëpunimit me përfaqësuesit e Komitetit Maqedonas. Sipas historiografisë bullgare, me ndihmën e Italisë dhe Austrisë, në fillim të muajit maj

²⁷ Halim Purellku, *Relacionet midis komiteteve ...*, 115.

²⁸ Државен архив на Република Македонија, Скопје (ДАРМ), мф. 344, Скопје 5.06.1920.

²⁹ Д-р. Димитар Госев, д-р. Стојан Германов, *Македонија, Историја и политичка средба (1912-1941)*, Том II, Софија 1998.

³⁰ ДАРМ, Скопје, Ф. ТАО, мф.... 344.

³¹ *Италијански дипломатски документи за Македонија 1918-1924*, Том I, Книга 1, (Избор, редакција и коментар: д-р. Иван КАТАРЦИЈЕВ и Аленка ЈАПЕ), Скопје 2001. стр.156

të vitit 1920, arrihet marrëveshje ndërmjet Aleksandar Protogerovit, anëtar i lartë i KQ të VMRO-së dhe qeverisë shqiptare,³² sipas së cilës është dakorduar që Qeveria e Tiranës të lejojë hapjen e përfaqësisë të VMRO-së në Tiranë dhe në Elbasan, si dhe formimin e punkteve (bazave) logjistike në regjionin afër kufirit me Maqedoninë, përkatësisht në Strugë, Pogradec dhe në Korçë, të cilët do të shërbenin për transferimin e komitëve maqedonas në pjesën e Maqedonisë së Vardarit.³³

Burimet e vjela nga Arkivi i Maqedonisë, dëshmojnë se në gjysmën e parë të vitit 1920, aktivitetet për organizimin e një kryengritjeje antiserbe në mesin e komiteteve shqiptare ishin të fuqishme ku si organizatorë kryesorë në pjesën e Maqedonisë së Vardarit përmenden Abdulla Bojku dhe Kalosh Lazam Dani.³⁴ Sipas burimeve të njëjta, në qershor të vitit 1920, Azem Bejta udhëton në Bullgari për t'u dakorduar me "Komitetin Bullgar" për veprime të përbashkëta me çetat komite. Në mesin e gushtit të po këtij viti, të njëjtat burime na bëjnë të ditur se një personalitet i rëndësishëm i Komitetit të Kosovës i lindur në Prishtinë,³⁵ ka qëndruar në Sofje me mision të veçantë.³⁶ Është kërkuar nga Komiteti Revolucionar Maqedonas që urgjentisht të organizojë një kryengritje në pjesën lindore të Maqedonisë së Vardarit kundër pushtetit serb, me të vetmin qëllim që të zgjerohet kryengritja dhe të lehtësohet pesha e kryengritjes e cila tanimë kishte filluar në Dibër në gusht-shtator të vitit 1920. Mirëpo, anëtarët e Komitetit Maqedonas kishin refuzuar një kërkesë të tillë të përfaqësuesve të Komitetit të Kosovës për zgjerimin e kësaj kryengritjeje edhe në pjesën lindore të Maqedonisë, por kishin premtuar se do të përkrahnin kryengritjen duke ndërmarrë disa aksione të vogla diversante të çetave komite në prapavijën e ushtrisë jugosllave me qëllim që të tërhiqej vëmendja e kësaj ushtrie edhe në pjesën tjetër të Maqedonisë.³⁷ Një vendim i tillë i Komitetit Maqedonas mbështetet në vendimin e marrë nga KQ i VMRO-së Autonomiste në qershor të vitit 1920, sipas të cilit ishte vendosur që VMRO-ja të tërhiqej nga metodat dhe veprimet e saja revolucionare, dhe të kalojë në një qasje legale të veprimtarisë të saj. Këtë veprim të Komitetit Maqedonas na e vërteton edhe raporti i përfaqësuesit italian në Berlin, z. XH. De Martino, në telegramin dërguar ministrit të punëve të jashtme të Italisë, grofit Sforca, për takimin me doktor Dimitar Toçkov, anëtar i lartë i Komitetit Qendror Revolucionar Maqedonas, me 21 tetor 1920, ku ndër të tjera thuhet: *gjatë vizitës të z. Toçkov u informove se organizata e tij mendon se momenti aktual nuk është në favor të lëvizjeve revolucionare, prandaj aktiviteti i së njëjtës është i orientuar në drejtim të "vetvendosjes", dhe se organizata e tij mund të kufizohet vetëm në drejtim të përforcimit të raporteve me Shqipërinë.* Më tutje, De Martino vazhdon: z. Toçkov

³² Д-р. Димитар Госев, д-р. Стојан Германов, *Македонија, Историја и...* 94.

³³ *Италијански дипломатски документи за Македонија 1918-1924,* 156.

³⁴ Државен Архив на Република Македонија (ДАРМ), микрофилм бр. 342

³⁵ Emri i këtij personaliteti nuk përmendet, por ne besojmë se bëhet fjalë për Hasan Prishtinën.

³⁶ ДАРМ, мф.... 344

³⁷ Архив на Институтот за Национална Историја (АИНИ), Скопје, Фонд. Трета Армиска Област (ТАО), Ред. бр. 5830, инв. бр. 515

*thotë se, maqedonasit do të jenë shumë të përshtatshëm për Italinë nëse organizohen në Shqipëri. Z. Toçkov nuk pajtohet me politikën e qeverisë aktuale bullgare e cila është e prirë për të nënshkruar marrëveshje me Qeverinë e Beogradit. Mes tjerash z. Toçkov mendon se nuk duhet kursyer kohë dhe mjete për t'u penguar Jugosllavija që të sundon me Ballkanin.*³⁸

Edhe përkundër vendimit për fillimin e një kryengritje të përbashkët të popujve joserbë që jetonin në kuadër të kësaj mbretërie kundër këtij pushteti, të sjellë nga ana e përfaqësuesve të lëvizjeve çlirimtare në Mbretërinë e SKS-së në gusht të vitit 1920 në Romë, një gjë e tillë nuk ndodhi.

Megjithatë, te popullata shqiptare vazhdon rezistenca kundër këtij regjimi. Në vitet e 20-ta, forma më e theksuar e kësaj rezistence ishte organizimi i çetave të armatosura, organizim ky i cili herë pas here arrinte edhe në shkallën e një lëvizjeje kombëtare. Duke luftuar për çlirim dhe bashkim kombëtar, të udhëhequr nga Komiteti i Kosovës, kryengritësit shqiptarë njëkohësisht luftonin edhe kundër gjenocidit serb, kundër reformave agrare si dhe kundër kolonizimit serb.³⁹ Të vetmit ishin shqiptarët, ata të cilët në këtë kohë kapën armët dhe organizuan kryengritje kundër ushtrisë jugosllave, kryengritje kjo e cila shumë shpejt edhe u shua nga forcat shumëfish më të mëdha serbe.

³⁸ *Италијански дипломатски документи....*143.

³⁹ Marenglen Verli, *Shqipëria dhe Kosova - Histori e një aspirate*, Tiranë 2007, f. 254.

NELSON R.ÇABEJ

KOMBI SHQIPTAR DHE FANTAZMA E “KOMBIT KOSOVAR”

Sot Europa dhe shumë vende të tjera të botës përjetojnë ngritjen historike të një vale të re nacionalizmi, me gjithë trysinë e fortë të liberalizmit mbikombëtar dhe doktrinës së globalizmit, e madje si reaksion ndaj tyre. Kjo dhe ideja e hedhur kohët e fundit për ekzistencën e një kombi “të ri” kosovar, na shtyn të rikujtojmë prejardhjen dhe natyrën e kombit shqiptar në veçanti.

Kombi shqiptar, si çdo komb tjetër, karakterizohet nga një gjuhë kombëtare që është shqipja. Kosovaret si çdo krahinë tjetër e trojeve shqiptare, flasin një dialekt/nëndialekt të shqipes. Duke lënë mënjanë absurditetet jashtëshkencore të shprehura në ndonjë vend fqinj, në më se 3 shekuj të studimit të gjuhës shqipe, asnjë gjuhëtar nuk i ka shkuar ndërmend se mund të ekzistojë një gjuhë e veçantë kosovare.

Prejardhja dhe natyra e kombit

Kombet e sotme i përkasin dy tipave themelore, kombit etnik dhe atij civil.

Kombi etnik, është bashkësi njerëzish që lidhen midis tyre nga gjuha, historia, territori, kultura e përbashkët dhe ndjenja e përkatësisë në këtë bashkësi, kundrejt çdo bashkësie tjetër njerëzore.

Ndryshe nga kombet etnike, kombet civile janë krijesa politike, të formuara të shumtën e herëve me forcën e një shteti të centralizuar, shumë herë të kontrolluar nga një etni qendrore. Kështu, p.sh., Rusia, është një komb civil multi-etnik me një ideologji federative, por me rusët si etni sunduese. Britania e Madhe, gjithashtu, është komb multi-etnik me gjuhë të përbashkët anglishten, ndërsa Franca përbëhet nga bashkësi me prejardhje dhe gjuhë të ndryshme, me frëngjishten si gjuhë e shumicës së popullsisë, por pa një grup etnik sundues. Jugosllavia dhe Çekosllovakia gjithashtu ishin kombe civile, krijesa politike të mbështetura në kushtetutën dhe pushtetin shtetëror, prej të cilave e para me serbët si etni sunduese. Shtetet e Bashkuara, po ashtu si dhe Kanadaja, Australia, vendet e Amerikës Latine, etj., si vende imigrimi dhe “enë të shkrirjes” së etnive të ndryshme, janë gjithashtu kombe civile, pa grupe etnike sunduese. Kombe multi-etnike si Greqia e lidhin kombin e kombësinë jo me prejardhjen dhe historinë e përbashkët, por me përbashkësinë e fesë ortodokse të banorëve të atij vendi.

Për këtë arsye, nuk mund të jepet një përkufizim gjithësor i kombit. Përkufizimet që i jepen kombit në vende të ndryshme janë të ndryshme, sepse synojnë të përputhen me natyrën e kombit në të cilin bën pjesë përkufizuesi.

Duke pasur një themel më solid e homogjen kulturor, gjuhësor e të traditës, kombet etnike janë më të qëndrueshme se sa kombet multietnike me etni sunduese, të cilat, në kushte demokracie dhe të zbatimit të së drejtës së popujve për vetëvendosje, mund të shpërbëhen, siç ndodhi me Rusinë sovjetike dhe Jugosllavinë pas përmbyesjes së sistemeve diktatoriale.

Çdo komb, në mënyrë të natyrshme, zhvillon ndjenjën dhe ideologjinë e tij kombëtare. Koha ka hedhur poshtë përfundimisht konceptin e Marksit rreth kombëtarizmit (nacionalizmit) si një ideologji e gënjeshtërt, që i shërben vetëm klasave sunduese. Thelbërisht, ky shpjegim u ringjall nga studiuesit modernistë e postmodernistë të kombit dhe kombëtarizmit pas luftës së dytë botërore. Por sot, 150 vjet pas parashikimit marksist, kombëtarizmi është i gjallë e në rritje, siç shihet nga shpërbërja e shteteve shumëkombëshe (Rusia sovjetike, Jugosllavia, Çekosllovakia), që u kanë lënë vendin mbi 20 shteteve kombëtare të pavarura. Prirje të forta nacionaliste për pavarësi ose autonomi sot vihen re dhe në pjesë të tjera të Europës (Spanjë, Britani e Madhe, pa folur për lëvizjet e forta autonomiste dhe federaliste në vende të tjera të Europës).

Kombi shqiptar është produkt objektiv dhe mishërim i historisë së shqiptarëve. Ai është një komb tipik etnik. Ashtu si të parët tanë, ne e njëjtësojmë veten si shqiptarë, e quajmë veten shqiptar dhe shprehim solidaritet me shqiptarët e tjerë. Nga historia e sotme e shqiptarëve shprehje monumentale e këtij solidariteti është pritja vëllazërore që shqiptarët e Republikës së Shqipërisë u bënë shqiptarëve të Kosovës gjatë pas pastrimit etnik dhe gjenocidit serb të viteve 1998-1999.

Rrënjët historike të kombit shqiptar

Si shumica e kombeve etnike, kombi shqiptar rrjedh nga një etni (një bashkësi që ka shumë karakteristika të kombit, por i mungon lidhja e brendshme e tij dhe synimi për një shtet të përbashkët) paraardhëse. Të parët tanë ilirë ishin një etni, që njihej si e tillë edhe nga fqinjët e tyre grekë e romakë, e më vonë edhe sllavët.

Ne mund të flasim për një komb arbëror mesjetar në kuptimin që arbërit, si një grup fisesh të Ilirisë së jugut, në Mesjetë filluan ta diferencojnë veten nga ajo pjesë e etnisë ilire, që kishte humbur gjuhën dhe një pjesë të traditave të tyre origjinale në një proces të gjatë të romanizimit dhe, pas shekullit VII, sllavizimit përfundimtar. Ky diferencim nxori për ta edhe nevojën e rinjëjtësimit (riidentifikimit) si një popull i veçantë nga ilirët e sllavizuar. Ata e quajtën veten arbanë/arbër, duke përgjithësuar emrin e një fisi të veçantë të Ilirisë së jugut, të albanëve (Albanoi), që përmendet për herë të parë nga gjeografi aleksandrin Ptolemeu (100-170 të erës sonë).

Përhapja e emrit të një fisi të veçantë për të përshkruar tërësinë e fiseve të një populli është një dukuri e mirënjohur në histori. Kështu emri i helenëve të lashtë doli nga emri i një fisi të vogël në Thesali, kurse nga emri i fisit të lashtë grek *graikoi*, ilirët mesapë përhapën në Europë emrin grek; nga emri i fisit gjerman

të frankëve doli emri i francezëve; nga emri i një grupi emigrantësh suedezë doli emri i rusëve, nga fisi gjerman i anglëve – emri i popullit anglez, etj.

Qysh në shekullin X të erës sonë arbërit përmenden nga perandori bizantin Konstantin Porfirogeneti si një etni e veçantë me një princ të tyre dhe në shekullin XI ata dalin si një forcë e vecantë dhe e tërësuar ushtarake në kuadrin e perandorisë bizantine. Krijimi i Shtetit të Arbrit nga fundi i shekullit XII tregonte se arbitaninë kishin kaluar nga një etni në një komb arbëror, ndonëse shteti i tyre përfshinte vetëm një pjesë të vogël të trojeve të banuara nga arbërit. Por, në dallim të qartë nga shtetet ilire (dardane, epirote, ardiane, taulante, të enkelejve, etj.), që lidheshin me identitetin fisnor e mbifisnor, por jo me tërë etninë iliriane, Shteti i Arbrit dilte me një emër që përfaqësonte tërë popullin arbëror. Edhe krijimi nga Anzhuinët i Mbretërisë së Arbërisë (Regnum Albania) në shekullin XIII, tregon se në atë kohë në Europën perëndimore njihej ekzistenca e kombit arbëror.

Pas një sundimi thuajse 10-shekullor bizantin, nga fillimi i shekullit XV mbretëria (despotati) arbëror i Epirit dhe principata e pavarur e Gjin Zenebishit, si dhe principatat e pavarura anembanë trojeve arbërore, ranë nën sundimin osman. Nga mesi i atij shekulli shqiptarët, nën udhëheqjen e heroit të tyre kombëtar, filluan luftën legjendare, që shpuri në krijimin e shtetit të parë kombëtar arbëror/shqiptar, që për një çerek-shekulli ia doli të prapsë sulmet e vazhdueshme të Perandorisë Osmane, superfuqisë ushtarake të kohës. Shteti i Skënderbeut ishte një shtet etnikisht i pastër arbëror.

Krijimi i një shteti komb, përveç bashkimit të një populli bazuar në gjuhën, historinë dhe kulturën e përbashkët, kërkon detyrimisht edhe krijimin e një miti kombëtar. Pikërisht ky ishte ingrediенти madhor që shtoi Skënderbeu në kompleksin e faktorëve shpirtërorë të kombit shqiptar. Me këtë “mit të të parëve”, ai krijoi forcën shpirtërore të nevojshme për të thyer ideologjinë partikulariste feudale, për të farkëtuar bashkimin e shqiptarëve dhe për të krijuar të parin shtet kombëtar shqiptar në histori.

Skënderbeu, siç del nga fjalimet e tij në veprën e historianit shqiptar Marin Barleti, shfrytëzoi (nëqoftëse nuk krijoi për herë të parë në histori) mitin kombëtar shqiptar për të forcuar vetëdijen kombëtare arbërore. Ai glorifikoi historinë e lavdishme të Piros së Epirit, për t’u kujtuar bashkëatdhetarëve prejardhjen e tyre të lashtë epirote: “Nëqoftëse kronikat tona nuk na gënjejnë – i shkruante ai princit të Tarantos – ne quhemi epirotë” (Se le nostre cronache non mentono, noi ci chiamiamo Epiroti). Ai e quante veten “Princ i epirotëve”, titull me të cilin e njohu dhe Europa perëndimore.

Pa hyrë në revoltat e paprera të popullit tonë gjatë tërë periudhës së sundimit osman, idea e formimit të një shteti kombëtar, autonom/të pavarur, u vu në qendër të programit politik të Rilindjes Kombëtare shqiptare në gjysmen e dytë të shekullit XIX. Falë luftës së armatosur dhe përpjekjeve diplomatike të shqiptarëve kjo ide u bë realitet në vitin 1912 me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Ashtu siç ndodhi kudo në Europë, edhe rilindasit tanë e ruajtën dhe pasuruan mitin kombëtar shqiptar të zhvilluar nga Skënderbeu, duke përfshirë në të edhe historinë e tij të lavdishme. Ata krijuan fenë civile të shqiptarëve, “Shqiptarinë” e Vaso Pashës, që qëndronte mbi dhe ishte e pavarur nga fetë e institucionalizuara

monoteiste. Sot kjo fe e shqiptarëve përfshin shumë simbole si flamuri kombëtar, himni kombëtar, festat kombëtare dhe festat patriotike lokale, monumentet e kulturës dhe historisë kombëtare, varrezat e deshmoreve, ceremonitë përkujtimore për luftëtarët, deshmorët, heronjtë dhe martirët e kombit, mitet kombëtare, praktikat e besimit popullor pagan, mitet, legjendat, vëndet e shënjeta pagane lokale dhe kombëtare, etj.

Kombi shqiptar është i pandashëm

Fjala komb (sinonim i fjalës njeje), është një neologjizmë e rilindasve tanë. Ajo fjalë nuk është thjesht një kalk, d.m.th. përkthim nga ndonjë gjuhë e huaj, por një krijim shumë i goditur. Nga ana kuptimore kjo fjalë është eprore ndaj fjalëve të gjuhëve të tjera, duke përfshirë fjalën *nacion* (nation), që nga latinishtja ka hyrë thajse në të gjitha gjuhët e Europës. Ndërsa fjala *nacion* rrjedh nga emri latin *natio* “lindje, prodhim” (e kjo nga protoindoeuropianishtja **gene* “prodhon, lind”), fjala shqip *komb*, shpreh përsosurisht thelbin e konceptit të kombësisë që është *lidhja* shpirtërore e pjesëtarëve të një kombi.

Kombi, si strukturë shoqërore, lind nga etnia, si një stad më i lartë i evolucionit të saj. Një popull ruan kombësinë dhe ndjenjën e tij kombëtare edhe nën sundimet e huaja, sa kohë që ai vazhdon të flasë gjuhën e tij. Vetë ekzistenca e kombit shqiptar pas 20 shekujsh sundimesh të huaja (romake, bizantine, bullgare, serbe e osmane) është një shëmbull *par excellence* i këtij pohimi.

Ndarja e një populli në dy ose dhe më shumë shtete nuk shpie në formimin e ndonjë kombi tjetër, sa kohë që ai popull ruan gjuhën e tij. Ka mjaft shëmbuj të tjerë etnish dhe kombesh që kanë mbijetuar si kombe të pandarë për shekuj e mijëvjeçarë nën sundime të huaja, pa pasur shtetin e tyre kombëtar. Kështu, p.sh., sot ka 20 deri 30 milion njerëz që flasin gjuhën kurde, të ndarë në katër shtete të ndryshme (Turqi, Irak, Iran e Siri), që i përkasin kombësisë kurde dhe ndjehen kurdë edhe pse gjatë mijra vjetëve të historisë së tyre nuk kanë patur ndonjë shtet plotësisht të pavarur. Vetëm çereku i 2.5 milion baskëve, që jetojnë sot në Spanjë dhe Francë flasin gjuhën e tyre, por ata si komb vazhdojnë përpjekjen e tyre dyshekullore për pavarësi. Ndarja e popullit kurd dhe bask në shtete nuk ka prodhuar e as mund të prodhojë kombe të reja.

Ndarja e Gjermanisë pas luftës së dytë Botërore u bë me një vendim të aleatëve të Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, as ndarja shtetërore (ekonomiko-shoqërore, politike e ushtarake) as sistemet e ndryshme armiqësore, që u vendosën në dy pjesët e Gjermanisë, nuk prodhuan dy kombe. Kombi gjerman mbeti një e i pandarë, siç provoi ribashkimi pa trauma e madje i lehtë i tyre në fillim të viteve 90-të. Për më se 70 vjet kombi korean vazhdon të mbetet i ndarë në dy shtete të pavarura dhe armiqësore, por të dy shtetet koreanë mëtojnë bashkimin e tyre kombëtar.

Kosova banohet nga shqiptarë, të cilëve edhe regjimet diktatoriale të midis dy lufrave botërore, si dhe të Titos e të Millosheviçit, u kanë njohur zyrtarisht kombësinë shqiptare. Banorët e Kosovës, si dhe ata të Shqipërisë, i përkasin kombit shqiptar qysh nga formimi i tij në Mesjetë.

Deklaratat për ekzistencën e një “*kombi kosovar*” në rastin më të mirë janë të paarsyeshme. Por edhe sikur t’i merrnim seriozisht mëtimet e disa publicistëve për “ekzistencën e një kombi kosovar”, pyetja e parë që na vjen në mend është: nga doli ky komb kosovar? Një komb lind nga një etni, por jo nga një komb. Meqë historia nuk njeh ndonjë etni kosovare nga e cila mund të evoluonte një komb kosovar dhe ndarja *natyrale* e një kombi në dy kombe të veçanta është e panjohur në historinë e Europës, ideja befusuese e “kombit kosovar” mbetet në mbretërinë e absurditeteve.

Kombi shqiptar, si çdo komb tjetër, karakterizohet nga një gjuhë kombëtare që është shqipja. Kosovarët si çdo krahinë tjetër e trojeve shqiptare, flasin një dialekt/nëndialekt të shqipes. Duke lënë mënjanë absurditetet jashtëshkencore të shprehura në ndonjë vënd fqinj, në më se 3 shekuj të studimit të gjuhës shqipe, asnjë gjuhëtari nuk i ka shkuar ndërmend se mund të ekzistojë një gjuhë e veçantë kosovare. Jo sot, por edhe një shekull më parë, kur ndryshimet dialektore midis shqiptarëve ishin më të theksuara, një nga studiuesit më të mëdhenj të gjuhës shqipe, indoeuropianisti i madh danez Holger Pedersen (1867-1953) theksonte:

”Ndryshimet midis dy dialekteve të shqipes janë shumë më të vogla se sa ndryshimet dialektore brenda shumicës së gjuhëve të tjera dhe, nga pikëpamja praktike, ato ndryshime janë krejtësisht të papërfillshme”.

Në këto rrethana, përkrahësve të idesë së një kombi kosovar u duhet të stisin një mekanizëm *sui generis* të panjohur deri sot të komb-formimit, ose të shpikin një *Deus ex machina* që do të “mbarste” kombin shqiptar për të prodhuar një komb tjetër.

MILLOVAN GJILLAS

SHQIPTARËT JANË AUTOKTONË DHE POPULLI MË I VJETËR I BALLKANIT

Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar Millovan Gjillas ishte njëri prej disidentëve antikomunist më të nderuar në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropën Perëndimore. Pothuajse të gjitha veprat e tij u përkthyen anglisht dhe u botuan nga shtëpitë më të njohura botuese në Amerikë. Vepra e tij monumentale “*Klasa e Re*” (New Class) u cilësua nga sociologët dhe filozofët amerikanë dhe perëndimorë si libri më antikomunist në botë. Parashikimet dhe shpjegimet e Millovan Gjillasit për rënien e sistemit komunist ishin shumë të qëlluara. Politikani dhe disidenti Millovan Gjillas ishte shkrimtar, filozof, sociolog dhe historian. Gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte qenë një ndër luftëtarët më të njohur antifashist në Jugosllavi. Deri në fund të viteve 40, ai kishte qenë komunist.

Në fillim në viteve 50’ filluan mospajtimet e tij me sistemin komunist të atij vendi. Kundërshtimet e mospajtimeve të tij, Gjillas i shfaqti publikisht në fjalime dhe në botime në kohën kur ishte kryetar i Kuvendit Federativ të Jugosllavisë dhe si pasojë u përjashtua nga të gjitha funksionet politike dhe shtetërore. Pas një gjykimi të ashpër u dërgua në burgun famëkeq të Sremska Mitrovicës, ku gjendej edhe disidenti i famshëm shqiptar Adem Demaçi. Gjatë vizitave në Shtetet e Bashkuara Adem Demaçi tregonte shumë për Millovan Gjillasin. Disidenti ynë Adem Demaçi e ka njohur më mirë se kushdo tjetër këtë disident të famshëm, i cili disa herë kishte qenë në pozitën numër 2 në Jugosllavi pas Josip Broz Titos. Në shumicën e veprave të botuara anglisht në Shtetet e Bashkuara Millovan Gjillas shkruan edhe për shqiptarët. Bile në veprën e tij letrare “*Toka pa Drejtësi*” (Land without Justice) Millovan Gjillas e përshkruan në mënyrë shumë të dhimbshme rënien heroike të Isa Boletinit në Podgoricë, ku kishte marrë pjesë edhe babai i tij. Vepra letrare ku flitet për rënien tragjike dhe heroike të Isës “*Toka pa Drejtësi*” (Land without Justice) u botua anglisht në New York në vitin 1956. Kritika letrare amerikane e cilësoi si veprën më të mirë nga bota komuniste pas “*Donit të Qetë*” të Shollohovit.

Në vitin 1966 Harcourt, Brace & World, Inc. në Neë York, botoi anglisht një vepër të Millovan Gjillasit. Titulli i kësaj vepre voluminoze prej pothuajse 500 faqesh është: “*Njegoshi Poet, Princ dhe Peshkop*”. Në kapitullin e parë “Vendlindja”, M. Gjillas shkruan gjerësisht për vendlindjen e Njegoshit. Ky shkrimtar dhe historian i famshëm në botën perëndimore, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shkruan tekstualisht këto:

“Nuk dihet koha dhe as origjina e klaneve malazeze, të cilat përmenden si komunitete qysh në shekullin XIV ose më parë. Për shkak se ato nuk përmenden

me emër qysh në kohën e dyndjes se sllavëve në Ballkan, në fillim të shekullit VII, kjo nuk do të thotë se origjina e tyre është e mëvonshme. Sllavët e Jugut imigruan në Ballkan në njësi fisnore, pasi u ribashkuan ata u zhdukën krejtësisht nga shoqëria feudale dhe shteti. Në qoftë se fiset malazeze nuk janë një konglomerat imigrantësh sllav e ilir, atëherë siç duket janë klane gjaku–fisësh—shqiptare– që natyrisht janë banorët më të vjetër të Gadishullit ballkanik. Nuk bëjnë këtu përjashtim as rrënjët e Njegoshit që shtrihen thellë në ato klane që jetojnë në Ballkan qysh në kohërat mitologjike të ilirëve dhe sllavëve.

Sidoqoftë, turqit i krijuan fiset në Mal të Zi dhe në pjesët veriore të Shqipërisë. Ishin këto bashkësi fisnore që u futën në konflikte kundër turqve. Lidhje të tilla fisnore kishte edhe në Serbi dhe në Maqedoni, bile edhe në More (Peloponez), veçanërisht në rajonet malore ku Turqia u kishte njohur këtyre fiseve një lloj autonomie. Shqiptarët jetonin për vete. Ata kishin probleme me malazet, por edhe me Vezirin e Shkodrës dhe me Stambollin. Shumë familje serbe, dhe klanet e tyre ishin konvertuar në fenë islame. Kështu kishin bërë edhe disa fise të Shqipërisë Veriore, që e kishin pranuar fenë islame për të ruajtur ose për të fituar pasuri të patundshme ku bënin pjesë tokat dhe pronat të ndryshme. Hoti e kishte ndihmuar disa herë Malin e Zi, sidomos në luftën për çlirimin e Podgoricës nga Turqia. Kryetarët e fiseve shqiptare kishin lidhje me udhëheqësit e fiseve malazeze. Njegoshi kishte deklaruar se shqiptarët nuk janë turq, sepse ata veprojnë ndryshe nga turqit. Kuçi që gjendet afër Shqipërisë e ka të vështirë qarkullimin, bile duhet të shkojë në Kotor për të blerë kripë e mos fol më për nevojat tjera. Në vitin 1613, Veziri i Shkodrës rekrutoi ushtrinë e tij në 7 sanxhakët e Shqipërisë dhe të Malit të Zi, për të shuar kryengritjen antiosmane në Bjellopavliq (Palabardhë) dhe në Pipër. Në këtë rast Turqia kishte kërkuar ndihmë nga Venediku.

Peshkopi Rade i Malit të Zi ishte ndje mirë kur e kishin njoftua se do t'i shkonte në ndihmë prijësi shqiptar i Mirditës Bibë Doda. Mirdita kishte bërë disa herë luftëra të përgjakshme kundër Malit të Zi. Megjithatë, Peshkopi Rade e kishte pritur mirë ndihmën e Bibë Dodës. Një prijës tjetër i Mirditës, Mark Prëkëlleshi kishte vajtur në Cetinë dhe kishte pritur gjatë, për t'u takuar me Njegoshin. Letra që i kishte dhënë Mark Prëkëlleshit ishte shumë e qartë e shkurtër dhe tregonte se miqësia midis këtyre dy krahinave heroike mund të përforcohet. Mirëditë kishte bërë shumë luftëra kundër Malit të Zi, qysh në kohëra që nuk mbahen mend, por më në fund kishte filluar koha e miqësisë. Njegoshi ishte gëzuar shumë për miqësinë me fisin heroik të Mirditës.

Shënim: Këto ishin disa prej shpjegimeve të Millovan Gjillasit për shqiptarët dhe autoktoninë e tyre. Shtojmë se në veprën e tij të njohur “*Bisedime me Stalinin*” (Conversations With Stalin), botuar në New York në fund të viteve 60’ Stalini e kishte pyetur Gjillasin kush janë shqiptarët? Millovan Gjillasi i ishte përgjigjur : “Shqiptarët janë populli më i vjetër në Ballkan, ata janë edhe më të vjetër se grekët”. Bisedimet midis Stalinit e Gjillasit ishin mbajtur në Moskë në vitin 1947. Në një prej fragmenteve në veprën e lartpërmendur M. Gjillas thotë se rrënjët e origjinës së Njegoshit shtrihen në fiset shqiptare. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Malit të Zi mund t’i ishte këshilluar edhe veprat e Millovan Gjillasit për

originën e fiseve shqiptare. Ky dijetar malazez është personaliteti më i nderuar sllavo-ballkanik në Amerikë pas Nikolla Tesllës. Vlen për t'u shënuar se Millovan Gjillas ishte disident antikomunist pro-amerikan, çfarë nuk është e vërtetë për disa të tjerë, ku bën pjesë disidenti i famshëm rus Aleksandar Solzhenitsyn, i cili ishte antikomunist dhe antiamerikan, pavarësisht se ishte strehuar në Shtetet e Bashkuara deri në kohën e rënjes së komunizmit në Bashkimin Sovjetik.

DORIAN KOÇI

IDENTITETI FETAR E KOMBËTAR I SHQIPTARËVE ORTODOKSË TË REKËS

Vilajeti i Manastirit, një nga katër vilajetet që përfshinte popullsi shqiptare në provincën osmane të Rumelisë, është parë gjithnjë si një territor ku identitetet nacionale kanë qenë më të zbehta, krahasuar me vetpërcaktimin dhe identitetet fetare të popullsive që banonin në të.

Si një nga krahinat më të hershme të pushtuara nga osmanët dhe ku në fakt ka pasur një proces kolonizimi me popullsi turke më të lartë se në territoret e tjera [1], sistemi osman i mileteve duket se kishte zënë mirë rrënjë dhe në fund të shekullit të XIX dhe fillimet e shekullit të XX, popullsia e këtyre anëve e kishte më të vështirë përqafimin e nacionalizmit që synonte formimin e identiteteve kombëtare përkundrajt një identiteti osman që imponohej nga lart.

Zakonisht kur studiohet kjo periudhë e historisë shqiptare të elementit shqiptar, uniformiteti fetar i Vilajetit të Manastirit studiohet njëlloj si vilajeti i Prishtinës, ku predominonte me pak përjashtime një lloj uniformiteti mysliman suni.

Kjo gjë ndodh për shkak lidhjeve të mëvonshme të territoreve të banuara nga shqiptarë në ish mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene dhe më vonë në Ish Jugosllavi si një tërësi gjeografike, ndërsa në fakt popullsia shqiptare e Vilajetit të Manastirit reflektonte një larmi tjetër identitësh fetare të ngjashme me vilajetin e Janinës, ku ishin të pranishëm edhe komuniteti bektashi në Tetovë dhe rrethinat e saj dhe komuniteti ortodoks në malësinë e Rekës.

Përthyerja e këtyre identiteteve dhe shkrirja e tyre në identitet kombëtar gjatë fundshekullit të XIX dhe fillim të shekullit të XX përbën një rast studimor të ngjashëm si dhe në territoret shqiptare ku nacionalizmi veproi dhe operoi nëpërmjet të njëjtave mjeteve, ndaj ai nuk mund të merret i shkëputur nga shqiptarizmi edhe pse panosmanizmi pati eksponentë të rëndësishëm nga këto territore.

Identiteti fetar ka luajtur një rol shumë të madh në krijimin e identiteteve kombëtare në Ballkan përgjatë shekullit të XIX. Ai së bashku me nacionalizmin është shfaqur si një nga farkëtuesit kryesorë të identiteteve kombëtare duke ndihmuar në këtë farë mënyre drejtë për së drejti në formimin e shteteve kombëtare.

Ky kontribut i përbashkët i tyre ka sjellë shpesh herë një konfuzion në rolin e tyre duke identifikuar shpesh herë me njëri-tjetrin por dhe në disa raste duke bërë një dallim të qartë midis tyre. Qasja metodologjike afron një mundësi më shumë për të dalluar qartë midis tyre dhe rolin specifik që luajnë në krijimin e kombit. Në literaturën dhe studimet moderne ekzistojnë dy pikëpamje të kundërta mbi

marrëdhëniet e nacionalizmit me besimin fetar, të cilat i shikojnë ato si alternativa të njëra-tjetrës ose të lidhura shumë ngushtë organikisht mes tyre.

Pikëpamja e parë konsiston në faktin sesi krijimi i publikut të masave lexuese të një gjuhe-një rezultat i shtypit dhe kapitalizmit, zëvendësoi përfshirjen aksiomatike të gjuhëve të shkruara në mendjet e njerëzve dhe shkatërroi solidaritetin e Krishterimit, Umanë islamike dhe gjithë solidariteteve të tjerë,[3] ndërsa pikëpamja e dytë sugjeron idenë se besimi fetar luajti një rol kryesor në formimin e kombeve moderne.

Studiuesi Miroslav Hroach e njohu nevojën për lidhjet gjuhësore ose fetare duke bërë të mundur një nivel më të lartë komunikimi brenda grupit dhe përtej tij, në formimin e një kombi modern. Ai argumentoi se identiteti kombëtar ishte më i fortë kur ai mbështetej nga institucione kishtarë dhe shënonte në shumë raste rolin e klerikëve në formimin e grupeve patriotike në Evropë.

Gjithsesi kjo gjë nuk mund të thuhet për sa i përket krijimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve, të cilët duke u përkatur shpirtërisht tre feve të ndryshme nuk mund të krijojnë një identitet kombëtar të bazuar në këtë faktor. Situata fetare në Shqipëri në prag të zgjimit kombëtar ishte pothuajse shumë e ndryshme nga ajo e vendeve të tjera ballkanike apo dhe vendeve të tjera të Evropës Juglindore që analizojnë këta autorë.

Duke qenë se Shqipëria ishte një nga territoret e para të rajonit në të cilin Kristianizmi ishte predikuar dhe përhapur por në të njëjtën kohë vendi dhe territori ku influencat e Romës dhe Kostandinopojës si qendra perandorake ishin përplasur, Shqipëria pak a shumë përfaqësoi këtë konflikt jo vetëm në aspektin politik dhe kulturor por dhe në aspektin fetar. Si rrjedhojë, dy dogmat kryesore të Kristianizmit, Ortodoksia dhe Katolicizmi praktikoheshin dhe ishin besime fetare dominante por dhe në konflikt të hapur në Shqipëri përpara pushtimit otoman në shekullin e XV.

Maqedonia ishte një nga rajonet e para të Ballkanit që u islamizua dhe një rol kryesor në këtë proces luajti dhe pozita shumë e favorshme gjeografike, të qenët në mes të rrugëve dhe luginave që bënë të mundur depërtimin osman drejt Serbisë dhe Austrisë. Si është pranuar gjerësisht, pas dështimit për të ngritur një flotë të fuqishme krahasuar me fuqitë e tjera detare europiane, osmanët e përqendruan strategjinë e tyre në avancimin tokësor duke ngritur fushata të përvitshme dhe të kushtueshme që drithëronin oborret mbretërore së Europës Qendrore.

Duke iu drejtuar në veçanti Islamit në qytetet maqedonase, John Thirkelli ka vënë në dukje se gjatë shekujve XV-XVI, feja në Maqedoni, me qendrën e vet në Shkup (e sidomos në një numër të caktuar qytetesh) përbënte një “marsh ushtarak”, nga i cili nisi konvertimi i Serbisë bashkë me Bosnjën.[5] Gjithsesi edhe pse në rastin e popullsisë shqiptare në Maqedoni niveli i islamizimit të kësaj popullsie krahasuar me popullsitë e rajoneve të tjera shqiptare ishte më i lartë, ashtu si kudo gjetkë në Ballkan nuk pati një uniformitet të njëtrajtshëm fetar.

Një rast tipik interesant në këtë drejtim mbetet popullsia e Rekës së Epërme, popullsi shqiptare që i përkiste besimit ortodoks dhe që mbetet rasti i vetëm deri më tash i njohur në veri të Shqipërisë që arriti të mbante në të njëjtën kohë identitetin e

vet fetar por që edhe përmes një përfaqësuesi të shquar të saj si Josif Bagëri (1868-1915) u përfshi qoftë edhe pjesërisht në lëvizjen kombëtare.

Po kështu edhe brenda popullsisë së islamizuar shqiptare nuk kishte një uniformitet suni-që ishte dhe dogma fetare zyrtare e Perendorisë, por kishte dhe një komunitet të fuqishëm bektashi të përqendruar rreth Tetovës dhe që merrte pjesë në jetën politike të Maqedonisë dhe të lidhjeve të saj me qendrën perandorake.

Urdhri i dervishëve bektashi ashtu si gjerësisht edhe në territore të tjera shqiptare predikonin dhe praktikonin urdhrat e ceremonitë e shumta të lidhura me ta. Meqë kishte mjaft ngjashmëri ndërmjet Krishterizmit dhe Islamit, ata nuk kishin ndonjë vështirësi të madhe që t'i përshtasin zakonet vendore me urdhrat e tyre.

Kjo ndërmjetësi fetare e sektit Bektashi, shumë e veçantë në rastin shqiptar krijonte premisa që identitetet fetare të mos ishin të njëtrajshme por të përthyeshin dhe reflektonin dhe shqetësimet politike të kohës, në vitet e lindjes së nacionalizmit në Ballkan. Periudha nga viti 1804 deri më 1878, në gadishullin ballkanik është ajo e revoltave kombëtare dhe e formimit të shteteve të reja.

Gjatë këtyre viteve Greqia, Serbia dhe Rumania do të fitonin pavarësinë, kurse Bullgaria do të bëhej autonome. Në këtë periudhë lind edhe një lëvizje kombëtare Shqiptare. Është e rëndësishme të bëjmë një vlerësim të disa zhvillimeve të përgjithshme, ku përfshihet jo vetëm Ballkani, por edhe pjesa tjetër e Europës, të cilat do të ushtronin një ndikim të rëndësishëm mbi aktivitetet revolucionare: së pari, formulimi dhe pranimi në shkallë të gjerë të ideologjive liberale dhe kombëtare; së dyti, kushtet ekonomike në ndryshim; dhe së treti, shkallëzimi i ndërhyrjes së fuqive europiane dhe zanafilla e çështjes lindore.

Intelektualët dhe udhëheqësit kombëtarë ballkanikë të shek XIX do të ndikoheshin nga dy doktrina politike me prejardhje evropianoperëndimore: liberalizmi që buronte nga idetë e iluminizmit në shek e XVIII; dhe nacionalizmi. Përballë këtij realiteti të ri në Ballkan, fillimisht nën një zgjim kulturor dhe pastaj nën një zgjim politik të nxitur më së tepërmi edhe nga Kriza Lindore, shqiptarët reagueshan duke sendërtuar format e para të një ndërgjegje kombëtare të avancuar që kërkonte një shtet shqiptar në rajon.

Veprimtarët e lëvizjes kombëtare shqiptare u përpoqën ta shmangin ndërgjegjen fetare si një faktor bashkues drejt krijimit të identitetit kombëtar dhe i dhanë më shumë rëndësi kulturës shqiptare, ndjenjës së origjine të përbashkët dhe në mënyrë të veçantë gjuhës shqipe.[8] Po kështu, elita kombëtare shqiptare nën shembullin e vendeve të tjera ballkanike që rrëmonin në të shkuarën e tyre për të gjetur epoka të lavdishme rizbuluan figurën e Skënderbeut, prijësit të tyre mesjetar që kish zhvilluar një nga epopetë më të ndritura në përballjen kundër pushtimit otoman në gadishullin ballkanik.

Përmes këtij procesi panshqiptar lëvizi edhe ideja kombëtare në Maqedoni dhe në popullsinë shqiptare që përbënte një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së saj. Shqiptarët nuk mund të bënin dallim nga popujt e tjerë ballkanikë kur nisën zgjimin e tyre nationalist. Prija e natyrshme do të ishte ashtu si dhe te fqinjët e vet, një kundërvënie ndaj fesë zyrtare të pushtuesve-Islamit, diçka që hasi në vështirësi që në hapat e parë, sepse një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve kishin pranuar

Islamin dhe nën influencën e shtetit teokratik osman e identifikonin veten shpesh herë si myslimanë dhe pastaj si shqiptarë.

“Kultura islamike e Perandorisë Osmane i kishte mëshuar identifikimit të besimit fetar me kombin, duke sheshuar dallimin midis shqiptarëve e myslimanëve të tjerë nga njëra anë dhe duke nxjerrë më në pah, nga ana tjetër, atë midis islamikëve dhe të krishterëve gjithfarësojësh.

Në një shoqëri shumëkombëshe, siç ishte ajo e Perandorisë Osmane, jeta e nënshtetasve të saj, ç’është e vërteta, ishte organizuar rreth besimit, të cilit, ata i përkisnin: domethënë, vija ndarëse ndërmjet të qeverisurve dhe qeverisësve-ose, thënë më shkoqur, popullsisë hegjemone-ishte religjioni dhe jo kombësia, ku padyshim, ashtu si në të gjithë perandorinë, myslimanët përftonin një pozicion të privilegjuar, gjë që, në rastin e Shqipërisë që shndërruar e kishte përbërë një pengesë objektive për të arritur bashkimin kombëtar të myslimanëve me të krishterët, qofshin ata ortodoksë apo katolikë.”

Ishte kjo arsyeja që në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit identiteti fetar kish luajtur një rol të fuqishëm dhe frenues, ku nuk u arrit të avancohej apo shkohej më tej në kërkesat ndaj Portës së Lartë, sepse “forcat që sundonin në mbledhjen e Prizrenit ishin forca myslimane konservatore dhe nëpërmjet tyre Porta mund të ushtronte një ndikim për interesat të veta. Kjo shpjegon përse shqiptarët e Prizrenit luftonin në fillim, bashkë me boshnjakët myslimanë për një kauzë të përbashkët.”

Ky lloj dyzimi i elitës administrative shqiptare jo vetëm gjatë Lidhjes së Prizrenit por në vazhdimësi, për t’i quajtur të vetat interesat e perandorisë, do të pengonte dhe vononte rrugëtimin e shqiptarëve drejt pavarësisë.

Rasti i shqiptarëve të Rekës, kësaj krahine të përbërë nga 18 fshatra dhe të shtrirë në lindje të Dibrës, përtej maleve Korab, Velivar dhe Kërçin, në të dy anët e lumit Radikë[11], ishte i kundërt nga ai shqiptarëve myslimanë pasi në identitetin e tyre kombëtar e kërcënonte Kisha Kombëtare Serbe që në kuadër të politikave asimiluese të saj që përkrahnin politikën nacionaliste të shtetit serb, kërkonte t’i përfshinte banorët e saj brenda një identiteti kombëtar serb.

Ashtu si sivëllëzërit e tyre ortodoksë në jug të Shqipërisë që kërcënoheshin me asimilim nga ithtarët e Patrikanës së Stambollit që bënte përpjekje të vazhdueshme për të helenizuar jugun e Shqipërisë, edhe banorët e Rekës së Epërme ishin nën kërcënimin serb që dëshironte që identitetin fetar ta shfrytëzonte për ti asimiluar.

Jeta dhe kujtimet e aktivistit të njohur Josif Bagëri që mëson të shkruaj shqip në Sofje, dhe aty kthehet në një nga përhapësit i idesë kombëtare, është një dëshmi e peripecive identitare që kalonin banorët e kësaj zone. Ardhja e tij në vitin 1908 në Rekë, menjëherë pas shpalljes së Hyrietit dhe përhapja e idesë kombëtare kishte vështirësi për shkak se propaganda serbe kishte zënë mirë vend.

Si zakonisht në këto përpjekje asimiluese predominonte Kisha Ortodokse Serbe, hierarkët e së cilës e kishin braktisur ideologjinë e universalizmit të krishterë dhe kishin rënë nën influencën e nacionalizmit. Josif Bageri do të haste në këtë vështirësi dhe për këtë arsye ai iu drejtua fshatarëve të vet, duke iu sqaruar se cili ishte qëndrimi i dhespotit serb Varnava të Dibrës ndaj tyre.

“Vendi në të cilin asht ngulur Varnava nuk asht i ngulun me serb; as me bullgarë, po me fjesht shqyptarë. Detyra e secilit shqyptar asht t’përipiqet për me

udhon dormën këtynej propagandorëve qi të qirohet vendi perj egërsinavet të mveshuna me lëkurë delje, se këto nuk janë gjë tjetër, përveç se ulq rrëmbenjës”.[12] Për herë të parë nëpërmjet kujtimeve të tij kemi edhe dokumentimin e hapjes së shkollës shqipe në këtë rajon, në fshatin e tij të lindjes Nistrovë, ku u bëri thirrje bashkëatdhetarëve t’i çojnë fëmijët për të mësuar të shkruajnë e të lexojnë shqip.

Ai kishte sjellë me vete, 20 copë abetare dhe filloi tu jepte mësim 8-9 fëmijëve të parë që u mblodhën. Gjithsesi puna e nisur nga Bageri që përdorte alfabetin e Stambollit në shkrimin e gjuhës shqipe, nuk është se ishte përpjekja e parë e banorëve të kësaj zone për të shkruar shqip, pasi në vend lëvronin e edhe tradita të vjetra të shkrimit të shqipes si ishte rasti i përdorimit të alfabetit cirilik të bullgarishtes që mesa duket kishte qenë një medium i përdorur nga popullsia, kryesisht nga ajo që ishte e emigruar në qendra të ndryshme të Ballkanit.

Një dokument i arkivave austriake i referohet në fakt ortodoksëve shqiptarë të fshatit të Brodecit, në rajonin e Rekës së Sipërme (afër Dibrës), të vendosur në Stamboll. Këta të fundit në vitin 1911 kishin themeluar një shoqëri bamirësie dhe arsimore, statuti i së cilës, hartuar në shqip dhe në alfabetin cirilik bullgar, tregonte një vullnet për të botuar libra në shqip me këtë alfabet, për të hapur një shkollë në fshatin e tyre të origjinës dhe për të restauruar kishën e fshatit.

Fati i popullsisë së Rekës do të diskutohej dhe 5 vjet më vonë pasi Bagëri do të largohej nga Nistrova, në Konferencën e Londrës, ku përfaqësuesi diplomatik i Rusisë do kërkonte që Dibra të përfshihej në shtetin serb për shkak të traditave kishtarë dhe fetare të popullsisë ortodokse të një pjese të vogël të qytetit.

Gjakova dhe Dibra kërkoheshin për Serbinë(nga ana e përfaqësuesit rus Petrajev në Konferencën e Londrës-shënimi im) jo për karakterin sllav të popullsisë lokale që nuk mund të provohej, por sepse manastiri serb i Deçanit kishte prona të gjera tokësore në krahinën e Gjakovës, kurse Dibra ishte selia e dy peshkopëve ortodoksë dhe fare pranë saj ndodhej një manastir ortodoks (i Shën Jovan Bigorit).

Si dihet pas traktivave të shumta midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë për caktimin e kufijve veriorë së Shqipërisë, qyteti i Dibrës së Madhe dhe malësia e Rekës së Epërme mbeti brenda kufijve të Serbisë pavarësisht faktit se popullsia shqiptare ishte më e madhe në numër dhe predominonte gjithandej. Popullsia e Rekës së Epërme do të kishte fatin e popullsisë të tjera ortodokse shqiptare në Greqi, të cilave identiteti fetar do tu merrej si faktor parësor për të përcaktuar dhe identitetin e tyre kombëtar.

Kështu, në qoftë se shqiptarët myslimanë të Maqedonisë do të kishin mundësi që të përdornin gjuhën shqip në jetën e përditshme apo qoftë dhe të organizoheshin politikisht në radhët e “Xhemitit”, duke shfrytëzuar identitetin fetar në radhët e partisë islamike të themeluar në Maqedoni në dhjetor 1919, shqiptarët e krishterë të Rekës së Epërme do i nënshtroheshin një presioni për asimilim të plotë dhe marrjen e identitetit sllav, përkundrajt atij shqiptar.

Pavarësisht një presioni të tillë dhe asimilimi të dhunshëm që ushtroi shteti serb pas përfshirjes së kësaj krahine brenda tij, identiteti i veçantë i shqiptarëve të Rekës vazhdonte të ishte problem për shtetin serb deri në vitet 30’ dhe të shfaqej si shqiptar.

Sipas të dhënave burimore që na servirin famulltarët e kishës katolike të Kosovës Gjon Bisaku, Shtjefën Kurti dhe Luigj Gashi, në Promemorien që i kanë dërguar më 5 maj të vitit 1930, Sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, zotit Erik Dramondit, duke u ndalur në dhunën e xhandarmërisë serbe ndaj ortodoksëve shqiptarë theksojnë: “Në disa vende, si në Rekë ku bashkërisht jetojnë shqiptarë të besimit ortodoksë me sllavët e të njëjtit besim dhe shqiptarët myslimanë, kjo diferencë qëndron në mbajtjen e kësulës në forma të ndryshme.

Shqiptarët mbajnë “çeçe”, ndërsa serbët “kaçketë”. Për të mënjeluar këtë diferencë të dukshme, nënprefekti z. Sokolloviç ka nxjerrë një urdhëresë, me anën e së cilës ua ndalon shqiptarëve të mbajnë çeçe.

Po kështu në prememorie nënvizohej se ishte e ndaluar edhe mësimi i fesë në gjuhën shqipe, duke përmendur faktin se shqiptarët ortodoksë të Rekës, që përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë së asaj krahine ishin të ndaluar të përdornin gjuhën amtare në kisha. Pra si shikohet në kuadër të politikave unifikuese për të siguruar kompaktësi etnike shteti serb nuk ushtronte dhunë vetëm ndaj shqiptarëve myslimanë në Maqedoni por edhe ndaj atyre të Rekës.

Disa vite më vonë në një dokument të hartuar më 5 shkurt të vitit 1944, nga konsulli i atëhershëm shqiptar në Shkup, Hamit Kokalari dëshmohej ende prania e fortë shqiptare në këtë trevë. Ky i fundit i dorëzoi qeverisë shqiptare një projekt, i cili konsistonte në botimin e një Atlas-Albumi për Kosovën. Në të ai kishte përfshirë një sërë hartash etnografike, fotografi të qyteteve e katundeve shqiptare të mbarë krahinave, duke përfshirë edhe Rekën. Në projekt, diplomati shqiptar theksonte: “Të mos mbeten mangut edhe zonat ku gjendet popullsi shqiptare ortodokse si Reka e Gostivarit”.

Duke u ndalur në vendbanimet shqiptare dhe veçanërisht në Rekën e Epërme, Kokalari rrëfen se: “Në shumë katunde që kam vizituar pleqtë dhe plakat flisnin një shqipe të kulluar”. Gjithashtu konsulli Hamit Kokalari tregon se shpesh ortodoksët shqiptarë i merrnin për serbë ose për bullgarë, prandaj gjenden fare pak ortodoksë në skajet veriore (në Kosovë e në Malin e Zi) si dhe në skajin lindor (në Maqedoninë Perëndimore).

Identiteti fetar dhe bashkimi fetar ka qenë një nga qelizat më të forta të shoqërive, që kanë aspiruar dhe janë krijuar si kombe. Në vende të ndryshme këto tipare vazhdojnë ende të jenë përcaktuese për zgjedhje të ndryshme apo hartimin e politikave të ndryshme. Në Shqipëri për shkak të ekzistencës së tre besimeve fetare, identiteti fetar u mënjau nga zgjimi nacionalist i tyre, duke ia lënë rrugën kulturës dhe gjuhës kombëtare.

Rasti i shqiptarëve të Maqedonisë, në një shtet multietnik është bash një rast i mirë që identitete të fjetura (si ka qenë rasti i shqiptarëve të Rekës) apo intregaliste si ka qenë ai i shqiptarëve të islamizuar të përbashkohen në një identitet kombëtar duke ndjekur prirjet e zgjimit të tyre nacionalist, duke u munduar për të nxjerrë vlerat më të mira të tyre dhe jo të imitojnë apo krijojnë identitete të rrema që nuk i qëndrojnë kohës.

FAUZI SKENDERI

VEÇORITË DEMOGRAFIKE TË KOMUNËS SË BËRVENICËS

Hyrje

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht prej vitit 1948 e deri më sot, në territorin e Republikës së Maqedonisë, ka patur lëvizje migruese të popullsisë, përkatësisht në relacion fshat-qytet, është për t'u përmendur shpërngulja e shqiptarëve në Turqi, si dhe procese të tjera. Shqiptarët në vendin e vet kanë qenë të diskriminuar vite me radhë, për këtë arsye edhe ndodhi lufta në vitin 2001 nga e cila pasoi Marrëveshja e Ohrit e cila pak a shumë e uli tensionin ndëretnik në mes shqiptarëve dhe maqedonasve, por përsëri kjo marrëveshje hasi në pengesa nga ana maqedonase, ndërsa pasojat nga mosrealizimi i saj dihen. Me shkatërrimin e ish- RSFJ-së në vitin 1990 formohet shteti i pavarur Republika e Maqedonisë. Në tetor të vitit 1996 kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Ligjin për ndarjen territoriale të vendit, ku prej 30 komunave u formuan 123 sosh, ndërsa nga ndarja më e re e vitit 2004 numri i komunave në Maqedoni u zvogëluar nga 123 komuna në vitin 1996 në 80 komuna në vitin 2004, në mesin e të cilave komuna rurale e Bërvenicës përsëri ekziston pa ndryshime sa i përket sipërfaqes dhe kufijve të saj. Në kuadër të komunës së vjetër të Tetovës sipas ndarjes më të re (2004 v.) formohen 6 komuna nga 10 sa kishte para kësaj ndarje (1996 v.), përkatësisht 5 rurale dhe 1 urbane, ajo e Tetovës. Si komuna rurale që u formuan janë këto: Bogovina, Zhelina, Bërvenica, Tearca dhe Jegunovca, si dhe komuna ekzistuese urbane e Tetovës. Në këtë temë do të përqendrohemi në komunën e Bërvenicës. Komuna në fjalë shtrihet në një sipërfaqe prej 162.8km² në të cilën gjenden 10 fshatra (vendbanime) të madhësive të ndryshme, në të cilat jeton një popullsi prej 15.855 banorësh (2002).

KARAKTERISTIKAT POPULLATIVE

Numri i popullsisë

Zhvillimi demografik ka rëndësi të veçantë për një vendbanim, komunë apo shtet, andaj edhe meriton t'i kushtohet vëmendje e posaçme, ku manifestohen përmes lëvizjes natyrore dhe asaj mekanike. Shtimi i popullsisë në rajonet e caktuara por edhe në suaza botërore në përgjithësi lidhet me resurset ekzistuese natyrore dhe kushtet ekonomike-shoqërore. Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në këtë hapësirë ka pasur ndryshime si për nga numri po ashtu edhe për

nga struktura demografike dhe socio-ekonomike e saj. Për numrin e popullsisë ka pasur të dhëna të ndryshme, e veçanërisht nga autorë të ndryshëm, si: maqedonas, serbë e tjerë të cilët në shënjestër i kanë patur shqiptarët dhe për këtë arsye të dhënat numerike populative nuk kanë vlerë praktike. Lëvizja numerike e popullsisë në komunën e Bërvenicës sipas regjistrimeve të realizuara në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore e deri në këto vitet e fundit, vazhdimisht ka shënuar rritje në nivel komune, ndërsa tre fshatrat që kryesisht janë të banuara me popullsi sllave (maqedonase), janë të përfshira nga procesi i shpopullzimit si që janë: Stençja, Bllaca dhe Vollkovia. Për shkak të shtimit natyror dhe proceseve migruese, popullsia e kësaj komune vazhdimisht ka shënuar rritje. Në vitin 1971 në këtë komunë kanë jetuar 11.685 banorë dhe në vitin 1994 ky numër është rritur në 14.793 banorë, kurse në vitin 2002 ky numër është rritur në 15.855 banorë, që do të thotë se prej vitit 1971-2002 popullsia është shtuar për 4.170 banorë. Dendësia mesatare në këtë komunë është 97 banorë në 1km² (2002), ndërsa të dhëna për numrin e popullsisë për vitin regjistruar 2011, nuk ka, pasi i njëjti për shkaqe politike dështoi. Pasi territori i kësaj përbëhet nga forma të ndryshme relievoe dendësia e popullsisë ndryshon prej një zone relievoe në tjetrën. Pjesa malore e kësaj komune mesatarisht është e banuar me 28 banorë në 1 km². Nëndërsa pjesa rafshinore është e banuar me 119 banorë në 1 km², që tregon se pjesa rafshinore e kësaj komune ka kushte më të mira për jetën e njeriut dhe për këtë shkak përqëndrimi i popullsisë është për disa here më i madh.

Tab. 1. Popullsia e Komunës së Bërvenicës (1971-2002)

Viti	1971	1981	1994	2002
Numri i popullsisë së komunës së Bërvenicës	11.685	13.820	14.793	15.855

Numri i familjeve në këtë komunë ka psur ndryshime të mëdha , gradualisht me shtimin e numrit të popullsisë janë shtuar edhe familjet, e veçmas në vendbanime ku mbizotëron popullsia shqiptare. Numerikisht familjet në komunën e Bërvenicës janë në ritje duke u bazuar në të dhënat statistikore prej vitit 1971-2002.

Tab.2.Lëvizja e numrit të familjeve në Komunën e Bërvenicës

Viti	Lëvizja e numrit të familjeve në komunën e Bërvenicës
1971	1.893
1981	2.366
1994	2.826
2002	3.477

Nga tabela vërejmë se numri familjeve në këtë komunë shkallë-shkallë është rritur edhe atë prej vitit 1971-2002 është shtuar për 1.584 familje. Numri mesatar i

anëtarëve në një familje në këtë komunë po ashtu edhe në Pollog të Poshtëm nuk është më pak se 5 anëtarë.

Tab.3.Mesatarja e anëtarëve për një familje.

Viti	Pjesmarja mesatare e anëtarve në një familje
1971	6.2
1981	5.8
1994	5.2
2002	4.5

Sipas të dhënave të tabelës vërehet një tendencë e zvogëlimit të numrit mesatar të anëtarëve për një familje që është pasojë e procesit jetësor, si dhe emigracioni. Prej të gjitha vendbanimeve (10) të kësaj komune vetëm dy fshatra (Stençja dhe Vollkovia) kanë më pak anëtar për një familje përkatësisht 3.3, dhe 3.7 anëtarë, ndërsa mbi mesatare e komunës kanë disa fshatra me popullsi dërmuese shqiptare siç janë: Gurgurishti me 6.1 anëtarë, Ballishti (Çellopeku) 5.8 anëtarë, Tenova 5.6 anëtarë etj

Tab.4.Numri i familjeve dhe mesatarja e anëtarëve.

Nr	Vendbanimet	Viti		1994	2002
		Numri i familjeve 1994	Numri i familjeve 2002	Numri mesatar për një familje	Numri mesatar për një familje
1.	Bllaca	82	87	4.5	3.9
2.	Bërvenica	615	758	4.5	3.8
3.	Ballishti(Çellopeku)	831	1.050	5.8	5.0
4.	Gurgurishti	233	260	6.1	4.4
5.	Miletina(Bardhi)	344	397	5.2	5.0
6.	Radiovca	184	255	5.5	4.1
7.	Stençe	55	49	3.3	3.0
8.	Tenova	259	335	5.6	4.7
9.	Vollkovia	71	74	3.7	3.6
10.	Sellarca e Poshtme	152	182	4.4	3.8
11.	Komn. Bërvenicës	2.826	3.477	5.2	4.5

Dendësia e popullimit

Për përcaktimin e dendësisë mesatare të popullimit duhet të merren parasysh sipërfaqja e një treve apo hapësire gjeografike dhe numri i përgjithshëm i popullsisë që jeton në te. Për tu definuar dendësia mesatare duhet vërejtur lëvizjen

numerike të popullsisë së përgjithshme në hapësirë të caktuar gjeografike. Mesatarja e popullsisë në komunën e Bërvenicës është 97b/km² (2002), që përputhet me mesataren e Republikës së Maqedonisë.

Tab. 5. Dendësia mesatare në komunën e Bërvenicës


Nr.	Hapsira e banuarë	Sipërfaqja në km ²	në vite			
			1971	1981	1994	2002
1.	Komuna e Bërvenicës	163	71	84	90	97

Në bazë të tabelës së më sipërme vërejm se dendësia mesatare e popullsisë është në rritje.

Për të patur pasqyrë të plotë sa i përket dendësisë mesatare të popullsisë në komunën e Bërvenicës në vazhdim do ta përcjellim tabelën me savijon.

Tab. 6. Dendësia mesatare e popullsisë në komunën e Bërvenicës.

Nr.	Vendbanimet	Sipërfaqja në km ²	Dendësia mesatare e popullsisë në km ²			
			Vitet			
			1971	1981	1994	2002
1.	Bllaca	7.7	64	50	49	44
2.	Ballishti(Çellopeku)	27.2	139	176	183	194
3.	Bërvenica	5.4	250	414	501	540
4.	Gurgurishti	48.1	26	25	30	32
5.	Radiovca	3.6	175	228	285	291
6.	Miletina(Bardhi)	22.0	73	81	82	90
7.	Stençja	16.4	25	17	11	9.1
8.	Tenova	5.3	231	274	277	302
9.	Vollkovia	22.1	18	14	12	12.2
10.	Sellarca e Poshtme	4.8	110	125	141	144
	Gjithsej	163	71	84	90	97

Grafiku. 2. Të dhënat në tab.6.

Lëvizja natyrore e popullsisë

Kur bëhet fjalë për lëvizjen natyrore të popullsisë, qoftë në një vendbanim rural apo urban, ajo mund të përcillet vetëm përmes lëvizjes natyrore (biologjike), ose përmes lëvizjes mekanike (migrimëve) të popullsisë. Lëvizja natyrore e popullsisë është në varshmëri nga shumë faktorë të ndryshëm, si biologjik, sociologjik, ekonomik, tradicional etj. Lëvizja natyrore e popullsisë nuk përcillet sipas viteve statistikore regjistruese, e cila sipas ligjit të Republikës së Maqedonisë mbahet çdo 10 vjet. Mirëpo, regjistrimi i vitit 1991, u përsërit për shkak të pakënaqësisë së shqiptarëve dhe mosbesimit ndaj organeve shtetërore. Të dhënat për lëvizjen natyrore të popullsisë në nivel të komunave të reja rurale për her të parë u shpallën në vitin 1997. Krahas këtyre të dhënave statistikore paraqiten edhe disa elemente përcjellëse demografike, që janë në lidhshmëri me lëvizjen natyrore të popullsisë. Këto të dhëna do të paraqesim në një table të përbashkët me komunën e Bërvenicës dhe Pollogun e Poshtëm.

Tab. 7. Lëvizja natyrore e popullsisë në Pollogun e Poshtëm dhe Komunën e Bërvenicës në vitin 1997.

Nr.	Hapësira e banuar	Lidhja e dysheve martesore	Moshja e grave që hynë në bashkëshortësi		Fertiliteti			Vdekshmëria
			-19 vj.	19-24 vj.	Foshnjat e gjalla të lindura sipas moshës së nënës			
					15-19 v	30-40v	<50	
1.	Komuna e Bërvenicës	115	30	59	15	40	-	2
2.	Pollogu i Poshtëm	1.478	278	128	128	639	6	49

Për shkak të dendësisë së konsiderueshme të popullsisë në komunën e Bërvenicës po ashtu edhe në Pollogun e Poshtëm, pason edhe numri i madh i dysheve martesore që lidhin kurorë, që dëshmon edhe shtimin e “gjallë” natyror të popullsisë të trevave në fjalë. Në vitin 1997 në komunën e Bërvenicës janë regjistruar 115 lidhje martesore, ndërsa në Pollogun e Poshtëm 1.478 sosh. Numri i femrave që hynë në martesë deri në moshë 19 vjeçare në komunën e Bërvenicës arrin në 30, kurse në Pollogun e Poshtëm 278, ndërsa ato femra që hynë prej moshës 19-24 në komunën e Bërvenicës është 59, kurse në Pollogun e Poshtëm arrin 128 sosh. Po t’i referohemi të njëjtës periudhë, në komunën e Bërvenicës kanë lindur 15 foshnje të gjalla, ndërsa në Pollogun e Poshtëm 128 foshnje, moshja e nënave 30-40 vjet kanë lindur 40 foshnje në komunën e Bërvenicës, kurse në Pollogun e Poshtëm 639 foshnje të gjalla. Në komunën e Bërvenicës nënat me mosh 50 vjeçare nuk kanë lindur asnjë foshnje, ndërsa në Pollogun e Poshtëm kanë lindur 6 foshnje. Në vitin 1997 në komunën e Bërvenicës kanë vdekur 2 foshnje, ndërsa në Pollogun e Poshtëm 49 foshnje. Duhet theksuar se fertiliteti (aftësia për të lindur fëmijë) është prezent si në komunën e Bërvenicës, ashtu edhe në Pollogun e Poshtëm. Sipas elementeve të lartë përmendura këto janë ngushtë të lidhura me procesin e lëvizjes natyrore të popullsisë, të cilat ndikojnë në shtimin natyror të popullsisë së kësaj ane, e bazuar në vitin 1997 që më së miri mund ta vërejmë tabela e mëposhtme.

Tab. 8. Lëvizja natyrore e popullsisë në vitin 1997 në komunën e Bërvenicës dhe Pollogun e Poshtëm

Nr.	Hapsira e banuar	Lindshmëria		Vdekshmëria		Shtimi natyror	
		Numri	%	Numri	%	Numri	%
1.	Komuna e Bërvenicës	292	19.7	111	7.5	181	12.2
2.	Pollogu i Poshtëm	3.504	20.3	1.198	6.9	2.306	13.4

Të dhënat e më sipërme vërehet se në vitin 1997 në komunën e Bërvenicës kanë lindur 292 foshnje të gjalla, në Pollogun e Poshtëm ky numër ka qenë 3.504 lindje. Vdekshmëria në komunën e Bërvenicës ka qenë 111 persona, kurse në Pollogun e Poshtëm 1.198 persona. Shtimi natyror në komunën e Bërvenicës ashtu edhe në Pollogun e Poshtëm nuk është përfaqësuar drejt pasi të dhënat statistikore janë të shtrembëruara, nga këto të dhëna varet fati i popullsisë shqiptare në Republikën e Maqedonisë, ku shqiptarët do të gëzonin më shumë të drejta siç janë arsimimi, përdorimi i gjuhës shqipe në administratë etj.

Veçoritë përbërëse të popullsisë

Për zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë të çdo vendi nuk është i rëndësishëm vetëm numri i popullsisë por edhe përbërja e asaj strukturore. Karakteristikat e përbërjes së popullsisë janë tregues të rëndësishëm për zhvillimin demografik të popullsisë. Nëpërmjet karakteristikave demografike zbulohen ndërrimet kryesore që janë të lidhura ngushtë me ndërrimet sociale, etnike dhe vetitë tjera të popullsisë që paraqet resursin kryesor për zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik këtij territori të komunës dhe më gjerë. Ndryshimet në përbërjen e popullsisë sipas gjinisë, moshës, arsimit, janë determinanta të rëndësishme dhe njëherësh janë të lidhura me faktorët e zhvillimit të një vendi. Këtu qëndron edhe rëndësia e studimit të përbërjeve të popullsisë, që kanë rëndësi për njohjen esenciale të lëvizjes së përgjithshme të popullsisë dhe zhvillimit ekonomik. Në shqyrtimet që pasojnë më hollësisht do të analizohen përbërjet e popullsisë sipas këtyre karakteristikave: *Përbërja gjinore e popullsisë, Përbërja moshore e popullsisë, Përbërja arsimore e popullsisë, Përbërja kombëtare e popullsisë dhe Përbërja fetare e popullsisë*

Përbërja gjinore e popullsisë

Popullsia sipas gjinisë paraqet elementin e rëndësishëm demografik, pasi që nuk është i rëndësishëm vetëm për ta paraqitur popullsinë përmes numrave të meshkujve dhe femrave, por edhe sipas gjinisë është shumë e rëndësishme edhe për parashtrimin dhe analizimin e disa segmenteve tjera demografike. Në komunën e Bërvenicës raporti numerik i popullsisë sipas gjinisë ndryshon prej vitit regjistruar në tjetrin për shkak të ndryshimit të numrit të popullsisë.

Në tabelën e mëposhtme mund të shohim përbërjen e gjinive për disa periudha kohore.

Tab. 9. Përbërja e gjinore e popullsisë në Komunën e Bërvenicës(1961-2002v.)

1961		1971		1994		2002	
Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
5.465	5.360	6.103	5.932	7.145	7.648	7.924	7931
50.5%	49.5%	50.4%	49.6%	48.3%	51.7%	49.9%	50.1%

Në shënimet e tabelës 9 mund të përfundojmë se në vitet 1961dhe 1971 dominojnë pjesëtarët e gjinisë mashkullore me afro 1% më tepër, ndërsa në vitin 1994 ndodhë e kundërta ku mbizotëron gjinia femërore, e njejta ndodhë si në vitin 1994 edhe në vitin 2002 ku mbizotëron gjinia femrore.

Tab. 10. Përbërja gjinore e popullsisë sipas vendbanimeve në Komunën e Bërvenicës

Nr.	Vendbanimet	Popullsia 1994	Meshkuj (%)	Femra (%)	Popullsia 2002	Meshkuj (%)	Femra (%)
1.	Ballishti (Çellopeku)	4.876	2.252(46.1)	2.624(53.9)	5.287	2.577(48.7)	2.710(51.3)
2.	Tenova	1.469	704(47.9)	765(52.1)	1.062	800(49.9)	802(50.1)
3.	Stençja	184	93(50.5)	91(49.5)	150	76(50.6)	74(49.4)
4.	Radiovca	1.026	506(49.3)	520(50.7)	1.049	528(50.3)	521(49.7)
5.	Miletina (Bardhi)	1.786	840(47.0)	946(53.0)	1.986	997(50.2)	989(49.8)
6.	Sellarca e P.	680	366(53.8)	314(46.2)	693	351(50.6)	342(49.4)
7.	Gurgurishti	1.428	689(48.2)	739(51.8)	1.556	784(50.3)	772(49.7)
8.	Vollkovia	269	140(52.0)	129(48.0)	270	147(54.4)	123(45.6)
9.	Bërvenica	2.700	1.358(50.2)	1.342(49.8)	2.918	1.478(50.6)	1.440(49.4)
10.	Bllaca	375	197(47.7)	178(52.3)	344	186(54.0)	158(46.0)

Siç vërehet nga kjo tabelë përbërja e popullsisë sipas gjinisë në regjistrimin e fundit të vitit 2002, në dy vendbanime dominon gjinia femërore edhe atë: Ballisht (Çellopek) dhe Tenovë, kurse në vendbanimet tjera gjinia mashkullore.

Deri te ndryshimi i përbërjes gjinore vjen edhe për shkak të migrimeve të shumta, kryesisht meshkujve të cilët mbi një vit qëndrojnë në mërgim të përkohshëm dhe nuk regjistrohen nga institucionet përkatëse. Gjithashtu nga tabela vërehet se vendbanimi me dominim të gjinisë femrore janë vendbanimet me popullsi shqiptare si p.sh.: Ballishti(Çellopeku) me 53.8%, Tenova me 52%, Miletina (Bardhi) me 53%, Gurgurishti 51.7%, ndërsa vendbanimet me popullsi sllave janë me një dominim të gjinisë mashkullore, me një përqindje të vogël e cila sillet prej 0.2% në Bërvenicë deri në 3% në Sellarcën e Poshtme. Por duke marrë

parasysh se popullata shqiptare gjithmonë ka qen në shënjestër, kjo përqindje sigurisht nuk ka të bëjë me realitetin që ekziston në trojet shqiptare.

Përbërja moshore e popullsisë

Një ndër përbërjet më të rëndësishme të popullsisë si për procesin e zhvillimit demografik ashtu edhe për atë socio-ekonomik është përbërja e popullsisë sipas moshës. Popullsia në përgjithësi ndahet në tre grupmosha kryesore edhe atë: grup moshë e re 0-14 vjet, grupmosha e pjekur ose aktive 15-59 vjet dhe e moshuar mbi 60 vjet. Përbërjen moshore sipas ndarjes kryesore të grup moshave është: prej 0-14 vjet merë pjesë me 31% ose 4.586 banorë, ajo e pjekur prej 15-59 vjet me 56.5% ose 8.399 banorë dhe ajo e moshuar mbi 60 vjet 12.1% ose 1.808 banorë. Nga këto të dhëna del se në këtë komunë ka më shumë popullsi të grupmoshës së dytë (15-59) ose popullsi të pjekur aktive, por më pak popullsi të mplakur por në kufi të plakjes demografike me 12,1%.

Tab. 11. Përbërja e popullsisë sipas moshës në komunën e Bërvenicës

Nr.	Hapsira e banuar	Grup moshë			
		0-14 v.	15-59 v.	>60 v.	Të panjohur
1.	Komuna e Bërvenicës	31.0%	56.5%	12.1%	0.4%

Sa i përket përbërjes moshore të popullsisë për vendbanimet ndaras, popullsi të re ka më shumë Gurgurishti me 43.2% të grup moshës prej 0-14 vjetë. Shumë pak dallohen vendbanimet tjera me shumicë shqiptare, ndërsa ndaj asaj sllave ka dallime të mëdha. Si psh. të grupmoshës prej 0-14 Çellopeku ka 32.9%, Tenova 32.7%, Radiovca 32.5%, ashtu që të gjitha këto vendbanime kanë mesataren më të lartë se ajo e komunës që është 30.8%, ndërsa vendbanimet me popullsi sllave janë nën kësaj mesatare. Më drastike gjendja është në fshatin Vollkovi ku popullsia e re prej 0-14 vjetë merë pjesë me 17% Stençja 19%, Bllaca 24%, Sellarca e Poshtme 25.4% dhe Bërvenica 26.3%, të gjitha vendbanime me popullsi sllave. Sa i përket grupmoshës së dytë prej 15-59 vjetë mesatarja e komunës është 56.6%, mbi këtë mesatare janë: Sellarca e Poshtme 61.2%, Vollkovia 59.2%, Miletina 58%, Vollkovia 59.2%, ndërsa nën këtë mesatare janë: Gurgurishti me 49.5%, Stençja 47.3% e tjerë. Në vendbanimet me popullsi shqiptare mungon popullsia e kësaj moshe për arsye të migrimit të popullsisë aktive për punë në botën e jashtme. Sa i përket grupmoshës së tretë mbi 60 vjet, mesatarja në këtë komunë është 12.1%, ndërsa si vendbanime me përqindje më të madhe të kësaj popullate janë: Stençja me 33.7% dhe Bllaca me 19.5%, ndërsa vendbanimet tjera janë 1% mbi ose ndër mesataren e kësaj komune.

Tab. 12. Përbërja moshore e popullsisë sipas vendbanimeve

Nr.	Vendbanimet	Grup moshat				
		Popullsia	0-14 vjet	15-59 vjet	>60 vjet	Të panjohur
1.	Bllaca	357 (100%)	90 (24%)	210 (56.0%)	73 (19.5%)	2 (0.5%)
2.	Ballishti(Çellopeku)	4.876 (100%)	1.600 (32.9%)	2.695 (55.3%)	536 (11.0%)	45 (0.10%)
3.	Bërvenica	2.700 (100%)	709 (26.3%)	1.691 (45.9%)	294 (10.9%)	6 (0.3%)
4.	Gurgurishti	1.428 (100%)	616 (43.2%)	707 (49.5%)	160 (11.3%)	5 (0.4%)
5.	Radiovca	1.026 (100%)	333 (32.5%)	582 (56.7%)	111 (10.8%)	-
6.	Miletina(Bardhi)	1.786 (100%)	53 (28.2%)	1036 (58.0%)	244 (13.7%)	3 (0.01%)
7.	Stençja	148 (100%)	34 (19.0%)	87 (47.3%)	62 (33.7%)	-
8.	Tenova	1.464 (100%)	479 (32.7%)	817 (55.6%)	167 (11.4%)	6 (0.03%)
9.	Vollkovia	296 (100%)	48 (17.8%)	159 (59.2%)	62 (9.1%)	-
10.	Sellarca e Poshtme	680 (100%)	137 (25.4%)	416 (61.2%)	90 (13.2%)	-

Përbërja arsimore e popullsisë

Përbërja arsimore e popullsisë është e rëndësishme jo vetëm për zhvillimin ekonomik, por edhe për përparimin e përgjithshëm të komunës dhe më gjerë. Në vendbanimet rurale shkalla e arsimit është më e vogël, kjo ndodh edhe në këtë komunë rurale. Në këtë hapësirë në të kaluarën niveli i shkollimit nuk ka qenë i volitshëm, mirëpo me sjelljen e ligjeve të posaçme për ndjekjen e mësimimit në shkolla fillore (tetëvjeçare) në gjuhën amtare dukshëm është rritur numri i personave me arsimim fillor, pastaj të mesëm dhe shumë pak të atë të lartë. Përbërja arsimore e popullsisë sipas vendbanimeve të komunës së Bërvenicës është si vijon në tabelë.

Tab. 13. Përbërja arsimore e popullsisë sipas vendbanimeve në vitin 1994

Nr.	Vendbanimet	Popullsia >15 vjet	Pa përgatitje shkolore	Me arsim fillor	Me arsim të mesëm	Me arsim të larë dhe superior
1.	Bllaca	285 (100%)	108 (37.8%)	60 (21.0%)	112 (39.2%)	5 (2.0%)
2.	Bërvenica	1.991 (100%)	470 (23.6%)	656 (32.9%)	754 (37.8%)	94 (5.1%)
3.	Vollkovia	221 (100%)	78 (35.2%)	47 (21.2%)	87 (39.7%)	9 (4.0%)
4.	Gurgurishti	812 (100%)	411 (50.6%)	381 (46.9%)	15 (1.8%)	1 (0.1%)
5.	Sellarca e Poshtme	507 (100%)	137 (27.0%)	180 (35.5%)	177 (34.9%)	12 (2.3%)
6.	Miletina (Bardhi)	1.283 (100%)	404 (31.4%)	624 (48.6%)	223 (17.3%)	26 (2.0%)
7.	Radiovca	963 (100%)	186 (19.3%)	354 (36.7%)	134 (13.9%)	13 (1.3%)
8.	Stençja	149 (100%)	71 (47.6%)	39 (26.1%)	37 (24.8%)	2 (1.3%)
9.	Tenova	990 (100%)	281 (28.3%)	533 (53.8%)	146 (14.7%)	12 (1.2%)
10.	Ballishti (Çellopeku)	3.276 (100%)	100.1 (30.5%)	1.798 (54.8%)	364 (11.1%)	65 (1.9%)
	Gjithsej	10.207 (100%)	3.147 (30.8%)	4.672 (45.7%)	2.094 (20.0%)	239 (2.3%)

Nga të dhënat e tabelës 13 mund të vërejmë përbërjen arsimore të komunës sipas vendbanimeve, ashtu sipas tabelës së mësipërme popullsinë e komunës në fjalë sipas përbërjes arsimore mund ta ndajmë në katër grupe: popullsia pa shkollim(analfabet) në kuadër të komunës mer pjes me 30.8%, popullsia me arsim fillor 45.7%, me arsim të mesëm 20.0% dhe me atë të lartë sipëror 2.3%.

Sa i përket grupit të parë pa përgatitje shkollore mesatarja në këtë komunë është 30.8% nën kësaj mesatare është Radiovca me 19.3%, mbi të është Gurgurishti me 50.6%. Në grupin e dytë me arsim fillestar mesatarja në komunë është 45.7%, mbi këtë mesatare është Ballishti (Çellopeku) me 54.8%, ndërsa nën këtë mesatare është Bllaca me 21.0%. Në grupin e tretë me arsim të mesëm mesatarja në këtë komunë është 20.0%, mbi këtë mesatare është Stençja me 39.3%, ndërsa nën të është Gurgurishti me 1.8%. Arsimi i lartë dhe sipëror në këtë komunë përfaqësohet me 2.3%, mbi këtë mesatare është Bërvenica me 5.1%, nën këtë mesatare Gurgurishti me 0.1%.

Përbërja kombëtare e popullsisë

Në këtë komunë shikuar historikisht që nga kohët e hershme, por edhe sot numrin më të madh të popullsisë e përbëjnë shqiptarët. Mirëpo në të jetojnë edhe përfaqësues të grupeve të tjera etnike si: maqedonas, serbë (shumë pak), bullgarë (të pa deklaruar) etj. Në vitin 1971 në komunën e Bërvenicës shqiptarët përbënin numrin më të madh të popullsisë me 6.516 banorë ose 56.8%, pastaj vinë maqedonasit me 4.994 banorë ose 42.7%, ndërsa serbët 88 banorë ose 0.7%, të tjerët me 77 banorë ose 0.6%. Në vitin 1981 në komunën e Bërvenicës shqiptarët edhe më tej përbënin numrin më të madh me 7.977 banorë ose 58.4%, maqedonasit me 5.797 banorë ose 41.9%, serbët 82 banorë ose 0.6%, kurse të tjerët 151 banorë ose 1.2%. Po ty referohemi vitit 1994 shqiptarët në komunën e Bërvenicës ishin 8.898 banorë ose 62.0%, maqedonasit 5.895 banorë ose 39.1%, serbët 88 banorë ose 0.5%, të tjerët 18 banor ose 0.1%.

Tab . 14. Përbërja kombëtare në komunën e Bërvenicës(1971-2002v.)

Nr.	Viti	Popullsia gjithsej	Shqiptarë	Maqedonë	Serbë	Të tjerë
1.	1971	11.685 (100%)	6.516 (56.8%)	4.994 (42.7%)	88 (0.7%)	77 (0.6%)
2.	1981	13.832 (100%)	7.977 (58.4%)	5.797 (41.9%)	82 (0.6%)	151 (1.2%)
3.	1994	14.793 (100%)	8.898 (62.0%)	5.895 (39.1%)	88 (0.5%)	18 (0.1)
4.	2002	15.855 (100%)	9.777 (61.6%)	5.949 (37.5%)	78 (0.4%)	58 (0.3%)

Në vitin 2002 në komunën e Bërvenicës shqiptarët përbënin një numër të madh të popullsisë edhe atë prej 9.777 banorë ose 61.6%, pastaj vinë maqedonasit me 5.949 banorë ose 37.5%, serbët përfaqësohen me 78 banorë ose 0.4%, të tjerët ku numri i tyre arin në 58 banorë ose 0.3% e popullsisë së përgjithshme.

Tab. 15. Përbërja kombëtare e popullsisë në komunën e Bërvenicës sipas vendbanimeve(1994-2002v.)

Nr	Vendbanimet	Popullsia gjithsej (%)		Shqiptarë (%)		Maqedonë (%)		Serbë (%)	
		1994	2002	1994	2002	1994	2002	1994	2002
1.	Bllaca	376 (100)	344 (100)	1 (0.1)	-	375 (99.9)	344 (100)	-	-
2.	Ballishti (Çellopeku)	4.876 (100)	5.287 (100)	4.378 (92.3)	4.803 (90.8)	500 (7.7)	463 (8.7)	2 (0.04)	1 (0.01)
3.	Bërvenica	2.700 (100)	2.918 (100)	-	-	2.623 (97.1)	2.834 (97.1)	72 (2.4)	78 (2.6)
4.	Gurgurishti	1.428 (100)	1.556 (100)	1.428 (100)	1.549 (100)	-	1 (0.06)	-	-
5.	Radiovca	1.026 (100)	1.049 (100)	678 (66.2)	691 (65.8)	376 (35.7)	346 (32.9)	2 (0.02)	2 (0.1)
6.	Miletina(Bardhi)	1.786 (100)	1.986 (100)	1.146 (64.1)	1.336 (67.2)	638 (35.7)	642 (32.3)	2 (0.02)	2 (0.1)
7.	Stençja	184 (100)	150 (100)	-	-	184 (100)	149 (99.4)	-	1 (0.6)
8.	Tenova	1.469 (100)	1.602 (100)	1.211 (82.3)	1.391 (86.8)	258 (17.7)	210 (13.1)	-	-
9.	Vollkovia	269 (100)	270 (100)	-	270 (100)	268 (99.7)	-	1 (0.3)	-
10	Sellarca e Poshtme	680 (100)	693 (100)	-	-	671 (99.6)	690 (99.6)	9 (1.4)	3 (0.4)

Gjithashtu nga të dhënat e tabelës.15. vërejmë se popullsia shqiptare jeton dhe mbizotëron në pesë vendbanime edhe atë: në Gurgurisht 100%, Ballisht (Çellopek) 92.3%, Tenovë 82.3%, Radiovcë 66.2%, Miletinë 64.1%. Struktura kombëtare e popullsisë nëpër vendbanime është e ndryshme, duke filluar prej atyre me popullsi të përzier e deri te ato një nacionale, me shqiptar është vetëm Gurgurishti, ndërsa me popullsi maqedonase janë tre vendbanime të vogla me nga pesëdhjetë shtëpi, kurse gjashtë fshatrat tjer janë me popullsi të përzier. Struktura kombëtare e popullsisë nëpër vendbanime sipas vitit 2002 është e ndryshme. Sipas vitit 2002 përbërja kombëtare ku dominojnë shqiptarët është kështu: fshati Gurgurisht 100%, Ballisht(Çellopek) 90.8%, Tenovë 86.8%, Miletinë(Bardh) 67.2%, Radiovcë 67.2% e popullsisë.

Përbërja fetare e popullsisë

Në komunën e Bërvenicës ekzistojn dy fe kryesore, islame dhe ajo ortodokse sllave. Përsa i përket popullsisë shqiptare në këtë komunë ajo i takon kryesisht fesë islame, ndërsa popullsia maqedonase i takon asaj ortodokse sllave. Ekzistojnë fshatra që i takojnë një konfesionit dhe të përziera. Kryesisht fshatra një konfesionale janë: Gurgurishti 100% myslimanë, ndërsa ajo ortodokse sllave përfaqshohet në këto fshatra Bërvenica 100%, Bllaca 100%, Vollkovia 100%, Stençja 100% dhe Sellarca e Poshtme 100%, ndërsa ato fshatra të përziera janë katër edhe atë: Ballishti(Çellopeku) ku mbizotëron më shumë feja islame, i njejt rastë është me Tenovën, Miletinën (Bardhin) dhe Radiovcën. Sipas të dhënave të vitit 1994 në komunën e Bërvenicës për nga përbërja fetare i kanë takuar 61.0% fesë islame, ndërsa asaj ortodokse sllave 39.0% e popullsisë së përgjithshme.

Migrimet e popullsisë

Migrimet janë kategori demografike e popullsisë që bashkë me shtimin natyror paraqesin komponentin kryesor që përcaktohet me emigrimin, lindshmërinë dhe vdekshmërinë. Determinanta kryesore e shtimit të popullsisë është lindshmëria(nataliteti) dhe imigrimi (ardhja), kurse tregues të zvogëlimit të popullsisë janë, vdekshmëria(mortaliteti) dhe emigrimi (shkuarja). Migrimet si dukuri demografike shkaktohen dhe nxiten nga faktor të ndryshëm, qofshin ato politik, socio-ekonomik, fetar apo ato natyror-gjeografik. Të gjitha këto shkaqe deri më sot dhe në të ardhmen do të vinë në shprehje si në territorin e kësaj komune ashtu edhe më të gjërë që do të shkaktojnë migrimet e popullsisë. Migrimet e popullsisë ndahen në migrime të brendshme dhe migrimet e jashtme. Migrimet e brendshme janë migrime që ndodhin brenda një komune apo Republike. Migrimet e jashtme janë ato migrime që ndodhin jashtë shtetit.

Migrimet e brendshme

Në migrimet e brendshme kjo komunë përfshinë një numër të madh të popullsisë siç janë: punëtorët, tregtarët, nxënësit, studentët etj. Migrimet në këtë komunë ndodhin edhe për shkak të kushteve për jetesë, largësia nga qyteti, mungesa e tokës për punë, mungesa e ujit për pije (gjatë verës) etj. Me këta kushte të vështira mund të përmendim fshatin Gurgurisht i cili shtrihet në zonën e thellë malore të Malit të Thatë, ku afër 200 familje janë shpërngul dhe shumica e tyre në janë vendosur Tetovë, Gostivar, Radiovcë, Pallaticë, Saraqinë etj. Këto lëvizje mekanike inspirohen nga motivet e ndryshme si ato ekonomike dhe jo ekonomike. Në lëvizjet ekonomike bëjnë pjesë: punëtorët fizik dhe të kualifikuar që pjesa më e madhe janë të punësuar në qytetin e Tetovës, por edhe në administratë, shoferët që bëjnë transportin e mallrave dhe materialeve të ndryshme, taksistët që bëjnë bartjen e njerëzve për në qytet dhe anasjelltas etj. Faktorë të cilët i kushtëzojnë këto migrime janë më tepër ato të natyrës ekonomike e më pak ato të natyrës socio-psikologjike.

Migrimet e jashtme

Për sa i përket migrameve të jashtme të popullsisë, ato ndodhin si pasojë e problemeve ekonomike, politike fetare etj. Në problemet ekonomike bëjnë pjesë ato persona të cilët largohen jashtë vendlindjes së tyre, për tu siguruar një jetë ekonomike më të mirë anëtarëve të familjes. Në problemet politike janë ato persona të përndjekur politikisht, që në këtë komunë apo vend nuk mund të jetojnë, siç është rasti me shpërnguljen e shqiptarëve të këtushëm për në Turqi nga ana e pushtetit Jugosllav, që ndodhi në vitet e 50-ta, për pakësimin apo shlyerjen e popullsisë shqiptare nga trevat e tyre. Ku sipas një studjuesi shqiptar nga Kosova, pra të P. Nushit ku vlerësohet se nga këto hapësira shqiptare të ish Jugosllavisë për në Turqi janë shpërngulur 246.108 shqiptarë, nga ana tjetër sipas autorit H. Bajrami janë shpërngulur 412.000 veta. Ndërsa sipas një studiuesi maqedonas (D. Maqievski) në të njëjtën periudhë, vetëm nga Maqedonia për në Turqi, janë shpërngulur 160 mijë shqiptarë. Pastaj shpërngulja e shqiptarëve përtej Oqeaneve në SHBA, Kanada, Australi etj. Në migrimet e jashtme kohëve të fundit ato janë të natyrës ekonomike, ku pjesa dërmuese janë në shtetet e Europës Perëndimore, më pak në Europën dhe shtete ish Jugosllave si: Slloveni, Kroaci, Bosnje etj.

Tab. 16. Migrimet e jashtme në komunën e Bërvenicës

Viti	Gjithsej të emigruar në komunën e Bërvenicës	Brenda R . M .	Jasht R . M .
1999	19	18	1
2000	64	64	/

Në migrimet e jashtme më tepër merr pjesë gjinia mashkullore, e aftë për punë, por kohëve të fundit marrin pjesë edhe gjinia femërore. Në komunën e Bërvenicës ekzistojnë mbi 3.000 persona të cilët gjenden me punë të përkohshme jashtë vendit, ku pjesa më e madhe në: Gjermani, Zvicër, Itali, Norvegji, Danimarkë etj.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. Grup autorësh: *Historia e Popullit Shqiptarë*, Tiranë, 1994.
2. Islami, H.: *Rrjedha demografike shqiptare*, 1994, Pejë.
3. Laçi, S.: *Shqiptarët në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë*, 1998, Tiranë.
4. Pushka, A.: *Kosova dhe vazhdimia etnike shqiptare*. QIK, 1997, Prishtinë
5. Selmani, A.: *Popullsia e Maqedonisë*, "Diskont", 2005, Shkup.
6. Shabani, F.: *Shqiptarët e Maqedonisë*, (1908-1913), 2004, Tetovë.
7. Skenderi, F.: *Pikëpamje demografike të popullsisë së komunës së Bërvenicës*, "Çabej", 2001, Tetovë.
8. Skenderi, F.: *Popullsia dhe vendbanimet shqiptare në Maqedoni*, "Idris Seferi", 2006, Kumanovë.
9. Skenderi, F.: *Popullsia e Pollogut të Poshtëm*, "Logos", 2000, Shkup.
10. Skenderi, F.: *Vështrimi demografik i popullsisë së komunës së Zhelinës*, "Jehona", 2000, Shkup.
11. Skenderi, F.: *Disa aspekte demografike të shtimit natyror të popullsisë shqiptare në Maqedoni*, "Studime gjeografike", 2001, Tiranë.
12. *Општините во Република Македонија*, "Мисла", Скопје,
13. Панов, М.: *Енциклопедија на селата во Македонија*, "Мисла", 1999, Скопје.
14. Стефановски, Ж.: & Павловски, Ј.: "Тетово", 1987, Тетово.
15. Стефановски, Ж.: *Тетово и околината*, "Напредок", 1980, Тетово.

NAIM HALIMI

DISA DOKE TË LINDJES E RITE TË VDEKJES NË ANËN E KUMANOVËS

Lindja dhe vdekja si për të gjithë njerëzit edhe për shqiptarët, kuptohet edhe për ata të anës së Kumanovës, kumanovarët, janë dy ngjarje më të rëndësishme në jetën e tyre. E para është gëzim, sepse vijnë në jetë, dhe e dyta hidhërim ngase dalin nga ajo. Sidoqoftë, të dy ngjarjet përcillen me një varg dokesh e ritesh popullore, të cilat ndryshojnë pak a shumë nga vendet e tjera të banuara me shqiptarë.

Për shqiptarët e këtushëm, të këtij skaji të botës shqiptare, fëmija (njeriu) është pasuria më e madhe, prandaj lindjes së tij i kushtojnë rëndësi të veçantë. Sipas mendësisë së tyre, me lindje të fëmijës lidhet koha nga momenti kur femra, gruaja, nusja e martuar, ngel shtatzënë, ranë, me bark siç thonë këtu, e derisa lind fëmija dhe i vihet emri (emërohet). Gjatë kësaj kohe, si burri, nëna e tij, motrat e kunatat, njerëz të besuar të saj, kujdesen për nusen me barrë, qoftë fëmija i parë apo fëmijë me radhë. Ajo nuk lihet vetëm, ushqehet (brenda mundësive) më mirë, nuk lejohet të punojë punë të rënda (me peshë), të marrë udhëtime të gjata, të frikohet etj. Gruas shtatzënë që t'i shkojë mbarë shtatzënia, i bëhen edhe disa adete, si të mos marrë mësysh (të mos e shohë syri i keq nga njerëz sykëqij, zemërzi), të mos e zënë sehuret (mxhitë), të ruhet nga koflargu (djalli) etj., krejt me qëllim që ta mbajë fëmijën, të mos e qesë, ta lindë në kohë më lehtë e të jetojë. Sipas mendimit të tyre, fëmija jeton nëse lind në shtatë, nëntë, dhjetë dhe dymbëdhjetë muaj (hanë), ndërsa në gjashtë e tetë muaj nuk jeton. Gjatë kësaj kohe, për shtatzënë shumë gjëra janë të ndaluara, p.sh. nuk duhet të kapërcejë gjëra të shtrira në tokë, si njerëz, litarin, shkambin, t'holluesin, etj., ta prekë macen me këmbë, sepse fëmija pastaj do të kërriasë gjatë rritjes, të marrë bukë ose diçka tjetër nga njerëz të dyshimtë dhe të panjohur, të mashtrohet me gjëra ushqimore që i sheh të tjerët duke ngrënë e nuk i japin për ta kërkuar etj. Disa adete janë të lidhura edhe me atë se çfarë fëmije do të lindë, mashkull apo femër, p.sh., nëse i ndizet zjarri shpejt lind djalë e nëse ngadalë e tymon lind vajzë. Disa adete janë të lidhura edhe me çështjen e grave që nuk bëjnë fëmijë apo nuk u rrojnë, shumica prej të cilave kanë karakter fetar, sidomos islamik, p.sh. ato i çojnë nëpër hoxhallarë, të cilët i frynë, u shkruajnë dhe u japin të mbajnë hajmali, i çojnë në teqe, therin kurbanë etj. Gratë të tilla i çojnë edhe nëpër njerëz të tjerë si nëpër plaka, që u ka dalë zani se dinë diçka për këtë punë të grave etj. Grave që s'bëjnë fëmijë u fusin edhe në ujë të ngrohtë, i çojnë nëpër banja etj. Gratë që nuk lindin fare konsiderohen si të pa fat, madje si të tilla konsiderohen edhe ato që lindin pak fëmijë dhe vetëm femra. Lindja e shumë fëmijëve e sidomos djemtë i gëzonte pa masë jo vetëm prindërit por tërë familjen sepse në kushte të rënda të jetës në malësi, po edhe në fushë e në qytet, për një

kohë të gjatë vetëm te ata, djemtë, e shihnin ushqyesin, mbajtësin dhe mbrojtësin e tyre. Prandaj thoshin se djali është me fat, lind me një nafakë, por mandej i shtohet fati, ndërsa, vajza (çika) lind me shtatë, me bereqet, por mandej i vogëlohet, sepse gjashtë nafakë i lenë te baba, e një e merr te burri. Kështu mendohej dikur, ndërsa sot thonë “vajza për babë e nënë është tërë jetën e djali deri sa të martohet”, ndoshta me të drejtë. Sidoqoftë, lindja e fëmijës së parë, sidomos kur është djalë i vetëm (hasreti), e gëzon shumë familjen e cila gëzimin e shfaq edhe me krisje pushke dhe disa ceremoni të tjera.

Një varg adetesh janë të lidhura edhe për momentin kurë shtatzëna e lind fëmijën. Në mungesë të mjekut (gjinekologut), pothuaj e gjithë gjenerata e vjetër dhe e mesme e fëmijëve kanë lindur në shtëpi. Të gjitha adetet që ia kanë bërë shtatzënë para se të lindë, kanë pasur për qëllim që fëmija të lindë sa më mirë, më shpejt dhe më lehtë, por fatkeqësisht të gjitha rastet nuk kanë përfunduar kështu, sepse gjatë lindjes ka pasur edhe shumë vdekje të fëmijëve madje edhe të nënave të tyre. Për lindje të mbarë janë bërë edhe përgatitje me kohë. Shtatzëna qysh para lindjes, me të hyrë në hanë të vet, siç thuhet, ka bërë disa përgatitje për vete dhe fëmijën që do të lindë, si shtrojën e mbulojën, pelenat, një pe dhe një brisk. Shtatzënë kur i vjen koha për ta lindur fëmijën, e kapin dhimbjet e lindjes, hyn në dhomë të veten, e shtron shtratin duke hyrë me të edhe një grua e cila do t'i ndihmonte në lindë, e kryente punën e mamisë, e afërt e saj dhe e burrit, e besuar dhe që i shkonin për dore punët e lindjes, por nëse gruaja kishte lindje të vështirë atëherë i ndihmonin edhe dy-tri gra të tjera. Nëse shtatzëna kishte mundime të mëdha në lindje, i bënin edhe disa adete si p.sh. i jepnin të pijë ujë nga lulja e Qabesë, për të cilën mendonin se çelej vetëm në raste të veçanta, ia zgjidhnin flokët kocol (bishtalecat), e shtinë në ujë të vakët në koritë, e avullonin etj. Në lindjen e fëmijës marrin pjesë vetëm gratë, madje sikur edhe të jetë lindja e vështirë, asnjë nga burrat s'guxon të afrohet aty, qoftë edhe burri saj. Nëse lindja shkon normal, fëmija lind pa vështirësi për atë dhe nënën, dhe fëmija qan, me të cilën kuptohet se është gjallë dhe ka ardhur në jetë, fëmijës së porsalindur ia presin kërthizën dhe ia lidhin me perin (e leshit) të siguruar më parë, e lajnë dhe lidhin lulakë (lirek), ia japin nënës ta marrë në gji, përkrah ose e fusin në djep, të cilin e përgatitin po ashtu që më parë. Pas lindjes, për djalin ose vajzën që lind, njoftohet familja e ngushtë. Sipas adetit, fëmijën së pari mund ta shohin anëtarët e familjes dhe dikush tjetër i afërm, të cilët e urojnë me fjalët “Hajrli qoftë djali ose vajza(çika)! Koftë me ymër e me nafakë! U rritë me babë e nanë!” etj., duke prekur për djalë edhe ndonjë send të metalit ose arit, me dëshirë që të jetojë sa hekuri gjatë dhe të bëhet i vlefshëm si ari. Sipas zakonit të kësaj ane, nëna e fëmijës apo lehona, pas lindjes, pasi rregullohet (pastrohet), bie në shtrat ku duhet të rrijë sipas mundësive deri në shtatë ditë për çështje qetësimesh trupore.

Lindja e fëmijës dhe hulumtimi për t'ia gjetur emrin, prestarit më të ri të asaj familje, paraqet një gëzim të veçantë. Prindërit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes, tani e edhe më herët fillojnë të interesohen që të posalindurit t'ia gjejnë një emër të mirë. Si zakonisht emërtimi i fëmijës bëhet brenda shtatë ditëve, jo pas e as para lindjes. Për pagëzimin e fëmijës, ekzistojnë disa rregulla dhe përcaktime, të cilat mbështeten në disa dispozita fetare e kombëtare dhe në disa doke e zakone të

krijuara, sipas nevojës. Sipas rregullave të vjetra, posa lindte fëmija, lihej pak në tokë sa i shkruhej nafaka (fati dhe fatkeqësitë, nga Zoti), dhe menjëherë emërohej nga të pranishmit që merrnin pjesë gjatë lindjes, duke e pagëzuar sipas bindjeve fetare me emra të profetëve të dalluar islamë si Adem, Havë, Muhamed, Fatime, Ali etj., me qëllim që ai të ketë mërsinë e tyre, të jetë i mirë, i hairit, i mbarë e me cilësi të tjera të mira si ata. Ky është pagëzimi i përkohshëm i fëmijës, i cili kishte të drejtë ta mbajë emrin e profetit deri në shtatë ditë, derisa t'i gjendej një emër tjetër, i përhershëm. Sipas besimit islam, fëmija s'bënte aspak të rrinte pa emër, sepse nëse vdiste nuk bënte të shkonte në varr pa emër, prandaj nëse vdiste brenda këtyre (shtatë) ditëve shkonte në varr me emrin të profetëve dhe nuk i vihej më emër tjetër. Në emërtimet e përhershme ka raste kur shumë fëmijë merrnin emrin e ndonjë të vdekuri nga familja, nga të parët, jo vetëm për ta përtërirë emrin e të ndjerit, por edhe për ta ruajtur të gjallë kujtimin ndaj tij. Gjithnjë sipas bindjeve fetare të banorëve të kësaj ane, i cili po rritet gjithnjë e ma shumë e nuk po vogëlohet, pothuaj të gjithë emrat e brezit të vjetër dhe të mesëm kanë karakter arabo-turk, si të muajve të mëdhenj e të festave si Rexhep, Shaban, Ramadan, Bajram etj., sidomos ata që lindnin në këto muaj. Duke menduar se është "sevap" i madh, fëmijët janë emëruar edhe me emra më të përafërt me atributet e zotit si Nimetulla, Bejtulla, Hajrulla etj., madje edhe me emra të cilët fëmijët nuk e kanë merituar por që për emërtuesit ka qenë të pakuptueshëm si Destan, që në shqipe do të thotë "qimja e bishtit të kalit". Emërtimet në shumë raste i kanë bërë njerëzit e ditur fetarisht, duke kënduar dovë në veshë të djathtë në formë të tallkinit, sepse sipas besimit të tyre të atëhershëm, njeriut i këndohen dy tallkine, kur t'i vihet emri dhe kur të vdesë, varroset. Për sa i takon kësaj çështje sot, po t'i analizojmë të gjitha emrat që u përkasin gjuhëve arabe-turke, do të dilnim shumë qesharakë, prandaj këtë dukuri të emërtimit të fëmijëve, me emra të gjuhës së huaj ia lamë së kaluarës, për t'iu kthyer pagëzimit me emra shqip. Sot pothuaj mbarë brezi i ri kanë filluar t'i pagëzojnë me emra kombëtarë shqiptarë, me burim nga gjuha shqipe, si: Arsim, Alban, Arbresh, Bekim, Besë, Bashkim, Dardane, Durim, Drita, Egzon, Edon, Florije, Flamur, Fitim, Genc, Gëzim, Herolind, Jeton, Ilir, Krenar, Liridona, Milot, Ndriçim, Patriot, Qëndrim, Rinor, Sokol, Shqiponja, Shqipe, Visar, Valon etj. Emrat e tillë të marrë nga leksiku ynë i pasur, jo vetëm që i japin kuptim, shije bukuri dhe kthim në vetvete, po e pasurojnë patroniminë tonë, e cila ka qenë e ndikuar nga ideologjitë e ndryshme fetare e politike. Tani me rastin e pagëzimit nuk bëhet ndonjë ceremoni fetare as familjare si më parë, pos ndonjë urimi si "E bajtë me fat, me shëndet e me jetë të gjatë emrin".

Përderisa lindja është ngjarje gëzimi, vdekja që këtu quhet ndryshe edhe mortja, është ngjarje hidhërimi, mërziqe, vaji e dëshirimi, sepse i dëshpëron dhe i trondit jo vetëm anëtarët e familjes, ku e zvogëlon numrin e anëtarëve e të punës, të fafësisit, por edhe shokëve e miqve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Dhimbja është edhe më e madhe kur në familjet e varfra të kësaj ane vdes "direki i shpisë" mashkulli i punës, mbajtës i vetëm i familjes.

Edhe për vdekjen si për ngjarjet të tjera populli ka krijuar një varg ritesh (ceremonish).

Sipas besimit të tyre (pleqve e plakave), vdekja njeriun e lajmëron më herët se në momentin kur vdes, jep shpirt, nëpërmjet disa shenjave si p.sh., i këputet trupi, si hahet ushqimi, gjumin s'e bënë mirë, s'ka interesim për të punuar as jetuar, vdekja i paraqitet në ëndërr etj., madje i paraqiten edhe disa shenja që e paralajmërojnë njerëzit e vdekur e të gjallë, gjësendet që e rrethojnë, shtazët, dergja (sëmundjet) etj. Prej gjithë këtyre si lajmëtarë më të sigurt të vdekjes e besojnë sëmundjen (dergjen), nga e cila i sëmuri pavarësisht nga koha që dergjeje, shkurt apo gjatë, të shumtën e rasteve përfundonte me vdekje. I sëmuri që dergjeje, nga padituria dhe mungesa e shërbimit medicinal, në këtë anë, e kërkonte shërimin e vet, në radhë të parë prej Zotit. Populli i kësaj ane, pothuaj i tëri është me përkatësi fetare islame (muhamedane) dhe fuqishëm i beson Zotit, i cili është i madh, fuqia e tij është e pakrahasueshme, i çon njeriut sëmundje e shëndet, varfëri e pasuri, në përgjithësi të mirat e të këqijat, për t'i sprovuar besimtarët e vet, se sa janë ata të besueshëm e të qëndrueshëm. Ata besonin se Zoti ka mundësi ta çojë të vdekurin, e lëre më të sëmurin, prandaj i sëmuri dhe familja e tij, madje edhe farefisi dhe shokët e miqtë e tij, i luten natë e ditë ta shërojë, t'ia shpëtojë jetën, të jetojë. Mandej ka raste kurë i sëmuri, s'bën më mirë as më keq i luten zotit ta drejtojë, o andej o këndej (nga jeta ose vdekja), e ta shpëtojë sa më shpejt nga vuajtjet e mëdha të sëmundjes. Kjo tregon se njeriu i ynë, më tepër e do vdekjen e shpejt se sa jetën e gjatë me vuajtje e dhimbje. Ka raste kur të sëmurit s'i hiqej dhimbja, kërkojnë ndihma të tjera, shkojnë te hoxha i shkruajnë hajmali, i çojnë ujë për t'i fryrë e për ta pirë, e nëse nuk i ndihmonin këto atëherë e thërrisnin në shtëpi hoxhën ose dikë tjetër të këndueshëm fetarisht, për t'i kënduar te kryet dua nga libri i shenjtë, Kurani. Nëse edhe këto nuk i ndihmonin, atëherë njeriu ynë i paarsimuar kërkon shpëtim në kotësi të tjera si në pokushe e adete të shumta në fallxhorë, në vende të shenjta, si në teqe, tyrbe, xhami etj.

Njeriun që është i sëmurë rëndë pa kurrfarë shprese për shërim nuk e lënë vetëm. E ruan dikush nga anëtarët e familjes, që të mos vdesë pa e parë askush, duke i bënë shërbime të nevojshme, në larje, pastrim dhe haje e pije, madje për të dëgjuar ndonjë amanet, porosi a këshill prej tij, nëse ka. Në këtë rast edhe familja bën përgatitje, lajnë e pastrojnë shtëpinë, blejnë gjëra ushqimore, sheqer, kafe, cigare etj. I sëmuri si e sheh që po i afrohet koha e vdekjes nëse e ka vetëdijen, i thërret dhe e mbledh familjen e vet për t'u përshëndetur, për të marrë hallallëk. Nëse është zot shtëpie i këshillon të tjerët që të jetojnë në harmoni, të ketë drejtësi në punë, ta duan njëri-tjetrin, u tregon nëse ka dhënë ose ka marrë borxh dikund etj. Më në fund ua bën hallall të gjithëve dhe merr hallallëk prej tyre, duke thënë "Ma bani hallall!". E ata ia kthejnë "Hallall të qoftë!". Nëse si del shpirti derisa është i shtrirë në shtrat, dikush prej të pranishmëve i hyn nën krahë, sqetulla, nga pas shpina, duke e ngritur pak si drejt. Derisa i sëmuri përpigjet të japë shpirt, të pranishmit në dhomë mbajnë qetësi të plotë, bien shehadet, luten që i sëmuri ta japë shpirtin më lehtë, nuk qajnë me zë, e nëse dikujt i shpëtojnë lotët, ruhen që të mos i shohë i sëmuri. Po ashtu të sëmurit ia kujtojnë, nëse ai nuk kujtohet vetë, habitet, të bjerë shahadet me qëllim që të shkojë, të dalë nga kjo botë, me iman, e të mos e mashtrojë djalli. Fëmijët nuk i lënë që të afrohen në këtë moment, që të mos frikësohen.

Posa vdes njeriu, i sëmuri, ia ndërrojnë vendin. E shtrinë në dyshek në mes të dhomës, me krye nga lindja, Qabeja, në shpinë, duart ia palojnë për mesi njërën mbi tjetrën, sikur falet, ndërsa fëmijëve ia lënë përkaj trupit anash drejt, duke mbuluar me çarshaf, qebe ose jorgan më të mirë. Të vdekurit ia mbyllin kapakët e syve, me dorë dhe ia mshelin gojën duke ia lidhur me një shervete prej mjekre kah kryet. Fytyrën ia mbulojnë me një maramë (peshkir) të bardhë. Të vdekurin para vdekjes e rregullojnë dhe e pastrojnë. Para se ta lajnë ia heqin stolitë dhe zburimet tjera, madje nëse ka edhe dhëmbë të arit. Në dhomën e të vdekurit, xhenazes, rrinë të afërmit të familjes, për grua gratë e për burra burrat, ndodh të rrinë edhe të përzier. Sa vdes, i sëmuri, caktohen njerëz për të njoftuar familjen e gjerë, farefisin, shokët e miqtë për vdekjen e të sëmurit, kohën dhe vendin e vorrimit. Njoftimi bëhet edhe nëpërmjet temxhitit, në xhami (minare të xhamisë), që e thirr hoxha apo njerëzit e caktuar nga ai. Kohën e fundit njoftimi bëhet edhe me anë të telefonit, me fjalët “Hajdi se ka vdekë NN”. Përderisa njoftohen njerëzit, bëhen edhe përgatitje tjera, për varrim. Njoftohet, thirret, hoxha për ta larë xhenazen mashkull dhe për t’i kryer ceremonitë e tjera të varrimit, ndërsa hoxhonica (grua) i lanë femrat. Larjen e xhenazes, mund ta bëjë edhe dikush nga të afërmit nëse di ose nëse i vdekuri e ka lënë me gojë amanet sa ka qenë gjallë. Në xhami merret teneshiri ku lahet i vdekuri dhe tabuti ku vendoset dhe bartet i vdekuri te varret, përgatitet varri, dërrasat dhe sigurohet qefini. Të gjitha këto punë i kryejnë njerëzit pa pagesë, pos hoxhës apo hoxhonicës (në qytet paguhet vend varrimi në ndërmarrje për mirëmbajtjen e varreve). Nëse shtëpia e familjes së të vdekurit është e vogël për të gjithë njerëzit që vijnë për varrim, lëshohet ndonjë shtëpi tjetër aty afër për burra, gratë rrinë të xhenazja, i vdekuri. Te i vdekuri në dhomë derisa të merret për t’u larë rrinë gratë po edhe burra të familjes. Sipas fesë islame i vdekuri duhet të varroset sa ma shpejt, prandaj banorët e kësaj ane, si besimtarë të kësaj feje, të vdekurin nuk e mbajnë gjatë në shtëpi. Pas përgatitjes dhe ardhjes së të ftuarve, xhematit, katër burra e marrin të vdekurin nga shtrati me qebe dhe e çojnë në oborr te vendi i larjes në teneshir, në vend të përgatitur për këtë qëllim. Dy njerëz e lajnë kufomën, njëri që i di rregullat e larjes e lan e tjetri i qet ujë të ngrohtë, pastaj mbështillet me qefin (çarçafë të bardhë), pos fytyrës që i lihet çelë për ta parë, vendoset në tabut, vendoset në vend të përshtatshëm ku njerëzit shkojnë për ta parë për herë të fundit dhe përshëndeten me te, duke u sjellë rreth tij. Më pas aty, në oborr, në xhami ose te varret, të vdekurit i falet xhenazja dhe dërgohet me bartje në krah të tabutit nga katër njerëz të cilët ndërrohen deri te varret, varri i hapur. Në varr sipas zakonit, me kokë kah lindja e diellit, Qabeja, lëshohet nga tre njerëz të afërt të tij, i vendosen dërrasat dhe mbulohet me dheun e varrit në formë të piramidës, duke ju vënë një shenjë prej guri ose dërrase te kryet e te këmbët. Këtu në prani të xhematit i këndohet tallkini, nga hoxha, dhe xhemati kthehet për në shtëpi, në radhë duke i ngushëlluar anëtarët e familjes, që të mos mërzhiten, me fjalët “Mos u mërzhitni, zoti u lasht shnoshë, e xhetshi në xhenet” etj. Me këtë përfundon vdekja dhe në familjen e të vdekurit hapet e pamja, ngushëllimi.

Në anën e Kumanovës, doket e lindjes dhe ritet e vdekjes që bëhen lidhur me lindjen dhe vdekjen janë të shumta dhe të ndryshme, por ne këtu bëjmë përpjekje që të vihen në dukje ato që janë më të përgjithshme për katundet e kësaj ane dhe që

janë më me interes, si për lexuesin ashtu edhe për këtë lloj të traditës sonë kulturore në përgjithësi.

JETON DOKO

NJË DOKUMENT MAQEDONAS KU PËRSHKRUHET SITUATA POLITIKE TE SHQIPTARËT NË OHËR ME RRETHINË

Në fondin e Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë gjendet e arkivuar informata për dukuritë irredentiste midis kombësisë shqiptare në rajonin e Ohrit. Dokumenti është i shkruar më datën 09.03.1960 në periudhën më të egër sistemit komunist, gjegjësisht në kohën e Aleksandar Rankoviq (1909-1983) dhe kryetarit të Jugosllavisë Josip Broz Tito (1892-1980) i cili e stimulonte shpërnguljen e shqiptarëve të Jugosllavisë në drejtim të Turqisë. Nisur nga fakti se dokumenti nuk është botuar deri më sot, e pamë të arsyeshme që përmes revistës “Studime Albanologjike”, ta botojmë në tërësi¹.

...

“Informate**Mbi dukuritë irredentiste midis pakicës kombëtare shqiptare në regjionin e Ohrit.**

Në muajt e fundit dukuritë irredentiste midis pakicës kombëtare shqiptare marrin dukurit më të mëdha. Si flamurtarë të këtyre dukurive në 1959 në këtë regjion janë regjistruar rreth 200 persona. Dukuri irredentiste janë zbuluar në krejt rajonin, por me ekstremitetin dhe masovitetin e vet janë për t’u theksuar dukuritë në rrethin e Dibrës dhe Strugës.

Për dallim prej më parë kur si flamurtarë të irredentizmit paraqiteshin elementet e ndryshme balliste dhe armiqësore, në kohën e fundit në këtë linjë paraqiten edhe persona që deri dje e kanë përkrahur politiken tonë, ndërmjet tyre edhe anëtar të LK-së.

Numri më i madh i këtyre personave rrjedhin prej radhëve të punëtorëve të arsimit, por nuk janë të pa involvuar edhe persona prej profesioneve të tjera si nëpunës, bujq etj /Dibër, rrethinën e Dibrës dhe Strugës/. Midis mësuesve janë zbuluar edhe paraqitje për veprimtari të organizuar.

Është për t’u theksuar që sot në qëndrimet irredentiste shihet edhe lidhja e përkrahësve të politikës të udhëheqjes të Republikës Popullore të Shqipërisë me elemente të ndryshëm të cilët janë të orientuar me ide pro-perëndimore me elemente shqiptaromëdha.

¹ Државен Архив на Република Македонија, фонд ЦК КПМ/СКМ, сиг. 1.427.97.32/396-400.

Dalja e këtyre dy grupeve me platformë të përbashkët të Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore ndaj Shqipërisë më shumë shihet pas mbledhjes së Hrushovit dhe Ajzenhaëerit në SHBA ka mjaft raste të personave të cilët janë të orientuar me ideologji kapitaliste, të cilët më herët me urejtje janë sjellur ndaj BRSS-së dhe udhëheqësve të Shqipërisë, tani qëndrojnë në linjën për luftë të përbashkët për bashkimin të Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore ndaj Shqipërisë dhe glorifikojnë BRSS-ne si fuqi e madhe ushtarake me ndihmën e së cilës Shqipëria dhe Bullgaria do të realizojnë kërkesat e tyre ndaj Jugosllavisë në këtë aspekt është shfrytëzuar edhe vizita e Hrushovit dhe Zhivkovit(Todor) në Shqipëri, flitet se Zhivkovi dhe Enveri janë marrë vesh që në një çast të volitshëm kërkesat e tyre ndaj Jugosllavisë ti shtrojnë para OKB-se.

Theksohet se në Shqipëri është themeluar komiteti i cili punon në mënyre paqësore për bashkimin e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë në këtë aspekt shfrytëzohet edhe shpërngulja e një pjese të maqedonasve nga rrethi i Dibrës në pjesët tjera të Maqedonisë. Ka komente që këtë e bëjnë Maqedonasit sepse e dinë se në këto vende do të bashkohen Shqipërisë.

Qëndrimet e ndryshme armiqësore dhe irredentiste të pakicës shqiptare lidhet me këtë:

-Kërkesa e hapur e Kosovës dhe një pjesë e Maqedonisë Perëndimore në një pjesë të Shqipërisë. Theksohet se Shqiptarët gjatë kohës së luftës kanë luftuar për çlirim të Shqipërisë dhe jo të Jugosllavisë, pastaj se këto vende janë të çliruara nga partizanët Shqiptar dhe ka pasur marrëveshje nga ana e Jugosllavisë që të bashkohen me Shqipërinë. Por Shqipëria ka qënë e gënjyer nga ana e Jugosllavisë për të cilën akuzohet edhe Koçi Xoxe që në vitin 1945 ka dhënë urdhër të tërhiqen repartet ushtarake shqiptare nga këto territore.

-Bindet popullata Shqiptare në bashkimin e shpejtë të këtyre vendeve në Shqipërinë për shkak që nuk duhet të këtë asnjë farë shpërngulje në këto territore.

-Se Shqiptarët në Jugosllavi janë kombëtarisht pa të drejta. I punojnë punët më të rënda fizike, për gabime të rënda burgosen, u jepen tatime të mëdha, në pushtet janë fare pak të angazhuar, nuk vihen në poste më të larta, nuk hapen shkolla të mesme në gjuhën shqipe etj.

-Propagohet përparimi i zhvillimit shoqëror të Shqipërisë. Theksohet se Shqipëria është vendi më stabil në Ballkan në të cilin ka mirëqenie të plotë ekonomike dhe bashkim i popullit.

-Në plan të përgjithshëm sulmohet politika e jashtme dhe e brendshme të Shqipërisë.

Për zmadhimin e sjelljeve irredentiste ndërmjet të tjerëve ndikon edhe kjo:

1. Propaganda intensive armiqësore kundër RFPJ-së nga ana e Shqipërisë në përmjet emisioneve të Radio Tiranës në lidhje me kërkesat territoriale të anës së Jugosllavisë.
2. Përkrahja e kërkesave të qëndrimeve Shqiptare nga ana e BRSS-së dhe vendeve të tjera të Evropës Lindore, vizita e Hrushovit në Shqipëri dhe SHBA si dhe vizita e Zhivkovit në Shqipëri.

3. Nënçmimi i fushatës kundër shtetit tonë dhe zgjuarsia e pamjaftueshme e aktivitetit politike në këtë fushë nga ana e Lidhjes Komuniste të Maqedonisë dhe organizatave të tjera politiko-shoqërore.
4. Shikimi i dobët i ndryshimeve që bëhen te pakicat kombëtare pas çlirimit. Aktiviteti i pamjaftueshëm i organizatave te ndryshme te LKM-së dhe vendosmëria për tërheqjen e disa pengesave objektive për afirmim më të madh dhe zgjerim te barabarësisë kombëtare.
5. Emisionet te pamjaftueshme të Radio Shkupit në gjuhën shqipe dhe pamundësia e i të njëjtit të dëgjohen në më shumë vende të rajonit.

Propaganda e cila zhvillohet në përmjet emisioneve të Radio Tiranës në masë të madhe është i zmadhuar edhe me interesimin e popullatës shqiptare ndaj ngjarjeve të brendshme të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ka mjaft raste që tregojnë se popullata shqiptare me interes e vëzhgon zhvillimin ekonomiko-shoqëror të Republikës së Shqipërisë. Në rajon ka rreth 600 radio aparate te familjet shqiptare, prej te cilëve 150 përdoren prej elementeve armiqësisht të disponuar. Komentet në lidhje me emisionet e Radio Tiranës mund të dëgjohen në të njëjtën kohë si në Dibër, Strugë dhe në vende në mënyre masive dëgjohej Radio Tirana dhe nëpërmjet saj ndiqen të gjitha ngjarjet në Shqipëri. Është karakteristike dhe ajo që këto emisione dëgjohej edhe prej komunistëve te cilat fare nuk reagojnë ndaj kësaj propagande armiqësore .

Përveç emisioneve të Radio Tiranës, propaganda armiqësore zgjerohet edhe nëpërmjet personave të ikur nga Jugosllavia në Shqipëri. Në letrat që i lëshojnë familjareve të vet dhe miqve të tyre në Maqedoni sulmohet vendi ynë (Jugosllavia J.D.), ndërkaq lavdërohet Shqipëria. Në letrat jepen edhe fotografi nga objektet te ndryshme ekonomike të ndërtuar në Shqipëri apo fotografi personale, të fotografuar me kostume, me orë dore, me stilolapsa ne xhepa etj. Këtë kryesisht e bëjnë nxënësit të ikur. Ato shkruajnë se u është e munduruar qe te shkollohen, per çka u janë dhënë stipendione të majme. Disa herë këto letra lexohen edhe para grupeve të ndryshme të njerëzve. Kësi rastesh ka nga ana e mësuesve nga fshati në Dollogozhdë, Kalishtë etj.

Investimet si dhe vet zhvillimi ekonomik në vitet e fundit në Shqipëri kanë ndikim të veçantë për zmadhimin e qëndrimeve irredentiste. Më parë si propagandë armiqësore e cila nuk ishte e vogël, por për shkak të zhvillimit më të ngadalshëm ekonomik të Shqipërisë zhvillimi i saj te pakica shqiptare nuk ishte e madhe (e ndikueshme).

Si rezultat i kësaj propagande prej këtij regjioni që në vitin 1959 në Shqipëri kanë ikur rreth 30 persona, që pas ikjes të familjes Lleshi është numër i konsiderueshëm, viteve të tjera kanë ikur 2,3 deri në 10 persona në vit.

Problemi i fushatës armiqësore si dhe ndikimi i saj te popullata shqiptare është analizuar nga ana e komiteteve komunale të LKM-së dhe janë marrë masa të nevojshme por nga ana e komiteteve komunale si dhe prej vet organizatave themelore manifestohet një aktivitet josistematik dhe konkret ideo-politik.

Prej diskutimeve me sekretariatet të komiteteve komunale të LKM-së në Dibër, Strugë dhe Kërçovë, mund të konstatohet se ato nuk i analizojnë rregullisht dhe me vëmendje manifestimet armiqësore dhe irredentiste si dhe masat për eliminimin e tyre. Disa dukuri edhe pse shihen se janë armiqësore shihen me nënçmim dhe nuk shihen tendencat që dalin prej tyre. Kështu për shembull në LKM Dibër i është i njohur fakti se dëgjimi i emisioneve të Radio Tiranës merr dukuri marramendëse, se ka komente armiqësore të ndryshme, por asgjë nuk ka konkrete. Në dukuritë për dënimin e këtyre dukurive nga ana e komitetit rajonal të LKM-së te disa anëtarë të komitetit komunal të Dibrës shihet mospajtimi, duke e motivuar këtë qëndrim se prej emisioneve të Radio Tiranës dëgjohen vetëm emisionet muzikore, për çka edhe ndikimi i këtij radistacioni te pakica kombëtare shqiptare është zakonisht minimale.

Në tri komunat në të cilat janë mbajtur mbledhje të veçanta të sekretariateve komunale nuk është e analizuar asnjë raste në muajt e fundit që në mbledhje të diskutohet për dukuri konkrete të manifestimeve irredentiste armiqësore.

Sekretariati i komiteteve komunale të LKM-së duke bërë analizë të mbarë fushatës armiqësore te pakica kombëtare shqiptare në këtë rajon dhe për shkatërrimin e të njëjtës, i propozon këto detyra:

1. Në mënyrë më konkrete të shkohet te zbatimi i detyrave të komiteteve komunale të LKM-së në lidhje me pakicat kombëtare;

2. Të mbahen mbledhje me aktivet e komunistëve prej radhëve të mësuesve dhe përveç këtyre probleme politike dhe ideore të diskutohet edhe për këtë dukuri, duke i theksuar dukurit e personave të ndryshëm;

3. Çështja e dëgjimit e Radio Tiranës të shtrohet në renditje te organizatat themelore të organizatave të LKM-së dhe të diskutohet rreth shfaqjeve dhe komenteve që janë në lidhje me këtë të kritikohet dukuria e dëgjimit të emisioneve në radiostacionet armiqësore nga ana e disa komunisteve dhe joreagimi i tyre kur komentohen të njëjtë. Për sa i përket theksimit të dukurisë së nënçmimit të fushatës dhe jo zgjuarsia gjatë shkatërrimit të propagandës armiqësore;

4. Organet e punëve të brendshme më shpesh ti informojnë komitetet për këtë dukuri gjithashtu, të zhvillohet zgjuarsia më e madhe te komunistët në organizatat themelore. Komitetet komunale më shpesh ti analizojnë dukuritë, të marrin masa të nevojshme dhe ta informojnë komitetin rajonal;

5. Në mënyrë sistematike dhe te vazhdueshme të punohet prej të gjithë faktorëve politik relevant për shkatërrimin e dukurive armiqësore dhe irredentiste, për çka duhet të ketë llogari që të mos glorifikohen këto dukuri dhe ky aktivitet mos e ketë karakterin e fushatës. Te gjitha këto dukuri të merren prej shumicës të aktiviteteve të LKM-së si dhe organizatave të tjera politiko-shoqërore.

Shkup, 23.02.1960”.

*ARSIM SINANI***PËRNDJEKJA E FAMILJES DERALLA NGA TETOVA****Abstrakt**

Kjo temë që po shtrohet për trajtesë konsiston me përndjekjen e familjes së patriotit dhe njërit nga ideologët e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Mehmet Pashë Derrallës. Edhe sot, derisa po shkruajmë mbi këtë temë, mbeten enigma disa çështje që kanë të bëjnë me këtë derë të madhe të shqiptarizmit, e cila i dha gjithçka shtetit të ri shqiptar, Republikës së Shqipërisë (1912). Parashtrrohet si hipotezë, pse familja Deralla u dëbua në mënyrë brutale nga Tetova, kujt i pengonte një familje kaq e fuqishme dhe si u sekuestrua pasuria e plotë e tyre. Si përfundoi në burgjet jugosllave e sllavo-maqedonase njëri nga djemtë e Mehmet Pashë Derallës, Gajuri, si dhe saga e familjes Deralla deri në ikjen përfundimtare në Itali e më vonë në Amerikë.

Pse pjesa e familjes së Halim Derallës u largua shumë kohë më herët drejt Tiranës, ndërsa familja e Hysen Derallës, me urdhër, u ngarkua në një kamion dhe në përcjellje të policisë sekrete jugosllave (OZNA) u përzu për në Shqipëri, duke e lënë të lirë në kufi me Shqipërinë. Të gjitha këto do të jenë objekt i studimit tim mbi përndjekjen që iu bë familjes së Mehmet Pashë Derallës.

Familja Deralla dhe kontributi i saj në historinë shqiptare

Një nga dyert e njohura të shqiptarizmit, s'do mend se është edhe familja Deralla nga Tetova, një familje patriotike dhe me veprime të jashtëzakonshme në historinë shqiptare. Kjo familje dha një kontribut të jashtëzakonshëm në kryengritjet e ndryshme, në periudha kur Shqipëria ishte nën sundimin osman. Fakt i pamohueshëm është se Derallajt u përpoqën pareshtur në këto zhvillime, për të mbajtur gjallë shpirtin dhe idenë për mëvetësinë e shtetit shqiptar, gjë që u kurorëzua më 28 Nëntor të vitit 1912, në vjeshtën që solli krijimin e shtetit modern shqiptar¹.

Po në atë periudhë historike do të shquhej një gjeneral, i cili vite me radhë kishte qëndruar në ekzil dhe ishte i izoluar për shkak të qëndrimeve të tij, pikërisht

¹ Fatkeqësisht nga hulumtimet e bëra për këtë familje, rezulton se në Muzeun e Lidhjes së Prizrenit në Kosovë të mos ketë asnjë fotografi e familjes Deralla, e cila dha aq shumë kontribut në këtë Lëvizje. Realisht, kjo familje përciptazi kalohet në etapa të historisë, që tregon për një shkujdesje institucionale. Duke pasur parasysh rolin e familjes Deralla, kjo është një padrejtësi që i bëhet kontributit të saj, duke e ditur se si përfundoi familje në vitet e pas pavarësisë e deri në ditët e sotme.

ky ishte Mehmet Pashë Deralla, njëri nga figurat më interesante të Qeverisë së Vlorës. Me një edukim ushtarak në shkollat më të mira të kohës në Perandorinë Osmane, u shqua për stilin e tij të veçantë të një lideri dhe ushtaraku të zhdërvjelltë, që të gjitha arritjet e tij në Ushtrinë Osmane i flaku tej për një ideal: ëndrrën për të shpallur të pavarur Shqipërinë. Angazhimi i gjeneral Mehmet Pashë Derallës dhe djemve të tij, Halimit² e Munipit dhe më vonë edhe të Gajurit³ e Hysenit, tregojnë vazhdimësinë e veprimit patriotik të trashëguar nga stërgjyshërit e tyre, për idealin e krijimit të shtetit shqiptar. Deri më 28 Nëntor të vitit 1912, familja Deralla do të jetë çerdhe e veprimtarive të rezistencës shqiptare, duke u bërë vend i strehimit dhe i mbështetjes financiare të lëvizjes patriotike shqiptare⁴. Nuk do të shihej me sy të mirë aktiviteti i kësaj familjeje aristokrate tetovare, e cila përveç se ishte e angazhuar për çështjen shqiptare, bënte një jetë shumë komode për kohën, të cilën gjë kam konfirmuar nga pinjollët e kësaj familjeje, nga fotot dhe nga rrëfimet e më të moshuarve në Tetovë.

Familja Deralla bënte një jetë të mirë, ishte e fuqishme ekonomikisht, që do të jetë një përparësi e madhe për lëvizjen kombëtare shqiptare, pasi që me këtë prestigj kjo familje investoi tërë kapitalin e saj, për synime kombëtare, sikundër edhe Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Isë Boletini, Ismail Qemali etj⁵. Këta ishin njerëz që kanë mund të kishin poste dhe pozita të lakmueshme në administratën osmane, por zgjodhën rrugën e sakrificës, që Shqipërinë e shpëtoi nga fundosja në perandorinë osmane, si komb dhe zhbërja në kuadër të perandorisë osmane.

Deri në shpalljen e pavarësisë, gjithë ky mund e sakrificë do të shpaguhet, kurse për këtë kjo familje pësoi me vetëdije të plotë⁶. Por, problemet vazhdojnë me

² Aktivitetet patriotike dhe politike Halim Deralla i bëri në Tetovë, por duke u shquar si një ideolog dhe si një figurë shumë popullore, do të vihej në shënjestër të qarqeve serbe, të cilat dëshironin ta eliminonin. Kështu që pas një veprimtarie, Halimi detyrohet që me familje të zhvendoset në Tiranë, ku kreu funksione të ndryshme shtetërore, duke qenë edhe deputet në Parlamentin shqiptar.

³ Gajur Deralla përfundoi disa herë në burgje të ish-Jugosllavisë dhe më vonë arratiset drejt Italisë dhe Amerikës, i përndjekur për shkak të veprimtarisë së tij atdhetare. Me një kontribut të jashtëzakonshëm, edhe ky mbetet i pavlerësuar deri më sot.

⁴ Nga gojëdhënat në fshatin e prejardhjes së Mehmet Pashë Derallës, pleqtë mbajnë mend se janë katër mullinj të familjes Deralla që ishin në shërbim të çështjes shqiptare. Aq shumë pasuri kishin nga mullinjët, sa që familja Deralla kishte vendosur nga ndjenjat e mëdha patriotike që të investojnë në ndërtimin e shtetit shqiptar. Kjo gojëdhënë apo legjendë, që nuk mund të faktohet me argument të shkruar për shkaqe të kuptueshme, është përcjellë brez pas brezi në familjen Deralla. Këtë e vërteton edhe rrëfimi se personalisht Mehmet Pashë Deralla i ka dhuruar një arkë me flori për krijimin e institucioneve funksionale të Qeverisë së Vlorës. Këtë e dëshmojnë trashëgimtarët e kësaj familjeje të madhe, që i kanë ruajtur në memorie ndodhitë e asaj kohe. Kjo familje, për fat të keq, u shpërbë dhe u nda nga regjimi serb, sllavo-maqedonas dhe u vu në mbikëqyrje sistematike.

⁵ Dëshmi e kësaj është edhe shtëpia e njohur e Halim beut në zemër të Tetovës

⁶ Nga biseda me Genc Derallën shihet se familja zgjodhi që të sakrifikojë për shumë arsye dhe, ajo më kryesorja, kjo familje ishte e ngritur, menduan dhe vepruan në interes të çështjes kombëtare shqiptare. Edhe sot do e bënin të njëjtën gjë dhe do të vendoseshin po në ato pozicione, Tiranë, janar 2015

intensitet të lartë pas pavarësisë së Shqipërisë, që familjes Deralla do i kushtojë shumë, deri në largimin e dhunshëm të saj nga Tetova. Ditët e lumtura do të përfundojnë për këtë familje, përderisa me një urdhër fshihet nga të gjitha ditarët e kohës, duke mbetur vetëm simbol i saj shtëpia në Tetovë, e cila, për fat të keq, u shndërrua në një institucion për rehabilitimin e të sëmurëve mentalë.

Largimi i dhunshëm i Derallajve nga Tetova

Familja do të përjetojë episode nga më të vështirat, që nga koha kur Mehmet Pashë Deralla u vendos nën mbikëqyrjen e OZNA-s dhe “Crna Rukës” serbe. Mehmeti përfundon në burgjet serbe dhe ky do të jetë çmimi që do e paguajnë Derallajt, madje jo vetëm kaq.

I pari, fizikisht, drejt Tiranës do të largohet Halim Deralla, i cili atje do të vazhdojë të veprojë dhe jetojë me familjen e tij deri në vdekje, pa pasur mundësi që të vijë në Tetovë. Rrethanat u krijuan të atilla që ai s’do mund të kthehej dhe ishte i rrezikuar nga qarqet shoviniste serbe dhe sllavo-maqedonase. Realisht, Halim Deralla si deputet dhe si zyrtar, kreu detyra me rëndësi në administratën shqiptare, gjë që dëshmohet edhe nga dokumentet të cilat ekzistojnë në arkivat shqiptare. Halim Deralla u tregua i mençur, duke u tërhequr drejt Tiranës, sikur e parandiente furtunën të cilën do ta përjetonte familja. Si një diplomat i regjur, ai kalimin në Tiranë e bëri si një gjest të pakënaqësisë dhe mungese për të vepruar, por asnjëherë nuk e harroi familjen, të parët e vet dhe trungun që e la në Tetovë. Edhe sot, shtëpia e Derallajve në Tetovë njihet si shtëpia e Halim beut, e ndërtuar nga vetë dora e tij, aty afër shtëpisë së paraardhësve të vet, ku e ngriti monumentin e mbamendjes kombëtare që sot quhet Shtëpia muze e Halim Beut.

I dyti, pa dëshirën e tij, drejt Tiranës do të largohet edhe Hysen Deralla, me familjen e tij.⁷ Për një përjetim, nga më të pabesueshmit, dëshmon vajza e tij, Valdete. “Janë ruajtur këto kujtime në familjen tonë gjatë gjithë jetës. Me përkushtim e kam ruajtur këtë letër nga babai, që të mbetet si dokument faktik se ne jemi përzënë nga Tetova. Kanë ardhur dhe na kanë dhënë afat vetëm 2 orë, që t’i mbledhin gjësendet tona, pastaj na kanë dërguar në drejtim të Shqipërisë”, evokon kujtimin për dokumentin e ruajtur të babait, Hysen Deralla⁸. Sipas dëshmisë së tij, që e kemi dokumentuar me publikimin e shkresës, ata janë përzënë në vitin 1946. Në deklaratën e tij, siç vërehet edhe në dokumentin origjinal, familja e Hysen Derallës ka marrë çka ka mundur nga gjërat më kryesore, ndër to edhe disa foto, si kujtim nga Tetova. Nga dëshmitë del se familja Deralla, pas deportimit të dhunshëm të anëtarëve të saj nga vendlindja në Tetovë, është shuar pjesa më vitale e trungut të Derallajve në këtë qytet. Nga një dokument origjinal i gjendjes civile në Shqipëri shihet se ishin 12 anëtarë të familjes, të cilët u larguan drejt

⁷ Dokumenti origjinal (deklaratë e nënshkruar nga Hysen Deralla, e datës 2 qershor 1990) botohet për herë të parë. Nga arkivi i vajzës së tij, Valdete Deralla.

⁸ Bisedë me Valdete Derallën, 2 qershor 2014, Tetovë, në ambientet e Qendrës për Marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime ballkanike.

Shqipërisë⁹. Por ky numër duhet të jetë edhe më i madh, duke pasur parasysh se pas arratisjes së Gajur Derallës drejt Amerikës, në vendlindje mbetën kushërinj dhe familjarë të tjerë, numri i të cilëve nuk dihet me saktësi. Hysen Deralla dëshmon për atë se si janë përzënë dhe se si u është konfiskuar pasuria.

I fundit nga djemtë e Mehmet Pashë Derallës, që mbeti me familjen në Tetovë, ishte Gajur Deralla, një ushtarak dhe një autoritet i pakontestueshëm i këtij qyteti. Nga ajo që mësohet nga dëshmitarë të gjallë dhe ata që e kanë njohur këtë personalitet, ai nuk ka dashur të largohet nga Tetova, madje duke mbetur i vetëm. Përfundon në burgje, në Tetovë dhe Shkup, deri në vitin e largimit të tij më 1972, kur arratiset me bashkëshorten dhe me djalin, Berat Derallën, nëpërmjet Italisë për në Amerikën e largët. Në Amerikë menjëherë aktivizohet dhe fillon përpjekjet për të organizuar rezistencë, por ndërron jetë pas sëmundjeve që i merr në burgjet e Tetovës dhe Shkupit¹⁰. Lë amanet që djali i tij të kthehet në Tetovë.¹¹ Berat Deralla sot jeton në Tetovë, punon si zyrtar në Komunën e Tetovës. Nga biseda e bërë me Beratin, ai kujton se babai i tij më shumë ka qëndruar në burg sesa jashtë burgut, ndërsa familja është endur nga një shtëpi në tjetrën. Nga Shkupi, pas tërmetit, familja kthehet në Tetovë dhe jeton përkohësisht në Teqenë Harabati Baba¹².

Pas vdekjes së Gajur Derallës në Amerikë, sipas të birit të tij, Berat Deralla, ai kishte lënë shumë punë të nisura larg vendit të tij, për të mirën e shqiptarëve¹³. Gajur Deralla, para se të vdiste, ka këshilluar të birin, Beratin, që të kthehet në vendlindjen e të parëve dhe pasurinë ta shfrytëzojë për të mirën e shqiptarëve. Por, Berati dëshmon se pasuria e tyre në Tetovë ishte sekuestruar, madje kishin kaluar një jetë nën tryninë e pushtetit dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të organeve shtetërore¹⁴.

Konfiskimi i pasurisë së Derallajve

Shteti jugosllav i sekuestroi dhe i nacionalizoi të gjitha pronat e Derallajve në Tetovë dhe gjithandej ku kishin pasuri në tërë territorin e Maqedonisë, madje vazhdoi edhe me pavarësimin e Maqedonisë. Familje Deralla kurrë nuk arriti që t'i kthejë pronat, të cilat ua mori shteti dhunshëm, po ashtu edhe shtetësia nuk u njoh

⁹ Nga një dokument i gjendjes civile të Republikës së Shqipërisë, origjinali botohet për herë të parë nga arkivi familjar i Valdete Derallës

¹⁰ Berat Deralla, djali i Gajur Derallës, tregon për përjetimin e tyre gjatë arratisjes, së pari nga Shkupi drejt Italisë dhe qëndrimit të tyre në kamp deri në vendosjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai tregon se si babai i tij do lejë amanet të birit se si duhet të veprojë, ndonëse vetë deri në frymën e fundit u mundua që të veprojë, por shëndeti i ligë dhe mosha bënë që shumë shpejtë të ndërrojë jetë në Amerikë.

¹¹ Bisedë me Berat Derallën, djali dhe trashëgimtari i vetëm i Gajur (Mehmet) Derallës, shkurt 2013, Tetovë

¹² Po aty

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

pasi që ishin fshirë nga të gjitha dokumentet dhe regjistrat shtetërorë¹⁵. Për absurd, shtëpia e familjes Deralla, e cila njihet si shtëpia e Halim Beut, u bë shtëpi ku trajtoheshin të sëmurët mentalë, me qëllim që të disiplinoheshin shqiptarët, me atë se sa herë ta shihnin këtë shtëpi ta kuptonin se si përfundojnë ata që flijohen për atdhe dhe të nxirrnin mësim nga ky shembull tipik. Por, realiteti dëshmoi ndryshe, sepse shqiptarët thurnin legjenda për familjen Deralla, për qëndrimin burrëror të tyre në ditë të vështira, që bëri tetovarët dhe shqiptarët në përgjithësi të krenohen me këtë familje.

Edhe sot e kësaj dite, shtëpia e Halim Beut mbetet e mbyllur dhe është katandisur në një gjendje të mjerueshme nga dhëmbi i kohës, ndërkohë që me gjithë përpjekjet e shumta, kjo shtëpi nuk i është kthyer kësaj familjeje atdhetare, si pronë e tyre, përkundër ligjeve ekzistuese të këtij shteti për denacionalizim të pronave nga koha e monizmit¹⁶. Mbase me qëllim të caktuar dhe me vetëdije po veprohet kështu me familjen Deralla, në mënyrë që t'i fshihen të gjitha gjurmët e ekzistencës së saj.

Përfundim

Persekutimi i familjes Deralla ka një vazhdimësi deri në ditët e sotme, ndërsa nga dokumentet mund të shihet se ndaj saj po veprohet me ligje të pashkruara, në mënyrë që t'u bëhet i pamundur fitimi i statusit të barabartë si qytetarë dhe kthimi i anëtarëve të saj në vendlindjen e tyre në Tetovë.

Përndjekja e tyre ka qenë e orkestruar dhe sistematike. Dokumentet e tyre individuale janë asgjësuar në regjistrat civilë, pasi që nga ajo që deklarohen familjarët dhe që janë të dokumentuara, shihet se familja Deralla është përzënë dhunshëm nga Tetova. Deklarata e Hysen Derallës është argumenti më i fortë për këtë dhunim që i bëhet familjes Deralla.

Persekutimi i djemve dhe vajzave të Mehmet Pashë Derallës kishte për synim që ta përmbyste lëvizjen shqiptare në këto treva dhe t'u dërgohet mesazh të gjithë atyre që do angazhoheshin si këta, se do të përfundonin në mënyrë të njëjtë. Fatmirësisht, familja Deralla edhe përkundër faktit se u përzu dhunshëm nga Tetova, mbetet simbol i rezistencës kombëtare shqiptare dhe trashëgimtarët me të drejtë kërkojnë të kthehen në Tetovë dhe t'u njihet shtetësia, si një e drejtë e marrë padrejtësisht dhe të bëhet kthimi i pasurisë së tyre, si një e drejtë që çdo qytetar lipset ta ketë. Në rastin e Derallajve, ata kanë të drejtë legjitime për këtë, pasi padrejtësisht u tjetërsua prona e tyre dhe anëtarët e saj u përndoqën për shkak të veprimtarisë atdhetare. Kjo çështje mbetet e pazgjidhur deri në botimin e këtij shkrimi. Po ashtu si dëshmi i bashkëngjishim një dokument origjinal nga Hysen

¹⁵ Familjarët janë munduar që të nxjerrin shtetësinë, por rezultoi se janë fshirë nga regjistrat e vjetër dhe nuk ekzistojnë askund, që flet se deri në çfarë shkalle kanë vepruar shërbimet sllave.

¹⁶ Në kohën kur prona u kthehej pronarëve në mungesë të shtetësisë por edhe nga pengesat sistimore familja Deralla nuk arriti të kthejë asnjë nga shumë pronat që posedon sipas bisedës me Valdeten, Gencin, Berat Deralla 02.12.2015

Deralla si dokument shumë i rëndësishëm historik dhe faktik për atë se çka i ndodhi kësaj familjeje.

Bibliografia:

- Neoshqiptarizmi i Mehmet Pashë Derallës, Revista shkencore Diskutime, numri 11, viti 2014
- Deklaratë origjinale e Hysen Derallës, botohet për herë të parë, e ruajtur nga vajza e tij, Valdete Deralla
- Listë e familjes Deralla nga regjistri i gjendjes civile të Shqipërisë
- Bisedë me Berat Derallën
- Bisedë me Valdete Derallën
- Bisedë me Genc Derallën
- Bisedë me Genc Derallën
- Bisedë me Nexhat Pilkun

Dokumenti

Hysen Deralla vjeç 78 nga Tetova, i biri i Mehmet Pashë Derallës.

Ne kemi një pasuri tokësore në fshatin Rataj, gjashtë kilometër larg Tetovë (kadastra) duhet ti ketë dokumentat e tokës dhe përmasat).

Kemi patur dhe një shtëpi të madhe moderne stil gotik, që sot është spital me bahçe të madhe dhe mure rrethuese me portë hekuri.

Kundërshtimisht së madhe kishim shtëpinë e vjetër të ndërtuar nga Mehmet Pasha me bahçe më vete. E shërba dhe fillova të heq themelet e një shtëpije të re dhe arrijta deri në katin e parë. Fatkaqësisht u-internova nga nazistët gjermanë në qershor të 1944 për shkak se kundërshtova mobilizimin e djemve kosovarë në njisitet e SS-ve. Kur mbaroi lufta vetëkuptohet se tokët tona u-shtetëzuan dhe në vitin 1946 më përzuamë me policë drejt Shqipërisë. Tokë të tjera kam patur në Jançisht e Vorcë pranë Tetovë dhe një pyll me lisa në Kotlinë.

Shkodër
2 Qershor 1990 Shkodër


Hysen Deralla

Hysen Deralla

*Verifikohet nëshkrimin e Hysen Derallës nën emrin
lejes "8 Mëntori" follet 111P me letërkryftim 219/15378
follet 157 vjeç. 157 follet 16P.*

*Shkollë Pop. Leje "8 Mëntori"
Shkodër*

(Rejzullëq Beqeri)



Shkodër, 8 Qershor 1990

PETRO MARKO

Ç'JEMI NE?

Gjaku i himariotëve është shqiptar, një histori me Ali Pashën dhe propaganda greke

Pra ç'jemi ne? Shqiptarë! Po pse e humbëm gjuhën? Unë do të them ato që di: Pse nënat plaka, gjyshët dhe gjyshet dinë më mirë shqipen se greqishten? Pse qajmë e këndojmë në shqip? Pse fjalët e urta i themi në shqip?

Siç duket që nga viti 1820 e këtej, greqizimi u bë me qëllim politik nga vetë Greqia, që fitoi lirinë me gjakun e shqiptarëve, qoftë në Mesolongji, qoftë në revolucionin grek. Suli dhe Himara ishin shqiptarë, po dy krahina autonome që nuk njihnin as Greqinë, as Shqipërinë, së cilës i kishte humbur edhe emri. Suli dhe Himara ishin kurdoherë në luftë me turkun.

Erdhi koha që Himara u nda: Himara bregdetare mbeti e lirë dhe e krishterë, kurse Himara e brendshme, Labëria, Kurveleshi, Lumi i Vlorës e Dukati u myslimanizuan dhe u ndanë. Megjithëse u ndanë në dy fe nuk e humbën kurrë lidhjet e gjakut dhe të fisit.

Çdo fshatar kishte të tijtë në një fshat të myslimanizuar që në kohën e Ali Pashë Tepelenës.

Kur bëheshin operacione ndëshkimore nga turqit, bregasit nuk shkonin përtej maleve, në Mesaplik e në Kurvelesh, për t'u mbrojtur, siç bënin gjer në atë kohë, por iknin me varka për në Korfuz ose për në Gjirit, nën mbrojtjen e venecianëve.

Aty shkonin pleq e plaka dhe fëmijët. Burrat luftonin. Aty rrinin shumë vjet, gjersa mbaronin operacionet ndëshkimore. Thonë se banorët e Dhërmiut shkonin në ishullin grek, kurse ata të Himarës në Gjirit.

Prandaj dhe, kur flasin greqisht, dhërmijasit flasin si korfjanët, kurse himarjotët, si gjiritlinjtë. Pastaj shkollat ishin greke. Mesha këndohej greqisht, tregtinë e bënin me Korfuzin, Janinën. Pak nga pak u shkëputen lidhjet me Labërinë, me Dukatin.

Greqia, që u çlirua e para, thoshte se kudo ku janë ortodoksë, janë grekë; myslimanët janë turq. Nisi antagonizmi turq e kaurë! Propaganda bënte punën e saj. Kjo u thellua në kohën e Ali pashë Tepelenës, i cili dërgoi një delegacion në Himarë, që dhe Himara të myslimanizohej.

Paria e Himarës delegacionin e priti në Qeparo, se kishte më shumë kapëdanë. Delegatët e Ali pashë Tepelenës u thanë mendimin dhe qëllimin e vizitës. Më plaku i kuvendit himarjot u tha delegatëve:

– E falënderojmë pashanë, që mendon për të mirën tonë. Po i thoni pashait se këtu poshtë, në fshat, kemi një fushë që s'ka ujë. Thahet në verë dhe nuk na jep asgjë. I jemi lutur Krishtit dhe Shën Mërisë, Shën Kozmait dhe Shën Spiridhonit,

po s'na dhanë ujë. Në na dhëntë Muhamedi ujë, menjëherë bëhemi myslimanë. Kështu i thoni pashait. Kur vajtën e ia thanë pashait përgjigjen e bregasve, ai qeshi me zemërim dhe tha:

– Eh kaurët e dreqit, do të ma paguajnë!

-Pastaj, duke qeshur: – Pizevengët, janë të zgjuar, s'ke ç'thua, janë rrufjanë të mëdhenj!

Pak nga pak propaganda greke bëhej më e madhe, duke pretenduar se Himara ishte krahina heroike e Greqisë. Shumë kapedanë, sidomos paria, kishin privilegje.

Dhe paratë e mirëbërësve himarjotë, që i kishin lënë në bankat greke për shkollat e Himarës, ishin një shkak shumë serioz për propagandën greke.

Gjikë Bixhili nga Dhërmiu kishte fituar shumë para në Rusi, ku e kishte marrë Pano Bixhili, përfaqësues i himarjotëve pranë Carit, në Petërsburg. Mësuesit dhe shpenzimet për shkollën merreshin nga fondi i Gjikë Bixhilit. Gjikë Bixhili ndërtoi dhe një shkollë, që është sot e kësaj dite. Ne kur ishim të vegjël, në shkollën e fshatit shihnim portretin e tij, të varur në klasë.

Siç i la Gjikë Bixhili paratë në bankën greke, ashtu i lanë dhe shumë mirëbërës të tjerë nga Jugu, si Zhapa me shokë. Ishin miliona, të cilat u bënë burim për të ushqyer propagandën greke në vendin tonë, sa u krijua miti i Vorio Epirit dhe sillogu vorioepiriot, që merrej me çlirimin e Vorio Epirit, domethënë të Shqipërisë së Jugut. Paratë u vunë në dispozicion të parisë, e cila merrte një mijë dhe shpenzonte një...

Paria merrte para nga banka greke, e cila qe e autorizuar nga qeveritë reaksionare nacionaliste të Megali Idhesë (Megali Idheja: që Greqia të behej e madhe duke përfshirë në kufijtë e saj jugun e Shqipërisë dhe vendet ballkanike ku janë ortodoksë).

Himarjotët që emigronin në Greqi, kishin privilegje: përkraheshin si bij të një "krahine heroike greke" me histori trimërie e burrërie.

Fatkeqësia ishte se Shqipëria u çlirua e fundit në Ballkan. Himara kishte ushqyer shpirtin e aneksartisë, autonomisë, si Suli, i cili pak nga pak u greqizua.

Dhe, pasi u çlirua Shqipëria, me kufijtë të cinguar shumë, propaganda greke e ushqeui shumë idenë e autonomisë së Himarës: as shqiptarë, as greke! Kishte hedhur rrënjë të thellë kjo propagandë në shpirtin e himarjotëve, të cilët sytë i mbanin nga Greqia.

Krerët himarjotë, si Spiro Miloja, një luftëtar që e ndihmoi shumë Greqinë, ishte në krye të kësaj propagande, me gjithë farefisnin dhe sojin e tij të përndarë në Dhërmi, Vuno e gjetkë.

Spiro Miloja ishte nga Progonati. Në fshatin tonë ai kishte farefis Llukë Zh. e të tjerë, që propagandonin ndarjen e Himarës nga Shqipëria. Si bazë kryesore të propagandës përdornin dhe këtë: Pse Labëria u bë turke?

E pse te mos bëhemi edhe ne me Greqinë, që është armike e betuar e Turqisë, siç jemi dhe ne armiq të betuar të turkut. Shumë fanatikë ishin fshatarët e mi! Njëzet e gjashtë kisha kishte. Mbaj mend unë se kishte tetë priftërinj.

Lidhjet ekonomike, privilegjet në Greqi, interesimi i Greqisë për himarjotët, sillogu vorioepiriot ndikuan shumë për t'i bërë himarjotët t'i kthenin sytë nga Greqia dhe të ëndërronin për një autonomi. Pastaj, edhe në kohën e pavarësisë

himarjotët panë se asnjë qeveri e Tiranës nuk u kujdesua asnjëherë për ta. Nuk shkonin as xhandarë dhe nuk merreshin në asnjë punë.

Ata pëlqyen të mërgonin: herën e parë në Llavriion, ku kishte miniera; në Korint, për të hapur kanalin; në Vllahi, në Rusi, pastaj në Amerikë, në Francë, në Meksikë, në Argjentinë, në Australi, Kanada e gjetkë. Kështu ne dinim më mirë ku binte Buenos Airesi sesa Kukësi, që nuk ia kishim dëgjuar kurrë emrin. Dinim ku binte Australia dhe jo Kosova, që nuk ja kishim dëgjuar kurrë emrin. Dinim ku binte Athina dhe Korfuzi ose Tirana e Shkodra. Ishim pa asnjë lidhje me atdheun tonë.

Disa përçarës, vetë regjimi i Zogut, sidomos Musa Juka, na përçau. U ndamë në fshat në dy parti: pendëkuqet që deshën Shqipërinë dhe shkollat shqipe; dhe pendëbardhët, që deshën Greqinë e shkollat greke në fshat. Këtë përçarje e ushqeun shumë Musa Juka, duke na armiqësuar vëlla me vëlla.

Familja jonë bënte pjesë në partinë e pendëkuqeve dhe mbanim në ballkon kurdoherë flamurin e Shqipërisë.

Kapedanët e Spiro Milos na kishin ardhur disa herë në shtëpi, duke na thënë se Andrea Deshën që ne të linim shtëpinë e të shkonim në Korfuz, ku do të na mbante me shkolla e me pensione Athina.

Qoftë im vëlla, Fotoja, qoftë kushëriri im Jani, i sikterisnin duke u thënë: “Andrea Markoja u vra për Himarën dhe Marko Jani vdiq i veremosur nga internimet dhe vuajtjet e shumta për Himarën dhe jo për Greqinë. Himara sot është dhe mbetet shqiptare. Prandaj mbajmë dhe flamurin ditë e natë në ballkon. Ne e dimë gjakun tonë se nga buron”.

Pjesë e shkëputur nga libri i “Intervistë me vetveten”.

ROBERT DUNIER

FSHATARËT ORTODOKSË SHQIPTARË NË GREQI NË VITIN 1912

Robert Dunier, që firmos reportazhin e mëposhtëm, është pseudonimi i dramaturgut dhe poetit francez Léon Charpentier, i njohur njëkohësisht për shkrimet e tij politike e psikologjike gjatë vitve 1900-1913 në disa revista të njohura të kohës, si "Mercure de France", "Nouvelle Revue Française", "Journal des Voyages". Autori ka ndjekur nga afër ngjarjet e Ballkanit në kohën e veniçjes dhe të shuarjes së Perandorisë osmane. Është i njohur për ne shqiptarët për shkrimin e tij të bukur "Festa e luleve për heroin kombëtar shqiptar", shkruar më 1910, ku vë në dukje se kjo festë organizohet në Shqipëri çdo fillim Bajrami, me qëllim që vashat bukuroshe të hedhin lule nga bedanat e kalave për të kremtuar "kujtimin dhe kreshnikëritë e Heroit të Madh Kombëtar që çliroi Shqipërinë nga zgjedha e turqve".

Në shkrimin që pason, Dunier, duke u nisur nga ideja dhe frazeologjia e gabuar e kohës se përkatësia fetare si teokraci, përcakton njëkohësisht edhe përkatësinë etnike, gjë që çonte ujë në mullirin e politikave shoviniste të megali-idesë, i quan fshatarët ortodoksë shqiptarë "fshatarë greko-shqiptarë". Po ashtu, duke mos bërë dallimin e shqiptarit mysliman nga shqiptari ortodoks, në mënyrë mjaft të turbullt, ai i sheh gegë e toskë si "raca të ndryshme", me/pa gjuhë të njëjtë dhe shpesh, me sa duket, ngatërron malësorët e Labërisë dhe të Bregut me gegët e Veriut të Shqipërisë, pa patur nocione të qarta etnike për kombin shqiptar. Nisur edhe nga fotot e botuara në revistën "Journal des Voyages", që ilustrojnë reportazhin e tij, e shohim gjithashtu me vend të sqarojmë se mjalti për të cilin bëhet fjalë këtu duhet të jetë mjalti i Bregut, i Llogarasë, i Çajupit, etj. dhe jo mjalti i Tropojës apo Valbonës. Po ashtu, shtëpitë-kulla të shqiptarëve në rrethinat e Athinës, për të cilat flitet në artikull, duhet të jenë të ngjashme me ato shtëpi të dikurshme fortesa të Himarës, Vunoit, Qeparoit, etj., gjurmët e të cilave i shohim sot e kësaj dite atyre viseve, në ato shtëpi rrënojë, tashmë të braktisura, por që flasin aq shumë në/për Histori. Më në fund, shohim se autori e mbyll shkrimin me një valle labe a himariote, të shoqëruar nga kënga polifonike, duke përdorur këtu termin "brokoyalas", që e ka huazuar, me sa duket, nga bashkëpatrioti i tij Cyprien Robert, i cili flet gjatë për shqiptarët në veprën "Bota greko-sllave" e vitit 1842. Dhe për ta bërë edhe më të shijshëm reportazhin e tij ekzotik, autori nuk mungon të na shfaqë, në mbyllje, "dashin në hell", si një element tipik i kuzhinës shqiptare. / Fotaq Andrea.

Shqiptarët ortodoksë - reportazh i vitit 1912

Ç'ka haset më pak në Greqi, janë grekët; dhe ç'ka gjendet më shumë, janë shqiptarët. Jo më larg se tre kilometra nga Athina, ka fshatra të banuara tërësisht nga shqiptarët. Shtëpitë në ato anë janë të ndërtuara sipas stilit shqiptar, nëse do t'u njihnim një stil atyre ngrehinave të çuditshme. Çdo shtëpi është një fortesë e shpuar nga frëngjitë. Dalimi është se në fshatrat e Greqisë, shqiptarët u kanë dhënë këtyre frëngjive njëfarë ngjashmërie me dritësoret.

Këto shtëpi-fortesa janë me plitharë. Secila, për aq sa mund, është e mënjanuar, ngritur majë një suke. Kanë një palë shkallë që befas vijnë e përfundojnë në ajri, dhe për të arritur gjer te pragu, duhet përdorur një shkallare e lëvizshme.

Është kjo një mënyrë se si fshatari grek apo shqiptar mbrohet ndaj kusarëve që gëlojnë në krejt vendin dhe po në këto shtëpi, ai vetë sjell edhe plaçkën që ka rrëmbyer gjetiu.

Megjithatë, jo të gjitha shtëpitë ortodokse-shqiptare janë fole të tilla fajkonjsh. Disa ngjasojnë me konakët e qyteteve dhe disa janë pothuaj konakë-haure, ku dalin e hyjnë paqësisht kope me qé e bagëti.

Në kësi konakë të llojit çiflig ka dritare të vërteta, po prapë, ato janë pa xham dhe në dimër i veshin me kartona; megjithatë, kanë edhe kanate.

Por ndodh kryesisht në tregje ku sheh të shpërthejë dukshëm sundimi i racës shqiptare ndaj racës helene.

Tregjet janë të pushtuara nga shqiptarët. Vetë banorin e Greqisë e sheh të veshur me kostumin mjaft të errët të helenit bashkëkohor: qillota të zeza, kaftan i murrët, feste e kuqe apo e bardhë. Kurse shqiptari që zbret nga malet atërore për të shitur këtu prodhimet e veta, vishet me xhamadanin e shkëlqyeshëm gjithë mëndafshe e qendisma në fije ari dhe me qillota kadifeje gjithë ngjyra të shndritshme.

Tek shet lëkurë kafshësh, vaj, kripë, dyll, lesh, mëndafsh, lin, e sheh shqiptarin të shpalosë gjoksin dhe në brez i duken dy pinjallë me doreza gjithë telish, që luajnë përgjithësisht një lojë shumë aktive në kësi takimesh.

Sepse midis grekëve e shqiptarëve jo të pakta janë rastet kur ka keqkuptime e zënka që përfundojnë me përleshje. Madje shqiptarët zihen e ndeshen edhe me shoshoq. Ngaqë edhe vetë shqiptarët janë një pleksje, ose më mirë të themi një antitezë e dy racave, që nuk kanë as edhe të njëjtën gjuhë, ose të paktën që i shqiptojnë aq ndryshëm të njëjtat fjalë, sa biseda mes atyre njerëzve është pothuaj e pamundur.

Në fakt, këta shqiptarë që grinden dhe zihen në tregjet greke vijnë nga Veriu dhe nga Jugu i Shqipërisë. Në rastin e parë janë Gegë; në rastin e dytë janë Toskë. Por, si njëra palë dhe tjetra përfshihen brenda një tipi njerëzor. Gegu e ka mjekrën të dendur dhe sytë zioshë; Tosku e ka syrin të përhimë a kaltërosh, leshrat verdhane, vetullat e holla, gjoksin të dalë dhe fytyrën vezake.

Gegë e Toskë, me të njëjtin zell, i dëgjon tek bërtasin në treg, gjithkush duke shpallur epërsinë e mallit të vet. Madje ka nga ata që e bëjnë reklamën edhe në mënyrë poetike, aq të denjë sa vetë rapsoditë homerike.

"Hajde, mjaltë nga bletë punëtore që kullot në lëndina plot lule buzë detit me valë. Mjaltë më të shijshëm nga ky s'ka!"

Është tregtari tosk që flet kështu.

"Ç'thua, o i pacipë! – ia kthen aty për aty tregtari geg. – Na e paske ti më të mirë nga mjalti i bletëve që kullosin në malet tona të shenjta? Më mirë qepe, o byrazer, se ku mjalti tënd, ku i imi!"

E, teksa klienti rrudh buzët për të mos pranuar si njërin, si tjetrin mjalt, dy shqiptarët kundërshtarë zënë e zihen në tregun grek dhe në fund qisin pinjallët duke iu lëshatur shoqi-shoqit.

Dhe në përleshjen e tyre grykë më grykë, duke u shtyrë e duke u goditur, mjalti e njërit dhe i tjetrit bie përtokë dhe shkelet me këmbë. Shuhet kështu bashkërisht lavdia e bletëve malësore dhe e punëtoreve të zellshme të Bregut.

Por, nëse ndonjë grek, lakmues e grabitës në çdo kohë i pasurisë së tjetrit, do orvatej të rrëmbente mbeturinat e ëmbëlsirave gatuar me mjaltë, në çast gegu e tosku, shqiptarë që të dy për nga raca, do bëhen bashkë kundër vjedhësve dhe nis atëhere një kasaphanë e vërtetë.

Andaj pra, kur shkohet në treg, ia vlen të jesh i armatosur, si të nisesh për luftë. Pazaret e mëdha të stinës së verës zgjasin disa ditë. Në këtë rast, shqiptarët fushojnë jo larg mallit të tyre. Gatuajnë qullin e misërt dhe mishin me lëng, që ata e quajnë jahni, apo supën e peshkut; pasandaj shtrihen mbi abatë e tyre, bërruca me lesh dhije apo me lëkurë dhensh.

Caktojnë roje për të ruajtur mallin dhe po qe se ndonjë vjedhës guxon të rrëmbejë diçka mbi tezgat shqiptare, kapet në vend dhe veç plumbi e pret, pa kurrfarë gjyqi.

Sapo "agu me gishtërinjtë e tij të trëndafiltë flakëron horizontin dhe ndriçon magjishëm" tregun dhe kampin e shqiptarëve ortodoksë, ata që nuk banojnë në Greqi, por që kanë ardhur nga Shqipëria për të shitur produktet, mblidhen në kor dhe ia nisin brokovalles, apo marshit ushtarak kombëtar i cili, edhe në vetë kohën e Skanderbegut, ishte tashmë i një lashtësie që nuk mbahet mend në rrjedhë të Historisë dhe që disa e çojnë gjer në kohë të Pirros. Kjo këngë, e shoqëruar me hapa të tillë që duken sikur po shpërthehet një sulm, dhe me gjeste nëpërmjet të cilave vringëllohen kamat e thikat, shkakton një efekt tmerrues.

Ja ku shihen në pikë të agut tek shkojnë në treg fshatarë gjysmatarë të varfër, përkundur mbi kafshën e tyre të ngarkesës dhe pasuar nga produkti i tyre i blegtorisë. U shkojnë të dridhura nëpër trup tek ndjejnë nga larg britmat luftënxitëse. Një numër buajsh janë renditur në dalje të çifligut ku ndodhemi, gati për të marrë rrugën e tregut, ia japin të pëlliturit një pas një, me pamje të trishtë a kërcënuese.

Si kanë ikur burrat në treg, gratë mblidhen edhe ato kokë më kokë me merakun e madh se mos plasë gjatë ditës sherri midis burrave. Në palën shqiptare, gratë shihen si më të qeta; sepse jo vetëm që ato i shoqërojnë burrat e tyre gjer në treg, por mbajnë madje edhe peshat më të rënda, kur burrat shihen të ecin përpara krenarë, krahët të lira, në një qendrim prej kapadaui, para të cilëve gjithçka epet. Por fakt është që këtu, tek helenët, shqiptarët nuk i përdorin kurrë gratë për punë të rënda dhe as që i trajtojnë si skllave, aspak.

E teksa i lashti Febus-Apolon është lartuar në qiell, brokavallja tani është ndalur. Ata këngëtarë të zhurmshëm kokë më kokë e kanë përfunduar këngën dhe i sheh tani të mblidhen përreth keçit duke u pjekur në hell, që është në fakt o një dhi, o një dash, që shërbehet i tëri dhe copëtohet shkathtësisht nga thikaçët e shpejtë për të përfunduar në çast në stomakët e uritur pas mbarimit të brokovalles.

Tregtarët e pasur grekë, për t'u dalluar nga shqiptarët ortodoksë pëlqejnë të shkojnë në treg me veshje perëndimore, me pantallona deri te syri i këmbës, setër moderne dhe borsalinë prozaike. Po prapë, i druhen disi brokovalles.

Journal des Voyages, e diel, 21 korrik 1912.

*FAIK KONICA***BORIS SARAFOV - CA KUJTIME DHE
CA MENDIME****Një shkrim i pabotuar i Faik Konicës për marrëdhëniet shqiptaro-maqedonase**

Duke vijuar rubrikën “Shkrime të Faik Konicës me tematikë aktuale”, të nxjerra nga revista e tij “Albania” dhe të pabotuara që nga ajo kohë, ramë edhe në dokumentin e mëposhtëm me vlerë të veçantë historiko-aktuale. Bëhet fjalë për “çështjen maqedone”, e cila po “zgjidhej” nga qarqet diplomatike të fillimshekullit XX në mënyrë arbitrare dhe në kurriz të çështjes shqiptare. Faik Konica, figurë e spikatur patriotike dhe personalitet i afirmuar politik në botën shqiptare e më gjerë, kërkohet në takim të drejtpërdrejtë, në fund të vitit 1901, nga Boris Sarafov (1872-1907), kryetar i komitetit maqedon për lëvizjen “revolucionare” e separatiste në Maqedoni, lëvizje kjo e nxitur dhe e përkrahur, ndër të tjera, nga qeveritë bullgare e serbe. Me nuhatje të fortë politike, patrioti shqiptar i kundërvihet intrigave të Sarafovit, demagogjisë që ky përdor për të mashtruar shqiptarët, si dhe veprimet që ndërmerr për të “çarë udhë të gjakshme në kurm të popujve të huaj”, siç shprehet Konica, tek ka parasysh në radhë të parë kombin shqiptar. Me gjuhë tepër të ashpër, ai godet edhe shqiptarët e gënjyer, që pandehën se Sarafovi do ndihmonte lëvizjen shqiptare, e më keq akoma, ata që i ranë pas atij thjesht për të fituar një kacidhe, duke i shërbyer si mish për top e duke vrarë vëllai-vëllain. Si largpamës i vërtetë, Konica kërkon t’u hapë sytë bashkëkombasve, t’i ndërgjegjësojë për veprimet e tyre të marra, tek përdor fshikull të ashpër dhe tek vë pikat mbi -i- se “e vetëthëna Maqedoni”, siç e cilëson ai (me emërtim thjesht gjeografik) po sajohej në kurriz të kombit shqiptar dhe të interesave të tij.

Konica i boton këto kujtime me rastin e vrasjes së Sarafovit në Sofie, më 1907, nga qarqe të brendshme kundërshtarë, duke e vënë theksin në mësimet që duhet të nxjerrin shqiptarët nga historia për t’u përqendruar në interesat e tyre kombëtare. Dhe historia nuk është e largët, por daton nga fillimi i shekullit XX, kur u cenua rëndë dhe padrejtësisht tërësia gjeografike dhe etnike e kombit shqiptar në “*Tre Vilajetet e Rumelisë*”, Selanik, Manastir e Kosovë, ku shqiptarët, që përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë, e panë veten të dëbuar kafshërisht nga vatrën stërgjyshore dhe të njihnin nën kërbaçin e shqaut kushtin “sous-homme” (nën njeri).

Sot, kur shqiptarët e Maqedonisë vazhdojnë të fyen e të poshtërohen pa të keq dhe kur merren nëpër këmbë të drejtat e tyre të ligjshme, e kemi për detyrë të

ngremë zërin tonë në përkrahje të fatit të vëllezërve tanë dhe të dëgjojmë këmbanat dhe buritë koniciane të alarmit: Se përherë fqinjët tanë kanë pasur dhe kanë zbatuar ndaj nesh “dy masa, dy pesha”, pra dy standarde, apo siç shprehet Konica dy programe: “një të shkruar a të folur, një tjetër të pashkruar e të pafolur”; një që hiqen si miq dhe tjetri që vepron si përherë nga pas kurrizit dhe në kurriz të interesave të kombit shqiptar.

Vetëm një Europë e Bashkuar, me emancipim të shëndoshë politiko-shoqëror të Ballkanit duhet të vërë në vend padrejtësitë historike dhe të shmangë fuçinë e dikurshme të barutit të Turqisë europiane që e la peng perandoria osmane në rënie dhe loja e rrezikshme diplomatike e Fuqive të kohës. /Monet Maneshi

Boris Sarafov – Ca kujtime dhe ca mendime

Nga Faik Konica

Albania nr.2, 1907

Një ditë, gjashtë vjet më parë, në Bruksel, më erdhi në shtëpi një djalosh i gjatë, me një ballë e me faqe pak si të verdha, me sy të ngulët; fytyrë asketi, fytyrë njeriu që vuan e që mendon, apo njeriu të sëmurë? – nuk e di. Po s’kam dyshim se ishte një djalë i mençur dhe mënyrat e ëmbla të tij më çudisnin. Ky zot, si i tregova një ndenjësore dhe iu luta të rrijë, më tha se ish “maqedonas”, edhe se “kryetari i tij Sarafovi”, i cili kish ardhur në Bruksel, dëshironte të njihej me mua. Në qoftë se kisha edhe unë atë dëshirë, ku mund të piqeshim? Dhe në pak fjalë, anëtari i Sarafovit më dha programin që kryetari i tij do më hapte [shtjellonte] më gjatë. U përgjigja se isha gati ta pres, të njihemi, të kuvendojmë kur dhe ku të donte. E bëmë të vinin që të dy pas dreke në shtëpi; dhe ashtu, më tre pas dreke, një trokëllimë në derë të rrugës më shënoi ardhjen e tyre.



Boris Sarafov

Fytyrë të fryrë, dhe më e kuqe se e verdhë, sy të krisur jashtë si dy të mëdha gështenja tepër të pjekura, qafën të shkurtër dhe posi të prerë, jakën e gunës frënge të ngritur nga prapa, më i shkurtër se i gjatë, më i trashë se i hollë, duar të majme dhe të dërsira: kështu m'u duk Sarafovi. Të dy gështenjat e plasura që kish nën ballë, të cilat i lëvizte në të mëngjër e në të djathtë posi një njeri i mësuar me gracka dhe i rritur në mes dyshimesh e pusirash, shfaqnin natyrën e ligë të tij dhe prapësinë. Po posa hapte gojën, përshtypja e ligë që bënte, harrohej menjëherë.

Sarafovi dinte frëngjisht, por jo mjaft për të mos pasur nevojë për ndihmë: herë-herë qëndronte dhe ahete miku i tij e mbaronte frazën e tij. Zëri i tij ish i bukur, të ndenjurit si të një burri të rritur mirë dhe çudi! i mungonte ajo mani që kanë gjithë njerëzit e Ballkanit, për më tepër bullgarët, të flasin duke përcjellë fjalët me dorësime të egra. Nuk dua ta mohoj: ky njeri i mbytur në gjak, kish gjer në një pikë sjelljen e një ushtari dhe të një zotërie. Dhe në këtë, ndofta jo më pak se në energji të tij, gjejmë hapësin e punëve që mundi të mbarojë.

Sarafovi, kur u poqa me të, kish një mendje dhe një nderim të madh për shqiptarët. Të paktën ashtu e kuptova ahete, jo aq nga ato që më tha, se nga ato që nuk më tha; në ndërroi pastaj, dhe pata provën që ndërroi, kini për të parë më poshtë se kish arsye mjaft të shëndosha.

Qëllimi i pjekjes së Sarafovit me mua ish të më kërkonte ndihmën e shqiptarëve për të kallur armë në të vetëthënë Maqedoni nga bregu i detit tonë. Me fjalë të tjera, donte që shqiptarët e një ane të dërgonin armë për vrasjen e shqiptarëve të një ane tjetër. Po përveç këtij qëllimi të veçantë, Sarafovi kish një më të përgjithshëm e më të gjerë: dëshironte një marrëveshje e një lidhje të shëndoshë me shqiptarët. Më thosh: të dy kombet tona janë të vendosura në një të tillë mënyrë sa natyra u thërret të bashkojnë forcat e tyre. Njëri nuk mund të përparojë pa miqësinë e tjetrit. Që të dy kanë për armiq turkun dhe grekun. Pse të derdhim gjakun e njëri-tjetrit që t'u bëjmë zemrën armiqve të përbashkët? "Dhe, a doni, shtonte Sarafovi, t'ju jap një provë që jam zemërbardhë dhe s'dua të rris Bullgarinë, por të themelohet një Maqedoni të lirë, për të cilën Shqipëria nuk duhet të ketë përveçse miqësi? Mjaft të them një fjalë, mjaft ta siguroj Bullgarinë që do të punoj pas qëllimeve të saj, dhe udha e kësaj princërie më hapet menjëherë për të kallur armë në Maqedoni. Në qoftë se jua kërkohet juve këtë nder, shkakun është se qëllimet e mia u qasen më afër interesave të Shqipërisë se të Bullgarisë". Tre a katër muaj më pas, në një letër që më shkruante nga Zvicra, në bashkëpunim me një nga më të diturit përvendas të tij, më përsëriste po ato siguri.*

Boris Sarafov dhe çeta e tij me shqiptarë, 1902

Këto, dhe të tjera që më thosh Sarafovi, s'ka një shqiptar që të mos i pëlqente. Programin që më shtroi, s'ka një atdhetar që të mos e shënonte (nënshkruante) me gjithë zemër. Por mjerisht, Sarafovi dhe shokët e tij, si dhe grekët, si dhe serbët, kanë dy programe: njërin të shkruar a të folur, tjetrin të pashkruar e të pafolur. Këta, nga një anë na ftojnë të bëhemi miq, nga ana tjetër sillen në një të tillë mënyrë që puna i nxjerr fjalët e tyre krejt të rrena. Si një njeri që ish i ftuar te mua, Sarafovi nuk mund t'i thosha në sy që nuk i zija besë. Po i dhashë të kuptoj se qëllimet e tij, të konceptuara liksht, kanë shtënë në mendje të shqiptarëve dyshime të vështira për t'i hequr. Shtova se mendimet e tij do t'i bëja të njohura ndër miqtë e mi. U gëzua shumë dhe, kur u ndamë, më përqafoi pas mënyrës së vjetër të viseve tona.

Fjalën që i kisha dhënë Sarafovi e mbajta. Ca shqiptarëve besnikë që i dija të zotët të reflektinin, u shkrova gjerë e gjatë dhe i pyeta. Të gjithë m'u përgjigjën se kisha të drejtë, edhe që programi i pafolur e i vërtetë i Sarafovi u dukej kundër

interesave të kombit shqiptar: Si pra të vemi t'i ndihim një armiku, aq më tepër i rrezikshëm sa dhe i fshehur?

Sarafovi dhe shqiptarët

Për fat të zi, këto fjalë të larta, pak shqiptarë qenë të zotët t'i thonë. Nipa të çsojësuar burrash të fortë, ç'poshtërsi nuk janë gati të bëjnë për të fituar një kacidhe?... Kur u hap fjala se Sarafovi dëshironte të lidhej me shqiptarët, me zjarr e me vrap, me sulm e rrebesh, toskë e gegë, mëmëdhetarë pak a shumë të shenjtëruar, malësorë që hanë barutin me grusht a me torbë dhe janë gati të luftojnë me të shtatë rigatat, të gjithë u hodhën përpara dhe, turmë e dërsitur e pa frymë, vanë e ranë në këmbë të Sarafovit. “Aman Sarafov, urdhërona! Dëgjuam se nga argjendi që nxore nga shpërblimi i Miss Stone-s, qenke gati të falësh një pjesë për të ndihur lëvizjen shqiptare, që të fitosh miqësinë e kombit shqiptar, miqësinë tonë. Ja ku e ke kombin, ja ku na ke në këmbë! Aman Sarafov, fol! Aman një urdhër! Mos ki turp, duke kujtuar se jemi ç'ishin gjyshërit tanë. Vërtet jemi edhe ne kryelartë, por kur na del hesapi. A pamë atë më të voglin fitim të ulemi? Nuk po ulemi, por po biem në gjunjë. S'ka burra zemërlartë dhe mendjelirë në mes tonë; edhe në u ndodhshin ca të paktë, një instinkt poshtërsie na bën t'i nuhasim, t'i gjejmë, t'u biem dhe t'i sosim. Të ndarë në çdo gjë e në çdo punë, bashkohemi të gjithë me një disiplinë të çuditshme, që nga telakët e gjer te vezirët, për të urryer e për të shpifur ndaj shqiptarëve më të mirë se vetja jonë. S'vijmë të të shesim nderin, se nder s'kemi. Vijmë të të shesim pështymën. Urdhëro, dhe jemi gati të pështyjmë çdonjërin që s'të lë të shkelësh kombin tonë. Sikur të mos ish vendosur tepër lart që të arrinte pështyma, edhe Skëndebe në do ta pështynim po të na urdhëroje.**

Dhe, që të të dëftojmë se sa pështymë kemi, shikona si zihemi që të arrijmë të parët të të lëpjmë këpucët...”

Kjo nuk është një fantazi letrare. Është e vërtetë pikë për pikë. Kur u mësua se Sarafovi donte një marrëveshje me kombin shqiptar – qindra mëmëdhetarë, atdhetarë, patriotë, matritotë, trima, vjershëtorë, aristokratë, demokratë dhe telakë të tjerë, u sulën që t'i falen dhe t'i përkushtohen me shërbimet e tyre; shumë kërkuan nderin që t'i flasin; të paktët që mundën t'i qasen, i folën me një poshtërsi aq të paturpshme, sa që atë ditë e pastaj, siç dëgjova, Sarafovi nisi t'i kontemnojë (poshtërojë) shqiptarët. Vërtitje e çuditshme e botës! Zbritësit [pasuesit] e një kombi, i cili u thye po s'u ul dot prej Cezarëve, bien në këmbë të një Sarafovi!... Dhe çudi më e rrallë, i ditur në histori të themelimit të kombeve, nëqoftë se thua që një popull i vogël, i vobektë dhe i mbetur prapa, nuk mund të bëjë gjë pa ndihmën lendore e morale të ndonjë mbretërie të madhe – këta njerëz, me gjuhën akoma të zezë nga boja e këpucëve të Sarafovit, venë e të përgjigjen me të shara dhe me argumente telakësh...

Por poshtërsia e këtyre njerëzve nuk duhet të na bëjë të padrejtë për Sarafovin, i cili në këtë rast, s'pati as atë më të voglin faj.

Cili është pra, mendimi im i fundit përmbi Sarafovin?

Sarafovi ish, pikë për pikë, po njëmijë herë më i vogël, pasqyra e dy njerëzve të shkëlqyer të farës së tij, Xhinxhis Khanit dhe Timurlengut. Forcë e verbër e sulur përpara, shihte vetëm qëllimin dhe, pa parë, pa dëgjuar, shtypte dhe prishte çdo gjë që ndodhej në vijë të drejtë të tij. Sarafovi ish një njeri tmerr, se ish një njeri pa vetëdije. Djalë i një race të rreptë dhe luftëtare nga natyra, po e shtrënguar të ulë kokën dhe të heshte nga mjerimi i kohëve, Sarafovi vetësoi tërë një komb, dhe pesëqind vjet zemërimesh, të fshehura në miliona krahërorë, krisën posi rrufeja nga goja e tij.

Një njeriu të tillë është lajthim t'i jepet emri hajduk. Që Sarafovi ka qenë vetëm një kryetar bandash është një goditje (aksident) historie: mendja, forca e karakterit, durimi i palodhur që shfaqti në një mënyrë të çuditshme, treguan mjaft se ç'do të ish bërë sikur të kish pasur rasën. Mbret, khan, hetman, gjeneral, secilido nga këta tituj mund t'i jepet, ndofta gabimisht sa për formën, por jo sa për vlerën e fjalëve.

Ne, që kemi tradita kalorësie, ne, që kemi për pasqyrë Skënderbenë, i cili ka qenë përqsasur edhe me Shën Luisin e Francës, edhe me Bajardin, nuk prisnim të na jepte Sarafovi një mësim burrërie të rrallë: Ky njeri, i cili çante nëpër kurme të popujve të huaj, një udhë të gjakshme për popullin e vet, nuk gënjeu kurrë ndonjë nga anëtarët e tij; dora e rrufenjtë, me të cilën shkretoi aq vende, ishte e paqme nga gjaku i miqve.

*Gjenevë, 11 mars 1902: "... mirëkuptimi i dy popujve tanë që, falë fatit të tyre jetësor dhe aspiratave që ushqejnë, duhet të ndihmojnë shoqi-shoqin ndërsjelltas në veprën e tyre të çlirimit e të përparimit": – "kam shpresë se ne mund të bashkojmë përpjekjet tona kundër tiranisë, e cila ka mbijetuar vetëm në sajë të mosbashkimit tonë"; – "...i kam dhënë përfundimisht lëvizjes revolucionare në Maqedoni karakterin e pavarësisë që ruan sot falë sakrificave të shumta" (shënim i Faik Konicës në origjinal, sikurse edhe shënimi që pason).

** Një punë e tillë ngjau, para tre a katër vjetësh në Itali. Një gegë, i paguar për të sharë guxoi të thotë se Skënderbeu kish qenë një hajdut". Dhe çudi! Asnjë nga patriotët që hanë barut me grushte nuk ngriti shkopin që t'ia zbrazte mbi kokë me të dy duart dhe me gjithë forcën e krahëve.

(Përgatiti me drejtshkrimin e sotëm: M. Maneshi. Burimi: "Tirana Observer")

ROBERT ELSIE

NJË VJEDHJE NË DUBROVNIK DHE DALJA NË SKENË E GJUHËS DHE E KULTURËS SHQIPTARE

Bisedoni një herë me një shqiptar dhe ka shumë të ngjarë që ai t'ju tregojë se populli i tij është më i lashti. Bisedoni një herë me një shqiptar nga Kosova dhe është e sigurt se ai do t'ju tregojë se populli i tij është më i lashti në Evropë dhe se që nga fillimi i historisë së botës nuk ka lëvizur fare nga toka e vet.

Ç'është atëherë kjo lashtësi? Populli shqiptar, a është i lashtë? Pse jo. Populli grek, a është i lashtë? Me siguri. Po bullgarët? italianët? gjermanët? turqit? rusët? kinezët? Dhe ç'është atëherë një popull i ri? Në fund del një absurditet, një krijim i homo balcanicus-it gjithmonë në konkurrencë me fqinjët. Unë nuk dua të prek sensibilitete të Ballkanit, por kam përshtypjen se është më e arsyeshme të mos përdorim fjalën lashtësi, dhe t'i kthehemi të dhënave gjuhësore dhe dokumentare.

Është një fakt se nuk ka asnjë të dhënë historike ose arkeologjike të qartë që tregon se shqiptarët erdhën nga një vend tjetër. Kështu ka shumë të ngjarë që shqiptarët gjithmonë të kenë jetuar në pjesën jug-perëndimore të gadishullit ballkanik ku gjenden edhe sot. Por problemi, në fund të fundit, nuk është se 'ku ishin shqiptarët?' por 'kush ishin?' Kjo çështje e shumë-diskutuar, d.m.th. prejardhja e popullit shqiptar, është jashtëzakonisht interesante, por nuk do të sqarohet përfundimisht kurrë.

Nuk është qëllimi i kësaj kumtese për të trajtuar, edhe një herë, teoritë e ndryshme të gjenezës së popullit shqiptar. Vetëm një tendencë të përgjithshme desha ta theksoj. Gjatë historisë, shqiptarët ishin gjithmonë eklektikë, d.m.th. ata kishin një qëndrim të hapur ndaj botës. Dinin të merrnin, të asimilonin, dhe të përshtatnin elemente të shumtë. Ky qëndrim i hapur shihet më mirë në gjuhën shqipe, e cila është një përzierje e habitshme elementesh. Zor të gjesh një fjalë shqipe pa ndikim të huaj. Ne dimë kush është shqiptari sot. Është anëtar i një komuniteti gjuhësor me një identitet të qartë dhe të theksuar. Mirëpo kush ishte shqiptari para një mijë viteve ose para dy mijë viteve? Kjo është më e vështirë. T'i kthehemi fakteve konkrete. Në çfarë periudhë dolën shqiptarët si komunitet gjuhësor në skenë nga mjegulla e historisë?

Në bazë të të dhënave që kemi në dispozicion, shqiptarët hynë në skenë të historisë së shkruar pasklasike në gjysmën e dytë të shekullit njëmbëdhjetë, dhe vetëm në këtë shekull mund të flasim me siguri mbi një popull shqiptar siç e njohim sot. Në Historinë e tij të shkruar në vitet 1079-1080, historiani bizantin Mihal Ataliates (Michael Attaleiates) flet për Albanoi si pjesëmarrësit e një

kryengritjeje kundër Konstantinopolit në vitin 1043 si dhe për Arbanitai si një popull i princit të Durrësit. Njëkohësisht, afër vitit 1081, Gjon Skilices (Joannes Skylitzes), një historian tjetër bizantin, flet për Arbanites si ushtarë në trupat e mbledhura në Durrës nga Nikeforos Basilakios. Me përjashtim të veprës së gjeografit Ptolemeus nga periudha romake, këta janë rastet e para të përdorimit të shkruar të fjalës Alban-, Arban-. Populli shqiptar fillon të marrë një fizionomi dhe një identitet, edhe për popuj të tjerë.

Ekzistenca e gjuhës shqipe përmendet për herë të parë në fund të shekullit trembëdhjetë dhe në fillim të shekullit katërmëdhjetë. Bile brenda këtyre viteve, 1285 deri në 1332, ekzistenca e gjuhës shqipe përmendet katër herë.¹ Rasti më i herët, i vitit 1285, i takon jo Shqipërisë vetë por krahinës së Dubrovnikut ose të Ragusës ku jetonin mjaft shqiptarë. Në hetimet për një vjedhje në shtëpinë e Petro del Volcio nga Belena, njëfarë Matheus, biri i Markut prej Mençe, i cili ishte siç duket një dëshmitar i krimit, raportoi kështu latinisht: "Audiui unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca" (Dëgjova një zë duke thirrur në malësi në gjuhën albaneske).²

Rastin e dytë, njëzet e tre vjet më vonë, e gjejmë në një përshkrim të Shqipërisë nga një vepër anonime e quajtur *Anonymi Descriptio Europae Orientalis* (Përshkrim Anonim i Evropës Lindore). Kjo vepër mesjetare latine e vitit 1308 trajton vendet dhe viset e Evropës Lindore, veçanërisht vendet e gadishullit ballkanik. Mendohet se autori ishte një prift frëng i urdhërit dominikan i cili u dërgua nga kisha në Sërbi. Teksti i *Anonymi Descriptio Europae Orientalis* ekziston në disa dorëshkrime, si për shembull Ms. Lat 5515 dhe Ms. Lat. 14693 në Bibliotekën Kombëtare të Parisit, Ms. 263 në Bibliotekën e qytetit Poatie (Poitiers) në Francë, dhe Cod. Lat. 66 në Bibliotekën Universitare të Laiden-it të Hollandës. Përshkrimi Anonim ka kapituj mbi viset e ndryshme të Greqisë bizantine, mbi Rashinë, Bullgarinë, Rutheninë, Ungarinë, Poloninë dhe Boheminë si dhe një kapitull mbi Shqipërinë, një përshkrim të rrallë të këtij vendi dhe të këtij populli në shekullin katërmëdhjetë. Në këtë tekst thuhet se Shqipëria ka "banorë me të vërtetë luftëtarë të cilët janë harkëtarë dhe ushtarë me shtizë të shkëlqyeshëm... dhe të cilët nuk kanë qytete, kampe, fortifikime ose ferma, por që jetojnë në çadër dhe janë gjithmonë duke lëvizur nga një vend në tjetrin." Kapitulli mbi Shqipërinë mbaron duke theksuar, edhe këtu, ekzistencën e gjuhës shqipe: "Habent enim Albani prefati linguam distinctam a Latinis, Grecis et Sclavis ita quod in nullo se inteligunt cum aliis nationibus" (Shqiptarët e lartpërmendur kanë një gjuhë të veçantë nga gjuha e latinëve, e grekëve dhe e sllavëve, kështu që nuk mund të komunikojnë fare me kombe të tjerë).³

Rasti i tretë ku gjuha shqipe përmendet, gjendet në një vepër të shkruar nga një shtegtar i krishterë në udhëtim për në Tokën e Shënjtë në vitin 1322. Veprat e shtegtarëve në rrugë për në Tokën e Shënjtë përbëjnë një burim kryesor informacioni mbi vendet e Mesdheut Lindor në gjysmën e parë të njëmijvjeçarit të

¹ cf. Elsie 1991a.

² cf. Jirecek 1901, 1904, & Ajeti 1977, 1982.

³ cf. Elsie 1990.

dytë. Në këtë rast, dy shtegtarë anglo-irlandez me emrat Symeon Semeonis dhe Hugo Illuminator, që mund ti quajmë shqip Simon Simoni dhe Hugo Iluminatori, kaluan në Shqipëri në vitin 1322 dhe Simoni shkroi përshtypjet e tij në një lloj udhëpërshkrimi. Kjo vepër na jep një përshkrim mjaft të vlefshëm të bregdetit shqiptar në shekullin katërmëdhjetë. Simon Simoni, një murg i urdhërit françeskan, u nis nga Klonmeli i Irlandës në pranverë të vitit 1322 me shokun e tij Hugo Illuminator. Ata kaluan në Londër, Kantërbëri, Dovër, Visant, Paris, Bonë, Lion, Avinjon, Nisë, Gjenovë, Bobbio, Piacencë, Parmë, Mantovë, Veronë, Vinçencë deri në Venedik. Nga Venediku udhëtuan me një anijë tregtare për në Tokën e Shënjtë duke qëndruar gjatë rrugës në Pulë, Zadar, Dubrovnik, Ulqin, Durrës, Korfuz, Kefaloni dhe Kretë, para se të arrijnë në Aleksandri. Vepra e Simonit, e njohur si *Itinerarium Symonis Semeonis ab Hybernia ad Terram Sanctam* (Rruga e Simon Simonit nga Irlanda deri në Tokën e Shënjtë) ruhet në Bibliotekën e Kolegjit Corpus Christi në Kembrixh të Anglisë. Duke udhëtuar në bregdetin shqiptar, Simoni shënoi ndër të tjerat: "Albanya est provincia inter Sclavoniam et Romanyam, per se linguam habens" (Shqipëria është një krahinë midis Sllavonisë dhe Romanisë, e cila ka një gjuhë të vetë). Për qytetin e Durrësit vazhdon kështu: "Inhabatur enim Latinis, Grecis, Judeis perfidis, et barbaris Albanensibus" (Banohet kështu nga latinët, grekët, çifutët e pabesë dhe barbarët shqiptarë). Në trajtimin e qytetit të Dubrovnikut flet edhe për gjuhën e këtyre barbarëve, duke thënë: "In eadem dominantur Veneti, et ad eam confluunt Sclavi, Barbari, Paterini et alii scismatici negotiatores qui sunt gestu, habitu et lingua Latinis in omnibus diffformes" (Në këtë [qytet] mbretërojnë venedikasit dhe qarkullojnë këtu edhe sllavë, barbarë, paterinë dhe tregtarë të tjerë skismatikë të cilët ndryshojnë krejt nga latinët në zakonet, veshjet dhe gjuhët e tyre).⁴

Rasti i fundit ku përmendet ekzistenca e gjuhës shqipe ndodhi në vitin 1332 në veprën e një murgu frëng të urdhrit dominikan me emrin Brokardi (Lat. Brocardus monachus). Në traktatin e tij latin, i quajtur *Directorium ad passagium faciendum* (Udhëzime për kapërcimin e detit), Brokardi shënon fjalinë tashmë të njohur në letërsinë shqiptare: "Licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris" (Shqiptarët kanë një gjuhë tjetër krejt ndryshe nga latinishtja, megjithatë përdorin shkronja latine në të gjithë librat e tyre). Kjo fjali u interpretua nga shkencëtarët shqiptarë si një dëshmi për ekzistencën e librave në gjuhën shqipe, por ka më shumë të ngjarë se Brokardi e kishte fjalën për gjuhën latine të përdorur në Shqipëri.

Çfarë rëndësi u jepet këtyre katër rasteve që u shënuan brenda një periudhe prej dyzet e shtatë vitesh (1285-1332)? Ata tregojnë me qartësi se në atë kohë, për herë të parë, shqiptarët kishin dalë përfundimisht në skenë si komb me një gjuhë dhe me zakonet e veta. Çfarë kishte ndodhur?

Që nga arritja e sllavëve në jug të gadishullit ballkanik dhe në Shqipëri deri në pushtimin turk në shekullin pesëmbëdhjetë, shqiptarët jetuan në kontakt të ngushtë dhe të vazhdueshëm me fqinjët sllavë. Mund të flitet bile për një simbiozë, një

⁴ cf. Elsie 1991b.

bashkëjetesë sllavo-shqiptare në shumë krahina të Shqipërisë. jatë gjithë kësaj kohe bashkëjetese, fiset nomade shqiptare po asimiloheshin nga sllavët. Një pjesë e popullsisë shqiptare qe asimiluar krejtësisht dhe një pjesë tjetër u tërhoq ngadalë ngadalë në tokën e mirëfilltë shqiptare, në malësi. Në Mesjetë, nuk kishte shumë banorë shqiptarë nëpër qytetet e bregdetit shqiptar. Banorët e Durrësit ishin kryesisht venedikas, grekë, çifutë dhe sllavë. Në Shkodër banonin venedikas dhe sllavë, dhe në Vlorë grekët bizantinë. Ashtu si indianët në Amerikën Veriore pas kolonizimit evropian, popullata shqiptare qe mënjeluar në vendin e vetë. Në fund të shekullit dhjetë, Perandoria e Madhe Bullgare u pushtua nga grekët e Bizantit, duke u dhënë fiseve shqiptare, po ta quajmë kështu, një mundësi për ta zgjeruar tokën. Gjatë shekujve njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, shqiptarët filluan të lëviznin nga malësia, duke zënë vend në fushën bregdetare të Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme. Në këtë periudhë u themelua shteti i parë shqiptar Arbanon i cili pati jetë prej vitit 1190 deri në vitin 1216. Në shekullin trembëdhjetë, shqiptarët u konsoliduan si komb dhe u zgjeruan ngadalë ngadalë në drejtim të jugut, duke marrë Shqipërinë e Jugut dhe Maqedoninë Perëndimore. Me kohë, zunë vend edhe në gjithë Greqinë. Me këtë zgjerim tokësor dhe me këtë konsolidim, kuptohet atëherë në këtë periudhë që shqiptarët nuk ishin më barbarë nomadë të rrallë të cilët bredhnin luginat e largëta të malësisë, por që kishin filluar të ishin të dukshëm si komb për popujt e tjerë.

Në periudhën 1285-1332, siç e pamë, gjuha shqipe për herë të parë u bë një dukuri për shkrimtarët e huaj që kishin kontakt me pjesën jug-perëndimore të gadishullit ballkanik. Në shekullin pesëmbëdhjetë dolën dokumentet e para të shkruara në gjuhën shqipe: 1405, 1462, 1483, 1497, dhe kështu pas shumë shekujve në errësi, kultura dhe letërsia shqiptare filluan me në fund të lulëzojnë. Ironia e fatit për ne është se hapi i parë i daljës në skenë të gjuhës shqipe lidhet me një vjedhje.

Sa material i bukur për një humorist!

BIBLIOGRAFI

AJETI, Idriz

Contribution à l'étude de l'origine de quelques toponymes du Monténégro. në: Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972. Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41. (Innsbruck 1977) f. 677-687.

- Kontribut për studimin e disa toponimeve të Malit të Zi. in: AJETI, Studime gjuhësore në fushë të shqipes. vëll. 1. (Rilindja, Prishtinë 1982) f. 113-119.
-

DUCELLIER, Alain, La façade maritime de l'Albanie au moyen age. Durazzo et Valona du XIe au XVe siècle. (Institute for Balkan Studies, Selanik 1981) 702 f.

ELSIE, Robert, The Albanian lexicon of Arnold von Harff, 1497. në: Zeitschrift für Vergleichende Sprachforschung, Göttingen, 97 (1984), f. 113-122.

- The Belfortis text and early Albanian.

në: Zeitschrift für Balkanologie, Berlin, 22.2 (1986), f. 158-162.

[= Elsie 1986a]

- Dictionary of Albanian Literature.

(Greenwood, Westport, New York & London 1986) 171 f.

[= Elsie 1986b]

- Albania in the 'Anonymi Descriptio Europae Orientalis' (1308 A.D.).

në: Zeitschrift für Balkanologie, Berlin, 26. 1 (1990), f. 24-28.

- The earliest references to the existence of the Albanian language.

në: Zeitschrift für Balkanologie, Berlin, 27.2 (1991), f. 101-105.

[= Elsie 1991a]

- Tëo Irish travellers in Albania in 1322 .

në: Albanien in Vergangenheit und Gegenwart. Südosteuropa- Studien 48. Hrsg. Klaus-Detlev Grothusen (Südosteuropa-Gesellschaft, München 1991), f. 24-27.

[= Elsie 1991b]

- History of Albanian literature. A survey of creative writing in Albanian from the beginning to the present day, including a selective bibliography. 2

vëllime.

(East European Monographs. Distributed by Columbia University Press, New York 1995) 1,057 f.

ESPOSITO, Mario (ed.)

Itinerarium Symonis Semeonis ab Hybernia ad Terram Sanctam. Scriptores Latini Hiberniae, vëll. 4.

(Dublin Institute for Advanced Studies, Dublin 1960)

GORKA, Olgierd (ed.)

Anonymi descriptio Europae orientalis. Imperium Constantinopolitanum, Albania, Serbia, Bulgaria, Ruthenia, Ungaria, Polonia, Bohemia. Anno MCCCVIII exarata.

(Sumptibus Academiae Litterarum, Krakov 1916) 70 f.

HOADE, Eugene (ed.)

Eastern Pilgrims. The itineraries of Fr. Simon Fitzsimons, O.F.M. 1322-23, a certain Englishman 1344-45, Thomas Brygge 1392 and notes on other authors and pilgrims. First impression 1952, reprinted 1970. Publication of the Studium Biblicum Franciscanum. No. 18.

(Franciscan Printing Press, Jerusalem 1952, 1970)

JIRECEK, Konstantin

Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters 1-3. Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Phil.-hist. Kl.

(Wien 1901, 1904)

NASMITH, James

Itinerarium Symonis Simeonis et Hugonis Illuminatoris ad Terram Sanctam
(Kembrixh 1778)

Recueil des Historiens des Croisades. Documents arméniens. Tome second.

Documents latins et français relatifs à l'Arménie.

(Paris 1906)

MIRON ÇAKO

VESHJA, SHPREHJE E DINJITETIT NJERËZOR

Veshja, së bashku me ushqimin dhe strehimin, është një aksesori i domosdoshëm për ekzistencën bazike të jetës së trupit tonë, ashtu siç thuhet: “Në qoftë se ke të hash e të vishesh, të mjafton”. Ajo e mbron trupin nga agjentët natyralë, si: lagështira, të ftohtët, të nxehtët. Përvoja njerëzore në shekuj ka përcaktuar edhe gardërobën që i përshtatet çdo klime në hapësira të ndryshme gjeografike të globit, prandaj kemi një gamë të pafund stilesh dhe formash veshjeje.

Përveç kësaj, veshja është edhe tregues i gjinisë përkatëse, e cila, e mbuluar, shprehet së jashtmi nëpërmjet stilit dhe ngjyrave të rrobave, që mbajnë veshur meshkujt dhe femrat. Meqenëse njeriu është krijuar heteroseksual, duhet që edhe veshja t’i përshtatet gjinisë së ndryshme. Sipas ligjeve të vjetra ishte e ndaluar dhe madje e neveritshme që burri të vishte rroba gruaje dhe anasjelltas. Prandaj dhe veshja unisex nuk i përgjigjet këtij rregulli dhe, pavarësisht se ajo duket më praktike, bëhet shkak i ngatërrimit të gjinisë dhe për më tepër, një mjet promovimi i konceptit “modern” për ndryshimin e gjinisë dhe përqasjes homoseksuale sipas lirisë së individit në kohën e sotme, ose i shfaqjes së një krijese të re njerëzore, biseksuale.

Veshja në shekuj ka qenë mbrojtëse ndaj shikimeve mikluese (provokuese) dhe ndaj rrezikut të bërjes viktime e abuzimit seksual. Arsyeja se pse sot po rritet frikshëm numri i abuzimeve seksuale është pa diskutim edhe veshja e papërshtatshme ose, më mirë, provokuese, jo vetëm në ambiente publike, si: rrugë, institucione etj., por edhe në shtëpi, duke qenë faktor nxitës për abuzim seksual me pjesëtarët e familjes, deri në incest. Statistikat janë alarmante. Psh., në Angli, më shumë se 35 gra raportojnë në polici se janë abuzuar seksualisht. Sipas “Daily Mail”, në total janë regjistruar 22 000 përdhunime, duke pasur një rritje prej 29% në vit. Në Amerikë, organizata RAINN (organizatë kundër sulmeve seksuale) thotë se në 2 minuta ndodh një dhunë seksuale, psikologjike ose fizike. Në 47% të rasteve, përdhunimet vijnë nga njerëz të njohur e të afërm të viktimave. 44% e viktimave janë nën moshën 18-12 vjeç. Kjo është moshja më liberale dhe jo shumë e përgjegjshme në lidhje me veshjen e përshtatshme si masë mbrojtëse.

Që nga qytetërimet primitive, veshja ka pasur funksion përcaktimin jo vetëm të statusit gjinor, por edhe të rendit në shoqërinë njerëzore. Ajo ka qenë tregues i gradës dhe i funksionit në shkallën sociale dhe nderim e përgjegjësi për atë që e mbante. Psh., ndryshe ishte rroba e një monarku dhe ndryshe e popullit të thjeshtë, ndryshonte dukshëm rroba e një funksionari nga ajo e një shtetasi, e të pasurve nga e të varfërve, e zotërinjve nga e skllëvërve, e klerikut nga e laikut, e përfaqësuesve

dhe grupimeve të komuniteteve të ndryshme fetare. Madje, sot veshja po bëhet një faktor kryesor i përplasjeve të kulturave të ndryshme dhe bindjeve fetare.

Pra, rroba ishte tregues i larmisë së funksioneve të jetës në shoqërinë njerëzore, për ta rregulluar dhe harmonizuar këtë bashkëjetesë. Kjo gjë vazhdon të ndodhë edhe sot, por në kohët tona ka një tendencë për unifikim të veshjeve funksionale në emër të barazisë, e cila në vetvete po krijon më shumë anarki dhe po humbet respektin ndaj funksioneve të rëndësishme shoqërore, që siç thamë, shprehen sipas rendit të tyre me anë të veshjes përkatëse. Për shembull, të gjithë ne e konstatojmë se ndryshe është respekti ndaj një shtetasi me detyrë të veçantë, kur ai është i veshur me rrobën e statusit shoqëror, p.sh. si polic, e ndryshe kur ai është i veshur si civil.

Rroba ishte edhe tregues i kulturës së fiseve, trevave, kombeve. Duke qenë të dallueshme nga njëra-tjetra, ato përcaktonin kufijtë etnografikë të një populli, por duke qenë të veçanta për nga stili, ato ngjanin si gurë mozaiku, që së bashku na jepnin një tablo të përgjithshme folklorike të popujve; kjo është një pasuri e madhe e njerëzimit, që nuk duhet humbur.

Krahas këtyre, veshja ishte edhe mjet për të lidhur miqësi e vëllazëri midis njerëzve, ashtu siç ishte zakon dhënia e mantelit si shenjë e vëllazërimit mes personave, ose e bashkimit të dy individëve në martesë, siç ishin rrobat që dhëndri i dërgonte nuses dhe nusja dhëndrit.

Veshja ishte dhe vazhdon të jetë, por më e zbehtë, tregues i shprehjes së gjendjes shpirtërore dhe pozicionit social në shoqëri. Ndryshe vishej një i gëzuar dhe ndryshe një i hidhëruar a i penduar, ndryshe një e martuar dhe ndryshe një e pamartuar a një e ve, ndryshe një i lirë dhe ndryshe një i burgosur.

Rroba ishte edhe një marrëdhënie jetike për shoqërinë, sipas porosisë: “Të veshësh atë që është i zhveshur”, jo vetëm për të mbuluar gjymtyrët e njeriut nevojtar, por edhe që nëpërmjet dashurisë konkrete, të mbajë gjallë një komunitet, ku e mira dhe e keqja e dikujt është e mira dhe e keqja e të gjithëve. Kjo e bën të qëndrueshëm një komunitet lokal, por edhe gjithë shoqërinë njerëzore, që në esencë janë e njëjta gjë: vëllezër e motra, rrjedhojë e çiftit të parë, Adamit dhe Evës, të cilët u krijuan nga Perëndia dhe u vendosën në një kopsht (Eden) ku trupat e tyre të krijuar prej dheu, ishin të veshur me një rrobë drite sipas Hirit (energjitë e Perëndisë). Kjo i tregonte ikona të Perëndisë, të ngjashëm me Atë, ndryshe nga të gjitha krijesat e tjera mbi dhé.

Por, rrobën e Hirit njeriu e humbi, sepse u rebelua i mashtruar nga xhelozia e djallit. Kur hëngri frutin e ndaluar, ai e pa veten lakuriq, domethënë të zhveshur nga Hiri dhe pati turp e frikë për dobësitë e tij mishore dhe bëri rroba si mbulesë prej gjeteshes fiku. Kjo gjë na tregohet në kapitullin e tretë të librit të Zanafillës në Biblën e Shenjtë. Kur Zoti e kërkoi Adamin duke e pyetur “Ku je?”, Adami dhe Eva iu përgjigjën: “Dëgjova zërin tënd në kopsht dhe pata frikë, se jam lakuriq dhe u fsheha” (Zan. 3- 1). Pavarësisht se Adami dhe Eva ishin të veshur me gjethet e pemës së fikut për të mbuluar lakuriqësinë e tyre, ajo lloj veshjeje ishte e pamjaftueshme për ta mbuluar lakuriqësinë e tyre; aq më tepër veshja me gjethet e fikut tregon se njeriu u vesh me mëkat, duke ngrënë frutin e ndaluar të një peme.

Kjo na bën të kuptojmë se mëkati ka veshjen që ai e frymëzon në stil dhe i shërben, e cila duket si veshje, por në të vërtetë është ekspozim i lakuriqësisë tunduese.

Lakuriqësia e ndau njeriun nga marrëdhënia me Zotin dhe e afroi me kafshët, që nuk kanë rroba në trupat e tyre. Kjo është edhe arsyeja përse kur kolonët (spanjollët, portugezët, anglezët etj.) kolonizinin vende të ndryshme e i gjenin lakuriq vendësit, i “shikonin” ata si kafshë, e kështu justifikonin veprimet e tyre të dhunshme e abuzuese ndaj këtij populli, duke i quajtur kafshë dhe jo njerëz. Kjo teori ka qenë e vjetër në sistemin skllavopronar, ku skllavi gjithmonë ishte i zhveshur, sepse lakuriqësia e tij e tregonte në nivelin e kafshës përpara skllavopronarit, i cili i veshur, tregonte një pushtet të pakrahasueshëm dhe të padiskutueshëm ndaj skllavit, njësoj si ka njeriu ndaj kafshës.

Sa paradoksal tingëllon ky fakt te njerëzit e brezit të sotëm, ku lakuriqësia është bërë një trend (modë) dhe një shenjë e “civilizimit” të këtij brezi. Dhe këtu nuk e kam fjalën për lakuriqësinë deri në nudo në plazh, e cila justifikohet për shëndetin e trupit, por kur kjo lakuriqësi transferohet në rrugët e qytetit. Sipas konceptit të rendit skllavopronar, kjo lloj kategorie lakuriqësh ose gjysmë lakuriqësh do të quheshin skllavë ose dhe më keq, kafshë me fytyrë njeriu.

Këtë fakt nuk duhet ta harrojmë si prindër dhe fëmijë, se njeriu bëhet skllav i atij që e skllavëron. Në qoftë se nuk vishemi vetë dhe nuk i veshim edhe fëmijët me hijeshi sipas dinjitetit njerëzor, por zhvishemi publikisht me paturpësi, ky është tregues se brezi ynë është bërë skllav i mishit (natyrës së rënë instiktive), se jemi rrëzuar nga rendi dhe dinjiteti njerëzor, se jemi njësuar me kafshët e paarsyeshme, që udhëhiqen vetëm nga instinktet dhe mburrja e gjymtyrëve të zhveshura, se jemi në fund të qytetërimit tonë, se meritojmë përbuzje dhe braktisje nga providenca Hyjnore. Zoti, gjykatësi me drejtësi, në të tilla gjendje të shturjes morale thotë me qortim, siç tha edhe para përmbytjes globale në kohën e Noes: “Shpirti im nuk do hahet gjithnjë me njeriun, sepse në shturjen e tij nuk është veçse mish” (Zan. 6-3). Dhe Zoti Krisht u tha nxënësve: “Koha e fundit do jetë si në kohën e Noes”.

Por, Bibla vazhdon e thotë se Zoti nuk e la njeriun të zhveshur, por e veshi me rroba prej lëkure (kafshe). Kjo lloj veshjeje nuk e riktheu njeriun në gjendjen e parë, siç ishte i veshur me rrobën e Hirit, por i tregoi se njeriu nuk duhet të qëndrojë lakuriq, duhet të vishet dhe kjo e dallon njeriun në rendin e krijimit nga kafshët e paarsyeshme. Që nga ai moment, veshja është shenjë e dyfishtë: ajo e ruajtjes disi të dinjitetit të njeriut të rënë në rendin e krijimit dhe mundësia që njeriu të rivishet me rrobën e Hirit. Rrobat prej lëkure, me të cilat u veshën njerëzit tregojnë se Perëndia flijoi kafshë për njeriun, që ai të vishet me lëkurën e tyre. Pra, për të fituar përsëri rrobën e Hirit, duhet bërë një fli më e lartë se ajo e kafshëve; këtë flijim e bëri të mundur përsëri Perëndia me anë të sakrifikimit vullnetar të Krishtit, që është Biri i Perëndisë dhe Biri i njeriut, i Cili u flijua vullnetarisht në Kryq, si Qengji i Perëndisë që shlyen mëkatet e njerëzve. Arsyeja pse Krishtin e zhveshën në Kryq, ishte për ta ofenduar, por si Njeri ai pranonte vullnetarisht të zhvishej, të turpërohej, që ta çlirojë Adamin dhe Evën dhe të gjithë ne që i besojmë Atij nga turpi i lakuriqësisë mëkatore dhe, pasi pagoi njëherë e përgjithmonë për mëkatet tona, u ngjall përsëri me lavdi si Adam i ri i veshur me dritën e shkëlqimit hyjnor, që kështu të mund ta riveshë përsëri njeriun me rrobën e Hirit të Perëndisë.

Prandaj, kur njeriu vjen pagëzohet në Kishën Orthodhokse në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë, ai zhvishet dhe futet lakuriq në ujë, simbol i gjendjes mëkatore të zhveshur nga Hiri si ajo e Adamit pas mëkatit, dhe mbasi del, e veshin me rroba të bardha, simbol i rrobës së Hirit që e rimori nga bashkimi me Krishtin në Misterin e Pagëzimit. Nga ai moment, njeriu i pagëzuar fiton përsëri dinjitetin, duke u veshur me Hirin e Perëndisë që është në Krishtin, Adamin e Ri, duke u bërë kështu një bir Perëndie, pjesëmarrës i natyrës Hyjnore. Prandaj edhe në shërbesën e Pagëzimit këndohet himni “Sa u pagëzuam me Krishtin, me Krishtin u veshëm. Alilua”.

Ata që do t’i qëndrojnë besnikë këtij bashkimi, kësaj veshjeje (Hiri) me Krishtin, deri në fund të jetës, vetë Zoti Krisht, i cili do të vijë përsëri me lavdinë e Atit bashkë me engjëjt për të gjykuar çdo njeri, u premton: “Kush fiton, do të ecë me mua me rroba të bardha.... dhe këta qëndronin në këmbë përpara fronit dhe përpara Qengjit (Krishtit) të veshur me rroba të bardha (pastërti dëlirësi) dhe me palma në duart e tyre (lavdi e përjetshme)” (Zbul. 3-4\ 7- 9). Këtu përmbushet kuptimi i veshjes, si shprehje e dinjitetit të lartë njerëzor.

* Përgjegjësi i zyrës së Katekizmit të KOASH

ABLA XHAFERI**KONSIDERATA PËR LUFTËN KUNDËR DHUNËS
NDAJ FËMIJËVE**

Dhuna ndaj fëmijëve sot është një fenomen mjaft shqetësues në çdo vend të globit, në vendet e zhvilluara dhe në ato më pak të zhvillara, pavarësisht nga kombësia, raca, moshë, seksi, statusi familjar a shoqëror, niveli arsimor e kulturor etj. Ky fenomen duhet parandaluar e luftuar, në mënyrë që shoqëria të mos vuajë pasojat dhe dëmet që shkaktohen prej tij. Format e shfaqjes së kësaj dhune janë të shumta, të shumta janë dhe rrugët e mënyrat e luftës për parandalimin e saj. Në këtë ndërmarrje përfshihen plotësimi dhe kompletimi i legjislacionit, ngritja e strukturave të posaçme shtetërore, gjetja e të gjithë mekanizmave dhe instrumenteve të nevojshëm deri te veprimtaria praktike konkrete për gjurmimin, evidentimin dhe parandalimin e rasteve të ushtrimit të kësaj dhune. Për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve duhet të luftojnë, në radhë të parë, prindërit, sepse ata kanë mundësitë, të drejtën, por edhe detyrimin që t'i rritin dhe edukojnë fëmijët e tyre pa dhunë, duke marrë në konsideratë interesat e tyre jetësorë. Edhe punonjësit e institucioneve arsimore publike apo private, shteti dhe shoqëria kanë detyrimin e tyre për të luftuar këtë fenomen. Çdo gjë është e arritshme në këtë drejtim, por kërkon përkushtim, mund dhe punë këmbëngulëse e sistematike.

Fjala *dhunë* është sot një apelativ mjaft i përdorur. Atë e dëgjon kudo: në familje dhe jashtë saj, në mjedise publike, në institucione publike dhe private; e dëgjon në mediet elektronike dhe e lexon në mediat e shkruara, e ndesh shpesh në rrjetet sociale.

Përkufizimi i dhunës është i vështirë, sepse ai është i varur sidomos nga kultura e studiuesve të dhunës dhe nga kultura e vendit apo e shtresës shoqërore ku ajo ushtrohet.¹ Varësia kulturore e dhunës shprehet me faktin se bashkë me evoluimin kulturor të shoqërisë ka evoluar edhe qëndrimi ndaj formave të ndryshme të ushtrimit të saj. Le të sjellim në kujtesë se në vitet '50 - '60 të shekullit të kaluar prindërit shkonin rrallë ose nuk shkonin asnjëherë në shkollë, kur fëmija ndëshkohej nga mësuesi. Sot mjaft prindër nuk lejojnë që të ushtrohet asnjë lloj dhune ndaj fëmijëve të tyre.

Në fjalor² dhuna është përkufizuar si përdorim i shtërngimit fizik ose psikik, i mjeteve e i metodave të vrazhda ndaj dikujt për ta detyruar të bëjë diçka jashtë vullnetit të tij, për ta nënshtruar, për ta shtypur etj.; detyrim a shtypje me anë të forcës. Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka përkufizuar si përdorim të

¹ A. Tamo, Dh. Karaj, *Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri*, Tiranë, 2006, f. 19

² *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984

qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim.³

Nga këto përkufizime del se dhuna është një fenomen me përmasa globale, që mund të ushtrohet ndaj kujtdo, pavarësisht nga raca, kombësia, mosha, seksi, statusi familjar a shoqëror, niveli kulturor, shkalla e arsimimit etj. Edhe në shekullin që kemi hyrë, dhuna vazhdon të shkatërrojë jetë njerëzish në çdo vend dhe në të gjithë shtresat e shoqërisë. Shtresat që provojnë më shumë dhunë, janë fëmijët dhe gratë. Dhunuesi në çdo rast është ai ose ajo që është dominues ndaj viktimës në aspektin fizik, moral, ekonomik, kulturor etj.

Para nesh sot shtrohen një sërë pyetjesh: Çfarë dimë për dhunën ndaj fëmijëve dhe për format e shfaqjes së saj? Cilat janë përmasat e kësaj dhune? Sa i janë përgjigjur politikat dhe programet globale dhe ato të shtetit shqiptar postkomunist zhvillimit të këtij fenomeni? Deri në çfarë mase kanë arritur ligjet, reformat dhe veprimtaritë e posaçme të organizmave të ndryshëm shtetërorë dhe të organizatave joqeveritare që merren me këtë problem në vende të ndryshme, ta frenojnë këtë fenomen të rëndë social? Cili ka qenë roli i i ligjvënësve, vendimmarrësve, zbatuesve dhe përfituesve në këtë proces? Këto dhe shumë çështje të tjera kërkojnë vëmendje të vazhdueshme për të arritur në përfundime konkrete dhe për të gjetur mundësi e forma të reja për luftimin e këtij fenomeni.

Fenomeni i dhunës në vetvete është një kompleks mjetesh, formash dhe metodash për të detyruar dikë që të veprojë jashtë vullnetit të vet ose për ta ndëshkuar për veprimet e kryera në kundërshtim me atë që mendon dhunuesi.

Është pranuar në përgjithësi se dhuna mund të përdoret vetëm në rastet kur është e nevojshme, kur fjala nuk e ka më forcën e duhur për të zgjidhur problemet. Për fat të keq, në realitetin e përditshëm ky fenomen është kthyer në mjet kryesor për disiplinimin, sidomos të fëmijëve dhe të grave. Format e dhunës për të dy këto shtresa të shoqërisë janë pothuaj të njëjta, ndërsa motivet, dhunuesit dhe mjediset ku ajo ushtrohet, janë të ndryshëm. Sikurse gratë, edhe fëmijët, dhunohen në familje, në mjedise jashtë saj apo në institucione publike dhe private.

Dhuna kundër fëmijëve është dhunim i të drejtave të tyre. Veprimtarët thonë se në Shqipëri shifrat që lidhen me dhunën në familje apo në shkollë, me konfliktet me mësuesit apo me bashkëmoshatarët, me konfliktet pas divorcit të prindërve etj., janë në rritje.⁴

Nga intervistat që kemi marrë, por edhe nga përvoja jetësore, mund të themi se në praktikë është shumë e vështirë të gjesh individ që nuk ka provuar një formë të caktuar dhune. Dhuna është kthyer në një mjet jetësor të vlerësimit dhe të reagimit ndaj sjelljes dhe të veprimeve të këqija të fëmijëve.

Jo të gjitha rastet e ushtrimit të dhunës denoncohen. Fëmijët janë të prirur më shumë për të denoncuar dhunën që ushtrojnë mbi ta bashkëmoshatarët ose fëmijët e tjerë më të rritur dhe më pak denoncojnë dhunën e edukatoreve apo të mësuesve.

³ *World report on violence and health*, World Health Organization, Geneva, 2002

⁴ *Shqiptarja.com*, 19 qershor 2014

Megjithatë, për fat të keq, edhe ato raste që ata i denoncojnë, nuk trajtohen me interesin e duhur nga prindërit apo personat kompetentë.

Mangësi të kuadrit ligjor dhe institucional, të politikave dhe programeve të punës lidhur me dhunën kundër fëmijëve

Në dekadat e fundit, kuadri ligjor dhe ai institucional janë përmirësuar e pasuruar sipas standardeve të njohura ndërkombëtare.

Në kuadrin ligjor janë ratifikuar një sërë konventash, sidomos Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Birësimet jashtë Vendit dhe konventa të tjera me karakter më të përgjithshëm. Qeveria shqiptare, ka bërë përpjekje për të reformuar ligjet dhe dispozitat që trajtojnë dhunën ndaj fëmijëve. Megjithatë, ka akoma shumë mangësi në legjislacion. Legjislacioni i lidhur me këtë fenomen ende nuk është i kompletuar, ende nuk trajtohen në mënyrë tërësore dhe të detajuar format e dhunës kundër fëmijëve. Lufta kundër këtij fenomeni në Shqipëri ende nuk është kthyer në veprimtari të rregullt e sistematike. Ligjet e hartuara për këtë qëllim kanë karakter të përgjithshëm. Në legjislacion është punuar më tepër duke u nxitur nga institucionet ndërkombëtare që merren me liritë dhe të drejtat e fëmijëve. Vëmendja është përqendruar kryesisht te disa forma të ushtrimit të dhunës, si dhuna seksuale apo trafikimi i fëmijëve, për të cilat sot ekziston një paketë ligjesh dhe dispozitash specifike. Por ende mungojnë dispozitat e plota për dhunën e ushtruar në shtëpi, në shkollë, në institucionet e tjera apo në mjediset publike, për raportimin dhe ankimin për ushtrimin e kësaj dhune, për kujdesin ndaj viktimave dhe për rehabilitimin e tyre.

Në kuadrin institucional ende mungojnë strukturat e veçanta shtetërore që merren posaçërisht me trajtimin e këtij fenomeni.

Për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri vihet re një angazhim më i madh i organizatave joqeveritare, sesa i institucioneve shtetërore qendrore dhe lokale. Këto organizata u kanë kërkuar shpesh autoriteteve qendrore dhe vendore që të zbatojnë ligjin për eliminimin e punës së fëmijëve, të dënojnë shfrytëzuesit dhe të ofrojnë strehim dhe ushqim për ta. Por veprimtaria e këtyre organizatave nuk ka pasur një strategji të mirëpërcaktuar dhe të mbështetur edhe financiarisht. Vëmendja dhe kujdesi ndaj fëmijëve është në krye të veprimtarive mbrojtëse të UNICEF - it, në bashkëpunim me institucionet shqiptare. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka

filluar të zbatojë një program komunikimi në shkolla, duke u fokusuar në uljen e rasteve të dhunës nga mësuesit nëpërmjet mënyrave të reja të disiplinës.⁵

Sot në Shqipëri ka edhe mjaft dokumente të rëndësishme që synojnë parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve, por duhet thënë se nuk ka ende një politikë të përgjithshme të përcaktuar, të mbështetur nga një legjislacion i plotë, nga mekanizmat dhe burimet e duhura njerëzore e financiare. Programet e derisotme nuk kanë instrumentet e duhura të zbatimit e të monitorimit dhe, më e rëndësishmja, nuk kanë mbështetjen e mjaftueshme buxhetore financiare. Në këto plane dhe programe fëmijët shpesh nuk janë palë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e tyre. Zakonisht për çështjet më thelbësore që lidhen me këtë fenomen, vendosin të rriturit.

Duhet thënë se mungojnë edhe përpjekjet e organizuara dhe sistematike për të dokumentuar më mirë ecurinë dhe zhvillimin e këtij fenomeni, si dhe për të kuptuar më mirë shkaqet e tij.

Përcaktimi i motiveve dhe i shkaqeve të përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve

Për të luftuar drejt fenomenin e dhunës ndaj fëmijëve është me shumë rëndësi përcaktimi i saktë i motiveve dhe i shkaqeve që çojnë drejt këtij fenomeni.

Qëndrimi i përgjithshëm sot se përdorimi i dhunës ndaj fëmijëve ka një motiv të vetëm: dobinë që sjell për miredukimin me normat e pranuar,⁶ duke e parë dhunën si mjet të domosdoshëm për zbatimin e këtyre normave dhe rregullave.

Një pjesë e madhe e njerëzve, kryesisht prindër, por edhe mësues dhe edukatorë dhunën (kryesisht atë fizike) e shohin si mjetin më efikas për rregullimin e sjelljes së fëmijëve. Gjatë bisedave dhe intervistave, prindër të ndryshëm (kryesisht baballarë) kujtojnë fëmijërinë dhe sjelljen e prindërve të tyre, duke vënë në dukje se asgjë e keqe nuk u ka ardhur nga dhuna që kanë ushtruar prindërit ndaj tyre. Përkundrazi, ata mendojnë se janë bërë më të disiplinuar dhe më të përgjegjshëm për sjelljen dhe aktivitetin e tyre jetësor. Këtë mendësi ata përpiqen për ta kultivuar edhe te fëmijët, në mënyrë që këta të fundit ta pranojnë dhunën si një mjet të nevojshëm për disiplinimin e tyre. Në bazë të anketimeve të kryera me fëmijët, studime të ndryshme kanë provuar se afro gjysma e tyre e pranojnë që dhuna është diçka e mirë në familje dhe në institucionet arsimore.

⁵ Në shkolla po përdoret karta PEET, kartë me përmasat dhe funksionin e kartonit të verdhë që përdor arbitri në një ndeshjeje futbollit. Karta PEET përdoret nga mësuesit kur ata përballen me raste problematike. Nxjerrja e kartës nga mësuesi tregon se është shfaqur një problem që kërkon zgjidhje nëpërmjet mënyrave të reja të disiplinës (MRD). Gjithashtu, midis Linjës telefonike ALO 116 dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit, që synon të mbrojë çdo fëmijë në situata emergjente dhe të rrezikshme.

⁶ Zhvillimi i fëmijërisë së hershme në Shqipëri, studim i Qendrës së Zhvillimeve Humane dhe Save the Children, 2001

Duke shkuar më tej, këta prindër këshillojnë edhe mësuesit e fëmijëve që të përdorin dhunë ndaj tyre, kur ata nuk iu binden urdhrave a këshillave ose manifestojnë sjellje të pahijshme në shkollë. Një pjesë e madhe e atyre që e ushtrojnë dhunën, por dhe e atyre që janë viktimë, e përligjin përdorimin e saj me mendësinë e krijuar abuzitivisht se ai që të do, të rreh.

Mjaft prindër, mësues dhe edukatore përdorimin e dhunës fizike e lidhin vetëm me momente të caktuara të sjelljes dhe të aktivitetit të fëmijëve. Ata nuk e shohin dhunën si mjet efikas për çdo rast, por nuk e mohojnë anën pozitive të saj në raste të caktuara.

Sot është edhe një numër i konsiderueshëm prindërisht, veçanërisht të rinj, të cilët e mohojnë në mënyrë kategorike dhunën fizike ndaj fëmijëve. Ata e shohin atë si një fenomen tepër të dëmshëm e të rrezikshëm, me pasoja mjaft të rënda dhe për këtë arsye nuk e pranojnë përdorimin e saj në asnjë rast, qoftë edhe rast ekstrem.

E përbashkëta e të gjitha qëndrimeve dhe opinioneve për dhunën ndaj fëmijëve është se ajo duhet përdorur kur fjala nuk e bën më efektin e saj, kur format e tjera jo të dhunshme nuk japin më rezultat. Forma më e përligjur dhe më e tolerueshme është dhuna psikologjike, edhe sepse ajo nuk lë “gjurmë” të dukshme te personi, siç mund të lërë dhuna fizike.

Shkaqet e ushtrimit të dhunës te fëmijët janë të shumta e të ndryshme. Ato duhen evidentuar saktë, për të pasur rezultate në luftën ndaj këtij fenomeni.

Një fëmijë mund të dhunohet në familje për shkaqe nga më të ndryshmet. Ai mund të shkaktojë rrëmujë, të shkelë rregullat e jetës familjare, mund të kryejë një veprim të pahijshëm ose të gabuar. Fëmija që dhunohet, mund të ketë përdorur fjalë të pahijshme ndaj dikujt tjetër ose nuk ka plotësuar një kërkesë të një të rrituri. Ai dhunohet edhe kur nuk ka aftësitë e nevojshme për të arritur synimet që kanë prindërit ndaj tij ose kur prindërit nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e tij. Përdorimi i dhunës lidhet gjithashtu me paraqitjen e jashtme të fëmijës, me veshjen, me ndërhyrjet kozmetike etj. Ky fenomen është edhe pasojë vendosjes, ruajtjes apo cenimit të autoritetit të padiskutueshëm të më të rriturve në familje, duke u mbështetur në traditat patriarkale dhe ligjet kanunore.

Në institucione dhuna ndaj fëmijëve është e lidhur me shkeljen rregullave të sjelljes dhe të etikës, por edhe me shkaqe banale, që lidhen me ndjenjën e egoizmit të sëmurë të punonjësve të këtyre institucioneve; me qejfmbetjen e këtyre punonjësve ndaj prindërve apo të afërmeve të fëmijëve, madje edhe ndaj kolegëve që i simpatizojnë apo i përkrahin ata fëmijë; me mosplotësimin e kërkesave të tyre absurde nga fëmijët etj.

Përcaktimi i formave të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe i pasojave të kësaj dhune

Për të qenë të suksesshëm në luftën kundër dhunës ndaj fëmijëve, evidentimi i të gjitha formave të ushtrimit është po aq i rëndësishëm sa edhe evidentimi i shkaqeve të saj.

Format e ushtrimit të dhunës te fëmijët janë të ndryshme. Format më të shpeshta janë dhuna fizike dhe dhuna psikologjike.

Dhuna fizike ndaj fëmijëve është prezente në çdo vend të globit, në vendet e zhvilluara⁷ dhe në ato në zhvillim. Studimet e shumta kanë provuar se kjo formë e dhunës ushtrohet ndaj fëmijëve në shtresat e ulëta dhe më pak të arsimuara, ndërsa dhuna psikologjike ushtrohet kryesisht te shtresat e mesme dhe me nivel më të lartë arsimor. Të dy format e kësaj dhune janë shumë të dëmshme për të dhunuarin.

Dhunën fizike fëmijët e përjetojnë më shpesh në familje, se sa në shkollë. Kjo shpjegohet me raportet që kanë fëmijët me pjesëtarët e tjerë të familjes ose me personat që ushtrojnë veprimtarinë në institucionet publike apo private. Dhunuesit më të shpeshtë në familje janë prindërit, ndërsa në institucionet arsimore janë mësuesit dhe edukatorët. Megjithëse në institucionet parashkollore dhe në shkollë dhuna fizike është e ndaluar me ligj dhe me dispozita normative, në praktikën e përditshme përdoret gjerësisht. Format e ushtrimit të saj lidhen me moshën e nxënësve. Në institucionet parashkollore zakonisht ushtrohen forma të lehta të dhunës, megjithëse kohët e fundit nga mediet televizive janë denoncuar raste të rënda të ushtrimit të dhunës në disa kopshte në Tiranë, në Elbasan e gjetkë. Me fëmijët më të rritur përdoren forma më të rënda, deri në dëmtime serioze të viktimës.

Në aspektin fizik si në familje, dhe jashtë saj (kryesisht në institucione publike dhe private) fëmijët përjetojnë tërheqje dhe shtytje me forcë, goditje me pëllëmba ose me grushte, goditje me shqelma, pickime, kafshime, shkulje flokësh, shtrëngim fyti, goditje me sende të forta, shpim me gjilpërë në trup a në gjymtyrë etj.

Në aspektin psikologjik dhuna ndaj fëmijëve ushtrohet nëpërmjet të thirrurave e të bërtiturave, me shantazhe e kërcënime me fjalë, me përdorimin e fjalëve dhe të epiteteve fyese, me kërcënim për dëbim nga shtëpia, me mbajtje mërie, me ngacmime seksuale, me izolim apo braktisje etj. Në institucionet arsimore këtyre formave u shtohen edhe kërcënimet me notën, me përjashtimin nga shkolla apo nga kopshti, me kërcënimin për thirrjen e prindit etj. Format më të shpeshta të ushtrimit të dhunës në familje janë të bërtiturat dhe përdorimi i fjalëve fyese, ndërsa në shkollë krahas të bërtiturave, përdoren edhe kërcënimet me notë apo me thirrjen e prindit.

Pasojat fizike dhe ato psikologjike të ushtrimit të dhunës te fëmijët janë të shumta dhe nga më të ndryshmet. Përdorimi i dhunës i dëmton fëmijët fizikisht dhe mendërisht, ndikon në aftësitë e tyre për të mësuar dhe për t'u edukuar.

Në planin fizik fëmijët përjetojnë marrje mendsh, qorrollisje, rënien e të fiktit, gjakosje, mavijosje të trupit apo plagë të tjera, ndërsa në planin psikologjik dhuna ndikon në ecurinë e përgjithshme të zhvillimit emocional të fëmijëve, kultivon pasigurinë, frikën, trembjen nga gjithçka dhe për gjithçka, traumat, mungesën e iniciativës e të vendimmarrjes,⁸ mungesën e vullnetit dhe të dëshirës për të mësuar e vepruar, sjelljen e dhunshme etj.

⁷ Një studim i kryer para një dekade tregon se edhe në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar 90% e fëmijëve dhunohen fizikisht (shih UNICEF, *Children and Violence*, Innocenti Digest No 2, 2007, f. 6)

⁸ *Childhood Trauma Leaves Its Mark On the Brain*, My Science Academy, 2016

Përfundime

Pavarësisht nga treguesit e shumtë të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe të ecurisë së saj, në Shqipëri ky fenomen nuk është i dokumentuar në mënyrë të plotë. Me gjithë rastet e shumta që janë evidentuar nga anketimet apo intervistat, që janë përmendur në medien e shkruar apo në atë elektronike, tabloja e shfaqjes së këtij fenomeni nuk është e plotë. Përveç kësaj, edhe disa nga të dhënat ekzistuese rreth përdorimit të dhunës janë të pasigurta dhe subjektive. Vërtetësia e tyre në disa raste është e diskutueshme dhe e dyshimtë. Nisur nga ky fakt, është i domosdoshëm hartimi i një studimi të gjerë e të detajuar mbi dhunën që ushtrohet ndaj fëmijëve nga prindërit e tyre, nga mësuesit, nga vetë fëmijët apo nga njerëz të tjerë në komunitet. Ky studim duhet bërë me shumë profesionalizëm dhe pa amatorizëm.

Dhuna ndaj fëmijëve nuk është problem vetëm i shqiptarëve. Ajo është tipar karakteristik sidomos i shoqërive të pazhvilluara. Parandalimi i saj kërkon një punë dhe përkushtim shumë të madh të strukturave shtetërore, të organizatave shoqërore dhe të të gjithë komunitetit. Zbatimi më përpikmëri i ligjeve e ul nivelin e përdorimit të dhunës. Dhuna nuk ndalohet vetëm me hartimin e ligjeve dhe të amendamenteve, por me masa të menjëhershme ndaj atyre që e ushtrojnë atë. *“Në të gjitha veprimet kundrejt fëmijëve, qoftë të marra nga institucionet e mirëqenies publike apo nga ato private, nga gjyqet e drejtësisë, nga autoritetet administrative apo nga trupat legislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë element primar.”*⁹

7 Rekomandime

- Institucionet shtetërore që merren me trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve, organizatat joqeveritare që ushtrojnë këtë aktivitet dhe agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të krijojnë një bllok solid për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve.

- Të intensifikohet më tepër veprimtaria e psikologëve dhe e punonjësve socialë të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve në çdo institucion arsimor dhe njësi të qeverisjes vendore. Aktiviteti i tyre të shtrihet edhe në familje.

- Të institucionalizohen të gjitha format e dhunës në familje dhe të zhvillohen sistematikisht e me rigorozitet proceset gjyqësore ndaj personave dhunues.

- Faktorët dhe shkaqet që çojnë në dhunën ndaj fëmijëve, të trajtohen në mënyrë sa më të plotë dhe më të specializuar në politikat dhe programet shtetërore, duke ngritur edhe strukturat përkatëse në qendër dhe në pushtetin lokal për parandalimin, trajtimin dhe monitorimin e kësaj dhune.

- Në familje dhe në institucione publike e private të zhvillohen aktivitete dhe veprimtari me karakter sensibilizues dhe parandalues me synime të përcaktuara,

⁹ Neni 3 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës

duke ofruar zgjidhje të ndryshme për miredukimin e fëmijëve dhe shmangien e dhunës ndaj tyre.

- Të hapet një zyrë e posaçme pranë çdo njësie të qeverisjes vendore për të grumbulluar raportimet dhe ankesat e fëmijëve dhe të prindërve, për të evidentuar të gjitha rastet e dhunës së ushtruar në familje dhe institucione, si dhe për të rehabilituar viktimat e kësaj dhune.

BIBLIOGRAFIA

- A. Tamo, Dh. Karaj, Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri, Tiranë, 2006
Childhood Trauma Leaves Its Mark On the Brain, My Science Academy, 2016
Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984
Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, 20 nëntor 1989
OBSH, Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës, 28 shtator 2001
Shqiptarja.com, 19 qershor 2014
UNICEF, Children and Violence, Innocenti Digest No 2, 2007
World report on violence and health, World Health Organization, Geneva, 2002
Zhvillimi i fëmijërisë së hershme në Shqipëri, Qendra e Zhvillimeve Humane dhe Save the Children, 2001

RECENSIONE

NJË FJALOR ME GJUHËN SHQIPE NË BULLGARI

Është fjala për një Fjalor tjetër bashkëbisedimor bullgarisht-shqip, të botuar në prill, 2015. Fjalori është hartuar nga Marija Hristova Georgieva (Peeva). E veçanta e Fjalorit është se teksti shqip ka si bazë të folmen shqipe në fshatin Mandricë, Bullgari.

Fjalori paraprihet nga një si hyrje, me titullin “Mandrica”, nga Ivajllo Petrov, kryetar i Shoqatës për Ringjalljen e Fshatit Mandricë. Hyrja shoqërohet me pamje nga fshati Mandricë, që duken si një copëz Shqipërie. Nga një mbishkrim në një gur në kishën e varrezave “Sveta Nedelja” (Shën e Diela), historia e fshatit fillon më 1636. Sipas një gojëdhëne, - thuhet në hyrje, - fshati është themeluar nga tre vëllezër shqiptarë ortodoksë nga Vithkuqi i Korçës. Rreth vitit 1700, - thuhet më tej në hyrje, - fshati ka filluar të rritet. Në fillim të shek. XX, numri i banorëve ka qenë rreth 3500 veta. Deri në vitin 1912, në fshat është përdorur vetëm gjuha shqipe. Në vitin shkollor 1913-1914 ka filluar shkollimi në gjuhën bullgare. Gjatë viteve '70 dhe '80 të shekullit XX, Mandrica rritet e zhvillohet edhe më. Sot, fshati është shpopulluar shumë. Banorët e paktë, që kanë mbetur, vijnë të flasin gjuhën shqipe.

Për historinë e themelimit të Mandricës dhe të folmen e saj shqipe ka shkruar edhe profesor Dhimitër Shuteriqi në “Studime filologjike”, 1965, I. Profesor Dhimitër Shuteriqi (*po aty*) dhe në “Studime filologjike”, 1965, II, bashkë me profesor Mahir Domin kanë bërë një studim të plotë shkencor për të folmen e Mandricës. Sipas profesor Shuteriqit, në vitin 1900, Mandrica ka qenë me 650 shtëpi. Ka disa gojëdhëna, - thotë profesori, - që Mandrica është themeluar që më 1453. “Fshati (është fjala për Mandricën), - shkruan profesor Shuteriqi më 1965, - prej së largu, duket si një tufë luleshqerrash midis gjelbërimit”. Edhe Bojka Sokollova ka shkruar për shqiptarët e Mandricës (Berlin, 1983). Kohët e fundit, për Mandricën kanë shkruar profesor Llukan Tase dhe profesor Abdurrahim Myftiu në librin e tyre “Bullgaria dhe studentët shqiptarë” (Tiranë, Onufri, 2011).

Në vitin 2011 është krijuar Shoqata për Ringjalljen e Fshatit Mandricë. Janë pasardhësit e sotëm të banorëve të Mandricës, që e kanë themeluar, me synimin ta ruajnë dhe ta zhvillojnë më tej në të ardhmen Mandricën – emrin e saj të mirë, traditat, gjuhën dhe pamjen e saj autentike. “Me botimin e këtij Fjalori, - thotë kryetari i Shoqatës, Ivajllo Petrov, - shpresojmë t’ju tregojmë ju dhe gjeneratave të ardhshme gjuhën, në të cilën është folur në fshatin Mandricë gjatë 400 viteve të fundit”.

Fjalori është në katër kolona: fjala a shprehja në bullgarisht; fjala a shprehja në të folmen shqipe të Mandricës, me tejkshkrim bullgar; fjala a shprehja në të folmen e Mandricës, me shkrim shqip; fjala a shprehja në gjuhën shqipe standarde. Në Fjalor ka 39 tema bashkëbisedimi, çka do të thotë se e folmja mund të shihet në 39 grupe tematike. Kjo është vlera më e parë e Fjalorit. Fjala jepet në një kontekst aktiv. Kësisoj, ajo del pa dykuptimësi e me sjelljen e saj të vërtetë gramatikore. Fjalori është kështu edhe si një fjalor i fjalëpërdorimit për të folmen shqipe të Mandricës. Kjo është një vlerë tjetër e tij.

“Ndikimi nga ana e greqishtes, turqishtes dhe bullgarishtes, - thuhet në hyrje, - nuk e ka ndryshuar thelbin e gjuhës sonë”. Është një e thënë me krenari të ligjshme. Në Fjalor, kjo gjuhë e ky thelb shihet, vërtet mjaft qartë. Fjalori nis me një gramatikë të shkurtër të gjuhës shqipe. Edhe nga gramatika, edhe nga tekstet e Fjalorit, lexuesi sheh shqipen dhe ndien mallin për shqipen. Përemrat vetorë janë: *unë, tinë, aju* (= ai, ajo), *neve, ive / vi* (nga bullgarishtja = ju), *ata*. Përemri pyetës: *çe: çe punoni?* Numërorët janë ruajtur si në gjuhën e sotme shqipe, por herë-herë, me shqiptim pak më të ndryshëm: *ni (nj → n), dju, tri, katrë, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, zjetë* (= dhjetë / ka humbur bashkëtingëllorja *dh*; në vend të saj, e folmja e Mandricës ka *z*), *nizetë, trizjetë, nikint* etj. Veta e parë e foljeve më *o • j* në kohën e tashme është me mbaresën *-n: unë gëzon*. Koha e ardhshme bëhet me *do të*, shkurtuar në *ot: unë ot këndon*. E kryera e thjeshtë e foljeve më *o • j* bëhet duke ruajtur mbaresën *j + ta: unë këndoja*. Ruhet vetvetorja më *-em: lozem* (= lodhem).

Në punë të shqiptimit: Nga Fjalori del se e folmja e Mandricës ka ruajtur grupin e vjetër të bashkëtingëlloreve *gl (gluha, glatë)* e *kl (klumësht)*. Ruhet *l* (ish – *lj* e vjetër) në rrokje fundore (tipi *bilë* / në gjuhën e sotme shqipe: *j = bijë*). Ruhet, gjithashtu, përgjithësisht bashkëtingëllorja grykore *k* (nuk është bërë *q*) përpara një zanoreje të përparme (*kuke = kuqe*). Ka *r* e jo *rr (tjer, var)*. Në fjalë që nisin me zanoren *e* shtohet një *j (jecën = eci)*. Bashkëtingëllorja *f* shndërrohet në *h (hurë = furrë)* etj.

Në punë të fjalorit (leksikut), e folmja ka ruajtur fjalë të gjuhës së sotme shqipe: *dorë, këmbë, sy, bukë, udhë, ujë* etj.; ditët e javës janë: *hënë, mara, murkurë, tënte, prënte, shtunë, djellë* (të paparaprirra nga nyja *e*). Emërtimet kryesore të ngjyrave janë: *bardë, zezë* (= i zi / e zezë), *verdë, kuke* (i kuq / e kuqe), *kalsër, gelbër, kafentë*. Fjalët për dukuritë e motit janë: *shorë* për *borë, jerë* për *erë, mëgllë* për *mjegull, fiftin* për *vetëtin, shtrakallin* për *bubullin, kieltë* për *qiell* etj. Për trupin e njeriut janë fjalët *premedis* për *mes / bel, shkrihem* për *krihem, sëmundë* për *sëmundje, shkëllçitor* për *ndrydhje* etj.; për familjen: *tatë* (baba), *bir / djalëzë, bilë / çupkë* etj.; për ushqime: *kokove, gurica, darda* ose *darza* (= dardhë), *kaçka* (arra), *cërvë* (peshk) etj. Te veshjet e stolitë ka huazime. Kjo, sigurisht ka shpjegimin e vet. Por e rëndësishme është që janë ruajtur fjalë të gjuhës amë: *gunë* (= xhakëtë), *mëngë, tjer* (tjerr), *shkrorë* (me shumë ngjyra, i/e shkruar), *hallkë* (unazë), *vës* (vëth) etj. Na duken interesante tri formime që kanë të bëjnë me veshën (*mbrëmshëm: mbrëmshme kupuca këpucë mbrëmjeje, natshëm: natshme roba* këmishë nate, *sbardërohet* zbërdhulet) dhe shumësi *pejna* për *penj*.

Fjalë të tilla, si *jam, kam, mar, dal, nisem, bën* (=bëj), *hin* (=hyj), *siel* (=sjell), *rufem* (=rruhem / e folmja nuk ka *rr* dhe *h → f*), *gigem* (=gjegjem, dëgjoj), *sbjer* (=zbjerr), *pres, zjetë* (=dhjetë), *diasë* (=djathë), *rush* (=rrush), *gellë* (=gjellë), *zemërherë* (=drekë; krahaso në gjuhën e sotme formimin *drekëherë*), *kruvë* (=krye), *glu* (=gju), *butë* (=i / e butë), *glatë* (=i / e gjatë), *mirë* (=i / e mirë), *vlorë* (=i / e vluar, i / e fejuar), *sëmurë* (=i / e sëmurë), *lagët* (=i / e lagët), *pasnesrë, jashë, brenda, nditëzë* (=njëditëzaj), *tuti* (=tutje, larg) etj. janë e përbashkëta. Kurse fjalë të tilla, si *patkë* (=rosë), *bibik* (=patë; gjel deti), *zokçe* (=zogëz), *gëzon* (=pëlqej), *përkëcen* (=kërcej), *punëshormë* (=punëtor, punëdashës), *tërzojtur* (=tërdhojtur / mbase lidhet me *tërthor = i / e gabuar*), *shkrikëshlle* (=frikacak), *sos* (=

mjaft), *cing* (= pak) etj. janë e veçanta, që mund ta ketë çdo e folme e shqipes brenda njësisë (unitetit). Te kjo e veçanta mund të ketë edhe vlera letrare potenciale për gjuhën shqipe standarde. E folmja e Mandricës ka humbur, siç u tha, bashkëtingëlloren *dh* (në vend të saj ka *z*: *zjetë, zëmb, zëndër, ze, maze* ose *d*: *bardë*). Ka humbur edhe bashkëtingëlloren *th* (në vend të saj ka *s*: *som* = thom, *satë* = i / e thatë, *ksehem, suva* = thonj). Janë ndikime të bullgarishtes. Mbiemri vihet para emrit (p.sh., *groftë ujë, toftë ujë, bardë verë, kuke verë, mblojtur kafë, djegor peper* / = piper djegës, *pjekor mish* / = mish i pjekur, *zijetor mish* etj.). Kësisoj, mbiemri është i panyjshëm dhe nuk ka gjini. Edhe rasa gjinore ndërtohet anasjellas (tipi *dorës sahat, xhobit sahat* = sahat xhepi). Edhe këtu nuk ka nyja. Janë ndikime të bullgarishtes. Edhe në fjalor (leksik) ka ndikime nga bullgarishtja, turqishtja, greqishtja etj.: *dvor* (derë), *odejallo* (batanije), *vie / ive / vi* (= ju), *li* (vallë), *jagodë* (luleshtrydhe), *mallinë* (mjedër), *kapinë* (manaferrë), *karpuz* (shalqi), *kaun* (pjepër), *kundurxhi* (këpucar), *hekim* (mjek), *asker* (ushtar), *kuvetli* (i fuqishëm), *saballe* (herët, në sabah, në mëngjes), *xhins* (fis), *kallpazan* (i rëndë, i ngathët), *freng* (domate) etj. Me këto të dhëna që jep Fjalori, mund të hetohet çfarë ka ruajtur e çfarë ka humbur e folmja, nga ç'krahinë e Shqipërisë janë bartësit e saj etj. Këto hetime mund të plotësohen, sigurisht me vjelje të reja dhe me një Fjalor shpjegues me fjalë e shprehje të së folmes së Mandricës, përfshirë edhe mbiemrat e njerëzve dhe emërvendet (toponimet, sidomos mikrotoponimet). Ai mund të jetë fjalor i plotë (i së folmes), domethënë, sipas mundësisë, të përfshijë gjithë fondin (aktiv e pasiv) të leksikut të së folmes. Fjalori do të ishte një dëshmi për të folmen e Mandricës, për historinë e shqipes (shekulli XVII), për dialektologjinë historike e leksikologjinë historike, e edhe për kulturën e shqiptarëve të Mandricës. Sigurisht, plotësia është relative, sepse e folmja bjerr vazhdimisht dhe nuk ngulitet dot me shkrim, ngaqë është gjuhë bisedore. Nëse ka skripte, puna do të ishte pak më e thjeshtë.

Nga ç'fusha të jetës e të veprimtarisë mund të gjurmohet më lehtë lënda për një fjalor të tillë? Mendojmë se mund të gjurmohen ato fusha të jetës e të veprimtarisë që janë marrë nga Atdheu. Gjurmimi mund të bëhet sipas sipas grupeve tematike, si një mënyrë e programimit të punës. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë ka botuar më 1981 (e ribotuar më 1989) një "Udhëzues për mbledhjen e fjalëve dhe të shprehjeve të gjuhës shqipe" sipas grupeve tematike (le të themi, grupi tematik për qumështin e prodhimet e qumështit, grupi tematik për gatesat e mënyrat e gatimit etj.). Siç thuhet në hyrjen e Fjalorit, në Mandricë ka pasur punishte për vaj susami, për shkrirjen e derdhjen e kabanave, për pijet e gazuara, për regjien e lëkurëve, për prodhimin e vozave, të rakisë e të mastikës, për mbarështimin e krimbit të mëndafshit etj. Këtej mund të jetë edhe udha e vjeljes së fjalëve dhe të shprehjeve të së folmes. Nga folklori mund të vilen sidomos përrallat, këngët rituale dhe këngët e motmotit, sepse ruajnë leksikun konkret.

Autorja, Marija Hristova Georgieva (Peeva) është shembull i spikatur i dashurisë për gjuhën amtare dhe meriton denjësisht përgëzime të përzemërta. Përgëzime të veçanta meriton edhe profesori i gjuhës shqipe në universitetin "Klement Ohridski" të Sofjes, Ludmill Stankov, autor i disa librave dhe teksteve për gjuhën shqipe: "Gramatika e gjuhës shqipe - fonetika, morfologjia, sintaksa,

leksikologjia", "Ndhimëtar për mësimin e gjuhës shqipe" etj. Pas rreth 400 vjetësh, me këtë fjalor bashkëbisedimor na vjen përsëri gjuha e të parëve, ashtu siç flitet ajo atje. Sot, kur fëmijët e mërgimtarëve pothuajse po e humbasin gjuhën shqipe, ky Fjalor, ata 100 veta, nga të cilët është vjelë Fjalori, ata vithkuqarë të nderuar që e mbajnë gjallë gjuhën e tyre, janë një rizgjim dhe një mësim për të gjithë shqiptarët jashtë vendit.

Hajri SHEHU

STUDIM MONOGRAFIK PËR AREALET GJUHËSORE TË RAHOVECIT

(Fridrik Dulaj: “E folmja e Rahovecit me rrethinë, shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike”)

Punimi monografik “*E folmja e Rahovecit me rrethinë, shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike*” i autorit Fridrik Dulaj trajton në mënyrë të hollësishme e të gjithanshme situatën gjuhësore të një zone qendrore me shumë interes të Kosovës, Rahovecit me rrethinë, nga këndvështrime të gjera dialektologjike e sociolinguistike.

Autori i këtij studimi në të folmen e Rahovecit me rrethinë vërteton ekzistencën e tri arealeve gjuhësore, që, përveç pikëtakimeve, kanë edhe të veçantat e tyre, të cilat e begatojnë mozaikun gjuhësor të gegërishtes verilindore. Rëndësia e këtij studimi, siç thekson dhe vetë autori, mbështetet në këto fakte: a) e folmja brenda qytetit të Rahovecit, me karakteristikat e saj dalluese, nga të gjitha të folmet e shqipes, meriton një vështrim më të plotë, në krahasim me atë që është bërë deri më sot, b) e folmja e arealit të Krushës, me karakteristikat e saj dalluese në fushën e fonetikës, sidomos të zanoreve të gjata që shkojnë kah hipergjatësia, kërkon një shpjegim të plotë e të argumentuar, c) anketimet për Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe kanë dhënë rast për t’i parë të dhënat e gjetura në terren në formë krahasimtare dhe ç) trajtimi sociolinguistik i ka munguar krejtësisht kësaj të folmeje. Prandaj autori Dulaj mëton që edhe nga kjo pikëpamje të sjellë të dhëna e hetime të reja për këtë trevë gjuhësore.

Punimi “*E folmja e Rahovecit me Rrethinë*” ka parasysht Rahovecin si kryeqendra e Podrimes. Ndërsa “rrethina” paraqet fshatrat përreth, të cilët i përkasin organizimit administrativ të Rahovecit. Përndryshe, ky emërtim paraqet dallim edhe në përmbajtje nga studimet e tjera që janë bërë deri më tani për këtë trevë gjuhësore. Duke vepruar kështu autori mendon se brenda punimit të tij do të gjejë vend trajtimi i shtratit natyror të këtij regjioni (Anadrinisë), e cila është e njohur edhe me emrin “Podrime”. Në punim, nga kjo trevë gjuhësore, janë lënë jashtë disa fshatra, të cilat u takojnë komunave të Prizrenit dhe Therandës (Suharekës). Duke i lënë jashtë këtij punimi këto fshatra të Anadrinisë, autori mendon se për të nxjerrë rezultate për tërësinë e këtij areali gjuhësor do t’i mjaftojnë fshatrat: Krushë e Madhe, Nagac, Hoçë e Vogël, Zaçisht, Reti dhe Apterushë.

Gjatë përshkrimit të situatës gjuhësore të zonës së Rahovecit Dulaj gjen pikëtakime gjuhësore me ato të mbarë gegërishtes verilindore. Përputhshmëritë më të mëdha janë gjetur në arealin e Ratkocit. Ndërsa në dy arealet e tjera, Rahovecit dhe Krushës ka hasur disa pika dalluese, qoftë në dukuri fonetike, qoftë morfologjike, apo sintaksore, të cilat janë trajtuar në vendet përkatëse në punim.

Në fonetikë paraqitet një tabelë ku mund të krahasohen zgjatimet në mes tri arealeve qoftë në rastin e zanores së theksuar te emrat e përveçëm vetjakë, qoftë në emrat e përgjithshëm:

Ratkoc	Rahovec	Krushë	Gjinia e njëjtë
<i>Bedri</i>	<i>Bedri:</i>	<i>Bedri::</i>	
<i>Sadri</i>	<i>Sadri:</i>	<i>Sadri::</i>	
<i>Sabri</i>	<i>Sabri:</i>	<i>Sabri::</i>	<i>Sabri-u</i> <i>S</i> <i>a</i> <i>br</i> <i>i-</i> <i>a</i>
<i>Arjeta</i>	<i>Arrje::ta</i>	<i>Arje:ta</i>	
<i>Argat</i>	<i>arga:t</i>	<i>arga::t</i>	
<i>Kunat</i>	<i>kuna:t</i>	<i>kunâ::t</i>	<i>Krusha</i>
<i>Kuna:t</i>	<i>Kuna:t</i>	<i>kunâ::t</i>	<i>nj</i> <i>ël</i> <i>lo</i> <i>j</i>
<i>kry:t</i>	<i>Krri::ja</i>	<i>kry:ja</i>	
<i>Kapak</i>	<i>kapa:k</i>	<i>kapa::k</i>	

Siç shihet nga shembujt e mësipërm zanoret nuk dyfishohen tek emrat e përveçëm në arealen e Ratkocit, përkatësisht në fshatrat Ratkoc, Palluzhë, Çifllak, Drenoc etj. ato janë të ngritjes së mesme p.sh: *Bedri* t'kam thon mos u vono. *Shkoj* heret n'pun.

E folmja e Ratkocit me fshatrat rreth tij dhe e arealit të Krushës së Madhe me fshatrat rreth saj nuk janë unike as në fushën e morfologjisë. Folja në kohën e kryer të thjeshtë në Ratkocin me rrethinë del me mbaresat vetore: *punova*, *lexova*, *shkrova*, *shkeva*, *kñoava*, *vrapova* (*ņava*), *bleva*, *leva* (*lyva*), *fshiva*. Në arealin e Krushës, veçmas te brezi i vjetër dhe brezi i mesëm, e kryera e thjeshtë merr mbaresat: *shkoj-ta*, *punoj-ta*, *lexoj-ta*, *ndërtoj-ta*, *mbaroj-ta*, *kërkoj-ta*, *filloj-ta*, *vrapoj-ta*, *mbuloj-ta* etj.

Në të folmen e Rahovecit me rrethinë krahas formës së paskajores *kam me punu*, *kam me lexu* etj., përdoret edhe lidhorja: *do t'punoj*, *do t'lexoj* etj. Në këtë të folme dëgjohet edhe e ardhmja e ndërtuar nga folja **du**, **due** (dua) dhe pjesorja e gegërishtes *me punu* p.sh: *Nesër du me shku ma heret n'shkollë*. Forma me **dot** e bjerrë pjesëzën **me**, p.sh: *neser dot shkoj n'shkollë*.

Autori Fridrik Dulaj në punimin e tij monografik konstaton se gjendja e së folmes së Rahovecit (qytet) është në kushtet e bilinguizmit dialektal, d.m.th përdoren këmbyerazi herë njëri e herë tjetri kod gjuhësor. Por që jo rrallë kemi edhe shfaqje të “përziera” gjuhësore: shprehje me togfjalësha shqip dhe rahoveciançe, si p.sh: *ti beše shko e eja si Adem Peja* (ti qenke shko e eja si Adem Peja), *fatbardha nana za tebe* (fatbardha nana për ty), *mu s izgubela fija* (i ka humb fija), *nikat ne vidaja dit t'bal* (mos pafsh ditë të bardhë), *nemoj da binaš fjalët si Demushi*, *punt si kerkuši* (mos u bën fjalët si Demushi punët si kërkushi), *nema*

niçin vjet (nuk i ka njëqind vjet), *ga udarili msish* (i ka ra msysh), *ne moj da çiniš hajgare* (mos luaj hajgare).

Duke u mbështetur në atë që thotë Hilmi Agani, në mendimin e B. Nushiqit si dhe në Gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit, që brenda Divanit janë përdorur vetëm pesë apo gjashtë fjalë sllave, autori Dulaj vjen në përfundime se rahovecjançja ka njohur dy etapa të zhvillimit të saj. Etapa e parë e lindjes dhe përdorimit në mënyrë masive fillon nga viti 1912, me rastin e pushtimit të Kosovës nga Serbia, etapë e cila do të vazhdojë të zhvillohet deri në vitin 1941. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, kur sllavishtja fillon të ushtrojë trysni mbi të folmen shqipe në qytetin e Rahovecit, por me të mbaruar Lufta e Dytë Botërore u rikthye pushtimi serb. Gjatë periudhës së parë, siç dëshmojnë edhe subjektet me të cilët janë zhvilluar anketa, rahovecjanët pothuajse iu kishin nënshtuar gjuhësisht sunduesit dhe si pasojë e kësaj ata e kanë bastarduar gjuhën amtare, duke i dhënë favore gjuhës së përzier, rahovecjançes, e cila siç duket me kohë mori edhe karakter kulture e identitet qytetar, për t'u dalluar nga fshatarësia e prapambetur ekonomikisht dhe të pashkolluar. Pushtimi i Kosovës nga Serbia në fillim të shekullit njëzet, pothuajse kishte shuar shpresën për liri të shqiptarëve në Kosovë. Prandaj në kushtet e dygjuhësisë që ndodheshin shqipja në Rahovec prestigji iu dha gjuhës së pushtuesit, gjuhës së atyre që kishin mekanizmin shtetëror, - serbishtes. Por, nëse i thua rahovecjanit se po flet serbisht, kur ai flet rahovecjançe, i mbetet hatri. Ngase ata këtë gjuhë e konsiderojnë të tyre dhe se është e ndryshme nga serbishtja. Mbetjet e fjalëve të shqipes brenda kësaj “gjuhe të re” (rahovecjançes) për autorin Dulaj paraqet ruajtje dhe jo futje të fjalëve shqipe. Më në fund, që shqiptarët janë asimiluar gjuhësisht, mjafton të kujtojmë këtu shembullin e shqiptarëve ortodoksë të arealit të Rekës së Epërme të Gostivarit, të cilët në rrethana pushtimi e shtypjeje nga regjimet serbe e maqedonase ruajtën fenë e të parëve, por konvertuan gjuhën e tyre amtare me maqedonishten dhe tani ndjehen si “maqedonas”.

Në fushën e sintaksës autori Dulaj konstaton se e folmja e Rahovecit (brenda qytetit) paraqet dallime në raport me të folmet e tjera, jo vetëm ato verilindore, por edhe me dy arealet brenda zonës së Rahovecit (Ratkocit dhe Krushës). Dallimet që paraqiten, në fushën e sintaksës së fjalisë evidentohen te format foljore p.sh.: në vend të formës veprorë është përdorur forma jo veprorë. Kështu në vend të foljes *kam* dëgjohet folja *jam* p.sh.: A *jam* une faj, në vend të: a *kam* unë faj. Edhe e folmja e dy arealeve (Ratkocit dhe Krushës), ashtu si të folmet e tjera, në gegërishten verilindore ka ndërtuar rrethanor vendi me anë të parafjalës *pej* që morfologjikisht i përket rasës rrjedhore, kurse në standard do të duhej të prihej nga parafjala e rasës kallëzore për p.sh.: A *po vjen shkojm pej shpie*, a *shkojm pej shpie*, a i *nisim lopt pej shpie*, u *kry pazari a shkojm pej shpie* etj.

Etnografia të folurit në Rahovec dhe rrethinë (doke, zakone, legjenda, tregime, frazeologjizma) paraqet një kapitull tjetër interesant, që i jep punimit një vlerë të veçantë. Edhe në zonën e Rahovecit dikur lindja e fëmijës ka pasur dallime në gëzim kur lindte djalë dhe kur lindte vajzë. Kur lindte djalë zbrazej pushkë, ndërsa lindja e vajzës përcillej me heshtje. Me rastin e lindjes së fëmijës janë një mori shprehjesh. Kur jepet lajmi për lindjen e djalit: *na u ka shtu ni pushkë*, *na u ka shtu ni krah pune*, *na u ka shtu ni burr*. Ndërsa për lindjen e vajzës: *nu ka shtu ni mik*,

m'ka le mik, me keqardhje që ka lind vajzë, por nuk mungon urimi duke u parë dobia praktike e saj si shërbyese për vëllezërit që do të vijnë pas saj: *ka le magari i djemve, ishalla t'i përkund djemt, ishalla e përkund vllaun*.

Kur nusja nuk është e mirëpritur nga familja dhe lind për herë të parë, në vend të urimit në zonën e Rahovecit thuhet: *Shtini dreqi rrâjë*.

Në të folmen e Rahovecit me rrethinë edhe në fushën e etnografisë së të folurit janë përcaktuar kufijtë, që përveç karakteristikave dalluese në lëmin gjuhësor, ata kanë vënë “*kufij*” në mes veti edhe përmes dhënies së përparësisë së trevës së vet e duke nënmuar të tjerët p.sh.: rahovecjanët duke e mbajtur veten si qytetarë dhe me kulturë, për fshatarët kanë krijuar fjalë ofenduese dhe nënmuese si: *Katundar!*, *Selanin!*, *Pluhun!*, *Opënga e katundarit!* Ndërsa fshatarët për rahovecjanët: *Bugar!*, *Shkavi*, apo *Shkina e Rahavecit!* *Uflaxhia i Rahavecit!*, *Rrushaxhija!*. Pjesa e arealit të Ratkocit për arealin e Krushës: *Taplluhak!* (*Taplluhë* quhet rajoni i Anadrinisë që përfshin arealin e Krushës dhe fshatrat tjera të Trekëndëshit Krushe-Prizren- Suharekë (Therandë), *Specaxhi!*, *Laknaxhi!* etj. Krushjanët për arealin e Ratkocit: *Lloq i Ratkocit*, *Vrajakës*, *Palluzhes*, *Vise t'pa zhvillume!* etj. Por kjo nuk është e gjitha, ndasitë janë shprehur edhe në kuptimin pozitiv. Fshatarët thonë: *T'rahovecjanin është zor me zân shok, po kur ta zâsh, nuk t'lshon; Rahavecjanët janë trima; Rahavecianin e mysish, po nuk e tutish*. Rahovecjanët për fshatarët: *Un shokniin ma t'mir i kam pi katudnve, (unë shoqërinë më të mirë e kam nga katundi), n'katund pa shkoj ma shpesh (n' katund shkoj shumë shpesh), n'katund e kam dajen (i kam dajt n'katund) etj.*

Leksikun autori e ka parë në dy pjesë: a) leksik burimor të gjuhës shqipe, b) shtresa e huazuar e leksikut, e cila ndërtohet nga huazimet sllave dhe nga huazimet e gjuhëve orientale (turqishtes e arabishtes). Gjendja e sotme e huazimeve të vjetra, në të folmen e Rahovecit me rrethinë, duhet të shihet në dritën e zhvillimeve gjuhësore në mbarë shqipen. Leksiku në këtë të folme mund të shihet si pjesë e leksikut pasiv dhe leksik aktiv. Fjalët pasive të leksikut të së folmes së Rahovecit me rrethinë janë kryesisht fjalë shqipe dhe sllavizma e orientalizma, të cilët mund të konsiderohen fjalë të vjetruara, por që kanë ende përdorim nga shtresa e vjetër e shoqërisë, kryesisht e pashkolluar, të tilla fjalë janë p.sh. orientalizmat: *aksham*, *akraba (miqësi)*, *sabah*, *hapsane*, *hamamxhik*, *divenhane*, *sylah*, *turxhiment*, *iz(leje)*, *horxhelden*, *sagllam (e sigurt) çystek (zingjir për oren) hamamxhik (banjo)*, *haber*, *çardak*, *terlik*, *nizam*; fjalët sllave: *zadruga*, *opshtina*, *sudija* etj. Dhe shumë fjalë burimore shqipe të cilat janë dhënë në fjalorth.

Materiali i eksploruar i ka mundësuar autorit Dulaj që të trajtojë edhe problemet etnografike, të cilat dalin përmes krijimeve të llojeve të ndryshme, si përralla, legjenda, gojëdhëna, besëtytni, tregime, këngë, rite të vdekjes, dasmash, kanagjegji, shprehje etnografike, frazeologjizma, emra njerëzish e emra vendesh, krijimtari letrare nga ato më të vjetrat e deri te brezi aktual, zhargone të grupmoshave të reja, të ardhura si ndikime nga mediet, apo edhe ndërtime të tipit të të folmeve të fshehta etj., të cilat autorit i kanë shërbyer edhe për efekte krahasimi gjuhësore, përmes të cilave argumentohet zhvillimi i gjuhës shqipe në këtë trevë, në periudha të caktuara dhe gjendja e saj sot.

Si bazë mbështetëse e këtij shqyrtimi kanë qenë materialet e mbledhura në gjithë hapësirën për të cilën bëhet fjalë, që autori Fridrik Dulaj i ka qëmtuar me kujdes nga 350 subjekte të të gjitha moshave dhe gjinive si dhe grupmosha të reja (nxënës të tri shkollave të mesme të larta, në Raovec, Ratkoc, Krushë).

Një çështje tjetër me interes ka krahasimi me ADGJSH. Aty Dulaj ka gjetur një mbështetje të mirë për ballafaqimin të argumenteve në mes Atlasit dhe gjetjeve në terren. Anketimet e ADGJSH-së, ndonëse të bëra herët dhe në kushte jo të përshtatshme për autorët e ADGJSH në të shumtën e rasteve janë në përputhshmëri me ato të cilat dëgjohen në terren.

Studimi monografik *“E folmja e Rahovecit me rrethinë, shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike”*, i autorit Fridrik Dulaj, me materien interesante që trajton, të një zone shumë specifike të Kosovës, pasqyron në plotni të folmet e Rahovecit me rrethinë në rrafshet e ndryshme gjuhësore: në fonetikë/fonologji, në morfologji, në sintaksë, në leksik e në aspekte të tjera sociolinguistike. Është punimi i parë i këtij lloji me një strukturë të qëndrueshme shkencore, i shtruar dhe i argumentuar mirë e ngeshëm (pa u nxituar) dhe është shumë i vlefshëm për gjuhësinë shqipe. Si i tillë, ky punim meriton të vihet në planin e botimeve të Institutit Albanologjik, sepse e pasuron literaturën tonë me një vepër të re e të çmuar linguistike, së cilës nuk mund të mos i referohen të gjithë ata studiues sa herë që do t’i qesë puna të merren me çështje e probleme gjuhësore të shqipes, por dhe të ballkanistikës.

Qemal MURATI

**NJË “TAPI” PËR SHKUPIN ME RRETHINË NDËRMJET DY
LUFTËRAVE BOTËRORE**

(Skender Asani, Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore, I-II, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2015, f. 1048)

“Kur e njeh natyrën e ndodhive dhe dukurive (në një shoqëri N. A)..., dhe shkaktarët e tyre, kjo ndihmon në hulumtimin e të dhënave, me ç'rast do të dallojmë të vërtetën nga gënjeshtra, gjë kjo, e cila në punën e hulumtimit është më se e dobishme”.

Ibën Haldun

Kështu mendonte dijetari i njohur botëror Ibën Haldun. Ky mendim, sigurisht që ka qenë evident edhe te studiuesi dr. Skender Asani. Si njohës i mirë i rrethanave të shoqërisë shqiptare në Shkup dhe rrethinë, ka besuar se do të ketë edhe më shumë të dhëna për këtë qytet, nga ajo çfarë na është ofruar deri më sot në shumë libra në këtë vend. Pikërisht për këtë, dr. Skender Asani do t'i qaset një pune, që për një periudhë kohore të caktuar t'i ofrojë lexuesit edhe dokumentet, të cilat ruhen në arkiva për qytetin e Shkupit me rrethinë.

Puna me dokumente arkivore, për studiuesit e historisë mbetet parësore. Për këtë arsye edhe studiuesit, pra edhe ata shqiptarë, e kanë vënë në dukje këtë fakt dhe kanë synuar dhe synojnë që historinë ta njohin përmes dokumenteve dhe ato t'ua paraqesin edhe të tjerëve. Sepse, sikurse thotë historiani i njohur gjerman i shekullit XIX, Leopold von Ranke *“Atje ku s'ka dokumente, nuk ka histori”*.

Përderisa ky historian flet për rolin e dokumentit në historishkrim, një tjetër historian i njohur francez me përmasa botërore i shekullit XX, Marc Bloch, i kushtoi rëndësi mbledhjes së dokumenteve. Ai në apologjinë e tij të njohur për historinë, në mes tjerash, shkruan: *“Për historianin, mbledhja e dokumenteve për të cilat ai mendon se ka nevojë, është një nga detyrat më të vështira”*.

Kurse për historianin e njohur të shekullit XXI, anglezin Noel Malcolm *“... historianët.., punën e tyre duhet ta bazojnë duke i interpretuar dokumentet apo faktet historike”*.

Pothuaj edhe disa nga studiuesit e historisë të hapësirës shqiptare e ndajnë mendimin e përafërt, kështu *“historia pa dokumente nuk ka vlera”* - konstatonte studiuesi Stefanaq Pollo. Publikimi i dokumenteve për të kaluarën tonë *“ka qenë dhe mbetet një detyrë e rëndësishme për historianët”* - shkruante grupi i historianëve shqiptarë që përgatitën disa vëllime me dokumente për historinë e Shqipërisë në vitin 2012.

Shikuar edhe nga konstatimet e lartcekura, por edhe të tjera që ne nuk i kemi përmendur, rezulton se edhe nga studiuesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë, dokumenti në punën e historianit mbetet i një rëndësie të veçantë.

Shi për këtë edhe studiuesi Dr. Skender Asani, që nga fillimi i punës së tij shkrimore, e ka pasur parasysh këtë fakt, fillimisht duke publikuar në vitin 2000 librin me titull: *“Kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912 sipas burimeve bullgare”*, pastaj *“Shkupi shqiptar”* më 2011, në vitin 2012 si bashkautor përgatit

vëllimin me dokumente “Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës”, “Vilajeti i Manastirit dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1911-1912”, botuar në vitin 2015. Ndërsa, në vitin 2015 vjen para lexuesve me përmbledhjen dy vëllimshe të dokumenteve “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore” të botuar nga Shtëpia Botuese Logos-A me qendër në Shkup, të cilën po e promovojmë sot. Shikuar nga kjo mori botimesh me dokumente nga e kaluara jonë, të botuara nga studiuesi Skender Asani, si autor e bashkautor, konstatimi i studiueses Valentina Duka se “Arkivi është buka dhe gjella e historianit” - në këtë rast do t’i flinte mjaft mirë këtij studiuesi.

Vepra “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore”, sikurse e thotë vetë autori, është rezultat i një pune hulumtuese disavjeçare të autorit në Arkivat e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës, duke hulumtuar fonde nga më të ndryshmet që ruhen në këto arkiva, duke vjelë me mjaft kujdes dokumentet që lidhen me Shkupin dhe shqiptarët në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore.

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, padrejtësitë e ushtruara nga pushteti i atëhershëm ndaj një pjesë të popullatës së Shkupit me rrethinë, kishin marrë përmasa shqetësuese. Përveç të tjerash, ishte evidente edhe lufta speciale që pushteti ushtronte edhe përmes disa njerëzve të infiltruar në shkollën të quajtur me djallëzi Medreseja e Madhe “Kral Aleksandër” dhe Ulema Mexhllisit për të futur përçarjen dhe ndasitë. Këtyre padrejtësive të shumta, intelektualët shqiptarë, do tu përgjigjen përmes formimit të “Xhemietit”, me qendër në Shkup, parti e cila përmes prememorive të përpiluara, fjalimeve në Parlamentin e mbretërisë SKS e sensibilizonte

opinionin për padrejtësitë që pushteti i atëhershëm ushtronte ndaj shqiptarëve të Shkupit me rrethinë. Një kundërvënie tjetër e intelektualëve shqiptarë ndaj pushtetit, ishte edhe themelimi i Medresesë së “Isa Beut” në Shkup. Përmes edukimit, kjo medrese iu kundërvu politikës “edukuese” të gjimnazit “Kral Aleksandër”.

Politika jo e drejtë u zhvillua ndaj qytetit të Shkupit dhe një pjesë të qytetarëve të saj, posaçërisht pjesës myslimane, edhe ndaj trashëgimisë së tyre, duke rrënuar objekte të trashëgimisë fetare, ose duke konfiskuar pronat e vakëfit si: xhamitë, teqetë, etj., të cilat deri më tani kanë mbetur pothuaj plotësisht në heshtje. Andaj, shumë përgjigje për këto gjëra, për medresetë, Xhemietin dhe veprimtarinë e tyre, konfiskimin e pronave të vakëfit dhe gjoja, kompensimin e tyre, shpërnguljet e shqiptarëve dhe konfiskimin e pronave të tyre, të interesuarit do t’i gjejnë në dy vëllimet, brenda 1048 faqeve sa ka kjo vepër.

Libri fillon me parathënien, vazhdon me sqarimin për lexuesin, për historikun e Shkupit, organizimin dhe “Xhemijetin”, rolin e fesë, shqiptarët gjatë shekullit XX, diplomacinë, betejën për dominimin, Mbretërinë SKS dhe rolin e “Xhemijetit”, pastaj vijon me publikimin e dokumenteve, disa edhe të ilustruara, dhe përmbillet me disa foto për Shkupin gjatë kësaj periudhe dhe disa faksimile origjinale të dokumenteve të publikuara.

Të dhënat e dokumenteve janë të detajuara, dhe përshkrimet na dalin shumë herë emocionuese. Sipas disa dokumenteve të botuara, çmenduria e pushtetit shkon nderi në atë masë, sa edhe tokën e destinuar për varreza, e merrte për vete.

Këto dokumente të përmbledhura, të përkthyer, madje një pjesë e tyre edhe të botuara në gjuhën shqipe, janë një dëshmi mjaft e mirë, për të gjithë ata që janë të interesuar të dinë edhe më shumë për të vërtetën e qytetit të Shkupit me rrethinë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Posaçërisht, këto vëllime me dokumente do t'u shërbejnë atyre, që deklarativisht janë të "interesuar" të dinë, kanë mundësi për të vepruar, por praktikisht nuk kanë bërë asgjë, dhe sidomos do t'u shërbejnë studenteve të të gjithë niveleve të studimeve.

Disa nga dokumentet në përmbajtjen e tyre, kalojnë kufijtë administrativ të Shkupit të sotëm, aty flitet për Prizrenin e rrethinën, Prishtinën, Mitrovicën, Pazarin e Ri, Tiranën, e etj., çka do të thotë se këto vëllime, mund të përdoren edhe nga të interesuarit tjerë nga gjithë hapësirat shqiptare.

Si nga ana përmbajtjesore, e deri te përgatitja teknike, ky botim është për t'u admiruar. Nuk ka si të jetë ndryshe puna e një studiuesi që tanimë ka bërë një përvojë të mirë në mbledhjen, klasifikim dhe përgatitjen për botim të dokumenteve nga e kaluara e jonë dhe gatishmëria e Shtëpisë Botuese "Logos-A" dhe stafit të saj, në krye me drejtorin gjeneral, Adnan Ismaili dhe kryeredaktorin, Husamedin Abazi, për t'i nxjerr në dritë këto dokumente dhe për të na ofruar vepra të tilla që do të lënë gjurmë. Kjo shtëpi botuese, lexuesve shqipfolës, me botimin e librit dyvëllimësh "Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore", dhe me botimin me ese historike të titulluar "Shkupi" i botuar në 2011, këtij qyteti i ka ngritur dy monumente, sepse "*librat janë monumentet më të mëdha të historisë...*"- thoshte mendimtari i njohur turk, Xhemil Meriç.

Dhe në fund fare, autorit dr. Skender Asani dhe botuesit, "Logos-A", ju uroj nga zemra shumë suksese duke u lutur që të kemi edhe më shumë vepra të tilla në të ardhmen!

Nuridin AHMETI

ETNOGJENEZA SHQIPTARE E REKËS SË EPËRME

Branko Manojlovski: "Reka e Epërme dhe fshati Kiçinicë", "Tringa Desing", Tetovë, 2016

Libri "Reka e Epërme dhe fshati Kiçinicë" i autorit Branko Manojlovski është një sihariq për kulturën dhe historinë shqiptare në tërësi e veçanërisht për shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme të Republikës së Maqedonisë. Autori i këtij libri për opinionin më të gjerë është bërë tepër i njohur i cili kohët e fundit te shqiptarët ka fituar respekt të lartë mbi mënyrën e deshifrimit të prejardhjes së tij etnike dhe të gjithë atyre shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme dhe të fshatit Kiçinicë të cilët padrejtësisht dhe përdhunisht u munduan t'i sllavizojnë.

Të vërtetën mbi shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme të cilën Xha Brankoja në fillim filloi ta thotë vetëm në aspektin verbal, e argumenton edhe përmes këtij libri, i cili do të mbetet një thesar tepër i çmuar për historinë dhe kulturën shqiptare të kësaj ane.

Ky libër është shkruar në tri gjuhë: shqip, maqedonisht dhe në gjuhën angleze dhe si i tillë i jep mundësi secilit që ta lexojë këtë material dhe të njoftohet me të vërtetën e madhe historike për shqiptarët e kësaj krahine.

Qëllimi i autorit të këtij libri është që përmes kësaj të vërtete të përmbushë dy synime: personalisht t'u kthehet rrënjëve etnike dhe të përfshijë një katarzë shpirtërore psikologjike; dhe, synimi i dytë është përhapja e një të vërtete të madhe historike mbi etnogjenezën dhe autoktoninë burimore shqiptare dhe reprezaljet e kësaj popullate që kishin përjetuar nën regjimin shekullor sllav.

Libri nuk është voluminoz, por ka një peshë dhe vlerë të veçantë historiografike, etnologjike, sociologjike dhe psikologjike mbi mënyrën e jetesës së shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme, duke përfshirë këtu të gjitha komponentët që kanë taban kombëtarë shqiptar.

Autori me nostalgji të madhe i përshkruan të gjitha karakteristikat kombëtare të shqiptarëve të Rekës dhe fshatit Kiçinicë ku kishte lindur edhe vetë (Xha Brankoja). Kjo do të thotë që ai, përmes elementit biografik dhe kujtesës memoriale nxjerr në sipërfaqe të gjitha ato karakteristika që kanë të bëjnë me etnogjenezën e kësaj hapësire shqiptare. Për periudhën më të hershme historike të krahinës së Rekës së Epërme, ai shërbehet nga të dhënat e metodës biografike, gjegjësisht nga gojëdhënat e paraardhësve të tij, të cilat i përshkruan dhe i interpreton në mënyrë autentike dhe burimore. Autori etnogjenezën shqiptare të Rekës së Epërme e nxjerr përmes disa karakteristikave: historike, gjeografike, demografike, etnokulturore, ekonomike, sociologjike, politike, arsimore, toponimike, etj.

Karakteristikën historike të Rekës së Epërme, autori e ndërlidh me periudhën ilire kur kjo krahinë ishte pjesë e Gadishullit Ilirik, atëherë kur ilirët kishin bërë lëvizje të mëdha në kërkim të kushteve më të mira për jetesë. Shtegtimi i tyre ishte bërë drejt grykës së lumit Radika, ku sipas autorit, ata kishin vërejtur se ky vend me këto burime uji ishte i përshtatshëm për të ndërtuar vendbanime. Autori e përshkruan mirë edhe gjendjen e kësaj popullate ilire në kohën e Perandorisë

Romake e më pastaj edhe asaj Otomane, deri te popullimi i Rekës së Epërme dhe themelimi i fshatit Kiçinicë.

Elementi gjeografik i krahinës Reka e Epërme, sipas përshkrimit të autorit, ndërlihet me hapësirën gjeografike të kësaj krahine shqiptare, gjegjësisht shtrirjen e saj në lindje të qytetit të Dibrës, rrethuar nga malet Korab, Velivar dhe Kërçin, në të dy anët e lumit Radika. Këtë krahinë, sipas autorit, e përshkon edhe elementi hidrologjik, që do të thotë se ajo është e pasur me burime uji, pastaj kullota të shumta, pyje dhe klimë të mirë.

Elementi tjetër i etnogjenezës së kësaj krahine shqiptare është edhe ai demografik që ka të bëjë me popullatën e saj shqiptare të ndarë në dy konfesionet: ortodoks dhe mysliman, të cilët asnjëherë nuk kishin pasur zënka dhe probleme ndërfetare dhe çdoherë kishin folur gjuhën shqipe. Sipas autorit, mesha mbahej në gjuhën e vjetër sllave, kurse komunikimi mes tyre është mbajtur tërësisht (vetëm) në gjuhën shqipe. Një ndër elementët kryesor që i jep kuptim dhe përmbajtje etnogjenezës së krahinës së Rekës së Epërme është elementi etnokulturor.

Këtë element autori Branko Manojloviski e përshkruan me një mjeshtri mbresëlënëse, duke demonstruar: dasmat-fejesat dhe martesat e banorëve të Rekës së Epërme, ku, sipas autorit, muzika përbëhej nga dy lodra dhe zurla, ku flitej dhe këndohej vetëm në gjuhën shqipe dhe luheshin vallet shqipe. Edhe veshja ishte tradicionalisht (tipike) shqiptare, që bën që kjo krahinë të dallohet nga hapësirat e tjera joshqiptare. Në kuadër të këtij elementi, autori përshkruan jetën religjioze, ceremoninë mortore, varrezat shqiptare, stilin arkitektonik të ndërtimit të shtëpive, mbajtjen e higjienës si karakteristikë tipike e shqiptarëve, sigurimin e ushqimit, ruajtjen dhe kultivimin e kafshëve, etj. të cilat e përbëjnë etnosin shqiptar të kësaj krahine.

Autori, duke folur për Rekën e Epërme dhe fshatin Kiçinicë, potencon edhe faktorin ekonomik, ku shqiptarët ortodoksë të kësaj krahine kanë mbijetuar nga kultivimi i tokës-bujqësisë, bagëtisë, blegtorisë, tregtisë dhe kurbetit. Edhe elementi sociologjik si pjesë e etnogjenezës së Rekës së Epërme e ka peshën dhe rëndësinë e vet, sepse ai ka të bëjë me mënyrën e të jetuarit dhe mënyrën e formimit të marrëdhënieve shoqërore, në kuadër të ndërveprimit shoqëror në relacionin mes individit dhe grupit si pjesë e bashkësisë e cila funksiononte dhe frymonte shqip. Sipas asaj, se si autori e përshkruan mënyrën e të jetuarit të shqiptarëve ortodoksë të kësaj krahine, na del se ata kishin një mënyrë tipike të të jetuarit, që i bënte të dalloheshin nga etnikumet e tjera, me: tradita, zakone, morali, besa shqiptare, mënyra e fejesës, martesës, ceremonia mortore, etj.

Në mesin e këtyre komponentëve, autori Branko Manojloviski, nxjerr në pah edhe elementin politik, i cili, siç duket, është vendimtar për sllavizimin dhe shpërnguljen e tyre. Autori na bën me dije se në këtë krahinë, në vitin 1903 kanë ndodhur disa zjarre dhe djegie të qëllimshme të fshatrave shqiptare ku janë djegur një numër i madh i shtëpive, kurse në vitin 1913 nga ushtria serbe me qëllim ishin djegur dhe tërësisht shkatërruar fshatrat: Shtirovica, Strezimiri, Reçi dhe Tërnica. Sipas tij, disa vite radhazi, xhandarmëria serbe ka bërë kujdestari që të mos kthehen banorët në fshatrat e tyre. Kjo ushtri serbe shpeshherë kishte bërë edhe masakra në popullatën e kësaj krahine, ku me mashtrim i tubonin meshkujt dhe i mbyllnin në

xhaminë e fshatit, ku më pas i digjnin të gjallë. Kurse fshati Gazhnjalla ishte djegur tërësisht nga ushtria bullgare. Djegiet e vendbanimeve shqiptare vazhdojnë edhe më tutje, ku sipas autorit, i cili bazohet nga gojëdhënat e më të moshuarve, në vitin 1947 komunistët partizanë e kishin djegur fshatin Vërbjan në afërsi të fshatit Sencë, me pretekst se aty ishte fshehur municion; pastaj fshati Staro Selo i djegur nga serbët, etj. (Këtë rrëfim autori Branko Manojllovski e merr nga gruaja e axhës së tij Foterica e cila akoma është gjallë në moshën 93 vjeçare).

Armiku kishte përdorur politikën e tokës së djegur, me qëllim të asimilimit dhe shpërnguljes masive të kësaj popullate ortodokse shqiptare.

Në vazhdim të rrëfimit të problematikës së shqiptarëve të Rekës së Epërme, autori bën fjalë edhe për komponentin arsimor i cili shpeshherë gërshetohet me elementin politik. Sipas autorit, fëmijët e kësaj krahine (Reka e epërme), filluan të arsimohen, por ky proces filloi më vonë, ku, ky arsimim nuk zhvillohej në gjuhën amtare shqipe por në atë maqedonase.

Është tepër e dhimbshme dhe groteske se si autori i këtij libri Branko Manojllovski e përshkruan ditën e parë të shkuarjes së tij në klasën e parë (në fshatin Belicicë). Mësuesi, thotë autori, quhej Mito dhe më pyeti si quhem dhe me kë jetoj. Unë, thotë ai, i tregova emrin dhe i thashë se jetoj me dajxhën e dajxhavicen, me kushëririn dhe kushërirën. Mësuesi erdhi me vizore dhe duke më goditur disa herë, filloi të më tregojë se thuhet: “vujko, vujna, bratuçet i bratuçetka” dhe pas çdo fjale më godiste me vizoren e tij të madhe prej druri në dorën time sa të vogël, aq edhe të njomë. Dhe kjo sipas tij, ishte dita e parë e tentimit të asimilimit dhe sllavizimit të tij dhe të gjithë shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme.

Nga kjo që rrëfen autori, vërehet qartë se procesi arsimor kishte prapavijë politike, që, në këtë mënyrë të vazhdojë dhe të kryhet asimilimi dhe sllavizimi i këtyre shqiptarëve ortodoksë (me qëllim) që të humbin gjurmët burimore të etnogjenezës shqiptare të kësaj krahine e cila është pjesë e pandashme e trungut etnik shqiptarë.

Edhe toponimet e kësaj krahine paraqesin mjaft interes.

Vetëm në fshatin Kicinicë, ku kishte lindur edhe autori i këtij libri Branko Manojllovski, kemi emërtime të vendeve të cilat janë produkt i mënyrës së të menduarit dhe jetuarit shqip, p.sh.: Mas Silevice, Te Kilevica, Breg T’epërm, Ara Madhe, Ara Gjatë, Baçelishta, Mas Rase, Te Shpia e Priftit, Vorret e Reçkës Evës, Te Mullini, M’breg t’kroit Demetrit, etj.

A ka folur Reka e Epërme gjithnjë shqip? Këtë përgjigje na e jep autori duke u bazuar në përdorimin e këtyre emërtimeve burimore shqipe: bukët, ujët, mielli, tomli, thekni, tërshona, urofi, mish viçi, pule, mish delje, pastromo, mish peshku, etj.

Më pas autori sjell edhe emërtime të tjera shqipe që kanë të bëjnë me shenjtorët: Pashka, Këshëndellja, Shëngjergji, Shënmitri, kisha, ikonat, kryqa, qiri, etj. Për botën shtazore janë përdorur këto emërtime: lopa, kali, guci, pulat, macat, qeni, miu, zhjarpni, lepra, arusha, shypja, dalldishkat, huti, qyqja, etj. Gjithashtu edhe emërtimi i veshjeve, që janë përdorur tradicionalisht në këtë krahinë, është tipike shqiptare, si psh: Tirshët, brezi, xhamadani, kmisha, tazlluket, apengat, ksula,

peshterka, fustani, etj. Sipas autorit, të gjitha këto janë argumente dhe mund të thuhet se Reka e Epërme dhe gjuha shqipe shkojnë së bashku qëkur mbahet mend.

Nga e gjithë kjo mund të konkludojmë se ky libër i autorit Branko Manojilovski ka një peshë të veçantë, sepse me fakte të gjalla e argumenton etnogjenezën shqiptare të Rekës së Epërme, ku: kishin vepruar, menduar, jetuar dhe vdekur në frymën e traditës dhe zakoneve iliro-shqiptare. Ky libër do të mbetet një referencë e madhe shkencore për gjithë ata që dëshirojnë të merren me hulumtimin dhe studimin e fenomenit të Rekës së Epërme. Porosia e madhe e këtij libri është argumentimi i autoktonisë shqiptare të kësaj krahine si dhe sensibilizimi dhe vetëdijesimi i të gjithë atyre shqiptarëve ortodoks që t'u kthehen rrënjëve etnike shqiptare dhe t'i kthehen vetvetes, duke u vetëdijesuar se kush janë ata, nga vijnë dhe cila është perspektiva dhe ardhmëria e tyre.

Metush SULEJMANI

POLLOGU NË DRITËN E FAKTEVE DHE DOKUMENTEVE HISTORIKE

(Zeqirja Idrizi, Treva e Pollogut në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899-1913, Tetovë, 2007)

Profesorin universitar, Zeqirja Idrizin, nuk e ka preokupuar vetëm “Historia e diplomacisë” dhe “Pozita e shqiptarëve në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore 1945-1981”, por edhe “Treva e Pollogut në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899-1913”. Edhe pse të tre librat janë të shkruara nga i njëjti autor, dallimet në temë, në qasje, në trajtim janë të dukshme. Tema e kësaj monografie është tjetër, shumë më e kufizuar në kohë dhe hapësirë, por e ideuar, konceptuar e sublimuar si është më së miri. Edhe tema e zgjedhur e këtij libri, edhe mënyra se si është trajtuar zgjojnë kureshtjen për lexim të vëmendshëm. Në gjithsej shtatë kapituj, me rreth 360 faqe tekst, autori ka në fokus një trevë shqiptare (Pollogun), e cila gjatë historisë, me theks të veçantë në Rilindjen Kombëtare Shqiptare, ka dhënë një kontribut të madh për çlirim kombëtar. Dhe një nga motivet kryesore të autorit ka qenë të na e sjellë në kujtesë e ta dokumentojë këtë fakt. Të na e sjellë në kujtesë, por edhe të na e rikujtoi amanetin e gradecarit gjeneral Mehmet Pashë Dërralla, ish- ministri i Parë i Luftës (Mbrojtjes) në Qeverinë e Parë të Shtetit modern Shqiptar, që të kemi parasysh e të mos i harrojmë këto sakrifica, por edhe katër shtyllat mbi të cilat duhet dhe mund të qëndrojmë në këmbë në rrugën drejt bashkimit kombëtar, siç janë: gjuha, gjaku (etnia), flamuri dhe historia. Historianët e mirëfilltë shpesh kanë shkruar për historinë e popullit të vet në mënyrë që të njihet çdo cep i historisë dhe gjeografisë së tij. Edhe autori i kësaj monografie e ka ndërre jo vetëm si detyrim profesional, por edhe si obligim moral e kombëtar në mënyrë që të njihet masa dhe përmasa e atdheut, masa dhe përmasa e historisë, gjeografisë fizike dhe shpirtërore e tij; që të njihen pasuritë, bukuritë dhe sakrificat e vuajtjet e bashkëkombësve. Janë të kuptueshme shqetësimet dhe preokupimet e autorit për trevën e Pollogut, e cila, përkundër faktit se i ka dhënë shumë Atdheut dhe Kombit, ende lëngon dhe vuan nën robëri. Prandaj, gjen mënyrën që argumentueshëm të na e shpërfaq para nesh të vërtetën e madhe dhe të pamohueshme historike, se kjo pjesë e historisë dhe e gjeografisë së atdheut, ka qenë dhe është shqiptare, se ajo ka sakrifikuar aq shumë për ta ruajtur e kultivuar dinjitetin kombëtar, gjuhën, traditën, kulturën, flamurin e arsimin kombëtar; se e ka mbajtur dhe e mban të gjallë në kujtesë fatin e vet dhe të atdheut; se me shumë sakrifica e mundime e ka ruajtur qenien e gjakun shqiptar. Madje edhe atëherë kur nuk ka qenë e lehtë jo vetëm të jesh nga Pollogu, por edhe të kalosh nëpër atë trevë ka qenë e zorshme, sepse aq shumë të këqija kanë kaluar mbi kurrizin e saj dhe, si Shtatë Demokleu i kanë qëndruar mbi kokë përgjatë historisë.

Edhe pse nuk e ka në fokus gjithë historinë e kësaj treve, por vetëm një periudhë të caktuar kohore (14-15 vjeçare), shumë delikate e me shumë të papritura e të panjohura, ai sikur e ka nxjerrë në sipërfaqe pothuaj gjithë përmasën e historisë, gjeografisë dhe vuajtjeve e sakrificave të saj. Dhe jo vetëm. Këtë e ka arritur duke kapur me finesë dhe elegancë aspekte të veçanta të kontributit, të

sakrificës, të jetës dhe të bëmave të kësaj treve në dobi të çështjes së pazgjidhur kombëtare. Në fakt janë veçuar disa nga ngjarjet kryesore që lidhen me atë trevë dhe kontributin e saj gjatë një periudhe kohore, siç ishte periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Këto ngjarje autorit i kanë shërbyer si shtylla, si pika referenciale për t'ia dhënë formën e përmbajtjen e duhur këtij libri.

Duke e trajtuar çështjen në rrafshin kronologjik dhe tematik, autori fillimisht flet për pozitën gjeografike, për shtrirjen në kohë dhe hapësirë të asaj treve, për pasuritë e begatitë e saj, por edhe përbërjen nacionale të saj, e cila vazhdimisht ka qenë me shumicë shqiptare. Në vazhdim fokusohet te roli dhe kontributi i pollogasve në periudhën kohore për të cilën ka shkruar, duke u nisur nga një ngjarje e madhe historike e Rilindjes Kombëtare, siç ishte Lidhja Shqiptare e Pejës (1899) në krye me Haxhi Zekën. Se edhe te kjo Lidhje autori gjen gjurmët e pollogasve, rolin dhe kontributin e tyre historik. Gjurmët, kontributi dhe roli i tyre janë të dukshme e të pranishme edhe në Kuvendin e Ferizajt, edhe në Kongresin e Manastirit, edhe në Kongresin e Dibrës, edhe në Kongresin e Elbasanit, edhe në kryengritjet e përgjithshme në Vilajetin e Kosovës 1910-1912, që u kurorëzuan më Pavarësi Kombëtare; edhe në kohën e Tanzimatit e në Revolucionin Xhonturk, por edhe në hapjen e shkollave të para kombëtare në gjuhën shqipe. Për shkak të gjithë këtij kontributi, pollogasit u ballafaquan, u përballën por nuk u thyen, as u dorëzuan përballë padrejtësive e egërsive të sulltanëve, vezirëve, pashallarëve, bejlerëve, agallarëve, çifligarëve; të ushtrive të Perandorisë Osmane; të ushtrive serbe, malazeze, bullgare dhe sllavëve të tjerë; të ushtrive mizore të aleancave ballkanike të cytura nga Rusia, të mbështetura nga Fuqitë e Mëdha, të cilat në mënyrë të padrejtë e copëtuan atdheun e shqiptarëve (gjoja në emër të paqes në Evropë), duke lënë nën mynxyrë mbi gjysmën e gjeografisë së tij, duke përfshirë edhe trevën heroike të Pollogut. Pjesëmarrja e denjë në ngjarje e kryengritje të mëdha Kombëtare, në kuvende e kongrese, në hartimin e programeve, projekteve, memorandumeve; reagimet me protesta, demonstrata dhe me luftë të armatosur; pjesëmarrja në Kuvendin e Qeverinë Kombëtare të Vlorës (1912) së Ismail Qemalit, pollogasve u bëri një vend të veçantë dhe të nderuar në Historinë Kombëtare, por ende nuk ua solli lirinë, ende nuk ua shpërbleu sakrificën. Me një kontribut aq të madh, me një shpërblim kaq të vogël, me një modesti të tillë, ata do të vazhdojnë krenar rrugën duke lënë gjurmë në histori. Në krye me gjeneral Mehmet Pashë Dërrallën, majorin rebel Tajar bej Tetovën, klerikun Sheh Mustafë Tetovën, intelektualin e atdhetarin Josif Bagerin, Abdylaqim Doganin, Anastas Arnaudovi-Albani, me rektorin e Parë të Universitetit Shqiptar të Tetovës, prof. Fadil Sylejmanin, por edhe me autorin e këtij libri, Zeqirja Idrizin, kjo trevë krenare gjatë historisë, kurrë kokulur, kurrë e nënshtruar, i ka rezervuar vetes vendin meritor në panteonin e vlerave madhore kombëtare. Dhe për të mos e harruar këtë vlerë e kontribut, autori ka bërë këtë vepër.

Autori, duke folur për pollogasit, ka në fokus dy shtresa, dy kategori pollogasish, të cilat jo rastësisht i veçon. Të parën (pakicën) e përbëjnë disa pashallarë, bejlerë, agallarët etj., të cilët dalin përçarës, inatçorë e hakmarrës, por edhe veprojnë kundër interesave të vendit e në shërbim të të huajve, por që para historisë dalin kokulur. Të dytët (shumica) janë intelektualët atdhetar si Josif

Bageri e ushtarakët si gjeneral Dërralla, popullata e thjeshtë, punëtorë e besnike, e djegur dhe e pjekur në mbrojtje të vatrave të tyre, por kurrë e nënshtuar, kurrë e ligësuar, por krenare. Të parët autori i shikon me përbuzje e me përçmim se shumë të këqija i sollën vendit. Të dytët i shikon me respekt e admirim, sepse falë tyre Pollogu e pollogasit janë krenarë e faqebardhë para kombit dhe historisë.

Se Pollogu ka lënë gjurmë në historinë e Shqipërisë dhe historinë shqiptare, shpesh si prijatë e pjesëmarrëse në kuvende e kryengritje të mëdha, dëshmon edhe kjo monografi me të cilën autori ka dhënë një kontribut të çmuar për historinë dhe historiografinë shqiptare. Historisë e historiografisë sonë i është dashur kjo monografi që flet për këtë trevë, sepse me këtë e plotëson informacionin për rolin dhe kontributin e gradecarëve, pollogasve dhe përgjithësisht kësaj pjese të atdheut në rrugën e çlirimit e bashkimit kombëtar. Pa njohjen dhe evidentimin e rolit dhe kontributit të kësaj treve nuk mund të jetë e plotë historia jonë, veçanërisht kjo e periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Sepse kjo trevë, siç del edhe në këtë monografi, në Rilindjen Kombëtare Shqiptare ishte një arterie e rëndësishme, pjesë e qenies dhe identitetit shqiptar, zemra dhe energjia e pashtershme, balli i kuvendeve, i historisë e krenarisë kombëtare. E synimi i autorit ka qenë të dëshmojë një gjë të tillë me fakte e dokumente historike. Për këtë dëshmojnë hulumtimet e bëra nëpër arkiva shqiptare, maqedone, vjeneze, bullgare, serbe, franceze etj.; e dëshmojnë programet, projektet, memorandumet etj., të përfshira në strukturën e këtij libri, të cilin e begatojnë dhe e plotësojnë përmbajtjen e librit, i cili del mjaft i pasur me të dhëna për këtë trevë. Të dhënat e mbledhura e grumbulluara e sistemuara në këtë libër, përveç nga arkivat (si dokumente të pabotuara) janë marrë edhe nga librat, gazetatat, revistat në gjuhën shqipe, gjermane, turke, serbe-malazeze, greke, bullgare-maqedonase e sllave, italiane e madje edhe amerikane. Pjesë e strukturës së librit janë edhe memoaret dhe shënimet e tjera të familjes Dërralla që e bëjnë këtë libër dhe bibliografinë e tij më të plotë për të cilën sigurisht që janë dashur vite t'i grumbullojë, lexojë, analizojë e sistemojë në strukturën e monografisë. Pjesë e strukturës janë edhe disa vargje këngësh popullore, por ka edhe pjesë të shkëputura nga memorandumet e projektet e ndryshme, të cilat autori i ka cituar në funksion të plotësimit të përmbajtjes, të idesë dhe asaj që ai e ka konceptuar. Disa prej tyre janë vendosur të plota a të pjesshme në brendësi të tekstit, e disa në fusnotë. Kudo që janë të vendosura, ato e bëjnë më të plotë punimin, më argumentues, më të afërt, por edhe më të qartë e të këndshëm për lexim. Për më tepër edhe struktura e tekstit bëhet më complete, trajtat ligjërimore më e pasur. Doemos se autori me këtë monografi do zgjojë kureshtje dhe admirim nga ata që kanë dëshirë të dinë më shumë e ta njohin nga afër këtë trevë në dritën e fakteve e dokumenteve historike. Kjo është një nga të veçantat e librit.

Për autorin nuk ka qenë e lehtë që në një monografi të formatit të tillë të mbledhë e të bëjë bashkë aq shumë kuvende, kongrese e personalitete; aq shumë ngjarje, aq shumë mund e sakrifica dhe, me fakte e dokumente të flas për kontributin e një treve në një periudhë kohore ku fati i kombit ishte në udhëkryq. Autori ka qenë i vetëdijshëm se kjo do të përbente një sfidë për të, por duke qenë se e kishte profesion, e ka bërë me përkushtim e krenari, se ka pasur ku e me çka të

motivohet. Kësisoj autori ka vazhduar rrugës së rilindësve të Rilindjes Kombëtare, mesazhit të atyre kuvendeve, kongreseve e kryengritjeve të mëdha, duke na e sjellë në kujtesë se deri ku shtrihet atdheu ynë. Kur autori i ka hyrë punës për përgatitjen e kësaj monografie doemos se ka pasur një qëllim, një mision: që ta ndriçojë të vërtetën për rolin dhe kontributin e pollogasve. Ky mision autorin e ka shpënë në një rrugë të gjatë, me plot sfida, me plotë përpjeta e tatëpjeta, nëpër fshatra, qytete e krahina shqiptare për të hulumtuar nëpër arkiva e biblioteka personale; nëpër arkiva e biblioteka të qyteteve e shteteve të Ballkanit dhe të Evropës. Ani se krenaria, subjektivizmi e dhimbja kanë mundur ta pengojnë, ta çojnë në rrugë të gabuar, ta bëjnë t'i dridhet dora e zemra, t'i rrjedhin edhe lotët, t'ia errësojnë shikimin e t'ia përmbysin arsyen që të mos jetë objektiv në mbarështimin e fakteve, sistemimin e lëndës etj., autori nuk ka rënë pre, viktimë e asnjërës nga to. Autori ka arritur ta mund smirën e xhelozinë, inatin e krenarinë e t'i thërrasë arsyes që të jetë në nivel, që të jetë argumentues, bindës, i qartë dhe objektiv, ashtu siç e do e drejta, e vërteta, argumenti, historia e shkenca.

Në fund duhet thënë se, përmes kësaj monografie, autori ka hapur një dritare prej nga shpërfaqen para nesh hapësira gjeografike e Pollogut, kreshta e vargmale, fusha e kullosa, bagëtia e bujqësia e saj; Lumi i Vardarit me luginat të paanë; Tetova e Gostivari si dy kryeqendra, si dy krih shqiponje; shpërfaqen para nesh horizonte historie, kongrese intelektualësh, udha e shkronjave; kuvende të ndryshime burrash, në ballë të të cilëve gjejmë shpesh njerëz të pushkës e të penës, arsimdashës e intelektualë, burra e kuvendarë që e nderuan kuvendin e historinë kombëtare. Natyrisht, se në ato horizonte shpërfaqen edhe pamje të zymta, të hirta, tym e flakë baroti, pamje trishtuese ushtarësh të sulltanëve, pashallarëve, bejlerëve e agallarëve dhe shpurat e tyre, por ama kokulur e të turpëruar para historisë e të ardhmes së asaj pjese të atdheut. Kurse Pollogu e pollogasit krenar e faqebardhë në Lëvizjen e historinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Dhe jo vetëm të saj. Krejt në fund duhet themi se, të gjithë ata që dëshirojnë të dinë më shumë për Pollogun, duhet ta lexojnë këtë monografi. Kurse historiografia shqiptare e ka tashmë në dorë një monografi, e cila mund t'i shërbejë mjaft në rast se shkruhet një Histori e plot dhe gjithëpërfshirëse e popullit shqiptar.

KRONIKA SHKENCORE

GJUHA SHQIPE NË NJË KONFERENCË PËR GJUHËSINË E KORPUSEVE

Nga data 5–7 dhjetor 2016, në Shën Petërburg, pranë Institutet të Studimeve Gjuhësore të Akademisë së Shkencave të Rusisë (më tej ASHR), u mbajt konferenca shkencore me temë “Trajtime të bazuara në korpuse të gjuhëve dhe të dialekteve të Ballkanit”. Në këtë tubim shkencor, veç ballkanologëve rusë, morën pjesë gjuhëtarë nga Europa Perëndimore, nga ShBA dhe nga vendet e Ballkanit, përfshirë edhe gjuhëtarë shqiptarë. Konferencën e përshëndeti drejtori i Institutit akademik Nikollai N. Kazanski.

Tematika e kësaj konference i kushtoj një qasjeje të re ndaj dukurive gjuhësore të gjuhëve në shqyrtim, të mbështetur në të dhënat e korpuseve elektronike. Gjuhësia e korpuseve është një disiplinë e re gjuhësore, fillimet e së cilës lidhen me përpjekjet për krijimin e korpuseve elektronike të teksteve, që zëvendësojnë kartotekat me skedarë e skeda, duke qenë më të manipulueshme dhe shumë më të pasura në informacion leksikor e gramatikor. Këto përpjekje nisën me atë që sot njihet si “Korpusi Broun” (Brown Corpus), i krijuar në vitin 1961 nga gjuhëtarët amerikanë Henry Kučera dhe W. Nelson Francis. Ky korpus, i përpunuar në mënyrë të tillë që të jepte të dhëna të vlefshme për gjuhëtarët e fushave të ndryshme, përmbante një milion forma fjalësh.

Duke u kuptuar rëndësia e korpuseve elektronike, dalëngadalë, madhësia e tyre u rrit duke arritur sot për gjuhë si anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja etj. në miliarda fjalë. Fillimisht, korpuset elektronike tërhoqën në radhë të parë vëmendjen e hartuesve të fjalorëve, që tani kishin mundësi të nxirrnin me shpejtësi lista fjalësh me denduritë e përdorimit, të gjenin kuptimet e një fjale si dhe shembujt për ilustrimin e tyre, kërkimi i të cilave më parë donte shumë kohë e forca pune. Korpuset elektronike revolucionarizuan leksikografinë, duke sjellë edhe lindjen e një discipline të re, të leksikografisë kompjuterike. Por ato nxitën edhe përpjekjet e gjuhëtarëve për të ndërtuar një teori të re linguistike, gjuhësinë e korpuseve, e cila merret me parimet e ndërtimit dhe të përpunimit kompjuterik të korpuseve elektronike. Si rrjedhim, në ditët tona korpuset kanë zëvendësuar kartotekat, duke shërbyer për studime më të thella të leksikut, semantikës, morfologjisë, sintaksës dhe të fushave të tjera të gjuhës.

Sot për gjuhët e Ballkanit janë ndërtuar korpuse elektronike të madhësive të ndryshme. Pikërisht, konferenca e Shën Petërburgut mbledhi specialistë të gjuhësisë kompjuterike, të cilët paraqitën aty arritjet e tyre në ndërtimin e korpuseve të këtyre gjuhëve, si dhe gjuhëtarë që studimin e aspekteve të ndryshme gjuhësore i kishin mbështetur në të dhënat e nxjerra prej këtyre korpuseve.

Edhe për gjuhën shqipe ka disa disa korpuse elektronike, si ai i Universitetit të Gjuhëve të Huaja të Pekinit, i Institutit të Studimeve Gjuhësore të Shën Petërburgut (me rreth 20 milionë fjalëforma), i katedrës së gjuhës shqipe në Universitetin e Kalabrisë (Kozencë) për letërsinë arbëreshe dhe i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Por korpusin më të pasur të shqipes e paraqiti në këtë

konferencë dr. Besim Kabashi, specialist i gjuhësisë kompjuterike në Universitetin “Friedrich Alexander” të Erlangenit në Gjermani. Korpusi i përgatitur prej tij tërhoqi vëmendjen e pjesëmarrësve jo vetëm për madhësinë (mbi 100 milionë fjalëforma), po edhe për shkallën e lartë të përpunimit, gjë që e bën atë një burim shumë të pasur e të vlefshëm të dhënash për studiuesit e shqipes.

Dita e parë e konferencës iu kushtua pikërisht korpuseve gjuhësore. Sesionin e paradites e çelën prof. Ronelle Alexander e Universitetit të Berkliut në Kaliforni dhe Vladimir Zhobov i Universitetit “St. Kliment Ohridski” të Sofies, të cilët mbajtën kumtesën “Dialektologjia bullgare si një traditë e gjallë: një korpus inovativ dialektor”; pastaj dr. B. Kabashi, në kumtesën me titull “Ndërtimi i një korpusi tekstesh të shqipes për kërkime gjuhësore”, tregoi për punën e bërë prej tij për ndërtimin e platformës kompjuterike të korpusit, për zgjedhjen e teksteve si dhe për të dhënat e shumta gramatikore që mund të nxirren prej këtij korpusi; Olja Jojić dhe Darko Drakulić të Universitetit të Sarajevës Lindore kumtuan për “Krijimin e korpusit serb të Republikës Serbska”; Branko Toshoviç e Arno Vonish të Institutit të Sllavistikës të Universitetit “Karl dhe Franc” të Gracit (Austri) kumtuan për “Korpusin shumëgjuhësor Galis në sistemin e korpuseve paralele të gjuhëve sllave jugore”; studiuesja greke Evangelia Adamou e departamentit Lacito të Qendrës Kombëtare Franceze për Kërkime Shkencore në Paris kumtoi për “Ndërtimin dhe shfrytëzimin e korpuseve të folura për kontaktet gjuhësore: dëshmi nga gjuhët sllave të Ballkanit dhe nga gjuha rome”; studiuesi Maksim Kisilier i Universitetit Shtetëror të Shën Petërburgut mbajti kumtesën “Korpusi i greqishtes së re dhe çështja gjuhësore greke”, rreth së cilës pati shumë pyetje, të cilave i riu poliglot iu përgjigj bindshëm; Eleni Karancola dhe Konstantinos Sampanis të Universitetit të Egjeut mbajtën kumtesën “Një korpus i hershëm i greqishtes moderne”; dhe Aleksandra Evdokimova e Institutit të Gjuhësisë të ASHR paraqiti kumtesën “Dialekti kapadok i greqishtes bizantine. Krijimi i korpusit dhe i bazës kompjuterike me përshkrimin e veçorive themelore gjuhësore”

Kurse dita e dytë e konferencës iu kushtua studimeve gjuhësore të mbështetura në të dhënat e korpuseve. Studiuesja Maria Hollodilova e Institutit të Kërkimeve Gjuhësore të ASHR kumtoi temën “Konkurrenca e përemrave lidhorë dhe pyetës në maqedonishte”; Ekaterina Tarpomanova e Universitetit “St. Kliment Ohridski” mbajti kumtesën me temë “Participët veprorë të aoristit dhe të imperfektit në bullgarishte – studim i mbështetur në korpus”; Elena Ivanova e Universitetit Shtetëror të Shën Petërburgut mbajti kumtesën “Pjesëza e bullgarishtes *da ne bi* si marker i aprehensivit (bazuar në materialet e korpusit kombëtar bullgar dhe të korpuseve paralele ruso-bullgare)”; Silje Susanne Alvestad e Universitetit të Oslos mbajti kumtesën “Një rast i përdorimit aspektor të infinitivit në rusishte i krahasuar me infinitivët dhe ndërtimet gjegjëse me *-da* të disa gjuhëve ballkanike”; Ruprecht von Waldenfels i Departamentit të Gjuhëve dhe të Letërsive Sllave në Universitetin e Berkliut mbajti referatin “Easy come, easy go: foljet deiktike të mocionit në gjuhët e Ballkanit në një korpus paralel”, e cila u prit me shumë interes, por edhe me sugjerimin që duhet të ishte përfshirë edhe shqipja, e cila, bashkë me rumanishten, përbën çelësin për shpjegimin diakronik të këtyre foljeve; Vladimir Plungian i Institutit të Gjuhësisë dhe i Institutit të Gjuhës Ruse të ASHR dhe Anna

Urmançieva e Institutit të Studimeve Gjuhësore të ASHR mbajtën kumtesën “Semantika e formave të perfektit dhe të pluskuamperfektit të sllavishtes së vjetër në prizmin e veçorive ndërtimore të tyre”; Kirill Kozhanov i Institutit të Gjuhësisë të ASHR kumtoi temën “A ka një ‘infinativ të ri’ në dialektin rus të gjuhës cigane?”; Sonja Oskolskaja e Institutit të Studimeve Gjuhësore mbajti kumtesën “Përshtatja e përcaktorit me emrin që përcakton në tekstet e shkruara të gjuhës së ciganëve rusë (në krahasim me materialin e dialektit kelderar)”; dhe, në fund, doktoranti shqiptar Vinçenco Dheskali pranë Departamentit të Gjuhës Angleze dhe të Gjuhësisë të Universitetit Teknik të Kemnicit në Gjermani mbajti temën “Një krahasim i mbështetur në korpus i tezave të studentëve shqiptarë dhe italianë në L1 dhe L2: rasti i Hedges and Boosters”, në të cilën kumtoi për punën e kryer prej tij për hetimin e dallimeve dhe të ngjashmërive midis studentëve shqiptarë dhe italianë në përdorimin e formave të sigurisë (Hedges) dhe të pasigurisë (Boosters) në shkrimet e tyre akademike, duke u mbështetur në dy korpusë paralele: një për italishten dhe anglishten, me 3 milionë fjalë secili, dhe një tjetër me 2,2 milionë fjalë për shqipen dhe 700 mijë për anglishten.

Dita e tretë e Konferencës iu kushtua vetëm gjuhës shqipe. Gjatë seancës së paradites, që qe e fundit, u mbajtën 4 kumtesa nga punonjësit e Institutit dhe u paraqitën tre postera nga studentët e vitit të tretë të degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe të Fakultetit Filologjik pranë Universitetit Shtetëror të Shën Petërburgut.

Albanologët rusë të Institutit të Studimeve Gjuhësore kanë meritën se kanë krijuar një korpus të shqipes, të bazuar në kriteret që janë ndjekur edhe për ndërtimin e korpusit kombëtar të gjuhës ruse. Pikërisht, në të dhënat e këtij korpusi ishin mbështetur kumtesat që u paraqitën prej tyre në këtë konferencë. E veçanta e këtyre studimeve është se tregojnë se si shfrytëzimi i korpusit lejon të arrihet në përfundime të drejta lidhur me përndarjen dhe dendurinë e përdorimit të dukurive e kategorive gramatikore, ndërkohë që vlerësime të tilla të sakta mungojnë në gramatikat dhe në studimet gramatikore të shqipes. Së dyti, mbështetja në korpus lejon edhe të ndiqen prirjet e zhvillimit si dhe shtrirja gjeografike e dukurive të caktuara gramatikore.

Seanca u hap me kumtimin e studiueses së njohur Albina Zhugra “Turqizmat foljorë në gjuhën shqipe (çështje të semantikës)”, objekt i të cilit ishte hetimi i përdorimit të huazimeve foljore turke në shqipen e sotme. Sipas autores, nga mbi 200 folje me burim turk që gjenden në fjalorin e T. Dizdarit, në shqipen e sotme letrare përdoret një numër shumë i vogël syresh. Synimi i autores ishte të shiheshin këto huazime foljore nga pikëpamja e dendurisë, e përdorimit sipas tipave të teksteve tipave dhe e veçorive funksionalo-stilistike. Nga pikëpamja e përkatësisë në fusha leksikore, prej autores dallohen grupi i foljeve të lëvizjes, i foljeve të gjendjes fizike e të sjelljes, foljet e të folurit etj. Një veçori e përgjithshme e këtyre foljeve që vihej në dukje në kumtesë, është ngjyrimi emocional dhe ekspresiv i kuptimeve të tyre; një veçori tjetër është se në gjuhën shqipe është huazuar vetëm një kuptim i tyre, shpesh jo kryesori. Duke u ndalur te folja *bastis*, autorja vuri në dukje se kjo folje nuk mund të futet ndër foljet me denduri të lartë. Nga analiza e korpusit të shqipes del se kjo folje përdoret 84 herë. Denduria e përdorimit të saj

është rritur sidomos në gjuhën e shtypit (65 herë), ku vërehen edhe kuptime të reja të saj që nuk gjenden në fjalorët shpjegues të shqipes. Analiza e

Maria Morozova, punonjëse e brezit më të ri të Institutit, kumtoi për temën “Ndërtimet fazore në gjuhën e sotme shqipe (studim i mbështetur në korpus)”, objekt i së cilës ishin ndërtimet e tipit *folje fazore + lidhore* dhe *folje fazore + së bëri* të shqipes. Fazore autorja quan foljet që përshkruajnë faza të një situate, të cilat ndahen në inkoative (ato që tregojnë fillim veprimi: *filloj, nis*), kontinueative (foljet që tregojnë vazhdim: *vazhdoj, vijoj*) dhe terminative (foljet që tregojnë përfundim: *mbaroj, përfundoj, ndërpres, lërej, praj, ndal, ndaloj*). Por veç këtyre, shqyrtoheshin edhe foljet jofazore që përdoren për të përshkruar faza të një veprimi: fillim (zë, vij, marr, vihem, mbes, qes) dhe vazhdim të tij (pushoj, resht, dështoj, shuaj, ngopem).

Nga analiza e shembujve me këto ndërtime, të nxjerra nga korpusi rus i shqipes, lidhur me përndarjen e *të bëj* autorja zbulon se, përgjithësisht, shkon me foljet inkoative e kontinueative. Sa u përket karakteristikave morfosintaksore të saj, ajo konstaton se pas foljeve në kohë të shkuar përdoret forma e së pakryerës së lidhore, ndërsa rastet kur folja në lidhore përdoret në të tashmen (si në rastin vazhdonin *të qëndrojnë*) shihen prej saj si përdorime të gjuhës së folur. Në të vërtetë, ndërtime të gjuhës së folur janë ato me bashkërenditje me lidhëz shtuese të dy foljeve (zë e rritet). Për ndërtimet me *së bëri* u tha se kjo formë shkon përgjithësisht me foljet terminative, dhe derivohet nga foljet e tipave të ndryshëm aspektorë, përfshirë (1) foljet që tregojnë përfundimin e një gjendjeje (stative), si *dua, jam, ekzistoj, jetoj*; (2) foljet atelike (*rritem*); (3) foljet që tregojnë veprime që zgjatin (multiplikative), si *trokas, qëlloj, pikoj*; (4) me foljet telike “të forta” (*vij, vdes, vë*); (5) me foljet punktive (*gjej, fitoj, ndez*), duke mos u përshtatur me foljen drejtuese. Pohimet e saj për përdorimin e ndërtimeve folje fazore + lidhore dhe folje fazore + *së bëri* autorja i mbështet në korpusin kombëtar të shqipes, i cili përmban të dhëna të periudhës 1960–2010. Statistikat provojnë se raporti i përdorimit të formës *së bëri* me *të bëj* me foljet inkoative është 47 me 4102, i foljeve kontinueative 19 me 4219, ndërsa i foljeve terminative 296 me 229. Një vrojtim tjetër me interes lidhur me shpërndarjen gjeografike (të mbështetur në tri gazeta: “Gazeta shqiptare”, “Zëri” në Kosovë dhe “Koha” në Maqedoni) është se ndërtimet me folje inkoative dhe kontinueative me *së bëri* pothuajse nuk përdoren në Shqipëri, përkundër përdorimit të tyre më dendur në dy gazetatat e tjera (me foljet inkoative raporti është 3 me 47, ndërsa për foljet kontinueative 1 me 19). Përfundimet në të cilat arrin autorja, janë se ndërtimet me *së bëri* përdoren rrallë në shqipen standarde, po edhe në tekstet toske të periudhës para standardizimit; se përzierja e ndërtimeve me *së bëri* dhe e atyre me lidhoren është një veçori e përgjithshme e gjuhës së folur, e cila ndikon edhe në gjuhën e medias; dhe se një interpretim i drejtë i ndërtimeve jostandarde me ndërtimet standarde do të ishte i mundur po të kishte tekste jostandarde.

Në kumesën e prof. dr. Larisa Kaminskajës “Mbi përdorimin e jusivit në gjuhën shqipe (sipas materialit të korpusit kombëtar shqiptar)” merren në shqyrtim përdorimi i formave të zbutura të urdhërores me pjesëzën *le* për të shprehur lejim, urdhër, vullnet dhe dëshirë, me qëllim që të shihet përdorimi i tyre sipas stileve

funkcionale, sipas vetës dhe numrit, sipas kohës dhe grupeve semantike të predikatëve. Për këtë qëllim, autorja ka analizuar 1496 raste të përdorimit të ndërtimit *le* + folje në lidhore nga nënkorporusi i teksteve gazetareske, publicistike, religjioze, shkencore dhe artistike të korpusit kombëtar shqiptar. Ajo jep denduritë e përdorimit të këtij ndërtimi me kuptim imperativ, optativ, kuaziimperativ, nonkurativ, etik, permisiv (lejor), të supozimit, të kushtit etj. në tekstet e secilit prej këtyre stileve. Të veçanta të këtij studimi janë jo vetëm specifikimi i funksioneve në të cilat përdoret ndërtimi *le* + folje në lidhore, duke i çuar më tej e thelluar pohimet për përdorimin e këtij ndërtimi nga F. Agalliu (në punimin e tij për mënyrën lidhore), po edhe të dhënat për dendurinë sipas stileve të ligjërimit të shkruar.

Kurse prof. dr. Aleksandër Rusakovi, punonjës i Institutit të Studimeve Gjuhësore të ASHR, në kumtesën e tij “Dy pluskuamperfektë në gjuhën shqipe: studim korpusor”, synonte të sqaronte, duke u mbështetur në korpusin kombëtar shqiptar, se sa e përhapur është në gjuhën standarde forma e mbipërbërë e së kryerës, të cilën e quan aorist 2, të krahasonte atë me formën e mbipërbërë të më se të kryerës (të cilën e quan pluperfekt 2) dhe të arrinte në disa përfundime paraprake për veçoritë kuptimore të saj.

Në fillim, autori i kumtesës paraqiti sistemin e formave të mbipërbëra të shqipes, duke quajtur perfekt 2 të kryerën e mbipërbërë, pluperfekt 2 më se të kryerën e përbërë, aorist 3 të kryerën e tejshkuar të përbërë, dhe perfekt 3 formën e tejshkuar të së kryerës (kam pasë pasë bërë). Prania e perfektit “posesiv” (me foljen ndihmëse *kam*) në shqipe shihet prej tij si tipar i gjuhëve SAE¹⁰. Autori jep dendurinë e përdorimit të më se të kryerës dhe të së kryerës së tejshkuar (aoristit 2), ku duket se më se e kryera ka një denduri të lartë.

Në mbyllje, autori arriti në një numër përfundimesh lidhur me këto dy forma, përfundime që janë të besueshme, sepse mbështeten në të dhëna faktike të nxjerra nga korpusi dhe jo në hamendësime. Kështu, nga të dhënat faktike del se aoristi 2 përfaqëson në vetvete një formë të rrallë, që ndeshet, megjithatë, në të gjitha stilet e ligjërimit dhe në të gjithë arealin e shqipes, po me dallimin që ka një denduri më të lartë në Kosovë e Maqedoni, gjë që, sipas tij, lidhet pas gjase me shkaqe dialektore; se nga të dhënat e korpusit del e pambështetur hipoteza e Viktor Fridmanit se kundërvënia e aoristit 2 me më se të kryerën përcaktohet nga përbërësit evidencialë të kuptimit të tyre; se më se e kryera ka një denduri të lartë përdorimi në krahasim me të kryerën e tejshkuar (aoristit 2); se shumica dërrmuese e përdorimeve të aoristit 2 i përkasin sferës të së “shkuarës shkuarës imediate” (veprimi që ndodh pak kohë përpara veprimit tjetër në të shkuarën); se në planin diskursiv, në dallim nga format e më se të kryerës, format e aoristit 2 tregojnë mjaft shpesh linjën bazë të rrëfimit; se aoristi 2 në shqipen standarde paraqitet si një gramemë jo e domosdoshme, që në çdo rast mund të zëvendësohet nga format e më se të shkuarës

¹⁰ SAE (Standard Average European), term i përdorur nga B. Uorf i për gjuhët e sotme indoeuropiane të Europës, të cilat kanë të përbashkëta disa tipare, të quajtura edhe *euroversale* (universale europiane).

së mbipërbërë, me përjashtim të rasteve kur është në protasën e periudhës me fjali kushtore me lidhëzën *po*, ku përdorimi i tij është gramatikalizuar.

Në posterat që u paraqitën ditën e tretë nga studentet e degës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Universitetit Shtetëror të Shën Petërburgut, cekeshin aspekte të gramatikës dhe të leksikut të shqipes. Kështu, studentja Anna Karpikova paraqiti posterin me temë “Një studim i mbështetur në korpus i “futurit destinativ” në gjuhën shqipe”, objekt i të cilit ishte ndërtimi foljor *kam për të bërë*, me qëllim përshkrimin e kuptimeve të këtij ndërtimi në literaturën e stileve të ndryshme, zbulimin e kushteve dhe të konteksteve që përcaktojnë interpretimin kohor ose modal të tij dhe arritjen në përfundime për mënyrat e ndryshme të gramatikalizimit të tij. Pas paraqitjes së sistemit të formave të futurit në gjuhën shqipe, autorja përshkruante kuptimet kryesore të kësaj forme foljore: detyrues (debitativ), destinativ (me këtë term kuptohet një situatë që do të ndodhë patjetër), qëllimor dhe e ardhme, duke i ilustruar të gjitha këto kuptime me shembuj të nxjerrë nga korpusi.

Studentja Kristina Klimenchenko trajtoi temën “Termtat për ngjyrën e BLERTË në gjuhën shqipe: studim i bazuar në korpus”, një qasje kognitive ndaj problemit. Duke parë kuptimet e drejtpërdrejta dhe figurative të ilustruara me shembuj të termave *i/e gjelbër*, *i/e blertë* e *jeshil* dhe dendurinë e përdorimit të tyre në korpus në togëfjalëshat me emra që u përkasin tri grupeve kryesore semantike, “sendet”, “hapësirat” dhe “bimët” (*i/e gjelbër* 330 raste, *i/e blertë* 69 dhe *jeshil* 47 raste), konstatatimi i autores ishte se këta mbiemra shoqërohen më shumë me emra sendesh dhe emra që tregojnë hapësirë e më pak me emra bimësh. Nga analiza e konteksteve të përdorimit të këtyre tri fjalëve, ajo arrinte në përfundimin se të të tre këta mbiemra përdoren më shumë në kuptimin e drejtpërdrejtë, veçanërisht me emra bimësh, ndërsa me kuptime figurative përdoren rrallë. Nga të tre, *jeshil* përdoret më shumë me emra sendesh, veçanërisht me emrin *sy*, po shumë pak me emra të hapësirës; *i gjelbër* përdoret me emra që tregojnë hapësirë, ndërsa *i/e blertë* përdoret pothuajse njëjloj me të tri klasat semantike të emrave. Për sa u përket kuptimeve, *jeshil* nuk përdoret metaforikisht, kurse *i/e gjelbër* përdoret shpesh me kuptime metaforike.

Studentja Julia Linnik në posterin e saj trajtoi temën “Huazimet turke në shqipen e sotme standarde: studim i bazuar në korpus”, duke synuar përcaktimin e dendurisë së përdorimit të turqizmeve në shqipen standarde dhe të konotacioneve të disave prej tyre. Për këtë qëllim, autorja kishte krijuar një listë prej 892 turqizmesh të nxjerrë nga Dizdari (2005) dhe Latifi (2012), të cilat i kishte ndarë në 24 fusha semantike. Në një tabelë jepej denduria e fjalëve të caktuara për çdo fushë semantike; pastaj, në një tabelë tjetër, jepej numri i fjalëve me denduri më të lartë se 100 për çdo fushë semantike. Më tej, merreshin dhjetë çifte fjalësh turqizëm – fjalë gjegjëse e shqipes (*odë – dhomë*, *krevat – shtrat* etj.) dhe, mbështetur në të dhënat e korpusit, krahasohej denduria e përdorimit të tyre në korpus për periudhën 1950–1989 dhe nga 1990 e deri sot. Autorja arrinte në përfundimin se, sipas klasave leksikore, emrat zënë vendin e parë, për arsye se, si në të gjitha gjuhët, emrat huazohen më lehtë, pastaj vijnë ndajfoljet, kurse folje në mikrokorpusin e saj janë vetëm tri; se turqizmat më të shumtë janë huazime kulturore, fjalë të sferës

fetare dhe social-politike; dhe, së fundi, se pas '90-s përdorimi i turqizimave është shtuar, ndonëse fjalët gjegjëse shqipe kanë denduri më të lartë përdorimi.

Vlen të vihet në dukje se gjuha shqipe në këtë konferencë zuri vendin e parë, me 6 kumtesa dhe tri postera, nga 28 kumtime që u mbajtën. Fakti që shqipes iu kushtua një e treta e kumtesave dhe një nga tri ditët e konferencës, është tregues i interesit të albanologëve rusë të Institutit të Studimeve Gjuhësore për gjuhën shqipe, të cilët, duke vijuar një traditë të nisur 60 e ca vjet më parë, kanë sjellë e po sjellin ndihmesa të vyera në studimin e saj. Ndhimesat e kësaj bërthame albanologësh do të vijojnë edhe në të ardhmen, meqenëse në këtë Institut është bërë kujdes për përgatitjen e brezave të rinj, duke arritur që në të të ketë përfaqësues të tre brezave. Risi të punës së albanologëve rusë janë jo vetëm problematika e trajtuar, por edhe mbështetja e studimeve të tyre jo në vjelje të rastit, po në një korpus elektronik. Kjo i ndihmon ata të zbulojnë prirjet e zhvillimit të dukurive gjuhësore të shqipes dhe të arrijnë në përfundime të besueshme lidhur me to.

Një ndihmesë e çmuar e albanologëve rusë është edhe korpusi elektronik i gjuhës shqipe, i cili përbën një burim të pasur informacioni, i hapur për t'u përdorur nga të gjithë. Kjo përvojë e tyre shtron nevojën e ngutshme që në të dy institutet tona të gjuhësisë, në Tiranë dhe në Prishtinë, të mendohet seriozisht për një korpus elektronik më të plotë të gjuhës shqipe, i cili do të ishte një kartotekë moderne dhe e përditësueshme, shumë më e pasur se kartoteka e vjetër e Institutit të Gjuhësisë, që do të shërbente për studime gjuhësore dhe për hartimin e fjalorëve të shqipes. Dhe për këtë nuk është nevoja të nisët nga e para. Një zgjidhje e shpejtë dhe shumë e mirë do të ishte të merrej korpusi i dr. Kabashit, që u vlerësua në këtë konferencë për madhësinë dhe për gjerësinë e informacionit. Më tej, mund të shihej edhe mundësia e shkrirjes së të gjitha këtyre korpuseve në një të vetëm.

Rami MEMUSHAJ

KRONIKË PËR PUNËN SHKENCORE TË ITSHKSH GJATË VITIT 2016

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, si institucion shkencor me financim publik në vitin 2016 ka përbushur një plan i përbushur me shumë aktivitete në shumë plane: hulumtues- shkencor, në dimensionin e veprimtarisë botuese, në atë të organizimit të tribunave e konferencave shkencore dhe në mbarëvajtjen e studimeve pasdiplomike. Bëhet fjalë për një angazhim të gjithë punonjësve shkencorë në shumë sfera, me qëllim të përbushjes jo vetëm të detyrimeve ligjore, por edhe të misionit që ka para popullatës shqiptare, identitetin e së cilës e kultivon, mbron, por edhe promovon dhe afirmon.

Veprimtaria botuese e ITSHKSH-së

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në bashkëpunimin me Institutin e Studimeve Shqiptare dhe Protestante në Tiranë promovoi tre vepra të rëndësishme:

–Gjerasimi : predikues, iluminist, rilindës të autorit Xhon Kuandrud.

-Pengu i kaçakëve të autorit Gjerasim Qiriazhi dhe

-Jeta ime të autores Sevasti Qiriazhi – Dako

Ndërsa Instituti është botues edhe i veprës shkencore "Presheva në rrjedhat e historisë (shek.XX)" të autorit Ardian Emini dhe i veprës nga fusha e studimit të folklorit "Besime popullore shqiptare -Rite e mitologji në rajonin e Kumanovës, të autorit Mumin Zeqiri.

Vepra Ekspozita "Shenjtorja nga Shkupi - korrespondenca = Sveticata od Skopje - korespondencii = The sain from Skopje - correspondences", është e studiuesit të ITSHKSH-së, Sevdail Demiri.

Studiuesi i njohur Qemal Murati botoi veprën "Hulumtime linguistike dhe kulturë-historike në etnoregjonin e Rekës së Epërme".

Revista "Studime Albanologjike" (numri 13 dhe 14)

Është botuar edhe numri 13 i revistës Studime Albanologjike, në të cilën botohen materiale të larmishme nga sfera të ndryshme. Në këtë numër janë përfshirë këto punime shkencore.

Skender ASANI- SHQIPTARËT DHE HEBRENJTË NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE Moikom ZEJ- ZEF MIRDITA, DIJETARI I MADH SHQIPTAR I FORMATIT EVROPIAN

Eqrem ÇABEJ- NJË GJUHË SHKRIMI E NJËSISHME

Thanas L. GJIKA- KUJTIME PËR PROFESORIN EQREM ÇABEJ

Xhevat LLOSHI- SULME ANTISHQIPTARE NËN PETK SHKENCOR

Naser FERRI- KULTI I HYJNESHËS DEA SYRIA NË SCUPIN DARDAN

Qemal MURATI- DHJETË POPUJ TË BALLKANIT ME DHJETË TË VËRTETA NË XHEPPËR “AUTOKTONINË” E TYRE

Hidajete AZIZI- GJENDJA E STUDIMEVE ONOMASTIKE NË MAQEDONI

Haredin XHAFERI- LOKUCIONET ME VLERË PËREMRI NË GJUHËN SHQIPE

Shpëtim ÇUÇKA- UMBERTO EKO – VËSHTRIM PËRMES PËRKTHIMESH E LEXIMESH

Ismail SYLA- VITI I GJENIUT KADARE (2016).

Mimoza CIKA-KELMENDI- NJË KADARE PAS LETRAVE

Lirak KARJAGDIU- NOLI PËRKTHYES I LETËRSISË ANGLEZE DHE AMERIKANE

Jolanda LILA- IRONIA SI PJESË E STRUKTURËS POETIKE TEK ALI PODRIMJA

Roger COHEN- LUFTA E TRETË

James PETTIFER- SI U MANIPULUA HISTORIA E BALLISTËVE NË MAQEDONINË PERËNDIMORE

Faik KONICA- VESET E PANDREQSHME TË SHQIPTARËVE

Ferid MUHIQ- APOLOGJIA E BALLKANIT.

Ardian EMINI - *Alfred MARLEKU*- PRESHEVA PAS SHPËRBËRJES SË REPUBLIKËS FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË

Ilir A. ZYLFIU- FILLESAT E ARSIMIT SHQIP NË PRESHEVË E RRETHINË

Sevdail DEMIRI- KONTROLLI POLITIK NDAJ PUNËS DHE PËRMBAJTJES SË GAZETËS “FLAKA E VËLLAZËRIMIT” NË SHKUP

Ermal MEHMETI- TRADITA E KËNDIMEVE POLIFONIKE

Angjelina HAMZA- ROLI FEMRËS NË FAMILJE

Naim HALIMI - FAQE KUJTIMI E LAVDIE: ISMET JASHARI – KOMANDANT KUMANOVA

Gabriela TOPUZOVSKA- AKTIVITETI I MINISTRISË SË SHËNDETIT POPULLOR DHE ZHVILLIMI I SHËRBIMIT EPIDEMIOLOGJIK NË MAQEDONI (1945-1947)

RECENSIONE

Oliver Jens SCHMITT- NJË VEPËR ORIGINALE DHE JOKONVENCIONALE (*Ylber Hysa, "Shqiptarët dhe të tjerët: nga Madona e Zezë deri te Molla e Kuqe"*)

Naser FERRI- PREZANTIM I DENJË I MITOLOGJISË DHE KULTURËS POPULLORE SHQIPTARE (*Elsie Robert, A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture, Hurst & Company, London 2001, f.357; Elsie Robert, Leksiku i Kulturës Popullore Shqiptare- besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore, Skanderbeg books, Tiranë 2005, f.282*)

Naser FERRI- ASPEKTE INTERESANTE TË BESIMEVE POPULLORE SHQIPTARE

(*Azem Qazimi, Fjalor i mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare, të kremte, rite e simbole, SHB Plejad Tiranë, 2008, f.196*)

KRONIKA SHKENCORE

Xhevat LLOSHI- NJË VIT I FRYTSHËM BOTIMESH I ITSHKSH-së
Avzi MUSTAFA -POEZIA E JETËS SIME (*ligjërata lamtumirëse e pensionimit*)

Numri 14 i revistës shkencore "Studime Albanologjike". Përmbajtja e saj poashtu është e larmishme.

Rami MEMUSHAJ - KOMISIA LETRARE E SHKODRËS 100 VJET MË PAS

Qemal MURATI-KOMISIA LETRARE SHQIPE (1916-1918) NGA PERSPEKTIVA E SHQIPES SË SOTME

Hidajete AZIZI- HIPOKORISTIKA NË ANTROPONIMI

Haredin XHAFERI- TOPONIMIA E TOMORICËS

Xhevat LLOSHI - MARRËDHËNIET E LËVIZJES PROTESTANTE ME RILINDJEN KOMBËTARE

Riza SADIKU- HASAN KALESHI PERSONALITET ME FAMË BOTËRORE, POR I MARGJINALIZUAR NGA INSTITUCIONET SHKENCORE

Muharrem BAZDUL- GJYSMË SHEKULLI I "GJENERALIT TË USHTRISË SË VDEKUR"

GONXHE BOJAXHI DHE FLETORJA E FSHEHTË ME POEZI

Genciana ABAZI - EGRO- LETËRSIA NË PROCESIN E FORMIMIT TË KOMBIT TE SHQIPTARËT

Skifter KËLLIÇI- NJË LEXIM NDRYSHE I “LAHUTËS SË MALCIS”

Mirlinda KRIFCA BEQIRI- “NJË SAGË E VOGËL” – E EROSIT DHE THANATOSIT

Isamedin AZIZI- BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMITETIT TË KOSOVËS DHE KOMITETIT MAQEDONAS 1918-1920

Nelson R.ÇABEJ - KOMBI SHQIPTAR DHE FANTAZMA E “KOMBIT KOSOVAR”

Milovan GJILLAS: SHQIPTARËT JANË AUTOKTONË DHE POPULLI MË I VJETËR I BALLKANIT

Dorian KOÇI- IDENTITETI FETAR E KOMBËTAR I SHQIPTARËVE ORTODOKSË TË REKËS

Fauzi SKENDERI- VEÇORITË DEMOGRAFIKE TË KOMUNËS SË BËRVENICËS

Naim HALIMI
DISA DOKE TË LINDJES E RITE TË VDEKJES NË ANËN E KUMANOVËS

Jeton DOKO- NJË DOKUMENT MAQEDONAS KU PËRSHKRUHET SITUATA POLITIKE TE SHQIPTARËT NË OHËR ME RRETHINË

Arsim SINANI- PËRNDJEKJA E FAMILJES DERALLA NGA TETOVA

Petro MARKO - Ç’JEMI NE?
ROBERT DUNIER- FSHATARËT ORTODOKSË SHQIPTARË NË GREQI NË VITIN 1912

Faik KONICA- BORIS SARAFOV - CA KUJTIME DHE CA MENDIME

Robert ELSIE- NJË VJEDHJE NË DUBROVNIK DHE DALJA NË SKENË E GJUHËS DHE E KULTURËS SHQIPTARE
<http://shqiptarja.com/Ripostiglio/oggetti/201504/168523.jpg>

Miron ÇAKO - VESHJA, SHPREHJE E DINJITETIT NJERËZOR

Abla XHAFERI- KONSIDERATA PËR LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ FËMIJËVE RECENSIONE

NJË FJALOR ME GJUHËN SHQIPE NË BULLGARI (Hajri SHEHU)

STUDIM MONOGRAFIK PËR AREALET GJUHËSORE TË RAHOVECIT
(Qemal MURATI)

NJË “TAPI” PËR SHKUPIN ME RRETHINË NDËRMJET DY LUFTËRAVE
BOTËRORE (*Skender Asani, Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore, I-II, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2015, f. 1048*) (Nuridin AHMETI)

ETNOGJENEZA SHQIPTARE E REKËS SË EPËRME

Branko Manojilovski “Reka e Epërme dhe fshati Kiçinicë”, “Tringa Desing”, Tetovë, 2016) (Metush SULEJMANI)

KRONIKA SHKENCORE

Gjuha shqipe në një konferencë për gjuhësinë e korpuseve (Rami MEMUSHAJ)

Revista SCUPI (numri 14 dhe 15)

Gjatë vitit 2016 janë botuar edhe dy numra të revistës shkencore periodike "Scupi". Në numrin 14 me titull "Karnavalet e Bozovcës" janë botuar punimet shkencore të prezantuara më 13 mars në Bozovcë të Tetovës, ndërsa në numrin 15 me titull "Dita e Verës" u botuan punimet shkencore të prezantuara në tribunën shkencore të mbajtur në qytetin e Strugës, me rastin e kësaj feste pagane, e cila është vlerë e trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni.

Aktivitetet e larmishme të ITSHKSH gjatë vitit 2016

Instituti e ka nisur mbarë vitin e kaluar. Që në 22 janar në Shkup promovoi librin “Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, i cili përmban materiale nga konferenca shkencore mbajtur më 5 qershor 2015 në Prishtinë. Në të vërtetë, ky projekt ishte fryt i bashkëpunimit në mes të Institutit të Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Institutit të Historisë – Tiranë dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Promovimin e përshëndeti pinjulli i familjes së Isa Boletinit, z.Gazmend Boletini, i cili theksoi rëndësinë e madhe të këtij libri për historiografinë shqiptare. Më tej, rreth rëndësisë së konferencës shkencore dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, folën drejtori i Institutit të Historisë së Prishtinës, Prof.dr.Sabit Syla, dhe drejtori i ITSHKSH-së, Doc.dr.Skender Asani, të cilët çmuan lartë figurën e Isa Boletinit dhe këtë përmbledhje me materiale shkencore historike. Ndërsa, më hollësisht rreth përmbajtjes së librit, folën Prof.dr.Sabile Keçmezi - Basha nga Instituti i Historisë së Prishtinës, dhe Dr.Sevdail Demiri nga ITSHKSH-Shkup. Në këtë libër me mbi 360 faqe, janë botuar kumtesat shkencore të 24 studiuesve të njohur shqiptarë nga të gjitha trojet etnike shqiptare, duke e ndriçuar figurën e heroit kombëtar Isa Boletini në më shumë aspekte. Libri u botua me rastin e 100 vjetorit të rënies së Isa Boletinit, dhe me rastin e ngritjes së shtatores së tij në Komunën Saraj të Shkupit.

Në mars në Bozovcë të Tetovës tradicionalisht u zhvillua manifestimi tradicional “Karnavalet Ilire”, në shenjë të përfundimit të dimrit dhe fillimit të stinës së verës, në bazë të traditës së vjetër pagane ilire. Me këtë rast, në

bashkëorganizim të ITSHKSH-së dhe organizatorëve të manifestimit, u zhvillua një tribunë shkencore, ku u lexuan disa kumtesa nga studiues të kësaj lëmie nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria. Referatin kryesor e paraqiti studiuesi i folklorit dhe etnokulturës shqiptare, Izaim Murtezani. Më 14 mars, në Strugë u zhvilluan disa aktivitete që lidheshin me Ditën e Verës. ITSHKSH në bashkëpunim me Shoqatën “Liqeri”, organizuan tribunën shkencore me temë “Dita e Verës – vlerë e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve”. Drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani, tha se vlerat tona të lashta kulturore e shpirtërore, duhet kultivuar, meqë ato janë pjesë e traditës dhe të së kaluarës sonë, janë pjesë e identitetit tonë. Gjatë tribunës shkencore u lexuan këto kumtesa: “Dita e Verës – konteksti historik dhe aktual” nga Prof.dr.Izaim Murtezani, “Dita e Verës- relik kulturor në fshatin Patishka-Karshiakë” nga Prof. dr.Bukurie Mustafa, “Festimi i Ditës së Verës në fshatrat Veshalle dhe Bozovcë të Malësisë së Tetovës” nga Prof.dr.Vebi Bexheti, “Simbolika e Ditës së Verës në trevën e Kërçovës” nga Prof.dr.Hamit Xhaferi, “Dita e Verës në trevën e Pellagonisë” nga Prof.dr.Mustafa Ibrahim, “Dita e Verës në Malësinë e Sharrit të Tetovës” nga Neshat Mehmedi, “Dita e Verës – praktika e sotme në fshatrat e Strugës” nga Mr.sc.Rini Useini, dhe “Rëndësia e Ditës së Verës për etnokulturën shqiptare” nga Afet Jashari.

Në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më 18 mars 2016 u mbajt një ligjeratë nga Prof.dr. Haki Kasumi, historian dhe kryetar i Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të Personave të Zhdukur në Kosovë gjatë luftës së fundit. Tema e ligjeratës ishte “Të pagjeturit – një dhimbje e madhe për Kosovën dhe njerëzimin”.

Më 29. mars ITSHKSH, në bashkëpunim me Institutin për Hulumtime Ballkanike në Edirne, në qytetin Edirne të Turqisë, në suaza të manifestimit “Ditë e Kulturës Maqedoni-Turqi”, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH)-Shkup dhe Institutit për Hulumtime Ballkanike (IHB) në Universitetin Thrakia të Edirnesë. Marrëveshja u nënshkrua nga drejtori i ITSHKSH, Dr.Skender Asani, dhe drejtori i IHB, Dr. Ridvan Xhanim, në prani të sekretarit shtetëror të Ministrisë së Kulturës së RM-së, Behixhudin Shehapi, dhe rektorit të Universitetit Thrakia të Edirnesë, Dr.Jener Joruk.

Më 4 prill të vitit 2016 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve në Shkup, promovoi projektin e Prof.dr.Zymer Neziri: “EPOSI I KRESHNIKËVE – monument i trashëgimisë kulturore të shqiptarëve në pesë vende të Ballkanit”. Bartësi i projektit, Prof.dr. Zymer Neziri nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, tha se ky projekt ka zgjatur katër vjet edhe ende vazhdon edhe më tej të rrumbullakohet. Në projekt janë angazhuar rreth 90 mbledhës të folklorit nga të gjitha trevat shqiptare. Materiali i mbledhur në terren është botuar në 15 vëllime si paralibra, të cilat bartin në vete vlera të mëdha të eposit epik shqiptar që nga kohërat më të hershme. Më pas Neziri ia dorëzoi drejtorit të ITSHKSH-së, Dr.Skender Asani për nevojat e Institutit, gjithë materialet e grumbulluara të këtij projekti, në formë elektronike. Rreth eposit të kreshnikëve, folën studiuesit e njohur të kësaj fushe: Prof.dr. Zeqirija Neziri, profesor në Fakultetin Filologjik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, Prof.dr.

Bukurije Mustafa, studiuese në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, dhe Prof. dr. Izaim Murtezani, studiues në Institutin e Folklorit në Shkup. Promovimin e përshëndetën edhe profesorë e studiues tjerë nga Prishtina e Tirana.

Më 13 prill Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Marrëveshja u nënshkrua në ambientet e ITSHKSH-Shkup, nga ana e kryetarit të ASHSH-së, Akademik Muzafer Kërkuçi, dhe drejtorit të ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani.

Më 3. Maj, 2016 me rastin e Ditës së ngadhënjimit kundër fashizmit, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, me në krye Dr. Skender Asani, duke u paraprirë përfaqësuesve të disa institucioneve tjera të rëndësishme të Maqedonisë, qëndroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Atje u prezantuan modelet pozitive të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, si dhe vlerat historike, traditën dhe besën shqiptare, për shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kështu, më 9 maj 2016 në Uashington DC, dhe më 12 maj 2016 në Nju Jork, para opinionit publik amerikan u prezantua ekspozita me temë “Ballafaqimi me të kaluarën – Guximi qytetar në kohë të vështira”. Përmes kësaj ekspozite arkivore, me 34 fotografi dhe dokumente autentike, pasqyrohen realitetet e bashkëpunimit mes komuniteteve në Maqedoni, në rrafshin human, në periudhat më të rënda të Luftës së Dytë Botërore. Drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani, theksoi se “Përmes kësaj ekspozite dhe këtyre aktiviteteve që promovojnë paqen dhe dialogun e ndërsjellë, duam të japim porosinë se vetëm të bashkuar mund ta mundim të keqen”.

Më pas delegacioni vizitoi Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kongresin Amerikan, ku zhvilloi takime edhe me përfaqësues të këtyre institucioneve amerikane. Është vizituar edhe Libraria e Kongresit Amerikan, të cilës drejtori Asani i dhuroi disa nga botimet e fundit shkencore të ITSHKSH-së.

Më 1 qershor 2016, pikërisht në 70 vjetorin e mbajtjes së Kongresit II (IV) të NDSH-së, në Shkup u mbajt konferenca shkencore, në të cilën u paraqitën me kumtesa studiues nga Kosova dhe Maqedonia. Konferenca ishte fryt i bashkëpunimit mes Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Në hyrje të konferencës, fjalë përshëndetëse patën drejtori i ITSHKSH – Shkup, dr. Skender Asani, drejtori i IH – Prishtinë dr. Sabit Sylja, të cilët theksuan rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference, pikërisht në Shkup, këtu ku ishte njëra ndër çerdhet kryesore të organizatës NDSH. Njëkohësisht shprehën gatishmërinë, që edhe më tutje të kontribuojnë në planin shkencor, për zbardhjen e kësaj ngjarjeje me rëndësi historike për të kaluarën tonë. “Atë që e filloi NDSH-ja, në kohërat më të vështira, me një orientim të qartë properëndimor, është obligim i gjeneratës sonë që ta vazhdojmë atë mision kombëtar”, theksoi Asani. Më pas u paraqitën studiuesit me temat e tyre. E para referoi studiuesja nga Prishtina, Sabile Keçmezi-Basha, në temën “Formimi dhe veprimtaria e NDSH-së (1945-1947)”; studiuesi nga Shkupi Qerim Lita referoi në temën: “Organizimi dhe mbajtja e Kongresit II

(IV) të NDSH-së në Shkup”; Skender Asani foli për “Komitetin e NDSH-së për qytetin e Shkupit dhe veprimtarinë e Ibrahim Haki-Kelmendit”; Sabit Sylja dhe Izet Miftari në kumtesën e tyre u përqendruan në “Rezistencën kundër vendosjes së pushtetit komunist në rajonin e Shalës së Bajgores (1944 – 1947)”. Më tej, studiuesi Haki Kasumi referoi për “Veprimtarinë atdhetare të Gjon Serreçit”, kurse Daut Bislimi për “Veprimtarinë dhe ndikimin e Halim Oranës në Kongresin e II-të të NDSH-së”; Ibrahim Gashi poashtu nga Prishtina kishte për temë ”NDSH-në në rajonin e Drenicës”; Izber Hoti për “Organizatën Nr. 2. dhe Ajet Gërgurin”; Naim Halimi u përqendrua në “Historiografinë shqiptare dhe të hauj për dhe rreth NDSH-së”; Nuridin Ahmeti foli për “Kontributin e krerëve fetarë nga Kosova në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare”; Sevdail Demiri për “Arrestimet dhe gjykimet e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së së Kumanovës në vitin 1946/47”, dhe Ismet Kroshi u paraqit me “Dëshmi të reja për aktivitetin e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së për qarkun e Tetovës”.

Gjatë konferencës u zhvillua edhe një debat mjaft konstruktiv, i cili do të ketë impakt në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të kumtesave shkencore, të cilat do të botohen në një nga numrat e ardhshëm të revistës “Scupi” në Shkup. Mjaft me interes ishte pjesëmarrja e familjeve të përfaqësuesve të lartë të NDSH-së, si të Azem Maranës, Gjon Sereçit, Ajet Gërgurit, Ibrahim Haki Kelmendit, Sulë Hotlës, Qemal Skenderit, Jetish Vishit, etj. Ndërsa pasditen e 1 qershorit në oborrin e Sh.F. “Liria” në Komunën Çair të Shkupit, në çerdhen e NDSH-së, u shpaloj një pllakë përkujtimore në nderim të delegatëve të Kongresit II (IV) të NDSH-së: Azem Marana, Qemal Skënderi, Hasan Bilalli, Hysni Rudi, Jonuz Balla, Osman Cami, Halim Orana, Haki Taibi dhe Faik Këpuctari-Prishtina.

Më 21 korrik 2016, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup në Prishtinë nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin universitar AAB. Marrëveshja që u nënshkrua nga drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani dhe prorektori i Kolegjit AAB, Shemsedin Vehapi, e cila ka për qëllim bashkëpunimin e dy institucioneve në promovimin e arsimit e hulumtimeve shkencore nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta.

Më 26 gusht, 2016 në Shkup, pikërisht në vendlindjen e saj, në mënyrë dinjitoze u shënuar ditëlindja e shkupjanes shqiptare, Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza. Fillimisht, në vendin ku ka qenë shtëpia e saj, në sheshin e Shkupit, u vunë kurora lulesh të freskëta nga disa delegacione, si nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë (SHHSHM), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITSHKSH), zëvendëskryeministrat Festim Halili e Arbër Ademi, ambasadorët e Shqipërisë e Kosovës, grupet e deputeteve nga Kosova e Maqedonia, etj. Më pas, në Galerinë Kombëtare të Arteve “Hamami i Daut Pashës” në Shkup, u hap ekspozita me fotografi e dokumente “Shenjtorja nga Shkupi – korrespondenca”, që i kushtohet 106 vjetorit të lindjes së Gonxhe Bojaxhiut, si një aktivitet që paralajmëron edhe shenjtërimin e saj, të paralajmëruar për më 4 shtator të këtij viti. Ekspozita e përgatitur nga SHHSHM, në bashkëpunim me ITSHKSH-Shkup, Institutin Shqiptar në St.Galen të Zvicrës, Arkivin Shtetëror të Lucernit në Zvicër, Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar në Tiranë, Institutin e

Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, dhe Shoqatën Zvicër-Shqipëri, nxjerr në pah aspekte të reja të jetës dhe veprës së shenjtores së ardhshme shqiptare.

Më 21 tetor, 2016 me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së kompozitorit, dirigjentit dhe etnomuzikologut të njohur shqiptar, Lorenc Antoni, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup (ITSHKSH), në bashkëpunim me Postën e Maqedonisë, organizoi tribunë përkujtimore, në të cilën edhe u promovua pulla postare me figurën e Lorenc Antonit. Për jetën dhe veprën e tij folën edhe përfaqësuesi i katolikëve shqiptarë të Shkupit, Anton Sereçi, pastaj Blerim Grubi, profesor pranë Universitetit të Tetovës, njëherit edhe anëtar i Filharmonisë së Maqedonisë, Ermal Mehmeti, etnomuzikolog si dhe gazetarja Dijana Toska.

Mori pjesë edhe vajza Lorenc Antonit, znj. Vilma Antoni– Bejtullahu, ndërsa në emër të familjes të pranishmit i përshëndeti dhëndri i familjes Antoni, z.Naip Bejtullahu. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, ishte pjesë edhe e organizimit të simpoziumit shkencor që mbahet në Korçë më 26 tetor 2016, me temë “SHKOLLA E VASHAVE: FOLEJA KOMBËTARE”. Simpoziumi u mbajt me rastin e 125-vjetorit të hapjes së shkollës së parë të vashave në Shqipëri. Organizatorë ishin Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës, në bashkëpunim edhe me Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani” dhe Institutin për Studime Shqiptare dhe Protestante në Tiranë. Nga ITSHKSH-Shkup, fjalë përshëndetëse pati drejtori Dr. Skender Asani, kurse me kumtesë u paraqit Prof. dr. Qemal Murati, i cili foli në temën “Gramatikë elementare» e Sevasti Qirias Dako – një libër udhëheqës për shkollat filltare”.

Më 1 nëntor u promovuan dy vepra shkencore “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore” me autor Skender Asanin dhe Tokat e liruar 1941-1944” nga Qerim Lita. Dy titujt e rinj i sollti Shtëpia Botuese “Logos A” në bashkëpunim me ITKSH-në. Në këto dy studime dhe hulumtime historike, të cilat u promovuan në Shkup, autorët u sjellin lexuesve dokumente të një periudhe të ndjeshme historike që deri më tani kanë qenë të mbuluara nga pluhuri i arkivave të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore”, siç u shpreh autori i saj, Skender Asani, ka të bëjë me mbijetesën e shqiptarëve si dhe sulmet e ashpra të pushtuesve të ndryshëm ndaj qytetit të Shkupit. Referuesit e librit në fjalë, Nuredin Ahmeti dhe Sevdail Demiri, u shprehën se ky botim është rezultat i një pune hulumtuese disavjeçare të autorit në arkivat e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës duke hulumtuar fonde nga më të ndryshme që ruhen në këto arkiva. Libri “Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore” është me dy vëllime.

Më 20 nëntor, 2016 në Shkup, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, në bashkëorganizim edhe me dy qendrat tjera albanologjike shqiptare: Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës, organizoi konferencën shkencore: “75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore”. Organizimi i kësaj konference shkencore përkoi me tre momente të rëndësishme të historisë së shqiptarëve të këtyre trevave: 108 vjetori i Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir, 75-vjetori i hapjes së shkollave të para shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, si dhe 9-të vjetori i themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Në emër të nikoqirit të konferencës, foli drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, i cili tha se ardhja e arsimitarëve shqiptarë në këto anë, që për herë të parë hapën shkolla shqipe dhe sollën libra shkollorë në gjuhën shqipe, për shqiptarët e Maqedonisë ishte më shumë se vetëm arsim. Punimet e konferencës i përshëndetën edhe drejtori i QSA-së së Shqipërisë, Marenglen Verli, drejtori i IA të Kosovës, Hysen Matoshi dhe drejtori i ISSHP të Tiranës, David Hosaflook. Më pas në dy seanca, mbi 15 studiuës, paraqitën punimet e tyre shkencore, në të cilën e vlerësuan lartë nismën e qeverisë shqiptare të viteve 1941-44, e cila që në fillim ndërmori masa të shpejta për arsimimin e popullsisë shqiptare në Kosovë e në Maqedoninë perëndimore. Me interes u ndoqën kumtesat e historianëve dhe studiuësve, si Beqir Meta, Xhevat Lloshi, David Hosaflook, Qerim Lita, Ragip Gjoshi, Nebi Dervishi, Marenglen Verli, Hysen Matoshi, Sabile Basha, Avzi Mustafa, Xheladin Murati, Tahir Zajazi, Zeqirija Ibrahim, Skender Asani, Sevdail Demiri, Memli Krasniqi, Milazim Elshani, Daut Bislimi, Hamdi Thaçi, Nuridin Ahmeti dhe Isamedin Azizi.

Më 21 nëntor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, me rastin e 9 vjetorit të Institutit, 108 vjetorit të Kongresit të Manastirit dhe 200 vjetorit të protestanizmit tek shqiptarët, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup në bashkëpunim me Institutin e studimeve protestante dhe shqiptare, promovoi tre veprat e rëndësishme, që lidhen me familjen Qiriaz. Me praninë e tij, këtë promovim e madhështoi edhe prezenca e ambasadorit amerikan në Shkup, z.Xhes Bejli. Në fjalën e tij drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani në fjalën e tij u shpreh se “Promovimi i këtyre veprave nuk është promovim i zakonshëm librash, por është një histori e arsimit shqiptar dhe i Rilindjes Kombëtare, duke filluar me hapjen e Shkollës së vashave, para 125 viteve dhe Kongresin e Manastirit, e sidomos në periudhat më të rëndësishme për popullin shqiptar dhe zbardhjen e të vërtetës mbi gjenocidin ndaj shqiptarëve nga fqinjët, serbët dhe grekët dhe sidomos në Konferencën e Versajës, në të cilën Sevasti Qiriaz ishte promotore e ndërlidhjes së çështjes shqiptare dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës”.

Pas vizitave të suksesshme në disa pjesë të Kosovës, më 5, 6 dhe 7 dhjetor 2016, vjen në Shkup Muzeu mobil i Kosovës, i cili para qytetarëve dhe nxënësve të disa shkollave fillore dhe të mesme të Komunës Çair të Shkupit, promovoi disa nga vlerat e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve. Organizator i këtij aktiviteti është Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore i Shqiptarëve (ITSHKSH) në Shkup, në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës dhe Komunën Çair të Shkupit.

Më 6 dhjetor, 2016 në sallën e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, u hap ekspozita e përhershme personale e piktorit me famë botërore, Omer Kaleshi. Në të vërtetë, 24 veprat artistike të Kaleshit, janë dhuratë e vetë piktorit për atdheun e tij. Ato javën e kaluar u ekspozuan në Galerinë Kombëtare të Maqedonisë.

Pjesë e rëndësishme e punës së ITSHKSH-së ka qenë edhe mbarëvajtja e studimeve pasdiplomike, të cilat po vazhdojnë me sukses, ndërsa planifikohet zgjerimi i veprimtarisë arsimore me programe të reja studimore në vitin 2017.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

STUDIME ALBANOLOGJIKE

14

2016

*Kopertina
Imer Bajrami*

*Përpunimi kompjuterik
Besnik Emini*

*Shtypi
Shtypshkronja
"Focus Print" – Shkup*

*Tirazhi:
300 kopje*